



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KUVENDI I SHQIPERISE

AVOKATI I POPULLIT

R A P O R T

**Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit
1 Janar – 31 Dhjetor
Viti 2006**

Tiranë, 19 Shkurt 2007

Fjala e Avokatit të Popullit

E nderuar Zonja Kryetare e Kuvendit te Republikes se Shqiperise Te nderuar deputete

Raporti Vjetor qe kam nderin te paraqes sot para jush eshte i shtati per nga numri. Avokati i Popullit eshte derivat i ketij Kuvendi te nderuar, i cili e ka krijuar ate ligjerisht dhe institucionalisht si nje element te rendesishem ne balancen ndermjet legjislativit, gjyqesorit dhe ekzekutivit. Pervoja jone ka treguar se nuk ka rendesi se si ideja e krijimit te nje Ombudsmeni behet pjese e axhendes politike. Pertej ketij momenti, e rendesishme eshte se si nje zyre e tille arrin te pershtatet ne sistemin ligjor, ne kontekstin social, administrativ dhe historik, pra se si funksionon lidhja e tij me tre pushtetet.

Paraqitja para jush e ketij raporti vjetor nuk eshte thjesht vetem per te treguar se çfare kemi bere dhe si e kemi bere. Natyrisht qe edhe kete vleresim, Ju do ta beni dhe ne dhe do ta mirepresim si çdo vit me pare. Pervec kesaj, ky raport perfaqeson ne vetvete nje instrument ne duart e ketij Kuvendi per te njohur administraten publike dhe qeverisjen ne shkalle vendi, pra ne nivel qendror dhe vendor. Pavaresisht nga shqetesimet individuale te shtetasve tane qe formalizohen nepermjet ankesave dhe kerkesave prane Avokatit te Popullit, te gjitha keto se bashku kane te bejne me ato shqetesime apo probleme te vogla e te medha me te cilat ndeshet sot shoqeria dhe administrata publike shqiptare. Pjesa me e madhe e tyre shkaktohet nga keqadministrimi i detyres apo postit nga zyrtaret e te gjitha niveleve, te shfaqura qe nga mungesa e informimit, si shfaqja me e lehte, deri tek perdorimi i dhunes psikike ose fizike, qe perben veper penale, si shfaqja me e rende e shkeljes se te drejtave dhe lirive themelore te njeriut ne Shqiperi. Ka edhe ankesa apo kerkesa te ligjshme qe shkaktohen nen efektet e korrupsionit, produkt i te cilave eshte pamjaftushmeria e ekonomise per te permbushur nevojat e njerezve, pamjaftushmeria e sigurise per te garantuar qetesine e qytetareve, pamjaftushmeria e drejtesise per te dhene drejtesi apo ndeshkim aty ku ka krim. Te gjitha keto perkthehen ne nje emerues te perbashket qe quhet shtet i varfer per shkak te varferise se shtetasve. Kjo

eshte edhe arsyeja qe instrumentet nderkombetare dhe bota e qyteteruar drejt se ciles synojme te shkojme, nuk e trajton varferine si çeshtje meshire, por si nje plage sociale, perkeqesimi i se ciles rrezikon jo vetem ata qe e vuajne individualisht, por me shume se kaq rrezikon mireqenien dhe sigurine edhe te qytetarëve, duke rrezikuar keshtu ne thelb mirefunksionimin e shtetit. Dhe kete ne shqiptaret e kemi perjetuar ne disa raste ne menyre dramatike shekullin e fundit.

Si Avokat i Popullit, pike e pare e axhendes tone ka qene, eshte e do te jete te moderojme autoritetin qeverises permes mbrojtjes se te drejtave te njeriut, ne emer te individeve dhe grupeve te individeve. Si i tille, Avokati i Popullit lipset te jete ne qender te perpjekjeve te shoqerise per te ballancuar te drejtat dhe detyrat e qytetareve ne raport me detyrimet qe ka shteti dhe instrumentet e tij ndaj tyre. Rekomandimet, propozimet apo kritikate e Avokatit te Popullit, si gjithmone, nuk behen e as duhet te konsiderohen si shfaqje opozitare, por si oponente per mireqeverisje.

Qe ne fillimet e punes se Institucionit gjithmone kemi patur parasysh se sfidat e qeverisjes kane qene sfida edhe per Avokatin e Popullit. I parashikuar si institucion qe synon te permiresoje cilesine e artit te mireqeverisjes, Avokati i Popullit eshte munduar qe me veprimtarine e tij te adresoje pikerisht ato probleme madhore qe kane shqetesuar mirefunksionimin e pushtetit, duke i konsideruar zyrtaret publike si sherbetoret e radhes ne ofrimin e sherbimeve publike si dhe per rritjen e cilesise se jetes se qytetareve.

Te nderuar deputete,

Duke patur parasysh faktin se Shqiperia tashme ka nenshkruar aplikimin per tu pranuar ne nje te ardhme ne nje kontinent te madh, jo vetem ne kuptimin gjeografik, por mbi te gjitha politik, sikunder eshte Bashkimi Evropjan, Avokati i Popullit ka synuar te justifikojte ekzistencen e tij institucionale ne vend jo vetem si nje garant me shume per zbatimin e shtetit ligjor dhe respektimin e te drejtave te njeriut ne Shqiperi. Ne kemi synuar qe me punen tone te tregojme se Shqiperia qysh ne kete faze ka institucione te rendesishme kushtetuese qe permbushin dhe barazohen ne standarte me homologet e tyre europiane.

Fakti i te qenit nen monitorim, afermendsh, askujt, aq me teper administrates shqiptare, mund te mos i pelqeje ne procesin e funksionimit te tij. Kjo, per arsye se performanca qeverisese, sado korrekte, e ndershme dhe transparente te jete, gjithmone ka perballe kerkesat ne rritje nga ana e te qeverisurve. Por ne kete menyre funksionon demokracia, prandaj edhe nuk

mund te cilesohet si rend i persosur, por qe rezulton te jete me i miri nga cfare ka njohur dhe pranuar shoqeria njerezore deri me sot.

Ditet e fundit, ne kuader te 50 vjetorit te Traktatit te Romes dhe pergatitjes se Deklarates se Berlinit, Ombudsmani i Bashkimit Evropjan, Z. Nikiforos Diamandouros i shkruante Kancelares gjermane Zj. Angela Merkel, ne cilesine e Presidences se radhes se BE-se, qe ne Deklaraten ne fjale te behet nje shtese, ku nder te tjera te thuhet: “Promovimi i mireadministrimit meriton nje vemendje te madhe ne axhenden e fokusuar tek qytetaret. Kjo do te thote administrate e orientuar tek qytetaret, administrate e hapur dhe e pergjegjshme, administrate e fokusuar tek rezultatet”.

Avokati i Popullit eshte pikerisht nje nder ata mekanizma monitorues, i cili permes ankesave te perditshme qe merr nga qytetaret, ka per detyre funksionale te trokase fort ne deren e autoritetit publik, per t’i kujtuar ketij te fundit se pavaresisht nga meritat qe e kane sjelle ne ate post apo pozicion, ne fund te fundit qellimi per te cilin e kane vendosur aty, eshte t’u sherbeje qytetareve. Dhe kete çdo zyrtar duhet ta shikoje jo si barre, por si arsye te ekzistences se tij ne ate post apo pozicion.

Te nderuar deputete,

Une besoj se Ju do ta konsideroni dhe perdorni kete raport, edhe si tregues te punes se Avokatit te Popullit, por edhe si nje mjet per te kontrolluar administraten tone dhe standartet mireqeverisese qe ajo ofron. Do te deshiroja gjithashtu qe ky raport te perdorej si nje manual per njohjen dhe zbatimin e praktikave me te mira mireqeverisese per te gjitha nivelet e autoriteteve dhe administrates publike ne Republiken e Shqiperise.

Ju faleminderit.

Avokati Popullit

Tirane, 16 Shkurt 2007

Ermir DOBJANI

PERMBAJTJA

	Faqe
Fjala e Avokatit të Popullit	1
Përmbajtja	4
Hyrje: Avokati i Popullit dhe parimet mbi të cilat ai funksionon	7
Prezantim i shkurtër i Raportit	11

KREU I PARE

1. Struktura, organika dhe cilësitë e personelit të zyrës së Avokatit të Popullit.	13
2. Bashkepunimi dhe mbështetja ndërkombëtare për Institucionin e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2006.	17
3. Buxheti i institucionit për vitin 2006.	22
4. Sfidat dhe objektivat e institucionit për vitin 2006 e në vazhdim.	24

KREU I DYTE

1. Statistika përmbledhëse e vitit 2006.	27
2. Opinione të përgjithshme për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri	30
3. Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë	38
4. Kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese	45
4. Marrëdhëniet e Avokatit të Popullit me publikun dhe median	59
a. Sektori i Pritjes së Popullit	62
b. Ditët e hapura – përvojë për t'u vazhduar	66

5.	Bashkëpunimi me Organizatat Joqeveritare dhe aktivitete të tjera të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2006	67
6.	Konferenca Kombëtare “Të drejta dhe dinjitet të Barabartë për personat me aftësi të kufizuar”.	70

KREU I TRETE

Veprimtaria konkrete e Avokatit të Popullit për ankesat, kërkesat dhe njoftimet, të grupuara sipas institucioneve qeveritare

1.	Këshilli i Ministrave (Qeveria)	80
	a. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare	87
	b. Grupi mbikqyres i firmave piramidale	89
	c. Instituti i të përndjekurve politikë	92
	d. Agjensia e kthimit dhe kompensimit të pronave	93
2.	Ministria e Drejtësisë	95
	a. Burgjet	97
	b. Zyrat e Përmbarimit	114
	c. Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	120
3.	Ankesat për pushtetin gjyqësor dhe administratën gjyqësore.	125
4.	Ankesat për Prokurorinë.	136
5.	Ministria e Brendshme	155
6.	Ministria e Mbrojtjes	224
7.	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.	231
8.	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve.	239
9.	Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës.	272
10.	Ministria e Financave	303
11.	Ministria e Arsimit dhe e Shkencës	316
12.	Ministria e Shëndetësisë	338

13.	Ministria e Punëve të Jashtme	348
14.	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.	352
15.	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave	353
16.	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.	356
17.	Ankesat për Administratën e Shërbimit Informativ Shtetëror	358
19.	Veprimtaria e Nën Seksionit të të Drejtave të Fëmijëve	359

KREU I KATERT

1.	E drejta e Avokatit të Popullit për rekomandime legislative	372
	Pasqyrat 1, 2, 3	374
3.	Çështje të filluara me iniciativën e Avokatit të Popullit (“ex officio”)	401
	Në ndjekje të rasteve të prezantuara në Raportin vjetor 2005	402

ANEKSE

1.	Vlerësime dhe letra falenderimi nga qytetarët	406
2.	Tabela dhe grafikët	410

HYRJE

Avokati i Popullit dhe parimet mbi te cilat ai funksionon

Avokati i Popullit është një institucion ekstra-gjyqësor, lende e parë e funksionimit të të cilit janë ankesat dhe kërkesat e qytetarëve për të rivendosur të drejtat e tyre të shkelura nga administrata publike në tërë piramidën e saj. Duke qenë një mekanizëm që funksionon në terma të kontrollit dhe balancës së pushteteve, synimi i nderhyrjeve të tij nuk është arritja e shpejtë e drejtave, por sa më shpejtë dhe rivendosja e tyre tek titullaret e tyre, që janë as më pak as më shumë se vetë qytetarët ose taksapaguesit e këtij vendi. Duke vepruar në këtë mënyrë, Avokati i Popullit paraqitet si njohës dhe shërues praktik i patologjive shoqërore që historikisht dhe në çdo vend, shoqëron marrëdhëniet individ-administratë. E theksuar në shkoqur, veprimtaria efektive e një institucioni të tillë ushqen çdo ditë besimin e individit tek administrata, dhe për pasojë siguron kohezionin social, arritje të domosdoshme për funksionimin e një demokracie normale. Për këtë arsye, Avokati i Popullit ose Ombudsmeni bëjnë pjesë në ato institucione që janë garante të demokracisë, të shtetit ligjor dhe të të drejtave të njeriut.

Në vendin tonë, Avokati i Popullit u parashikua për herë të parë në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të miratuar më 28 Nëntor 1998. Në 5 nënartikujt e kësaj Kushtetute përcaktohen detyrat, statusi dhe kompetencat e Avokatit të Popullit. Në shkurt të vitit 1999, Kuvendi miratoi Ligjin Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”. Kurse me Ligjin 8600, datë 10.04.2000, bëri një plotësim në nenin 35 të këtij ligji me qëllim që të mbronte pavarësinë e tij nga Qeveria. Pas thirrjes së vitit të veprimtarisë, me propozim të një grupi deputetesh, më 12 Maj 2005, me ligjin nr. 9398, Kuvendi i Shqipërisë miratoi disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për Avokatin e Popullit”, duke forcuar me shumë kompetencat e Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Republikën e Shqipërisë.

Pavarësia institucionale dhe kompetencat e Avokatit të Popullit nuk janë privilegje që i jepen Kreut të Zyrës dhe punonjësve të saj, por garanci

për të vepruar me profesionalizëm dhe përkushtim gjatë ndërmjetësimit midis qytetarit dhe autoritetit publik, kur ky i fundit me veprime apo mosveprime lejon të shkelen të drejtat dhe liritë e individit, të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet.

Ligji për Avokatin e Popullit ka përcaktuar vlerat dhe parimet mbi të cilat vepron ky Institucion, sikunder janë pavarësia, paanshmëria, profesionalizmi dhe konfidencialiteti, të përcaktuara edhe si Parimet e Parisit.

Avokati i Popullit, përmes veprimtarisë së tij, ndikon që të afrojë gjithnjë e më shumë administratën publike me qytetarin, duke synuar ta beje ate sa më transparente. Pertej mbrojtjes se te drejtave te qytetareve nga padrejtësitë dhe abuzimet e administratës ose të nëpunësit publik, Avokati i Popullit zhvillon atë që quhet *kultura e qeverisjes së mirë*, qe do të thotë administrim i mirë, çiltërsi, transparencë dhe llogaridhënie e administratës publike.

Dimensioni i drejtësisë sociale, drejt te cilit orientohet veprimtaria e Avokatit të Popullit ndihmon që individëve t’u krijohen shanse të barabarta, në mënyrë që të mund të trajtohen si të barabartë në çdo marrëdhënie me administratën. Tipar themelor i institucionit të Avokatit të Popullit është pavarësia nga Qeveria dhe nga çdo ndikim politik. Pasi ka siguruar kete, ai mundeson lehtësi kontaktimi, shpejtësi procedimi, fleksibilitet qendrimesh, efektivitet nderhyrjesh. Rekomandimet e tij formalisht nuk janë detyruese. Megjithate, është pikerisht mungesa e forcës detyruese, ajo që kushtëzon edhe praninë sa më të madhe të forcës argumentuese, dhe per pasoje edhe detyrimin moral dhe ligjor te administrates dhe autoriteteve publike per te zbatuar kete rekomandim.

Si në vende të tjera me demokraci në tranzicion, edhe administrata shqiptare nuk mund t’i shpëtojë lehtë psikologjisë së të qenit “monopol sherbimesh”. Tendenca për të diktuar dhe qenë e mbyllur, më tepër se sa për të dëgjuar dhe sqaruar, është e pranishme, sidomos në sjelljen e saj me qytetarët. Per kete aresye, Avokati i Popullit vazhdon të përpiqet për ta bërë publikun të kuptojë se të drejtat e tij përbëjnë detyrim për administratën publike.

Thjesht fakti i ekzistencës së Institucionit të Avokatit të Popullit ka një ndikim pozitiv në administratë, së paku edhe vetëm për arsyen e thjeshtë se kjo e fundit e di se është një palë e tretë që e vëzhgon performancën e saj në raport me qytetarin.

Dihet se Avokati i Popullit nuk është një institucion akuze dhe as gjurmimi ndaj administratës publike në Shqipëri. Për këtë detyrë ka disa organe dhe institucione të tjera të specializuara. Kritikata apo kërkesat tona

për masa ndëshkuese ndaj punës së administratës apo zyrtarëve të veçantë, nuk përbëjnë qëllim në vetvete. Ne kritikojmë veprimet ose mosveprimet e administratës në rekomandimet dhe raportet tona, sikurse veprojnë ombudsmanët në të gjitha vendet. Qëllimi ynë nuk është për të punuar kundër institucioneve publike, por as për të marrë meritat e punës së të tjerëve.

Në vendet e tjera ku ky institucion ka qindra apo dhjetra vite që ekziston është vënë re se Ombudsmeni mund të ndryshojë pozitivisht imazhin e administratës në publik. Edhe tek ne, kjo ka ndikuar për ta bërë administratën shqiptare më të përgjegjshme për cilësitë e vendimeve të saj dhe për përgjegjësitë ndaj publikut.

Çdo zyrë ombudsmeni në botë, sikundër edhe në Shqipëri, faktikisht ndeshet çdo ditë edhe me forma të rezistencës të organeve të administratës apo të autoriteteve publike. Në kushtet tona, kur institucionet ende rezultojnë jo të mësuarat e të konsoliduara me ndërgjegjen e shtetit të së drejtës, kjo është edhe më e dukshme. Por, nëse secili do të udhëhiqet nga parimi demokratik i pushteteve të kufizuara, mendojmë se ekzistojnë hapësira të mjaftueshme për njëri-tjetrin, ku bashkëpunimi të jetë sa më efikas. Fakti që ligja i mundëson Avokatit të Popullit ngritjen e problemit si për kryetarin e komunës, ashtu dhe për ministrin deri në Parlament, tregon qartë se instrumenti ynë kryesor, që është Rekomandimi, kur ka brenda argumentin ligjor, ka edhe forcën reale të “imponimit”. Në kushtet kur kjo bëhet me të vetmin qëllim, për të rivendosur të drejtën e shkelur të qytetarit në raport me administratën, rezultati merr edhe më shumë vlerë, sepse para se të jemi shtetarë, policë, prokurorë apo zyrtarë, të gjithë jemi qytetarë të këtij vendi ndaj të cilit kemi të drejta, por edhe shumë detyrime.

Qëndrimi që administrata mban ndaj rekomandimeve të Avokatit të Popullit është tregues i përgjegjshmërisë së saj ndaj shkeljeve që kryen si edhe i faktit se sa e gatshme është ajo për t’i riparuar ato.

Ky është viti i dytë, kur që prej zgjedhjeve parlamentare të Korrikut 2005, në Shqipëri ka ndodhur rrotacioni demokratik i pushtetit nga partitë e majta tek ato të djathta. Pra ne po punojmë me një administratë qendrore të ndryshme nga mandati ynë i parë. Ne keto kushte ne jo vetëm rideklorojmë, por jemi perpjekur në çdo rast edhe të deshmojmë se Avokati i Popullit në Shqipëri, duke ofruar oponente për mireqeverisje, nuk është në Opozitë me Qeverinë, veçse punon që ajo të realizojë detyrat dhe angazhimet e saj para popullit shqiptar.

Ky ka qënë, është dhe do të jetë thelbi i filozofisë së funksionimit të këtij institucioni jopolitik. Sepse nëse do të zhvendoseshim nga ky thelb, do të komprometoheshin rende parimet themelore, mbi të cilat ai mbështetet.

Kjo eshte edhe filozofia e analizave qe behen ne kete raport, i cili e analizon çdo rast apo ankese nen driten e problematikes se pergjithshme te situates ne vend, sikurse edhe ne kahje per nga praktikat me te mira qe ofrojne legjislacioni nderkombetar dhe veprimtaria e zyrave homologe ne bote.

PREZANTIMI I SHKURTËR I RAPORTIT

Institucioni i Avokatit të Popullit është në vitin e shtatë të punës së tij dhe ky fakt na jep mundësi të reflektojmë mbi arritjet e Institucionit të raportuara në vitet e para si dhe për percaktimin e veprimeve të nevojshme që duhet të ndermarrim për të ardhmen e institucionit. Numri i ankesave të shqyrtuara dhe aktivitetëve të organizuara këto vite, na ka bërë të shohim qartë se çfarë shkon mirë dhe çfarë duhet përmirësuar në të ardhmen në punën tonë në lidhje me marrëdhëniet me administratën publike shqiptare.

Në mbështetje të nenit 26 të Ligjit nr.8454 dt.04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, Avokati i Popullit, ka përgatitur Raportin e 7-të Vjetor, i cili pasqyron veprimtarinë e Institucionit gjatë vitit 2006.

Raporti përmban katër krerë me dy anekse dhe fillon me një fjalë të veçantë të Avokatit të Popullit, në të cilën ai shpreh vizionin e tij për misionin e Institucionit në përballimin e sfidave që kemi përpara si shoqëri dhe si shtet.

Kreu i parë shpjegon shkurtimisht arritjet e Institucionit dhe objektivat e tij për të ardhmen, strukturën, organikën dhe buxhetin. Gjithashtu i kushton vëmendje bashkëpunimit të Institucionit tonë me zyrat homologe dhe pjesëmarrjes aktive të Institucionit të Avokatit të Popullit në aktivitete të ndryshme ndërkombëtare.

Kreu i dytë ka të bëjë me aktivitete të informimit dhe komunikimit të Institucionit të Avokatit të Popullit. Ky kapitull është ndarë në 6 seksione ku një vënd të veçantë zënë opinionet për situatën e të drejtave të njeriut si dhe për mirëqeverisjen në Shqipëri. Një seksion i veçantë i është kushtuar bashkëpunimit me mediat, nëpërmjet të cilave kemi siguruar aksesin e nevojshëm në publik si dhe kemi krijuar individualitetin e domosdoshëm të Institucionit, për ushtrimin e funksionit sipas Kushtetutës dhe Ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Kreu i tretë, i cili zë dhe pjesën më të madhe në raport, ka të bëjë me rastet e trajtuara nga Avokati i Popullit, të ndara sipas ministrive përkatëse dhe organeve të tjera të administratës publike, hetimet e kryera për disa nga rastet dhe rezultatet. Këtu kemi prezantuar dhe mënyrat për zgjidhjen e rasteve tipike dhe të përsëritura, të cilat mendojmë se duhet të shërbejnë si udhërrëfyes për veprimet e organeve përgjegjëse të administratës në situata

të ngjashme. Pasqyrimi i rasteve sipas ministrive perkatëse, është bërë duke mbajtur parasysh strukturën e Keshillit të Ministrave dhe emertimet e reja të disa agjensive. Ky kre gjithashtu përmban rekomandime dhe propozime për eliminimin e shkeljeve dhe padrejtësive, të cilat janë identifikuar gjatë shqyrtimit të ankesave të paraqitura tek Avokati i Popullit. Një vend të veçantë në këtë kre, zë dhe raportimi për veprimtarinë e nënseksionit për fëmijët për vitin 2006.

Kreu i katërt paraqet shkurtimisht rastet e papërfunduara të prezantuara në Raportin Vjetor 2005, shqyrtimi i të cilave ka përfunduar gjatë vitit 2006 si dhe çështjet e filluara me iniciativë nga Avokati i Popullit.

Në këtë kre janë paraqitur për herë të parë gjatë 7 viteve pasqyrat e ligjeve dhe akteve nënligjore normative të shfuqizuara, të plotësuara apo të ndryshuara, sipas rekomandimeve të Avokatit të Popullit për periudhën e viteve 2000-2006.

Në aneksin 1 kemi paraqitur disa nga letrat e falenderimit të qytetarëve drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Aneksi 2 paraqet në mënyrë grafike statistikën e punës së Institucionit.

Në këtë Raport kemi përfshirë edhe shumë analiza të detajuara për ato raste dhe në ato fusha që sipas këndvështrimit tonë përbëjnë elemente kyç dhe të cilave në të ardhmen do t'u kushtojmë më shumë vëmendje.

KREU I PARE

1. Struktura, organika dhe cilësitë e personelit të zyrës së Avokatit të Popullit

Ligji nr. 8600, dt.10.04.2000, “Për disa ndryshime në ligjin 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit””, i jep Avokatit të Popullit të drejtën e përcaktimit të strukturës dhe organikës (numrit të personelit) të tij. Kurse pagat janë caktuar me vendim të veçantë të Qeverisë Nr.500, dt.18.07.2003 “Për miratimin e struktues dhe pagave të punonjësve të Avokatit të Popullit”.

Zyra e Avokatit të Popullit funksionon me tre seksione të specializuara, siç i ka përcaktuar neni 31 i ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”

Seksioni i parë merret me ankesat dhe kërkesat për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre dhe është drejtuar nga z. Gëzim Lleshi.

Seksioni i dytë merret me ankesat dhe kërkesat për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura, prokurorinë dhe pushtetin gjyqësor dhe është drejtuar nga z. Jorgo Dhrami..

Seksioni i tretë, ose seksioni i përgjithshëm, është drejtuar nga z. Riza Poda, trajton çështjet jashtë fushave të mësipërme, ndjek bashkëpunimin me organizatat joqeveritare dhe kryen studime në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Këtu funksionon edhe nënseksioni i fëmijëve.

Hallkë e rëndësishme e strukturës së institucionit është edhe Kabineti, në përbërje të të cilit janë Shefi i Kabinetit dhe këshilltarët, të cilët janë në vartësi direkte nga Avokati i Popullit.

Sektorët mbështetës që ndihmojnë në realizimin e detyrave kryesore të Institucionit janë Drejtoria e Informacionit, Marrëdhënieve me Publikun dhe me Jashtë dhe Drejtoria e Personelit dhe Administrates, te cilat jane ne varesi direkte te Sekretarit te Pergjithshem. Pjese të rëndësishme të këtyre drejtorive, jane Sektori i Informacionit dhe Pritjes së Popullit, dhe Sektori i

Financës. Kjo strukture e cila është percaktuar nga Avokati i Popullit ka rezultuar e efektshme, në përputhje me prioritetet e vendosura për vitin 2006.

Kuvendi në ligjin për Buxhetin e Shtetit për vitin 2006 ka miratuar 45 punonjës dhe po kaq kanë qenë të punësuar. Nga këta janë 17 juristë që quhen ndihmëskomisionerë, të cilët merren direkt me zgjidhjen e ankesave, Juristë janë edhe Shefi i Kabinetit, 2 këshilltarë, 3 komisionerët dhe vetë Avokati i Popullit.

Në Korrik 2006, Kuvendi miratoi me shumicë të thjeshtë ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”. Nenet, 1/1, 4, 7/2, 9, 10/1,2 dhe 20 të këtij ligji, prekin në mënyrë direkte pavarësinë e Institucionit të Avokatit të Popullit dhe nuk marrin parasysh parashikimet e bera në ligjin organik të Institucionit të Avokatit të Popullit, si institucion i pavarur kushtetues. Ky është një ligj që është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me shumicë të thjeshtë. Kurse ligji “Për Avokatin e Popullit” është ligj që është miratuar me shumicë të cilesuar, në bazë të gërmes “a” të pikës 2 të nenit 81 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ky fakt është në ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006, të pazbatueshëm. Për më tepër, dispozitat e sipërcituara të ligjit nr. 9584, datë 17.07. 2006, janë të papajtueshme me Kushtetutën. Për këtë arsye në datën 03.10.2006, bashkë me Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit i kemi drejtuar Gjykatës Kushtetuese me një kerkese për të deklaruar si të papajtueshëm me Kushtetutën nenet e cituara më lart të ligjit në fjalë. Për më tepër lexoni në faqen 53 në këtë raport.


Një element i rëndësishëm i cili është lidhur me strategjinë e Avokatit të Popullit, është dhe rritja e vazhdueshme e kapaciteteve të institucionit.

Pjesëmarrja në trajnimet e ndryshme të ndihmëskomisionerëve dhe e punonjësve të tjerë të Administratës, ka ndihmuar në ngritjen e tyre profesionale, gjë kjo që vërtetohet edhe me pajisjen e tyre me certifikatat e marra nga Instituti i Trajnimit të “Departamentit të Administratës Publike”. 5 anëtarë të stafit kanë fituar titullin Master dhe 2 të tjerë janë në proces të fitimit të këtij titulli.

Kurse 5 juristë të tjerë aktivizohen për mësimdhënie si pedagogë të jashtëm në Fakultetet e Drejtësisë dhe në Shkollën e Magjistraturës.

Pjesa më e madhe e specialistëve të Zyrës së Avokatit të Popullit zotërojnë dhe përdorin mirë një ose më shumë gjuhë të huaja, kryesisht anglisht, frëngjisht, italisht, rusisht, gjermanisht etj.

STRUKTURA E INSTITUCIONIT TE AVOKATIT TE POPULLIT



Pasqyra nr.2

ORGANIKA E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT

Nr.	EMËRTIMI	NËPUNËS
I.	AVOKATI I POPULLIT	(1)
II.	KABINETI Shefi i Kabinetit + Zëdhënës i Avokatit të Popullit Këshilltarë të Avokatit të Popullit Sekretare e Avokatit të Popullit	(5) 1 3 1
III.	SEKSIONI I ORGANEVE TË ADMINISTRATËS QENDRORE DHE VENDORE Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Sekretare + Rregjistruese	(8) 1 6 1
IV.	SEKSIONI I SHËRBIMEVE TË VEÇANTA Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Sekretare + rregjistruese	(8) 1 6 1
V.	SEKSIONI I PËRGJITHSHËM Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Nënseksioni për Fëmijët (Ndihmëskomisioner) Sekretare + rregjistruese	(7) 1 4 1 1
VI.	SEKRETARI I PËRGJITHSHËM	(1)
VII.	DREJTORIA E INFORMACIONIT, MARREDHENIEVE ME PUBLIKUN DHE ME JASHTË Drejtor Shef Sektori Specialist Arkivist+Sekretare e Sekretarit të Përgjithshëm	(5) 1 2 1 1
VIII.	DREJTORIA E PERSONELIT, ADMINISTRATËS DHE FINANCES Drejtor Shef Sektori Specialist Shofer Pastrues	(10) 1 2 1 4 2

Punonjës gjithsej të Institucionit të Avokatit të Popullit janë 45 veta

2. Bashkëpunimi dhe mbështetja ndërkombëtare për Institucionin e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2006

Marredheniet me Jashtë të Avokatit të Popullit janë zhvilluar kryesisht në tre drejtime. Se pari, në shkëmbimin online të informacioneve mbi zhvillimet e forumeve ndërkombëtare të familjes së Ombudsmanit dhe të Institucioneve Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (marredhenie shumëpaleshe). Se dyti, në shkëmbimin e vizitave njohëse dhe trajnimeve me zyrtarë homologë (marredhenie dypaleshe). Se treti, në pjesëmarrjen në konferenca, seminare, tavolina të rrumbullakta etj. ku diskutohet për të drejtat e njeriut dhe veprimtarinë e Ombudsmanëve apo institucioneve kombëtare të kësaj natyre.

Marredheniet me Jashtë të Avokatit të Popullit kanë konsistuar në prezantimin e arritjeve të zyrës sonë, sikurse dhe të perpjekjeve që bëhen shteti shqiptar për të përmbushur standartet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, një nga të cilat është ngritja dhe konsolidimi i institucionit të Avokatit të Popullit apo Ombudsmanit.

Një drejtim tjetër i marredhënieve me faktorin ndërkombëtar është edhe bashkëpunimi me organizmat vepruesë në Shqipëri, interesimi i të cilave për shtetin ligjor dhe të drejtat e njeriut është tejet i artikuluar. Kështu mund të përmendim bashkëpunimin e vazhdueshëm me Departamentin Amerikan të Shtetit, përmes Ambasades Amerikane në Tiranë, për përditesimin e Raportit Vjetor të këtij Departamenti për të Drejtat e Njeriut. Fale besueshmërisë së shfaqur në veprimtarinë e Avokatit të Popullit, Ambasada Amerikane në Tiranë e konsideron Avokatin e Popullit si një ndër filtrat informativ, të vlefshëm për referim në rastet e shumë trajnimeve që kjo ambasada ofron për nepunësit dhe autoritetet publike shqiptare, duke afishuar me këto rast si standart sjelljen dhe figurën e tyre për sa i përket rekordit të shkeljeve të mundshme të të drejtave të njeriut. I tillë është edhe bashkëpunimi me Zyren e OSBE-së në Tiranë për probleme të ndryshme që lidhen me respektimin e të drejtave të njeriut dhe standartet e shtetit ligjor.

Institucioni i Ombudsmanit, forcohet më shumë dhe zhvillohet më tej edhe përmes bashkëpunimit me zyrtarë homologë si dhe pjesëmarrjes aktive në forumet ndërkombëtare, cilësuar joformalisht si Familja Ndërkombëtare e Ombudsmanit.

Avokati i Popullit është aktualisht anëtar me të drejta të plota i Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanit (IOI), i Ombudsmanit Europian (EOI), Shoqatës së Ombudsmanit dhe Mediatorit Frankofon (AOMF), Shoqata e Ombudsmanit të Shteteve të Bashkuara (USOA) dhe (TOA). Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga anëtarësia, Avokati i Popullit i

realizon përmes pjesëmarrjes në aktivitete si brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

I. Aktivitete te organizuara nga Keshilli i Europes:

1. Avokati i Popullit, mori pjese ne seminarin me teme “Mbikqyrja e Policise nga Ombudsmani” organizuar me 1-3 qershor 2006 ne ishullin Syros, Greqi, nga Keshilli i Europes ne bashkepunim me Zyren e Ombudsmanit te Greqise, mbeshtetur nga Programi Eunomia. Qellimi i ketij seminari ishte shkembimi i pervojes dhe diskutimi i games se gjere te ceshtjeve qe Ombudsmani has ne punen e tij te perditshme lidhur me ankesat e qytetareve ndaj organeve te policise.

2. Nje perfaqesues i Institucionit te Avokatit te Popullit mori pjese ne seminarin me teme “Ombudsmani si Mediator ne Proceduren Administrative”, organizuar nga Ombudsmani Grek me mbeshtetje te programit EUNOMIA te Keshillit te Europes, ne Oher, Maqedoni, me 14-17 shtator 2006. Pjesemarresit shkembyen pervojat per ankesat e shqyrtuara prej tyre ndaj administrative te vendeve perkatese.

3. Me 29-30 Shtator 2006, Komisioneri per te Drejtat e Femijeve te Avokatit te Popullit mori pjese ne Konferencen me teme “Puna e Ombudsmanit per Femijet”, bashke-organizuar nga Komisioneri per te Drejtat e Njeriut te Keshillit te Europes dhe Ombudsmanet per te Drejtat e Njeriut te Federates Ruse, dhe te Republikes se Greqise. Kjo konference u organizua pikerisht 6 muaj pas hapjes se fushates se re 3 vjecare te Keshillit te Europes “Te ndertojme nje Europe per femijet dhe me ata”. Konferenca u fokusua kryesisht ne sfidat thelbesore qe dalin per Ombudsmanin ne fushen e mbrojtjes se te drejtave te femijeve.

4. Nje perfaqesues nga Institucioni i Avokatit te Popullit mori pjese ne Seminarin nderkombetar me teme “Liria e organizimit dhe grumbullimit – burimet, parimet dhe implementimi i duhur ne praktike” organizuar nga Komisioni per Demokraci nepermjet Ligjit (Komisioni i Venecias), me 27-30 nentor 2006, ne Trieste, Itali.

Qellimi kryesor i ketij seminari ishte te realizonte shkembimin e eksperiencave te vendeve te ndryshme, njohjen dhe krahasimin e legjislacioneve perkatese dhe te rekomandimeve te Komisionit te Venecias sikurse dhe njohjen e praktikave te fundit te Gjykates se Strasburgut lidhur me interpretimin dhe zbatimin e nenit 11 te Konventes Europiane te te Drejtave te Njeriut mbi lirine e grumbullimit dhe organizimit.

II. Aktivitete te organizuara nga Organizata e Kombeve te Bashkuara (OKB)

1. Nje perfaqesuesi i Zyres se Avokatit te Popullit mori pjese ne Tavolinen e Rrumbullaket te Institucioneve Kombetare per te Drejtat e Njeriut me teme "Roli i Institucioneve Kombetare per te Drejtat e Njeriut ne Procedurat qe ndjekin Organizmat Nderkombetare te Traktateve", organizuar nga Zyra e Komisionerit te Larte per te Drejtat e Njeriut te Kombeve te Bashkuara ne bashkepunim me Institutin Gjerman dhe ate Danez per te Drejtat e Njeriut, me 26 tetor 2006, ne Berlin.

Objektivi i kesaj Tavoline ishte roli qe duhet te luajne Institucionet Kombetare per te Drejtat e Njeriut ne kuader te dhenies se mendimeve dhe asistences se nevojshme gjate pergatitjes dhe paraqitjes se raporteve te shteteve apo ndjekjes se rekomandimeve te institucioneve nderkombetare nga shtetet pale.

III. Aktivitete te organizuara nga Bashkimi Europian

1. Me 20-22 nentor 2006, Avokati i Popullit mori pjese ne Konferencen Nderkombetare me teme " Bashkepunimi me Ombudsmanin - Faktor i Rendesishem per Zhvillimin e Demokracise", organizuar nga Bashkimi Europian - Njesia e Ndertimit te Institucioneve (TAIEX) ne bashkepunim me Zyren e Ombudsmanit te Republikes se Maqedonise.

Objektivi i kesaj Konference ishte shkembimi i eksperiencave lidhur me luften ndaj keqadministrimit si dhe forcimi e pozicionit te Ombudsmanit si nje mekanizem kontrolli per nje qeverisje te mire.

IV. Aktivitete te organizuara ne bashkepunimi me OSBE-ne

1. Gjate vitit 2006, dhe respektivisht nga 20 Janar deri me 4 Dhjetor, Zyra e Avokatit te Popullit ka bashkeorganizuar dhe realizuar me Prezencen e OSBE-se ne Tirane, nje projekt lidhur me njohjen dhe sensibilizimin e Administrates Publike Shqiptare, ne nivel vendor, mbi paketen ligjore qe permbledh Ligjin per te Drejten e Informimit te Publikut me Dokumentet Zyrtare, Ligjin per Mbrojtjen e te Dhenave Personale si dhe Ligjin per Ruajtjen e Dokumentacionit te Klasifikuar.

Nga ana e Avokatit te Popullit, ne realizimin e ketij projekti u angazhua Kabineti, kontributi i te cilit ka konsistuar ne shpjegimin e paketes ligjore ne teresi, duke u ndalur ne veçanti ne Ligjin per te Drejten

e Informimit dhe veprimtarine e Avokatit te Popullit ne zbatim te ketij ligji.

Projekti ne fjale eshte realizuar ne 11 Qarqe te Republikes, dhe konkretisht sipas radhes, ne ate te Beratit, Fierit, Elbasanit, Vlores, Gjirokastrës, Lezhes, Shkodres, Kukesit, Durresit, Peshkopise dhe Korçes, duke perfshire ketu thujse te gjitha njesite vendore ne perberje te tyre, dhe kerkuar marrjen e masave per ngritjen e infrastruktures se nevojshme qe kerkon zbatimin e Ligjit per te Drejten e Informimit.

2. Nje perfaqesues i Avokatit te Popullit mori pjese ne Tavolinen e Rrumbullaket me teme “Legjislacioni qe rregullon apo ndikon ne lirine e grumbullimit ne disa Shtetet Europiane: Sfidat dhe Mesimet perkatese”, organizuar ne Beograd, nen kujdesin e Misionit te OSBE-se ne Serbi dhe Mal te Zi, me 28 qershor 2006.

V. Konferenca te tjera nderkombetare:

1. Avokati i Popullit mori pjese ne Konferencen e Ombudsmaneve te vendeve anetare te Bashkimit Ekonomik te Detit te Zi, organizuar nga Asambleja Parlamentare e Bashkimit Ekonomik te Detit te Zi(PABSEC) ne Stamboll, me 26-27 prill 2006, me teme: Roli i Ombudsmanit ne Konsolidimin e Demokracise.

Synimi i kesaj Konference nder te tjera, ishte te promovonte kontributin e Ombudsmanit per bashkepunimin ekonomik, politik dhe kulturor midis popujve te vendeve anetare per te kontribuar ne kthimin e rajonit te Detit te Zi ne nje zone me stabilitet, te begatshem dhe paqesor, si nje pjese perberese e arkitektures se re Europiane.

2. Me 11-14 qershor 2006, Avokati i Popullit mori pjese ne Konferencen Vjetore te Ombudsmanit dhe Asamblene e Pergjithshme te Institutit te Ombudsmanit Nderkombetar- Rajoni Europian, organizuar ne Viene, nen kujdesin e Bordit te Ombudsmaneve Parlamentare te Austrise.

3.Me ftese te Ombudsmanit grek per te Drejttat e Femijeve, nje Komisioner i Avokatit te Popullit mori pjese ne Konferencen Vjetore te Rrjetit Europian te Ombudsmaneve per te Drejttat e Femijeve qe u zhvillua ne Athine me 26-28 Shtator 2006 me teme: “Te luftojme diskriminimin ne edukim”. Kjo konference u dha mundesi pjesemarrsesve te diskutonin mbi ceshtjet e politikave anti-diskriminuese dhe sistemet e monitorimit, te mjeteve edukative dhe te masave ne mbeshtetje te integritimit te femijeve me nevoja te vecanta etj. Pjesemarrsesit shkembyen idete dhe eksperienat e tyre duke identifikuar praktikat me te mira te punes se perditshme te tyre.

4. Nje perfaqesues nga Institucioni i Avokatit te Popullit, nenseksioni i femijeve, mori pjese ne Seminarin me teme “Te drejttat e

femijeve me aftesi te kufizuar”, organizuar nga Instituti Nderkombetar per te Drejtat e Femijeve ne bashkepunim me Pro Infirmis, me 10-14 tetor 2006, ne Sion, Zvicer.

Qellimi i ketij seminari ishte te prezantonte me qarte realitetin e jetuar te femijeve me aftesi te kufizuar, duke sjelle ne vemendje situata specifike dhe duke identifikuar shkaqet dhe ofruar njekohesisht sinergjine e mundshme dhe partneritetin e aktoreve nderkombetare ne kete fushe.

VI. Vizita te Autoriteteve Nderkombetare ne Shqiperi

Me 22-24 maj 2006 erdhi per nje vizite zyrtare prane Zyres tone ne Tirane, ish Senatori i Shteteve te Bashkuara te Amerikes, Kryetar i Bordit te Qendres Nderkombetare per Femijet e Humbur dhe te Shfrytezuar, Z. Denis DeConcini.

Gjatë vizitës se tij ai u njoh nga afër me punën e Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri dhe u prit nga autoritetet më të larta të Shtetit Shqiptar. Permendim ketu takimin me Kryeministrin e Shqiperise, Z. Sali Berisha dhe Ministrin e Drejtesise.

VII. Vizitat e Avokatit te Popullit ne zyrat e Ombudsmaneve te vendeve te tjera.

1. Me ftese te Zyres se Puneve te Jashtme dhe Commonwealth-it ne Londer, dhe nen kujdesin e Ambasadorit te Mbreterise se Bashkuar te Britanise se Madhe dhe Irlandes se Veriut, ne Tirane, Z. Richard Jones, Avokati i Popullit, Z. Ermir Dobjani, i shoqeruar nga dy anetare te stafit, moren pjese ne nje vizite studimore me 23-26 janar 2006. Ne takimet e bera ne zyren e Ombudsmanit per Ceshitet Parlamentare dhe te Shendetit, me Ombudsmanin e Pushtetit Vendor, ne Komitetin e Standarteve ne Jeten Publike dhe me Zv/Ombudsmanin e Burgjeve dhe Lirimit me Kusht etj. u vendosen urat e bashkepunimit me keto institucione britanike gje qe perbente edhe nje nga synimet e kesaj vizite studimore. Perfaqesuesit e ketyre Institucioneve treguan gadishmerine e tyre per te realizuar ne te ardhmen trajnime te stafit profesional te Zyres se Avokatit te Popullit prane zyrave te tyre.

2. Avokati i Popullit beri nje vizite zyrtare ne Viene, Austri, me 15-17 Maj 2006, ne kthim te vizites zyrtare qe Ombudsmani Parlamentar i Republikes se Austrise, Zv/President i Institutit te Ombudsmanit Nderkombetar per Europen, Z. Peter Kostelka, beri ne Tirane ne vitin 2005. Bisedimet u perqendruan ne rritjen e bashkepunimit dhe shkembimit te pervojave midis dy zyrave, me interesim te veçante rritjen e efikasitetit te Institucionit te Avokatit te Popullit ne Shqiperi. Ne vijim

jane planifikuar per vitin 2007 disa trajnime per stafin profesional te Avokatit te Popullit.

Gjate vizites ne Austri, Avokati i Popullit u prit nga autoritete te larta te Shtetit te Austrise.

VIII. Vizita studimore te stafit te zyres se Avokatit te Popullit

Me 8-12 Maj 2006, pese anetare te Nenseksionit te Femijeve te Institucionit te Avokatit te Popullit moren pjese ne nje vizite studimore ne Suedi, financuar nga Organizata "Save the Children" ne Shqiperi.

Qellimi i kesaj vizite studimore ishte te prezantoheshin procesi i vendimmarrjes ne favor te te drejtave te femijeve, metodat per nje komunikim te drejtperdrejt apo indirekt me femijet, metodat per edukimin e zyrtareve publike me Konventen e Organizates se Kombeve te Bashkuara per te Drejtat e Femijeve si dhe perspektivat per te drejtat e femijeve.

IX. Avokati i Popullit ndan pervojen e tij ne Jordani

Me 20-23 Janar 2006, nje perfaqesues i Institucionit te Avokatit te Popullit u ftua te merrte pjese ne diskutimet dhe te jepte mendime dhe sugjerime lidhur me projekt - ligjin e parapergatitur per ngritjen e Institucionit te Ombudsmanit ne Jordani. Ky është një projekt që ndiqet nga Zyra e Ombudsmanit të Mbretërisë së Danimarkës, por që është ndërprerë për momentin. Në këtë projekt danez, zyra jonë shërben si shembull i implementimit të ndihmës daneze për ngritjen dhe konsolidimin e institucioneve të reja demokratike.

3. Buxheti i Institucionit për vitin 2006

Per të funksionuar me efikasitet një institucion, kërkohet jo vetëm mbështetje politike, institucionale, potenciale njerëzore, por dhe mbështetje financiare. Mbështetja financiare për Institucionin e Avokatit të Popullit, realizohet nga buxheti i shtetit në përputhje me ligjin "Per hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit". Në nenin 36 të ligjit "Për Avokatin e Popullit", parashikohet se: "Mjetet financiare të Avokatit të Popullit përballohen nga buxheti i shtetit ku Avokati i Popullit ka një kre të veçantë. Projekt buxheti propozohet nga Avokati i Popullit në Komisionin e Përhershëm të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit, i cili e paraqet për miratim në Kuvend, në përputhje me ligjin "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit". Avokati i Popullit duhet të përgatisë

çdo vit llogaritë e veta, në përputhje me ligjin “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit”. Llogaritë financiare të Avokatit të Popullit kontrollohen nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

Mbi këtë bazë ligjore, kemi kërkuar nga organi kompetent, të na akordohej për vitin 2006, një buxhet prej 107.000.000 lekë. Por, buxheti që na u vu në dispozicion për zërin “shpenzime operative”, ishte 40% më i ulët se ai i kërkuari. Konkretisht Institucionit të Avokatit të Popullit, i është dhënë një buxhet në shumën 76.600.000 lekë, i cili për periudhën objekt raportimi është konsumuar në masën 99% e konkretisht:

Nr. Llo.	Emërtimi	Plan lekë	Realizim lekë	Realiz. %
600	Pagat	44.600.000	44.572.484	100%
601	Sigurim shoqëror	10.000.000	9.474.777	95 %
602	Shp operative	16.650.000	16.649.154	100%
605	Kuotë anëtaresie	350.000	172.676	49%
231	Investime	2.967.000	2.882.929	97%
230	Hartim Projekti	2,033,000	1,980,000	97%
	Totali	76,600,000	75.732.020	99%

Përsa i përket shpenzimeve të buxhetit ato janë përdorur për paga, sigurime shoqërore dhe dieta për punonjësit, blerje kancelerie, shpenzime për energji elektrike, shpenzime telefoni, shpenzime poste, shërbim telegrafik, abonime gazetash, riparime automjetesh etj. Faktikisht ky buxhet ka qenë i pamjaftueshëm për të realizuar si duhet detyrën tonë, sidomos për të verifikuar në vend në qytete e fshatra ankesat e qytetarëve, për të organizuar më tepër “ditë të hapura”, për më shumë inspektime, botime etj.

Në lidhje me kuotat e anëtarësisë ne bëjmë pagesën në Institutin European të Ombudsmanëve, Institutin Ndërkombëtar të Ombudsmanëve, Shoqatën e Ombudsmanëve Frankofonë, Shoqatat e Omudsmanëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës USOA dhe TOA.

Në gusht 2006, në mbështetje të vendimit nr. 408 date 21.06.2006 të Këshillit të Ministrave, Institucioni i Avokatit të Popullit i kaloi zyrat e tij në ambjentet e ndodhura në ish ndërtesën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Energjistikës. Realizimi i transferimit të zyrave kishte një kosto, e cila nuk ishte parashikuar në buxhetin e vitit 2006, në zërin “shpenzime operative”. Kjo gjë bëri që Institucioni të vihej në vështirësi të mëdha financiare. Po kështu, për rehabilitimin e zyrave duheshin 45,000,000 lekë dhe megjithë kërkesat e njëpasnjëshme të Avokatit të Popullit në Ministrinë e Financave për akordimin e një shtese buxheti për vitin 2006, në zërin “shpenzime operative” dhe “investime” për shkak të shpenzimeve

të nevojshme për transferimin e Institucionit dhe rikonstruksionin e ambienteve të caktuara për ne situata nuk ndryshoi. Asnjë shtesë nuk u miratua për Institucionin e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2006.

Për vitin 2007 janë akorduar 40 milion lekë për rehabilitimin e zyrave.

4. Sfidat dhe objektivat e Institucionit për vitin 2007 e në vazhdim

Ajo që ka më shumë rëndësi është mirëfunksionimi i institucionit të Avokatit të Popullit dhe efikasiteti i nderhyrjeve të tij. Duke ndjekur ankesat rast pas rasti, ne kemi rekomanduar masa administrative dhe dhënë opinione për parandalimin e shkeljeve nga Administrata Publike në të ardhmen.

Sfidat dhe objektivat e Avokatit të Popullit janë gjithmone komplementare me sfidat dhe objektivat e qeverisjes në nivel qendror dhe lokal. Kjo për arsye se tranzicioni shqiptar ngelet gjithnjë me të njejtat ulje dhe ngritje, e për pasoje problemet e njerezve mbeten gjithnjë të njejtë, pavaresisht nga shkalla e virulences së tyre.

Në keto kushte, edhe për të ardhmen, ne do të vazhdojmë t'u kushtojmë vëmendje të veçantë këtyre objektivave:

1. Nxitja e nismave ligjvënese të deputetëve, për të bërë rregullimet e duhura ligjore sipas rekomandimeve tona si dhe informimi intensiv i Parlamentit për problematika specifike, sikunder janë ato që kemi bërë e do të vazhdojmë të bëjmë lidhur me shërbimet e KESH sha apo të shërbimeve telefonike.

2. Rritja e efikasitetit të nderhyrjeve të Avokatit të Popullit, duke përdorur me shume kopetencat që na japin ndryshimet ligjore të aprovuara nga Parlamenti Shqiptar në Maj 2005.

3. Rritja e vëmendjes për ndjekjen e rasteve me vetiniciativë, fokusuar në mbrojtjen e të drejtave që prekin grupe të mëdha njerëzish apo grupet më në nevojë e më të prekshëm, pa përjashtuar rastet individuale të bera publike nga media.

4. Bashkëpunimi me efikas i Zyrës për trajtimin e rasteve të personave të zhdukur, jo vetëm për të krijuar një regjistër të plotë dhe një rrjet bashkëpunimi me ministritë e linjes dhe prokurorinë, me përfaqësitë shqiptare jashtë vendit, me zyrat homologe si dhe me organe të medias investigative, por për të sjellë rezultate të prekshme për fatin e këtyre individëve dhe familjeve të tyre.

5. Angazhimi me energjik për zbatimin e Rregullores së unifikuar tashmë, për të drejtën e informimit të publikut me dokumentet zyrtare,

duke i rekomanduar Qeverisë që t'i japë fuqi detyruese asaj për zbatim nga gjithë administrata publike.

6. Trajnimi intensiv i stafit dhe konkretizimi i përvosjes së grumbulluar për krijimin e Rregjistrimit të trajtimit të të dhënave personale, siç e kërkon neni 15 i ligjit 8517 datë 22.7.1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

7. Bashkëpunimi me OJF-te dhe median për rritjen e presionit pozitiv mbi administratën ka qenë dhe mbetet një kusht i domosdoshëm dhe jetik për vetë ekzistencën e Avokatit të Popullit, me synim ngulitjen e praktikave të mira administrative.

8. Vazhdimi i praktikës së suksesshme të ditëve të hapura në mënyrë periodike në zona të ndryshme të vendit, por edhe për të gjetur e zbatuar edhe forma të tjera për t'ju afruar sa më shumë publikut.

9. Publikimi më mirë dhe më shumë i problemeve kryesore të evidentuara nga shkeljet e Administratës Publike në fushën e të drejtave të njeriut. Krahas kësaj, Avokati i Popullit synon të vazhdojë botimin e Gazetës së tij, e cila do të promovojë më mirë veprimtarinë konkrete dhe profilin e Institucionit. Pasurimi i përditshëm i faqes tonë në Internet do të jetë një përparësi.

10. Konsolidimi i nënseksionit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, duke e bërë atë me të prekshëm dhe me të ndjeshëm, pa u justifikuar me faktin se është njësi e re dhe deri tani e kushtëzuar nga financimi i programit SIDA të Qeverisë Suedeze, nën kujdesin e organizatës Save the Children në Shqipëri.

11. Rritja e forcës funksionale të dy zyrave rajonale në Shkoder dhe Korçë, duke realizuar kështu një shtrirje organizative gjeografike të Institucionit.

12. Vazhdimi i bashkëpunimit me strukturat qeverisëse të shtetit të tona për rritjen cilësore të raportimeve pranë organizmave ndërkombëtare. Kjo do të bëhet si në përditësimin e raporteve të paraqitura nga pala shtetërore, ashtu edhe të njohjes me raportet alternative, të përgatitura nga organizmatë shoqërisë civile.

13. Krijimi i një grupi të tipit "task force" për të rritur racionalitetin e shpërndarjes dhe menaxhimit të rasteve në varësi të rritjes së volumit të punës, duke zbatuar me shpesh teknikën e mediacionit në punën tonë.

14. Ruajtja e qëndrueshmërisë teknike, pavarësisht se kjo është e kushtëzuar kjo deri diku edhe nga ajo financiare. Rrjeti ynë i sistemit kompjuterik kërkon mirëmbajtje të vazhdueshme, prandaj do vazhdojë të ketë përparësi

15. Sigurimi i financimeve nga bashkëpunimi me partnere ndërkombëtare, i cili do të ndikonte pozitivisht në qëndrueshmërinë financiare të institucionit, pasi shteti shqiptar është i detyruar të ndjekë

një politikë të rreptë në shpenzimet operative, përmes shkurtimit të buxhetit, dhe nga kjo nuk pretendojmë të privilegjohemi vetëm ne. Sidoqoftë, ritmet e deritanishme të suksesit, veç përkushtimit të stafit drejtues dhe të specialistëve, janë kushtëzuar në një masë thelbësore edhe nga hetimet në vend që kanë shumë shpenzime.

Garanci për përballimin e këtyre sfidave dhe të tjerave që lidhen me to është përvoja e deritanishme si dhe ndërgjegjësimi në rritje i organeve të administratës publike për përmbushjen e standarteve të mirëqeverisjes.

KREU I DYTË

1. Statistika përmbledhëse e vitit 2006

(Rastet sipas fushave përkatëse dhe mënyra e përfundimit të tyre)

Nëpërmjet ushtrimit të funksioneve të tij, Avokati i Popullit ka synuar të rrisë efektivitetin e zyrës dhe në të njëjtën kohë të promovojë shtetin e së drejtës, mirëqeverisjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Shqyrtimi i ankesave të adresuara për Institucionin e Avokatit të Popullit na ka bërë të njohim problemet e qytetarëve jo vetëm në Tiranë, por në të gjithë vendin dhe të ndërmarrim iniciativa për të rritur në maksimum shërbimin ndaj tyre.

Ne kemi nënvizuar dhe në raportet e mëparshme se qëllimi i Institucionit të Avokatit të Popullit është që t'i sigurojë gjithë qytetarëve që i drejtohen atij, të marrin ndihmën ose këshillat e nevojshme në kohën dhe mënyrën e duhur. Tashmë është e qartë se qytetarët nuk do të adresonin përsëri tek ne problemet e tyre, nëse nuk do të kishin besim në zgjidhjen e tyre. Gjatë vitit 2006, ne vazhduam të provojmë se ky besim ekziston. Këtë e provon fluksi i rritur i ankesave të qytetarëve që ka shqyrtuar Institucioni gjatë vitit 2005.

Gjatë periudhës 1 Janar - 31 Dhjetor 2006 janë trajtuar nga Zyra e Avokatit të Popullit **3609** ankesa, kërkesa dhe njoftime (duke përfshirë dhe ato të Zyrës së Pritjes së Popullit, të cilave ju është dhënë përgjigje menjëherë). Nga **3609** ankesa, **280** kanë qenë të mbartura nga viti 2005, **2555** janë raste të regjistruara në vitin 2006 dhe **774** janë raste të cilave iu është dhënë përgjigje menjëherë në Zyrën e Pritjes së Popullit. Për shkak të ndryshimit të adresës së institucionit dhe kalimit në zyrat e reja, në muajin gusht 2006, numri i personave të cilët i janë drejtuar Zyrës së Pritjes së Popullit ka rezultuar të jetë më i vogël, krahasuar kjo me vitin e kaluar. Ankesa, kërkesa dhe njoftime të cilat i janë nënshtruar shqyrtimit nga ana e Zyrës sonë kanë qenë **2835** ose **127** më shumë se në vitin 2005. Nga këto, **226** ankesa ose rreth **8 %** e tyre kanë kaluar për shqyrtim në vitin 2007. Gjatë vitit 2006 janë përfunduar së shqyrtuari gjithsej **2623** ankesa, nga të cilat ka rezultuar se **1192** ankesa, ose **45.4 %** e tyre, kanë qenë jashtë juridiksionit dhe kompetencës. Por për këto ankesa është bërë punë efektive, sepse qytetarët janë sqaruar për rrugën që ata duhej të ndiqnin për zgjidhjen e problemit të prezantuar tek ne. **725** ose **27.6 %** e

ankesave kanë rezultuar të padrejta, kurse **554** ose **22 %** e tyre janë zgjidhur në favor. Për **37** ankesa, ose **1.4 %** e ankesave të përfunduara, rekomandimet me shkrim drejtuar organeve përkatëse të administratës për shkelje të konstatuara prej tyre, nga zyra jonë, janë refuzuar. Për **92** raste, ose **3.5 %** të tyre, të paraqitura për shqyrtim pranë nesh, ankuesit kanë hequr dorë gjatë procesit të shqyrtimit. Për ankesat e gjetura të bazuara, për **100** prej tyre janë bërë rekomandime apo propozime përkatëse me shkrim, drejtuar autoriteteve publike me qëllim që të rritet cilësia e administrimit publik dhe të sigurohen standarte mirëqeverisje. Për pjesën tjetër zgjidhjet pozitive janë arritur që në fazën e marrjes së shpjegimeve apo ndërmjetësimit tonë verbal me organet e Administratës Publike, të cilat pas komunikimit me ne, kanë rregulluar gabimin e bërë ose kanë hequr dorë nga qëndrimet refuzuese apo negative që kanë mbajtur me ankuesit. Rekomandimet e bëra nga Avokati i Popullit dhe të pranuar nga organet të cilave ato u janë drejtuar tregojnë për ndërhyrje të argumentuara nga institucioni ynë për rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura qytetarëve.

Në këtë Raport Vjetor do të prezantojmë, ashtu si dhe vitet e kaluara, rastet e trajtuara nga Zyra e Avokatit të Popullit, të ndara sipas Ministrive përkatëse dhe organeve apo enteve të tjera të Administratës Publike Shqiptare në vartësi të tyre, ndaj të cilave janë drejtuar ankesat apo kërkesat, duke shprehur shpesh dhe opinionet tona për fushat përkatëse.

Më poshtë po paraqesim numrin e ankesave, kërkesave apo njoftimeve të trajtuara në vitin 2006, të ndara për Këshillin e Ministrave dhe sipas Ministrive përkatëse, organeve apo enteve të tjera të administratës publike.

1. Këshilli i Ministrave	80 , nga të cilat
për vetë Qeverinë	18
a. Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare	9
b. Grupin Mbikqyrës të Firmave Piramidale	4
c. Instituti i Integritimit të ish të Përndjekurve politikë	5
d. Agjensia e kthimit dhe kompensimit të pronave	44
2. Ministria e Drejtësisë	331 , nga të cilat:
për vetë ministrinë	12
a. Burgjet	115
b. Zyrat e Përmbartimit	116
c. Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	88

3. Organet e pushtetit gjyqësor	374
4. Prokuroria	197
5. Ministria e Brendshme	564 , nga te cilat:
Organet e policisë	215
Organet e pushtetit vendor	349
a. Komunat	83
b. Bashkite	216
c. Prefekturat	13
d. Qarqet	12
dh. Gjëndja Civile	25
6. Ministria e Mbrojtjes	61
7. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta	159 , nga të cilat
vetë ministrinë	19
a. Institutin e Sigurimeve Shoqërore	132
b. Shërbimi Social Shtetëror	8
8. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	181 , nga të cilat:
vetë ministrinë	40
a. Policia ndërtimore	70
b. Ujësjellës kanalizime	18
c. Albtelekom dhe telefonia mobile	23
ç. Posta Shqiptare	7
f. Shërbimi hekurudhor	1
dh. Enti Kombëtar i Banesave	22
9. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës	111 , nga të cilat:
Vetë Ministrinë	57
KESH	54
10. Ministria e Financave	61 , nga të cilat:
11. Ministria e Arsimit dhe Shkencës	76
12. Ministria e Shëndetësisë	47
13. Ministria e Punëve të Jashtme	34
14. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	13

15. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe	
Administrimit të Ujërave	5
16. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe	19
Mbrojtjes së Konsumatorit	
17. Ankesa ndaj administratës së shërbimit	
informativ shtetëror	11
Të tjera	231
TOTALI	2555 ankesa

Gjatë vitit 2006, një numër i konsiderueshëm ankesash (577 ankesa) janë arritur të zgjidhen në favor të ankuesve, nëpërmjet punës së mediacionit të Avokatit të Popullit me organet e administratës publike qendrore dhe vendore.

2. Opinione të përgjithshme për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri

Avokati i Popullit është i vetmi institucion kombëtar me status kushtetues për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri. Çdo vit në Raportet vjetore kemi dhënë konsiderata të veçanta apo të përgjithshme për çështje të të drejtave të njeriut. Por në lidhje me gjendjen e të drejtave dhe lirive të individëve në Shqipëri jemi shprehur jo vetëm në Raportet tona, por edhe në analizat, diskutimet apo rekomandimet, kur kemi shqyrtuar ankesa apo kërkesa të caktuara. Për problemet që do të prezantojmë më poshtë, nuk jemi bazuar vetëm në ankesat e paraqitura tek Institucioni ynë, por dhe në informacionet e marra nga organizatat jofitimprurëse për fusha të veçanta të së drejtës, nga sondazhet dhe informacionet e publikuara në Mediat shqiptare, si dhe në raportet e organizmave dhe institucioneve prestigjioze që analizojnë gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Shqipëri, siç janë ato të Bashkimit Europian, Këshillit të Europës, Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Human Rights, Amnesty International, Freedom House, Komitetet e të drejtave të njeriut pranë organizmave të Kombeve të Bashkuara, Komiteti Shqiptar i Helsinkit etj.

Ne të gjithë e dimë, por edhe të gjitha Raportet e institucioneve dhe organizmave ndërkombëtare që na monitorojnë theksojnë se në Republikën e Shqipërisë janë miratuar pothuajse të gjitha ligjet specifike që kanë si objekt respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Vendin kryesor e zë Kushtetuta shqiptare e vitit 1998 që ka përcaktuar qartë se “të drejtat e njeriut dhe liritë themelore janë të patjetërsueshme

dhe i takojnë çdo njeriu me lindjen e tij”. Ajo gjithashtu thekson që “njohja dhe respektimi i të drejtave të njeriut është detyrë e shtetit”. Por dihet gjithashtu se hartimi i ligjeve të reja nuk është i mjaftueshëm. Aftësia për t’i zbatuar ato mirë është një element po aq thelbësor i garantimit të demokracisë dhe sundimit të ligjit. Dihet gjithashtu prej vitesh se në Shqipëri në drejtim të zbatimit me efikasitet të kuadrit ligjor pozitiv vazhdojnë të hasen një sërë problemesh serioze që kërkojnë zgjidhje. Në këto kushte në jetën e përditshme të përballjes së njerëzve me administratën publike ndeshim mjaft fenomene negative, që në thelb janë shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut.

E drejta e jetës, si e drejtë themelore e njeriut ka qenë në qendër të Konferencës Kombëtare që Avokati i Popullit organizoi në Dhjetorin e vitit 2001. Synimi i saj ishte inicimi i një strategjie kombëtare të përbashkët nga të gjithë organet shtetërore dhe OJF-të, për masat parandaluese të ngutshme dhe të qëndrueshme, në mbrojtje të së drejtës së jetës dhe në veçanti, ndaj fenomenit të gjakmarrjes. Konkluzionet dhe rekomandimet e kësaj konference janë publikuar qysh në fillim të vitit 2002. Është pozitive se pas vitit 2004 ka patur një angazhim më serioz ndaj gjakmarrjes. Pozitive është se Kuvendi ka miratuar Ligjin nr.9389 date 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër Gjakmarrjes”. Por për fat të keq deri tani, pas rreth 20 muajsh, Këshilli Koordinues nuk është mbledhur asnjë here. Gjithashtu edhe Këshilli i Ministrave nuk ka nxjerrë aktet nënligjore përkatëse në zbatim të këtij ligji. Nga ana jonë këto çështje i janë ngritur Presidentit të Republikës, Kryeministrit si dhe gjithë anëtarëve të Këshillit Koordinues. Deri tani e rëndësishme është që të gjitha institucionet qeveritare e kanë kuptuar se duhet të angazhohen më seriozisht për këtë “plagë” që e bën të papranueshme Shqipërinë në familjen e madhe të Bashkimit Europian, por konkretisht nuk shohim ndonjë zhvillim apo inisiativë të rëndësishme qeveritare, veç atyre të organizatave joqeveritare.

E drejta e jetës në Shqipëri, si e drejtë themelore e njeriut, vazhdon të jetë e rrezikuar për sa kohë që armët vazhdojnë të jenë pa kontrollin e duhur në duart e popullsisë civile. Këto armë përditë marrin jetë njerëzish nëpërmjet krimeve brenda familjes, vetvrasjeve, krimeve me dashje apo pakujdesive në administrimin e tyre. Ashtu siç e kemi prezantuar dhe në Raportet e mëparshme, ligji për mbledhjen e armëve nuk ka dhënë dhe nuk po jep rezultatet e pritshme. Ndonëse nga policia ka patur disa rezultate të bujshme për trafikun e armëve dhe zbatimin e ligjit për armëmbajtësit pa leje është forcuar, numri i armëve pa leje në duart e popullsisë vazhdon të jetë ende i madh. Për t’i dhënë fund kësaj gjendje mendojmë se çarmatimin nuk mund ta presim që ta bëjnë vetëm strukturat e Policisë së Shtetit. Ne vazhdojmë të insistojmë se duhen gjetur zgjidhje

të reja që mund të jenë që nga kombinimi i pagesës për çdo armë të dorëzuar deri tek ligjësimi i mbajtjes së armës nga çdo individ i rritur, i përgjegjshëm dhe pa precedentë penale. Psikologjia na ndihmon të kuptojmë se konflikti ndërmjet njerëzve nuk degjeneron deri tek përdorimi i armës sa kohë se sejcili e din që të gjithë kanë armë me leje në posedim. Dihet se ka jo pak shtete, përfshirë edhe SHBA, që lejojnë armëmbajtjen me leje për qytetarët e tyre të rritur dhe pa precedentë penale.

Liritë dhe të Drejtat Vetjake si liria e shprehjes, e shtypit, medias e televizionit, liria individuale, paprekshmëria e banesës, liria e fshehtësia e korrespondencës janë të garantuara me ligj. Për to ka patur dhe do të ketë ankesa apo dhe mbrojtje të tyre si nga ana e Avokatit të Popullit ose me anë të proceseve gjyqësore. Por mendimi ynë, ashtu sikundër është thënë dhe më parë, është se këto të drejta dhe liri përgjithësisht respektohen. Janë ndëshkuar shkaktarët, kur pas proceseve ligjore të rregullta janë vërtetuar shkelje të tyre të kryera nga autoritete publike, apo nga individë të veçantë që ju kanë cënuar këto të drejta, në rastet që janë ankuar tek Avokati i Popullit apo në organet gjyqësore.

Për lirinë e shtypit, medias e televizionit, duhet thënë se vazhdon të ketë raste kur kjo liri është shkelur. Por mediat tona duket se po ndërgjegjësohen, sepse më pare nuk e konsideronin shkelje të jepnin me hollësi të dhënat personale që shkelin të drejtën e privacisë, të rregulluar nga dispozitat e Ligjit nr. 8517, datë 22.07.1999, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Më e theksuar ka qenë kjo kur ka patur akuza për vepra penale dhe, aq më tepër, kur janë të akuzuar dhe të dëmtuar të miturit apo femrat e shfrytëzuara për trafikë të paligjshme, për krime seksuale në familje etj. Më pak se në vitet e shkuara, gazetarët kanë rendur të marrin intervista dhe të botojnë foto, me identitete të plota e të sakta për fëmijë të vetrvarrë apo femra të dhunuara si nga trafikantët, përsëritësat në krimet seksuale apo prindër dhunues. Nuk duhet harruar se publikimi i këtyre fakteve i sjell dëme të pariparueshme auditorit, sidomos fëmijëve apo personit të dhunuar. Rasti i fundit ka qenë shkelja e bërë nga Zyra e Mbrojtjes së Qytetarëve dhe Tv.Klan (Emisioni Zonë e Lirë) që intervistoi një burrë që pretendon për keqtrajtime nga gruaja, por u harrua se pas atij çifti janë dy fëmijë të mitur që pësuan trauma. Është fakt se për shkak të mungesës së nivelit të duhur arsimor, kulturor e juridik, shpesh herë personat e cënuar nuk kanë ngritur padi apo bërë ankesa, por kjo nuk do të thotë se këto shkelje nuk ekzistojnë. Rol të madh parandalues duhet të lozin shoqatat e gazetarëve, nëpërmjet aftësimin profesional të tyre. Por edhe institucioni ynë duhet të bëjë më shumë në këtë drejtim, duke vepruar me inisiativë për të ngritur opinionin publik kundër këtyre shkeljeve.

Liria e ndërgjegjes dhe e fesë njihen dhe respektohen nga shteti.

Avokati i Popullit nuk ka munguar te trajtoje ankesa qe lidhen me respektimin e lirisë se shprehjes dhe te besimit privatisht dhe publikisht, dhe ne çdo rast ka mundur te arrije zgjidhje me mirekuptim te ketyre rasteve, te bera keto publike jo si qellim ne vetvete, por per te krijuar shembullin pozitiv te trajtimit te tyre konform ligjit dhe ne frymen e kartave nderkombetare.

Qysh vitin e kaluar ne kemi shprehur mendimin se procedura e dhënies se lejes për ndërtime të objekteve fetare, si dhe organi qe duhet te jete kompetent per miratimin e lejes se ndertimit, duhet t'i pershtaten nje rregulli specifik ligjor. Konkretisht kemi propozuar plotesimin e Ligjit "Per Urbanistiken", duke parashikuar qe KRRTSH-ja te jete organi i vetem qe duhet te miratoje vendimin per dhenien e lejes se ndertimit per objekte kulti, pasi te kete marre edhe mendimin e Komitetit Shteteror te Kulteve.

Kete kufizim te te drejtave te organeve te pushtetit vendor, por edhe te lirisë së komuniteteve fetare, e argumentojmë duke u bazuar ne nenin 17 te Kushtetutes, pika 1 e te cilit justifikon kufizime te tilla me ligj per "nje interes publik ose mbrojtjen e te drejtave te te tjereve ... ne perpjestim me gjendjen qe e ka diktuar kete kufizim".

Ne kushtet kur solidariteti brendafetar perben nje norme te respektueshme te besimit, shteti duhet ta konsideroje kete fakt per te ballafaquar dhe parandaluar pasojat reale qe mund te sjellin akte te tilla per te sotmen dhe te ardhmen e vendit dhe te qytetareve te tij. Avokati i Popullit është bashkuar me deklaratat e drejtuesve fetare se besimi ruhet ne shpirt e ne ndërgjegje dhe shfaqet brenda institucioneve dhe ndertesave te kulteve. Por shteti shqiptar dhe Administrata Publike etj nuk duhet te qendrojne indiferente, por duhet të marrin përgjegjësi dhe të rregullojnë me ligje fenomene dhe aktivitete fetare që rrezikojnë laicitetin shtetëror, harmoninë fetare në Shqipëri. Për më tepër lexoni në faqen 325 të këtij Raporti.

Liritë dhe të Drejtat Politike, si e drejta e zgjedhjeve, e organizimit, e tubimeve dhe manifestimeve paqësore, janë të garantuara me ligj. Të gjitha institucionet publike punojnë që ato të respektohen. Për fat të keq vazhdojnë diskutimet dhe dyshimet, mungesa e besimit reciprok, rrjedhur nga proceset elektorale të shkuara. Natyrisht ka dhe do të ketë opinione të ndryshme në këto drejtime, sidomos nga partite politike. Avokati i Popullit ka zbatuar dhe është mbështetur fort në parimin e paanësisë, për të mos u kompromentuar në pakënaqësitë e natyrshme të partive politike, që gjithmonë shoqërojnë garat elektorale për pushtetin qëndror apo atë vendor. Avokati i Popullit është shprehur pozitivisht për masat legjislative dhe ato administrative për të zbatuar Rekomandimet e

ODIHR-it. Kur ka qenë rasti kemi punuar konkretisht për respektimin e të drejtës themelore të votës së lirë për çdo qytetar të Republikës së Shqipërisë, duke dhënë edhe rekomandime konkrete për të mos lejuar asnjë mundësi manipulimi nga cilado palë apo subjekt elektoral. Kujtojmë se qysh në vitin 2002, duke marrë shkas nga ekzistenca e të vdekurve në regjistrat e gjendjes civile, rekomanduam që të hiqeshin ata nga listat e zgjedhjeve. Ky rekomandim u muar parasysht dhe u bë edhe rregullimi i ligjit “Për gjendjen civile” për të lejuar që zyrat e gjendjes civile, të bëjnë me inisiativë pastrimin e regjistrave dhe si rrjedhojë edhe të listave elektorale. Pozitive është që vazhdon të punohet që të bëhet pastrimi i plotë i listave.

Veç krijimit të Regjistrat të saktë të zgjedhësve dhe pajisjes së shtetasve me kartë identiteti ne insistojmë që të ndryshohet Kodi Zgjedhor dhe për zgjedhjet e ardhshme do të rekomandonim që në vend të skuadrave të numërimit të përdoren skanerët elektronikë për të numëruar votat, ashtu siç Universitetet bënë procesin e vlerësimit të studentëve. Kjo zgjidhje veçse zhdok subjektivizmin njerëzor, është edhe me mjaft përfitim ekonomik. Kështu rezulton që për zgjedhjet lokale të 18 shkurtit 2007 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka planifikuar nga buxheti i shtetit rreth 600 mijë USD ose 58.000.000 lekë vetëm për të paguar skuadrat e numërimit. Po të blesh me këto para mjetet elektronike (skanerët), nuk do të ketë nevojë të harxhosh para të tjera për zgjedhjet që do të zhvillohen pas vitit 2007. Kjo zgjidhje mund të ishte zbatuar në 18 shkurt 2007 edhe për disa komuna e bashki si projekte pilot, por ky propozim nuk gjeni përkrahje. Institucioni i Avokatit të Popullit mbështet mendimet që të ndryshohet Kushtetuta dhe që Kuvendi të përbëhet vetëm nga 100 deputetë, të zgjedhur me sistem proporcional. Kjo do ta bënte legjislativin më pak të kushtueshëm për taksapaguesit shqiptarë si dhe fushatën elektorale më të qetë, për shkak se nuk do kishte fushata personalizimi të kandidatëve në zonat elektorale. Partite politike do kishin më tepër mundësi për të përfshirë në listat e tyre më shumë gra dhe figurat e tyre më aktive dhe nga profesione të tilla, si juriste, ekonomiste, sociologe etj, me qëllim që Parlamenti të jetë sa më cilësor në veprimtarinë e tij.

Në lidhje me trafikun e qënieve njerësore nuk duhen mohuar rezultatet pozitive të viteve të fundit që kanë patur të bëjnë sidomos me rritjen e kontrollit të kufijve. Këtë e vërteton vetëm fakti se tashmë shqiptarët nuk mund të kalojnë ilegalisht nga Shqipëria direkt në Itali, dhe janë kapur në tentativë duke kaluar nga vende të treta p.sh. në Kroaci. Trafikimet e femrave për prostitucion dhe ato të fëmijëve në çdo formë janë zvogëluar dhe çdo ditë e më tepër flitet për vënie para ligjit të cilitdo që ka kryer vepra të tilla, sidomos në vitet e shkuara.

Avokati i Popullit gjatë shqyrtimit të ankesave konkrete, sidomos për abuzime me fëmijët ka shqyrtuar nëse janë zbatuar detyrimet që rrjedhin nga nënshkrimi i konventave ndërkombëtare apo nga legjislacioni vendas. Në këto raste ndërhyrjet e Avokatit të Popullit kanë qenë frutdhënëse, jo vetëm sepse janë vene në levizje strukturat e përmbartimit, ato të shkollës apo të ndihmës sociale, por se duke ju bërë këtyre rasteve edhe publiciteti i nevojshëm, është krijuar precedenti pozitiv, janë hartuar Rekomandime për Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Rendit, Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministrinë e Arsimit dhe shumë struktura të tjera, për t'i sensibilizuar që të kontrollojnë e t'u kërkojnë llogari organeve të tyre vartëse, për të vlerësuar në radhë të parë interesin e fëmijëve. Këtij qëllimi i shërbeu edhe organizimi në dhjetor 2005 i Konferencës Kombëtare "Të gjithë së bashku në mbrojtje të fëmijëve". Rekomandimet përkatëse u janë dërguar gjithë institucioneve dhe organeve shtetërore qysh në janar 2006. Mund ta konsiderojmë një sukses edhe për nënshkrimin më 27 shkurt 2006 të Marrëveshjes ndërmjet Qeverive të Shqipërisë dhe Greqisë "Për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve, viktimave të trafikut".

Në bashkëpunim me "Save the Children", qysh në vitin 2004 në zyrën tonë ka filluar funksionimi i një nënseksioni që merret në mënyrë specifike me problemet e fëmijëve në Shqipëri. Synimi është që edhe në Shqipëri të krijohet një autoritet i fortë shtetëror, i cili jo vetëm që do të nxitë autoritetet dhe organet shtetërore për zhvillimin e fëmijëve, por do të jetë edhe një organ specifik si mbrojtës i të drejtave të fëmijëve. Por për këtë kuptohet që duhet vullnet politik, angazhim financiar si dhe ndryshimet e duhura në legjislacion, kushte të cilat kërkojnë disa kohë që të plotësohen. Ky projekt tashmë ka gjetur një financim për 3 vjet nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze e Zhvillimit (SIDA). Për më tepër lexoni në faqen 359 të këtij Raporti.

Edhe Ministria e Drejtësisë së bashku me Komisionin Europian, Unicefin dhe Sidan kanë filluar një projekt të posaçëm 3-vjeçar për hartimin e ligjeve të posaçme për të drejtat e fëmijëve, krijimin e një sistemi gjyqësor dhe penitenciar, të veçantë për minorenët, krijimin e qendrës për edukimin e minorenëve, por mundësisht edhe një burg të veçantë për minorenët.

Në lidhje me të drejtat e grave, konstatohet që vitet e fundit ka rënie të trafikut të femrave në mënyrë të ndjeshme. Kjo ka ardhur edhe si rrjedhojë e fushatave ndërgjegjësuese të ndërmarra nga OJF-të e ndryshme në media, shkolla, universitete etj. Por kryesore ka qenë ndjekja dhe zbatimi me rreptësi i ligjit ndaj trafikantëve, miratimi dhe zbatimi i politikave dhe programeve të posaçme për mbrojtjen e viktimave të trafikut, si dhe monitorimin e këtij procesi nga organizmat

që janë krijuar enkas nga strukturat qeveritare. Por çështjet që kanë të bëjnë me keqtrajtimin bashkëshortor apo dhunën në familje ndaj grave dhe vajzave janë të shumta. Situata duket që përmirësohet ngadalë, prandaj puna parandaluese nuk duhet lënë vetëm në dorë të organizatave joqeveritare.

Organizmat ndërkombëtare rekomandojnë në vazhdimësi që shteti shqiptar duhet të ndërmarrë hapa të menjëhershme për ndryshimin e sjelljes së publikut ndaj pjesëmarrjes së gruas në çështjet publike, si dhe të marrë në konsideratë miratimin e një politike pozitive veprimi në këtë drejtim. Shteti duhet të marrë masat e duhura për të siguruar pjesëmarrjen efikase të gruas në jetën politike, publike si dhe në sektorë të tjerë të shtetit. Ndryshimi i sistemit elektoral do t'i jepte më tepër hapësirë pjesëmarrjes së grave në jetën publike dhe do rriste nivelin e tyre të përfaqësimit në organet e zgjedhura. Për më tepër lexoni në faqen 41 të këtij Raporti.

Ristrukturimi i Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, që u bë në vitin 2005, mendojmë se duhet të ketë mjete efektive për të ndikuar që të ruhen dhe zbatohen të drejtat e grave, për të përmirësuar trajtimin dhe pozitën e femrave në familje dhe në shoqërinë shqiptare. Gjithashtu vlerësohet pozitivisht ngritja e nënseksionit për Çështjet e Minorenëve dhe barazisë Gjinore pranë Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë në Parlamentin Shqiptar.

Trajtimi i të dënuarve dhe të paraburgosurve në dhomat e izolimit pranë komisariateve të policisë, megjithë përmirësimet nga viti në vit, vazhdon të ketë probleme dhe ankesa. Edhe trajtimi i të sëmurëve mendorë në spitalet tona psikiatrike vazhdon të jetë problem shqetësues.

Qeveria Shqiptare duhet t'i kërkojë më tepër llogari institucioneve vartëse të drejtësisë, policisë e mjekësisë që të punojnë më seriozisht për zbatimin e vendimeve të saj, për t'i ndarë përgjegjësitë për këta persona. Mund të themi se kjo Qeveri ka filluar ta bëjë më mire këtë detyrë dhe angazhim të saj, sepse është vendosur të përfundojë sa më shpejt kalimi i dhomave të paraburgimit në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë.

Institucioni i Avokatit të Popullit është i ndërgjegjshëm se ndonëse ka mjaft përmirësime në trajtimin e të dënuarve dhe të të paraburgosurve në dhomat e izolimit pranë komisariateve të policisë, ka patur mjaft ankesa dhe kërkesa për të cilat kemi bashkëpunuar me Ministrinë e Drejtësisë dhe atë të Brendshme. Për më tepër lexoni në faqet 97 dhe 185 të këtij Raporti.

Ne kemi bërë hetimet përkatëse për rastet arbitrare të arrestimit dhe ndalimit, përdorimin e dhunës nga oficerët e policisë, keqtrajtimin e të ndaluarve në dhomat e paraburgimit si dhe përdorimin e dhunës për të

detyruar të ndaluarit të pranojnë fajin. Gjithashtu ne kemi rekomanduar masa të rrepta për eliminimin e të gjitha rasteve të keqtrajtimit nga punonjësit e policisë. Për më tepër lexoni në faqet 155-192 të këtij Raporti.

Edhe për prokurorinë dhe gjykatat vazhdohet të ketë një numër të madh ankesash tek Avokati i Popullit, sidomos të vonesës së paarsyeshme (zvarritjeve) të çështjeve gjyqësore, duke kërkuar që të paraburgosurit e padënuar të dalin para gjyqit sa më shpejt që të jetë e mundur.

Duke patur këtë situatë edhe ne kemi rekomanduar vazhdimisht se duhet vazhduar puna për përmirësimin dhe hartimin e ligjeve të reja, për të cilat kemi bërë edhe propozime konkrete për luftën kundër korrupsionit brenda sistemit gjyqësor; zbatimin pa kushte të vendimeve gjyqësore; reforma për përjasjen e legjislacionit vendas me marrëveshjet ndërkombëtare, përmirësimi i marrëdhënieve konkrete të punës së përditshme midis prokurorisë, policisë gjyqësore dhe gjykatave kundër krimit të organizuar etj.

Për të siguruar më mirë të drejtën e jetës dhe të drejtat dhe liritë private të njeriut përsëritim propozimin që të studjohet edhe përgatitja e një ligji për Investigatorin privat dhe Avokatin e personit të dëmtuar (viktimës) qysh në fazën e hetimit, siç e kanë edhe shumë vende të tjera të botës së qytetëruar. Këto dy funksione me të drejta dhe detyrime procedurale do të rritnin forcën zbuluese ndaj krimeve, do parandalonin vonesat në hetime dhe gjykime, sidomos do të parandalonin në prokuroritë dhe gjykatat tona korrupsionin. Procesi i trajnimit dhe testimi të gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet vazhduar, por me kritere e kontroll të rreptë për aftësitë e tyre profesionale. Gjithashtu atyre u duhen siguruar kushte më të mira jetese dhe për sigurinë e jetës së tyre.

Duhet patur parasysh se sipas nenit 116/1 b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara kanë fuqi në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe njëkohësisht, sipas nenit 117/3, ato duhet të shpallen dhe të botohen në Fletoren Zyrtare, me qëllim që të marrin fuqinë juridike.

Në këtë kuadër, rezulton se, nga tërësia e mbi 120 akteve ndërkombëtare të ratifikuara, rreth 75 prej tyre janë të papërkthyer e të pabotuara zyrtarisht.

Pra këtu ka dhe një problem tjetër të madh, sepse këto tekste akoma nuk janë në përdorim të të gjitha institucioneve zyrtare të interesuara dhe në veçanti të gjykatave shqiptare.

Pra, si mund të zbatohen këto tekste, në qoftë se ato fizikisht nuk ndodhen në dispozicion të organeve që duhet t'i zbatojnë ato? Edhe Rekomandimi REC (2002) 13 i Komitetit të Ministrave të vendeve

anëtare të Këshillit të Europës, miratuar më 18 dhjetor 2002 u kërkon shteteve anëtare që “të garantojnë që teksti i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut është përkthyer dhe i është shpërndarë autoriteteve kombëtare, veçanërisht gjykatave, dhe se për zhvillimet në jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut ka akses të mjaftueshëm në gjuhën e vendit”. Për më tepër lexoni në faqe 95 të këtij Raporti.

Si përfundim theksojmë se, është e qartë për të gjithë, se përgjegjëse për gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në çdo vend janë Parlamenti dhe Qeveritë që dalin prej tij. Në këtë kuadër secili duhet të bëjë punën e tij. Avokati i Popullit e ka të qartë rolin dhe ka bërë dhe do të vazhdojë të bëjë vetëm detyrën e tij për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Republikën e Shqipërisë.

3. Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë

Pas rreth 7 vjetësh të veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit, për të gjithë është e qartë se Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka ndikuar mjaft për forcimin dhe konsolidimin e tij. Kjo sepse tashmë dihet se “Ombudsmani është krahu i zgjatur i Parlamentit mbi Administratën Publike, me qëllim që gjatë zbatimit të ligjit, të punojë që të arrihen qëllimet e ligjvënësit”. Gjatë vitit 2006, ashtu si edhe në të gjitha vitet që nga krijimi i tij, Avokati i Popullit ka vazhduar të informojë herë pas here me shkrim ose verbalisht Kryesinë e Kuvendit, si dhe komisionet parlamentare përkatëse për veprimtarinë e tij ose ka bashkëpunuar me grupe deputetësh për çështje të veçanta.

Kemi marrë pjesë në diskutime si dhe kemi dhënë mendime për projektligje dhe rekomandime për çështje të ndryshme. Synimi ka qenë që deputetët në komisionet parlamentare jo vetëm të informohen për veprimtarinë dhe opinionet tona, por edhe që të ndërmarrin inisiativën legjislative për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve, kur i vlerësojnë me vend Rekomandimet që kemi bërë.

Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë e datës 20 mars 2006 “Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2005”, kërkonte që për vitin 2006 t’i kushtohej vëmendje e veçantë këtyre objektivave:

- vazhdimit të bashkëpunimit me Kuvendin për informimin për shkallën e respektimit të të drejtave të njeriut, si dhe për shkeljet e administratës publike në Shqipëri;
- rritjes së nivelit të bashkëpunimit me administratën publike shqiptare për rritjen e standardeve të qeverisjes, si dhe forcimit të bashkëpunimit me shoqërinë civile;

- organizimit të ditëve të hapura në mënyrë periodike në zona të ndryshme të vendit, për të rritur shkallën e ndërgjegjësimit të publikut, si dhe zbatimin edhe të formave të tjera për t'iu afruar sa më shumë atij;

- bërjes publike në mënyrë të vazhdueshme të shkeljeve të administratës publike në fushën e të drejtave të njeriut, duke kërkuar edhe masa ndaj personave përgjegjës sipas ligjit;

- rritjes cilësore të nivelit të raportimeve pranë organizmave ndërkombëtarë;

- rritjes së këmbënguljes së institucionit për ndjekjen e rekomandimeve të dhëna për administratën publike shqiptare, përfshirë edhe gjyqësorin dhe prokurorinë.

Siç del nga ky Raport dhe nga shifrat përkatëse për veprimtarinë konkrete mund të deklarojmë se në tërësi është punuar mirë për të realizuar objektivat e mësipërme.

A- Në Raportet tona vjetorë nga viti 2001 e në vazhdim ne i kemi bërë të ditur Kuvendit se i kemi rekomanduar Qeverisë që të marrë masa për të përgatitur disa ligje e akte të tjera që të plotësohen detyrimet që rrjedhin nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Me këtë rast informojmë Kuvendin e Shqipërisë se për dy çështje detyrimet e përcaktuara nga nenet 10 dhe 44 të Kushtetutës nuk janë plotësuar siç duhet:

1. Detyrimi i Qeverisë për lidhjen e marrëveshjeve me bashkësitë fetare, dhe që këto marrëveshje të ratifikohen në Kuvend siç kërkon neni 10 i Kushtetutës. Për më tepër lexoni në faqen 402 të këtij Raporti.

2. Nxjerrja e ligjit për rehabilitimin apo zhdëmtimin nga aktet apo veprimet e paligjshme të organeve shtetërore, siç kërkon neni 44 i Kushtetutës. Deri tani është miratuar vetëm ligji nr.9381 datë 28.04.2005 "Për kompensimin e burgimit të padrejtë". Por dihet se nocionet e rehabilitimit dhe të zhdëmtimit janë shumë më të gjerë se kompensimi i burgimit të padrejtë. Prandaj duhet nxjerrë edhe një ligj tjetër. Ne nuk do heqim dorë nga rekomandimi për të zbatuar siç duhet nenin 44 të Kushtetutës sonë.

B- Gjatë vitit 2006, i kemi nisur direkt Kuvendit këto Rekomandime për përmirësimin e ligjeve me qëllim që deputetët të marrin nismë legjislative:

1. Rekomandim drejtuar Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, me qëllim që të dënuarve që kanë ndenjur në dhomat e paraburgimit tej kohës mbasi vendimi i tyre kishte marrë formë të prerë, t'u llogaritet kjo kohë sipas nenit 57 të Kodit Penal, pra një ditë paraburgim baraz me një ditë e gjysmë burgim. Rekomandimi u pranua, dhe një grup deputetësh e paraqitën Rekomandimin tonë në formë projekt

ligji. Në maj 2006 projekti u diskutua në Komisionin e Çështjeve Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, u pranua në parim si çështje e drejtë, por u shty për të gjetur një formë tjetër formulimi juridik.

2. Katër Rekomandime për ndryshime dhe plotësime në ligjin nr.9087 datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i janë nisur më datë 20.10.2006 dhe 25.10.2006 Komisionit parlamentar për Reformën Zgjedhore.

I. Sipas pikës 3 të nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë “Të dënuarit që janë duke vuajtur dënimin me heqje të lirisë, kanë vetëm të drejtën për të zgjedhur”.

Në pikën 3 të nenit 63 të ligjit nr.9087, datë 19.06.2003 “Për zgjedhjet dhe referendimet vendore” thuhet: “40 ditë para ditës së votimit, drejtuesi i Institucionit të posaçëm, përgatit listën e zgjedhësve me vendbanim në njësinë zgjedhore, ku ndodhet institucioni dhe ia dorëzon atë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse”.

Nga praktika e zgjedhjeve të kaluara vendore të vitit 2003, sipas përcaktimit të bërë nga kjo dispozitë, pjesa më e madhe e të dënuarve në burgje u privuan nga e drejta për të zgjedhur. Kjo për arsyen e thjeshtë se ligji ka përcaktuar dhe është zbatuar, që në listën e zgjedhësve, janë përfshirë vetëm ata të dënuar që kanë patur vendbanimin në vendin ku ndodhet institucioni (burgu). Në praktikë kjo ndodh shumë rrallë për shkak se p.sh. në burgjet e Tiranës ka me qindra të dënuar që e kanë vendbanimin në qytete të tjera. Sipas ligjit ekzistues, ata nuk mund të regjistrohen në listat e zgjedhësve, për rrjedhojë edhe nuk votojnë.

Duke parë se vetë Kodi Zgjedhor në nenin 63, pika 3, është bërë pengesë që të dënuarit të ushtrojnë të drejtën e zgjedhjes që ju njih Kushtetuta jonë në pikën 3 të nenit 45 të saj; rekomandua për përmirësimin e Kodit Zgjedhor, duke bërë zëvendësimin e fjalës “vendbanim” me “vendqëndrim”.

II. Propozua që me zgjedhje direkte të përfshihet edhe funksioni i zëvendëskryetarit të bashkisë apo komunës. Kjo sepse parandalohet provokimi i zgjedhjeve shpesh herë për shkaqe të tilla si vdekja, burgim, largim në emigracion etj, i kryetarëve të bashkive apo komunave. Në këtë mënyrë nuk ngelen njësitë e qeverisjes vendore pa përfaqësues të zgjedhur nga populli dhe nuk bëhen as shpenzime për rizgjedhje në bashkitë apo komunat që ngelen pa kryetarë.

III. Përsëritëm rekomandimin që të përcaktohet në Kodin Zgjedhor mospërfshirja e fëmijëve në takimet elektorale nga forcat politike të vendit. Nisur nga imazhet e të gjitha fushatave të mëparshme elektorale, ka mjaft raste kur vërehet një pjesëmarrje aktive e fëmijëve gjatë fushatave elektorale të cilësdo parti politike. Nuk duhet harruar që fëmijët nuk kanë pjekurinë intelektuale, fizike apo mendore si të rriturit, dhe

shpesh as vetë ata nuk e kuptojnë qëllimin e këtyre organizimeve apo mitingjeve. Për këtë arsye moshë e përcaktuar me ligj për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur është caktuar 18 vjeç. Është pikërisht kjo arsyeja që ata kanë nevojën për një mbrojtje të veçantë. Ata duhen mbrojtur jo vetëm nga neglizhenca apo abuzimi, por edhe nga përgjegjësitë që kalojnë tej aftësive të tyre. Në jo pak raste në tubime gjen shprehje gjuha e konfliktualitetit dhe akuzave respektive tepër të rënda.

Duke respektuar faktin që në shoqërinë tonë diversiteti respektohet dhe duke kërkuar që të drejtat fëmijëve në çdo rast të mbahen në konsideratë dhe ku asnjë fëmijë të mos ndjehet i përjashtuar, kemi sugjeruar mjaft herë publikisht mospërdorimin e kësaj pjese të shoqërisë për nevoja elektorale nga të gjitha forcat politike në vendin tonë.

Institucioni i Avokatit të Popullit rekomandoi që të shtohet në kapitullin e Përkufizimeve dhe Parimeve në Nenin 3 ose në Nenin 5 të Kodit Zgjedhor, një pikë e veçantë shprehimisht si më poshtë: “Të ndalohet përfshirja apo pjesëmarrja dhe angazhimi i fëmijëve nën 18 vjeç në takimet e partive politike”. Megjithatë kjo moshë mund të ulet deri në 16 vjeç.

IV. Shoqëria civile në Shqipëri, konkretisht Koalicioni për nxitjen e pjesëmarrjes së grave dhe të rinjve në politike, Grupimet politike të grave, si dhe organizmat nderkombëtarë, kanë rekomanduar që shteti shqiptar duhet të ndermarre hapa të menjehershme për ndryshimin e sjelljes së publikut ndaj pjesëmarrjes së gruas në çështjet publike, si dhe të marre në konsideratë miratimin e një politike pozitive veprimi në këto drejtim.

Pjesëmarrja e grave në jetën publike dhe politike në Shqipëri si dhe në procesin e vendimmarrjes mbetet e kufizuar. Aktualisht Shqipëria shënon standartin më të ulët të përfaqësimit të grave në Evropë dhe paraqitet vetëm me 7.1% grua në Kuvend, ndonëse në Kodin e Etikës që u nënshkrua nga të gjitha partitë politike në kuadër të Zgjedhjeve Parlamentare të vitit 2005 theksohej shprehimisht: *Ne do të nxisim dhe mbështesim konkretisht pjesëmarrjen e plote të grave, qoftë si kandidatë edhe si anëtarë të komisioneve në procesin zgjedhor*”.

Megjithë angazhimin e mesipër rezultatat ishin krejt të pakënaqshme dhe realiteti tregon se pjesëmarrja e grave në politike në Shqipëri nga viti në vit ka ardhur në rënie. Për të përmirësuar këto situata nevojitet një rregullim në Kodin Zgjedhor duke vendosur sistemin e kuotave dhe të “vendëve të përcaktuara” në Parlament dhe Këshillat Bashkiakë e Komunave, së bashku me sanksionet për moszbatimin e tyre.

Sistemet e kuotave zgjedhore janë të ndryshme. Ata mund të zbatohen me qëllim që të rezervojnë një numër të caktuar vendesh për grua në organet e zgjedhura, duke ju ofruar atyre mbështetje për të dale

nga izolimi politik. Ato synojne qe te sigurojne se paku nje minoritet kritik per grate, prej 20, 30 ose 40% e deri ne garantimin e nje balance te vertete gjinore, prej 50% burra e 50% gra.

Edhe pse ne mjaft shtete qe kane parashikuar kuota, nuk jane vendosur limite kohore per zbatimin e tyre, duket se tendenca e fundit eshte per te mbeshtetur me teper sistemet e kuotave te perkohshme. Kjo me qellim qe te tregohet perkohshmeria e aksioneve politike te shtetit, deri ne zhdukjen e te gjitha barrierave qe ekzistojne ne realitetin patriarkal zgjedhor. Nje gje e tille duke e qarte dhe ne rekomandimet qe Komiteti i Kombeve te Bashkuara per eleminimin e diskriminimit kunder Grave, i ka bere shtetit shqiptar pas raportit te pare te shtetit tone per zbatimin e Konventes “Per eleminimin e te gjitha formave te diskriminimit per grate”, Sesioni 28, 13-31 janar 2003. Nder te tjera Komiteti citon:

“Ndersa mirepriti perdorimin e kuotave minimale te kandidateve femra nga disa parti politike shqiptare ne zgjedhjet lokale, komiteti shpreh shqetesimin per perfaqesimin e ulet te grave ne nivelet e larta te zgjedhura dhe te emeruara dhe, *i ben thirrje Qeverise shqiptare te marre masa qe të përfshijne permiresime ne ligjin elektoral, rritjen e perfaqesimit te grave ne organet e zgjedhura apo te emeruara nepermjet zbatimit te masave te perkohshme specifike, me qellim qe te realizoje te drejtat e grave per t’u përfshire ne te gjitha fushat e jetes publike, veçanerisht ne nivelet e larta te vendimmarrjes*”.

Sa me siper shprehëm mendimin se eshte e domosdoshme qe paraprakisht te vendoset kuota zgjedhore prej te pakten 30% per grate, çka dikton ne menyre te domosdoshme percaktime te reja legjislative ne Kodin Zgjedhor, si kuote e detyrueshme te perfaqesimit te grave ne organet e zgjedhura, si ato te pushtetit vendor, ashtu dhe ne zgjedhjet politike.

Sa me siper në Kodin Zgjedhor duhet te percaktohet:

a) Ne lidhje me listat nje-emerore:

Çdo parti politike qe paraqet kandidate per deputetet, kandidate per kryetare bashkie dhe komune, apo keshilltare ne keshillin e bashkise apo te komunes, 30% e ketyre kandidateve duhet te jene gra ose vajza.

Partite politike ose koalicionet , partite anetare te te cilave kane fituar se bashku me shume se 20% te votave ne zgjedhjet e pergjithshme pararendese, janet te detyruara qe te paraqesin minimumi 30% te kandidateve ne te gjitha zonat zgjedhore gra ose vajza.

b) Ne lidhje me listat shumeemerore:

Renditja e kandidateve ne liste caktohet nga subjekti zgjedhor qe e paraqet ate, duke ruajtur gjithmone nje balance te drejte gjinore me jo me pak se 30% gra ose vajza.

Ne listen e renditjes se paraqitur nga subjekti zgjedhore nje nder tre emra duhet te jete grua ose vajze.

Për fat të keq, siç dihet Komisioni Parlamentar për Reformën Zgjedhore dështoi. Si rrjedhojë edhe Rekomandimet dhe Propozimet e mësipërme nuk janë shqyrtuar seriozisht dhe në mënyrë institucionale. Prandaj do t'i propozojmë sërish pas zgjedhjeve për organet e pushtetit vendor që mbahen më 18 shkurt 2007.

3. Rekomandimi për përfshirjen në paketën fiskale lidhur me ndërmarrjen e iniciativës ligjore për parashikimin ligjor të termit "taksë e drejtpërdrejtë" në Ligjin nr. 8977, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë" si dhe në Ligjin nr. 8982, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave vendore" për cilësimin ligjor të llojeve të "taksave vendore të drejtpërdrejta" për efekt të përjashtimit të veteranëve të luftës, invalidëve, dhe të të verbërve. Rekomandimi është pranuar zyrtarisht nga Ministria e Financave, nuk ka pasoja financiare dhe do ta ndjekim që të miratohet sa më shpejt në vitin 2006.

C- Gjithashtu gjatë vitit 2006 Kryesia e Kuvendit apo Komisionet e Përhershme parlamentare janë informuar me shkrim për:

1. Rekomandimet për detyrat që dalin për të gjitha organet shtetërore nën frymën e Konferencës Kombëtare "Të gjithë së bashku në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve" më datën 12.01.2006.
2. Informacion për rekomandimin drejtuar Qeverisë për nevojën e nxjerrjes së akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr.9389 datë 04.05.2005 "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Korodinues në luftën kundër gjakmarrjes" më datën 02.02.2006.
3. Informacion për Rekomandimin drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për ndalimin e përdorimit të pajustificueshëm të dhunës nëpër burgje dhe nxjerrjen e përgjegjësive për këto shkelje, më datën 02.03.2006.
4. Informacion drejtuar Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për problemet që kanë ngritur të dënuarit në Greqi dhe që vuajnë dënimet në Shqipëri, më datën 02.03.2006.
5. Informacion për Rekomandimin drejtuar Entit Rregullator të Energjisë për të mos pranuar propozimin e KESH sh.a. për rritjen e çmimit të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë, më datën 03.04.2006,
6. Informacion për Rekomandimin drejtuar Prokurorisë dhe Ministrisë së Brendshme për fillimin e hetimit për veprën penale të

“Torturës” si dhe përjashtimin nga policia e shtetit të punonjësve të policisë Altin Gusho e Gëzim Lullalli, si dhe marrje mase disiplinore ndaj z. Ilia Nasi, shef i Komisarariatit të Policisë Korçë dhe z. Elidon Veizi me detyrë shef i Policisë Kriminale Korçë, më datën 23.06.2006 (ka të bëjë me çështjen e vetvrasjes së të riut Anarildo Përfundi).

7. Informacion për Rekomandimin drejtuar Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë për marrjen e masave të nevojshme për lejimin e avokatëve që të hyjnë në ambientet e policisë për të takuar me klientët e tyre që në momentet e para të shoqërimit, ndalimit apo arrestimit, më datën 11.07.2006.
8. Informacion për Rekomandimin drejtuar Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave për nevojën e krijimit të një fondi financiar në organet e policisë vendore për pagimin e punonjësve socialë dhe avokatëve mbrojtës për të miturit, më datën 12.07.2006.
9. Mendime drejtuar Komisioneve Parlamentare të Kuvendit për projektligjin “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, më datën 13.07.2006.
10. Informacion për moszbatimin e ligjit dhe moskryerjen e veprimeve ligjore për lirin e godinave të studentëve të zëna në mënyrë të paligjshme, më datën 04.10.2006. Kjo është një çështje e zvarritur për të cilën do të flitet me hollësi tek kapitulli për ankesat ndaj Ministrisë së Arsimit.
11. Informacion për Rekomandimin drejtuar Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit etj, për marrjen e masave për krijimin e kushteve të pranueshme në shërbimin udhëtar në transportin hekurudhor, më datën 01.11.2006.
12. Mendime për projektligjin e ri “Për Policinë e Shtetit” drejtuar Komisioneve Parlamentare më datën 05.12.2006.

Pa u vetëkënaqur për sa më sipër, për të ardhmen ndjejmë si detyrë që të informojmë më tepër Kuvendin si për veprimtarinë tone, ashtu dhe për gjendjen e ligjshmërisë dhe të zbatimit të të drejtave të njeriut nga ana e Administratës Publike Shqiptare. Gjithashtu duhet të shfrytëzojmë akoma më tepër mundësinë për të rekomanduar në komisionet parlamentare marrjen e iniciativës legjislative direkt nga deputetët, në interes të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njerëzve në Shqipëri.

4. Kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese

Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ndër subjektet që kanë të drejtë të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese përfshihet edhe Avokati i Popullit.

Por, sipas nenit 134 të Kushtetutës, subjektet që mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese ndahen në dy grupe: në subjekte që mund të ushtrojnë kërkesë në mënyrë të pakushtëzuar dhe në subjekte, që mund të ushtrojnë kërkesë të kushtëzuar “vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre”. Ky dallim, del nga përmbajtja e pikës 2, të nenit 134 të Kushtetutës dhe në këtë kategori subjektësh që mund t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë të kushtëzuar, përfshihet edhe Avokati i Popullit.

Për vitin 2006 e kemi shfrytëzuar në dy raste këtë të drejtë:

I. Kërkesa e paraqitur më 9 shkurt 2006, bashkë me Komitetin Shqiptar të Helsinkit dhe Grupin Shqiptar të të Drejtave të Njeriut me objekt shfuqizimi si antikushtetues të:

1. Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 43, datë 27.I.2006 “Për shmangien e nepotizmit dhe ndikimit të pushtetit në rekrutimin dhe karrierën e personelit të administratës tatimore”.

2. Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 44, datë 27.1.2006. “Për shmangien e nepotizmit në administratën publike”.

3. Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.48, datë 27.1.2006 “Për disa shtesa në vendimin nr.205, datë 13.IV.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.

Paraprakisht: Kërkuam edhe pezullimin e zbatimit të tre vendimeve të mësipërme të Këshillit të Ministrave pasi zbatimi i tyre do të sjellë pasoja të dëmshme që çënojnë interesat e ligjshme të shtetasve.

Kjo kërkesë u argumentua si vijon:

1. Në të tre vendimet e sipërcituar të Këshillit të Ministrave janë kufizuar pa ligj të drejtat e njeriut të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konkretisht: parimi i barazisë para ligjit, parimi i mosdiskriminimit si dhe e drejta e punonjësve për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme që ata zgjedhin ose pranojnë vetë.

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë thuhet se:

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit.

2. Askush **nuk mund të diskriminohet padrejtësisht** për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjëndja ekonomike, arsimore ose përkatësia prindërore (nenet 18 i Kushtetutës së RSH)

3. “Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës me punë të ligjshme, që e kanë zgjedhur ose pranuar vetë. **Ai është i lirë të zgjedhë**

profesionin, vendin e punës si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional (49 të Kushtetutës).

4. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë **mund të vendoset vetëm me ligj** për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjestim me gjendjen që e ka diktuar atë (neni 17, paragrafi 1 i Kushtetutës së RSH).

Nga përmbajtja e dispozitave të mësipërme kushtetuese është e qartë se është

të **vetëm Kuvendi i Shqipërisë** që vlerëson nëse për shkak të një interesi publik ose në mbrojtje të të drejtave të të tjetërve mund të kufizohen këto të drejta. Gjithashtu, është Kuvendi i Shqipërisë **ai që vlerëson nëse kufizimet janë ose jo në përpjestim me gjendjen që e ka diktuar** atë dhe nëse ato çenojnë ose jo thelbin e të drejtave. Kuvendi i Shqipërisë është **i detyruar gjithashtu që kufizimet e të drejtave që mund të vendosen, të mos tejkalojnë** ato që parashikohen në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Nga sa u tha më lart, është mëse e qartë se **me miratimin e akteve normative të mësipërme, Këshilli i Ministrave ka ushtruar attribute që nuk i takojnë, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, sepse ka vënë kufizime të të drejtave të njeriut me akte nënligjore.**

2. Vendimet nr. 43, 44, 48 të Këshillit të Ministrave mbështeten në ligjin 8549, datë 11.11.1999” Për statusin e nëpunësit civil”, neni 9 të ligjit 7961, datë 12.7.1995 “Kodit i Punës i Republikës së Shqipërisë; ligjin 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike, ligjin nr. 8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Në fakt, në asnjë nga dispozitat e ligjeve të mësipërme nuk del që Këshilli i Ministrave të jetë ngarkuar me nxjerrjen e akteve nënligjore për të kufizuar të drejtat e shtetasve, të parashikuara në Kushtetutën e RSH, duke i ndaluar ata të punësohen në këtë apo në atë sektor të administratës publike për shkak të lidhjeve të tyre familjare, të gjinisë ose të krushqisë.

Tërheq vëmendjen faktin se vendimi nr. 43, datë 27.1.2006 “.Për shmangien e nepotizmit dhe ndikimit të pushtetit në rekrutimin dhe karrierën e personelit të administratës tatimore” i referohet nenit 9 të ligjit nr. 7961, datë 22.7.1999 “ Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”. Në këtë nen të Kodit të Punes thuhet: “Ndalohet çdo lloj diskriminimi në fushën e marrjes në punë dhe të profesionit” se “me diskriminim kuptohet çdo dallim, përjashtim ose parapëlqim që bazohet në racë, ngjyrë, seks,

moshë, fe, bindje politike, kombësi, origjinë shoqërore, **lidhje familjare**”.

Këshilli i Ministrave duke iu referuar dispozitës së mësipërme të Kodit të Punës, dispozitë që është në përputhje me nenin 18 dhe 49 të Kushtetutës, ka kufizuar një të drejtë të parashikuar në Kushtetutën e RSH, duke bërë të kundërtën e asaj që parashikohet në këtë nen të Kodit të Punës.

3. Sipas nenit 107, paragrafi i dytë i Kushtetutës së RSH, “Nëpunësit në administratën publike caktohen me konkurs më përjashtim të rasteve të parashikuara në ligj”.

Me vendimet e Këshillit të Ministrave ndalohet punësimi për shkaqe të lidhjeve familjare, gjinie ose krushqie, madje edhe në qoftë se punonjësi është pranuar në përputhje me ligjin “Për statusin e nëpunësit civil”, ai detyrohet të largohet, nëse rezulton se ka lidhje familjare, gjinie apo krushqie me Presidentin e Republikës dhe stafin e tij politik etj.

Këshilli i Ministrave i jep zbatimit të këtyre vendimeve fuqi jo vetëm për ata që do të punësohen, por edhe për ata që kanë vite që janë punësuar në këto detyra, efekte prapavepruese. Kjo vjen në kundërshtim me pikën 3 të nenit 107 të Kushtetutës ku thuhet se “Garancitë e qëndrimit në detyrë dhe trajtimi ligjor i nëpunësve publikë rregullohen me ligj”, sepse largimi i nëpunësve nga shërbimi civil bëhet vetëm në bazë të nenit 21 dhe 25 gërma “d” të nenit 25 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, për shkaqet e përmendura në këto ligje.

Këto tre vendime caktojnë rregulla edhe për marrëdhënie që janë rregulluar shumë kohë para hyrjes në fuqi të ligjeve ku thuhet se ato janë bazuar. P.sh: Kodi i Punës ka hyrë në fuqi në vitin 1995, Statusi i Nëpunësit Civil në vitin 1999, Kodi Doganor në vitin 1999, etj. dhe këto ligje vetë nuk kanë patur fuqi prapavepruese.

Theksojmë se as në fushën penale nuk zbatohet efekti prapaveprues kur në kohën e kryerjes së veprës penale nuk kishte ligj për ta ndëshkuar atë.

Veç sa më sipër, sipas nenit 118 të Kushtetutës, aktet nënligjore, siç janë edhe vendimet e Këshillit të Ministrave, merren në bazë edhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë e RSH. Në rastin konkret vendimet e Këshillit të Ministrave rregullojnë çështje që janë në kompetencën ekskluzive të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe që bien ndesh edhe me parimet që përcaktohen në ligjin “Statusi i nëpunësit civil” dhe ligjet e tjera ku “mbështeten” këto akte normative.

Duke patur parasysh se mënjëherë pas hyrjes në fuqi të vendimeve të mësipërme dhe udhëzimit të mësipër cituar:

1. Do të fillojnë procedurat e plotësimit të formularëve dhe verifikimet përkatëse qysh në momentin e kërkesave për të punësuar,

2. Se efektet e tyre do të shtrihen edhe në personat e punësuar më parë, por që mund të kenë lidhje familjare, gjinie apo krushqie brenda një institucioni publik si edhe në sektorin e doganës e të tatimeve,

3. Për parandalimin e pasojave të dëmshme, sepse mund të punësohen persona të tjerë në vend të atyre që do hiqen dhe në qofte se këta të fundit fitojnë ligjërisht të drejtën e rikthimit, rikthimi është praktikisht i pamundur, duke ju humbur tërësisht të drejtën e punësimit.

Palët kërkuese e konsiderojnë të justifikueshme kërkesën e tyre për pezullim te menjëhershëm të ekzekutimit të këtyre akteve normative të kundërshtuara. Në përfundim të shqyrtimit të bërë më datën 21.03.2006, Gjykata Kushtetuese pezulloi tre vendimet e Qeverisë.

Kurse në vendimin e saj përfundimtar nr.20 të datës 11.07.2006, Gjykata Kushtetuese vërejt:

“Shkaqet e parashtruara nga kërkuessit evidentojnë probleme të kontrollit kushtetues në aspektin e pajtueshmërisë së akteve normative me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Gjatë shqyrtimit të çështjes, Gjykata Kushtetuese vlerësoi të bazuar kërkesën për pezullim të zbatimit të vendimeve të Këshillit të Ministrave deri në një vendim përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese dhe me vendimin e datës 21.03.2006, vendosi pezullimin e tyre. Gjithashtu, ajo çmon se analiza e çështjeve që dalin në funksion të kontrollit kushtetues të këtyre akteve normative lidhet me faktin nëse vendimet e kundërshtuara kufizojnë të drejtat e njeriut dhe nëse ato janë në pajtim me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Për këtë, është e nevojshme që të analizohen një sërë dispozitash të Kushtetutës që trajtojnë drejtpërsëdrejti problemet e ngritura ose të lidhura me to dhe sidomos nenet 4, 17, 18, 49 të Kushtetutës.

Neni 49 i Kushtetutës ka këtë përmbajtje:

“1. Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional.

2. Të punësuarit kanë të drejtën e mbrojtjes shoqërore të punës”.

E drejta për punë që garanton neni 49/1 i Kushtetutës, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit profesional, me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetues, është një e drejtë e individit në sensin, që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës.

Kjo e drejtë e individit për të përfituar me punë të ligjshme, fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi.

E drejta për punë dhe liria e profesionit nënkupton çdo veprimtari të ligjshme që sjell të ardhura dhe që nuk ka afat të përcaktuar, me përjashtim të rregullimeve të veçanta ligjore. Në këtë kuptim, veprimi i organeve shtetërore që sjell pasoja të drejtpërdrejta në pengimin e veprimtarisë profesionale, përbën cenim të kësaj lirie veprimi. Garancia që i jep Kushtetuta individit lidhur me të drejtën për punë dhe lirinë e profesionit, ka si qëllim mbrojtjen e tyre nga kufizimet e papërligjura të shtetit.

Liria e profesionit nuk është thjeshtë një e drejtë për të patur një vend pune. Ajo nuk duhet kuptuar si e drejtë sociale, por dhe si liri negative që nuk lejon ndërhyrjen ose pengimin e shtetit, gjatë ushtrimit të saj.

Përcaktimi që i bën neni 49 i Kushtetutës të drejtës për punë duhet të merret në kuptim të dyfishtë. Ajo përbën një detyrim pozitiv që kërkon angazhimin shtetëror për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e një të drejte të tillë, por edhe detyrim negativ, i cili kërkon mosndërhyrjen e shtetit për të cenuar këtë të drejtë. Në këtë mënyrë e trajton të drejtën për punë edhe doktrina kushtetuese, duke theksuar se liria për punë mbrohet nga rregullimet kushtetuese.¹

2. Sipas nenit 17 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë e individit mund të kufizohen vetëm me ligj. Gjykata Kushtetuese vlerëson se në radhë të parë duhet të sqarohet se, ç'kuptohet me termin ligj. Kjo për faktin se në kundërshtim me pretendimet e kërkuësve, subjekti i interesuar argumenton, se me fjalën ligj, duhet të nënkuptohen të gjitha aktet normative, pra kjo shprehje duhet kuptuar “nga dhe në bazë të ligjit”.

Duke iu referuar përmbajtjes së nenit 17 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese çmon se kjo dispozitë, në mënyrën se si është formuluar, nuk i ka lënë mundësi delegimi ndonjë organi tjetër përveç Kuvendit si organ përfaqësues. Qëllimi i këtij neni është, që në rastin e kufizimeve, jo vetëm që duhet të respektohen kriteret e tjera të caktuara në të, por në mënyrë që garancitë të jenë sa më të plota, kompetent duhet të jetë vetëm një organ dhe pikërisht, organi më i lartë ligjvënës. Shprehja “vetëm me ligj” ka kuptimin që në rast se është i nevojshëm kufizimi i një të drejte të parashikuar në Kushtetutë, atëherë ky vlerësim është në diskrecion vetëm të ligjvënësit dhe jo të organeve të tjera, përfshirë edhe Këshillin e Ministrave. Rastin e delegimit të kompetencave Qeverisë për aktet me fuqinë e ligjit, Kushtetuta e ka shprehur në nenin 101 duke përcaktuar

edhe kriteret përkatëse të një rregullimi të tillë, gjë që nuk e ka bërë në nenin 17.

Termi “ligj” i përdorur në Kushtetutë dhe në përgjithësi në legjislacion, ka raste që nënkupton një interpretim të gjerë duke përfshirë dhe aktet nënligjore. Kjo ka të bëjë me rastet që u përkasin rregullimeve të përgjithshme, që nënkuptojnë përdorimin e fjalës ligj në kuptim të legjislacionit ose të së drejtës dhe jo të aktit të organit ligjvënës. Për të përcaktuar nëse ndodhemi para njërit ose tjetrit variant, rëndësi ka të sqarohet konteksti, nga i cili del qëllimi i normës. Nisur nga konteksti, fjala ligj, në nenin 17 të Kushtetutës, nuk ka të njëjtin kuptim me atë të përdorur në nenin 18 “barazia para ligjit”. Kjo shprehje e fundit identifikohet me të drejtën në përgjithësi, ndërsa e para të referon në kompetencën e një organi të vetëm. Konteksti në të cilën është përdorur shprehja “vetëm me ligj” nuk lejon që të bëhet interpretim i zgjeruar. Kjo edhe për faktin se një interpretim i tillë i normave kushtetuese mund të bëhet vetëm në aspektin pozitiv, kur ky interpretim shkon në favor të mbrojtjes së të drejtave dhe jo e kundërta si në rastin në shqyrtim. Këtë qëndrim ka mbajtur dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në praktikën e saj.²

Koncepti i zgjeruar i termit ligj që përdoret në doktrinë, nuk vlen për nenin 17 të Kushtetutës. Shprehja përjashtuese “vetëm me ligj” e përdorur në nenet 11/3 dhe 17 të Kushtetutës, kanë të bëjnë me kufizime të të drejtave dhe kanë kuptim të njëjtë, atë të interpretimit të ngushtë, në dallim nga dispozitat e tjera ku fjala ligj mund të kuptohet më gjerë.

Në këtë përfundim, veç sa u përmend, arrihet edhe duke iu referuar fjalës “vetëm” që përmendin nenet 11/3 e 17 të Kushtetutës. Përdorimi i kësaj fjale nuk është i rastit, por për të treguar se kufizime të tilla nuk mund të vendosen me ndonjë akt tjetër përveç ligjit.

Gjykata Kushtetuese çmon se rregullimi i parashikuar në nenin 17 për kufizimin e të drejtave dhe lirive vetëm me ligj, ka të bëjë edhe me përcaktimin e kompetencës së një organi konkret që në këtë rast është vetëm Kuvendi. Një shprehje e tillë të referon në kompetencën e organit ligjvënës dhe nxjerrja e akteve të tjera për të rregulluar marrëdhënie të tilla, cenon kompetencat e këtij organi.

Duke përfunduar analizën e shprehjes “vetëm me ligj”, parashikuar në nenin 17 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese, vlerëson se çdo interpretim i kundërt, është padyshim një zhvleftësim i garancisë që jep Kushtetuta për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe efektivisht do t'i cenonte këto liri e të drejta.

3. Përveç sa sipër, vendimet e Këshillit të Ministrave, objekt kërkese, i shtrijnë efektet edhe për ato marrëdhënie që kanë lindur më parë. Në bazë të tyre, personat e punësuar në sektorët përkatës të

përcaktuar në këto vendime, detyrohen të lenë vendin e punës, nëqoftëse vërtetohet shkaku i papajtueshmërisë që ka të bëjë me lidhjet nepotike apo lidhjet nepotike me pushtetin.

Nga përmbajtja e vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.43 e 48, del se “lidhje nepotike me pushtetin ekzistojnë apo lindin kur konkurrentët apo personeli ... kanë apo krijojnë lidhje nepotike”. Kurse në vendimin nr.44, përcaktohet se “përbën shkak për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës ekzistenca e lidhjeve ...”.

Nga këto shprehje kuptohet se vendimeve u është dhënë fuqi prapavepruese, duke prekur edhe ata punonjës që kanë qenë në marrëdhënie pune para daljes së vendimeve. Antikushtetutshmëria e vendimeve nuk qëndron vetëm në faktin se vendimet e Këshillit të Ministrave kanë efekt edhe për marrëdhëniet e krijuara më parë, por dhe për shkak të mosrespektimit të parimit të proporcionalitetit, sepse punonjësve që preken nga këto vendime nuk u sigurohet punë tjetër. Sipas këtij parimi, nga të gjitha mjetet e ndryshme që mund të shfrytëzohen për të arritur një qëllim të ligjshëm, autoriteti administrativ duhet të përdorë mjetet ligjore më të përshtatshme, me të cilat, mund të arrihet në shkaktimin e padrejtësisë më të vogël për një individ. Prandaj duhen përdorur vetëm mjetet që shkaktojnë padrejtësinë minimale për individin dhe me masa sa më pak të dëmshme për të. Kjo nënkupton elementin e dytë të parimit. Ky parim kërkon detyrimisht dhe plotësimin e kushtit të tretë, sipas të cilit ndërhyrja në të drejtat e individit nuk duhet të jetë jashtë raportit të qëllimeve të aspiruara. Në këtë mënyrë, përfshirja e tre elementeve të domosdoshëm kërkon, që një masë ose mjet, duhet të jetë i përshtatshëm dhe i nevojshëm për të arritur një qëllim të kërkuar dhe mjeti e qëllimi të qëndrojnë në përpjestim të arsyeshëm.

Parimi i shtetit të së drejtës ku të mbështetet një shtet demokratik, nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike. Disa nga elementet e shtetit të së drejtës që lidhen me objektin e këtij shqyrtimi kushtetues janë parimi i ndarjes së pushteteve, miratimi i ligjeve në përputhje me Kushtetutën, mbështetja e veprimtarisë së organeve ekzekutive vetëm në ligj, kontrolli i administratës, garantimi i të drejtave dhe lirive themelore dhe parimi i sigurisë juridike.

Sipas doktrinës, praktikimi i një profesioni mund të kufizohet nga rregullime të arsyeshme që mund t’i atribuohen konsideratave të së mirës së përgjithshme. Situata ndryshon kur shteti drejtohet për të kontrolluar kushtet objektive të pranimit në një vend pune. Në këto raste, kufizimet janë të lejueshme vetëm në terma shumë të ngushta dhe të përcaktuara. Përgjithësisht, legjislatori mund të vendosë kushte të tilla vetëm kur ato

nevojiten për të treguar rreziqe jashtëzakonisht shumë të mundëshme për interesa të një rëndësie thelbësore të komunitetit.³

Lidhur me këtë, Gjykata Kushtetuese në një vendim të saj shprehet se “Doktrina e së drejtës kushtetuese ka pranuar se siguria juridike është ndër elementet thelbësorë të shtetit të së drejtës. Kjo siguri presupozon veç të tjerave besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me faktin se qytetari nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve normative që cenojnë dhe përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Nuk do të kishim të bënim me një rast të garantimit të besueshmërisë në sistemin e normave juridike nëse siguria lidhur me një situatë të caktuar juridike nuk mund të justifikohet dhe nuk mund të mbrohet materialisht”.⁴

Duke iu referuar rastit konkret, lidhur me rregullimet që bëjnë tre vendimet e Këshillit të Ministrave përsa i përket efekteve prapavepruese, duhet theksuar se edhe në rast se këto kufizime do të ishin bërë me ligj, sipas kriterëve të nenit 17/1 të Kushtetutës, duhej të zbatoheshin parimet e përmendura më lart.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkesa e paraqitur është e bazuar, duhet të pranohet dhe se vendimet e Këshillit të Ministrave duhen shfuqizuar si të papajtueshme me Kushtetutën.

Prandaj me Vendimin e saj nr.20, datë 11.07.2006 vendosi shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.43, datë 27.01.2006 “Për shmangien e nepotizmit dhe ndikimin e pushtetit në rekurrimin dhe karrierën e personelit të administratës tatimore”; nr.44, datë 27.01.2006 “Për shmangien e nepotizmit në administratën publike” dhe nr.48, datë 27.01.2006 “Për disa shtesa në vendimin nr.205, datë 13.04.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.”

Për fat të keq kohët e fundit jemi informuar se shtetasit që ishin larguar nga puna në bazë të tre vendimeve të mësipërme, jo vetëm nuk janë kthyer në punë, por as që u paguhet paga për këtë kohë që janë lënë pa punë në mënyrë të paligjshme. Ka një “kokëfortësi” të paspjegueshme të drejtuesve, sidomos të doganave dhe tatimeve, në refuzimin e tyre për të zbatuar direkt jo vetëm vendimin e Gjykatës Kushtetuese, por edhe ato të Komisionit të Shërbimit Civil dhe të Gjykatës së Apelit, në rastet e rivendosjes së të drejtave të individëve të larguar nga puna, në bazë të këtyre 3 vendimeve, apo edhe për shkaqe të tjera. Është për të qarë hallin, por edhe për të qeshur p.sh., kërkesë padia e drejtorisë së Përgjithshme të

Doganave kundër vendimit të K.Sh.Civil për ankuesen G.M., kur arsyeton se: “masa disiplinore “largim nga puna” ndaj G.M. është i ligjshëm pasi është bazuar në VKM nr.48, datë 27.01.2006.. Ky vendim është në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet ku është mbështetur. Në vendimin e dhënë (nr.20, datë 11/07.2006) Gjykata Kushtetuese ka pasur dhe mendim pakice, që argumenton shumë saktë mbështetjen në ligj të VKM nr.48, datë 27.01.2006”. Duket qartë se kjo drejtori “anullon apo zëvendëson Gjykatën Kushtetuese në funksionin e saj”.

II. Kërkesa e paraqitur më 3 tetor 2006, bashkë me Kontrollin e Lartë të Shtetit me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të pikës 1 të nenit 1, nenit 4, pikës 2 të nenit 7, nenit 9, pikave 1 e 2 të nenit 10 përsa përfshijnë institucionet e pavarura kushtetuese dhe nenit 20 të Ligjit nr.9584 datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”.

Kjo kërkesë është arsyetuar si vijon:

Institucionet kushtetuese Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Avokati i Popullit, paraprakisht janë njohur me projektligjin e përgatitur nga Qeveria “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të krijuara me ligj”, për të cilin paraqitëm në Kuvend vërejtjet dhe sugjerimet përkatëse, me qëllim që ky ligj të ishte në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe ligjet organike të institucioneve kushtetuese që përfaqësojmë.

Megjithatë nga ana e Kuvendit nuk u morën parasysh këto vërejtje. Si rrjedhim, Kuvendi miratoi me shumicë të thjeshtë Ligjin nr.9584 datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”.

Nisur jo vetëm nga titulli i ligjit, por nga përmbajtja e pikës 1 të nenit 1, nenit 4, pikës 2 të nenit 7, nenit 9, pikave 1 dhe 2 të nenit 10, si dhe nenit 20 të këtij ligji, vërejmë se këto dispozita janë të papajtueshme me Kushtetutën në dy aspekte:

1. Në aspektin formalo juridik, ligji në fjalë nuk pajtohet:

a. Me nenin 6 të Kushtetutës që përcakton se “**Organizimi dhe funksionimi i organeve të parashikuara në këtë Kushtetutë rregullohen me ligjet e tyre përkatëse, përveç rasteve kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe**”.

Dihet se elementet e strukturës dhe organikës (numri i punonjësve) janë pjesa e pandarë e konceptit organizim të një institucioni apo çdo strukture tjetër shtetërore. Këto dy elemente aktualisht, në zbatim të kësaj Kushtetute, janë rregulluar shprehimisht në ligjet përkatëse organike të institucioneve tona. Konkretisht në nenet 31, 32 e 35 të ligjit “Për

Avokatin e Popullit” dhe me nenin 12 të ligjit “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”. Kjo papajtueshmëri ekziston edhe në raport me ligjet organike të institucioneve të tjera Kushtetuese të thirrur në këtë gjykim si subjekte të interesuara.

b. Me gërmën “a” të pikës 2 të nenit 81 të Kushtetutës që përcakton se **ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit**. Konkretisht dihet se nga votimi i ligjit që kundërshtojmë ka rezultuar se ai është miratuar nga shumica e përbërë me pak se 84 deputetë. Këtë e vërteton edhe fakti se në Kuvend nuk u fut për votim projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në disa ligje organike”, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 353 datë 14.06.2006, i cili është depozituar në Kuvend në të njëjtën kohë me propozimin e ligjit të miratuar nr.9584 datë 17.07.2006.

2. Në aspektin substancial dispozitat e ligjit që kërkojmë të shpallet si antikushtetues çënojnë pavarësinë e disa institucioneve Kushtetuese. Kjo pavarësi për institucionin e Avokatit të Popullit garantohej nga pika 2 e nenit 60 të Kushtetutës ku parashikohet shprehimisht “**Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij**”. Po kështu edhe për **Kontrollin e Lartë të Shtetit pika 1 e nenit 162 e Kushtetutës përcakton se “është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar. Ai u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve”**. Kjo pavarësi garantohej me dispozita të Kushtetutës edhe për institucione të tjera Kushtetuese.

Dëshirojmë të theksojmë se, ashtu siç dihet dhe përcaktohet edhe në të gjitha tekstet e shkencave juridike nocioni i pavarësisë së një institucioni përfshin tre aspekte; pavarësinë organizative, pavarësinë funksionale dhe atë financiare.

Ne gjykojmë se përcaktimet e bera në Ligjin nr.9584 datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, i kundërvihen hapur këtyre parimeve si dhe garancive kushtetuese dhe ligjore nga të cilat buron pavarësia dhe integriteti i institucioneve kushtetuese që përfaqësojmë.

a. Pavarësia organizative e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Avokatit të Popullit shprehet në mënyrën e:

- *zgjedhjes së Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe të Avokatit të Popullit*. Ata zgjidhen në Kuvend, me një mandat përkatësisht 7 dhe 5 vjeçar me të drejte rizgjedhjeje dhe nuk emërohen nga Qeveria (ekzekutivi). Gjithashtu edhe të gjithë stafet të cilët punojnë në këto institucione zgjidhen dhe emërohen nga ne, me përjashtim të tre

komisionerëve që propozohen nga Avokati i Popullit dhe zgjidhen nga Kuvendi.

-Imuniteti i Kryetarit të KLSH-së dhe Avokatit të Popullit është një tjetër element i pavarësisë, pasi ata gëzojnë imunitetin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

Në Ligjin nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, pavarësia e garantuar në Kushtetute detajohet në disa elemente të tjerë shumë të rëndësishëm për funksionimin normal të këtij institucioni në përputhje me objektin e punës që ai ka. Të tillë elemente janë:

-Emërimi i një përfaqësuesi vendor (neni 32) nga vetë Avokati i Popullit, për një çështje dhe për një kohë të caktuar.

-Personeli i Zyrës së Avokatit të Popullit bën pjesë në Shërbimin Civil. Struktura dhe organika e zyrës së Avokatit të Popullit caktohet nga Avokati i Popullit. Në tërësinë e vet, neni 35 i Ligjit “Për Avokatin e Popullit” shpreh dhe sanksionon pavarësinë, jo vetëm në përzgjedhjen dhe emërimin e personelit (veç komisionereve), por edhe të drejtën që ka Avokati i Popullit për percaktimin e organizimit të brendshëm të zyrës së tij.

Në Ligjin organik “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, detajimi i elementeve të tjera shumë të rëndësishëm për funksionimin normal të këtij institucioni, shprehet në:

-Të drejtën që ka Kryetari i KLSH-së për caktimin e drejtoreshave të departamenteve dhe për të vendosur për departamentet e veta rajonale (neni 10).

-Të drejtën e Kryetarit të KLSH-së për të vendosur për strukturën, organiken dhe emërimin e funksioneve të KLSH-së, kompetencat dhe detyrat e drejtoreshave dhe njesive organizative (neni 12).

b. Pavarësia funksionale qëndron në faktin se asnjë organ apo institucion tjetër që përbëjnë tre pushtetet nuk mund të ndërhyjnë në trajtimin e çështjeve që përbëjnë objektin e veprimtarisë së institucioneve tona. Kjo sepse sipas nenit 162/1 të Kushtetutës, *Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar. Ai u nënshtrohet vetëm Kushtetutes dhe ligjeve. Sipas nenit 60/2 të Kushtetutes tonë, Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij.*

c. Për pavarësinë financiare, kushtetuta në nenin 60/3 shprehet se *Avokati i Popullit ka buxhet të veçantë, të cilin e administron vetë. Financimi i institucioneve tona që bëhet nga buxheti i shtetit, në këtë kuptim, përcaktohet në një kre të veçantë. Projektbuxheti propozohet nga vetë Avokati i Popullit në Komisionin e Përhershëm të Ekonomisë dhe Financave dhe Privatizimit, i cili e paraqet më pas për miratim në Kuvend.*

Të njëjtën rrugë, sipas përcaktimeve të nenit 3 të Ligjit “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” ndjek edhe rasti i buxhetit vjetor të Kontrollit të Lartë të Shtetit që propozohet nga Kryetari i KLSH-së.

3. Që në titullin e ligjit që përbën objekt shqyrtimi konstatohet se bëhet një barazim në trajtimin e *institucioneve të pavarura kushtetuese*, me ato të tjera të *quajtura të pavarura, të krijuara me ligj*. Nuk mund të cënohen parimet kushtetuese që lidhen me pavarësinë e Institucioneve të Pavarura Kushtetuese, nga iniciativa të ekzekutivit për barazim apo njëtrajtësim të këtyre organeve. Kjo vlen edhe për trajtimin e tyre nga pikepamja organizative dhe financiare, duke mbajtur parasysh prevalencën e institucioneve të krijuara me Kushtetutë, ndaj atyre të krijuara me ligj.

Ky konstatim bëhet me i dukshëm po t’i referohemi përmbajtjes së pikës 2, të nenit 1 të këtij ligji, ku termi “*institucione të Pavarura Kushtetuese dhe institucione të tjera të pavarura të krijuara me ligj*”, merret si një dhe i pandare, nderkohe që me pas jepen nominalisht emertesat e institucioneve konkrete që përfshihen në këtë grupim, por edhe duke bërë përjashtime për Gjykatën e Lartë, Prokurorinë dhe Bankën e Shqipërisë.

Ndalemi në këtë moment, pasi konceptimi korrekt për institucionet sipas mënyrës së krijimit dhe rolit të tyre, përcakton edhe një sërë parimesh dhe rregullash të tjera të rëndësishme, respektimi i të cilave nuk bën gjë tjetër, por shkon në përputhje me Kushtetutën e cila i ka krijuar ato dhe ka përcaktuar edhe specifika të tjera në këtë funksion.

Çështja që shtrohet është se, a duhet të barazohen në trajtimin organizativ, administrativ dhe financiar njëkohësisht institucionet e pavarura Kushtetuese, me ato të tjera, *te pavarura të krijuara me ligj*?

Kur bëjmë fjale për “Institucione të Pavarura Kushtetuese”, kuptojmë që këto institucione parashikohen shprehimisht për krijimin dhe funksionimin e tyre nga Kushtetuta. Ky grupim institucionesh, sikurse ai i Kuvendit, Presidentit, Gjykatës Kushtetuese, Avokatit të Popullit, Kontrollit të Lartë të Shtetit etj, me këtë mënyrë krijimi dhe rregullimi, kanë ligjërisht një garanci me të madhe për ekzistencën dhe funksionimin normal të tyre, pasi garant në këtë mes është vetë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Në përputhje me nenin 116 të Kushtetutës dhe në referencë të hierarkisë të akteve normative që kanë fuqi në territorin e Republikës së Shqipërisë, *Kushtetuta qëndron mbi marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, mbi ligjet dhe aktet normative të Këshillit të Ministrave*. Në këtë këndvështrim, nuk mund të vihet shenjë barazimi për dy kategoritë e sipërcituara të institucioneve që trajtohen në këtë ligj. Problemet që dëshëron të rregullojë ligjvënësi mund të rregullohen vetëm duke zbatuar

dhe respektuar garancitë kushtetuese të parashikuara në nenet 6 dhe 81/2a të Kushtetutës.

4. Në nenet 7 dhe 9 të ligjit, shihet tendenca e qarte për barazimin dhe unifikimin e kabineteve të ministrive me ato të institucioneve të pavarura kushtetuese, sikurse sekretar i përgjithshëm dhe specialist i ministrive me ato të institucioneve të pavarura kushtetuese. Për çfarë pavarësie do të bëjmë fjalë në këtë përcaktim të ri që bën ligji, kur është një *parim dhe standart i njohur ndërkombëtar për këto institucione*, kontributi i tyre në sistemin e kontrollit të pushtetit si shembull i *“pushtetit që kontrollon pushtetin”*.

Një element shumë i rëndësishëm që ka ndikuar ndjeshëm në punën e paanshme, profesionale të KLSH-së dhe Avokatit të Popullit, ka qenë pikërisht sistemi stimulues i pagave dhe shpërblimeve të nëpunësve civilë dhe funksionarëve të kabinetit në këto institucione, sistem ky i mbështetur në bazën ligjore ekzistuese dhe në parimet e funksionimit si institucione të pavarura kushtetuese. Prishja e sistemit aktual të pagave, struktura dhe organika ekzistuese të këtyre dy institucioneve, sikurse parashikohet në këtë ligj, përben në thelb cenim të pavarësisë të garantuar për të nga Kushtetuta.

Në përfundim të kësaj analize kemi krijuar mendimin se, ligji objekt shqyrtimi, vjen në kundërshtim me Kushtetutën, duke cenuar pavarësinë e institucioneve të Kontrollit të Lartë të Shtetit të Avokatit të Popullit, për sa vijon:

- Në teresinë e vet cenon pavarësinë e këtyre institucioneve në elementet me të ndjeshëm ato të organika, struktura dhe pagave apo shpërblimeve.

- Barazohet niveli i përcaktimit të pagave të nëpunësve të institucionit, me pjesën tjetër të administratës që është nën varesinë e ekzekutivit. Nderkohe ky nivel i ri që kërkon të vendoset është i paargumentuar për vetë statusin ligjor që kanë institucionet tona.

- Krijohet premisa për cenimin e elementeve të tjera që përcaktojnë termin e dhënë në Kushtetutë për pavarësinë e institucioneve kushtetuese.

- Mund të vlerësohet si formë presioni nga ana e ekzekutivit, ndaj institucioneve që, në fund të fundit, *cilesohen si të pavarura*, por që *në thelb nuk janë vendimmarre*.

Parashikimet e bera në këtë ligj gjykojmë se do të kenë pasoja direkte në performancën në teresi të institucioneve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe të Avokatit të Popullit, jo vetëm në aspektin juridiksional dhe të kompetencës, por do të ndihen tek burimet njerezore dhe financiare.

Parimet ndërkombëtare të krijimit dhe funksionimit të institucioneve të pavarura kushtetuese, sikurse Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Avokati i Popullit parashikojnë se krijimi, organizimi dhe funksionimi

i tyre, duhet te kete garancite e nevojshme per ruajtjen institucionale te pavaresise se tyre. Konkretisht, Deklarata e Limes për Institucionet Supreme të Kontrollit dhe normat e kontrollit duhet të gjejë zbatim nëpërmjet praktikave kushtetuese e ligjore që mundësojnë një aktivitet sa më të paanshëm dhe objektiv të tyre. Më konkretisht, kjo Deklaratë përcakton:

Kapitulli V: “Pavarësia e Institucioneve Supreme të Kontrollit”, pika 2 përcakton se: “Institucionet Supreme të Kontrollit duhet të kenë pavarësinë funksionale dhe organizative të nevojshme për përmbushjen e detyrave të tyre”.

Kapitulli VI: Pavarësia e titullarëve dhe zyrtarëve të Institucioneve Supreme të Kontrollit, pika 3 përcakton se: “Në karrierën e vet profesionale, stafi i Institucioneve Supreme të Kontrollit nuk duhet të influenohet dhe të ketë vartësi nga institucionet e kontrolluara”.

Kapitulli VII: Pavarësia financiare e Institucioneve Supreme të Kontrollit, pikat 1 dhe 3 parashikojnë që: “Institucionet Supreme të Kontrollit duhet të kenë të gjithë mjetet e dhura financiare për përmbushjen e detyrave të tyre. Atyre duhet t’u sigurohet përdorimi i fondeve të alokuara, nën një kapitull të veçantë buxheti, në mënyrën që ato shohin më të përshtatshme”.

Në kuadër të detyrimeve të marra përsipër në formën e marrëveshjeve ndërkombëtare, duhet përmendur edhe Ligji nr.9590 datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare”, që në nenin 90, përcakton se: “... *Palët bashkëpunojnë në mënyrë të veçantë për të zhvilluar një sistem efikas të Kontrollit Financiar dhe të Brendshëm Publik dhe sisteme të auditimit të jashtëm në Shqipëri, në përputhje me standartet dhe metodologjitë e pranuar botërisht si dhe me praktikat më të mira të BE-së*”.

Veç kesaj, rekomandimi nr.1615 i miratuar nga Asambleja Parlamentare e Keshillit të Europës më 8 Shtator 2003, për institucionin e Ombudsmanit pohon se: “*Garantimi i burimeve të mjaftueshme për kryerjen e të gjithë përgjegjesive të institucionit që të ushtrohen në mënyrë të pavarur nga nderhyrjet e mundshme të ekzekutivit, si dhe sigurimi i autonomise për çështje të buxhetit dhe stafit, duhet të jete pikësnyim kryesor i realizimit nga vendet anëtare, (pika 7/vii)*”.

Ne vijim të angazhimeve dhe qendrimeve ndërkombëtare për rolin dhe pavaresinë e institucioneve kombëtare të drejtave të njeriut, Karta e Kopenhagenit miratuar në Konferencën e OSBE-se, 29 Qershor 1990, parashikon se: “*Shtetet anëtare duhet të mundësojnë ngritjen dhe forcimin e institucioneve kombëtare në fushën e të drejtave të njeriut dhe të shtetit ligjor, duke dhene garancite e dhura për pavaresinë e integritetin e*

tyre”. Moszbatimi i kriterëve të Kopenhagenit bazuar në statutin e anetaresisë të Këshillit të Europës, pasqyrtim ose kalim të anetarit në rolin vezhgues në mbledhjet e organeve përkatëse të këtij organizmi ndërkombëtar.

Në thelb këto përcaktime jo vetëm japin parimet e ngritjes dhe funksionimit të institucioneve të pavarura kushtetuese, sikurse Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Avokati i Popullit, por përbejnë edhe një detyrim për shtetin të marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara dhe të ratifikuara, moszbatimi i të cilave përben mospërbushje të standarteve të kërkuara duke u parashikuar edhe sanksione”.

*
* *

Kjo çështje u shqyrtua në Gjykatën Kushtetuese më datën 20 nëntor 2006 dhe morën pjesë si persona të interesuar edhe Gjykata e Lartë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Prokuroria e Përgjithshme, të cilët u bashkuan me kërkesën e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Avokatit të Popullit.

Pritet vendimi i Gjykatës Kushtetuese.

5. Marrëdhëniet e Avokatit të Popullit me Publikun dhe Median

Kemi thënë dhe mbajtur gjithmone parasysh faktin se një Ombudsman i panjohur nuk mund të jetë Ombudsman. Kjo për arsye të efektivitetit të një zyre të tillë varet në masën më të madhe nga reputacioni dhe integriteti i saj. Po të kemi parasysh edhe faktin tjetër të forcës së munguar imponuese që përmban instrumenti i përditshëm i këtij institucioni, sikurse është “rekomandimi”, elementet e reputacionit dhe integritetit të institucional marrin një rëndësi edhe më të madhe. Kjo është përse i takon autoritetit publik. Ana tjetër i takon publikut. Sa më i njohur dhe më integritet të jetë një Ombudsman, aq më i madh është besimi i publikut tek kjo zyre. Por jo vetëm besimi i publikut. Me një rëndësi më të madhe është informimi i tij për shërbimin që ofron ky institucion.

Kjo është arsyeja që, qysh në fillim të veprimtarisë të institucionale, marrëdhëniet me publikun i konceptuam si një teresë raportesh që krijohen nga performanca funksionale e çdo punonjësi të zyrës të tyre. Nga ky konceptim kemi kaluar edhe në konkretizimin e tij, sikurse është ngritja e infrastrukurës së nevojshme që mundësojnë në

menyre efikase informimin e publikut. Me kete rast kemi patur parasysh dy drejtime themelore, sikunder jane informimi i qytetareve per sherbimet e zyres, pritja dhe sqarimi i tyre korrekt per tu ardhur ne ndihme halleve dhe shqetesimeve qe ata ngrejne prane nesh, dhe e dyta, informimi i publikut permes medias rreth nderhyrjeve tona mbi bazen e ceshtjeve te ndryshme, ne varesi te rendesise se tyre.

Me konkretisht, prane Avokatit te Popullit funksionon nje zyre e veçante dhe person i veçante qe merret me pritjen e ankuesve dhe qe ofron sherbimin e pare nga zyra e Avokatit te Popullit. Ky element perben ate qe quhet front office ose zyra e parme. Veç sqarimit paraprak te qytetareve, personi i posaçem qe punon ne kete zyre realizon edhe regjistrimin e rasteve konkrete, per t'ia percjelle me pas keto nje elementi tjeter qe quhet back office ose zyra e pasme, qe perfshin strukturalisht protokollin dhe arkiven. Ndersa nga ana funksionale parashikon angazhimin e te gjitha strukturave te institucionit per te adresuar sipas rastit lenden e filtruar nga zyra e parme. Keto elemente, te cilat ne i kemi zbatuar ne Institucionin tone, ne i kemi sugjeruar edhe ne rregulloren tip qe i kemi derguar Qeverise per ta miratuar si Rekomandim te Avokatit te Popullit, ne menyre qe nje praktike e tille te unifikohet ne shkalle vendi ne tere piramiden administrative te vendit.

Nderkohe, konceptin e marredhenieve me publikun, sikunder e shpjeguem me lart, Avokati i Popullit nuk e ka ngaterruar me konceptin dhe funksionin e zedhenesit te institucionit. Ky i fundit perben nje funksion institucional qe ka te beje me shume me promovimin e veprimtarise se institucionit, me berjen publike te politikave te institucionit, pra me profilizimin gjithnje e me pozitiv te imazhit te institucionit. Ne funksion te ketij qellimi, ne kemi hartuar nje strategji te shkruar, e cila perfshin ne teresine e saj te gjitha elementet e mundshem qe duhet te funksionalizojne nje institucion i ri ose tradicional qofte, per te krijuar e rritur imazhin e tij dhe mbi te gjitha besimin te publiku dhe autoritetet, pra ate qe perben reputacionin dhe integritetin e tij institucional. Kete strategji ne e kemi bere te ditur dhe botuar thuajse ne te gjitha raportet e meparshme vjetore, dhe komponentet e saj vazhdojne te mbeten fusha gjithnje per te elaboruar dhe prodhuar here pas here profile te te ndryshme funksionale, ne varesi te problematikave qe ndjek institucioni.

Avokati i Popullit e ka bërë të mundur njohjen dhe promovimin e punes e tij duke qene ne kontakt te perditshem me gazetaret dhe furnizuar ata me informacione ne menyre profesionale, larg çdo inercie sekretomanie, pa rendur pas lajmeve qe shkaktojne skandale, por edhe pa u lidhur duart atyre vetem me njoftime per shtyp.

Marrëdhëniet me median gjithmonë i kemi parë me përparësi, sepse kemi patur dhe kemi si objektiv të rrisim besueshmërinë e publikut ndaj institucionit tonë në praktikë. Jemi të bindur se **suksesi** arrihet duke u bazuar në dy shtylla, të cilat **profesionalizmi** dhe **besueshmeria**.

Ajo që kemi synuar është mënjanimi i çdo elementi demagogjik në marrëdhëniet me median. Ne mendojmë se këtë e kemi arritur, duke zbatuar një strategji disi të veçantë të informimit për punën tonë. Modeli tashmë i konsoliduar në marrëdhëniet me median është përqendruar në tre nivele komunikimi. E para, mediave u kemi dhënë materiale, kryesisht mbi bazën e rasteve konkrete. E dyta, jemi munduar të bëjmë përgjithësime, duke shpjeguar rolin, kompetencat dhe juridiksionin tonë pas çdo rasti konkret, të trajtuar gjithmonë me mjaft transparencë nga ekspertët tanë. E treta, njoftimet për shtypin, të shpërndara për median sipas rasteve dhe aktivitetit të Zyres, pasqyrohen brenda ditës edhe në faqen tonë elektronike.

Përmes Medias ne jemi njohur edhe me ankimet e mjaft njërëzve, por dhe me prioritetet e Qeverisë shqiptare. Në këtë mënyrë, fokusin e punës tonë e kemi drejtuar për të krijuar precedentë në ato sektorë të qeverisjes, tek të cilët kërkohet krijimi dhe rritja e standarteve për shërbimet publike, presioni për uljen e kostos së këtyre shërbimeve, domosdoshmëria e zbatimit të vendimeve gjyqësore, të drejtat e fëmijëve, zbatimi i të drejtës së informimit, përmirësimi i legjislacionit për pronësinë, lufta kundër korrupsionit, kundër abuzimeve të zyrtarëve si dhe fusha të tjera që janë pasqyruar në kreun përkatës sipas rasteve. Tek media kemi patur aleatin më të sigurtë për tu bërë pjesë e opinionit publik, në rastet kur na është dashur të ndeshemi me rezistencën e atyre zyrtarëve publikë, të cilët fatkeqësisht ende e konsiderojnë rekomandimin e Avokatit të Popullit si diçka bezdisëse.

Informacionet nga shtypi përbëjnë bazën e një drejtimi të rëndësishëm të punës tonë, sikundër është vënia në lëvizje me vetiniciativë, parashikuar nga neni 13-te i Ligjit “Për Avokatin e Popullit”. I gjithë spektri i shtypit të përditshëm, atij periodik shqiptar si dhe shërbimi i plotë i ATSH-se, filtrohet posaçërisht çdo ditë në zyrën tonë.

Sikunder permenden edhe me lart, mjetet që kemi përdorur kanë qënë ato të parashikuara në strategjinë që kemi formuluar që në fillim të veprimtarisë sonë njohëse dhe sqaruese për grupe të ndryshme të komunitetit. Produktet e Zyres së Avokatit të Popullit si broshura “Avokati i Popullit në Shqipëri – Ombudsmani Parlamentar” (në shqip, anglisht dhe frëngjisht), posterat tematikë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përmbledhjet me tituj “Akte ligjore në ndihmë të të burgosurve shqiptarë jashtë vendit” si dhe “E drejta e informimit – e drejtë themelore

e njeriut”, apo pesë fletëpalosje për grupe te ndryshme interesi, përmes te cilave shpjegojme rolin, kompetencat dhe rrugët si mund t’i drejtohen Avokatit të Popullit kane qene ne qarkullim pergjate gjithe vitit. Gjate vitit 2006 ne filluam edhe botimin e gazetës “Avokati i Popullit”, botim te cilin synojme ta vazhdojme edhe kete vit sapo te sigurojme qendrueshmerine financiare per botimin e saj, nga ana e Agjencise Nderkombetare te Frankofonise, e cila ka mundesuar edhe botimin e dy numrave te pare. Ne bashkepunim me OSBE-ne kemi realizuar afishimin thuajse ne te gjitha institucionet publike, komisarjate dhe vende te vuajtjes se denimit, te tre posterave te medhenj, ku qytetarët informohen per te drejtat e tyre per informim, per problemet e mjedisit dhe per te drejtat e tyre ne momentin e ndalimit ose paraburgimit. Kete vit synojme qe, po ne bashkepunim me OSBE-ne, te botojme nje Manual “per te drejtat e te burgosurve shqiptare brenda vendit” si dhe disa fletepalosje ne gjuhen e pakicave, nese mund t’i quajme keshtu per marreveshje fjale. Dokumentari njohës dhe promovues për Institucionin e Avokatit të Popullit tashmë është vënë në dispozicion dhe transmetuar në shumicen e televizioneve lokale dhe kombëtare. Të disponueshme kanë qenë edhe pesë spotet televizive që informojnë publikun për shërbimet që ne ofrojmë dhe rrugët e përfitimit të këtyre shërbimeve. Ne prodhim jane edhe dy spote televizive per te drejtat e femijeve, te cilat do te afishojne funksionimin e nenseksionit per te drejtat e femijeve si dhe adresat e dy zyrave rajonale, tashme te hapura respektivisht ne Shkoder dhe Korçe. Instalimi i teknologjisë informative na ka mundësuar që tashmë të kemi edhe faqen tonë në Internet, ku të interesuarit mund të gjejnë të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me zyrën tonë dhe aktivitetin që kryen ajo.

Mbulimi mediatik ka qenë gjithmonë në përshtatje me problematikën dhe intensitetin e punës që institucioni ka kryer. Larmia e problematikës, që është pasqyruar në Media është pa komente në tabelat përkatëse me statistikat e mbulimit mediatik. Duke u nisur qoftë edhe nga titujt e informacioneve, bëhet e qartë edhe veprimtaria që kemi kryer dhe sa kemi mundur ta bëjme të njohur atë për publikun.

a) Sektori i pritjes se popullit

1. Organizimi i punes

Avokati i Popullit edhe gjate vitit 2006, vazhdon ti kushtojte nje rendesi kryesore funksionimit ne çdo kohe, pa pengesa, me kulture e profesionalizem, të zyrës se Pritjes se Popullit. Ne kete zyre qytetaret qe paraqiten per ankesa apo kerkesa, ndjehen te mirepritur siç duhet dhe perfitojne aty çfare mund t’iu ofroje institucioni yne. Ketu qytetaret, ne

çdo ore te dites gjate orarit zyrtar, mund te paraqesin ankesat apo kerkesat e tyre dhe te marin sqarimet e nevojshme.

Me masat qe jane mare, eshte arritur qe ky sherbim qe i ofrohet qytetareve te jete sa me cilesor. Ai ka rritur besimin tek ata dhe per rrjedhoje eshte i konsiderueshem numri i shtetasve qe perfitojne nga ky sherbim.

Spektori i Pritjes se Popullit u ka dhene ndihme qytetareve te paraqitur si nepermjet perpilimit te ankeses apo kerkeses qe ata parashtriojne, ashtu dhe nepermjet keshillimeve ose orientimeve ligjore profesionale qe ata kerkojne, kur çeshtja qe parashtrohet prej tyre nuk eshte objekt i veprimtarise se Avokatit te Popullit. Nga kjo zyre, qytetareve u behet i njohur informacioni i kerkuar dhe njohja me legjislacionin ne fuqi, si dhe u jepen sqarime te metejshme per rrugen qe ndiqet pas ankeses se bere.

Pervoja e fituar nga viti i kaluar, duke pranuar kerkesa per ndihme juridike, meqenese shume shtetas kane njohuri te pakta ne lidhje me legjislacionin, ka bere qe nepermjet pergjigjeve me shkrim ti ndihmojme ata dhe te eliminojme sa me shume sorollatjet e tyre ne dyert e Administraes Publike, ku shpesh hasin mjaft pengesa burokratike. E gjithë kjo procedure, direkt ne kontrollin dhe kujdesin e Avokatit te Popullit, rrit besimin te qytetaret dhe ben te mundur shtimin e ankesave apo keshillimeve nga viti ne vit.

2. Statistikat permbledhese

Mbeshtetur ne numrin e individeve te paraqitur, si dhe larmine e problematikave te bera prezent, me poshte ashtu si dhe ne raportimet e kaluara, japim nje pasqyre te aktivitetit vjetor ne shifra te Sektorit te Pritjes se Popullit.

Ne vitin 2006, numri i pergjithshem i ankesave te paraqitura prane Zyres se Pritjes se Popullit, eshte **1624 ankesa apo kerkesa**. Ne tabelen e meposhteme pasqyrohen ankesat e paraqitura çdo muaj dhe numri i pranimit te atyre, qe kane qene brenda juridiksionit dhe kompetencave te Avokatit te Popullit.

Muaji	Ankesa gjithsej	Ankesa te pranuar
Janar	171 ankesa	82 ankesa
Shkurt	178 -"-	89 -"-
Mars	193 -"-	89 -"-
Prill	193 -"-	95 -"-
Maj	172 -"-	100 -"-
Qershor	157 -"-	83 -"-
Korrik	116 -"-	78 -"-

Gusht	pushim		
Shtator	112	-“-	69
Tetor	95	-“-	57
Nentor	114	-“-	53
<u>Dhjetor</u>	<u>123</u>	-“-	<u>55</u>
Totali	1624	-“-	850

Pra siç mund të shikohet nga numri i përgjithshëm i ankesave ose kërkesave që janë paraqitur pranë Sektorit të Pritjes së Popullit, janë pranuar për shqyrtim 850 ankesa apo kërkesa. Këto gjejnë pasqyrim në pjesë të tjera të raportit sipas fushave dhe organeve të administratës publike.

Zyra e Pritjes së Popullit në përmbushje të detyrave të saj funksionale gjatë vitit 2006, ka pritur, keshilluar, orientuar dhe kthyer përgjigje të menjehershme, 774 të kërkesave dhe ankesave të paraqitura. Është konstatuar se këto ankesa apo kërkesa kanë qenë jashtë juridiksionit dhe kompetencave të Avokatit të Popullit. Megjithatë të gjithë këtyre individëve iu është dhënë një keshillim profesional, mbi rrugën ligjore dhe institucionale që duhet të ndjekin dhe afatet që duhen të respektojnë për zgjidhjen e ankesës së tyre.

3) Problematikat e shfaqura

Në ndryshim nga vitet e tjera Sektori i Pritjes së Popullit, ka evidentuar e monitoruar me kujdes, problematikat që individë të ndryshëm kanë paraqitur, ankesa që nga zyra e pritjes nuk janë pranuar pasi janë jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit. Ankuesve u është dhënë konsulencë e nevojshme juridike, si dhe institucionet në të cilat duhet të paraqiten për zgjidhjen e ankesave të tyre.

Nga ky evidentim del se ankesat jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit kanë qenë si më poshtë:

Ankesa ndaj vendimeve të Gjykatave	175
Kërkesa për perfaqësim në gjykatë	115
Konflikte midis individëve	86
Ankesa ndaj subjekteve private	70
Konflikte në familje	68
Kërkesa për punësim	58
Ankesa ndaj kompanive të huaja private	52
Ankesa ndaj gjykatave të shteteve të huaja	50
Ankesa ndaj perfaqësive të huaja në Shqipëri	38
Ankesa ndaj shteteve të huaja	36
Kërkesë për falje denimi	10
<u>Te tjera</u>	<u>16</u>
	774

Siç mund të shikohet në tabelën e mësipërme numri më i madh i ankesave, drejtohet ndaj gjykatave të të gjitha niveleve. Këto ankesa zënë rreth 25% të të gjitha ankesave jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit. Në këto ankesa, sipas individëve të paraqitur mbartin padrejtësi, paragjykim, pavetësi dhe njëanshmeri. Ata nuk janë dakort me vendimet e gjykatave, kanë pretendime për trupin gjyqësor, ankohen për korrupsion, si dhe marrje rryshfeti. Gjithashtu, ankohen për punën në nivel të avokateve mbrojtës, të cilët në disa raste sipas ankuesve bëjnë mbrojtje të dyfishtë kundrejt rryshfetit.

Në mjaft raste, qytetarët me të drejtë ankohen se nuk mund të kundërshtojnë vendimet e gjykatave, pasi kanë të bëjnë me çështje penale e këto të drejta ligji ia njeh vetëm Prokurorise. Ky problem, është ngritur shpesh nga Avokati i Popullit, në mënyrë që familjet e dëmtuara të kenë të drejtë ankimi, për vetë faktin se në të shumtën e rasteve janë familjarët e viktimave që mendojnë se gjykimi nuk ka qenë i drejtë.

Një problem tjetër që është evidentuar gjatë pritjes së individëve në Zyren e Pritjes së Avokatit të Popullit, janë konfliktet në familje si dhe konfliktet midis individëve. Këto ankesa zënë rreth 20 % të ankesave jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit. Në më të shumtën e rasteve, problematika e këtyre ankesave kanë të bëjnë me probleme në familje, burime të grua, kanë të bëjnë me fëmijet, probleme trashëgimie, të pronës, e të tjera. Nga ana tjetër, është bërë kujdes në dhenien e konsulcencës për mënyrën e zgjidhjes së ankesave, me qëllim eliminimin e konflikteve të mundshme. Për këto, veç konsullatave tona është bashkëpunuar me organizata jo qeveritare, si me organizata për mbrojtjen e të drejtave të grave, fëmijëve, gjithmone në funksion të parandalimit të konflikteve të mundshme.

Rreth 70 ankesa kanë ardhur për subjekte private. Problemet janë të ndryshme, mosrespektim i të drejtave të njeriut, prishje e njëanshmeri e kontratave, sidomos nga ndertues që nuk zbatojnë kontratat e shitjes, afatet e përcaktuara, mos dhenie e pages nga punëmarresit, punë në të zeze, largime nga puna, mos pagim i Sigurimeve Shoqërore e të tjera probleme që rëndojnë mbi qytetarin.

Si dhe vitet e kaluara, një numër i madh ankesash drejtohet ndaj perfaqësive të huaja, të cilat ndaj kërkesave të shtetasve për paisje me vize, reagojnë me sjellje aspak dinjitoze dhe diskriminuese. Ky diskriminim, i vërejtur veçanërisht nga perfaqësitë Greke dhe Italiane, shprehet shpeshherë, me mos dhenie të arsyes për mospaisjen me vize ndaj individëve, të cilët kanë bërë një kërkesë të tillë. Gjithashtu, një numër i madh ankesash drejtohet ndaj institucioneve të shteteve të huaja, që kanë të bëjnë me padrejtësi të ndryshme ndaj shtetasve shqiptarë që jetojnë në to.

Per sa i perket ankesave drejtuar shteteve apo perfaqesive te huaja, Avokati i Popullit, ka bashkerenduar punen me Ministrine e Jashtme dhe perfaqesite tona jashte vendit. Por e shikojme me vend te theksojme se puna e perfaqesive tona jashte vendit, duhet te jete me afer problemeve dhe shqetesimeve te shtetasve Shqiptare, sepse ka shume ankesa per punen e tyre.

Ne te gjitha rastet, ankuesve iu eshte bere e qarte se Avokati i Popullit eshte i gatshem te nderhyje me kompetencat qe i jep ligji, vetem kur organet apo autoritetet per te cilat ka ankesa apo kerkesa, jane pjese e Administrates Publike, dhe kur prej tyre nuk konstatohet angazhimi i duhur institucional. Ne rastet e tjera, qytetareve i eshte ofruar keshillim ligjor, ose orientim dhe sugjerim per zgjidhjen e problemeve te prezantuara.

Nga konkluzionet e arritura, si rrjedhim i nje eksperience prej me shume se 6 vjetesh te Zyres se Pritjes se Popullit dhe te maredhenieve me individe ne pergjithesi, mendojme se angazhimi yne ne te ardhmen eshte i domosdoshem per ti ardhur sa me teper ne ndihme, qytetareve qe kerkojne ndihmen e Avokatit te Popullit.

b. "Ditët e hapura" – Përvojë për t'u vazhduar

Në kushtet e një decentralizimi gjithnjë e në rritje në favor të kompetencave të qeverisjes vendore, Avokati i Popullit mendon se më e mira është që problemet të zgjidhen atje ku lindin dhe me personat që me dashje apo nga padituria, ua krijojnë atyre këto probleme. Kjo është edhe arsyeja aq tashme ne kemi konsoliduar edhe praktiken e organizimit të një formë të re komunikimi të drejtpërdrejtë me qytetarët, që ne e kemi quajtur "Ditët e hapura".

Zbatimi i "ditëve të hapura" ka rezultuar te jete një praktikë shumë e frutshme që shkurton së tepërmi procedurat burokratike, rrugët e gjata drejt Tiranës, shpenzimet ekonomike, e pse jo, edhe manipulimet e mundshme me të drejtat e qytetarëve. Nëse procedurat zbatohen me korrektesë, qytetari nis të rrisë besimin tek shteti i vet, tek institucionet dhe ligji, dhe kjo fillon qysh nga njesia me e vogel administrative.

Gjate vitit 2006, ekspertet e Avokatit te Popullit kane organizuar "ditë te hapura", në 32 bashki dhe nje komune te vendit, në Lazarat. Jane pritur gjithsej 672 ankues, nga te cilet jane pranuar 489 ankesa. Ne vend jane sqaruar dhe keshilluar 183 ankues.

Takimeve tona nëpër rrethe në "ditët e hapura" u kanë paraprirë eventualisht bisedat në televizione lokale me ekspertë të Zyrës së Avokatit të Popullit, si njoftimet e bera nga zyrtaret e bashkive perkatese. Nga takimet me qytetarët ka rezultuar se, në shumicën e rasteve, objekti i

ankesave të tyre ka patur te bëjë me politikat sociale të shtetit (punësimi, strehimi, ndihma sociale etj), me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore, me procedurat e ndjekura nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, konflikte të lindura në marrëdhëniet e punës, probleme të lindura në lidhje me shtesat e pensioneve apo dhe probleme të tjera.

Përvoja e fituar në “Ditët e Hapura”, por dhe në disa takime e inspektime me grupe pune, me objekt të caktuar siç janë inspektimet në burgje, takime me efektiva të reparteve ushtarake etj, për t’u njohur nga afër me shkeljet e të drejtave të cilat janë të sanksionuara me ligj, na ka nxjerrë si domosdoshmëri që kjo punë të thellohet në të ardhmen.

5. Bashkepunimi me Organizatat joqeveritare dhe aktivitete të tjera të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2006

Ne baze te nenit 30 dhe 31 te Ligjit nr. 8454 “Per Avokatin e Popullit”, njeri nga tre seksionet e Zyres se Avokatit te Popullit merret edhe me bashkepunimin me Shoqerine Civile, dhe konkretisht me OJF-te qe veprojne ne fushen e te drejtave dhe lirive te njeriut. Ne kryerjen e funksioneve te veta, Avokati i Popullit bashkepunon ngushte me keto organizma joqeveritare, duke marre ne menyre periodike mendimet e tyre per gjendjen e te drejtave te njeriut, si dhe organizimin nje here ne vit te nje veprimtarie kombetare per nje problematike te caktuar qe paraqet gjendja e te drejtave te njeriut ne vend. Per vitin 2006, ky aktivitet, i cilesuar tashme Konference Kombetare, iu kushtua te drejtave te personave me aftesi te kufizuara, dhe u realizua ne bashkepunim me Ministrine e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, me UNICEF-in dhe Save the Children.

Krahas ndjekjes së problematikës së përditshme për të shqyrtuar ankesat e qytetarëve, Avokati i Popullit ose përfaqësues të tij, kanë marrë pjesë duke dhënë kontributin e tyre në aktivitete të ndryshme, organizuar nga organizma qeveritare dhe të shoqërisë civile. Ashtu siç kemi theksuar dhe në Raportet Vjetore të mëparshme një gjë e tillë ka qenë dhe mbetet një angazhim sa institucional, aq edhe qytetar i Institucionit të Avokatit të Popullit, për tu investuar dhe thënë fjalën e tij për një problematikë edhe më të gjerë se ajo që paraqitet në statistikat e punës së tij normale.

Më poshtë po ju njohim thjesht me tematikën e këtyre aktiviteteve, që janë organizuar nga partnerë të tjerë dhe ku Institucioni i Avokatit të Popullit ka kontribuar bashkë me grupet e interesit.

1. Tryezë e rrumbullakët me temë “Të drejtat e konsumatorit”, organizuar nga Shoqata “Për mbrojtjen e konsumatorit”, Mars 2006.
2. Aktivitet i Avokatit të Popullit me Zyren e Mbrojtjes së Qytetareve për të bashkërenduar veprimtarinë në denoncimin e përpjekjeve favorizuese ndaj kompanive celulare në Shqipëri. Prill 2006.
3. Seminar me temë “Për shëndetin mendor” organizuar nga O.B.SH dhe Ministria e Shëndetësisë, Prill 2006.
4. Tryezë e rrumbullakët me temë: “Mbi disa ndryshime të ligjit “Për noterinë”” organizuar nga Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe Dhoma e Noterisë Durrës, Prill 2006.
5. Seminar me temë: “Për reformën ligjore në burgje”, organizuar nga OSBE, Prill 2006.
6. Tryezë e rrumbullakët me temë “Për disa çështje të telefonisë celulare”, organizuar nga Vodafone, Prill 2006.
7. Tryezë e rrumbullakët me temë “Diskutime për draftin e Konventës “Mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuar”” organizuar nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, Prill 2006.
8. Takim i Avokatit të Popullit me Levizjen MJAFT, për të denoncuar publikisht rritjen e pajustifikuar të çmimit të energjisë elektrike. Maj 2006.
9. Takim me temë: “Reforma në administratën publike”, organizuar nga PNUD dhe OLI, Maj 2006.
10. Aktivitet i organizuar nga Misioni Evropian i Ndhjes Ligjore për Sistemin Shqiptar të Drejtësisë EURALIUS, me temë: “Çfare do të thote MSA-ja për Sistemin Shqiptar të Drejtësisë”. Maj 2006.
11. Konferencë Kombëtare me temë “Te drejtat e njeriut fillojnë tek të drejtat e fëmijëve”, organizuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta, UNICEF dhe Qendra Every Child. Maj 2006.
12. Aktivitet me temë “Projekti i shtetit ligjor në Shqipëri” për rishikimin e projekteve të aplikueshme në vazhdim, organizuar nga Cassals, Qershor 2006.
13. Seminar me temë: “Kundërshtimi nga individit i akteve normative në Gjykatën Kushtetuese”, organizuar nga Gjykata Kushtetuese, Qershor 2006.
14. Tryezë e rrumbullakët me temë “Buxhetet për fëmijët”, organizuar nga Nën Komisioni Parlamentar për të Miturit dhe Barazinë Gjinore dhe Aleanca për fëmijët, Qershor 2006.
15. Aktivitet i organizuar nga Ministria e Brendshme me temë: “Te drejtat e njeriut, bashkëpunim i hapur për të njejtin qellim”. Qershor 2006.

16. Tryezë e rrumbullakët me temë “Rritja e efikasitetit të parandalimit të trafikimit të qënieve njerzore: krijimi i kapaciteteve rajonale dhe vendore të komuniteteve rome”, organizuar nga ODHIR dhe OSBE, Shtator 2006.
17. Aktivitet me temë “Zhvillimi dhe forcimi i sistemit të ndihmës ligjore”, me specialistë të misionit “Cards”, Tetor 2006.
18. Aktivitet me temë “Forcimi i realizimit të legjislacionit për barazinë gjinore”, organizuar nga PNUD, UNIFEM dhe ILO, Tetor 2006.
19. Seminar me temë: “Organizimi dhe funksionimi i zyrave për marrëdhëniet me publikun dhe informimin dhe etika e komunikimit”, organizuar nga Qendra e Studimeve Parlamentare, Tetor 2006.
20. Tryezë e rrumbullakët me temë “Fëmijët në situatë rruge, parandalimi i dëmit të mëtejshëm”, organizuar nga UNICEF, Terres des Hommes, BKFT dhe ARSIS, Tetor 2006.
21. Pjesëmarrje në grupin ndër-sekstorial për “Analizën e sistemit për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri”, ngritur nga UNICEF, Tetor 2006.
22. Konferenca me teme “Prokurimet Publike – nje hap i rendesishem drejt integritimit evropjan”, organizuar nga Kryeministri i Shqiperise dhe Shefi i Delegacionit te Komisionit Evropjan ne Shqiperi. Tetor 2006.
23. Takim me temë “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, me grupin teknik të ngritur nga Ministria e Brendshme, Nëntor 2006.
24. Seminar me temë: “Analiza e sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri”, organizuar nga OSBE, Nëntor 2006.
25. Konferenca me temë “Mbi ndërgjegjësimin për sigurinë rrugore”, organizuar nën kujdesin e Presidentit të Republikës, Nëntor 2006.
26. Seminar me temë “Dhuna ndaj fëmijëve”, organizuar nga UNICEF, Nëntor 2006.
27. Aktivitet me rastin e 15-Vjetorit te krijimit te Shoqates se Invalideve te Punes. Dhjetor 2006.
28. Tryezë e rrumbullakët me temë “ Eksperienca dhe e ardhmja e ndërmjetësimit, mundësi për Shqipërinë”, organizuar nga Ministria e Drejtësisë dhe Banka Botërore, Dhjetor 2006.
29. Seminar me temë “Menaxhimi i integruar i kufijve, trajtimi i shtetasve të huaj dhe respektimi i të drejtave të njeriut”, organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe policia kufitare, Dhjetor 2006.
30. Takim me teme “Roli i gjyqtarve kombetare ne sistemin ligjor te Bashkimit Evropjan”, organizuar nga Misioni EURALIUS. Dhjetor 2006.
31. Konferenca ballkanike me teme “Konventa e OKB-se per te drejtat e personave me aftesi te kufizuara”. Dhjetor 2006.

32. Tryeze e rumbullaket me teme: “Mbeshtetje per ndertimin e Qendres se Kujdestarise Shtepia e Perbashket”, organizuar nga Shoqata Kombetare “Shprese e Dashuri”. Dhjetor 2006.
33. Forum i hapur me teme “Minoritetet në Shqipëri dhe pjesëmarrja e tyre në procesin politik”, organizuar nga Koalicioni për nxitjen e pjesëmarrjes së grave, të të rinjve dhe minoriteteve në politikë, Dhjetor 2006.

Në të gjitha këto aktivitete dhe të tjera, Institucioni i Avokatit të Popullit ka promovuar rolin, kompetencat dhe juridiksionin e tij në ndërveprimin me institucionet e tjera shtetërore dhe ato të shoqërisë civile. Problematika e diskutuar në to na ka ndihmuar në sqarimin e pozicioneve të ndryshme, në të cilat ndodhemi, në raport me instancat të cilave u drejtohem, nisur nga ankesat konkrete që vijnë pranë zyrës tonë. Kjo pjesëmarrje aktive do të vazhdojë edhe në të ardhmen, pasi bashkëpunimin me organet e administratës publike si dhe me organizmat e shoqërisë civile e shohim si domosdoshmëri për perfeksionimin e mëtejshëm të punës tonë.

6. Konferenca Kombëtare “Të drejta dhe dinjitet të barabartë për Personat me Aftësi të Kufizuar”

Në bazë të nenit 30 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, Institucioni ynë në bashkëpunim me organizatat joqeveritare duhet të organizojë, të paktën një herë në vit, veprimtari kombëtare për gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Shqipërisë. Në zbatim të këtij detyrimi, më datën 11 Dhjetor 2006, në bashkëpunim me organizatat Save the Children, UNICEF, Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Këshillin Kombëtar të Personave me Aftësi të Kufizuar, u zhvillua Konferenca Kombëtare “Të drejta dhe dinjitet të barabartë për Personat me Aftësi të Kufizuar”. Në Konferencë morën pjesë zëvendëskryeministri Z. Ilir Rusmajli, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta Z. Kosta Barka, Ministri i Arsimit dhe Shkencës Z. Genc Pollo etj.

Kjo përzgjedhje u motivua nga fakti që kjo kategori njerëzish në nevojë, sipas burimeve zyrtare përfshin rreth 100.000 persona, që zënë të paktën 3 % të numurit të përgjithshëm të popullsisë në vendin tonë. Këta janë perhere e me shume te ekspozuar nga sfidat e nje tranzicioni te veshtire dhe te vendosur ne skajet e shoqerise, me standarte te ulta ekonomike; me mundesi te pakta arsimimi; me nivel teper te larte papunesie; me aftesi te kufizuara levizjeje; me te drejta njerezore

pergjithesisht te kufizuara dhe me prezencen e nje realiteti dhe mentaliteti social jo shume integrues.

Qellimi i Konferences Kombetare “Per te drejta dhe nje dinjitet te barabarte per Personat me Aftesi te Kufizuar” ishte evidentimi i problemeve sociale, ligjore, ekonomike dhe politike qe shqetesojne jeten e ketyre personave, sensibilizimin e metejshem te strukturave shteterore, te opinionit te gjere publik, te mediave vizive dhe te shkruara dhe per te vendosur objektivat dhe formuluar Rekomandimet e duhura ne perputhje me legjislacionet dhe praktikat e vendeve me te zhvilluara demokratike.

Parametrat e te drejtave dhe lirive te Personave me Aftesi te Kufizuar dhe zbatimi i tyre, jane te sanksionuara ne Akte dhe Konventa te shumta Nderkombetare, si dhe ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise.

Ne Deklaraten Universale te te Drejtave te Njeriut shpallet se: *“te gjitha qeniet njerezore kane lindur te lire dhe te barabarte ne dinjitet dhe te drejta dhe se gjithkush duhet t’i gezoje keto te drejta dhe liri te shprehura ne te, pa dallim te cfaredolloji, si race, ngjyre, seksi, gjuhe, besimi fetar, politik dhe cfaredolloj tjetër besimi, origjine kombetare apo sociale, pasurie, status i lindjes apo nje status tjetër”*.

Konventa e OKB-se “Per Mbrojtjen dhe Nxitjen e te Drejtave dhe Dinjitetit te Personave me Aftesi te Kufizuar” miratur gjate vitit 2006, e ngritur mbi parimet e mosdiskriminimit, te barazive e te mundesive, te perfshirjes se plote te pjesmarresve, te respektit per te ndryshmit, te autonomise, etj, perben nje akt madhor dhe kontribut te veçante ne njohjen, zgjerimin, standartizimin dhe unifikimin e te drejtave dhe lirive te ketyre personave.

Ne te parashikohet qe: *“Shtetet pale marrin persiper te sigurojne dhe promovojne realizimin e plote te te gjitha te drejtave dhe lirive themelore te njeriut per te gjitha personat me aftesi te kufizuar pa diskriminim te ndonje lloji me baze aftesine e kufizuar...”*

Edhe ne Kushtetuten tone jane nje sere normash te rendesishme qe sanksiojne te drejtat e personave ne nevoje. Keshtu ne nenin 52/2 te saj parashikohet qe: *“Kushdo, kur mbetet pa pune per shkaqe te pavarura nga vullneti i tij dhe kur nuk ka mjete te tjera jetese, ka te drejten e ndihmes ne kushtet e parashikuara me ligj”*-Ndersa ne nenin 56 te Kushtetutes sanksionohet se : *“Shtetasit gezojne ne menyre te barabarte te drejten per kujdes shendetesor nga shteti. Kushdo ka te drejte per sigurim shendetesor sipas proçedures se caktuar me ligj”*

Kurse ne nenin 59/e të Kushtetutës nenvizohet detyrimi qe: *“Shteti brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve qe disponon, si dhe te plotesimit te nismes dhe te pergjegjesive private, synon...e) perkujdesjen dhe ndihmen per te moshuarit, jetimet dhe invalidet”*.

Për përgatitjen e Konferencës u punua gjatë gjithë vitit 2006, duke shqyrtuar të gjitha ankesat që i kanë ardhur Avokatit të Popullit që lidhen me të drejtat e kesaj kategorie personash gjatë viteve 2000-2006, problemet që kanë dalë si në drejtim të legjislacionit që mbron të drejtat e tyre, ashtu dhe të zbatimit konkret të tij nga ana e organeve të administratës publike shqiptare.

Konferenca trajtoi kryesisht politikat qeveritare në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të ketyre grupeve, ndryshimet dhe permiresimet që i janë bere legjislacionit ne fushen e ndihmes dhe sherbimeve shoqerore, njohjes dhe shkallen e zbatimit te tij, roli i OJF-ve ne mbrojtje të të drejtave të Personave me Aftesi te Kufizuar dhe mbajti shenim verejtjet dhe sugjerimet e perfaqesuesve te tyre.

Shqipëria nepermjet aderimit dhe nenshkrimit te shume akteve dhe konventave nderkombetare ka marrë përsipër shumë angazhime për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të Personave me Aftesi te Kufizuar. Për të gjithë është më se e qartë se ratifikimi i Konventave ndërkombëtare nuk është një qëllim në vetvete, por është shprehje zyrtare e angazhimit të shtetit dhe shoqërisë për të garantuar zbatimin e të drejtave të parashikuara në to.

Në përfundim të punimeve të Konferencës Kombëtare me teme “Të drejta dhe dinjitet të barabartë për Personat me Aftësi të Kufizuar” në bazë të diskutimeve, vërejtjeve, sugjerimeve dhe propozimeve të pjesëmarrësve dolen keto:

PERFUNDIME:

1) Venia ne fokus te Konferences Kombetare vjetore te te drejtave te Personave me Aftesi te Kufizuar, tregon se problemet e ketyre grupeve shoqerore te rrezikuara te popullsisë, jane nje prokupim mbareshoqeror, perbejne nje deshmi te ndergjegjsimit dhe vemendjes se institucioneve te pavarura, te shoqerise civile dhe opinionit publik ndaj te drejtave dhe nivelit te jeteses se tyre. Shoqëria shqiptare, me gjithë problemet e shumta që e shoqërojnë ne rrugen e integritit në strukturat euro-atlantike, ne menyre te veçante pas nënshkrimit së Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me Bashkimin European, vazhdon te shprehe mirekuptim per detyrimin dhe perballimin e kesaj sfide, ne perpjekje per bashkimin e te gjitha zerave te saj ne ndihme dhe perkrahje te sistemit aftesues per Personat me Aftesi te Kufizuar.

2) Politikat kombëtare te ndjekura deri tani ne drejtim të ngritjes, reformimit dhe zgjerimit te sistemit të Ndhimes dhe Sherbimit Shoqeror ne mbeshtetje te Personave me Aftësi të Kufizuar kane synuar plotesimin e nevojave jetike baze te tyre, zhvillimin e aftesive dhe mundesive

personale, ruajten dhe forcimin e procesit të perfaqesimit, si një çështje e drejtave të njeriut, zbutjen e varferise dhe të perjashtimit shoqëror për këta persona dhe familjet e tyre, dhe të krijoje kushte sa më optimale për integrimin e tyre të mëtejshëm në shoqëri dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës të tyre.

Në mbare vendin funksionojnë 6 qendra publike rezidenciale të perkujdesit shoqëror ku trajtohen rreth 400 fëmijë me aftësi të kufizuara dhe 3 qendra ditore me rreth 70 fëmijë.

Në mbështetje të Personave me Aftësi të Kufizuara janë edhe rreth 16.000 kujdestare me pagesë.

3) Pjesëmarrja e gjere në këto Konferencë Kombëtare të perfaqesuesve të Kuvendit dhe drejtuesve të ministrive të linjes, tregon interesimin dhe përpjekjet e vazhdueshme të strukturave shtetërore në mbrojtjen dhe realizimin e një spektri sa më të pranueshëm të drejtave dhe lirive themelore të Personave me Aftësi të Kufizuara.

4) Personat me Aftësi të Kufizuara, përveç mbrojtjes të veçantë Kushtetuese dhe një legjislacioni të gjere dhe që përmirësohet vazhdimisht, në mbrojtje të drejtave të tyre, kanë edhe mbështetjen e gjitha Konventave Ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë, si Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave; Karta e Rishikuar Sociale Evropiane; Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve; Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore; Konventa Kundër Torturës dhe Dhunës, Trajtimin apo Ndëshkimin Ç'njerëzor dhe Poshtëruar; Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, etj. Miratimi i Strategjisë së Shërbimeve Shoqërore ishte një arritje e madhe, por që duhet shpejtuar për përmbushjen e planit të veprimit që shoqëron këto Strategji.

5) Qeveria shqiptare për vitin 2006 vuri në dispozicion të Personave me Aftësi të Kufizuara 16% fonde me shumë se një vit më parë. Ndërsa për vitin 2007, këto shpezime janë planifikuar 8.1 miliard leke. Konstatohet se ka patur mbështetje nga buxheti i shtetit për projekte të Shoqatave Kombëtare të Aftësisë së Kufizuara për ndërtimin e qendrave rehabilituese.

6) Faktor evident që vihet re është edhe fakti që Organizatat jo Fitimprurëse, që veprojnë në fushën e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore janë shtuar dhe forcuar vazhdimisht me potencialet e duhura njëzore-profesionale dhe materiale, duke u bërë me ofrimin e shërbimeve të tyre një faktor tepër i rëndësishëm kontribues, alternativ dhe konkurrenues me shërbimet e ofruara nga strukturat shtetërore. Konstatohet një bashkëpunim me i gjere i tyre me strukturat shtetërore dhe me donatorët.

7) Megjithë impenjimin e organeve të pushtetit vendor dhe aktoreve të tjere të administratës publike, vazhdon të mbeten shqetësimi i zvarritjet për realizimin e të drejtave të tyre për të cilin Personat me Aftësi të Kufizuar paraqesin ankesa konkrete.

8) Konstatohet se Personat me Aftësi të Kufizuar gjithnjë e më shumë janë ndergjegjsuar për të drejtat e tyre dhe detyrimet që ju ka shoqëria, kërkojnë gjithnjë e më shumë të degjohet zeri i tyre, të jenë faktore reale në promovimin e politikave të reja dhe përpiqen të luftojnë diskriminimin dhe mentalitetet tradicionale ndaj tyre, si “një grup meshire ose si njëri që kanë nevojë vetëm për trajtim mjekësor”.

9) Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë gjithë ushtrimit të veprimtarisë së tij në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individëve, nëpërmjet trajtimit të ankesave të këtij grupi të ekspozuar nga mundësitë e kufizuara për të përfituar nga programet shtetërore në nevojë, ka qenë tepër i ndjeshëm në respektimin dhe zbatimin e kërkesave të legjislativës aktual nga organet dhe strukturat përkatëse shtetërore. Konstatohet se herë pas here, nga këto organe, shkelen, zvarriten ose mohohen të drejta dhe lehtësira të tilla që kanë të bëjnë me punësimin, arsimimin, strehimin, votimin, informimin, aksesin për lëvizje të lira e pa pengesa në banesa dhe ambiente publike, e deri në mungesën e ndjeshme të numurit të institucioneve rezidenciale në dispozicion të tyre, që si emërues të përbashkët të tyre kanë neglizhencën, mungesën e kontrollit dhe anashkalimit të ligjit me shumë lehtësi nga strukturat shtetërore përkatëse.

Në bazë të perfundimeve dhe konstatimeve të mësipërme, Konferenca doli me këto:

REKOMANDIME:

Riformulim dhe saktësim i mëtejshëm në legjislativën tonë, mbi bazën e konceptit evolucionar të aftësisë së kufizuar dhe praktikës botërore, për personin me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike.

Evidentimi i saktë i të gjithë Personave me Aftësi të Kufizuar, duke treguar kujdes të veçantë në identifikimin e tyre në zonat e thella rurale.

Nevojitet për të bërë një punë shumë të madhe me të gjithë faktorët e shoqërisë shqiptare, duke vënë në efikasitet potencialet e saj me të mira intelektuale, në mënyrë që shoqëria jonë të iluminohet deri në atë shkallë sa të shkarkojë ngarkesat jo të pakta negative për këtë shtresë në nevojë dhe t'i pranojë si të barabartë në të drejta dhe detyrime.

Fillimin e funksionimit normal të veprimtarisë të Këshillit Kombëtar për Çështjet e Aftësisë së Kufizuar, si një organ i rëndësishëm

që do të ndikojë ndjeshëm në zbutjen e problemeve të Personave me Aftësi të Kufizuar.

Qeveria të diskutojë me partneret sociale në të gjitha rastet kur diskutohen dhe formulohen politikat dhe strategjite e çështjeve të zbutjes së varferisë dhe të perkrahjes me skemat e ndihmes dhe shërbimit shoqëror të shtresave në nevojë.

Të realizohet reforma në kuadrin legjislativ me objektiv aftësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar, për rritjen e aksesit të tyre në shoqëri dhe për të përfituar mundësi të barabarta si dhe sistemimi dhe përafrimi i legjislacionit tonë në fushën e ndihmes dhe shërbimeve sociale me standartet e Bashkimit Europian duke i shoqëruar edhe me politika dhe mekanizma zbatuese.

Pas ratifikimit të Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, miratuar nga Kombet e Bashkuara, nga Kuvendi të bëhen të gjithë përpjekjet për implementimin e tij të legjislacionit tonë mbi bazën e filozofive të reja të trajtimit të avancuar të Personave me Aftësi të Kufizuar, të respektimit dhe realizimit të standarteve të lirive dhe të drejtave si gjithë qytetarët e tjerë dhe krijimin e mundësive konkrete për integrim.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta të botojë një përmbledhje të veçante të legjislacionit për problemet dhe Personat me Aftësi të Kufizuar.

Sekretariati Teknik i Personave me Aftësi të Kufizuar të përgatisë objektivat e vitit në vazhdim për të gjitha ministrat e linjës dhe strukturat vendore.

Legalizimi falas i banesave në zonat informale për Personat me Aftësi të Kufizuar.

Të punohet për përgatitjen dhe të miratohet Ligji “Kundër Diskriminimit”.

Monitorimi i respektimit të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar, vlerësohet si një element mjaft i rëndësishëm në përmirësimin konkret të cilësive së jetës së tyre.

Të shpejtohet puna për përgatitjen dhe miratimin e një Ligji të ri integral, në të cilin të unifikohet përfshirja edhe e Personave me Aftësi të Kufizuar të lënë deri tani jashtë skemave të përfitimit, si të dëmtuarit nga minat, personat endacakë, njerëzit me distrofi muskulare, persona me aftësi të kufizuara të bërë të tillë pas moshës 21 vjeç, persona handikapë mendorë, etj.

Të bëhen rekomandime për daljen e akteve nënligjore për zbatimin tërësor të Ligjit Nr.9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”, për VKM Nr.8, datë 07.01.2005 “Strategjia e Shërbimeve Shoqërore”.

Garantimi i te drejtes se punesimit te sigurohet ne kushte te barabarta edhe per Personat me Aftesi te Kufizuar, si gjithë shtetasit e tjere, ne menyre qe kjo kategori te kete nje pune te pershtateshme dhe te kene te ardhura nga puna, te cilat do te ndikojne ne rritjen e mireqenies dhe te respektimit te integritetit te tyre human. Të bëhen ndryshime në Ligjin Nr.7995, datë 20.09.1995 “Për nxitjen e punësimit”, per forcimin e strukturave te kontrollit ne realizimin e normës ligjore që parashikon që subjektet punedhenese që punësojne 25 punonjës, njëri prej tyre duhet të jetë Person me Aftësi të Kufizuar, si dhe forcimin e sanksioneve dhe zgjerimit te tyre me alternativa te tjera per kundravajtesit administrative. Gjithashtu të studjohet mundësia e permiresimit te stimujve per inkurajimin e punesimit te ketyre personave dhe te legalizimit per disa vende pune në Administratën Publike ose në sektorin e shërbimeve shteterore apo private, të jenë të destinuara vetëm për këtë kategori personash.

Të shtohen fondet sociale për ngritjen e shërbimeve të reja me ndarje të gjere gjeografike, veçanerisht te njesive ditore te sherbimit, për konsolidimin e qendrave rezidenciale ekzistuese, sidomos per femijet dhe te moshuarit me aftesi te kufizuar, sigurimin e mjeteve lëvizëse, si dhe per decentralizimin e tyre.

Ministria e Shendetesise te konkretizojë angazhimet e saj ne ngritjen e nje rrjeti kabinetesh te rehabilitimit fizik-mjekesor dhe te trajtimit mendor.

Te ngrihet nga strukturat shteterore te linjes nje sistem informacioni i detajuar per Personat me Aftesi te Kufizuar, qe te perfshije te dhena per grup-moshat, llojin e aftesise se kufizuar, gjinine, nivelin arsimor, qe do jete ne sherbim te vleresimit me te mire te politikave aktuale dhe ne ndermarrjen e hapave te tjere per realizimin e te drejtave te ketyre personave

Shteti mund të lehtësohet në fushën e shërbimeve sociale, duke u ndihmuar në këtë drejtim nga biznesi dhe donatore vendas dhe te huaj. Asnjë shtet, sado i fuqishëm të jetë, nuk mund të mbajë vetëm një barrë të tillë.

Te punohet per permiresimin e legjislacionit per projektimin dhe planifikimin urban, per pershtatshmerine e ambienteve te institucioneve publike, arsimore dhe te sektorit te shërbimeve per Personat me Aftesi te Kufizuar, per ndarjen e qarte te kompetencave midis strukturave perkatese te pushtetit qendror dhe atij vendor dhe te forcimit te konceptimit, ndertimit dhe pershtatjes se ambientit me akses te plote per levizje te lire dhe pa barriera per grupimet e ketyre personave.

Problemi i strehimit të personave me aftësi të kufizuar, kërkon një rindarje më të mirë të fondeve për ndërtimin e banesave publike dhe

shitjen e tyre me çmimin e kostos. Për të verbërit të kërkohet zbatimi i normës ligjore të parashikuar në Ligjin Nr.8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit” për dhënien e një dhome shtesë falas.

Plotesimi dhe permiresimi i kuadrit ligjor per lehtesira sherbimi ne te gjitha llojet e transportit per Personat me Aftesi te Kufizuar, hartimin e normave vendore te pershtatshmerise ndertimore ne infrastrukturen e transportit dhe zbatimin e akteve ligjore per rimbursimin e biletave ne linjat e transportit urban dhe interurban.

Media, si një faktor i rëndësishëm në informimin e publikut të mundësojë këtë te drejte edhe për personat me aftësi të kufizuar. Televizionet publike apo shtetërore mund të japin të paktën një herë në ditë, një edicion lajmesh për personat që nuk dëgjojnë. Ndërsa, shtypi i shkruar të gjejë një hapësirë në faqet e tij edhe për informimin e të verbërve.

Të rishikohen mundësitë për shtimin e kujdestarëve për një kategori Personash me Aftësi të Kufizuar, si dhe për rritjen e pagesës së tyre, pasi ajo aktuale nuk është tërheqëse për aplikuesit.

Te behet rivleresim me real i mundesise se rritjes se mases mujore te karburantit dhe riindeksim i çmimit te blerjes te tij te caktuara per levizjen e Personave me Aftesi te Kufizuar.

Te permiresohet sistemi i pagesave per Personat me Aftesi te Kufizuar, ne perputhje me Ligjin nr.9355, date 10.3.2005 “Per ndihmen dhe sherbimin shendetesor”

Përmirësimi i garantimit te te drejtes per arsimim per Personat me Aftesi te Kufizuar, kerkon ndryshime ne sistemin e edukimit, te percaktimit te procedurave te sakta per pranimin, vleresimin dhe regjistrimin e femijeve dhe Personave te tjere me Aftesi te Kufizuara ne institucionet arsimore, kualifikimin specifik te stafeve pedagogjike, te pergatitjes dhe pershtatjen e kurikulave, programeve dhe teksteve per edukimin dhe arsimimin e ketyre grupeve, permiresimin e kuadrit ligjor ekzistues dhe mbeshtetja e tij me akte nenligjore, shtimin dhe ngritjen e shkollave dhe klasave speciale për edukimin dhe rehabilitimin e femijeve dhe Personave me Aftesi te Kufizuar, te aplikimit te edukimit ne shtepi ose qendra ditore, favorizimin e arsimimit ne arsimin universitar, rishikimin e sistemit te rehabilitimit dhe formimit profesional sipas mundësive dhe aftësive individuale, favorizimin për ndjekjen falas të kurseve te kualifikimit, per mesimin e perdorimit te programeve kompjuterike, për pervehtesimin e gjuhëve të huaja dhe te kurseve te tjera ne dobi te personave me aftesi te kufizuar.

Te punohet per permiresimin e sistemit arsimor per personat qe nuk degjojne, i cili duhet te konsistoje ne keto drejtime : ne ngritjen e nje sistemi identifikimi sa me te shpejte te femijeve qe nuk degjojne, ne

ngritjen e qendrave komunitare per te rritur shkallen e socializimit, keshillimit, trajtimit dhe parapergatitjes se tyre per ndjekjen e Institutit te nxenesve qe nuk degjojne, ne marrjen e masave per ngritjen e disa shkollave te reja me sistemin dygjuhesor (gjuha e shenjave dhe gjuha shqipe) per nxenesit qe nuk degjojne mbi bazen e disa qarqeve, ne marrjen e masave per ngritjen e nje shkolle te mesme per personat qe nuk degjojne dhe per pergatitjen e interpretuesve per kete grup personash.

Te sigurohen Personat me Aftesi te Kufizuar me te njejtat sherbime, cilesi dhe standarte te sherbimeve mjekesore pa pagese ose me shpenzime te perballueshme, si te gjithe personat e tjere. Të studjohet mundësia e përmirësimit të legjislacionit për trajtimin shëndetësor të këtyre personave, në elementë të tillë si shërbimin dentar falas dhe të një pjese analizash laboratorike të domosdoshme dhe të përhershme.

Të punohet më shumë nga vetë organizatat jofitimprurëse qe veprojnë ne fushen e ndihmes dhe sherbimeve shoqerore, per te qene aktore te rendesishem ne lobimin per te drejtat e njerezve ne nevojte dhe te ekspozuar ndaj rrezikut, për forcimin e kapaciteteve te tyre profesional, organizativ dhe infrastrukturor, per respektimin e simotrave te tyre duke hequr dore nga konfliktet dhe konkurenca ne zgjerimin e games se sherbimeve alternative ne ndihme te grupeve te ndryshme te Personave me Aftesi te Kufizuar, të realizojne një koordinim dhe bashkëpunim më të frytshëm me strukturat përkatëse shtetërore, me organet e pushtetit vendor dhe donatorët.

Te realizohet konkretisht nje nga te drejtat themelore te njeriut, e drejta per te zgjedhur dhe per t'u zgjedhur per Personat me Aftesi te Kufizuar, nepermjet permiresimit te Kodit Zgjedhor per te votuar keto grupe edhe jashte qendrave te votimit, per alternativat e aksesit ne qendren e votimit, te sherbimit te perkthimit per personat qe nuk degjojne dhe perdorimin e mjeteve te votimit te posaçme per personat qe nuk shikojne.

Te shikohet mundesia e lehtesimit te metejshem ose te perjashtimit nga detyrimet e disa taksave dhe tatimeve per Personat me Aftesi te Kufizuar, si nje ndihme konkrete ne permiresimin e gjendjes ekonomike te tyre.

*
* *

Ne perfundim Konferenca konkludoi se permiresimi i sistemit te ndihmes dhe sherbimit shoqeror dhe pershtatja e legjislacionit aktual ne kete fushe me ate te vendeve me te perparuara dhe te Mareveshjeve dhe Konventave ne te cilat Republika e Shqiperise ka aderuar, do te ndikojte

ndjeshem dhe pozitivisht ne permiresimin e trajtimit dhe integritit te grupeve te Personave me Aftesi te Kufizuara ne komunitet.

Sipas mendimit te pergjithshem, Konferenca ja arriti qellimit per sensibilizimin dhe angazhimin me te madh te te gjitha organeve, strukturave dhe autoriteteve te administrates publike per zbatimin e Kushtetutes, akteve te njohura nderkombetare, ligjeve perkatese si dhe rekomandimeve te kesaj Konference. Rekomandimet ju derguan Presidentit, Kuvendit, Kryeministrit dhe gjithe ministrive etj qe kanë detyrime ne fushen e te drejtave te Personave me Aftesi te Kufizuar . Materialet e Konferences do te botohen dhe shperndahen te gjithe te interesuarve.

Shpresojme se rekomandimet e kesaj Konference do te vleresohen me seriozitet dhe do te fillojne te implementohen nga te gjitha organet kompetente. Institucioni i Avokatit të Popullit do të ndjekë zbatimin e këtyre rekomandimeve.

KREU I TRETE

Vepriimtaria konkrete e Avokatit të Popullit për ankesat, kërkesat dhe njoftimet, të grupuara sipas institucioneve qeveritare

1. Këshilli i Ministrave (Qeveria)

Në zbatim të detyrës së tij kryesore, mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri, ne kemi patur ankesa, kërkesa apo njoftime për të cilat është dashur vënia në lëvizje e Qeverisë. Prandaj Avokati i Popullit ka informuar, rekomanduar apo i ka bërë propozime Kryeministrit dhe ministrave për të gjitha çështjet kryesore që kanë dalë gjatë punës së tij dhe që është dashur angazhimi i tyre. Pavarësisht nga forma në të cilën janë paraqitur çështjet e ngritura mendojmë se, në një rën ose tjetrën mënyrë, ato kanë ndikuar në rritjen e standarteve në favor të mirëqeverisjes, dhe të performancës së ekzekutivit shqiptar.

Nga janari deri në dhjetor 2006, Qeverisë, të kryesuar nga kryeministri, zoti Sali Berisha, i kemi dërguar zyrtarisht këto rekomandime, propozime apo informacione:

1. Rekomandimet për detyrat që dalin për të gjitha organet shtetërore, nën frymën e Konferencës Kombëtare të organizuar nga Avokati i Popullit me temë: “Të gjithë së bashku në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve”, dërguar në datën 12.01.2006.

2. Rekomandim drejtuar Qeverisë për nevojën e nxjerrjes së akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr.9389 datë 04.05.2005 ”Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes” dërguar në datën 02.02.2006. Përsëritur rekomandimi më datën 25.09.2006. Zëvendëskryeministri na ka vënë në dijeni se janë urdhëruar Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Brendshme që të përgatitin projektaktet nënligjore dhe t’i paraqesin për miratim në Qeveri. Problemi do të vazhdojë të ndiqet nga ne.

3. Informacion për rekomandimin drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për shpejtimin e punës për hartimin e marëveshjes teknike shqiptaro-greke, për përfitimin e sigurimeve shoqërore nga shtetasit e të dy vendeve, dërguar në datën 15.02.2006.

4. Informacion për Rekomandimin drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për ndalimin e përdorimit të pajustificueshëm të dhunës nëpër burgje dhe nxjerrjen e përgjegjësive për këto shkelje, dërguar në datën 02.03.2006.

5. Informacion për rekomandimin drejtuar Ministrisë së Brendëshme dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për përgatitjen e projektvendimit të Këshillit të Ministrave, në zbatim të neneve 8,9,10 dhe 11 të ligjit nr.8661, datë 18.09.2000 "Për sigurimet shoqërore suplementare të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe dërgimin për miratim në Qeveri, dërguar në datën 03.03.2006. Ka ardhur përgjigja se po punohet për përgatitjen e projekteve.

6. Informacion për Rekomandimin drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës për hartimin dhe dërgimin për miratim në Qeveri të një projekt vendimi që duhet të dalë në zbatim të nenit 57 të ligjit nr.9135 datë 11.09.2004 "Për mbrojtjen e konsumatorit", dërguar në datën 20.03.2006. Ministria e Ekonomisë (METE) na është përgjigjur se "me urdhër të kryeministrit nr.236 datë 02.10.2006 është ngritur Grupi ndërministror i drejtuar nga zëvendëskryeministri, ku ngarkohet METE dhe MBUMK për drejtimin e procesit të përgatitjes së një strategjie ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikqyrjen e Tregut".

7. Informacion për sugjerimin drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Brendëshme dhe Prokurorit të Përgjithshëm për të bërë të mundur që të dërgohen në Greqi si dëshmitarë 4 fëmijë shqiptarë "të humbur" në qendrën Agia Varvara të Athinës, dërguar në datën 23.03.2006. Dëshmitarët ishin kërkuar nga prokuroria greke, por me gjithë impenjimin tonë nuk është bërë e mundur dërgimi i tyre në Greqi.

8. Informacion për rekomandimin drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë për përshpejtimin e procedurave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 9/2 të ligjit nr.9381 datë 28.04.2005 "Për kompensimin e burgimit të padrejtë", dërguar në datën 27.03.2006. Na është kthyer përgjigje nga dy ministrinë se është nxjerrë udhëzimi përkatës.

9. Për të ndihmuar me eksperiencë pozitive në luftën kundër korrupsionit, në datën 27.03.2006 i është dërguar Kryeministrit praktika e legjislacionit kundër korrupsionit në Makao.

10. Informacion për rekomandimin drejtuar ERE për të mos pranuar propozimin e KESH sh.a. për rritjen e çmimit të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë, dërguar në datat 03.04.2006 dhe 22.05.2006. Dihet publikisht se Qeveria e ka përkrahur këtë rekomandim.

11. Vlerësimi i Avokatit të Popullit për angazhimin e Qeverisë për respektimin e të drejtave të të dënuarve dhe përmirësimin e kushteve në burgje dhe në vendet e paraburgimit, dërguar kryeministrit në datën

07.04.2006, ku kërkohet edhe që linja telefonike e komunikimit direkt nga komisaritet e policisë për të paraburgosurit të vendoset edhe për institucionin e Avokatit të Popullit, ashtu si edhe për Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Brendshme, siç ka sugjeruar z. Kryeministër. Në fakt deri tani nuk është realizuar në praktikë ky angazhim pozitiv i Qeverisë.

12.Kërkesë për të kthyer përgjigje për Rekomandimin tonë të përsëritur për ndryshimin dhe përmirësimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.552 datë 27.11.1999 për të përfituar trajtim ekonomik dhe financiar edhe policët e vrarë apo plagosur për periudhën 1991-1998, dërguar Qeverisë në datën 12.04.2006.

13.Informacion për rekomandimin drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës për hartimin e projektvendimit të Këshillit të Ministrave, në zbatim të nenit 62 të ligjit nr.9072 datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, dërguar në datën 20.04.2006.

14.Informacion për rekomandimin drejtuar Ministrisë së Drejtësisë për konstatimin si akt administrativ të pavlefshëm të urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nr.1522 datë 01.03.2006 “Mbi organizimin dhe kryerjen e takimeve speciale në burgje”, dërguar në datën 20.04.2006.

15.Rekomandimi për vënien në zbatim të Vendimit të Qeverisë nr.334 datë 20.05.2005 “Për hapjen e pikës së kalimit kufitar në fshatin Borje të Kukësit në kufirin shtetëror me Kosovën”, drejtuar Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme në datën 11.05.2006. Ministri është përgjigjur se pengesa ka qëndruar tek Unmiku dhe pritet transferimi i kompetencave tek Qeveria e Kosovës për të plotësuar kërkesën e komunitetit të fshatit Borje në Kukës.

16.Informacion për rekomandimin drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës për shmangien e abuzimeve dhe veprimeve të parregullta të administratës publike në fushën e HEC-et e vogla vendore, duke rivënë në vend lirinë e sipërmarrjes efektive private dhe të drejtave të ligjshme të investitorëve seriozë, dërguar në datën 17.05.2006. Kemi marrë përgjigje pozitive nga Ministria e Energjitikës.

17.Rekomandimi drejtuar Kryeministrit dhe Ministrit të Drejtësisë për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 10 të ligjit nr.9110, datë 24.07.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”, lidhur me sigurimin e ruajtjen e posaçme të mjediseve të punës, ruajtjen e afërt fizike, mbrojtjen e familjeve dhe pasurisë së gjyqtarëve, dërguar në datën 24.05.2006. Eshtë kthyer përgjigje në datën 12.10.2006 nga Kryeministria se Ministria e Drejtësisë po përgatit kuadrin e nevojshëm ligjor për këtë problem. Por rasti i tentativës për vrasje në janar 2007 të gjyqtarës Irena Maneku në Fier tregon se ky problem nuk mund të shtyhet më.

18.Dërgohet një kopje e rekomandimit “Për miratimin e Projekt rregullores tip për të drejtën e informimit (RTDI) dhe kërkohet bashkëpunim për zbatimin e tij, dërguar zëvendëskryeministrit në datën 13.06.2006.

19.Informacion për rekomandimin për fillimin e hetimit për veprën penale të ”Torturës”, parashikuar nga neni 86 i Kodit Penal në ngarkim të punonjësve të policisë Altin Gusho e Gëzim Mullali si dhe marrje të masës disiplinore ndaj z. Ilia Nasi, shef i Komisariatit dhe z. Elidion Veizi, shef i Policisë Kriminale në Korçë, dërguar në datën 23.06.2006. Kjo çështje ka të bëjë me vetvarjen e të miturit Anarildo Përfundi nga fshati Pirg i Korçës

20.Informacion për rekomandimin drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë për konceptimin e drejtë dhe zbatimin e ligjit gjatë shoqërimit të personave nga policia dërguar në datën 28.06.2006.

21.Mendime për projektligjin “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve kushtetuese dhe të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, dërguar Kryeministrit në datën 30.06.2006. Mendimet tona nuk u morën parasysh, ligji u miratua dhe prandaj në tetor 2006 është kërkuar nga ne në Gjykatën Kushtetuese shfuqizimi i pjeshëm i tij.

22.Informacion për rekomandimin drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për marrjen e masave të nevojshme për lejimin e avokatëve që të hyjnë në ambientet e policisë për t’u takuar me klientët e tyre që në momentet e para të shoqërimit, ndalimit apo arrestimit, dërguar në datën 11.07.2006.

23.Rekomandim drejtuar Qeverisë që të bëjë propozim në Kuvendin e Shqipërisë për përmirësimin e ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, me qëllim që të rregullohet rregjistrimi i fëmijëve të lindur që kanë mbetur pa regjistruar, dërguar në datën 12.07.2006

24.Informacion për rekomandimin drejtuar Ministrit të Financave dhe Ministrit të Brendshëm për krijimin e një fondi finaciar në organet vendore të policisë për pagimin e punonjësve socialë dhe avokatëve mbrojtës për të miturit, dërguar në datën 12.07.2006.

25.Rekomandimi drejtuar Kryeministrit dhe Ministrit të Brendshëm për përmirësimin e shërbimeve të gjendjes civile në favor të qytetarëve, duke shmangur praktika që shkaktojnë shpenzime të tepërta, volum të panevojshëm pune dhe rradhë të gjata, dërguar në datën 14.07.2006.

26.Informacion për rekomandimin drejtuar Ministrit të Ekonomisë dhe Energjitikës dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë Elektrike për korigjimin e menjëhershëm të veprimtarisë së Policisë Elektrike në kuadër të vendosjes së dëmeve të pa mbështetura në ligj në ngarkim të subjekteve private dhe nxjerrja e përgjegjësive konkrete për këto shkelje, dërguar në datën 19.07.2006.

27.Rekomandim për ekzekutimin e vendimit të gjykatës së formës së prerë në favor të shtetasve Rexhep dhe Zoje Rama, dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave dhe Ministrit të Financave më datën 20.07.2006. Ky vendim ngelet akoma pa zbatuar për faj të ministrisë së Financave.

28.Informacion për rekomandimin drejtuar Ministrit të Punëve Publike, Ministrit të Shëndetësisë, Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Mjedisit etj, për ndjekjen dhe përmbushjen përfundimtare të detyrimeve për rritjen e cilësisë së ujit të Bovillës dhe marrjen e masave për mirëmbajtjen e këtij ujëmbledhësi, dërguar në datën 21.09.2006. Kemi patur përgjigje pozitive nga Ministria e Punëve Publike dhe Ministria e Shëndetësisë.

29.Informacion drejtuar Kryeministrit dhe Ministrit të Ekonomisë për kërkesën drejtuar drejtorit të Albtelekomit dhe Këshillit Mbikqyrës të tij për të marrë masa dhe vendime konkrete për vënien në zbatim të ligjit nr.9135 datë 11.09.2003 ”Për mbrojtjen e konsumatorit”, në kuadrin e përmirësimit të Shërbimeve të telefonisë fikse që ofrohen nga Albtelekom sh.a. dërguar në datën 25.09.2006.

30.Informacion drejtuar Kryeministrit për rekomandimin për marrjen e masave për krijimin e kushteve të pranueshme në shërbimin udhëtar të transportit hekurudhor, drejtuar Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Shëndetësisë etj, dërguar në datën 01.11.2006.

31.Propozim për kryerjen e një analize për treguesit e menaxhimit të KESH sha dhe marrjen e masave për përmirësimin e Ekonomisë dhe Energjitikës dhe Këshillit Mbikqyrës të KESH sha në datën 14.12.2006.

32.Rekomandim drejtuar Qeverisë për shfuqizimin e pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.87, datë 15.02.2006 “Për administrimin dhe mbulimin e shpenzimeve të recetës me rimbursim”, dërguar në datën 21.12.2006.

Siç shihet, Qeveria, më shumë se çdo vit tjetër më parë, është informuar për mjaft probleme që ka hasur gjatë veprimtarisë së tij institucioni i Avokatit të Popullit, por që lidhen në mënyrë të pazgjidhshme edhe me objektivat e saj që janë mirëqeverisja dhe lufta kundër korrupsionit. Në përgjithësi rekomandimet tona janë mirëpritur dhe nga Qeveria ka mirëkuptim për t’u marrë me problemet dhe impenjim për t’i zgjidhur ato.

*
* *

Gjatë vitit 2006 pranë Institucionit të Avokatit të Popullit janë paraqitur **18** ankesa për Qeverinë, nga të cilat 1 ankesë është ende në shqyrtim, **2** kanë qenë të pabazuara, 10 kanë qenë jashtë kompetencave dhe juridiksionit, ndërsa 5 të tjera janë zgjidhur pozitivisht.

Gjatë këtij viti, objekt kryesor i ankesave për Qeverinë ka qenë përfitimi i pensioneve të posaçme, trajtimi i veçantë i familjeve të punonjësve të policisë të rënë në krye të detyrës gjatë vitit 1997, kërkesat e sindikatave të punonjësve të minierave për trajtim më të mirë financiar, kërkesat e shoqatës së pensionistëve për rritje pensioni, largime nga puna të individëve që kanë punuar në aparatin e Këshillit të Ministrave, kërkesa nga qytetarë të Vlorës për mos ndërtimin e Petroliferës, kundërshtimi nga disa shoqata të iniciativës qeveritare “Shqipëria 1 Euro” etj.

Avokati i Popullit është përpjekur në çdo rast që ankesat e ardhura në adresë të tij, megjithëse në shumë raste jashtë juridiksionit dhe kompetencave, të gjejnë një përgjigje dhe sqarim të shpejtë. Kjo pasi kërkesat e individëve të ndryshëm janë në diskrecion për zgjidhje nga vetë Qeveria dhe nuk mund t’i kërkohej si detyrim i pazbatuar ligjor.

Gjithsesi ne kemi patur gjithmonë në konsideratë për të trajtuar me seriozitet ato raste, kur gjatë këtyre procedurave nuk janë respektuar afatet apo detyrimet e tjera për transparencë ndaj të drejtave të individëve. Ky ka qenë edhe thelbi i ndërhyrjeve tona, sepse për raste të tjera, nuk mund të ndërhyhej duke shprehur thjesht opinione të qytetarëve për politika të caktuara qeveritare.

Referuar sa më lart në disa raste është vënë re se administrata e Këshillit të Ministrave nuk kryen veprimet e duhura në favor të shtetasve brenda afateve ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative apo në Ligjin “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentat Zyrtarë”. Ky ka qenë në disa raste shkak për ankesa dhe ka pasqyruar një mungesë transparencë.

Megjithëse Qeveria ka një faqe interneti tepër informative dhe të përditësuar për veprimtarinë e saj, ky kujdes duhet të tregohet edhe në veprimtarinë e saj të përditshme ndaj kërkesave apo ankesave të individëve.

Gjithsesi, ky aktivitet është ndjekur i pavarur nga trajtimi i ankesave të tjera që kanë përfunduar me ndërhyrje rekomanduese për Qeverinë, por që fillimisht janë drejtuar kundër institucioneve të tjera shtetërore.

Në vijim, po ju parashtrijmë raste që kemi shqyrtuar dhe zgjidhur pozitivisht, duke pasqyruar njëkohësisht edhe problematikën e vënë re gjatë trajtimit të tyre.

1. Në ankesën drejtuar Institucionit tonë, një nënë na shkruante se djali i saj, ishte vrarë në vitin 1998, tek Ura e Mifolit Vlorë, duke shkuar në ndihmë të punonjesve të policisë me automjetin e tij për kapjen e një bande grabitësish. Gjatë ndjekjes së kriminelëve ai është qëlluar me armë prej tyre dhe është vrarë.

Pas vrasjes ai ishte shpallur dëshmor i atdheut, mirëpo familja e tij nuk kishte përfituar asnjë trajtim ekonomik-financiar, sikurse kanë përfitur persona të tjerë të vrarë në ndihmë të policisë pas vitit 1999. Për këtë çështje nga ana e ankueses ishin bërë disa ankesa në Këshillin e Ministrave dhe në Ministrinë e Brendshme, por nuk ishte marrë ndonjë përgjigje pozitive.

Nga ana e Institucionit tone, duke parë se kjo çështje hasej shpesh edhe në ankesa të tjera të shtetasve, ju propozua sërish Qeverisë dhe Ministrisë së Brendshme që të kryheshin ndryshimet përkatëse në Vendimin e KM Nr. 552, dt. 27.11.1999.

Sipas këtij vendimi përfitojnë punonjesit e policisë dhe qytetarët që shkojnë në ndihmë të policisë, kur ata humbin jetën apo plagosen në krye të detyrës apo për shkak të saj. Mirëpo ky vendim e ka shtrirë fuqinë e tij që nga data 01.01.1999 e në vijim. Ndërsa për punonjesit e policisë të vrarë apo të plagosur para kësaj date, ky vendim padrejtësisht i diskriminonte ata.

Për të eliminuar këtë diferencim në trajtim, Avokati i Popullit, ashtu si dhe disa herë të tjera, parashtrroi një rekomandim pranë Qeverisë për të përmirësuar këtë vendim, me qëllim që ai ta shtrinte fuqinë e tij që nga data 01.01.1991.

Në përgjigjen e paraqitur së fundi nga Ministria e Brendshme jemi informuar se projekti për ndryshimin dhe përmirësimin e këtij vendimi i ishte paraqitur për miratim Qeverisë dhe pritej të miratohej së shpejti. Me miratimin e tij, ne mendojme se bëhet plotësisht e mundur zgjidhja e problemit të ankueses dhe rreth 300 individëve të tjerë. Kjo çështje do të ndiqet nga ana jonë, deri në zgjidhjen e saj përfundimtare.

2. Në letrën drejtuar Avokatit të Popullit, Zv.Kryetarja e Shoqatës së Hotelerisë së Shqipërisë, paraqiti shqetësimin në lidhje me vjeljen nga organet përkatëse kompetente të tarifës për përdorimin e veprave audiovizuale të autorëve vendas dhe të huaj, ndaj hoteleve apo moteleve. Kërkesa për vjeljen e saj nga Policia Tatimore kishte krijuar sipas saj, një situatë që rëndonte aktivitetin normal të hoteleve dhe bilancin e tyre ekonomik. Këtë tarifë të vendosur ndaj hoteleve dhe moteleve, ankuesja e evidentonte si shkak të mospërputhjes së Ligjit “Për të drejtën e autorit” me VKM-ne nr.309 date 13.06.2000 “Për tarifën e përdoruesve të pronësive artistike”.

VKM-ja në fjalë parashikonte pagimin dy here te tarifës për përdorimin e veprave audiovizuale, qofte nga TV publike e private, qofte nga hotelet dhe motelet, te cilat kishin aparat TV ne dhomat e tyre.

Më konkretisht, sipas ankueses, nuk kishte pse te ngarkoheshin hotelet me pagesën e këtyre tarifave, e cila paguhej njëherë nga TV kombëtare e lokale, publike e private. Për më tepër, hotelet nuk mund të ngarkoheshin me këtë tarifë, sepse ato nuk kishin për objekt aktivitetin e përdorimit të veprave të autorëve për qëllime fitimi, por ofrimin e shërbimit të hotelierisë për klientelën.

Pas shqyrtimit nga ana jonë u konkludua se VKM-ja nr.309 datë 13.06.2000 “Për tarifën e përdoruesve të pronësive artistike” vinte në kundërshtim me Ligjin “Për të drejtën e autorit” dhe parimet e percaktuara në Kodin Civil, pasi përcaktonte tarifa fikse, ndërkohë që ligji shprehej për caktimin e këtyre tarifave nëpërmjet kontratës së lidhur mes palëve.

Në këto kushte, nga ana Avokatit të Popullit ju rekomandua Qeverisë dhe Ministrisë së Kulturës, Turizimit, Rinisë dhe Sporteve që të rishikohej VKM-se nr.309 date 13.06.2000, duke ndërmarrë nismat përkatse për ta bërë atë të pajtueshme me dispozitat ligjore në fuqi.

Nga ana e Ministrisë së Turizimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve jemi njoftuar se në parim është mbështetur propozimi ynë dhe aktualisht është duke u punuar për modalitetet e këtij projekti, që do të kalojë më pas për miratim Qeverisë dhe Kuvendit.

Si konkluzion mendojmë se detyrimet e qeverisë për zgjidhjen e problemeve që parashtrihen nga individë të ndryshëm, duhet të jenë një prioritet i saj. Në këtë kuadër ndihma dhe ndërhyrjet tona do të jenë të vazhdueshme dhe nuk do të ndalen deri në zgjidhjen e plotë të kërkesave të drejta të qytetarëve.

Ne e kuptojmë volumin e madh të punëve që shoqëron veprimtarinë e Qeverisë, rradha e të cilave ndonjëherë të krijojnë perceptimin e gabuar se gjërat nuk po ndryshojnë. Por në çdo rast jemi të obliguar të vëmë në dukje mangësitë apo vonesat, pasi besojmë se kjo është mënyra më e drejtë për të përmbushur misionin tonë kushtetutes, duke ndihmuar njëkohësisht edhe vetë Qeverinë.

a) Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare

Gjatë vitit 2006, ndaj Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare janë bërë 9 ankesa, nga të cilat 3 kanë rezultuar jashtë kompetencës dhe për 6 të tjerat është ndërhyrë me rekomandim, duke zgjidhur pozitivisht 3 prej tyre.

Në një numër të konsiderueshëm ankesash për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare problem ka qenë largimi nga puna i disa punonjësve dhe mos përfitimi sipas ligjit i të drejtave dhe trajtimit financiar në favor të tyre. Ky qëndrim nga titullarët e kësaj drejtorie është bërë shkak që nga ana jonë të merren në shqyrtim dhe të ndërhyhet me rekomandime për zgjidhjen e pretendimeve të ankuesve, të cilat kanë rezultuar të bazuara ligjërisht. Në vijim po ju paraqesim shkurtimisht praktikrat që ilustrojnë veprimtarinë tonë për këtë çështje.

Pranë Avokatit të Popullit, prezantuan shqetësimin e tyre gjashtë punonjës të DSHQ-së, lidhur me mos pagimin nga ky organ të shpërblimit të vjetërsisë në punë, pas lirit të tyre nga detyra, për shkak të suprimimit të vendit të punës.

Konkretisht ata sqaruan se duke qenë në detyra të ndryshme në ndërmarrjet në varësi të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, janë njoftuar për ndërprerjet e marrdhënieve të punës dhe ju është premtuar shpërblimi në masën 1.5% të pagës bazë në përfundim të zgjidhjes së kontratës.

Duke qenë se ky shpërblim nuk ju është dhënë, ata kanë kërkuar nga Avokati i Popullit që të ndërmjetësonte për zgjidhjen e të drejtave të ligjshme që ju takonin.

Për këtë çështje nga ana jonë ju kërkuam fillimisht shpjegime Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, duke kërkuar arsyet e vonës së dhënies së shpërblimit. Në përgjigjen e ardhur nga D.SH.Q-ja u sqarua se për tre punonjës nuk do të jepej shpërblim, pasi ata kishin mbushur moshën për pension. Ndërsa për tre punonjësit e tjerë D.SH.Q-ja konfirmoi dhënien e shpërblimit në një kohë të mëvonshme, pasi sipas saj, ajo ishte ndërmarrje me humbje dhe nuk kishte parashikuar fonde për shpërblimin e vjetërsisë në punë.

Referuar përgjigjes së mësipërme si dhe duke analizuar në tërësi elementët e kësaj çështje, Avokati i Popullit paraqiti rekomandim pranë D.SH.Q-së, duke kërkuar shmangien nga praktikrat antiligjore dhe respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, konkretisht Nenin 145 të “Kodi të Punës në RSH”.

Si rrjedhim u kërkuam lëvrimi i menjëhershëm i shpërblimit për vjetërsi në punë në favor të të gjithë punonjësve, duke e argumentuar ligjërisht se pretendimi se disa prej tyre ishin në moshë pensioni ishte i pasaktë dhe nuk përlligjte mosdhënien e shpërblimit.

Në përgjigje të rekomandimit tonë, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare ka kundërshtuar përfitimin e shpërblimit për vjetërsi në punë të tre ish punonjësve, që sipas saj ishin në moshë pensioni, duke pretenduar se në bazë të Ligjit 7703, date 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, ata kishin mbushur moshën për

të përfituar pension. Ndërsa për tre punonjësit e tjerë D.SH.Q-ja ka pranuar argumentat ligjorë të sjellë në vëmendje të saj nga ana jonë dhe ka marrë përsipër që në buxhetin e vitit 2007 të parashikojë një fond të veçantë për shpërblimin e vjetërsisë në punë.

Referuar kësaj përgjigje, Avokati i Popullit ka rënë dakort me zgjidhjen e problemit për tre punonjësit që do të përfitojnë shpërblim në vitin 2007. Por ka insituar në zbatimin e rekomandimit të tij për tre punonjësit e tjerë, duke argumentuar se motivacioni i largimit të tyre nga puna nuk ka qenë mbushja e moshës për pension, por shkurtimi i vendit të punës.

Megjithëse ky argument ligjor nuk është marrë në konsideratë nga D.SH.Q-ja, jemi vënë në dijeni se Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë i ka dhënë të drejtë kërkesës së punonjësve në fjalë, duke argumentuar ligjërisht, ashtu si dhe mendimi ynë i mëparshëm, se motivacioni i D.SH.Q-së është shkak që ish punonjësit e saj të përfitojnë shpërblim si të tjerët.

Kjo praktikë ilustron më së miri parregullsitë që konstatohen në veprimtarinë e këtij organi dhe janë një mësim i mirë që drejtuesit e tij të kuptojnë rëndësinë e zbatimit rigoroz të ligjit dhe të respektimit të të drejtave të punonjësve. Përveç kësaj, çështja e mësipërme tregon për një nivel të dobët të njohjes së ligjit nga ana e punonjësve të kësaj drejtorie, çështja e ka vënë në pozitë të vështirë jo pak herë këtë organ edhe në të kaluarën.

Avokati i Popullit do të vazhdojë të mbajë në vëmendjen e tij edhe në të ardhmen veprimtarinë e këtij institucioni dhe do të ndërhyrë pa hezitim në ato raste ku do të vërehen shkelje të ligjit dhe të të drejtave të individëve.

b) Grupi Mbikqyrës i Firmave Piramidale pranë Këshillit të Ministrave

Nder problematikat e trajtuara nga ana e Avokatit të Popullit gjatë këtij viti, ka qenë edhe veprimtaria e Grupit Mbikqyrës pranë Këshillit të Ministrave.

Megjithëse numri i ankesave të paraqitura që lidhen me veprimtarinë e kësaj pjese të administratës publike ka ardhur vit pas viti në rënie, edhe në vitin 2006 nuk kanë munguar çështje, të cilat shprehin shqetësimin e individëve apo subjekteve përkatëse për procesin e administrimit dhe transparencës së firmave piramidale.

Numri i ankesave të marra nga ana jonë për këtë vit është 4. Të gjitha këto ankesa kanë përfunduar se shqyrtuari nga ana jonë. Kane

rezultuar, nje e pabazuar, kurse tre te tjerat jashtë juridiksionit dhe kompetencës sone.

Problemet e parashtruara në ankesat e marra në shqyrtim kanë qenë:

1. Për mosperfshirje ne listat e kreditoreve gjate procesit te kthimit të parave per kreditorët e ish firmave piramidale, nga ana e Grupit Mbikqyrës.

2. Për mungese te informimit, lidhur me procesin e kthimit te vlerave monetare kreditoreve te ish firmave piramidale.

3. Per veprime te kryera gjate procesit te administrimit te pasurive nga ana e administratoreve te caktuar me VKM-te perkatese ne ish firmat piramidale, ndaj pasurise se individeve konkrete.

Sikunder konstatohet, transparenca e munguar në punën e administratorëve të firmave piramidale dhe të Grupit Mbikqyrës pranë Këshillit të Ministrave, vazhdon të mbetet problem, fakt ky që është evidentuar çdo vit.

Proçesi i shpërndarjes së parave sipas përqindjes përkatëse të depozituar në firmat piramidale, për të cilat ka përfunduar proçesi i administrimit dhe transparencës, rezulton se ka ende probleme lidhur me gjeneralitetet e pakta që kanë kreditorët në listat e këtyre kompanive piramidale. Gjykojmë se ky problem, duhej të ishte kapercyer me kohë, pasi në punën që është bërë nga administratorët përkatës të firmave piramidale për listat e kreditoreve të këtyre firmave, të dhënat personale në listë, duhej të ishin të plota dhe të mjaftueshme për shmangjen e një fenomeni të tillë, sepse është e dukshme se koha në dispozicion për këtë qëllim ka qënë mëse e mjaftueshme.

Përcaktimi i afateve të shlyerjes së përqindjeve përkatëse dhe të shumave të derdhura nga ana e kreditorëve në firmat piramidale, eshte evidentuar tashme paresor dhe ka kapercyer problemin e mospërfundimit të plotë të proçesit të transparencës dhe mospërcaktimit te afateve konkrete të proçesit të kthimit të parave ndaj kreditorëve të firmave piramidale.

Problem kryesor mbetet mosinformimi ne kohe i qytetareve sipas dispozitave te Kodit te Procedurave Administrative ne kuptimin qe, p.sh. zoterimi i nje kontrate orgjinale nga ata, por mospasja e emrit ne lista, qe si pasoje sjell dhe mosnjohjen e kontrates nga administratorët, keta te fundit t'i orientonin ne kohe qytetaret per ndjekjen e rruges gjyqesore per vertetimin e qenies kreditor tek firmat piramidale.

Lidhur me veprimtarine e Grupit Mbikqyres te Firmave Piramidale prane Keshillit te Ministrave dhe administratoreve te caktuar per administrimin e ketyre firmave, mund te dilet fare qarte ne konkluzionin se per nje periudhe rreth 10 vjeçare, ende nuk eshte arritur te perfundoje

plotesisht procesi i administrimit te asetëve te këtyre subjekteve dhe se ende nuk ka përfunduar procesi i këthimit te parave tek kreditorët. Kjo kohezgjatje, veç problematikes se saj, anëve jo transparente dhe mungeses se informimit ne përgjithësi, ka nxjerrë ne dukje mungesën e efektshmerise se punës se këtij organi te administratës publike, i cili sot e kesaj dite nuk mund te deklarojë se ka përbushur qëllimin për te cilin ai u ngrit dhe u krijua.

Për sa është e vërtetuar më sipër, po paraqesim dy raste tipike të shqyrtuara nga ana jonë:

1. *Shtetasi Xh.B* nga Vlora, ka paraqitur një ankese ne te cilën ngrinte shqetesimin se ende nuk është trajtuar sipas te drejtave te ligjshme që gëzon si kreditor i ish Firmës Rentiere “Gjallica” dega Vlore. Për këte çështje ai pretendonte se është ankuar edhe pranë Kryeministrit, por nuk kishte marrë ende një përgjigje zyrtare.

Ne këto kushte ai ka kërkuar nga ana e Avokatit te Popullit që te shikojë mundësinë e dhënies se informacionit ndaj tij si individ ne lidhje me këte çështje.

Pas marrjes ne shqyrtim te kesaj çështje nga ana jonë, ankuesi është sqaruar se, procesi i këthimit te shumave te depozituara ne Ish Firmat Rentiere është një procedurë që po zgjat për shkak se, sipas autoriteteve përgjegjëse shtetërore, kjo mbetet ne varesi te identifikimit dhe konfiskimit te mjeteve monetare dhe materiale te tyre, që me tej do të jua ndahen ne mënyrë përpjestimore kreditorëve. Ne këto kushte ankuesi është vënë ne dijeni te faktit se megjithëse nga ana e Institucionit tone ka patur interesim te vazhdueshëm, deri me sot nuk është bërë i njohur një afat zyrtar për përfundimin e kesaj procedurë.

Sa me sipër, kjo çështje është mbyllur duke e konsideruar atë jashtë kompetencës se Avokatit te Popullit.

2. *Shtetasi B.T* nga Tirana, ka paraqitur një ankese me ane te se ciles pretendonte për mosmarrje te përqindjes se interesave si person i përfshirë ne listat e kreditorëve te firmës “Demokracia Popullore Xhaferri”, e vërtetuar kjo me ane te mandat – arketimit numer 9277, date 09.12.1996. Për këte arsye, ai i ishte drejtuar administratorëve te pavarur te kesaj firme piramidale te vënë nen administrim, por i është thënë se nuk e kishte emrin ne lista.

Për sa me lart, ankuesi ka kërkuar nderhyrjen e Avokatit te Popullit, pranë administratorëve te kesaj ish firme piramidale, për zgjidhjen e kesaj çështje.

Me marrjen ne shqyrtim te kesaj çështje, nisur nga kjo ankese por edhe nga një shqetesim i njëjtit i shprehur me parë nga shumë ankues te tjerë, kemi kërkuar shpjegime nga administratorët e pavarur te kesaj ish

firme piramidale. Sipas informacionit te derguar prane zyres sone rezultonte se keta administratore kishin marre ne administrim listat e kreditoreve te regjistruara ne kompjuterat e shoqerive perkatese. Kjo nenkuptonte faktin qe nese nga verifikimet qe i ishin bere karteles se ankuesit, ai nuk rezultonte te ishte i regjistruar, administratoret perkates nuk mund te merrnin persiper nje regjistrim te ri nga ana e tyre.

Ne keto kushte, duke e konsideruar çeshtjen jashte juridiksionit tone kemi orientuar ankuesin t'i drejtohej rruges gjyqesore per zgjidhjen e kesaj çeshtje, bazuar ne nenin 9 te Ligjit nr.8360 date 10.06.1998, ku percaktohet se: *Personi, i cili nuk gjen emrin e tij ne ate liste dhe disponon dokumente autentike qe verteton kredine e tij ne ate shoqeri, ka te drejten e ankimit.....*,

Ankimi i paraqitet Grupit te Administratoreve dhe Eksperteve te Pavarur. Pas marrjes se pergjigjes nga ky i fundit, kreditorët kane te drejten e ankimit ne Gjykatën e Apelit jo me vone se 10 dite nga dita e marrjes se pergjigjes”.

c) Instituti i Integritit të të Përndjekurve Politikë (IIPP)

Gjatë vitit 2006, ndaj Institutit të Integritit të të Përndjekurve Politikë (IIPP) janë bërë 5 ankesa Nga këto 2 kanë qënë jashtë kopetencave, 2 të pabazuara dhe 1 është zgjidhur në favor. Kjo e fundit ka të bëjë me Shoqatën e ish të Burgosurve Politikë të Shqipërisë e kryesuar nga Z. Tanush Kaso e cila pretendon se Instituti i Integritit të të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë në bashkëpunim me disa shoqata të tjera, kanë bërë shumë abuzime me fondet e dhëna nga shteti shqiptar për ish të përndjekurit politikë.

Nga ana jonë i është rekomanduar Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit ushtrimi i një kontrolli financiar për verifikimin e përdorimit të fondeve të dhëna nga shteti për ish të përndjekurit politik, Institutit të Integritit të të Përndjekurve Politikë si dhe shoqatave të të përndjekurve politikë të Shqipërisë. Ky rekomandim është pranuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe raporti përfundimtar u është dhënë të gjithë të interesuarve..

Një problem, i paraqitur në një numër të konsiderueshëm ankesash edhe para vitit 2006 është ai i mospërfitimit të statusit të të përndjekurit politik. Ky problem prek rreth 400 persona që presin të fitojnë statusin e ish të përndjekurit politik, dhe që nëpërmjet statusit, pretendojnë të përfitojnë të gjitha benefitet që mund të përfitohen prej zotërimit të tij. Kjo si pasojë e mosfunksionimit të Komisionit Shtetëror Trepalësh si organi kompetent për dhënien e së drejtës së Statusit të ish të Përndjekurit Politik. Ky komision ka funksionuar gjatë periudhës Nëntor 1993-Korrik 1997. Më pas edhe pse ka qënë detyrim ligjor ekzistenca e tij, ky

funksionim është ndërprerë. Ndaj në kuadër të një prej detyrave të tij, asaj të mirëfunksionimit të administratës publike, Institucioni i Avokatit të Popullit në mars 2005 i rekomandoi ish Zv.Kryeministrit përshpejtimin e procedurave për ngritjen e Komisionit Tre Palësh si organ kompetent për dhënien e së drejtës së Statusit të ish të Përndjekurit Politik dhe nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve 1 dhe 2 të Ligjit. Nr.9260, datë 15.07.2004 “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr.7748, datë 29.07.1993 “Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist” i ndryshuar. Në Nëntor 2005 dhe në Tetor 2006 këtë rekomandim ia kemi dërguar dhe Qeverisë të drejtuar nga Kryeministri Z.Sali Berisha, dhe po presim përgjigje për të.

d) Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave

Me ligjin nr. 9583, datë 17.07.2006 ‘Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompesimin e pronës”, dhe me Vendimin nr.566, date 23.08.2006 të Këshillit të Ministrave, është krijuar Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të cilës i kanë kaluar kompetencat ligjore dhe praktika dokumentare e veprimtarisë së ish-Komitetit Shteteror te Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

Ky institucion pjesën më të madhe gjatë vitit 2006 ka qenë ne pritje te akteve nenligjore ne zbatim te Ligjit nr. 9235 date 29.07.2004, i ndryshuar.

Kërkesat dhe ankesat do të shqyrtohen sipas kërkesave të ligjit, si dhe rregullave të reja për përpunimin dhe administrimin e të dhënave, të cilat janë në fazën e shqyrtimit dhe miratimit nga Këshilli i Ministrave.

Ankesat e shtetasve për Komisionet e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) për vitin 2006 jane 44 raste. Ndërsa 5 ankesa të tjera ishin të mbartura nga viti paraardhës. Nga këto, janë përfunduar 42 ankesa, nga të cilat 8 janë zgjidhur në favor të ankuesve, dhe 2 të tjera kanë kaluar për trajtim për vitin 2006. Objekti i ankesave vazhdojnë të jenë pretendimet për zvarritje në shqyrtimin e kërkesave nga Komisionet për njohjen dhe kthimin fizik të pasurive të paluajtshme, si dhe kundër vendimeve të tyre përfundimtare. Nga verifikimet e bëra rast pas rasti, ka dalë se një pjesë e konsiderueshme e tyre ishin të pabazuara, pasi dokumentacioni i depozituar pranë Komisioneve ka patur mangësi të theksuara, të tilla si mungesa e gen-planeve, mospërcaktimin e saktë të kufinjve për identifikim të pronës së pretenduar, mungesës të vendimeve gjyqësore në rastet e mos pasjes së aktit të pronësisë, e të tjera si këto, që kanë bërë praktikisht të pamundur shqyrtimin e tyre. Një pjesë e ish-pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre, duke u ndodhur jashtë shtetit për

motive ekonomike, nuk kanë patur kontakte me Komisionet për të verifikuar vonesat në trajtimin e kërkesave për njohje dhe kthimin e pronave. Për të gjitha këto raste, të vlerësuara si të pabazuara, ju është sugjeruar ankuesve të plotësojnë sa më shpejt dokumentacionin e duhur, shoqëruar me kopjen e ligjit të ri dhe sqarimet e duhura për hyrjen në fuqi të tij dhe të kërkesave kryesore proceduriale për realizimin e këtij procesi.

Nga çështjet e shqyrtuara, ato që kishin të bënin me kontestimet për vendimet e K.K.K. të Pronave, duke qënë se janë jashtë juridiksionit tonë, ju është bërë e ditur se duhet bërë kundërshtimi i tyre në rrugë gjyqësore. Një ankesë tjetër, ajo që i takonte shtetasit I.Gj. banues në Tiranë, është zgjidhur pozitivisht. Personi në fjalë ankohej për vonesa të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në shqyrtimin e kërkesës për njohje dhe kthim prone. Ndërhyrja jonë mundësoi shpejtimin e trajtimit të dosjes së personit të shpronësuar. Gjithashtu vlen të theksohet edhe ankesa e shtetasit F.T. me banim në Fier i cili shprehte pretendimin e tij për vonesa në shqyrtimin e një kërkesë që kishte bërë pranë K.K.K.P. të Qarkut Fier për korrigjim gabimi të bërë në vendimin nr. 14 datë 20.12.1995 të K.K.K.P. Lushnjë. Lidhur me këtë çështje ankuesi i ishte drejtuar me një ankesë edhe ish-Komitetit Shtetëror dhe pretendonte për shkelje të të drejtës së informimit lidhur me ankesën që kishte paraqitur pranë këtij institucioni. Pas ndërhyrjes tonë institucionale, nga ana e Kryetarit të K.SH.K.K.P. u sqarua me hollësi në lidhje me ankesën e parashtruar nga ankuesi si dhe u konfirmua fakti se do të merren të gjitha masat e duhura për njoftimin e ankuesit për të marrë pjesë gjatë shqyrtimit të kërkesës për verifikimin e vendimit të kontestuar.

Edhe ankesat e tjera të zgjidhura në favor të ankuesve kanë patur të njëjtën problematike.

Ka patur edhe ankesa të tjera që gjatë shqyrtimit nga ana jonë, kanë rezultuar të pabazuara apo jashtë kompetencave tona institucionale dhe nuk mund të shqyrtoheshim më tej. Këtu vlen të përmendim rastin e banorëve të Hotel “Pensioni” tek Rruga e Durrësit të cilët kanë paraqitur një ankesë ku na bënin të ditur shqetësimin e tyre në lidhje me vendimin nr. 207 datë 30.12.1993 të K.K.K.P. pranë Bashkisë Tiranë, që i kishte kthyer pronën trashëgimtarëve të B.K. Lidhur me trajtimin e ankesës së tyre, i jemi drejtuar me anë të disa shkresave të përsëritura K.SH.K.K.P. dhe Drejtorisë Juridike në Kontrollin e Lartë të Shtetit për të kërkuar shpjegime lidhur me pretendimin që ngrinin banorët në ankesën e tyre dhe për të bërë të mundur një rishqyrtim të vendimit të kontestuar nga ana e tyre. Në përgjigje të kërkesave tona, nga ana e K.SH.K.K.P. jemi njoftuar zyrtarisht se kërkesa e parashtruar nuk legjitimohet në zbatim të dispozitave ligjore të Ligjit nr. 9235 datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompesimin e Pronave”, duke qënë se “banorët” në interpretim të

dispozitive të këtij Ligji nuk konsiderohen si subjekte të shpronësuar. Çështja e lartpërmendur, mbi bazën e kërkesës tonë, u shqyrtua edhe nga ekspertë të Kontrollit të Lartë të Shtetit, nga të cilët kjo çështje u cilësua si konflikt privat mes palëve dhe që duhet të gjente zgjidhje në rrugë gjyqësore.

Marrëdhëniet tona institucionale me ish-Komitetin Shtetëror e me Komisionet e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në Qarqe e më vonë me Agjencinë e Kthimit e Kompensimit të Pronave dhe Zyrat Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për periudhën që trajtojmë, kanë qënë të mira. Përgjigjet e kthyerë kanë qënë brenda afateve ligjore dhe të argumentuara në shpjegimet e tyre për çdo rast.

2. Ministria e Drejtësisë

Një nga problemet që kemi ngritur edhe më parë për këtë Ministri është mospërkthimi, mosbotimi dhe si pasojë mosnjohja, në radhë të parë nga gjyqtarët i akteve ndërkombëtare, të firmosura e të ratifikuara nga shteti shqiptar.

Në lidhje me këtë çështje më datën 10.04.2006 Ministri i Drejtësisë na ka vënë në dijeni se:

“Ne përgjigje të shkresës tuaj Nr. 63, datë 16.03.2005, si dhe në vazhdimin e korrespondencës tonë lidhur me përkthimin në gjuhën shqipe dhe botimin e akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, ju sqarojmë si më poshtë:

Shumica e akteve ndërkombëtare të ratifikuara përpara hyrjes në fuqi të Kushtetutës me 1998 nuk janë botuar në fletoren zyrtare. Në rezultatin se përkthimi i këtyre akteve bëhet prej ministrive dhe institucioneve të fushës së përcaktuar në këto akte ndërkombëtare dhe Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet Drejtorisë së Kodifikimit jep mendimin mbi këto akte pa u shprehur për përkthimin e tyre. Me ligjin për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë të vitit 2001, u krijua sektori i përkthimeve zyrtare të cilit iu ngarkua edhe detyra funksionale e vlerësimit dhe verifikimit të përkthimit të këtyre akteve ndërkombëtare të kryera nga ministrive të fushës përkatëse. Deri në vitin 2005 cilësia e përkthimit, edhe pas insistimit dhe vërejtjeve të MD, nga ministrive të linjës vazhdoi të ishte e dobët. Për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së cilësisë së përkthimit Ministria e Drejtësisë sugjeroi dhe arriti në konkludimin e një akti përkatës nëligjor siç ishte Udhezimi i Përbashkët i saj dhe Ministrisë së Financave që vendoste modalitetet përkatëse të përkthimit zyrtar në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu vihet re se organet kompetente sipas legjislacionit shqiptar per depozitim e akteve nderkombetare dhe per administrimin e ketyre akteve ne momentin e ratifikimit jane perkatesisht Ministria e Puneve te Jashtme dhe Kuvendi. Keshtu ne baze te Ligjit Nr. 8371, date 09.07.1998, "Per lidhjen e Traktateve dhe Marreveshjeve Nderkombetare", Ministria e Puneve te Jashtme percaktohet si organi kryesor ne ndjekjen e procedurave te nenshkrimin dhe ratifikimit te akteve nderkombetare si dhe eshte percaktuar si depozitari i te gjitha akteve te ratifikuara nga Republika e Shqiperise. Pra, nese keto akte nuk do t'i paraqiteshin Keshillit te Ministrave per miratim ne parim dhe me pas Kuvendit per ratifikim kur mungonte perkthimi i aktit apo kur cilesia e perkthimit ishte e papranueshme dhe nese do te insistohej qe te tere ministrite e fushes, perfshire edhe Ministrine e Drejtesise, t'i ndiqnin sakte procedurat per nenshkrimin dhe ratifikimin e akteve nderkombetare, duke marre ne konsiderate rendesine e perkthimit zyrtar te tyre ne gjuhen shqipe, sot te gjitha keto akte do te ishin te botuara ne fletoren zyrtare. Gjithashtu edhe komisionet parlamentare gjate diskutimit te ketyre akteve si dhe Kuvendi gjate ratifikimit te tyre ne seance plenare i kane kaluar ato ne gjuhen origjinale, duke i percjelle QPZ-se per botim vetem ligjin perkates te ratifikimit pa perkthimin zyrtar ne gjuhen shqipe te akteve te ratifikuara.

Pra edhe pse mangesite e ketyre akteve ne perkthim kane qene qe ne origjine (ministrite e fushes), ato jane pranuar pa verejtje prej institucioneve pergjegjese per bllokimin e tyre dhe per pasoje nuk eshte bere botimi i tyre, por vetem botimi i ligjit dhe te dhenat e tij me te cilin akti nderkombetar eshte ratifikuar.

Meqenese behet fjale per nje problem te mbartur prej vitesh, pas insistimit te drejte te Avokatit te Popullit qe ne vitin 2002, Ministria e Drejtesise, edhe pse ligjerisht jo pergjegjese per krijimin e kesaj situate, deshiron t'i jape nje zgjidhje sa me te shpejte dhe perfundimtare. Meqenese behet fjale per perkthimin dhe botimin e te pakten 75 akteve nderkombetare me nje kosto financiare prej rreth 2 milione lekesh, Ministria e Drejtësisë do t'i propozoje Ministrise se Financave shtimin e fondit te mesiperm me kete destinacion ne buxhet gjate rishikimit te buxhetit te pergjithshem te shtetit per gjashtemujorin e dyte te vitit 2006. Ne rast sigurimi te fondit ne fjale prej buxhetit te shtetit, Ministria e Drejtësisë eshte plotesisht e gatshme qe te siguroje perkthimin dhe botimin e tyre brenda ketij viti". Jemi në djekje të zbatimit të kësaj detyre

Gjatë vitit 2006 janë trajtuar gjithësej 331 ankesa e kërkesa që kanë të bëjnë me autoritete në juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë, e konkretisht me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Zyrat e Permbarrimit, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme etj.

a. Ankesat për burgjet dhe administratën e burgjeve

Në lidhje me burgjet dhe personelin e burgjeve kemi patur 115 ankesa. Burgjet janë institucione të mbyllura dhe liria në të gjitha shprehjet e saj është e kufizuar dhe të drejtat e të burgosurve mund të shkelen më lehtë. Ne kemi mbajtur gjithmonë parasysh thënien e ish ministrit britanik, përgjegjës për burgjet Z. Jack Straw ku thotë se: “Mënyra si i trajtojnë shoqëritë ata të cilëve u është hequr liria, është provë vendimtare e përkushtimit ndaj të drejtave të njeriut”. Prandaj nga ana jonë, ankesave nga këta persona ju është kushtuar dhe do t’i kushtohet vëmendje e veçantë. Gjatë vitit 2006, punonjës të stafit të Avokatit të Popullit kanë vizituar të gjitha burgjet dhe paraburgimet që janë në vartësinë e Ministrisë së Drejtësisë, ashtu si dhe dhomat e izolimit të komisarivateve të policisë në rrethe. Në këto të fundit qëndrojnë të burgosur, për të cilët vendimi i gjykatës ka marrë formën e prerë si dhe të paraburgosurit, që presin të gjykohen. Në fund të vitit 2006 ka patur 3811 të burgosur dhe të paraburgosur në burgjet dhe paraburgimet që janë në vartësinë e Ministrisë së Drejtësisë, ndërkohë që kapaciteti i tyre është për 3341 persona, pra 470 persona mbi kapacitetin. Në ambjentet e paraburgimit që akoma janë në vartësinë e Ministrisë së Brendshme me datë 31.12.2006 ndodheshin 775 të paraburgosur, prej të cilëve 73 të dënuar me vendim të formës së prerë, ndërkohë që kapaciteti i tyre është për 671 persona, pra 104 persona mbi kapacitetet. Gjithsej kanë qenë 4566 persona të privuar nga liria, nga 4152 persona që ishin në fund të vitit 2005, pra 414 persona më shumë.

Gjatë vizitave në këto institucione janë takuar personalisht 384 të dënuar apo të paraburgosur. Në 134 raste ankesat e të dënuarve janë bërë me shkrim.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten te arrestuarit ne shkalle republike që ndodheshin ne dhomat e izolimit ne vartesi te Ministrise se Brendshme më datën 31.12.2006.

Në kohën që u përpilua ky raport, në shkurt 2006, u informuam nga Ministria e Brendshme se ishin marë nën administrim nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të gjithë ambjentet e paraburgimit që ndodhen pranë komisarivateve apo drejtorive të policisë.

Ky është një hap mjaft pozitiv i Qeverisë, i cili do të ndikojë mjaft në parandalimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut në vendin tonë.

Tabela 1

Rrethet	Kapaciteti	Të arrestuar	Me vendim të formës së prerë	Të mitur	Gra	Spital burgu	Spital civil	Të huaj
Berat	55	45	2	1				
Durrës	80	153	5		1	2	1	8
Krujë	30	30	7	6		2		
Dibër	30	22	3					
Mat	30	16	3			1		
Elbasan	70	100	4	4		1		
Librazhd	20	17						
Gramsh	12	9						
Fier	50	104	11	6		2	1	
Lushnjë	35	34	3	2	1	1	2	1
Gjirokastrë	30	40	4				1	
Përmet								
Tepelenë	25	17	2				1	
Kukës	40	13	3	2				
Tropojë	15	15	2					
Korçë	45	108	21	5				
Pogradec								
Lezhë	24	2						
Kurbin								
Shkodër	50	26	1	2			1	
Pukë								
Malësi Madhe								
Sarandë	30	24	2	3				
Tiranë								
TOTALI	671	775	73	31	2	9	7	9

Gjëndja e mbingarkuar është në Durrës, Fier, Korçë dhe Elbasan.

Gjatë vitit 2006 gjithsej janë ankuar 212 persona, ku përfshihen të burgosur, familjarë të tyre apo personel i administratës së burgjeve për çështje që lidhen me administratën gjyqësore, të prokurorisë dhe burgjeve.

Si veçori të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2006 për burgjet, përmendim organizimin e inspektimeve në të gjitha burgjet shqiptare, në dhomat e izolimit si dhe në Spitalin e Burgjeve, për të parë nga afër zbatueshmërinë e Ligjit Nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat

dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, të “Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, dhe “Rregulloreve të Brendshme të Burgjeve” etj.

Në Shqipëri, nga njëri vit në tjetrin vjen duke u rritur dhe konsoliduar interesi i publikut në drejtim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të burgosurve dhe të paraburgosurve. Edhe në vitin 2006 të burgosurve ju është ardhur në ndihmë nëpërmjet linjës telefonike 08001111 që funksionon falas për ankesat e tyre. Është verifikuar disa herë dhe ka rezultuar se ajo ka funksionuar rregullisht. Në disa raste (që janë përfshirë në numrin përgjithshëm të ankesave) të burgosurit i kanë paraqitur ankesat nëpërmjet telefonit që është vendosur në dispozicion të tyre. Kjo tregon për një hapje akoma më të madhe të burgjeve shqiptare dhe është një arritje në drejtimin e duhur e institucionit të Avokatit të Popullit. Telefonata ka patur edhe nga të burgosurit tanë në Greqi. Gjatë vitit 2006 ka patur shumë ankesa nga të burgosurit se nuk janë lejuar nga administrata e burgjeve të marrin në telefon Avokatin e Popullit.

Të ndarë sipas burgjeve, gjëndja e ankesave paraqitet si më poshtë:

1. Nga burgu 313 Tiranë	janë ankuar	7 persona
2. Nga burgu 302 Tiranë	janë ankuar	2
3. Nga burgu 325 Tiranë	janë ankuar	4
4. Nga burgu i Lushnjës	janë ankuar	3
5. Nga burgu i Tepelenës	janë ankuar	2
6. Nga burgu i Burrelit	janë ankuar	32
7. Nga burgu i Vaqarrit	janë ankuar	4
8. Nga Spitali burgjeve	janë ankuar	4
9. Nga burgu i Rrogozhinës	janë ankuar	8
10. Nga burgu i Lezhës	janë ankuar	19
11. Nga burgu i Krujës	janë ankuar	3
12. Nga burgu i Peqinit	janë ankuar	18
13. Nga paraburgimet	janë ankuar	17
14. Nga burgjet jashtë vëndit	janë ankuar	2

Në këtë numër nuk janë përfshirë ankesat apo kërkesat me shkrim të familjarëve të burgosurve si dhe kërkesa të tjera që janë paraqitur nga drejtoritë e burgjeve, komisariatet e policisë në rrethe, punonjës të administratës së burgjeve dhe të policisë së burgjeve.

Të ndarë sipas gjinisë, në 109 raste kanë bërë ankesë burrat, në 6 raste gratë dhe në rastet e tjera ankesat apo kërkesat janë dërguar nga drejtoritë e burgjeve, komisariatet e policisë në rrethe apo familjarët e të burgosurve dhe të paraburgosurve.

Sipas mënyrës së përfundimit ankesat paraqiten si vijon:

Për vitin 2006 janë përfunduar 199 ankesa apo kërkesa të ardhura me shkrim, nga 207 të ardhura gjithësej.

Nga këto 39 ose 20 % prej tyre janë zgjidhur në favor, 118 kanë qenë jashtë juridiksioni dhe kompetencës, 31 janë konsideruar si të padrejta, 8 raste janë në shqyrtim.

Gjendja ne burgjet dhe paraburgimet në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë me date 31.12.2006

Nr.	Institucioni	TE DENUAR										Mbipopullimi	
		Burra				Gra		Te mitur		Te semure mendore	Totali		Kapaciteti
		Siguri e larte	Siguri e zakonshme	Siguri e pashprehur	Te arrestuar	Te denuara	Te arrestuara	Te denuar	Te arrestuar				
1	P/burg "Jordan Misja"				403		48		22		473	395	78
2	P/burg Vlore		10		57				2		69	46	23
3	P/burg "M.Peza"		4		227						231	182	49
4	I.E.D.P. Lezhe		381		156						537	528	9
5	I.E.D.P.Burrel	174	2	19							195	195	0
6	I.E.D.P. Tepelene	96	3	6							105	105	0
7	I.E.D.P. Peqin	312	424	39							775	700	75
8	I.E.D.P. Lushnje	1	294	12							307	240	67
9	I.E.D.P. Vaqarr		143								161	150	11
10	I.E.D.P.Rrogozhine	2	402	14							418	380	38
11	I.E.D.P. Ali Demi		160					77			237	140	97
12	I.V. Kruje		199								199	200	-1
13	Spitali i Burgjeve		17		23				1	61	104	80	24
SHUMA		585	2039	90	866	0	48	77	25	61	3811	3341	470

Duke bërë grupimin sipas natyrës së ankesave rezulton:

1. Ankesa për mbipopullimin e burgjeve

Mjaft të burgosur janë ankuar se mbahen padrejtësisht në dhomat e izolimit të komisariateve të policisë, në të njëjtën kohë kur vendimet e gjykatave kanë kohë që kanë marrë formën e prerë. Ata kanë pretenduar se ju është shkelur e drejta e njohur nga neni 462 i K.Pr.Penale që urdhëron ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit të gjykatës që ka marrë formën e prerë.

Numri i ankesave të kësaj natyre për vitin që raportojmë në krahasim me vitin 2005 është i njëjtë. Institucioni i Avokatit të Popullit ndërmori një ispektim, në përfundim të të cilit, rezultoi se ende në dhomat e izolimit pranë komisariateve të policisë në rrethe, kishte dhe vazhdon të ketë një numër jo të vogël të dënuarish me vendim të formës së prerë. Me datë 31. 12. 2006 ndodheshin 73 të dënuar me vendim të formës së prerë në dhomat e izolimit (ndërkohë që edhe me datë 31.12.2005 ndodheshin 73 vetë), të cilët qëndrojnë në kundërshtim të hapur me nenin 462 të K.Pr.Penale. Shkaku i qëndrimit të këtyre të burgosurve në këto ambiente është mungesa e kapaciteteve në burgje.

Për rastet konkrete të të dënuarve që bëjnë ankesat me shkrim pranë zyrës së Avokatit të Popullit, ne kemi ndërhyrë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve që ata të dërgohen sa më parë në burgje. Si rrjedhojë ata janë transferuar nga dhomat e paraburgimit për në sistemin e burgjeve. Por këta nuk kanë përfutur nga rregulli i Nenit 57 të Kodit Penal që koha e qëndrimit në këto dhoma paraburgimi të llogaritet një ditë paraburgim baras me një ditë e gjysëm burgim. Për këtë ne kemi bërë edhe rekomandimin e përsëritur drejtuar Kuvendit dhe Ministrisë së Drejtësisë për të bërë ndryshime në ligj, por që deri tani nuk është miratuar.

Ashtu si edhe më parë, problemi i të dënuarve me vendim të formës së prerë që mbahen në dhomat e izolimit pa të drejtë ka qënë dhe do të mbetet, një nga drejtimit kryesore të punës sonë deri në zgjidhjen përfundimtare të tij.

Në takimet me drejtuesit e Ministrisë së Brendshme dhe atyre të Ministrisë së Drejtësisë në vazhdimësi është kërkuar që të përfundojë sa më shpejt kalimi gradual i dhomave të izolimit në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë, deri në zgjidhjen përfundimtare të këtij problemi. Në takimet që kemi patur gjatë vitit 2006, drejtuesit e Ministrisë së Brendshme kanë kërkuar ndërhyjen e Avokatit të Popullit pranë Qeverisë për kalimin e menjëhershëm të të gjitha ambjentëve të paraburgimit në vartësinë e Ministrisë së Drejtësisë.

Edhe Ministria e Drejtësisë është angazhuar se do të merrte masa për zgjidhjen përfundimtare të problemit. Ky problem është ndjekur dhe vazhdon të ndiqet në vazhdimësi, duke bërë presion mbi Ministrinë e Drejtësisë dhe Administratën e Burgjeve për të zbatuar menjëherë V.K.M Nr. 327, datë 15.05.2003, për kalimin e sistemit të paraburgimit në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë.

Siç thamë më sipër ky problem tashmë konsiderohet i kapërcyer.

Zyra jonë është duke e ndjekur këtë problem mbasi deri tani, faktikisht kanë kaluar në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë vetëm dhomat e izolimit në Vlorë, Shkodër, Lezhë dhe Tiranë.

Një nga problemet kryesore është niveli i mbipopullimit. Problemi i mbipopullimit ka marrë forma çnjerëzore në shumë ambjente paraburgimi si në Vlorë, Durrës, Fier, Korçë etj, mbipopullimi është në mënyrë të dukshme më i keq kur të burgosurit apo të paraburgosurit duhet të kalojnë pothuajse gjithë kohën në këto qeli ose dhoma dhe dalin jashtë tyre vetëm për një periudhë të shkurtër kohe.

Problemi i mbipopullimit të burgjeve nuk mund të zgjidhet vetëm duke ndërtuar burgje të reja. Më shumë rëndësi duhet t'i jepet në radhë të parë punës parandaluese që duhet të bëjë gjithë shoqëria dhe shteti Shqiptar, dhe së dyti prokuroritë dhe gjykatat duhet të bëjnë një politikë më të drejtë në zbatimin e masave alternative të dënimit. Prokurorët duhet të jenë më racionalë, jo çdo gjë duhet të zgjidhet me burg. Kufizimi i lirisë është një masë ekstreme, e cila duhet të jepet dhe të përdoret vetëm nëse masa të tjera alternative do të ishin pa vënd për shkak të rrezikshmërisë së krimit të kryer dhe autorit. Këto janë rekomandime të përsëritura jo vetëm të Avokatit të Popullit, por edhe të organizmave ndërkombëtare që merren me këto probleme.

**Informacion mbi gjendjen dhe përbërjen e të denuarve
në muajin dhjetor 2006**

Emërtimi	Moshë							Shuma.	Veprat penale								Të tjera	Masa e dënimit						
	Nën 18 vjeç	18<21 vjeç	21<30 vjeç	30<40 vjeç	40<50 vjeç	50<60 vjeç	Mbi 60 vjeç		Vjedhje me dhunë	Vjedhje	Vrasje	Plagosje	Marr Seks	K/vajtje	Droga	0<1 vjet		1<2 vjet	2<5 vjet	5<15 vjet	15<20 vjet	20<25 vjet	Per jete	
Burgu 313	1	2	3	4	2	1	1	14	1	4	2		1		2	4	1	4	5	3	1			
I.R.325 (B)		25	38	36	28	10	18	155	17	38	30	9	10	8	15	28	38	32	37	36	9	3		
I.R.325(G)		13	23	16	15	10	2	79		4	48				4	23	7	7	20	23	20	28		
I.R.Lushnje		23	126	103	45	18	8	313	37	27	108	13	8		70	50	5	25	54	162	27	40		
B. Burrel		1	74	63	36	14	18	206	63	3	128		3		5	4		1	9	82	49	32	33	
B.Tepelenë		2	24	54	14	8	3	105		22	64		6		1	12		1	22	14	39	29		
B. Vaqarr	27	7	49	50	26	6		165	31	16	62	5	13		29	9	7	4	29	82	32	11		
B. 302			8	14	2			24	4	1	14		3			2		1		7	9	4	3	
B. Rrogozhinë		27	184	126	57	25	4	423	84	15	127	8	23		59	107	4	11	78	266	42	22		
B. Kruje		4	56	64	20	24	41	209	30	3	126	4	9	1	15	13	2	9	20	120	40	17	1	
B. Peqin		28	358	230	117	44	6	783	75	99	393	20	21		85	90	7	11	76	379	146	118	46	
B. Lezhe		28	149	128	50	22	4	381	111	106	134	30	20	4	20	10	16	49	80	185	51			
Shuma	28	150	1092	888	412	182	105	2857	453	338	1190	89	117	13	305	352	8	154	409	1367	440	288	112	

2. Të sëmurë mendorë që mbahen ende padrejtësisht në Spitalin e Burgjeve

Të burgosurit dhe të paraburgosurit gëzojnë të drejtën themelore për të gëzuar shëndet të mirë, si mendor ashtu edhe fizik, si dhe kujdes shëndetësor në një standart që është të paktën në nivelin e standartit që i sigurohet komunitetit të gjërë. Pakti ndërkombëtar “Për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore” (neni 12) përcakton”:

“Kushdo ka të drejtë për të gëzuar në standartet maksimale të mundshme shëndet mendor dhe fizik”.

Përveç të drejtave themelore që gëzojnë të gjithë personat, të burgosurit gëzojnë edhe disa të tjera për shkak të statusit të tyre. Kur shteti u heq njerëzve lirinë, merr përsipër përgjegjësinë të kujdeset për shëndetin e tyre si në lidhje me kushtet në të cilat i mban ata, ashtu edhe në lidhje me trajtimin individual që mund të jetë i nevojshëm si rezultat i këtyre kushteve.

Shëndeti i mirë është shumë i rëndësishëm për këdo. Ai ka një rëndësi jashtëzakonisht të veçantë në komunitetet e mbyllura të burgjeve dhe paraburgimeve. Për nga natyra, kushtet në burg mund të kenë ndikim dëmtes, si në gjendjen mendore, ashtu edhe atë fizike të të burgosurve. Për këtë, administrata e burgjeve ka përgjegjësi jo thjesht të sigurojë kujdes mjekësor, por edhe të krijojë kushte që promovojnë mirëqenien, si të të burgosurve, ashtu edhe të personelit të burgjeve. Të burgosurit nuk duhet të largohen nga burgu në gjëndje më të keqe se ajo që kishin kur u futën në burg. Kjo duhet të zbatohet për të gjitha aspektet e jetës në burg e veçanërisht për shëndetin. Në vendin tonë, përdorimi në rritje i denimeve të gjata apo të përjetshme po çon në një shtim të problemeve shëndetësore në popullsinë e burgjeve. Kjo kërkon nga administrata e burgjeve që të bëjë planifikimet e duhura për problemet shëndetësore. Vendi ynë ka vështirësi të mëdha për të siguruar kujdes shëndetësor të standarteve të larta për popullsinë në përgjithësi. Edhe në këto rrethana të burgosurit kanë të drejtë dhe duhet të gëzojnë kujdesin më të madh të mundshëm shëndetësor dhe pa pagesë. Komiteti European për Parandalimin e Torturës (KEPT) ka deklaruar që edhe në periudha të vështirësive të mëdha ekonomike, asgjë nuk mund ta justifikojë shtetin të mos përmbushë përgjegjësinë për t’u siguruar kushtet bazë të jetës atyre të cilëve ai u ka hequr lirinë. KEPT-ja, gjithashtu, e ka bërë të qartë që kushtet bazë të jetesës përfshijnë edhe paisjet dhe medikamentet e përshtatshme dhe të mjaftueshme shëndetësore. Në zbatim të këtyre rekomandimeve, administrata e burgjeve duhet të plotësojë para së gjithash të gjitha burgjet e vendit me personelin e nevojshëm dhe sipas

profilin të shërbimit shëndetësor. Sidomos, në Burgun e Krujës, ku vuajnë denimin të denuar me probleme të rënda të shëndetit mendor dhe të denuar të moshave të vjetra.

Edhe në vitin 2006, problemi i personave për të cilët gjykata ka marrë masën mjeksore të mjekimit të detyruar nuk ka marrë ende zgjidhje. Gjatë vitit 2006 specialistë të zyrës së Avokatit të Popullit kanë bërë inspektime në Spitalin e Burgjeve për të parë gjëndjen e të sëmurëve mendorë për të cilët gjykatat kanë marrë masën mjeksore të mjekimit të detyruar dhe padrejtësisht mbahen në kushte burgimi. Nga këto inspektime doli se këta persona, ndonëse nuk janë të denuar, mbahen ende brënda sistemit të burgjeve. Nga hetimet e ndërmara nga ana jonë, rezultojnë se veç të tjerash, pengesë për zgjidhjen përfundimtare të këtij problemi është edhe mosplotësimi nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë të akteve nënligjore për ruajtjen e këtyre personave. Për këtë kemi rikërkuar zbatimin e rekomandimit të bërë qysh me datën 13.05.2002: “Për plotësimin e kërkesave të Ligjit Nr.8092, datë 03.02.1996 “Për Shëndetin Mendor”, për të nxjerrë rregulloren “Për masat e sigurimit të personave për të cilët gjykata ka marrë masën mjeksore të mjekimit të detyruar”.

Pra ky ligj përcakton detyrimin e Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Shëndetësisë për të miratuar rregulloren e masave të sigurimit për personat që kanë kryer një vepër penale dhe është vendosur nga gjykata mjekimi i detyrueshëm në institucione psikiatrike. Por megjithëse kanë kaluar rreth 10 vjet nga dita kur ka hyrë në fuqi ligji “Për shëndetin mendor”, një rregullore e tillë ende nuk ka dalë. Aktualisht 65 persona që kanë kryer vepra penale për të cilët gjykata ka urdhëruar “mjekim të detyruar” qëndrojnë në kundërshtim flagrant me ligjin në një pjesë të Spitalit të Burgjeve. Ky qëndrim ka sjellë moszbatimin e nenit 28 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që përcakton se çdo person i tillë ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij dhe ka lënë shteg për të abuzuar në drejtim të kërkesave ligjore për të drejtat e liritë e këtyre personave, duke i dëmtuar edhe më tepër nga ana mendore.

Në përgjigje të këtij rekomandimi para disa vitesh Ministria e Shëndetësisë e ka quajtur të zgjidhur problemin me kalimin kapital që ka bërë godinës së Spitalit të Krujës në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë. Kurse Ministria e Drejtësisë në përgjigje të këtij rekomandimi kishte marrë angazhimin se me hapjen e Burgut të Krujës do të fillojë së funksionuari edhe rregullorja e kërkuar nga ana jonë.

Në realitet Burgu i Krujes ka filluar nga aktiviteti, por funksionon përsëri si burg dhe jo si institut mjekësor që të sistemohen personat e sipërpërmendur. Ka patur ankesa se të sëmurëve këtu nuk u janë siguruar

ilaçet. Në kushtet kur ligji ndalon sistemimin e këtyre personave brenda sistemit të burgjeve nuk duhet marrë në konsideratë pretendimi i sistemit tyre në këtë burg. Gjate vitit 2006 zyra jonë ka insistuar pranë të dy ministrive për nxjerrjen e rregullores dhe përcaktimin e vendit ku do të shkojnë këta persona, por ende nuk është miratuar as rregullorja dhe as vendi i trajtimit tyre.

Ne mendojmë se ka munguar vullneti i të gjitha Qeverive për zgjidhjen e këtij problemi. Këtë konkluzion e nxjerrim duke parë kohën tepër të gjatë prej 10 vjetësh që ka kaluar që nga hyrja në fuqi e Ligjit “Për shëndetin mendor”.

Edhe për të ardhmen sistemimi i këtyre personave, ashtu siç është përcaktuar në ligj, do të jetë një nga përparësitë e punës sonë.

3. Ushtrim dhune dhe shkelje të tjera nga Policia e burgjeve

Menaxhimi i burgjeve, para së gjithash, duhet të bëhet brenda një kuadri ligjor dhe etik. Ata të cilët janë përgjegjës për administrimin e burgjeve duhet ta kenë përherë parasysh këtë parim. Ata duhet të kuptojnë se nuk janë thjeshtë roje, me të vetmen detyrë heqjen e lirisë së njerëzve. Përkundrazi, ata duhet të ndërthurin rolin e tyre të mbikëqyrjes së të burgosurve me një rol edukativ dhe reformues. Personeli i burgut duhet të ketë cilësi personale që i lejon të komunikojnë në mënyrë të barabartë, njerëzore dhe të drejtë me të gjithë të burgosurit, përfshirë këtu edhe ata më të vështirët dhe më të rrezikshmit.

Avokati i Popullit ose personat e autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim e pa autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në burgje, në vende ku policia ose prokuroria mbajnë persona të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar (të paraburgosurit), në reparte ose institucione shtetërore, në spitale psikiatrike, në azile, në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër kur ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirisë të njeriut.

Në zbatim të këtij ligji nga ekspertët e zyrës së Avokatit të Popullit janë organizuar inspektime të hollësishme në Burgun “Ali Demi” Tiranë, Burgun e Krujës, Burgun e Lezhës, Burgun e Burrelit, Burgun e Peqinit, Burgun 302 Tiranë, si dhe janë vizituar edhe burgjet e tjera si Burgu i Lushnjës, Burgu i Rrogozhinës, Burgu i Tepelenës dhe Burgu i Vaqarrit. Këto inspektime u organizuan me iniciativën e Avokatit të Popullit për shkak të të dhënave që erdhën se në burgje përdorej dhunë nga ana e policisë së burgjeve. Pas këtyre inspektimeve të hollësishme rezultoi se ka

patur raste për përdorim të dhunës nga ana e policisë së burgjeve, sidomos nga forcat e policisë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve si p.sh. në Burgun e Shenkollit në Lezhë dhe në Burgun e Burrelit. Me dt.14.09.2006 me iniciativën e Avokatit të Popullit është bërë një inspektim në Burgun e Shënkollit në Lezhë për ngjarjen e ndodhur në këtë burg me dt.13.07.2006 rreth orës 23.00.

Në rastin e kontrollit të kryer me dt.13.07.2006 në Burgun e Lezhës nga ana e policisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nuk janë respektuar ligjet dhe rregulloret për funksionimin e burgut.

Gjatë këtij kontrolli janë shkelur rëndë nga ana e policisë neni 47 i Ligjit Nr.8328, dt.16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të denuarve me burgim”, si dhe neni 40 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve. Në paragrafët 5 e 6 të nenit 40 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve thuhet: “*Kontrollet e të denuarve dhe të dhomave të tyre duhet të bëhen duke treguar respektin më të madh për personalitetin e të kontrolluarit dhe pa dëmtuar sendet që posedojnë ata.*”

Ushtrimi i kontrollit personal të anësive lejohet të bëhet vetëm kur ekziston një dyshim i arsyeshëm se i denuari mban sende të ndaluara sipas rregullave në fuqi”.

Gjatë verifikimeve të bëra nga ana jonë nëse janë zbatuar apo jo këto dispozita gjatë kontrollit të bërë në Burgun e Lezhës me dt.13.07.2006 rezultoi se jo vetëm që nuk janë zbatuar, por gjatë kontrollit nga ana e policisë janë kryer shkelje të rënda të këtyre dispozitave duke kryer veprime çnjerzore dhe poshtëruese ndaj të burgosurve, deri në përdorim të paligjshëm të dhunës fizike dhe psikologjike. Veprimet arbitrare dhe të paligjshme që janë kryer nga policia e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve gjatë kontrollit në Burgun e Lezhës janë: përdorimi i qenve antidrogë, mbyllja në banjo e të burgosurve gjatë kontrollit të dhomave të tyre, mbajtja për minuta të tëra të të burgosurve me duar lart, me kembë të hapura dhe mbështetur pas muri, fyerjet, sharjet me fjalor të pisët deri dhe demtimi i sendeve personale të të burgosurve si dhe përdorim i tejskajshëm dhune fizike dhe psikologjike ndaj tyre.

Gjatë vitit 2006 dhuna fizike është përshkallezuar rrezikshëm nga policia e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në kontrollet e kryera nëpër burgje me arsyetimin për pastrimin e burgjeve nga sendet e ndaluara dhe për rritjen e sigurisë në burgje.

Siguria ka të bëjë me ato procedura që duhen zbatuar për të parandaluar prishjen e rregullit apo arratisjen. Disa prej këtyre rregullave më të rëndësishme janë ato që kanë të bëjnë me kontrollin, si të hapësirave fizike, ashtu edhe të individëve.

Me qëllim që të shmangen abuzimet dhe shkeljet e lirive dhe të drejtave të të burgosurve duhet që në çdo burg të ketë një tërësi të qartë dhe të kuptueshme rregullash e procedurash që përshkruajnë në detaje rrethanat në të cilat duhet të zhvillohen kontrollet, metodat, mjetet që duhet të përdoren dhe shpeshtësinë e tyre. Aktualisht janë disa burgje që prej kohësh nuk kanë fare rregullore të brendshme. Burgu i Lezhës që kur është hapur dhe deri me dt.31.12.2006 nuk ka rregullore të brendshme.

Këto procedura duhet të hartohen dhe të publikohen me qëllim që të parandalojnë prishjen e rregullit apo arratisjen si dhe të mbrojnë në maksimum dinjitetin e të burgosurve dhe të vizitoreve të tyre.

Për problemet që i përkasin Burgut të Lezhës, kemi bërë dy rekomandime për marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin me përpikmëri të konventave ndërkombëtare, ligjeve dhe akteve nënligjore të njohura nga shteti shqiptar për burgjet, me qëllim që të respektohen në maksimumin e mundshëm liritë dhe të drejtat e të burgosurve si dhe mos të përsëriten në të ardhmen shkelje të tilla. Nga ana Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve jo vetëm që, nuk është marrë asnjë masë për këtë qëllim, por nuk ka marrë as mundimin për të përmbushur detyrimin ligjor që ka për të kthyer përgjigjen e këtyre rekomandimeve.

Si përfundim me keqardhje konstatojmë se gjendja e respektimit të lirive dhe të drejtave të të dënuarve në Burgun e Lezhës dhe në Burgun e Burrelit në krahasim me një vit më parë ka ardhur duke u përkeqësuar.

Përdorimi i dhunës nga policia e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve gjatë kontrolleve është konstatuar edhe në burgje të tjera si në Burgun e Peqinit dhe Burgun e Burrelit.

Konstatimet tona janë bërë prezent Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve si dhe Ministrit të Drejtësisë. Vlen për tu theksuar fakti se gjatë vitit 2006 ka patur më pak ankesa për keqtrajtime nga policia e burgjeve, por janë shtuar ankesat për keqtrajtime nga policia e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Disa drejtorë burgjesh kanë theksuar se ushtrimi i dhunës nga forcat e policisë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve ka rritur artificialisht konfliktin midis të burgosurve dhe punonjësve të burgjeve. Me miratimin e të drejtës së Avokatit të Popullit për të bërë vizita në burgje pa autorizim, si dhe për të organizuar inspektime në burgje është krijuar një mundësi shumë më efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të dënuarve. Praktika e inspektimeve do të bëhet më e shpeshtë në të ardhmen.

Sipas ankesave të të dënuarve dhe pas inspektimeve të bëra nga institucioni ynë gjatë vitit 2006 është konstatuar se Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve në tejkalim të kompetencave të tij ligjore dhe në kundërshtim të hapur me ligjet dhe aktet nënligjore të njohura nga shteti shqiptar për burgjet

ka nxjerrë urdhëra dhe lëshuar fonograme që kanë sjellë si pasojë shkeljen masive të të drejtave dhe lirive të të denuarve me burgim. Këtu mund të përmendim Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve me Nr.1522 datë 01.03.2006, “Mbi organizimin dhe kryerjen e takimeve speciale në burgje” si dhe fonogramin me Nr. 4629/15 datë 14.06.2006, që bën fjalë për mosdhënjen e lejeve shpërblyese. Këto dy akte administrative janë akte absolutisht të pa vlefshme sepse janë nxjerrë në kapërcim të kompetencave dhe në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit Nr.8328, datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të denuarve me Burgim”.

4. Ankesa të të burgosurve kundër vendimeve të gjykatave

Edhe gjatë vitit 2006 në zyrën tonë kanë vazhduar të vijjnë ankesa të të dënuarve kundër vendimeve të gjykatave të cilat i kanë deklaruar ata fajtorë. Në ankesat e tyre ata pretendojnë se nuk janë fajtorë për veprat për të cilat janë dënuar, duke pretenduar se gjykatat nuk kanë vlerësuar drejt provat në ngarkim të tyre. Numri i këtyre ankesave për vitin 2006 është 81. Pavarësisht se Avokati i Popullit në bazë të ligjit nuk ka në juridiksion shqyrtimin e vendimeve të gjykatës, në të gjitha këto raste nga ana jonë ankuesve ju është treguar rruga që ata duhet të ndjekin për të realizuar të drejtën e pretenduar prej tyre, me kërkesë për rishikimin e vendimit pranë Gjykatës së Lartë.

Kjo sepse pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.9398 datë12.05.2005 Avokatit të Popullit i është dhënë e drejta të presë ankesa ndaj vendimeve të gjykatave, por nuk janë bërë ndryshimet në Kodet e Procedurës Penale dhe Civile, për të realizuar këtë të drejtë.

5. Grevat e urisë

Avokati i Popullit në të gjitha rastet që është vënë në dijeni nga media apo nga administrata e burgjeve për hyrjen në greva urie të të denuarve, ka qenë ndermjetës midis administratës dhe të burgosurve. Në disa raste, ndërhyrja e Avokatit të Popullit ka qenë e suksesshme sepse të dënuarit kanë ndërprerë grevën e urisë, pasi ju janë plotësuar më parë ato kërkesa apo ankesa për të cilat kanë patur të drejtë. Ndërsa, në rastet kur ata kanë përdorur këtë mjet si presion për ndryshimin e vendimit të gjykatës, ju është bërë e qartë se ankesa nuk ishte në juridiksionin tonë dhe se çështja nuk zgjidhet me grevë urie, por duke apeluar në organet më të larta të gjyqësorit. Duke ndjekur në vazhdimësi fenomenin e shpeshtë të grevave të urisë nëpër burgje, Zyra e Avokatit të Popullit ka konstatuar se grevat e urisë

nëpër burgje nuk bëhen sipas udhëzimeve të Organizates Botërore të Shëndetësisë dhe Urdhërit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Pothuajse në të gjitha rastet e grevave të urisë, të burgosurit që pretendojnë se janë në greve urie nuk marrin ushqimin e burgut, ndërkohë që ushqimet nga familja mbahen në dhoma ku bëhet greva. Drejtuesit e burgut, duke mos dashur të konfliktohen me të burgosurit, bëjnë sikur ju besojnë atyre që janë në greve urie, ndërkohë edhe të burgosurit bëjnë sikur janë në greve urie. Për këto arsye, grevat fiktive të urisë po bëhen më të shpeshta nëpër burgje.

6. Ankesa për transferime të padrejta nga një burg në tjetrin

Transferimet e paligjshme të të denuarve nga një burg në tjetrin dhe sidomos kur nuk respektohet paragrafi i 5-te i nenit 31 të Ligjit Nr.8328, dt.16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të denuarve me burgim”, ku thuhet: *“Duhet të favorizohet kriteri i caktimit të të denuarve në institucione pranë vendbanimit të familjeve të tyre”*, dëmton shumë rëndë përpjekjet e administratës së burgjeve dhe sidomos të edukatorëve për kujdesin e veçantë që duhet t’i kushtohet ruajtjes, përmirësimit ose rivendosjes së lidhjeve të të denuarve me familjen. Transferime të tilla të paligjshme dëmtojnë jo vetëm të denuarit, por edhe familjarët e tyre.

Pas përfundimit të inspektimeve në Burgun e Lezhës u konstatua një numër i madh transferimesh të bëra nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nga njëri burg në tjetrin e anasjelltas. Kështu për periudhën 8 mujore Janar- Gusht 2006 është bërë transferimi i 84 të burgosurve nga Burgu i Lezhës për në burgje të tjera. Ky fenomen vërehet pothuajse në të gjitha burgjet. Transferime të tilla të paligjshme jo vetëm shkelin rëndë liritë dhe të drejtat e të denuarve dhe familjarëve të tyre, por dhe i shkaktojnë një kosto finaciare buxhetit të shtetit.

Në disa raste të dënuarit janë ankuar për transferime të padrejta ose kanë kërkuar të transferohen nga njëri burg në tjetrin në zbatim të nenit 31 të Ligjit Nr.8328 dt.16.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të denuarve me burgim” ku thuhet: *“duhet të favorizohet kriteri i caktimit të të denuarve në institucione pranë vendbanimit të familjeve të tyre*. Në të gjitha rastet që të denuarit janë ankuar se ndaj tyre nuk është respektuar kriteri i caktimit të tyre në institucione pranë vendbanimit të familjeve të tyre, pas ndërhyrjes së zyrës tonë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve është bërë i mundur transferimi i tyre.

Nga verifikimet tona është vërtetuar se në disa raste transferimi i të denuarve nga një burg në tjetrin është bërë në kundërshtim me kriteret

ligjore. Gjatë viteve kemi konstatuar se transferimi i të denuarve nga një burg në një tjetër është përdoruar si masë disiplinore, veprim që bie në kundërshtim të hapur me Ligjin Nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të denuarve me burgim”. Konstatojmë se si burg ku transferohen të denuarit e vështirë dhe të rrezikshëm po përdoret Burgu i Burrelit. Ne do propozonim që për shkak të kushteve jo të mira, që janë shumë larg standarteve të kërkuara të shikohet mundësia që Burgu i Burrelit të mbyllet. Avokati i Popullit nëpërmjet rekomandimit në këto raste ka kërkuar anulimin e urdhrave të transferimit. Kërkesa jonë në shumë raste është quajtur e drejtë dhe nga Drejtoria e Përgjithme e Burgjeve është vendosur transferimi i tyre në një burg afër vendbanimit të të familjeve të tyre. Por kemi patur edhe raste kur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është refuzuar, pa u argumentuar, rekomandimi i Avokatit të Popullit.

7. Ankesa të të dënuarve të ekstraduar nga Greqia që vuajnë dënimin në burgjet shqiptare

Edhe gjatë vitit 2006 kemi patur shumë ankesa nga të denuarit e transferuar nga Greqia që vuajnë dënimin në Shqipëri.

Nga ankesat e tyre dhe nga takimet e vazhdueshme që kemi patur me ta ka rezultuar se këta të burgosur ndonëse i kishin kaluar të gjitha shkallët e gjyqimit në Greqi, pretendojnë se ishin dënuar padrejtësisht ose se janë dënuar me masa denimi shumë të rënda për shkak se janë shqiptarë.

Ata janë sqaruar se vendimet e gjykatave greke janë jashtë juridiksionit të zyrës sonë dhe se shqyrtimi i këtyre vendimeve nga gjykatat tona nuk mund të bëhet. Disa vendime unifikuuese të Gjykatës së Lartë i ndalojnë gjykatat tona që të marrin në shqyrtim vendimet e dhëna nga gjykatat greke.

Ky problem është duke u ndjekur në kuadrin e hetimit të rastit që ka filluar me iniciativë zyra jonë, ku pretendohet që gruaja që është paraqitur para gjykatës greke si përkthyes nuk di fare gjuhën shqipe.

Ne mendojmë se mbajtja e dy të denuarve, të denuar nga gjykata greke, duke patur si përkthyes greken Niki Vavacula e cila nuk dinte fare gjuhën shqipe, pa u rishikuar vendimi i tyre është një shkelje e rëndë e të drejtave të tyre. Gjithashtu, zyra jonë ka kërkuar nga Ministria e Drejtësisë të na dërgohet lista e shtetasve shqiptarë të denuar në Greqi, që janë ekstraduar nga Greqia në Shqipëri dhe që aktualisht janë duke vuajtur dënimin penal në burgjet shqiptare si dhe vendimet e plotë të gjykatave greke të përkthyer në gjuhën shqipe të cilat duhet të gjënden në dosjet gjyqësore në gjykatat tona ku është bërë njohja e vendimeve të gjykatave

greke. Pas këtyrë të dhënave dhe pasi të studjojmë vendimet e plota të gjykatave greke, të përkthyer në gjuhën shqipe, ne do të mund të konkludojmë nëse pretendimet e tyre kanë bazë ligjore. Në këtë çështje bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve nuk ka qënë i mirë. Sepse kjo Ministri nuk na ka siguruar kopje të plota të vendimeve të kërkuara nga ana jonë.

8. Ankesa të familjareve të shtetasve shqiptarë që vuajnë dënimin në burgjet e shteteve të tjera

Për vitin 2006 ka patur 4 ankesa nga të denuar dhe familjarë të tyre, me anën e të cilave ata kanë pretenduar se ndaj të afërmeve të tyre në burgjet në Itali dhe Greqi përdoret dhunë, se ata nuk kanë asnjë djeni për shkaqet e burgosjes së fëmijve të tyre etj. Ata në ankesat dhe kërkesat e tyre kërkojnë përshpejtimin e procedurave për transferimin e tyre nga burgjet e vendeve të huaja për të vuajtur dënimin në burgjet shqiptare. Këto ankesa ju janë dërguar Ombudsman-ve në këto vende.

* * *

Nga analiza e ankesave dhe kërkesave të të burgosurve që ndodhen në burgje dhe në dhomat e izolimit pranë komisariateve të policisë, del se gjatë vitit 2007, veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit duhet të synojë në realizimin e rekomandimeve kryesore për Qeverinë, për Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Ministrinë e Brëndshme dhe konkretisht:

1. Shpejtimin e procedurave për marrjen në dorëzim nga Ministria e Drejtësisë të dhomave të izolimit në të gjithë vëndin.

2. Sistemimin në një institut mjekësor të personave për të cilët gjykata ka vendosur mjekimin e detyruar, ashtu siç kërkon ligji.

3. Mbi bazën e ankesave të të burgosurve, duke parë se në disa raste vetë ligji ishte bërë shkak për shkeljen e disa te drejtave të të burgosurve dhe të paraburgosurve, mbështetur në ligjin për Avokatin e Popullit, kemi bërë edhe rekomandime për ndryshimin e akteve ligjore që lidhen me të drejtat e të burgosurve. Konkretisht të dënuarve që janë mbajtur në qelitë e paraburgimit nuk ju njihet dhe nuk ju llogaritet kjo kohë si paraburgim. Shkaku i shkeljes së të drejtës së të paraburgosurve është bërë neni 7 i ligjit nr.7941, datë 27.01.1995, “Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, i cili përcakton se: “Me paraburgim do të kuptojmë ditët e qëndruara në ndalim dhe arrestim në burg. Kur arrestimi nuk është ndërprerë, periudha e paraburgimit do të konsiderohet nga dita e ndalimit, derisa vendimi i

gjykatës ka marrë formën e prerë”. Duhet gjetur mënyra që të rregullohet kjo dispozitë.

4. Gjithashtu duke parë se një pjese të madhe të të dënuarve nuk ju sigurohet e drejta për të votuar në zgjedhjet për pushtetin vendor. Zyra jonë do të vazhdojë t’u kërkojë forcave politike parlamentare ndryshimin dhe reformimin e legjislacionit për zgjedhjet dhe të marrë parasysh edhe rekomandimet tona që të gjithë të paraburgosurve dhe te denuarve t’ju sigurohet mundësia për të votuar në zgjedhjet vendore.

5. Gjithashtu i kemi ridërguar Ministrisë së Drejtësisë rekomandimet e mëposhtëme, për të cilat ndonëse kemi marrë përgjigje se janë pranuar si të drejta, në realitet nga ana e kësaj Ministrie nuk janë bërë hapa konkrete për vënien në zbatim të angazhimeve të marra:

a. Rekomandim për plotësimin e kërkesave të ligjit nr.8328 dt.16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim.”

Megjithëse kanë kaluar më se 8 vjet nga dita kur ka hyrë në fuqi ligji “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, gjithë të burgosurit që punojnë në burgje, marrin një shpërblim simbolik 90 lekë në muaj. Për çdo një muaj pune deri tani përfitonin 3.9 ditë burgim. Por me Urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm me Nr.3223 Prot. të dt.08.10.2004, është urdhëruar që të gjithë të dënuarve që kanë përfituar ditë burgu nëpërmjet punës t’ju hiqen. Për këtë qëllim Avokati i Popullit i ka dërguar rekomandim Prokurorit të Përgjithshëm “Për rregullimin e çështjes së uljes së denimit për të denuarit që punojnë në burgje dhe marrjen e masve për korrigjimin e pasojave të aktit të nxjerrë nga Prokurori i Përgjithshëm me shkresën Nr.3223, datë 08.10.2004 dërguar Prokurorive në Rrethe”. Kjo çështje po ndiqet nga ana jonë. Aktualisht në sistemin shqiptar të burgjeve janë të punësuar 545 të denuar.

b. Rekomandim për krijimin e kushteve të nevojshme për funksionimin e Komisionit Mbikqyrës të Ekzekutimit të Vendimeve me Burgim, sipas kreut të tretë të ligjit nr.8331 datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e Vendimeve Penale”

Nga shqyrtimi i çështjes prej zyrës sonë rezulton se ngritja e këtij komisioni ka përfunduar dhe se është miratuar vendimi për shpërblimin e antarëve të këtij komisioni, por Komisioni nuk funksionon siç duhet.

c. Katër Rekomandime për Marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin pa të meta të Ligjit Nr.8328, dt 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, sigurimin e kushteve të jetesës në Burgjet e Lezhës, të Krujës, të Burrelit dhe Burgut të grave si dhe Rekomandimi për hartimin dhe miratimin me procedurë të përshpejtuar të rregullores së brendshme në Burgun e Lezhës.

6. Të hartohen dhe të miratohen me procedurë të përsheptuar një tërësi e qartë dhe e kuptueshme rregullash dhe procedurash që përshekruajnë në detaje rrethanat në të cilat duhet të zhvillohen kontrollet, metodat, mjetet që duhet të përdoren dhe shpeshtësinë e tyre. Këto rregulla dhe procedura duhet të jenë në përputhje të plotë me konventat ndërkombëtare, ligjet dhe aktet e tjera nënligjore të njohura nga shteti shqiptar për sistemin e burgjeve.

7. Të shfuqizohet fonogrami me Nr. 4629/15 datë 14.06.2006, që bën fjalë për mosdhënien e lejeve, pasi ky fonogram është në kundërshtim të hapur me nenet 59 e 60 të Ligjit Nr.8328, “Për të drejtat dhe trajtimin e të denuarve me burgim”.

8. Të mos pengohen të burgosurit të telefonojnë me nr.08001111 direkt në çdo kohë me institucionin e Avokatit të Popullit.

Institucioni i Avokatit të Popullit mbetet në pritje të zbatimit të rekomandimeve të sipërpërmëndura, të cilat sipas Ministrisë së Drejtësisë do të jenë pjesë e një pakete të re ligjore dhe nënligjore që po përgatitet të miratohet.

Gjatë vitit 2006 në sistemin shqiptar të burgjeve, me gjithë shkeljet e mësipërme, nga institucioni ynë janë konstatuar edhe disa përparime të dukshme. Mund të përmëndim si arritje të këtij viti miratimin e normës së re për ushqimin e të denuarve. Gjithashtu në burgun 313 Tiranë, Burgun e Lushnjës, Burgun e Grave si dhe në Burgun e Peqinit janë organizuar disa aktivitete masive në drejtim të rehabilitimit të të denuarve dhe parapregatitjes së tyre që, pas përfundimit të denimit penal, edhe ata të jenë qytetarë të denjë të shoqërisë shqiptare.

Gjatë vitit 2006 bashkëpunimi i institucionit të Avokatit të Popullit me Ministrinë e Drejtësisë dhe me të gjitha burgjet ka qënë i mirë, gjë që nuk mund të thuhet për bashkëpunimin e institucionit tonë me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

b. Ankesat për Zyrat e Përmbarimit

Edhe për vitin 2006 problemet lidhur me zvarritjet në ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë, nga Zyrat e Përmbarimit në rrethe kanë zënë për qindje jo të vogël në ankesat e drejtuara institucionit tonë.

Kështu për vitin 2006 janë regjistruar 116 raste nga të cilat 113 janë ankesa dhe 3 kërkesa nga kreditorë të ndryshëm. Pretendimet për të drejtat e shkeluara, në shumicën dërmuese, kanë të bëjnë me zvarritje nga Zyrat e Përmbarimit në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Ndërsa pjesa tjetër ka si shqetësim kundërshtimet ndaj veprimeve, apo mosveprimeve dhe vendimeve të përmbaruesve gjyqësorë gjatë procesit të ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë. Nga 116 ankesa, janë përfunduar 111 ankesa, nga të cilat 25 janë zgjidhur në favor të ankuesve. Për shkeljet nga shërbimi përmbarimor kemi bërë 10 rekomandime, nga të cilat 8 janë pranuar, ndërsa 2 janë refuzuar.

Nga ankesat e tjera, 59 kanë rezultuar të pabazuara dhe 17 kanë qënë jashtë kompetencës dhe 8 ankesa me heqje dorë. Ndërsa 5 ankesa kanë kaluar për vazhdimin e shqyrtimit në vitin 2007.

Nga vitit 2005 kanë qënë të mbartura edhe 28 ankesa të të njëjtës natyrë, nga të cilat kanë përfunduar 20. Nga këto 11 janë zgjidhur në favor të qytetarëve, 5 të pabazuara, 4 jashtë kompetencës dhe 8 janë mbartur për vitin 2007.

Mjaft ankesa kanë rezultuar të pabazuara, mbasi kanë kërkuar pezullim të ekzekutimit të titujve ekzekutivë nga Gjykata e Lartë, ose kundërshtimin e vendimeve të pezullimit apo të pushimit të çështjes nga përmbaruesit gjyqësor. Për këto vendime ju është sugjeruar ankuesve që të ankohen në gjykatën kompetente, në bazë të nenit 617 të Kodit të Proçedurës Civile.

Ankesat kanë qënë pothuajse për të gjitha Zyrat e Përmbarimit, por me të shumta për Zyrat e Përmbarimit Tiranë, Lezhë, Korçë, Vlorë, Durrës, Lushnjë, Tropojë dhe Shkodër.

Rezulton se me shumë çështje përmbarimore pas ndërhyrjes tonë, janë përfunduar nga Zyra e Përmbarimit Tiranë. Statistikat tona tregojnë se kjo Zyrë ka edhe një pjesë tepër të madhe të praktikave të të gjithë shërbimit Përmbarimor në rang vëndi.

Në marrëdhënie me Avokatin e Popullit kjo Zyrë, së bashku me atë të Korçës dhe Lezhës, kërkesave tona ju përgjigjen brënda afateve të kërkuara dhe të shoqëruara edhe me kopjet e akteve dhe veprimeve proçeduriale përmbarimore të kryera. Më pas renditen për sa u takon çështjeve të ekzekutuara, Zyrat e Përmbarimit Shkodër, Mirdirë, Sarandë. Ndërsa me Zyrën e Përmbarimit Tropojë kemi probleme të mëdha komunikimi, pasi nuk respektojnë asnjë afat ligjor, gjë për të cilën kemi kërkuar marrjen e masave nga organi epror.

Një pjesë e konsiderueshme e ankimeve drejtuar Institucionit tonë, ka të bëjë me mos ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga debitorët institucione buxhetore që janë detyruar për kthim shumësh monetare të caktuara. Ky problem ka qënë i mbartur nga viti në vit, duke bërë kështu shqetësimin kryesor si për Shërbimin Përmbarimor, ashtu edhe për institucionin e Avokatit të Popullit dhe veçanërisht për protagonistët

kryesorë, gjyqfituesit, të cilët nuk kanë mundur të realizojnë të drejtën e fituar në rrugë gjyqësore.

Sipas informacioneve tona për çështjet e regjistruara pranë zyrave të përmbartimit nga viti 2002 deri në 6 mujin e parë të vitit 2006, që këto vendime të ekzekutohen duhen rreth 3 milion dollarë.

Ky problem u kap me shumë përgjegjësi nga kryeministri Zoti Sali Berisha që në Shtator 2005. Ai caktoi si objektiv kryesor të Qeverisë se tij shlyerjen deri në Dhjetor 2005. Të gjithë vendimet e kësaj natyre, arrinin shifrën 6 milion dollarë.

Duke ju referuar statistikave të zyrave të përmbartimit është mundur të realizohet në 50%.

Ka edhe mjaft ankesa të tjera që kanë të bëjnë me mosrrikthimin në punë të gjyqfituesve, mosëkzekutimin e vendimeve gjyqësore për trajtimin me toke bujqësore nga komisionet e tokave të fshatrave dhe komunave që nuk janë ekzekutuar.

Në nderhyrjet tona me mjetet ligjore që na kanë vënë në dispozicion ligji, jemi përpjekur në rradhë të parë të terheqim vëmendjen e Qeverisë dhe institucioneve buxhetore debitorë, për ndryshimin e mentalitetit të tyre që konsiston në moskonceptimin e drejtë të fuqisë së vendimit gjyqësor të formës së prapë. Shpesh ka patur raste që ekzekutimin e kanë konsideruar si jo të detyrueshëm për zbatim, si fakultativ, për të mosthënë që nuk janë të pakta rastet kur merrnin guximin që të shpreheshin që..... “vendimet janë ekzekutuar 70% dhe si të tilla mund të konsiderohen si të ekzekutuara teresisht”.

Një problem tjetër që duhet prekur, është edhe niveli jo gjithmone i kënaqshëm i cilësisë së veprimeve të përmbartuesve gjyqësorë, bazuar në kërkesat ligjore të Kodit të Procedurës Civile. Në shumë raste, gjatë verifikimeve të ankesave me dosjet përmbartimore, rezulton se ka veprime ose mosveprime, që janë tregues të mangësive të formimit profesional, pavarësisht shkakut apo motivit konkret, si: mungesë e njohjes së legjislacionit civil dhe atij procedural civil, keq interpretim të dispozitivit të vendimit gjyqësor, nënvleftësim, harresë, ngutje, etj.

Ndër shkaqet kryesore që kanë penguar ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prapë ka qenë edhe qëndrimi jo konsequent i përmbartuesve për zbatimin e kërkesave të ligjit. Janë jo të pakta rastet kur përmbartuesit gjyqësorë zbatojnë nenin 606 të K. Procedurës Civile për denim me gjobe të drejtuesve qëndrorë e lokalë të cilët nuk zbatojnë vendimet gjyqësore dhe thuajse nuk zbatohet fare neni 320 i K. Penal për pengim ekzekutimi ndaj këtyre drejtuesve për të denoncuar për ndjekje penale.

Qëndrime të tilla kane ulur besimin e shtetasve ndaj organeve dhe nëpunësve të administratës, duke cënuar reputacionin e shkallën e besueshmërisë të sistemit tonë të drejtësisë. Sot ne Shqiperi ekzekutimi I vendimeve gjyqesore eshte nje handicap ne sistemin e dhenies se drejtesise, qe ne raste ve ne dyshim funksionimin e vete sistemit.

- Nder rastet e paraqitura prane Institucionit tone mund te permendim: Ankesen e marre nga qytetari N.D ne te cilen shpreh shqetesimin e tij lidhur me mosekzekutimin e vendimit te formes se prere te Gjykates se Rrethit Vlore ne te cilen ishte vendosur detyrimi i qytetarit R.C te ktheje shumen prej 1.650.700 leke. Nga ana e zyres se permbarimit Vlore qytetari zvarritej per me shume se 3 vjet. Ne procesverbalet e mbajtura nga permbaruesja rezulton se nga ana e kesaj zyre ishte marre vendim refuzimi me argumentimin se ekzekutimi eshte kompetence e Administratorit te caktuar U.C vendim ky teresisht gabim.

Ne kushtet qe Institucioni yne shqyrtoi ankesen e lartepemundur, dhe konstatoi nje shkelje te hapur me kerkesat e nenit 510 te K.P.Civile, i rekomandoi Drejtorise se Pergjithshme te Permbarimit marrjen e masave te menjehershme per ekzekutimin e vendimit.

Rekomandimi u pranua pranua pozitivisht nga ana e kesaj Drejtorie duke urdheruar permbaruesen gjyqesore te rinisi veprimet proçeduriale per ekzekutimin e vendimit.

Konstatohet se ka zvarritje te pamotivuara ne ekzekutimin e vendimeve gjyqesore te formes se prere ne pagesen e pages, si dhe rikthimin ne vendin e meparshem te punes. Tipike eshte ankesa e qytetarit E.M nga Tirana per zvarritjen proçeduriale te bere prej zyres se permbarimit Tirane. Ai kishte nje vendim te formes se prere ne te cilen gjykata shprehej qe qytetarit t'I paguhej paga e plote deri ne ekzekutimin e vendimit, si dhe te rikthehej ne vendin e meparshem te punes.

Mbas rekomandime te bera prej Institucionit tone u veme ne dijeni se shuma e cila ishte percaktuar ne vendimin e Gjykates ishte arketuar ne favor te qytetarit, si dhe eshte punesuar ne te njejtin pozicion ne nje institucion tjeter.

- Ndersa ankimi tjeter i ankuesit F.D gjithashtu ka te beje me sekuestrimin dhe bllokimin e pasurise se luajtshme nga ana e zyres se permbarimit Tirane per efekt te shlyerjes se detyrimit qe shprehej vendimi i gjykates. Ankuesi ju drejtua Institucionit tone me ankesen se kete detyrim e ka shlyer dhe eshte pasqyruar edhe ne procesverbalet perkatese. Nga ana e permbaruesit, edhe pse kishte cenim te pronesise dhe taraca e qytetarit ishte riparuar ne shumen perkatese, vertetuar kjo nga procesverbalet e ekspertit,

pretendohej qe qytetari duhet te paguante edhe 43.000 leke per demin e shkaktuar.

Mbas nderhyrjes tone, pas nje kohe te shkurter ankesa e tij u zgjidh duke u vendosur pushimi i urdher ekzekutimit.

- Rast tjetër qe duhet permendur eshte ai i ankuesit Th.A lidhur me moszbatimin e vendimit gjyqesor te Gjykates se Larte nga ana e zyres se permbarimit Lushnje ne te cilen ishte vendosur pezullimi I vendimit te Gjykates se Apelit Vlore.

Mbasi shqyrtuam me vemendje ankesen e qytetarit si dhe dokumentacionin perkates vume re se ne procesverbalin e mbajtur nga ana e permbaruesit gjyqesor ishte vepruar ne kundershtrim flagrant me kerkesat ligjore te parashikuara ne K.Procedures Civile.

Nga ana e Institucionit tone ky veprim u konsiderua absolutisht i pavlefshem, dhe i rekomandoi zyres se permbarimit Lushnje marrjen e masave te menjehershme per venien ne vend te te drejtes se shkelur dhe per te pezulluar keshtu veprimet permbarimore.

Nga ana e kryetarit te kesaj zyre u informua se lidhur me kete ceshtje vendimi eshte ekzekutuar dhe nuk mund te kryhet asnje veprim per ta kthyer ne gjendjen e meparshme, duke mos e pranuar keshtu shkeljen e bere.

Ne vijim ju drejtuam Drejtorit te Pergjithshem te Permbarimit me rekomandimin e bere per te kontrolluar veprimtarine e kesaj zyre si dhe marrjen e masave disiplinore ndaj kryetarit te saj pasi ishte kryer nje shkelje te rende e K.P.Civile.

Nga ana e Drejtorise se Pergjithshme u informuam se zbatim te rekomandimit tones eshte proceduar me shkarkimin e kryetarit te kesaj zyre , si dhe jane marre masat per zgjidhjen e kesaj ceshtje konforme akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi.

- Rast tjetër eshte ankesa e qytetarit P.G nga Rresheni per zvarritjen prej 2 vjetesh nga ana e zyres se permbarimit Mirdite per mosekzekutimin e nje vendimi te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Mirdite .

Mbasi shqyrtuam ankesen e qytetarit ju drejtuam zyres permbarimore Mirdite per tu informuar mbi shkaqet e mosekzekutimit te vendimit gjyqesor. Ata na informuan se ekzekutimi I ketij titulli ekzekutiv nuk eshte bere I mundur pasi, prezenca e Policise Ndertimore se bashku me logjistiken qe ajo disponon nuk ka qene evidente”.

Pas rekomandimit tone nga Drejtoria e Pergjithshme e Permbarimit u mbajt nje qendrim i drejte duke urdheruar Zyren e Permbarimit Mirdite te kryeje veprimet e saj procedurale konform ligjit, duke aplikuar dhe sanksionin e parashikuar ne nenin 606 te Kodit te Procedures Civile, nepermjet gjobotjes se Kryetarit te Policise Ndertimore Lezhe.

Gjithashtu, nga ana e kesaj zyre ju derguam shkresa te shumta Policise Ndertimore Lezhe dhe Drejtorise se Policise Tirane dhe u be i mundur ekzekutimi i titullit ekzekutiv.

- Rast tjeret eshte ai i qytetarit Z.C ne te cilen ankohej lidhur me pergjigjet e marra prej Zyres se Permbarimit Shkoder per mosekzekutimin e vendimit te formes se prere te Gjykates se Rrethit Puke nr.123 date 18.07.03 ne te cilen detyrohej Prefektura Shkoder te paguaje shumen e papaguar ne vleren 520.875 leke.

Mbas rekomandimit te bere prej Institucionit tone u informuam se jane marre masat e nevojshme per venien ne ekzekutim te vendimit te mesiperm.

- Vlen per tu permendur ankesa e marre prej shtetasit R.R qe ankohet lidhu me mosnjohjen e detyrimit te percaktuar ne vendimin e gjykates nga Ministria e Financave persa i perket demshperblimit te tij per token qe i eshte marre per ndertimin e ujesjellesit te Bovilles.

Zyra e Permbarimit Tirane na informoi se e vetmja pengese eshte mosnjohja e detyrimit nga ana e Ministrise se Financave .

Ne te tilla kushte ju drejtuam Ministrise se Financave me rekomandimin perkates ne te cilen kerkuam marrjen e masave te nevojshme per te bere te mundur ekzekutimin e vendimit te Gjykates se Tiranes, lene ne fuqi edhe nga Gjykata e Larte.

Ministria e Financave u pergjigj se detyrimi per te demshperblyer qytetarin I takon Ministrise se Puneve Publike dhe Telekomunikacionit, e cila ka pasur fondet e nevojshme per ta kryer ate.

Ne kushtet qe Gjykata detyron Ministrine e Financave te demshperbleje qytetarin ju ridrejtuam Ministrise se Financave per te korrigjuar qendrimin e tyre, dhe venien ne ekzekutim te vendimit gjyqesor. Ndaj ketij rasti jemi ne pritje te qendrimin qe do te mbaje kjo Ministri ndaj rekomandimit tone.

Mendojme se eshte koha per institucionet qe administrojne financat shteterore, qe te ballafaqohen me kete realitet, te mbajne pergjegjesite qe ju takojne dhe te punojne per zbutjen e problemit me mundesite reale financiare te disponueshme. Gjithashtu i duhet kushtuar vemendje forcimit te ndjenjes se pergjegjesise se administratoreve shteterorë ne raport me ligjin, qe ne veprimtarite e tyre te perdritshme ne marrredhenie me individet, te jene te kujdesshem ne raporte te tilla te ndjeshme, si ne respektimin e prones private, te marrredhenieve te punes, te interesave te tjera te ligjshme te individeve, pasi cenimi i tyre po te drejte, jo vetem qe cenon demokracine, por rendon buxhetin e shtetit.

Pavarësisht që u përqendruam tek mangësitë e zyrave të permbarimit theksojmë se sistemi i permbarimit gjyqësor, ka edhe shumë shembuj e praktike të mira, dukshëm shumë më të mira se vitet paraardhese.

Institucioni i Avokatit të Popullit edhe në të ardhmen do t'i kushtojë vëmendjen e duhur problemeve të permbarimit gjyqësor në rastet e konstatimeve të veprimeve apo mosveprimeve që cenojnë të drejtat dhe interesat të ligjeshme të palëve në procesin gjyqësor.

c. Ankesa për Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP)

Për vitin 2006 pranë Institucionit tonë kanë ardhur 88 ankesa, që si objekt të tyre kanë patur pretendime për zvarritje në regjistrimin e pasurisë të tyre të paluajtshme, veçanërisht të oborreve të banesave private dhe zvarritje në procesin e marrjes së certifikatës së pronësisë. 7 ankesa kanë qënë të mbartura nga viti 2005.

Nga 95 ankesa gjithsej, janë shqyrtuar 83, nga të cilat 24 janë zgjidhur në favor të ankuesve, ndërsa 12 të tjera kanë kaluar për shqyrtim të mëtejshëm për vitin 2007.

Konstatojmë se për këtë periudhë kohore, bashkëpunimi dhe mirëkuptimi midis ZVRPP në rrethe dhe Institucionit të Avokatit të Popullit, në funksion të ushtrimit të funksioneve tona të njohura me Kushtetute dhe me Ligj, nuk ka qënë aspak në nivelin e dëshiruar dhe në frymën e respektimit të dispozitave ligjore.

Problematike shfaqet veçanërisht Z.V.R.P.P. Tiranë, ku pavarësisht faktit të fluksit të madh të punës për shkak të shtrirjes së madhe të zonës që mbulon kjo zyrë, janë konstatuar vazhdimisht vonesa dhe zvarritje të pajustificueshme të qytetarëve për kërkesa të ndryshme që ato kanë bërë pranë kësaj Zyre. Kjo situatë është krijuar për shkak të menaxhimit të dobët dhe keqadministrimit të veprimtarisë së kësaj zyre nga drejtuesit e saj.

Shkak i vonesave të kontestuara, vazhdon të jetë neglizhenca dhe mosrespektimi i deyrimeve ligjore nga ana e nëpunësve të ndryshëm të këtyre Zyrave për t'i kthyer përgjigje brenda afateve ligjore si kërkesave të qytetarëve, ashtu edhe të institucionit tonë. Megjithëse ka patur edhe raste të shumta ku pengesë në shqyrtimin e rasteve dhe indentifikimin e saktë të problemit të ngritur ka qënë edhe mosplotësimi i saktë i dokumentacionit për aplikim. Pas sugjerimit tonë për plotësimin e këtyre mangësive, kërkesat e ankuesve janë përmbytur nga ana e Z.V.R.P.P. Këtu mund të përmendim rastin e ankuesit L.Ç. që prej vitesh nuk po mund të realizonte regjistrimin fillestar dhe marrjen e certifikatës së pronësisë në Z.V.R.P.P. të rrethit

Durrës të banesës së tij pronë private. Pasi plotësoi aktet me dokumentat që i mungonin, ju bë regjistrimi dhe ju dha edhe certifikata e pronësisë. Të njëjtin problem ka ngritur edhe shtetasia Z.K. banues në Tiranë, që ju bë i mundur regjistrimi i pasurisë së paluajtshme, pasi plotësoi të gjithë dokumentacionin që i ishte kërkuar.

Gjithashtu për vonesa në pajisjen me certifikatë pronësie është ankuar pranë institucionit tonë edhe shtetasja M.Ç. me banim të përkohshëm në Greqi, e cila ngrinte pretendimet e saj ndaj Z.V.R.P.P. Vlorë. Pas ndërhyrjes tonë në vend dhe sqarimit të çështjes me punonjësit e Zyrës, u arrit pajisja e shtetasës me certifikatën e pronësisë.

Veçojmë për nivelin e mirë të bashkëpunimit Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në rrethin e Shkodrës, Lushnjës e Pogradecit. Kjo për rastet e zgjidhura shpejt dhe thjeshtë vetëm në sajë të kërkesave tona, si dhe mbi bazën e kontakteve të vendosura me personat e ngarkuar nga ana e Regjistruesve për mbajtjen e një korespondence korrekte me institucionet publike dhe personat privatë. Problematike gjatë shqyrtimit të ankesave të veçanta paraqitet Z.V.R.P.P. Durrës ku ka patur raste të vonesave në kryerjen e veprimeve, vonesa të cilat nga ana e drejtuesve të Zyrës justifikohen me kryerjen e punimeve rikonstruktuese të kësaj Zyre.

Përveç ankesave të përfunduara në favor të shtetasve, mjaft ankesa kanë rezultuar të pa bazuara, jashtë juridiksionit tonë ose jashtë kompetence, pasi kanë qënë në vetvete konflikte pronësie që kërkojnë zgjidhje gjyqësore. Janë konsideruar të pabazuara për faktin se thuajse të gjithë ankuesit konsiderojnë veprime korruptive dhe cënim të të drejtave të tyre, kur vihen në dijeni se pjesa e pronës që mendonin se ju takonte, në sajë të veprimeve të ndryshme juridike të kryera më përpara apo atyre që nuk janë kryer para noterit, nuk mund të regjistrohet tashmë nga ana e Z.V.R.P.P., pasi përbën shkelje të ligjit organik dhe Rregullores së brendshme përkatëse. Ndërsa pjesa që është vlerësuar jashtë kompetencave tona, nuk është gjë tjetër veçse bllokimi me të drejtë i pasurisë pasi janë krijuar mbivendosje pronash. Këto pasoja janë rrjedhim i veprimeve të nxituara të organeve të ngarkuara nga ligji për kalimin e pronësisë, të cilat pa bërë verifikimet e duhura japin, apo kthejnë në pronësi apo pjestojnë prona që pjesërisht apo tërësisht janë të regjistruara në emër të pronarëve të tjerë, duke krijuar në fakt një konflikt të ri pronësie. Edhe mos regjistrimin e oborrit funksional të banesave private, që siç duket po vazhdon si problem prej vitesh për shkak të moshapjes së proceseve gjyqësore për fitimin e këtyre pasurive me parashkrimin fitues, nga Z.V.R.P.P. të rretheve, në mungesë të akteve ligjore për fitimin e pronësisë, ankuesit i pretendojnë si të drejta të shkelura haptazi nga këto zyra, pasi sipas tyre kanë me dhjetra vjet që e shfrytëzojnë apo mbajnë këtë

truall. Për të mos thënë se ka edhe raste kur qytetarët blejnë banesa të paregjistruara ose të regjistruara me vërtetim gjyqësor të faktit, dhe mos regjistrimin e tyre apo mos dhënien e çertifikatës së pronësisë, kur janë ndërtime të paligjshme, e vlerësojnë si të qëllimshëm dhe me motive korruptive. Me këto konstatime, nuk kemi për qëllim mbrojtjen e veprimeve të këtyre zyrave, sepse ka edhe punonjës që në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës të tyre, mundohen të përfitojnë materialisht nga personat që paraqiten në sportelet e Z.V.R.P.P. Por për fat të keq, qytetarëve ju mungon vullneti për të bërë kallëzim penal pranë organit të akuzës, dhe kështu që ankesat në media ngelin vetëm në kuadrin e thashethemeve.

Siç e përmendëm edhe më lart, mos njohja e ligjit dhe mos përgatitja e dokumentave të duhura për rregjistrimin fillestar të pasurive të palujtshme, janë shkak kryesor që mosveprimet e Z.V.R.P.P.-ve në rrethe, një pjesë e madhe e individëve t'i konsiderojnë shkelje të të drejtave dhe interesave të tyre të ligjshme.

Kështu 14 ankesa kanë qënë të pabazuara, pasi regjistrimi nuk ju është bërë për shkak të mosplotësimit të dokumentacionit përkatës ligjor dhe të mos pasjes së aktit të pronësisë për oborret funksionalë. Ankuesit janë orientuar rast pas rasti dhe ju është sugjeruar forma dhe mënyra e veprimeve që duhet të bëjnë, përfshirë edhe ndjekjen e rrugës gjyqësore për fitimin e pronësisë së oborreve të banesave private me parashkrimin fitues. Një mangësi që sjell zvarritje në shqyrtimin e këtyre ankesave dhe keq kuptime në marrëdhëniet tona me ankuesit, janë vonesat e pajustificuara në kthimin e përgjigjeve nga disa Z.V.R.P.P. në rrethe, që nuk respektojnë afatet ligjore në kthimin e përgjigjeve apo të ecurisë së rekomandimeve konkrete, duke shkelur Kodin e Procedurave Administrative. Kjo është një e metë e madhe e këtyre zyrave.

Problem i evidentuar dhe ngritur edhe gjatë vitit 2006, ka qënë ai i hezitimit të pakuptueshëm të ndonjë Zyre të Regjistrimit të Pasurive të Palujtshme për rregjistrimin e pasurive të fituara me vendim gjyqësor të formës së prerë, duke shkelur haptazi të drejtat dhe interesat e ligjshme të individëve që kanë fituar gjyqësisht një të drejtë të shkelur. Kështu mund të përmendim rastin e shtetasit A.M. nga Saranda i cili pas zvarritjeve të shumta nga ana e Z.V.R.P.P. së Sarandë i është drejtuar Gjykatës e cila ka vendosur detyrimin e Z.V.R.P.P.-së që të bëjë regjistrimin përkatës të pronës së palujtshme të shtetasit. Pas zvarritjeve nga ana e nepunesve të Zyres për ekzekutimin e vendimit gjyqësor për regjistrimin e pronës, shtetasi A.M. iu drejtua institucionit të Avokatit të Popullit. Pas verifikimeve përkatëse dhe në zbatim të funksioneve tona kushtetuese i jemi drejtuar me rekomandim Regjistruesit të Z.V.R.P.P.-së Sarandë për ekzekutimin e vendimit gjyqësor

dhe regjistrimin e pasurise se ankuesit ne regjistrat e pasurive te paluajtshme. Ky rekomandim i eshte derguar per dijeni edhe Kryeregjistruesit, por për të nuk kemi patur akoma asnjë përgjigje zyrtare.

Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme duhet të unifikojë sa më shpejt praktiken e Zyrave në vartësi të saj, për zbatimin e kërkesave të pikës 3 të nenit 142 të Kushtetutës që i detyron organet shtetërore të ekzekutojnë vendimet gjyqësore të formës së prerë. Çdo kontestim ndaj këtyre vendimeve gjyqësore, duhet bërë vetëm në rrugë gjyqësore, me anë të rishikimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, parashikuar në nenin 494 të Kodit të Proçedurës Civile. Në të kundërt, duhet të jene koshiente ne respektimin e pavaresise te pushtetit gjyqesor dhe te veprojne ne regjistrimin e tyre.

Gjithashtu në kuadër të ushtrimit të kompetencave të njohuar me ligj institucionit të Avokatit të Popullit, duke marrë shkas ankesat e shumta të qytetarëve në të gjitha rrethet për zvarritje të proçedurave dhe vonesa në kryerjen e veprimeve nga ana e nëpunësve të Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme si dhe përgjithësimit të kësaj problematike, me qëllim përmirësimin e kësaj veprimtarie, i kemi dërguar një rekomandim përgjithësues Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme me anë të të cilit kemi rekomanduar:

-Marrjen e masave administrative për shmangien e veprimtarisë të Z.V.R.P.P.-ve nga veprime që dëmtojnë rëndë të drejtat dhe interesat e ligjshme të individëve.

-Shmangien e praktikave antiligjore dhe të parregullta që aplikohen nga Z.V.R.P.P. dhe respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, gjatë proçedurave të shqyrtimit të aplikimeve që kryhen nga shtetas të ndryshëm, per te zgjidhur të gjitha rastet e parashtruara.

-Marrjen e masave organizative për kthimin brenda afateve ligjore të kërkesave për informacion që dërgohen nga Avokati i Popullit dhe për shmangien e pengesave që hasen gjatë verifikimeve në vend nga ekspertë të institucionit të Avokatit të Popullit.

Megjithë kërkesat tona, deri tani nuk kemi patur përgjigje zyrtare nga ana e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Për këte rekomandim, ka patur një qëndrim mjaft pozitiv nga ana e Zyrës Vendore te Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë e cila na ka kthyer përgjigje dhe sqaruar për çdo rast të veçantë të përmendur në rekomandimin tonë dhe që kishte lidhje me punën e kësaj Zyre. Ndër këto ankesa mund të përmendim:

1. Mbi bazën e ankesës së shtetasit A.S. Drejtor i Shoqërisë “Dajtel” sh.a., i cili shprehte shqetësimin e tij për veprime të kundraligjshme dhe në

tejkalim të kompetencave nga ana e ZQRPP dhe ZVRPP Tiranë, veprime që kanë të bëjnë me fshirjen e regjistrimit të pronës së shoqërisë “Dajtel” sh.a. Nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit i është rekomanduar Z.Q.R.P.P.-së konstatimi i pavlefshmërisë së Urdhrit për anulimin e regjistrimit të pasurisë së shoqërisë “Dajtel” sh.a., ndjekja e rrugës gjyqësore dhe paraqitja para Gjykatës së pretendimeve të palëve përkatëse. Pastaj do të jetë Gjykata e cila do të shprehet me një vendim për çështjen në fjalë. Në këtë rast, ashtu siç përmendëm edhe më sipër, nuk kemi patur përgjigje nga ana e Z.Q.R.P.P.-së.

2. Mbi bazën e ankesës së shtetasës M.C. me banim në Durrës, objekti i të cilës është pretendimi për rregjistrimin e paligjshëm në emër të dy shtetasve të tjerë të një rrugice pranë pronës së saj, rrugicë e cila ishte në bashkëpronësi të të gjithë pronarëve përfaqë dhe që përdorej si rrugë kalimi nga të gjithë, i kemi rekomanduar Zyres Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nxjerrjen e urdhërit mbi ngritjen e një grupi kontrolli për verifikim e procedurave të regjistrimit të kësaj pasurie të përbashkët nga ana e Z.V.R.P.P. Durrës në emër të këtyre shtetasve. Edhe për këtë rast nuk kemi patur përgjigje nga ana e Z.Q.R.P.P.

3. Veçojmë ankesën e shtetasit A.B. me banim në Tiranë për vonesa nga Z.V.R.P.P. Tiranë për regjistrimin e një trualli pronë e tij, pasi kishte lidhur një kontratë shkëmbimi për ndërtimin e një pallati me një firmë ndërtimi. Ankuesi, në zbatim të kontratës, i kishte vënë firmës ndërtuese një sipërfaqe të caktuar trualli të caktuar në dispozicion, dhe për pjesën tjetër që kishte mbetur kishte kërkuar hipotekimin e saj. Ky proces nuk ishte kryer nga nëpunësit e Z.V.R.P.P., duke qenë se në favor të firmës ndërtuese ishte hipotekuar një sipërfaqe me e madhe se ajo që parashikohej në kontratën e shkëmbimit. Pas shqyrtimit që i bëmë kësaj ankese, i jemi drejtuar me rekomandim Regjistrueses së Z.V.R.P.P. Tiranë ku kemi rekomanduar shqyrtimin e pretendimeve të ankuesit dhe vënien para përgjegjësisë të nëpunësve që kanë shkaktuar shkelje të të drejtës së pronësisë të tij dhe në të njëjtën kohë edhe shkelje të dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e Z.V.R.P.P.-së. Akoma nuk kemi patur një përgjigje zyrtare.

Rëndësi të veçantë për mirëfunksionimin dhe administrimin sa më të mirë të punës së këtyre Zyrave është ai i rritjes së shkallës së transparencës të Z.V.R.P.P. në marrëdhëniet dhe komunikimin e tyre me qytetarët. Forcimi i infrastrukturës së tyre, siç është rasti i përmirësimeve rrënjësore me ambientet e reja të funksionimit të Z.V.R.P.P. të rretheve Tiranë, Durrës, etj, ku përveç të tjerave, është rritur ndjeshëm numri i sporteleve dhe i juristëve që kontaktojnë direkt gjatë gjithë orarit zyrtar me aplikuesit, padyshim që, do t’u shërbejë më mirë nevojave të qytetarëve dhe do të çojë në fund të

fundit në rritjen e besimit të tyre ndaj këtyre organeve mjaft të rëndësishme të administratës publike.

Veç kësaj, e rëndësishme është që Kuvendi të miratojë sa më shpejt projektligjin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7843 datë 13/07/1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”.

Këto ndryshime besojmë se do të kontribuojnë edhe për zgjidhjen e mjaft ankesave që vijnë për shkak të boshlleqeve të ligjit në fuqi.

3. Ankesat për pushtetin gjyqësor dhe administratën gjyqësore

Institucioni i Avokatit të Popullit dhe gjykatat janë dy institucionet më të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ndihamë e institucionit të Avokatit të Popullit, i cili është jashtë gjyqësorit, luan një rol të rëndësishëm për rritjen e efektivitetit dhe besimit të publikut tek gjyqësori.

Në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit “Për Avokatin e Popullit” juridiksioni i Avokatit të Popullit në lidhje me gjyqësorin është i tillë, që as prek dhe as rrezikon pavarësinë e gjyqtarëve në dhënien e vendimeve gjyqësore.

Nga praktika disa vjeçare del se ne kemi marrdhënie të mira dhe mirëkuptim me gjyqësorin. Edhe në të ardhmen marrdhëniet tona do vazhdojnë të jenë korekte në këtë drejtim. Kjo sepse të gjithë jemi të interesuar që të realizohen e të respektohen me përpikmëri të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Avokati i Popullit në punën e tij gjatë verifikimit të ankesave dhe kërkesave ka dhënë ndihmën e duhur në punën e gjykatave duke njoftuar në çdo rast me shkrim Ministrin e Drejtësisë, apo Inspektoriatin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për shkelje të ndryshme proceduriale të kryera nga gjyqtarë të veçantë, si dhe për shkelje të kryera nga administrata gjyqësore.

Avokati i Popullit nga ana e tij ndihmon edhe duke kërkuar që organet e administratës shtetërore të zbatojnë patjetër vendimet gjyqësore në të gjitha rastet kur ato kanë marrë formë të prerë. Në këtë mënyrë ne ndihmojmë që të rritet autoriteti i pushtetit gjyqësor, ndaj degës së ekzekutivit i cili ka treguar në disa raste se nënvlerëson fuqinë e vendimeve gjyqësore, duke i bërë në këtë mënyrë një dëm të madh moral dhe ekonomik shtetit të së drejtës.

Avokati i Popullit gjatë kësaj periudhe ka patur akses të kufizuar në gjykatë dhe në asnjë rast gjatë veprimtarisë sonë nuk kemi prekur apo cënuar pavarësinë e gjyqësorit.

Kuvendi i Shqipërisë me ligjin Nr.9398 dt.12.05.2005 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ndryshuar me ligjin nr.8600 dt.10.04.2000, ka parashikuar disa të drejta dhe kompetenca të tjera të reja në funksion të veprimtarisë së institucionit tonë.Këto shtesa dhe ndryshime u bënë duke u bazuar në eksperiencën e fituar gjatë këtyre viteve dhe përvojës së mirë të Ombudsmanëve të vendeve të tjera, në mënyrë të veçantë të Ombudsmanit të Polonisë.

Në paragrafin e fundit të nenit 25 të këtij ligji parashikohet se Avokati i Popullit, pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkeljen e të drejtave të njeriut që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor, vendimet e formës së prerë, dhe procedurat gjyqësore.Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prek pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimeve.

Në këto rrethana me këto ndryshime të ligjit ne si institucion jemi të detyruar për të pranuar për shqyrtim çdo ankesë, apo kërkesë që bëhet ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë.Por ndryshimi i ligjit nuk zgjidh problemin se cili do të jetë mjeti ligjor i reagimit të Avokatit të Popullit ndaj këtyre vendimeve të formës së prerë.Për zgjidhjen e këtij problemi është e nevojshme që të bëhen disa shtesa dhe plotësime në Kodin e Proçedurës Civile dhe Kodin e Proçedurës Penale. Ja kemi ngritur këtë çështje Kuvendit dhe Qeverisë, por deri tani nuk ka ndonjë projektligj për këtë qëllim.

Ankesat për Gjykatat

Gjatë vitit 2006 ndaj gjykatave kanë ardhur me shkrim për shqyrtim gjithsej 374 ankesa, nga të cilat 150 prej tyre kanë qënë kundra vendimeve gjyqësore dhe si të tilla nga ana e jonë janë refuzuar, duke sqaruar faktin se akoma nga Parlamenti nuk janë bërë ndryshimet e nevojshme në kodet e proçedurave. Në këtë numër nuk përfshihen edhe ankesa të tjera që i ka prituri Sektori i pritjes së popullit dhe i ka dhënë ndihmë juridike, por kanë qënë jashtë juridiksionit tonë.

Por 224 ankesat e tjera, duke i analizuar sipas objektit të tyre, kanë qënë për këto probleme :

Vendin kryesor të ankesave të ardhura gjatë këtij viti ndaj gjykatave e zënë ato për zvarritje pa shkaqe ligjore të gjykimeve për çështje të ndryshme si në fushën penale dhe atë civile.

Në disa ankesa ndaj gjykatave është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e Avokatit të Popullit për të përfaqësuar palët ndërgjyqësa në shkallët më të larta të gjyqësorit në mënyrë të veçantë në Gjykatën e Apelit apo në Gjykatën e Lartë, me arsyetim se ato nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të përballuar marrjen e një avokati privat.

Ankesa kanë ardhur kryesisht ndaj gjykimeve dhe vendimeve gjyqësore të marra në mungesë të palëve, ose të subjekteve përkatëse. Palët mbas vënies në dijeni të këtyre gjykimeve dhe vendimeve të marra janë ankuar tek ne duke kërkuar ndihmën dhe ndërhyrjen tonë për prishjen e këtyre vendimeve nga organet më të larta gjyqësore.

Edhe gjatë këtij viti kanë ardhur në disa raste ankesa për veprime e qëndrime të njëanshme të gjyqtarëve të veçantë gjatë gjykimeve konkrete dhe është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e jonë për përjashtimin e tyre nga gjykimi i çështjes.

Ankesa kanë ardhur edhe ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë ndaj të cilëve është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë dhe është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e Avokatit të Popullit për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor derisa të shqyrtohet rekursi nga Gjykata e Lartë.

Po kështu ka patur ankesa ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë kur palët kanë zbuluar prova të reja shkresore dhe për këtë është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e Avokatit të Popullit për t'ju drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikim vendimi.

Në disa raste ankesa kanë ardhur ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë duke pretenduar se nga gjykatat gjatë gjykimit të çështjeve të tyre nuk janë respektuar të gjitha kërkesat e ligjit material e procedurial për një proces të rregullt ligjor. Në këto rast është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e Avokatit të Popullit që çështja e tyre të dërgohet për gjykim në Gjykatën Kushtetuese, për të kërkuar që vendimet gjyqësore të deklarohen antikushtetuese.

Edhe gjatë këtij viti në disa raste kanë ardhur ankesa ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë të gjykatave për të cilat janë ezauruar të gjitha mjetet e ankimit, duke përfshirë edhe ankimin kushtetues dhe kërkohet ndihma jonë që çështja e tyre të dërgohet për gjykim në Gjykatën e Strasburgut.

Ankesa kanë ardhur edhe ndaj vendimeve gjyqësore ku janë marrë masa të rënda dënimi dhe është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e Avokatit të Popullit në Gjykatën e Apelit apo në Gjykatën e Lartë, me qëllim që ndaj tyre të zbatohet Amicus Curie (Miku i gjykatës)

Ankesa kanë ardhur edhe për zvarritje të padrejta nga administrata e gjykatave në drejtim të dërgimit të dosjeve për gjykim nga Gjykatat e Rretheve në Gjykatat e Apelit apo në Gjykatën e Lartë dhe anasjelltas.

Po kështu ankesa kanë ardhur edhe për faktin se ndonëse kanë përfunduar gjykimet, palëve nuk u jepen kopjet e vendimeve nga administrata gjyqësore.

Ankesa kanë ardhur edhe nga persona të ndryshëm të cilët janë gjykuara e dënuar nga gjykatat Greke dhe kanë ardhur për të vuajtur dënimet me burgim në burgjet shqiptare, duke pretenduar se vendimet ndaj tyre janë marrë me masa dënimi të rënda dhe të papërshtatshme.

Po kështu në disa raste ankesat kanë patur për objekt lirimin e personave të dënuar kur gjatë vuajtjes së dënimit ato janë sëmure nga sëmundje të rënda ose kanë kërkuar ndihmën dhe ndërhyrjen e Avokatit të Popullit për lirimin e tyre me kusht ose faljen e dënimit të dhënë nga gjykatat.

Ankesa kanë ardhur edhe ndaj gjyqtarëve të veçantë të Gjykatave të Shkallës së Parë apo të Gjykatave të Apelit duke i akuzuar ato për veprime korruptive dhe kërkohet që nga Avokati i Popullit të fillohet procedimi disiplinor si për shkelje të ndryshme në detyrë ashtu dhe për korrupsion.

Nga analiza e ankesave të ardhura ndaj gjykatave vrehet se në përgjithësi ka një besim të madh ndaj institucionit tonë dhe arrihet deri aty sa ankuesit të paraqesin edhe dokumente apo fakte të ndryshme për të argumentuar dhe bërë vlerësimet e vendimeve gjyqësore.

Në këtë drejtim nga ana e jonë në çdo rast janë bërë sqarimet e nevojshme për rrugën ligjore që duhet ndjekur si dhe argumentat kushtetuese dhe ligjore se vendimet gjyqësore nuk mund të ndryshohen nga institucioni ynë, por vetën nga gjykatat më të larta mbi bazën e ankimeve dhe rekurseve të parashikuara në ligj.

Gjatë vitit 2006 për gjithë ankesat e ardhura ndaj gjykatave, në 30 raste ato janë zgjidhur në favor të ankuesave.

a. Ankesat e ardhura ndaj gjykatave të Rretheve Gjyqësore.

Nga 374 ankesa të ardhura gjatë vitit 2006, ndaj Gjykatave të Rretheve Gjyqësore kanë qenë 296 ankesa.

Nga verifikimi i këtyre ankesave ka rezultuar se në pjesën më të madhe ankuesit nuk kanë patur të drejtë mbasi gjyqtarët e akuzuar për shkelje kanë bërë “kujdes” që nga ana ligjore të mos vërtetohet ndonjë shkelje e dispozitave ligjore.

Ja disa nga rastet e ankesave të ardhura ndaj Gjykatave të Rretheve Gjyqësore gjatë vitit 2006 dhe për të cilat ankuesit janë ndihmuar nga ana jonë:

1. Ankuesi S.Ç. nga rrethi i Durrësit është ankuar se djali i tij mbahet i arrestuar tej afateve ligjore.

Nga ana e jonë ankuesi u sqarua se djali i tij duhet ti drejtohet Gjykatës së rrethit Durrës, dhe të kërkojë prej saj shuarjen e masës së sigurimit me arrest në burg pa afat.

Nga verifikimi i kësaj ankese rezultoi se Gjykata e rrethit Durrës mbasi e ka shqyrtuar kërkesën e tij ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pa bazuar në ligj. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin Nr.27 dt.13.03.2006.

Ndaj këtyre dy vendimeve është ushtruar rekurs nga të gjykuarit në Gjykatën e Lartë. Nga ana tjetër duke patur parasysh se në rastin konkret kishim të bënim me shkeljen e të drejtave të njeriut nga ana e jonë ju kërkua Gjykatës së Lartë që të shikohej mundësia që të bëhej shpejtimi i gjykimit të kësaj çështje.

Gjykata e Lartë me vendimin e saj dt.09.06.2006 vendosi prishjen e vendimeve gjyqësore dhe konstatimin e humbjes së fuqisë së paraburgimit për të pandehurit R.Ç, A.P, A.K, L.K duke urdhëruar lirimin e tyre menjëherë nga burgu. Ndaj tyre u la si masë sigurimi ajo me arrest në shtëpi dhe personat e akuzuar gjykohen tashmë të lirë.

2. Ankuesi Sh.Xh. nga Tirana është ankuar ndaj Gjykatës rrethit Tiranë, për zvarritje pa shkaqe ligjore të gjykimit të një çështje civile kundra Degës së Sigurimeve Shoqërore Tiranë, me objekt saktësim dokumenti të librezës së punës.

Nga ana e jonë ju kërkuan shpjegime Gjykatës së rrethit Tiranë. Nga përgjigja e ardhur rezultonte se seancat gjyqësore ishin shtyrë se nuk paraqitej pa shkaqe ligjore ana e paditur.

Mbas ndërhyrjeve tona u arrit sigurimi i pjesmarrjes së anës së paditur dhe u bë e mundur përfundimi i gjykimit dhe pranimit të kërkesës së ankuesit.

3. Ankuesi D.D. nga rrethi i Tiranës është ankuar ndaj Gjykatës rrethit Tiranë, për zvarritje pa shkaqe ligjore të një çështje penale ndaj të gjykuarës E.D, e akuzuar për veprën penale të fallsifikimit të dokumentave zyrtare, por që gjykohej në mungesë.

Nga verifikimi ynë rezultoi se shtyerjet e seancave gjyqësore ishin bërë për thirrjen dhe pyetjen e dëshmtarëve të cilët ishin të domosdoshëm për sqarimin e rrethanave më të domosdoshme të çështjes.

Në përfundim si rezultat i ndërhyrjeve tona u arrit jo vetëm shpejtimi, por edhe përfundimi i këtij gjykimi.

4. Ankuesi B.G. nga rrethi i Vlorës është ankuar se megjithse është ankuar në Ministrinë e Drejtësisë ndaj Zyrës së Përmbarrimit Vlorë për mos ekzekutim të një vendimi gjyqësor, për një kohë të gjatë nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Nga verifikimi ynë rezultoi se për këtë problem kishte ngritur padi civile pala kundërshtarë në Gjykatën e rrethit Vlorë, e cila ka vendosur në favor të saj. Për këtë vendim gjyqësor nuk ka marrë dijeni sipas ligjit ankuesi i cili ndodhej jashtë shtetit në Greqi. Mbasi mori dijeni, ai filloi procedurat e ankimit në Gjykatën e Apelit.

5. Ankuesi B.Gj nga qyteti i Shkodrës është ankuar se është larguar nga puna padrejtësisht nga Ndërmarrja e Ujësjiellit Kopluk dhe për këtë ai ankohet ndaj Gjykatës së rrethit Shkodër, e cila zvarrit pa shkaqe ligjore gjykimin e kësaj çështje.

Nga verifikimi ynë rezultoi se Gjykata e rrethit Shkodër ka përfunduar gjykimin, por ankuesi nuk ka bërë kërkesë pranë saj për lëshimin e urdhër ekzekutimit me qëllim që vendimi gjyqësor të ekzekutohej nga Zyra e Përmbarrimit Shkodër, sipas procedurave ligjore.

6. Ankuesi A.B. nga Tirana ankohet ndaj Gjykatës rrethit Tiranë, e cila zvarrit pa shkaqe ligjore gjykimin e një çështje me objekt anulim të vendimit të pushimit të çështjes penale nga Prokuroria e rrethit Tiranë, me arsyetim se gjykata ka kërkuar t'i dërgohet për administrim dosja penale e cila është pezulluar dhe që ndodhet në Komisarjatin e Policisë Nr.2 Tiranë. Por kjo dosje nuk i dërgohet gjykatës.

Nga ana e jonë ju kërkuan shpjegime Gjykatës rrethit Tiranë, dhe nga ana tjetër u ndërhy në Prokurorinë e rrethit, e cila bëri të mundur sigurimin e kësaj dosje dhe dërgimin e saj gjykatës.

7. Ankuesi A.Ç. nga Elbasani ankohet se është gjykuar e dënuar me gjobë nga Gjykata e rrethit Elbasan, por duke qënë se ndodhet pa punë nuk ka lekë për të paguar gjobën.

Nga ana tjetër ai pretendon se ka dy vendimet gjyqësore të formës së prerë, ku shteti i detyrohet t'i paguaj atij shumën prej 700.000 lekë, prandaj ka kërkuar ndihmën tonë për zgjidhjen e kësaj çështje.

Nga ana e jonë mbasi u bënë verifikimet përkatëse u sqarua ankuesi për rrugën ligjore që ai duhet të ndjek për zgjidhjen e këtij problemi.

8. Ankuesi Z.N. nga Lezha është ankuar ndaj Gjykatës së rrethit Lezhë, e cila ndonëse ka gjykuar nipin e tij për veprën penale të moskallëzimit të krimit, dhe gjatë hetimeve paraprake i kishte bllokuar si provë materiale një telefon celular, gjykata në përfundim nuk ja ka kthyer atë sipas ligjit.

Nga verifikimi i kësaj ankese rezultoi se kërkesën për kthimin e provës materiale që i ishte bllokuar në gjykatë, nuk e kishte bërë personi i interesuar ose i autorizuar prej tij. Nga ana tjetër ju bënë sqarimet e nevojshme ligjore për të kërkuar nga Gjykata e rrethit Lezhë lëshimin e urdhër ekzekutimit dhe vënien e tij në ekzekutim në Zyrën e Përmbaramit Lezhë.

Po kështu ankuesi u sqarua se në rast se gjatë ekzekutimit të vendimit do të dalin probleme në lidhje me cilësinë e sendit të bllokuar, ai në bazë të kërkesave të nenit 601 të KPrC, mund t'i drejtohej me kërkesë padi Gjykatës së rrethit Lezhë për zgjidhjen e çështjes.

Në disa ankesa nga të afërmit ose familjarët e viktimave janë ankuar për veprime korruptive për gjyqtarë të veçantë si të gjykatave të rretheve ashtu edhe për ata të gjykatave të Apelit.

Nga ana e jonë, në zbatim të kërkesave të nenit 17/b të ligjit “Për Avokatin e Popullit” ankesat e bëra së bashku me dokumentat shoqëruese të tyre i janë dërguar për shqyrtim organit kompetent, Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Në përgjithësi në këto ankesa bëhet fjalë se gjyqtarë të veçantë gjatë kryerjes së detyrës së tyre janë treguar të njëanshëm dhe jo objektiv për raste konkrete, duke dhënë dënime të buta në saj të veprimeve të hapura korruptive.

Po kështu në disa raste të tjera ankuesit, duke qënë të mërzhitur nga tejzgjatja e proceseve gjyqësore nga njera shkallë e gjykimit tek tjetra nuk binden me përgjigjen e kthyer nga ana e jonë, sidomos me arsyetimin “se vendimet gjyqësore janë jashtë juridiksionit tonë”.

Ankuesit nga ana e tyre këmbëngulin se Avokati i Popullit duhet të bëjë patjetër vlerësimin e vendimeve gjyqësore mbasi sipas tyre ato janë hapur të padrejtë dhe të pa mbështetur në ligj. Ato paraqesin tek ne edhe dokumenta apo prova të tjera shkresore me të cilët këmbëngulin që ne të krijojnë bindje me çdo kusht se ato kanë të drejtë, por kjo e drejtë atyre nuk u jepet nga gjykatat, mbasi ato janë të korruptuara.

Në lidhje me ankesat e ardhura gjatë kësaj periudhe ne kemi bërë të gjitha sqarimet e nevojshme se për vendimet gjyqësore nuk mund të ndërhyhet nga ne derisa të bëhen ndryshimet përkatëse në Kodin e Proçedurës Penale, ashtu edhe në Kodin e Proçedurës Civile nga Kuvendi i Shqipërisë.

Në lidhje me problemet e zvarritjeve të gjykimeve të ndryshme për çështje penale për mendimin tonë del nevoja e shqyrtimit të disa dispozitave në Kodin e Proçedurës Penale, me synim shkurtimin e afateve si të hetimit ashtu edhe të gjykimit të çështjeve.

Në këtë përfundim arrihet sepse me afatet ekzistuese lihet shteg për abuzim nga punonjës të veçantë si në fazën e hetimit paraprak, ashtu edhe në fazën e gjykimit të proçedimeve penale.

Për mendimin tonë në lidhje me afatet e hetimit dhe të gjykimit ka vend që të bëhen studime dhe përgjithsime për të parë mundësinë e rishikimit të tyre, duke patur parasysh periudhën e gjatë të miratimit të Kodit të Proçedurës Penale (1995) dhe problemet që kanë dalë gjatë zbatimit të tij.

Edhe në drejtim të zvarritjeve në gjykimin e çështjeve civile mendojmë se duke u bazuar edhe në ankesat e ardhura në Institucionin e Avokatit të Popullit ku vendin kryesor të tyre e zënë zvarritjet pa shkaqe ligjore ka vend për t'u bërë rishikim dispozitave të Kodit të Proçedurës Civile.

Gjithashtu ka vend për të parë mundësinë e rritjes së gjykimeve civile me 1 gjyqtar për disa gjykime që sot shqyrtohen nga gjykata me 3 gjyqtarë. Për këtë duhet patur parasysh se gjyqtarë të një gjykate shpesh konsumohen në gjykimin e çështjeve, të cilat kthehen për rishikim disa herë dhe kështu kanë pengesa ligjore për gjykimin e tyre. Ky problem deri tani është zgjidhur duke u komanduar sipas rastit gjyqtarë nga Gjykatat e rretheve të tjera gjyqësore, me vendim të KLD-së.

b. Ankesat ndaj Gjykatës së Apelit

Gjatë vitit 2006 ndaj gjykatave të Apelit kanë ardhur gjithsej 48 ankesa. Vendin kryesor të këtyre ankesave e zënë ato me objekt kundërshtim vendimi gjyqësor për të cilët është vendosur refuzimi i tyre mbasi kanë qënë jashtë juridiksionit tonë.

Për 18 raste të tjera ankesat kanë patur si objekt shpejtimin e gjykimit, ose është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja jonë për uljen e masave të dënimit të dhëna nga Gjykatat e Shkallës së Parë, ose na janë kërkuar ndërhyrje për dhënie kopje vendimi për të ushtruar rekurs brenda afatit ligjor, mbasi ka përfunduar gjykimi dhe nga gjyqtarët nuk janë arsyetuar vendimet etj.

1. Shtetasi G.T. nga Tirana është ankuar ndaj Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila po zvarrit pa shkaqe ligjore gjykimin e një çështje civile me objekt zgjidhje martesë dhe lënien e fëmijës së mitur për rritje dhe edukim.

Në lidhje me këtë ankesë nga ana e jonë ju kërkuan shpjegime Gjykatës së Apelit Tiranë, për vonesën e gjykimit të kësaj çështje, duke vënë në dukje se paditësi nuk kishte bërë takimin me fëmijën e tij të mitur për 1 vit.

Duke arsyetuar shkaqet e parashtruara Gjykata e Apelit Tiranë, vendosi shpejtimin e këtij gjykimi duke e trajtuar si rast i veçantë dhe sepse zgjidhja e çështjes kishte lidhje me interesin më të lartë të fëmijës së mitur.

2. Shtetësja Sh.Z. nga Bulqiza është ankuar se djali i saj ndodhej në burg i dënuar nga Gjykata e rrethit Bulqizë për veprën penale të plagosjes së rëndë me dashje. Ajo duke mos patur të ardhura për të marrë avokat privat për mbrojtjen e tij në Gjykatën e Apelit Tiranë, ka kërkuar ndihmën e Avokatit të Popullit për ta përfaqësuar atë gjatë gjykimit në këtë gjykatë.

Nga ana e jonë u bënë sqarimet e nevojshme ligjore ankuesit dhe u ndërhy në Gjykatën e Apelit Tiranë, që atij t'i caktohej një avokat kryesisht, kërkesë e cila u konsiderua e drejtë nga gjykata dhe u realizua menjëherë, duke respektuar kështu parimet kushtetuese të mbrojtjes gjatë gjykimit.

3. Shtetasi F.Dervishi nga Tirana është ankuar ndaj Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila megjithse ka përfunduar gjykimin e një çështje civile atij nuk i jepej kopje e vendimit gjyqësor, me qëllim të ushtronte rekurs në Gjykatën e Lartë. Edhe në këtë rast me ndërhyrjen tonë u bë e mundur dhënia e kopjes së vendimit ankuesit.

4. Shtetasi E.R. nga Delvina është ankuar ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit të Gjykatës rrethit Sarandë.

Nga verifikimi ynë rezulton se ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila mbasi e ka shqyrtuar ka vendosur mospranimin e rekursit.

Nga ana e jonë u bënë sqarimet e nevojshme ligjore për rrugën që mund të ndjek ankuesi për zgjidhjen e problemit si me kërkesë për gjykim në Gjykatën Kushtetuese, në bazë të nenit 131 germa "f" të Kushtetutës, ashtu edhe me kërkesë për rishikim vendimi në Gjykatën e Lartë, në bazë të nenit 494 të Kodit Procedurës Civile, duke kërkuar për realizimin e këtyre të drejtave edhe ndihmën e një avokati privat.

c. Ankesat ndaj Gjykatës së Lartë

Dihet se Gjykata e Lartë nuk ka lidhje vartësie nga Ministria e Drejtësisë. Por ne i kemi radhitur ankesat në këtë kre, për shkak të problemeve që ngrenë shtetasit për këtë gjykatë që janë pothuaj të njëjllota me ato që ngrejnë ata edhe për gjykatat më të ulta.

Në vitin 2006 kundër Gjykatës së Lartë kanë ardhur gjithsej 30 ankesa. Nga këto, në 17 raste ankesat kanë qënë kundra vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Lartë. Nga ana e jonë janë bërë të gjitha sqarimet e nevojshme duke orjentuar ankuesit që në rast se ato kanë argumenta ligjore

se ndaj tyre gjykatat nuk kanë zhvilluar një proces të rregullt ligjor mund t'i drejtohen me kërkesë për gjykim Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 131 shkronja " f " të Kushtetutës.

Nga 13 ankesat e tjera, në 6 raste ato kanë qënë për shpejtim gjykimi, në 5 raste është kërkuar të shpejtohet kërkesa e tyre për rishikim vendimi, në 1 rast është kërkuar t'i jepet kopja e vendimit dhe në një rast tjetër është kërkuar që të bëhet ndreqje gabimi e vendimit të asaj gjykate.

Ja disa nga rastet e këtyre ankesave sipas objektit të tyre.

1. BSHPSH nga qyteti i Tiranë është ankuar se në Gjykatën e Lartë po shqyrtohet rekursi i tyre që ka lidhje me largimin e padrejtë nga puna të 80 punonjëseve të Parkut të Shërbimit Urban të Udhtarëve Tiranë. Çështja e tyre është prishur e kthyer për rigjykim disa herë si dhe është zvarritur pa shkaqe ligjore nga Gjykata e rrethit dhe Gjykata e Apelit. Kjo sindikatë ka kërkuar ndihmën dhe ndërhyrjen e Avokatit të Popullit si për pjesmarrje gjatë gjykimit të saj, ashtu edhe për shpejtimin e këtij gjykimi.

Nga verifikimi ynë rezultoi se kjo dosje ndodhet për shqyrtim në dhomën e këshillimit dhe ndjek radhën e gjykimit.

Po kështu ankuesi u sqarua se mbrojtja e kësaj çështje nuk mund të bëhet me pjesmarrjen e Avokatit të Popullit mbasi një veprim i tillë nuk parashikohet në ligj. Të drejtat dhe interesat e palëve në këtë gjykim mbrohen vetëm me avokat privat, ashtu siç është vepruar edhe në shkallët e tjera të gjykimit.

2. Shtetasi A.Gj, nga Tirana ankohet ndaj një vendimi gjyqësor të Gjykatës së Lartë, mbasi pas dhënies së tij, kanë dalë dokumenta dhe prova shkresore të reja, që hedhin poshtë themelin e vendimit të marrë prej saj.

Për këtë ankuesi ka kërkuar ndihmën dhe ndërhyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit, për të bërë rishikimin e këtij vendimi nga kjo gjykatë.

Në rastin konkret nga ana e jonë u bënë sqarimet e nevojshme ligjore duke orjentuar ankuesin që në bazë të nenit 494 të Kodit Procedurës Civile, të konsultohet me një avokat privat, i cili pregatit dokumentat e nevojshme dhe bën mbrotjen e tij në gjykatë, të drejta këto të cilat nuk i ka institucioni ynë.

3. Shtetasi Z.B.nga rrethi i Kukësit është ankuar ndaj Gjykatës së Lartë, e cila zvarrit pa shkaqe ligjore shqyrtimin e një kërkesë për rishikim vendimi të bërë nga djali i tij i cili pretendon se është gjykuar e dënuar padrejtësisht nga gjykatat Greke.

Për këtë problem ankuesi pretendon se është ankuar edhe në gjykatat e zakonshme dhe ato nuk e kanë zgjidhur problemin duke arsyetuar se për këtë

problem bëhet si pengesë ligjore një vendim unifikues i marrë nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Nga verifikimi ynë rezultoj se kërkesa e tij për rishikim vendimi ndodhej e rregjistruar në Gjykatën e Lartë, dhe se ajo ndjek rradhën e gjykimit.

4. Shtetasi P.B. nga Tirana është ankuar ndaj Gjykatës së Lartë e cila me vendimin Nr.311 dt.23.03.2006 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë së tij. Megjithse ka kërkuar që t'i jepet një kopje e vendimit gjyqësor, që të ankohet kundra tij në Gjykatën Kushtetuese, atij nuk i jepej vendimi.

Nga verifikimi ynë rezultoi se gjykimi është bërë në bazë të gjitha procedurave ligjore dhe kopja e vendimit gjyqësor ndodhej gati dhe mund ta merrte atë menjëherë sapo të paraqitej pranë administratës së asaj gjykate.

5. Shtetasi A.A. nga Tirana është ankuar ndaj një vendimi gjyqësor të Gjykatës së Lartë, duke pretenduar se ai është i gabuar dhe kërkon ndihmën dhe ndërhyrjen tonë për të bërë ndreqje gabimi në bazë të ligjës në Gjykatën e Lartë.

Nga verifikimi ynë rezultoi se Gjykata e Lartë ka marrë vendimin Nr.626 dt.21.09.2005 me të cilin ankuesi nuk është dakord.

Në rastin konkret nga ana e jonë ankuesi u sqarua se në rast se ai disponon argumenta se ndaj tij nuk është zhvilluar një proces i rregullt gjyqësor në bazë të nenit 131 shkronja "f" të Kushtetutës mund t'i drejtohet vet me kërkesë për gjykim Gjykatës Kushtetuese.

Për realizimin e kësaj të drejte ankuesi u sqarua se duhettë konsultohet paraprakisht me një avokat privat, i cili pregatit kërkesën dhe bën mbrojtjen e çështjes pranë Gjykatës Kushtetuese, veprime këto që në rastin konkret nuk mund të kryhen nga Institucioni ynë, mbasi nuk parashikohet nga ligji.

*
* *
*

Duke patur parasysh problemet që kanë dalë këtë vit për sigurinë e gjyqtarëve, kemi dërguar një rekomandim për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit Nr.9110 dt.24.07.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda" Rekomandimi i është drejtuar Kryeministrit, Ministrit të Drejtësisë dhe për dijëni Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Në nenin 10 të këtij ligji parashikohet se brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave, pasi të ketë marrë edhe mendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë duhet të nxjerrë aktet nënligjore të nevojshme lidhur me sigurimin dhe ruajtjen e posaçme të mjediseve të punës, ruajtjen e afërt fizike, mbrojtjen e familjes dhe atë pasurore si dhe të

masave të tjera që lidhen me mbrojtjen e posaçme të Gjykatave për krimet e rënda, të gjykatave të Apelit për krimet e rënda si dhe të gjyqtarëve të tyre.

Duke qënë se afati i parashikuar në ligj ka kaluar dhe nuk janë nxjerrë aktet nënligjore, nga ana e Avokatit të Popullit u dërgua Rekomandimi për nxjerrjen e tyre. Për këtë problem na është kthyer përgjigje nga Qeveria se Ministria e Drejtësisë po përgatit projektaktet, por deri tani ato nuk janë miratuar.

4. Ankesat për Prokurorinë

Sipas Kushtetutës sonë Prokuroria nuk bën pjesë në juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë, por për lehtësi studimi e kemi përfshirë pas saj.

Veprimtaria e punës së Avokatit të Popullit, në shqyrtimin e ankesave të shtetasve ndaj organit të Prokurorisë ka konsistuar në zbatimin korrekt dhe objektiv të Kushtetutës, ligjit që normon punën tonë dhe ligjit procedural penal.

Qëndrimi ynë është se, duke konstatuar shkeljet reale të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve që janë subjekte në procesin penal, si dhe duke bashkëpunuar me prokurorinë ato duhet t'i shërbejnë qëllimit të mirë për përmirësimin e punës së prokurorisë në drejtim të respektimit të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.

Për vitin 2006 në Institucionin tonë **380** shtetas të ndryshëm kanë paraqitur **197** ankesa apo kërkesa, të cilat kanë patur për objekt veprimtarinë e punës së organit të Prokurorisë. Mënyra e përfundimit të ankesave për vitin 2006 është: **68** ankesa janë zgjidhur në favor ose 33 përqind, **36** ankesa kanë qënë jashtë juridiksionit, **72** ankesa jashtë kompetence, **16** ankesa kanë qënë të pabazuara dhe për 1 ankesë ka hequr dorë ankuesi. Për vitin 2007 kanë kaluar për shqyrtim 4 ankesa. Gjatë vitit 2006 janë shqyrtuar dhe 5 ankesa të mbartura nga viti 2005, të cilat kanë përfunduar në këtë mënyrë: 3 ankesa janë zgjidhur në favor, 1 ankesë kanë qënë jashtë kompetence, dhe 1 ankesë ka qënë e pabazuar.

Për vitin 2006 **ka patur një numër të njëjtë me ankesat e shqyrtuara në vitin 2005**. Kjo sepse në ndryshimet e bëra me ligjin Nr.9398 datë 12.5.2005 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin Nr. 8454 datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, janë qartësuar edhe më shumë disa marrëdhënie të Avokatit të Popullit me Prokurorinë.

Edhe për vitin 2006 ankesat e shtetasve ndaj veprimtarisë së organit të Prokurorisë janë shqyrtuar me përparësi. Për ankesat që kanë qënë brënda

kompetencës sonë, Avokati i Popullit ka bërë vlerësimet e rastit dhe ka urdhëruar kryerjen e procesit të hetimit nëpërmjet realizimit të veprimeve të nevojshme si marrja e deklarimeve të shtetasve të ndryshëm, kqyrja e dokumentave, kryerja e ekspertimeve mjeko-ligjore ose teknike me specialistë të fushave përkatëse, apo duke studjuar dosje hetimore për të cilat Prokuroria kishte vendosur pushimin apo pezullimin e çështjes penale.

Për mjaft ankesa është shkuar në vëndbanimin e ankuesit ose kërkuesit, apo janë kryer veprimet në vënd, duke marrë dhe shpjegimet apo informacionin e nevojshëm në organin e Prokurorisë, ndaj të cilit shtetasi ka bërë ankimin. Pra, për vitin 2006 është bërë një vlerësim korrekt i ankesave e për rrjedhojë janë kryer hetime të gjithanëshme me ditë të tëra e me grup ekspertësh, duke ndjekur ecurinë e tyre në vazhdimësi deri në përfundimin e çështjeve penale nga organi i Prokurorisë.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur me precedencë dhe ankesat e shtetasve apo shoqatave që përfaqësojnë interesa të një grupi të caktuar personash të organizuar në sindikata, fondacione si nga Sindikata e Qëndrave të Prodhimit të Naftës e Gazit të Shqipërisë; Bashkësia e Sindikatave të Shqipërisë; Fondacioni “Dëshmitarët e Jehovahit”; shoqata e Romëve të Korçës etj.

Për vitin 2006 vihet re se, ankesa apo kërkesa në Institucionin e Avokatit të Popullit janë paraqitur dhe nga përfaqësues të disa fshatrave si Koblarë, Vërçisht etj në rrethin e Përmetit. Shqetësimi i tyre ka konsistuar në ruajtjen e pasurisë natyrore, pyllit që shtrihet në atë zonë, për shfrytëzimin pa kriter të tij dhe zvarritje të hetimit të çështjes së filluar nga Prokuroria, pas kallëzimit penal të bërë prej tyre.

E veçanta në ankesat, kërkesat apo njoftimet për vitin 2006, janë dhe ato të bëra nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Kosovë, kryesisht për raste të arrestimeve të shtetasave kosovarë për “kalime të paligjshme të kufiri” në Itali, nëpërmjet Portit të Durrësit me pasaportë të falsifikuar, apo për akuza të tjera. Kështu, pas shqetësimit e këtij Këshilli, ka qënë interesimi i Institucionit të Avokatit të Popullit për arrestimin e shtetasit kosovar B.M në muajin maj të vitit 2006 nga policia e Durrësit. Nga verifikimi i bërë në policinë dhe prokurorinë e rrethit Durrës rezultoi se, arrestimi i shtetasit B.M. ishte kryer për efekt ekstradimi, mbi bazën e një urdhëri për arrest ndërkombëtar të lëshuar nga autoritetet gjyqësore të UMNK-ut.

Shtetasit kosovarë kanë paraqitur dhe kërkesa apo ankesa individuale në Institucionin e Avokatit të Popullit. I tillë është rasti i shtetasit K.M. nga Prizreni i cili ka kërkuar njohjen me afatet e qëndrimit në paraburgim për babanë e tij shtetasin M.M, akuzuar për veprën penale të “Rrëmbimit ose

mbajtjes peng të personit”, parashikuar nga neni 109/1 e 25 të Kodit Penal, hetuar nga Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë. Ne kemi sqaruar kërkuesin duke dërguar në mënyrë të detajuar afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit të përcaktuara në nenin 263 të Kodit të Proçedurës Penale.

Avokati i Popullit ka ndjekur me shqetësim edhe rastet kur shtetasit shqiptarë me banim jashtë vëndit, kanë kërkuar ndërhyrjen e tij për shkelje të të drejtave të tyre nga autoritetet e atij vëndi. I tillë është rasti i shtetasit shqiptar S.H. i cili ka kërkuar ndërhyrjen për kryerje të ekspertimit mjekoligjor për dëmtimet e shkaktuara nga një aksident automobilistik të ndodhur në Selanik. Nga ana e jonë shtetasi është orientuar për kryerjen e aktit të ekspertimit pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore në Kretë, ekspertët e të cilit në takimin që kanë patur me Avokatin e Popullit kanë shfaqur predispozicionin e nevojshëm për dhënie ndihmë ligjore për këto raste.

A. Gjatë shqyrtimit të ankesave për vitin 2006, vihet re se objekti i tyre është i njëjtë me objektin e ankesave të paraqitura edhe gjatë vitit 2005. Në mënyrë të grupuar shtetasit ankohen ndaj Prokurorisë :

1. Për zvarritje në hetimin e çështjeve penale

Raste të tilla mund të përmëndim ankesën e shtetasve M.M. nga Tirana; Gj.G. nga Tirana; F.M. nga Tirana; A.M, dhe A.P. nga Shkodra; M.K nga Berati; L.B. nga Klosi i Burrelit; E.B. nga Përmeti etj.

- Në Institucionin e Avokatit të Popullit një numur i konsiderueshëm ankuesish nga rrethe të ndryshme të vëndit ngrenë shqetësimin për zvarritje në hetimin e çështjeve penale për krime të rënda si “vrasje”, “shfrytëzim të prostitucionit” etj. Kështu në ankesën e tyre shtetasit A.P, A.M dhe A.M. të arrestuar nga Prokuroria e rrethit gjyqësor Shkodër, e cila qysh në vitin 2001 ka filluar proçedimin penal për veprat penale të “Vjedhjes me pasojë vdekjen e një personi të kryer në bashkëpunim” dhe “Mbajtjes pa lejë të armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 141 e 25 dhe 278/2 të Kodit Penal. Pas pezullimit të hetimit organi i Prokurorisë në muajin dhjetor të vitit 2004 ka rifilluar hetimet të cilat kanë përfunduar në vitin 2006.

- Shtetasi M.M. nga Tirana ka paraqitur në Komisaratin e Policisë Nr.2 Tiranë, kallëzimin e tij penal lidhur me vdekjen në banesë të vëllait të tij të ndjerit L.T. pas operacionit të kryer nga mjekët e spitalit “Nënë Tereza”, P.R etj. Nga ana e atij Komisarati më datën 10.02.2006 janë dërguar materialet kallëzuese në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë, e cila nga ana e saj ka filluar proçedimin penal Nr. 634 për veprën penale të “Mjekimit të Pakujdesshëm”, parashikuar nga neni 96 të Kodit Penal.

Janë kryer disa veprime hetimore, si janë marrë deklarime ankuesit,

pra vëllait të viktimës, deklarime të mjekëve dhe mandej me vonesë është përpiluar dhe vendimi për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor në Institutin e Mjekësisë Ligjore Tiranë. Pas marrjes së aktit të ekspertimit mjeko-ligjor të kryer nga grup ekspertësh më datën 14.11.2006, është vendosur pushimi i çështjes penale.

- Në ankesën e saj shtetësja F.M. nga Tirana, ish banuese në rrethin e Matit, ka ngritur shqetësimin për zvarritje në hetimin e proçedimit penal që bën fjalë për vrasjen e djalit të saj të ndjerit G.M, ngjarje e ndodhur në muajin gusht të vitit 2004, për të cilën Prokuroria e rrethit gjyqësor Mat ka filluar proçedimin penal dhe mandej pas shpalljes së moskompetencës e ka dërguar për hetime të mëtejshme Prokurorisë së rrethit gjyqësor Dibër. Kjo e fundit më datën 20.03.2005 ka filluar proçedimin penal Nr. 45, për veprën penale të “vrasjes me paramendim” të kryer në bashkëpunim, “plagosjes së rëndë me dashje” dhe “mbajtjes pa lejë të armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 78/2 e 25, 88/1 e 278/2 të Kodit Penal në ngarkim të tre të pandehurëve në mungesë dhe, përfundimisht vetëm më datën 28.06.2006 ka dërguar çështjen në gjyq.

- Në ankesën e tyre shtetasit E.B, L.M, N.K etj, përfaqësues të fshatrave Verçisht, Koblarë dhe Gostomickë në rrethin e Përmetit, kanë ngritur shqetësimin për zvarritje në hetimin e proçedimit penal filluar nga Prokuroria e rrethit gjyqësor Përmet, mbi kallëzimin e tyre për veprën penale të “shkatërrimit të pronës” pyllit. Organi i Prokurorisë më datën 24.05.2006 ka filluar proçedimin penal Nr. 30 në ngarkim të shtetasit P.T. për veprën penale të parashikuar nga neni 150 të Kodit Penal, për të cilën ka marrë zgjatje afati dhe përfundimisht më datën 20.11.2006, ka pushuar çështjen penale.

Nga studimi dhe analiza e rasteve kur hetimet e proçedimeve penale janë zvarritur në mënyrë të pajustificuar nga organi i Prokurorisë konstatohet se zvarritjet e tejzgjatura në hetimin e çështjeve penale shpesh nuk kanë qënë justifikuese. Zvarritjet flasin sa për mosplanifikim në kryerjen e veprimeve hetimore të gjithanëshme dhe në vazhdimësi, ashtu dhe për moskontroll të prokurorit që ndjek hetimin ndaj oficerëve të policisë gjyqësore. Shpesh, zvarritjet e hetimeve të proçedimeve penale kanë patur si shkak transferimin e çështjeve penale nga një rreth tek tjetri duke shpallur moskompetencën gjatë hetimeve paraprake, kërkesë kjo e parashikuar nga neni 84 i Kodit të Proçedurës Penale. Ankesat e shtetasve për zvarritje në hetimin e çështjeve penale kanë qënë dhe ndaj Prokurorisë për Krime të Rënda. I tillë është rasti i ankesës së shtetasit L.T. nga Tirana; SH.A. nga Kruja etj.

Mendojmë se më tepër duhet të vlerësohet momenti i rregjistrimit të veprës

penale në rregjistrin penal që disponon organi i Prokurorisë, pra duke pasqyruar në të me vërtetësi dhe emrin e personit që i atribuohet vepra penale, mbasi nga ky moment fillon afati i hetimit të çështjes penale, parashikuar nga neni 287/1 e Kodit të Proçedurës Penale.

Nuk duhet të abuzohet në këtë drejtim duke zgatur hetimin e çështjes me justifikimin se vepra penale është pa autor. Kjo për faktin se në kallëzimin e tyre drejtuar Prokurorisë, shtetasit tregojnë dhe për autorin e veprës penale.

2. Për moskryerje të hetimeve të gjithanëshme dhe objektive

Të tilla janë rastet e ankesave të shtetasve të shtetasve I.XH dhe E.P nga Tirana; M.S. nga Laçi; B.A. nga Korça; P.N. nga Shkodra; L.S. nga Librazhdi; SH.A. nga Prrenjasi i Librazhdit etj.

Më konkretisht ankesat e tyre kanë konsistuar në mosvënien para përgjegjësisë ligjore të autorit dhe bashkëpunorëve në kryerjen e krimit, në mosnjoftimin e akuzave për të gjitha veprat e kryera nga të pandehurit, në mosnxjerrjen e motiveve që kanë shtyrë autorët në kryerjen e veprës penale, në ndryshimin e kualifikimit të veprës nga një vepër më e rëndë në veprën më të lehtë në ngarkim të pandehurit, në moskryerjen e ekspertimeve të ndryshme mjeko-ligjore apo tekniko-grafike të nënshkrimit etj. Për rrjedhojë moskryerja e hetimeve të gjithanëshme në disa raste, ka sjellë për pasojë dhe pezullimin e hetimit apo pushimin e çështjes penale.

- Kështu, mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit I.XH më datën 08.05.2006, Prokuroria e rrethit gjyqësor Kurbin ka filluar proçedimin penal për veprën penale të “vrasjes me dashje” mbetur në tentativë. Kjo lidhet me ngjarjen e ndodhur më datën 03.05.2006, ndërsa shtetasi ndodhej tek një karburant në Fushë-Mamuras dhe aty, disa persona kanë kryer veprime të dhunshme me qëllim vrasjen e tij. I dëmtuari nga vepra penale gjatë hetimit jo vetëm ka sqaruar në mënyrë të hollësishme ngjarjen, por dhe ka dhënë emra konkrete të personave organizatorë në kryerjen e krimit. Por megjithatë ende nuk ishin kryer veprimet e nevojshme me qëllim vënien para përgjegjësisë ligjore të autorëve të veprës penale.

- Në ankesën e tij shtetasi B.A. nga Korça ankohet për Prokurorinë e atij rrethi, e cila jo vetëm nuk ka kryer hetime të plota e të gjithanëshme lidhur me vrasjen e vëllait të tij, të ndjerit F.A, por në përfundim e ka pushuar atë në mënyrë të padrejtë. Shqetësimi i ankuesit lidhet me ngjarjen e datës 22.07.2003 ndodhur në rrugën automobilistike Libonik – Drithas, ku vëllai i tij që drejtonte mjetin ka pësuar aksident me pasojë vdekjen, ndërsa në makinë me të ishte vetëm një pasagjer e konkretisht shtetasi R.Ç. ish agjent i policisë kriminale, për të cilën ankuesi ka patur dyshime si autor të

vrasjes së vëllait të tij. Prokuroria ka vendosur mosfillimin e proçedimit penal. Pas ankesës së familjarëve Prokuroria e Përgjithshme ka shfuqizuar vendimin e mosfillimit të proçedimit penal, dhe fillimin e proçedimit penal për veprën penale të “vrasjes me dashje”, parashikuar nga neni 76 e Kodit Penal. Prokuroria në përfundim ka vendosur pushimin e këtij proçedimi me arësyetimin se vdekja e shtetasit F.A. ka ardhur si rezultat i shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor.

- Në ankesën e tij shtetasi L.S. nga Librazhdi paraqet shqetësimin për moskryerje të hetimeve të gjithanëshme nga Prokuroria e atij rrethi, në proçedimin penal të “Mjekimit të Pakujdesshëm” ndaj mjekut A.L. dhe farmacistit P.S. të cilët jo vetëm nuk kanë përcaktuar në mënyrë të qartë diagnozën, por dhe i kanë dhënë medikamente të gabuara duke sjellë për pasojë dëmtimin e shëndetit të tij. Nga verifikimet e kryera u konstatua se organi i Prokurorisë ishte mjaftuar vetëm me marrjen e deklarimeve të mjekëve, administrimit të atyre pak dokumenteve që ekzistonin në spital, por pa u kryer ekspertimi mjeko-ligjor për këtë qëllim. Në përfundim ka pushuar çështjen penale për arsye se ishte parashkruar afati i ndjekjes penale.

- Rast tjetër është dhe ankesa e shtetasës F.T. nga Prrenjasi i Librazhdit, e cila është ankuar ndaj Prokurorisë për moskryerje të hetimeve të gjithanëshme me qëllim vënien para përgjegjësisë ligjore të të gjithë pjesëmarrësve autorë të vrasjes së djalit të saj E.T, ngjarje e ndodhur në muajin gusht të vitit 2005.

3. Për mosvënie në lëvizje apo mosvlerësim të kallëzimit të shtetasve

Të tilla janë rastet e ankesës të shtetasit A.M. nga Vlora, për mosfillim të proçedimit penal lidhur me vdekjen e njeriut të të tij të afërm G.J.S. në spitalin neuropsihiatrik të atij qyteti, ndodhur më datën 02.06.2006. Ankuesi R.A. nga Tirana, i cili është ankuar për mosmarrje të kallëzimit penal për ushtrim dhune nga policia e rrethit të Korçës, ndërsa do të shkonte si refugjat në Greqi, nëpërmjet kufirit shtetëror në zonën e Devollit. Shtetasi R.A. u sqarua se në bazë të nenit 283 të Kodit të Proçedurës Penale mund të paraqiste kallëzimin pranë Prokurorisë së rrethit gjyqësor Korçë. Ankesa e shtetasit N.H. nga Memaliaj e Tepelenës për kallëzimin e tij penal për kontroll dyqani e banese nga ana e punonjësve të policisë etj.

Në praktikën e punës të organit të Prokurorisë vihen re raste kur personat e marrë në përgjegjësi penale, ndaj të cilëve është ushtruar dhunë fizike nga punonjësit e policisë, kanë paraqitur kallëzim penal para punonjësit të Prokurorisë. Kallëzimi jo vetëm nuk është marrë, por dhe nuk

është bërë vlerësimi i nevojshëm. Është detyra e Prokurorit që, mbi pretendimin e ankuesit (të pandehurit) apo konstatimet e tij kur dëmtimet janë të dukshme, të marrë kallëzimin duke e vlerësuar atë dhe menjëherë të përpilojë vendimin për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor.

4. Për mosnjoftim apo njoftim me vonesë për mënyrën e zgjidhjes së kallëzimit apo përfundimit të çështjes penale, si p.sh ankesat e shtetasve M.D. e S.SH nga Tirana; M.I. nga Tirana; S.P. nga Pogradeci; H.R. nga Burreli; M.N. nga Kurbini etj.

- Kështu, shtetaset M.D dhe S.SH, nga Tirana kanë paraqitur kallëzim penal në Prokurori për veprën penale të “falsifikimit të dokumentave” ndaj vëllezërve të tyre shtetasve H.K etj. Pas kryerjes së hetimeve organi i Prokurorisë ka dërguar në gjyq noterin G.SH, ndërsa për të kallëzuarit ka vendosur pushimin e çështjes. Ankueset gjithashtu kanë bërë kallëzim penal dhe për një notere tjetër L.T, për të cilën Prokuroria ka vendosur pushimin e çështjes. Por ankueset nuk kanë patur dijeni mbi mënyrën e zgjidhjes së kallëzimeve të tyre drejtuar Prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë. Nga ana e jonë ankueset janë sqaruar për të drejtën e ankimit në Gjykatë ndaj vendimit të pushimit, në rast se ata e çmonin të arsyeshme.

- Rast i dukshëm është ankesa e shtetases P.G. nga Tropoja, e cila duke qënë kujdestare e bashkëshortit të saj A.G. ka paraqitur kallëzim penal për veprat penale të “vjedhjes së pasurisë” dhe “ mashtrimit” ndaj punonjësve të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës, për përfitimet e padrejta të pensionit të tij si invalid i grupit të dytë prej vitit 1988.

Pas kalimit të akteve nga Prokuroria e rrethit gjyqësor Kukës në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Tropojë, ankuesja nuk është vënë në dijeni lidhur me mënyrën e zgjidhjes së kallëzimit të saj. Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe verifikimeve të kryera, ankuesja u sqarua lidhur me faktin se Prokuroria ka filluar procedimin penal dhe aktualisht ajo është duke kryer veprimet e nevojshme hetimore si, ekspertimin grafik të shkrimeve tek borderotë etj.

- Shtetësja S.P. nga Pogradeci ka paraqitur pranë Prokurorisë materialet e kallëzimit penal për veprën penale të “falsifikimit të dokumenteve”, por ato kanë qënë fotokopje. Në këto rrethana nga ana e Prokurorisë është sqaruar se, në atë organ duhet të paraqiten dokumenta origjinale, sepse mbi ato dokumenta do të kryhej ekspertimi grafik i shkrimit. Nga ai moment shtetësja S.P. nuk është paraqitur në Prokurori. Pas ankesës drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit e kemi sqaruar se në Prokurori ajo duhet të paraqeste materialin kallëzues me dokumente origjinale.

- Në ankesën e tij shtetasi M.N. nga Kurbini është ankuar ndaj Prokurorisë së atij rrethit për arësye se, nuk ka vënë në lëvizje kallëzimin penal për “kryerje të veprimeve arbitrare” nga ana e punonjësit të policisë Z.M. në dëm të djemve të tij M.N. dhe N.N.

5. Për bllokime apo sekuestrime të sendeve prove materiale, për mosdhënie të tyre gjatë fazës së hetimit apo për dhënie të tyre me vonesa

- E tillë është ankesa e shtetasit Z.N. nga Lezha, i cili ka ngritur shqetësimin dhe ankohet ndaj Prokurorisë së rrethit gjyqsësor Lezhë, për arësye se gjatë hetimit të procedimit penal në ngarkim të djalit të tij N.N e L.L akuzuar për veprat penale të “mbajtjes pa lejë të armëve luftarake” dhe “moskallëzim krimi”, parashikuar nga nenet 278/2 dhe 300 të Kodit Penal, ka sekuestruar dy aparate telefoni celular. Edhe pse është insistuar në kërkesën e tij për kthimin e sendeve prova materiale gjatë fazës së hetimit paraprak, Prokuroria ka dërguar çështjen në gjyq duke lënë Gjykatën të bëjë dorëzimin e tyre, personave të interesuar.

Një veprim i tillë mund të bëhej dhe nga Prokuroria gjatë hetimit të çështjes. Kjo për faktin se për rastin konkret nuk dëmtohej zgjidhja e çështjes. Kjo kërkesë përcaktohet në mënyrë të qartë në Pikën 2 të nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale, ku thuhet shprehimisht se, “Provat materiale mund t’u kthehen personave që u përkasin edhe para mbarimit të procedimit, kur nuk dëmtohet zgjidhja e çështjes”.

6. Për akuzë të padrejtë apo rëndim të akuzavë në ngarkim, në momentin e marrjes në përgjegjësi penale

- Rastet që ankuesit janë drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit për akuzë të padrejtë të ngritur nga organi i Prokurorisë kanë qënë kryesisht kur të pandehurit kanë marrë pafajësi nga Gjykata e Faktit. Por mandej pas ankimit të këtyre vendimeve nga Prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe prishjes së atyre vendimeve, vendimi për fajësinë e tyre ka marrë formë të prerë nga Gjykatat e Apelit. Të tilla janë rastet e ankesave të shtetasit E.N. nga Lezha dhe A.RR. nga Korça, të cilët janë sqaruar për rrugët e tjera gjyqësore që mund të ndjekin ndaj vendimit penal që ka marrë formë të prerë, siç është “kërkesa për rishikimin e vendimit penal që ka marrë formë të prerë”, drejtuar Gjykatës së Lartë, parashikuar në nenet 449 e vijim të Kodit të Procedurës Penale.

- Në ankesën e tij shtetasi G.H. nga Tirana është ankuar ndaj

Prokurorisë për akuzë të padrejtë për veprën penale të “Shkatërrimit të pronës”, parashikuar nga neni 150 e Kodit Penal. Hetimi i kryer sqaroi se ankuesi kishte të drejtë. Në këto rrethana Prokuroria ka vendosur ndryshimin e kualifikimit të veprës penale duke e akuzuar përfundimisht të pandehurin për veprën penale të “vetgjqësisë”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal. Pas dërgimit të çështjes në gjyq Gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë e ka dënuar të pandehurin me gjobë.

Rast tjetër është ankesa e shtetasës N.T. po nga Tirana, e cila është ankuar ndaj organit të Prokurorisë për akuzë të padrejtë në ngarkim të djalit të saj F.T. Kështu nga verifikimi i kryer rezultoi se shtetasi F.T. ishte akuzuar nga Prokuroria për veprën penale të “vrasjes me paramendim”, mbetur në tentativë dhe “mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 78 e 22 dhe 278/2 të Kodit Penal. Pas përfundimit të hetimit dhe dërgimit të çështjes në gjyq, Prokuroria kërkoi deklarinim fajtor të pandehurit dhe dënimin e tij me 10 vjet burgim. Ndërsa Gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë, ndryshoi kualifikimin e veprës duke e akuzuar atë për veprën penale të “plagosjes së lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 vjet burgim.

Gjatë shqyrtimit të disa ankesave është konstatuar se, organi i Prokurorisë ka vepruar në mënyrë të nxituar dhe të pabazuar në verifikimin e ngjarjes me të gjithë elementët që përbëjnë veprën penale apo duke mosvlerësuar të dhënat e paraqitura me qëllim fillimin e hetimit të proçedimit penal. Të tilla janë rastet e njoftimeve të shtetasve M.B. etj nga Kukësi të cilët ankohen ndaj Prokurorisë së rrethit gjyqësor Kukës për mosfillimin e proçedimit penal ndaj drejtorit të Albtelekomit për veprën penale të “vjedhjes duke shpërdoruar detyrën”; njoftimi i shtetasit F.K. nga Tirana për mosfillim proçedimi penal nga ana e Prokurorisë së atij rrethi etj. Pas studimit të ankesave është konstatuar se ato janë drejtuar në Institucionin tonë menjëherë pas marrjes së vendimit nga Prokuroria. Kështu nga ana e jonë ankuesit janë sqaruar për ndjekjen e rrugës ligjore, për të kundërshtuar vendimin në gjykatë, e drejtë kjo e përcaktuar në nenin 291/2 të Kodit të Proçedurës Penale.

7. Për shkelje proçeduriale në kryerjen e veprimeve hetimore

Të tilla janë ankesat e shtetasve H.N dhe I.GJ. nga Tirana; SH.H. nga Shkodra; M.K. dhe B.D nga Durrësi etj.

Këto shkelje kanë konsistuar në thirrjen e shtetasve për marrjen e deklarimeve në cilësinë e personit që ka dijeni për rrethana të hetimit apo si person ndaj të cilit zhvillohen hetimet, në kundërshtim me rregullat e

përcaktuara në nenin 132 të Kodit të Proçedurës Penale që bën fjalë për “Njoftimet”.

- I tillë është rasti i ankesës së shtetasit B.D. nga Durrësi, nxënës në vitin e tretë të shkollës së mesme. Nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore ai është marrë nga shkolla për t’u pyetur, ndërsa ishte në mësim. Mandej në kundërshtim me rregullat proçeduriale shtetasit B.D. i janë marrë deklarime pa praninë e prindit apo psikologut duke i sugjeruar atë çka kërkohet prej tyre dhe nën një presion psikologjik. Duke siguruar deklarin e tij për një ngjarje të ndodhur në lokalin ku ankuesi punonte si kamarjer, oficerët e policisë gjyqësore kanë njoftuar prokurorin e çështjes me qëllim për të realizuar sigurimin e provës. Gjatë hetimit të kryer duke gjetur se ankesa e shtetasit B.D. ishte e drejtë, arritëm në përfundimin se, vetëm duke zbatuar me korrektësi dispozitat proçeduriale në rastin konkret për të miturit, duke filluar nga thirrja, krijimi i kushteve komode, marrja e deklarimeve në prani të një specialisti të fushës së edukimit të fëmijve, konsolidohet dëshmia e marrë gjatë hetimit, sigurohet prova para gjykatës e për rrjedhojë deklarinet e tij jepen me vullnet të lirë në seancë gjyqësore.

Për këto shkelje i kemi rekomanduar Prokurorisë së rrethit gjyqësor Durrës marrjen e masave disiplinore ndaj oficerëve të policisë gjyqësore, rekomandim, i cili jo vetëm që u mirëprit, por dhe u punua me gjithë punonjësit e Prokurorisë.

- Në të njëjtën mënyrë dhe për të njëjtën çështje penale policia gjyqësore ka vepruar me shkelje dhe ndaj shtetasit M.K. me profesion jurist, i cili është thirrur për të dhënë deklarime për ngjarjen ndërsa ishte duke pirë kafe në një lokal të qytetit të Durrësit. Pikërisht thirrja në kundërshtim me rregullat proçeduriale dhe mandej trajtimi i tij si një person i shoqëruar në polici, patën si përfundim mosmarrjen e deklarimeve të dëshiruara, mbasi shtetasi M.K. i sqaroi se nuk kishte dijeni për ngjarjen e ndodhur.

- Rast tjetër është dhe ankesa e shtetasit H.N. me profesion avokat, i cili është ankuar ndaj Prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë, pasi pa kryer verifikimet e nevojshme lidhur me dijeninë për paraqitjen e tij në atë organ, ka dërguar grupin e gatshëm të policisë. Ata e kanë marrë shtetasin H.N. në mjetin e tyre, duke e çuar fillimisht në mjediset e Komisariatit të Policisë dhe mandej në Prokurori. Nga ana e Prokurorisë shtetasi H.N. është pyetur në cilësinë e “personit ndaj të cilit zhvillohen hetime”. Megjithatë ndaj tij nuk janë zbatuar me korrektësi rregullat proçeduriale të parashikuara në nenin 296 të Kodit të Proçedurës Penale që bën fjalë për “Ftesën për paraqitje”, akt i cili përdoret për personat ndaj të cilit zhvillohen hetime. Për këto shkelje dhe mungesën e seriozitetit në kryerjen korrekte të njoftimit, kemi rekomanduar marrjen e masave disiplinore ndaj oficerëve të policisë

gjqësore, i cili është pranuar nga Prokuroria e rrethit gjyqësor Tiranë.

Në ankesën e tij shtetasi SH.H. nga Shkodra (i paraburgosur në Burgun e Shënkollit Lezhë), ka ngritur shqetësimin dhe është ankuar ndaj Prokurorisë së atij rrethi për arsye se, në procedimin penal në ngarkim të tij, akuzuar për veprën penale të “vrasjes me paramendim”, kryer në bashkëpunim me persona të tjerë jashtë vendit, vendimet për zgjatjen e afatit të hetimit nga organi i Prokurorisë i janë dërguar me postë dhe ai ka marrë dijeni për to me shumë vonesë.

8. Për ekzekutim të padrejtë të vendimit penal apo për vonesa në kryerjen e ekzekutimeve të vendimeve penale që kanë marrë formë të prerë

I tillë është rasti i ankesës së shtetasit G.D nga Tirana, i cili është ankuar ndaj Prokurorisë të rrethit gjyqësor Tiranë për arsye se, ka ekzekutuar padrejtësisht vendimin e dënimit me burgim për vëllanë e tij E.D. ndonëse kishin kaluar 5 vjet nga dënimi i tij. Për rrjedhojë ishte parashkruar afati i ekzekutimit të dënimit, përcaktuar në nenin 68 të Kodit Penal.

- Ndërsa shtetësja M.G. nga Berati ankohet ndaj Prokurorisë së atij rrethi për arsye se, nuk ka marrë masat e nevojshme për ekzekutimin e vendimit me burgim ndaj autorëve të vrasjes së vëllait të saj F.G, ngjarje e ndodhur në vitin 1999.

B. Gjatë vitit 2006 në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë paraqitur ankesa shtetas nga rrethe të ndryshme të vendit për moszbulimin dhe vënien para përgjegjësisë penale të autorëve të vrasjeve të fëmijëve apo të afërmëve të tyre, ngjarje të ndodhura kryesisht gjatë vitit 1997. Të tilla janë rastet e ankesave të shtetasve M.M. nga Tepelena për vrasjen e djalit të tij R.M. ndodhur më datën 31.07.1997; Shtetasi B.B. nga Peqini për vrasjen e vajzës së tij M.B. më datën 10.07.1997; Shtetasi Sh.K. nga Korça për vrasjen e bashkëshortit H.K. në muajin qershor 1997; Shtetasi A.K. nga Tirana për vrasjen e vëllait K.K. në vitin 1997 etj.

-Për vitin 2006 janë marrë në shqyrtim dhe një numur ankesash të shtetasve për vepra penale, sidomos për vrasje të ndodhura pas vitit 2000, por që nga ana e Prokurorisë është vendosur pezullimi i hetimit për moszbulim të autorit. Të tilla janë rastet e ankesave të shtetasve S.B. nga Sheqi i Fierit për vrasjen e nipit të tij Sh.B., ngjarje e ndodhur në Angli në muajin qershor të vitit 2000; Ankesa e shtetasit M.G. nga Tirana për vrasjen e vëllait të tij P.G. ndodhur po në vitin 2000; Ankesa e shtetasës A.A. nga Tropoja për vrasjen e vëllezërve të saj dhe të afërmëve të familjes duke

filluar nga viti 1997 e në vazhdim; Ankesa e shtetasit S.Y. nga Fieri për plagosje të rëndë, shkaktuar në muajin nëntor të vitit 2004 etj.

Konstatohet se për këto çështje të cilat fillojnë mbi bazën e ngjarjes dhe që jo vetëm janë me rrezikshmëri të madhe shoqërore, por dhe që trondisin komunitetin e më gjërë, ndonëse janë kryer veprimet e para hetimore të domosdoshme, nuk është predispozicioni i duhur për kryerjen e veprimeve të gjithanshme për zbulimin e autorit të veprës penale, si dhe mungon bashkëpunimi mes prokurorisë e policisë kriminale. Për rrjedhojë, shpesh hetimet pezullohen dhe materialet e çështjes i dërgohen policisë kriminale. Atje shpesh nuk ka asnjë impenjim për bashkëpunim për ndjekjen në vazhdimësi të çështjes dhe analizën e tyre të herëpashershme. Në këto kushte ato mbeten pa veprime nga policia kriminale.

Nga ana e jonë për një pjesë të mirë të këtyre rasteve është bërë verifikimi në vënd, duke u marrë kontakt si me drejtues të Prokurorisë, ashtu dhe të policisë kriminale. Nga studimi i materialeve vihet re se, pas pezullimit të hetimit të procedimit penal, nuk kryhen veprimet e mëtejshme nga policia kriminale si dhe nuk bëhen analizat përkatëse me organin e Prokurorisë. Në takimet e kryera keni orientuar dhe insistuar në kryerjen e shpejtë të veprimeve dhe ndjekjen në vazhdimësi të çështjeve të pezulluara.

-Gjatë shqyrtimit të ankesave apo kërkesave të shtetasve për vitin 2006 konstatohen raste kur, prej tyre kërkohet konsulencë juridike për mënyrën e veprimit të mëtejshëm për problemin që ata i shqetëson. Të tilla janë rastet e shtetasit M.S. nga Elbasani i cili është dëmtuar rëndë në shëndetin e tij nga vepra penale e “shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” dhe nuk ka marrë shpërblim për dëmin e shkaktuar; Shtetasi D.B. i cili ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë për veprën penale të “falsifikimit të dokumenteve” ndaj ish bashkëshortes së tij dhe me të drejtë e pandehura është dërguar në gjyq. Ndërsa shqetësimi i ankuesit dhe kërkesa e tij drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit ka qënë dhe zgjidhja e problemit të takimit më fëmijët e tij të cilët mbaheshin në mënyrë të padrejtë nga ish bashkëshortja. Në këto rrethana ankuesin e kemi sqaruar se, vepra penale e “Marrjes së padrejtë të fëmijëve” që parashikohet si kundravajtje penale nga neni 127 e Kodit Penal është nga ato vepra penale që përcaktohen tek neni 59 i Kodit të Procedurës Penale “I dëmtuari akuzues”. Në këto rrethana ai gëzon të drejtën për të paraqitur kërkesë në gjykatë duke marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të marrë shpërblimin e dëmit; Ankesa e shtetasës V.B. nga Tirana e cila ishte e dëmtuar nga vepra penale e “mashtimit” prej të akuzuarës J.I. ku kjo e fundit ishte dënuar nga gjykata për atë vepër penale. Shqetësimi i ankueses konsistonte në faktin se ajo nuk kishte ngritur padi

civile gjatë procesit penal, fakt të cilin nuk e dinte, por dhe që nuk ishte bërë me dije nga ana e organit të Prokurorisë. Shtetësja V.B. u orientua për të drejtën ligjore të përcaktuar në nenin 61 të Kodit të Proçedurës Penale, për t'ju drejtuar gjykatës me anë të kërkesë padisë civile me objekt “kthimin e shumës së lekëve”, duke ju referuar dhe dispozitave përkatëse të përcaktuara në nenet 640 e në vijim të Kodit Civil të Republikës të Shqipërisë. Të njëjtin shqetësim kanë ngritur në Institucionin tonë dhe shtetasit M.T dhe P.S. nga Tirana.

Në këto raste nga ana e jonë shtetasit janë sqaruar sipas rastit, për të drejtën e parashikuar në nenin 283 të Kodit të Proçedurës Penale me qëllim bërjen e kallëzimit penal tek oficeri i policisë gjyqësore apo prokurori, plotësimin e materialeve të kallëzimit sipas kërkesave të parashikuara në ligj, paraqitjen në prokurori të dokumenteve origjinale, të drejtën për rishikimin e vendimit penal që ka marrë formë të prerë dhe dërgimin e saj pranë Gjykatës së Lartë duke respektuar kërkesat e neneve 449-453 të Kodit të Proçedurës Penale, duke dërguar dhe fotokopje të neneve respektive që bëjnë fjalë për këtë institut, dërgimin e formularit me dokumentet e nevojshme për faljen që bën Presidenti i Republikës etj, për dokumentet dhe proçedurat që duhet të ndjekin për rastet kur ankesa i drejtohet Gjykatës së Strasburgut etj.

- Avokati i Popullit ka vlerësuar dhe ndjekur me përparësi dhe rastet e ankesave të shtetasve që kanë pësuar dëmtime fizike apo të shëndetit mendor nga veprime ose mosveprime të punonjësve të policisë, apo mjekët kurues për kohën që ata kanë qënë të arrestuar. Në këto raste jo vetëm janë administruar dokumentat shkresore siç janë kartelat mjekësore etj, por dhe është përpiluar vendimi për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor, i cili është dërguar Institutit të Mjekësisë Ligjore. Tek ekspertët e këtij Instituti kemi gjetur predipozicionin e nevojshëm për realizimin e aktit mjeko-ligjor dhe sjelljen e tij në Institucionin tonë brënda afateve të kërkuara. Të tilla janë rastet e shtetasve B.L. nga Tirana dhe E.B. nga Durrësi.

-Ka edhe ankesa kur shtetasit ngrenë shqetësimin për masë të ulët dënimi për autorët e veprave penale ku ata ose pjestarë të familjes janë të dëmtuar, si p.sh. ankesa e shtetasit M.K. ndaj Prokurorisë së rrethit gjyqësor Elbasan për masë dënimi me gjobë kërkuar nga Prokuroria, ndaj mjekëve të akuzuar për veprën penale të “Mjekimit të Pakujdesshëm” me të dëmtuar ish bashkëshorten e tij; Ankesa e shtetasit P.C. nga Mirdita, për masë dënimi të ulët kërkuar nga Prokuroria Tiranë ndaj të pandehurve Gj.R dhe V.Ç. punonjës policie, akuzuar për veprat penale të “Kryerje të veprimeve arbitrare” dhe “Shkelje të rregullave të shërbimit të rojes” me pasojë vdekjen e nipit të saj N.C; Ankesa e shtetasit A.Ç. nga Tirana i cili ankohet ndaj

Prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë për arsye se, padrejtësisht ka vendosur masë sigurimi të lehtë “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”, ndaj autorit të veprës penale të “vjedhjes me dhunë kryer në bashkëpunim” parashikuar nga neni 139 e 25 ë Kodit Penal, në dëm të djalit të tij F.Ç, etj.

-Ka edhe një grup ankesash ku shtetasit ankohen ndaj Prokurorisë për aplikim të masës së sigurimit “arrest në burg” ndaj fëmijve të tyre, për vepra penale jo me rrezikshmëri të madhe dhe për të cilat organi i akuzës mund të kërkonte masë sigurimi më të butë. E tillë është ankesa e shtetasit H.K. ndaj Prokurorisë së rrethit gjyqësor Elbasan për masë sigurimi “arrest në burg” ndaj djalit të tij S.K. për “fyerje e goditje për shkak të detyrës”, parashikuar nga nenet 237 e 239 të Kodit Penal, (gjatë debatit me punonjësit e policisë rrugore); Ankesa e shtetasit A.L nga Tirana për vendosje masë sigurimi “arrest në burg” ndaj djalit F.L. me moshë mbi 14 vjeç akuzuar për veprën penale të “mbajtjes pa lejë të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 të Kodit Penal; Ankesa e shtetasit A.D. nga Tirana për masë sigurimi “arrest në burg” ndaj djalit të tij T.D. akuzuar për veprën penale të “vjedhjes së pasurisë”, parashikuar nga neni 134 e Kodit Penal etj.

- Na raste të tjera ankesat e shtetasve janë drejtuar ndaj organit të Prokurorisë e cila sipas tyre, ka kërkuar masë të lartë dënimi me burgim ndaj fëmijve apo të afërmeve të tyre, të akuzuar për vepra penale të ndryshme si p.sh. ankesa e shtetasit I.A. nga Kavaja i cili ankohet ndaj Prokurorisë që ka kërkuar masë të rëndë prej 21 vjet burgim për djalin e tij N.A. akuzuar për veprën penale të “vrasjes në rrethana cilësuese” kryer ndaj më shumë se dy personave, parashikuar nga neni 79 gërma “dh” e Kodit Penal; Ankesa e shtetasit J.R. nga Cërriku i Elbasanit për kërkesën e Prokurorit për masë dënimi të lartë prej 6 vjet burgim ndaj djalit të tij L.R. akuzuar për veprat penale të “vjedhjes së pasurisë” dhe “mbajtjes pa lejë të armëve luftarake” etj.

Nga ana e jonë ankuesit janë sqaruar për mosndërhyrjen e Avokatit të Popullit në pavarësinë e organeve të drejtësisë, kërkesë kjo e përcaktuar në nenin 145 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe për të drejtën e ankimit kundër vendimit të gjykatës duke i u drejtuar instancave përkatëse gjyqësore sipas procedurave të parashikuara në ligj. Pavarësisht nga sa sipër shqetësimi i tyre mbetet një problem që mendojmë se duhet rregulluar për të futur të drejtën e ankimit të viktimës që të kundërshtojë vendimet gjyqësore. Pra, të përmirësohet Kodi i Procedurës Penale.

- Shqetësim i shtetasve për vitin 2006 ka qënë dhe mosndjekja e problemeve të tyre prej Institucioneve që u janë drejtuar, lidhur me humbjen e të afërmeve të tyre vite më parë. Të tilla janë rastet e ankesave të shtetasve

N. Ç. nga Malësia e Madhe për mosmarrjen e masave të nevojshme si nga ana e policisë ashtu dhe prokurorisë me qëllim kryerjen e veprimeve të nevojshme me qëllim gjetjen e djalit të tij P.Ç. larguar nga vëndbanimi qysh në muajin Korrik të vitit 1995; Ankesa e shtetasit M.A nga Tirana për humbjen e vajzës së tij E.A. në muajin tetor të vitit 1996; Ankesa e shtetasit L.SH. nga Durrësi për mosgjetjen e nipit të tij J.L. larguar nga vëndbanimi qysh në muajin qershor të vitit 1995 etj. Vërehet se, nuk është bërë vlerësimi i nevojshëm si nga prokuroria, ashtu dhe policia kriminale si organe kompetente për ndjekjen e këtyre ankesave që përbëjnë vepra me natyrë kriminale. Në këto rrethana shtetasit bëjnë përpjekjet e tyre në Institucione të tjera, por pa asnjë rezultat. Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndërhyrë pranë Drejtorisë së Përgjithme të Policisë së Shtetit me qëllim shpalljen e fëmijve në kërkim ndërkombëtar, duke ndjekur fatin e shkresës deri në Komisaritet e Policisë të cilët pasqyrojnë shpalljen në kërkim të shtetasve sipas rregullave.

-Nga ana e zyrës sonë janë kryer verifikimet e nevojshme si në organet e Prokurorisë, Policisë ashtu dhe në Drejtorinë Konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme edhe për raste kur shtetasve shqiptarë u janë marrë dokumentat gjatë kalimit jashtë vëndit, ndonëse ato kanë qënë të rregullta. I tillë është rasti i ankesës së shtetasit R.L. nga Durrësi i cili edhe pse ka patur dokumente të rregullta “kartë greke”, është ndaluar nga autoritetet policore në Ankona të Italisë ndërsa udhëtonte me tragetin e linjës Durrës-Ankona. Mandej, Prokuroria e rrethit gjyqësor Durrës filloi procedimin penal për veprën penale të “kalimit të paligjshëm të kufirit”, parashikuar nga neni 297 e Kodit Penal. Avokati i Popullit ka ndjekur me shqetësim ankesën e shtetasit R.L. jo vetëm duke vënë në dijeni Drejtorinë Konsullore në Ministrinë e Punëve të Jashtme, por dhe i ka kërkuar informacion Konsullatës së Përgjithshme në Milano të Italisë dhe Janinë të Greqisë. Nga ana e Konsullit të Përgjithshëm në Janinë, kemi marrë përgjigje të shpejtë nëpërmjet faksit. Konsulli ka sqaruar faktin se, “karta greke” në emër të shtetasit R.L. e lëshuar nga autoritetet policore greke ishte e rregullt. Mandej këto të dhëna ja kemi dërguar dhe Prokurorisë së rrethit gjyqësor Durrës, që duhet të pushojë akuzën e padrejtë.

- Për periudhën që analizohet ka patur dhe raste kur, shtetas të ndryshëm ankohen për “mbyllje” të çështjeve për veprën penale të “shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” me pasoja të rënda për jetën apo shëndetin e shtetasve. Të tilla janë ankesat e shtetasve D.K. nga Lushnja për dëmtimin e rëndë shkaktuar nga vepra penale; Shtetasi K.S. nga Lushnja për vdekjen e vëllait të tij N.S. dhe plagosjen e rëndë të një personi tjetër; Ankesa e shtetasit B.S. nga Tirana për vdekjen e nënës së tij M.S; Shtetasi

A.K. nga Korça për aksidentimin e shtetas G.RR. në Pogradec etj.

Nga studimi dhe analiza e bërë ankesave të paraqitura në Institucionin tonë arrijmë në përfundimin se, nga ana e Prokurorisë jo gjithmonë bëhet vlerësimi i duhur i këtyre çështjeve, të cilat fillojnë mbi bazën e ngjarjes, dhe kërkojnë kryerje të shpejta të veprimeve të para hetimore të papërsëritshme, njohuri profesionale në fushën autoteknike dhe objektivitet. Njëanshmëria, dhënia e konkluzioneve të pasakta dhe të padrejta në aktet e ekspertimit mjeko-ligjor ose autoteknik, moskryerja e veprimeve të gjithanëshme, janë pasoja të vendimeve të pabazuara të ndërmara nga policia gjyqësore e të miratuara nga Prokuroria. Nga ana tjetër, ato sjellin zvarritje në hetimin e çështjeve penale dhe pasoja të tjera që lidhen me probleme sociale, deri në acarimin e marrëdhënieve ndërmjet autoreve të veprës me familjarët e të dëmtuarëve apo viktimave të shkaktuara nga vepra penale. Veç sa sipër, këto qendrimet ndikojnë negativisht në rritjen e numurit të aksidenteve në shkallë vendi, i cili për vite me radhë është mjaft shqetësues.

Pikërisht mbi këtë shqetësim qytetar, duke konstatuar se në vitet e fundit aksidentet rrugore janë konsideruar si “vrasësit” kryesore të shqiptarëve me gati 1 të vdekur dhe 2 të plagosur në ditë, nga ana e jonë janë kërkuar informacione të hollësishme Prokurorive në rrethe të ndryshme të vendit për veprën penale të “shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” me pasojë vdekje apo dëmtime në shëndetin e shtetasve për periudhën 5 vjeçare 2001-2005. Informacionet u janë kërkuar kryesisht Prokurorive të rretheve të mëdha dhe, ku në territorin që ato ushtrojnë ndjekjen penale kalojnë autostrada apo superstrada dhe lëvizja e mjeteve është tepër e madhe. Pas marrjes së të dhënave të nevojshme si nga Prokuroritë e rretheve të ndryshme ashtu dhe nga dërgimi i të dhënave nga Prokuroria e Përgjithshme, u realizua dhe studimi. Konkluzionet e nxjerra nga ky studim do t’i dërgohen Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë etj.

- Për vitin 2006, duke ndjekur me shqetësim rastet e ankesave të disa shtetasve për humbjen e jetës së të afërmëve të tyre, si rezultat i punës së pakujdesshme të mjekëve apo personelit tjetër mjekësor, janë grumbulluar të dhëna dhe informacione nga disa Prokurori të rretheve, të cilat kanë hetuar çështjet penale për veprën penale të “Mjekimit të Pakujdesshëm”, me pasojë vdekjen e personit, parashikuar nga neni 96 e Kodit Penal. Me marrjen e të gjitha të dhënave të nevojshme do të realizohet një studim disa vjeçar dhe problemet që do të dalin, mendojmë t’ja dërgojmë institucioneve shtetërore si, Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Shëndetësisë etj.

C. Nga shqyrtimi i ankesave të ndryshme që janë konsideruar të drejta për shkeljet e konstatuara, Avokati i Popullit i ka paraqitur Prokurorit të Përgjithshëm, apo drejtuesve të Prokurorive në rrethe 7 rekomandime, nga

të cilat 5 janë pranuar dhe për 2 rekomandime të cilat janë të muajit dhjetor të vitit 2006 akoma nuk është kthyer përgjigje.

Pra, konstatohet se rekomandimet e Avokatit të Popullit, përgjithësisht janë pranuar. Në mënyrë të grupuar rekomandimet tona drejtuar organit të Prokurorisë, paraqiten si më poshtë:

1. Rekomandim drejtuar Prokurorit të rrethit gjyqësor Korçë, “Për fillimin e hetimit për veprën penale të “Torturës”, parashikuar nga neni 86 i Kodit Penal, në ngarkim të punonjësve të policisë të Komisarariatit të Policisë Korçë, z. G.M. dhe A.G. (Me inisiativën e Avokatit të Popullit). Rekomandimi është pranuar.

2. Rekomandim drejtuar Prokurorit të rrethit gjyqësor Tiranë, “Për marrjen e masave disiplinore ndaj z.H.K. dhe B.K. me detyrë oficerë të policisë gjyqësore në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë”. (Ankesa e shtetasit H.N. me profesion avokat pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë). Rekomandimi është pranuar.

3. Rekomandim drejtuar Prokurorit të rrethit gjyqësor Gjirokastrë, “Për marrjen e masave me qëllim zbatimin e vendimit Nr. 97 datë 05.07.2006 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, për vazhdimin e hetimeve të proçedimit penal Nr. 302 të Prokurorisë së rrethit gjyqësor Gjirokastrë, e cila kishte vendosur mosfillimin e këtij proçedimi”. (Ankesa e shtetasve F.dhe B. S. nga Delvina). Rekomandimi është pranuar.

4. Rekomandim drejtuar Prokurorit të rrethit gjyqësor Korçë, “Për ndryshimin e kualifikimit të veprës penale në plagosje të rëndë në ngarkim të autorit të veprës penale R.T.” (Ankesa e shtetasit A.C. nga Korça). Rekomandimi është pranuar.

5. Rekomandim drejtuar Prokurorit të rrethit gjyqësor Durrës, “Për marrjen e masave disiplinore ndaj z. E.M. dhe A.H. me detyrë oficerë të policisë gjyqësore në Komisariatin e Policisë Durrës”. (Ankesa e shtetasit B.D. nga Durrësi). Rekomandimi është pranuar.

6. Rekomandim drejtuar Prokurorit të rrethit gjyqësor Pukë, “Për marrjen e masave me qëllim vënien në vënd të së drejtës së shkelur të paraburgosurit Z.F.”. Ankesa e shtetasit L.K. me profesion avokat mbrojtës në emër të të mbrojturit prej tij Z.F. nga Puka). Rekomandimi është në shqyrtim dhe akoma nuk ka ardhur përgjigja.

7. Rekomandim drejtuar Prokurorit të rrethit gjyqësor Tiranë, “Për marrjen e masave për zvarritje në hetimin e proçedimit penal Nr. 634 të vitit 2006, me qëllim përmirësimin e punës për hetime të shpejta dhe brënda afateve të përcaktuara me ligj”. (Ankesa e shtetasit M.T.nga Tirana). Rekomandimi është në shqyrtim dhe akoma nuk ka ardhur përgjigja.

Në bërjen e rekomandimeve drejtuar organit të Prokurorisë, nga ana e

jonë është insistuar dhe zbatuar për të drejtën kushtetuese që i është shkelur ankuesit, nga veprimet ose mosveprimet e punonjësve të Prokurorisë. E drejta që i është shkelur shtetasit është parë në një këndvështrim më të gjërë dhe në harmonizim me aktet ndërkombëtare që përcaktojnë këto të drejta si, Konventën Europiane “Për të Drejtat e Njeriut”, “Deklaratën Universale të Njeriut” të Kombeve të Bashkuara etj. Nga ana tjetër duke respektuar nenin 116 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë që bën fjalë për “Aktet Normative”, i kemi rekomanduar Prokurorisë që, në ushtrimin e ndjekjes penale për vepra penale të caktuara të ketë parasysh dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara. I tillë është rasti i Rekomandimit drejtuar Prokurorisë së rrethit gjyqësor Korçë, për fillimin e hetimit për veprën penale të “torturës”, parashikuar nga neni 86 i Kodit Penal në ngarkim të punonjësve të policisë G.M dhe A.G, ndaj të miturit A.P. Ne kemi sqaruar organin e Prokurorisë se, Konventa “Kundër torturës dhe dënimeve e trajtimeve të tjera mizore çnjerëzore ose degraduese”, miratuar nga Asambleja e Kombeve të Bashkuara më datën 10.12.1984, është një akt ndërkombëtar i ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, dhe pavarësisht se neni 86 i Kodit Penal që bën fjalë për “Torturën” ka një përcaktim të përgjithshëm e të cinguar, duke i rekomanduar trajtimin e kësaj vepre penale sipas përcaktimit të hollësishëm që ka bërë Konventa e mësipërme.

Vlen të theksohet fakti se për të gjitha rekomandimet e sipërpërmëndura drejtuar Prokurorive në rrethe të ndryshme gjyqësore të vëndit, nga ana e jonë është vënë në dijeni Prokurori i Përgjithshëm, i cili pas shqyrtimit të tyre ka kthyer përgjigje brënda afatit ligjor në Institucionin e Avokatit të Popullit. Nga ana tjetër, në bazë të kompetencave të parashikuara në ligj, ai ka urdhëruar dhe fillimin e hetimit, siç është rasti i rekomandimit drejtuar Prokurorisë së rrethit gjyqësor Gjirokastrë.

Për vitin 2006 konstatohet se nga ana e Prokurorive në rrethe, ka një vlerësim më të mirë dhe korrekt në rekomandimet e dërguara nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Raste të tilla mund të përmëndim Prokurorinë e rrethit gjyqësor Durrës, e cila jo vetëm ka mirëpritur rekomandimin tonë pas ankesës së shtetasit B.D, por edhe e ka punuar materialin me kolektivin e punonjësve të Prokurorisë, pra me Prokurorët dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore duke nxjerrë konkluzionet e nevojshme për përmirësimin e punës.

Për një vlerësim të drejtë dhe hetim të gjithanshëm flet dhe puna e mirë e Prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë, në hetimin e çështjes penale Nr. 3271 të vitit 2005 filluar mbi bazën e rekomandimit tonë.

Kështu, shtetësja N.M. nga Tirana ka paraqitur ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit, lidhur me aksidentimin me vdekje të bashkëshortit të

saj të ndjerit D.M, ndërsa ai ishte duke punuar tek një pallat i firmës “Skënderi” pranë stadiumit “Selman Stërmasi”, ngjarje e ndodhur më datën 14 maj të vitit 2002.

Ankuesja ndërmjet të tjerave sqaroi se, në vëndngjarje kishte qënë dhe një punonjës i policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Nr.2, ndonëse nuk kishte dijeni për gjeneralitetet e plota të tij. Për ankesën e saj, është urdhëruar kryerja e një hetimi i cili ka konsistuar në verifikimet e hollësishme në Komisariatin e Policisë Nr. 2, Drejtorinë e Policisë së Qarkut dhe Prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë. Nga ana tjetër, duke marrë dijeni për faktin se pas aksidentimit në punë, i ndjeri D.M. ishte transportuar në spitalin ushtarak ku edhe kishte gjetur vdekjen, janë administruar kartela mjekësore e tij, si dhe janë kryer verifikime në Institutin e Mjekësisë Ligjore Tiranë. Kjo me qëllim për të saktësuar faktin nëse është kryer ekspertim mjeko-ligjor i kufomës, çka dhe do të konfirmonte fillimin e procedimit penal për këtë ngjarje me natyrë kriminale. Pas hetimit të kryer është konkluduar se Prokuroria nuk kishte filluar hetime si mbi bazë ngjarje apo dhe nga materialet e dërguara prej Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë. Për rrjedhojë, më datën 02.11.2005 i kemi rekomanduar Prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë “Fillimin e hetimit për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 të Kodit Penal, në ngarkim të oficerëve të policisë gjyqësore të K.P.Nr. 2 Tiranë”. Prokuroria vlerësoi rekomandimin tonë, ka filluar hetimin, mandej ka marrë në përgjegjësi penale shtetasin F.K. me detyrë drejtues teknik i firmës për veprën penale të “shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 189/1 të Kodit Penal dhe më datën 22.09.2006 ka dërguar çështjen në gjyq. Gjykata nga ana e saj ka deklaruar fajtor të pandehurin F.K. dhe e ka dënuar atë më gjobë.

Organi i Prokurorisë, pas hetimeve të kryera ka veçuar dhe mandej ka pezulluar hetimin për veprën penale të “shpërdorimit të detyrës” ndaj oficerëve të policisë gjyqësore, me arësytimin se nuk i ka identifikuar dot, duke i kaluar materialet e çështjes për ndjekje të mëtejshme, policisë kriminale në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë. Interesimi jonë për këtë çështje vazhdon dhe për kryerjen e veprimeve nga policia kriminale, çka do të zbardhë në mënyrë të qartë veprimet apo mosveprimet e kryera nga policia gjyqësore e Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë.

D. Gjatë shqyrtimit të çështjeve që kemi paraqitur për keqtrajtime apo veprime arbitrare të organeve të policisë ndaj qytetarëve organi i prokurorisë ka filluar procedimin penal ndaj personave përgjegjës, por në përfundim ka vendosur pushimin ose pezullimin e hetimit. Raste të tilla kanë qënë ankesa e shtetasit A.H. nga Tirana për ushtrim dhune në banesën e tij nga punonjësit e policisë së Komisarariatit të Policisë Nr.2 dhe forcat “Renea”; Ankesa e

shtetasit P.M. nga Patosi i Fierit për ushtrim dhune në lokalitë e tij nga Forcat Speciale të Policisë Tiranë etj.

Prokurorët e rretheve kanë vlerësuar më me korrektësi rekomandimet tona. Por ka edhe raste që disa Prokurori si ajo e Gjirokastrës apo e Durrësit, ngurojnë të dërgojnë informacione apo akte, s'japin për studim dosjet penale për të cilat janë pushuar hetimet prej tyre, por për të cilat ka patur ankesa nga shtetasit, megjithëse me ndryshimet e bëra në maj 2005 në ligjin "Për Avokatin e Popullit", janë qartësuar më tej kompetencat tona edhe në marrëdhënie me prokurorinë.

5. Ankesat për Ministrinë e Brendshme

Gjatë këtij viti ndaj Ministrisë së Brendshme dhe organeve të pushtetit vendor kanë ardhur gjithsej 564 ankesa, kërkesa apo njoftime. Nga këto 215 kanë qënë ndaj institucionit të Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit, ndërsa 349 kanë qënë ndaj organeve të pushtetit vendor si, Këshillave të Qarqeve, Prefekturave, Bashkive, Komunave dhe Zyrave të Gjëndjes Civile.

A. Pranimi dhe shqyrtimi me përparësi dhe me rigorozitet i ankesave dhe kërkesave ndaj organeve të Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit ka qënë dhe do të vazhdojë të mbetet një nga prioritetet tona kryesore. Kjo jo vetëm për faktin se ky organ i administratës publike përbën strukturën që përfaqëson fuqinë shtrënguese të shtetit, por edhe për vetë specifikën e Policisë Shqiptare, e cila krahas arritjeve pozitive, vazhdon të ketë në radhët e saj elementë të pakulturuar, të papërgatitur profesionalisht, të pa trajnuar me konceptet e shtetit ligjor dhe respektimit të të drejtave të Njeriut, të korruptuar etj.

Në institucionin tonë për sektorin e policisë gjatë vitit 2006 kanë ardhur gjithsej 215 ankesa, kërkesa apo njoftime. (Në këtë numër nuk përfshihet numri i ankesave të mbartura nga viti 2005). Nga këto, 98 prej tyre janë bërë nga banorë të Tiranës, ndërsa 117 nga banorë të rretheve të ndryshme të vendit. Kanë përfunduar 193 ankesa si vijon: 69 ose rreth 36% janë zgjidhur në favor, 27 kanë qënë jashtë juridiksionit, 92 kanë qënë të padrejta, kurse 5 ankues kanë hequr dorë. Janë mbartur për shqyrtim në vitin 2007, 22 ankesa.

Gjatë këtij viti për rastet që kemi vërtetuar shkeljet e ligjit janë bërë 4 rekomandime për fillimin e ndjekjes penale, të cilat janë pranuar. Janë bërë dhe 13 rekomandime për dhënien e masave disiplinore, të cilat janë pranuar

të gjithë. Në bazë të rekomandimeve tona Prokuroritë e Rretheve Tiranë, Fier dhe Korçë kanë filluar ndjekjen penale ndaj disa punonjësve të policisë të Komisarariatit të Policisë Nr. 4 Tiranë, Korçë dhe Forcave Speciale Tiranë dhe janë dhënë 16 masa disiplinore ndaj punonjësve të policisë që kanë bërë shkelje të ligjeve, nga të cilat 2 përjashtime nga Policia e Shtetit.

Ankesat e trajtuara ndahen sipas problemeve të mëposhtme:

I. Ankesat për keqtrajtim të shtetasve

Këto ankesa janë vlerësuar më tepër sepse kur ato kanë rezultuar të vërteta, kanë qënë shkelje të rënda të nenit 25 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që parashikon se: *“Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues”*. Njëkohësisht ato janë edhe dhunime të rënda të nenit 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Në institucionin tonë janë bërë 18 ankesa për keqtrajtime të shtetasve nga Policia e Shtetit, të cilat janë përfunduar. Mënyra e zgjidhjes së tyre është: 6 janë vlerësuar të drejta, 8 të pa bazuara dhe 4 kanë qënë jashtë juridiksionit.

Për rastet kur kemi vërtetuar pretendimet e ankuesve për keqtrajtime nga punonjësit e Policisë kemi bërë rekomandime organeve përkatëse. Gjatë këtij viti, vetëm për rastet e keqtrajtimit, i janë bërë 3 rekomandime organit të Prokurorisë për fillimin e ndjekjes penale, të cilat janë pranuar.

Si raste të ankesave për keqtrajtime të shtetasve të vërtetuara mund të përmëndim:

1. Rasti i filluar me iniciativë lidhur me vetvarjen e shtetasit Amarildo Përfundi në datë 16.06.2006, në fshatin Pirg të rrethit Korçë. Nga hetimi i këtij rasti rezultoi se më datën 11.06.2006, në orët e vona të natës është vjedhur një magazinë ushqimore në fshatin Pirg të Korçës, me pronar shtetasin A.F.. Pas konstatimit të vjedhjes së magazinës në mëngjesin e datës 12.06.2006, shtetasi A.F. ka bërë njoftim në polici dhe mbi këtë bazë është shkuar në ngjarje me grup hetimor, ku edhe janë kryer veprimet e para hetimore. Gjatë këqyrjes së vëndit të ngjarjes janë fiksuar dhe janë marrë gjurmë gishtash të vlefshme për ekspertim daktiloskopik. Prokuroria e rrethit Korçë kishte filluar procedimin penal për vjedhje të pasurisë, pa autor. Pas ndodhjes së ngjarjes me porosi të specialistit të policisë kriminale Altin Gusho, agjenti i policisë kriminale Robert Memelli dhe specialisti i policisë së zonës Gëzim Mullalli, kanë punuar për të siguruar informacion mbi autorët e mundshëm të vjedhjes së magazinës. Më datën 12.06.2006, agjenti i policisë kriminale Robert Memelli ka përpiluar një informacion në të cilin

bëhet fjalë se, autorë të mundshëm të kësaj vjedhje janë disa persona, ndër të cilët dhe viktimë A.P.. Nga ana tjetër specialisti i policisë së zonës Gëzim Mullalli më datën 13.06.2006, kishte përpiluar një informacion për autorët e mundshëm të kësaj vjedhjeje, ku dyshohej dhe për shtetasin A.P.

Të dy informacionet e mësipërme i janë dhënë specialistit të policisë kriminale Altin Gusho, i cili më datën 14.06.2006 urdhëron të dy punonjësit e Policisë të sipër përmëndur që të shkonin në fshatin Pirg, të bënin shoqërimin e personave të dyshuar, si dhe t'u merrnin gjurmët e gishtave. Po në këtë ditë, rreth orës 12.00, specialisti i policisë kriminale, specialisti i policisë së zonës dhe agjenti i policisë kriminale, kanë shoqëruar për në Komisaratin e Policisë Korçë, tre shtetas dhe konkretisht A.P., R.R. dhe F.F..

Sipas librit të personave të shoqëruar, të tre këta shtetas janë shoqëruar në Komisaratin e Policisë Korçë në orën 14.10, arësyeja e shoqërimit ka qënë për verifikim, dhe punonjësi që ka bërë shoqërimin ishte specialisti i policisë kriminale Altin Gusho. Siç rezultoi nga kqyrja e librit për personat e shoqëruar, lirimi i tyre është bërë në orën 20.15, po nga specialisti i policisë kriminale.

Në Komisaratin e Policisë Korçë, viktimë A.P. është marrë në pyetje nga specialisti i policisë së zonës Gëzim Mullalli në katin e dytë dhe në mjediset e sallës së mbledhjes së policisë është pyetur lidhur me vjedhjen e magazinës ushqimore. Sipas specialistit të policisë së zonës, viktimës i është kërkuar të bënte një deklaratë për të treguar se çfarë vjedhjesh kishte kryer ai në atë zonë. Nga përmbajtja e deklaratës dilte se aty bëhej fjalë për vjedhje të ndryshme si pula, lepuj, bateri etj, për të cilat nuk kishte kallzim penal nga personat e dëmtuar. Në deklaratë bëhej fjalë edhe për një armë që ndodhej në banesën e viktimës për të cilën kishte dijeni babaj i tij, Y.P.. Deklarata nga ana e saj ishte pa datë si dhe pa emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e personit që kishte deklaruar.

Rreth orës 19.00 të datës 14.06.2006, me kërkesë të specialistit të policisë kriminale Altin Gusho, është bërë fotografimi dhe marrja e gjurmave të gishtave të shtetasit A.P.. Në orën 20.15, me urdhër të specialistit të policisë kriminale Altin Gusho, të tre shtetasit janë lënë të lirë. Shtetasit R.R. dhe F.F. janë marrë nga një prind i tyre, i cili i kërkoi Policisë për të marrë dhe A.P., person i cili nuk kishte të holla për t'u kthyer në shtëpi me makinë, por Policia nuk e lejoi duke i thënë se do t'a shoqëronin ata vetë në shtëpi.

Në orën 21.00 me mjetin e Policisë nën drejtimin e specialistit të policisë së zonës Gëzim Mullalli u bë shoqërimi i viktimës për në banesën e tij, ku dhe u muar arma për të cilën bëhej fjalë në deklaratën e dhënë nga

shtetasi A.P.. Kjo armë u dorëzua nga shtetasi Y.P., mbi baza vullnetare me anë të një deklarate.

Nga hetimi i kryer, deklaratimet e personave të ndryshëm që kishin dijeni për ngjarjen, si dhe kqyrja e administrimi i dokumenteve të ndryshme rezultoi se:

Shoqërimi në Polici i shtetasve të cituar më sipër, duke përfshirë dhe viktimën A.P., ishte i paligjshëm për arsye se, është cënuar neni 27 pika 2, gjurmë “c” e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në të cilën thuhet shprehimisht se:

“Liria e personit nuk mund të kufizohet përveçse në rastet e mëposhtme: ... Kur ka dyshime të arësyeshme se ka kryer një veprë penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj”.

Në rastin konkret ndodhemi para rastit të privimit të lirisë, që sipas Kodit të Proçedurës Penale, zgjidhet me marrjen e masës së sigurimit, të kërkuar nga prokuroria dhe të vleftësuar nga gjykata. Pra, në se shtetasi A.P. i duhej hequr liria ose jo, kjo zgjidhej nga organi kompetent (Prokurori - Gjykatë), në bazë të Kodit të Proçedurës Penale dhe jo nga Policia, me anë të shoqërimit të tij në Polici.

Theksojmë faktin se nga ana e punonjësve të policisë në momentin e thirrjes dhe mandej marrjes së shtetasit A.P. në Polici, nuk është vënë në dijeni as familja e viktimës ashtu dhe personeli mësimdhënës.

Momenti i marrjes së deklaratës shtetasit A.P është i kundërligjshëm dhe bie ndesh me nenin 37 të Kodit të Proçedurës Penale i cili bën fjalë për *deklarimet që tregojnë vetëpërgjegjësi*. Sipas kësaj dispozite, autoriteti proçedues që në rastin konkret është specialisti i policisë së zonës, duhet të ndërpriste pyetjen dhe t’u paralajmëronte shtetasin A.P. se pas këtyre deklaratimeve, ndaj tij mund të zhvillohen hetime, duke e ftuar të caktonte dhe një mbrojtës. Vlen të theksohet se nga punonjësi i policisë viktimë është pyetur për vjedhjen e magazinës ushqimore dhe ai ka sqaruar se nuk ishte autor i saj. Në asnjë pjesë të deklaratës së bërë nga viktimë nuk përmendet fare fakti që ai të ishte autor i vjedhjes së magazinës, për të cilën Policia kishte dyshime.

Por, nga ana tjetër, bazuar në të dhënat e paraqitura në çertifikatën e lindjes lëshuar nga Zyra e Gjëndjes Civile Përgj, shtetasi A.P. ishte i datëlindjes 28.06.1998, çka konfirmon faktin se në rastin konkret kemi të bëjmë me një shtetas të mitur ndaj të cilit nuk mund të kryhet asnjë veprim proçedural pa praninë e kujdestarit të tij, si dhe avokatit mbrojtës, pra atij duhej t’i sigurohej ndihma psikologjike dhe juridike. Këto kërkesa të domosdoshme përcaktohen qartë në nenin 35 të Kodit të Proçedurës Penale,

i cili bën fjalë për *ndihmën që i jepet të pandehurit të mitur*. Theksojmë edhe faktin, se veprimi i kryer nga specialisti i policisë së zonës është i pabazuar në ligj, pasi për rastin konkret Prokuroria kishte filluar procedim penal dhe ai nuk ishte i autorizuar nga ana e organit procedues për marrjen në pyetje të shtetasit A.P..

Siç u përmënd dhe më lart, viktimës A.P., në Komisaratin e Policisë Korçë i janë marrë dhe gjurmët daktiloskopike, veprim i cili është i kundërligjshëm pasi urdhër-shërbimi Nr.1634, datë 13.05.2003, i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për fotodaktiloskopimin e personave”, bie ndesh me nenin 353 të Kodit të Procedurës Penale. Më konkretisht, ky urdhër është bazuar në nenin 3 pika 1 gërma “c” të, nenin 37 pika 1 dhe 4 të Ligjit “Për Policinë e Shtetit”, në të cilat flitet *për marrjen e masave për parandalimin dhe zbulimin e krimeve, për marrje informacioneve, por duke respektuar garancitë kushtetuese për liritë dhe të drejtat e personit*.

Urdhëri bazohet dhe në nenin 295 paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Penale, i cili bën fjalë për *identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime*. Për rastin konkret, shtetasi A.P. është i identifikuar dhe nuk ishte në pozitën procedurale të personit ndaj të cilit shvillohen hetime.

Urdhëri i mësipërm mbështetet në urdhërin Nr. 74 të vitit 1992, i cili pas daljes se Ligjit “Për Policinë e Shtetit” nuk kanë me fuqi ligjore dhe rregulloren e policisë shkencore Nr.1063, datë 18.12.2001.

Këto veprime bien në kundërshtim dhe me nenet 2 dhe 11 të Ligjit Nr. 8517 datë 22.07.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Duke analizuar në tërësi provat e administruara rezultoi, se nga ana e punonjësve të policisë Gëzim Mullalli dhe Altin Gusho janë kryer veprime të kundërligjshme procedurale, si dhe është ushtruar dhunë fizike e psikike, si pasojë e të cilave viktimës i është shkaktuar një gjëndje e tillë emocionale, të cilat e çuan atë në vetvarje, veprime të cilat përbëjnë dhe vepër penale.

Bazuar në Konventën Europiane e të drejtave të Njeriut dhe konkretisht në nenin 1 të pjesës së parë të saj, me termin “torturë” kuptohet, *çdo veprim me anën e të cilit një personi i janë shkaktuar me dashje dhimbje ose vuajtje të rënda fizike ose mendore me synim për të marrë prej tij, ose prej një tjetri informata ose pohime për të ndëshkuar për një veprim që ai ose një person tjetër ka kryer ose dyshohet që e ka kryer për t’a frikësuar ose për të bërë presion mbi të... ”.*

Referuar dhe këtij kuptimi që i jep Konventa termit “torturë”, rezulton se nga ana e punonjësve të policisë është konsumuar vepra penale e “torturës”, parashikuar nga neni 86 i Kodit Penal.

Për këto arsye, i rekomandua Ministrisë së Brendëshme që të merrte masa disiplinore ndaj punonjësve të Policisë që kishin bërë shkeljet ligjore,

si dhe ndaj drejtuesve të Komisarariatit të Policisë Korçë që me qëndrimet e tyre indiferente kishin lejuar kryerjen e këtyre shkeljeve nga vartësit e tyre. Rekomandimi u mirëprit dhe punonjësit e Policisë Altin Gosho dhe Gëzim Mullalli u përjashtuan nga Policia, ndërsa për Shefin e Komisarariatit Ilia Nasi dhe Shefin e Policisë Kriminale Elidon Veizi nuk u pranua rekomandimi. Gjithashtu, i rekomanduam Prokurorisë së Rrethit Gjyqësorë Korçë fillimin e hetimit për veprën penale të “torturës”, parashikuar nga neni 86 i Kodit Penal, në ngarkim të punonjësve të Policisë Altin Gusho dhe Gëzim Mullalli. Prokuroria e filloi ndjekjen penale dhe çështja u hetua dhe pas hetimit u dërgua për gjykim vetëm shtetasi Gëzim Mullalli, ndërsa për Altin Gushon u pushua.

2. Ankesa e shtetasit P. M., banor i qytetit Patos të rrethit Fier. Ai pretendonte se në dt. 04.11.2005, kishte qënë me familjen duke ngrënë drekë në lokalin e tij, i cili ndodhet në Patos. Në këtë kohë, forca të shumta të policisë, shumica e të cilëve ishin me maska në kokë e me armë në duar, i kanë hyrë forcërisht në lokal, duke thyer xhama, tavolina e karrike. Pa patur asnjë shkak ligjor, punonjësit e policisë e kanë kërcënuar atë, e kanë shtrirë në dysheme dhe kanë tentuar t’i vinin prangat. Por për shkak të shëndetit (trashësisë trupore) të tij dhe jo për shkak të rezistencës, ata nuk kanë mundur t’a lidhnin atë. Ndërkohë ata, pa patur ndonjë vendim gjyqësor, kanë ushtruar kontroll në lokal. Pas kontrollit të ushtruar nuk kanë gjetur ndonjë gjë të kundërligjshme dhe nuk kanë mbajtur e dhënë atij procesverbal. Në prezencë të familjes e kanë qëlluar atë me shkelma në pjesë të ndryshme të trupit, ndërsa njëri prej tyre e ka goditur me qytë automatiku në kokë, duke e çarë e shkaktuar plagë e hemoragji. Në fund të veprimeve, njëri prej tyre, i cili iu prezantua si komandanti i aksionit, i quajtur Robert Pataj, i ka thënë se kundërt tij kishin bërë gabim. Gjithashtu, ai na shkruante se pas shumë përpjekjesh ishte takuar me Drejtorin e Policisë së Qarkut Fier dhe i kishte prezantuar problemin e ndodhur, por ai nuk ja kishte zgjidhur atë.

Nga ana jonë u muar vendim për kryerjen e ekspertimit mjekoligjor të ankuesit. Mbi këtë bazë, Instituti i Mjekësisë Ligjore bëri ekzaminimin e tij dhe nga akt dëshmia mjekoligjore Nr. 1135, dt. 09.11.2005, rezultoi se në trupin e ankuesit u konstatuan dëmtime, të cilat hynin në kategorinë e atyre dëmtimeve që shkaktojnë paaftësi të përkohëshme për punë deri në 9 ditë.

Në bazë të kërkesës tonë, Drejtoria e Policisë e Qarkut Fier na informoi, se operacioni policor që lidhej me këtë ankesë ishte kryer nga forcat e Policisë të ardhura nga Tirana dhe na sugjeroi që t’i drejtoheshim Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për sqarime.

Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit na informoi se ky operacion policor ishte organizuar në bashkëpunim me Prokurorinë për

Krime të Rënda Tiranë, e cila në dt. 01.11.2005, kishte regjistruar procedimin penal Nr. 87. Operacioni i goditjes ishte zhvilluar në ambjentet e lokalit “Liqeni”, pronë e shtetasit P. M., pasi pjestarët e grupit të trafikimit të lëndëve narkotike gjatë gjithë kësaj dite kishin shfrytëzuar ambjentet e këtij lokali për t’u takuar dhe komunikuar me njeri tjetrin. Sipas përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit rezultonte, se në këtë aksion kishin qënë Shefi i Sektorit të Operacioneve Speciale A. P., Shefi i Sektorit të Luftës Kundër Drogës S. S. dhe punonjës të tjerë të policisë, të cilët janë paraqitur me identitete të fshehura.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese, ne arritëm në konkluzionin se ankuesi ishte keqtrajtuar nga punonjësit e Policisë dhe ishte bërë kontroll i paligjshëm i lokalit të tij, duke shkelur rëndë të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura dhe garantuara nga nenet 25 dhe 37 të Kushtetutës tonë, neni 3 i Konventës Europiane për të drejtat e Njeriut, si dhe nga nenet 27/ 2 dhe 43/2 të Ligjit Nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”.

Me veprimet e tyre punonjësit e policisë kishin konsumuar elementët e veprës penale të kryerjes së veprimeve arbitrare të parashikuara nga neni 250 i Kodit Penal. Për këto arsye, i rekomandua Prokurorisë së rrethit Fier fillimin e ndjekjes penale në ngarkim të punonjesve të Policisë që kishin marrë pjesë në veprimet e kryera me shtetasin P. M., për veprën penale të kryerjes së veprimeve arbitrare, të parashikuara nga neni 250 i Kodit Penal. Rekomandimi i mirëprit dhe u pranua. Çështja i kaloi për kompetencë Prokurorisë Ushtarake Vlorë, e cila vazhdon hetimet.

3. Ankesa e shtetasve F. D. dhe R. Th., me banim në Tiranë, të cilët na shkruanin se në dt. 26.11.2005, kishin qënë në shtëpinë e shtetasit A. H. në Tiranë. Në orën 22.00, punonjësit e Policisë të Komisarariatit Nr. 2 Tiranë dhe ata të RENEA-s, kishin shkuar në shtëpinë e A. H. dhe kishin hyrë brënda. Sipas tyre, punonjësit e Policisë pa patur asnjë shkak e motiv kanë ushtruar dhunë barbare ndaj tyre, ndërkohë që as ata dhe as A. H. nuk kanë bërë asnjë rezistencë ndaj punonjësve të policisë. Pas kësaj, rreth orës 22.00, ata janë shoqëruar në Polici dhe janë mbajtur aty deri në orën 18.00 të datës 27.11.2005, ndërsa A. H. ishte arrestuar.

Meqënëse nga ana jonë u konstatuan dëmtime tek ankuesit, u muar vendim për ekzaminimin mjekoligjor të tyre pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë. Nga Akt Dëshmia Mjekoligjore Nr. 1201, dt. 01.12.2005, mbi ekzaminimin e shtetasit F. D., rezultoi se tek ai u konstatuan plagë, ekimozë e dërmishje, të shkaktuara me mjet të fortë mbretës, të cilat hynin në kategorinë e dëmtimeve që kanë shkaktuar një humbje të aftësisë së përkohshme mbi 9 ditë. Ndërsa nga Akt Dëshmia Mjekoligjore Nr. 1202, dt.

01.12.2005, mbi ekzaminimin e shtetases R. Th., rezultoi, se tek ajo u konstatuan ekimoza dhe enjtje, të shkaktuara me mjet të fortë mbretës, të cilat hynin në kategorinë e dëmtimeve që kanë shkaktuar një humbje të aftësisë së përkohshme deri 9 ditë.

Gjithashtu, nga ana jonë iu kërkuan shpjegime Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë rreth pretendimeve të ankuesve. Ky komisarariat na informoi se kapja dhe shoqërimi i personit të arrestuar A.H., si dhe i personave që ndodheshin në banesë me atë, ishte bërë nga Forcat Speciale.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese ne arritëm në konkluzionin se ankuesit F. D. dhe R. Th. ishin keqtrajtuar nga punonjësit e Policisë të Forcave Speciale, duke iu shkëlur rëndë të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura dhe garantuara nga neni 25 i Kushtetutës tonë, neni 3 i Konventës Europiane e të drejtave të Njeriut, si dhe nga neni 27, pika 2 e Ligjit Nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”.

Me veprimet e tyre punonjësit e Policisë të Forcave Speciale kishin konsumuar elementët e veprës penale të kryerjes së veprimeve arbitrare të parashikuara nga neni 250 i Kodit Penal.

Për këto arsye, i rekomanduam Prokurorisë së Rrethit Tiranë fillimin e ndjekjes penale në ngarkim të punonjësve të policisë të Forcave Speciale që kanë marrë pjesë në veprimet e kryera me ankuesit për veprën penale të ”kryerjes së veprimeve arbitrare”, të parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal. Rekomandimi u mirëprit, u fillua procedimi penal dhe çështja është në hetim.

II. Ankesat për veprime të tjera të paligjshme apo të parregullta nga Policia

Kanë qënë 149 ankesa për veprime arbitrare të punonjësve të Policisë, nga të cilat 4 për kontrole të paligjshme banese e lokali; 2 për arrestime të paligjshme; 26 për shoqërime në Polici; 51 për mos evidencim apo mos ndjekje të kallzimeve apo të ankesave; dhe 66 për veprime të tjera të kundërligjshme apo te parregullta, si për sende të sekuestruara apo bllokuara nga policia; për veprime korruptive; për gjoba të padrejta; mospajisje me pasaportë apo bllokime të tyre etj. Si raste të zgjidhjes pozitive mund të përmëndim:

1. Ankesa e shtetasit P. B., me banim në rrethin e Fierit, i cili na shkruante se në dt. 09.06.2006, Shefi i Policisë Kriminale të Rajonit të Policisë Patos kishte shkuar në fshat dhe kishte marrë e shoqëruar në polici djalin e tij 17 vjeç të quajtur G. B.. Shoqërimi i tij ishte bërë në Komisariatin e Policisë Fier. Shkaku i shoqërimit në polici kishte qënë sqarimi i vjedhjes

së një freze motorrike bujqësore, ngjarje e ndodhur para disa muajve. Sipas ankuesit, djali i tij nuk kishte lidhje me këtë vjedhje sepse nuk ishte vjedhës dhe se pesha e mjetit të vjedhur ishte e tillë sa që atë nuk mund t'a merrte e transportonte ai. Mbasi e kanë mbajtur disa orë të shoqëruar, djali ishte lënë i lirë. Pasi ishte lënë i lirë nga policia, ai i kishte thënë të atit se në polici i kishin marrë shënjat e duarëve, e kishin fotografuar, rrahur dhe detyruar që të pranonte vjedhjen e frezës.

Ne i kërkuam shpjegime Komisarariatit të Policisë Fier për të na informuar për shkaqet ligjore të shoqërimit në Polici të shtetasit të mitur G. B., cilët punonjës policie e kishin shoqëruar atë, çfarë veprimesh ligjore kishin kryer, a ishte keqtrajtuar, si dhe në se ishte pyetur në praninë e avokatit mbrojtës dhe të kujdestarit apo psikologut.

Komisariati i Policisë Fier, midis të tjerave, na informoi se shoqërimi në polici i G. B., ishte bërë sepse kishin marrë informacione nga burime konfidenciale se ai ishte autor i mundshëm i vjedhjes së frezës së shtetasit Xh. B.. Shoqërimi i tij ishte bërë nga inspektori i policisë kriminale Sajmir Dervishi dhe inspektori i policisë së zonës Aristir Goga, të cilët e kishin pyetur gojarisht jo me shkrim për të sqaruar rrethanat e vjedhjes së frezës dhe se nuk e kishin keqtrajtuar atë. Sipas përgjigjes, meqënëse ai nuk ishte pyetur me shkrim, as si person që tregon rrethanat e hetimit dhe as si person ndaj të cilit zhvillohen hetime, nuk ishte parë e nevojshme thirrja e avokatit, kujdestarit apo psikologut.

Nga ankesa dhe nga përgjigjia e policisë rezultonte se shtetasi i mitur G. B., ishte shoqëruar në Polici si autorë i mundshëm i vjedhjes së frezës dhe se ndaj atij ishin kryer veprime hetimore. Pretendimi i Policisë, se ai ishte pyetur gojarisht dhe jo me shkrim nga punonjësit e policisë për problemin për të cilin u shoqërua, nuk kishte bazë ligjore. Pyetja e tij pa praninë e prindit, psikologut dhe të mbrojtësit të tij, përbente shkelje të të drejtave kushtetuese të parashikuara në nenin 54 të saj, ku shprehimisht thuhet se:

“Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatëzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti”.

Ky veprim përbën edhe shkelje të të drejtave të të miturve të garantuara nga dispozitat e K.Pr.Penale dhe konkretisht:

a) Nga neni 35, ku parashikohet se:

“Të pandehurit të mitur i sigurohet ndihmë juridike dhe psikologjike, në çdo gjëndje dhe shkallë të procedimit, me praninë e prindit ose të personave të tjerë të kërkuar nga i mituri dhe të pranuar nga autoriteti që procedon.

Organi procedues mund të kryejë veprime dhe të përpilojë akte, për të cilat kërkohet pjesëmarrja e të miturit, pa praninë e personave të treguar në

paragrafin 1, vetëm kur një gjë e tillë është në interes të të miturit ose kur vonesa mund të dëmtojë rëndë procedimin, por gjithmonë në praninë e mbrojtësit”.

b) Nga neni 49/2, ku parashikohet se:

“Kur i pandehuri është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç ose me të meta fizike a psikike që e pengojnë për të realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes, ndihma nga një mbrojtës është e detyrueshme”.

c) Nga neni 296/1, ku parashikohet se:

“Oficerët e policisë gjyqësore marrin të dhëna nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet në praninë e detyrueshme të mbrojtësit të tij. Kur mbrojtësi nuk është gjetur ose nuk është paraqitur, policia gjyqësore kërkon nga prokurori që të caktojë një mbrojtës tjetër”.

ç) Nga neni 361/6, ku parashikohet se:

“Pyetja e dëshmitarëve të mitur mund të bëhet nga kryetari, mbi kërkesat dhe kundërshtimet e palëve. Kryetari mund të ndihmohet nga një familjar i të miturit ose nga një specialist i fushës së edukimit të fëmijëve...”.

Për këto arsye, i rekomanduam Drejtorit të Policisë së Qarkut Fier që t'i jepte masa disiplinore punonjësve të policisë Sajmir Dervishi e Aristir Goga në prezencë të efektivit, me qëllim parandalimin e shkeljeve të kësaj natyre në të ardhmen. Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua.

2. Ankesa e shtetasit Sh. M., i cili na shkruante se djali i tij S. M. ishte arrestuar në dt. 02.01.2006 nga Komisariati i Policisë Nr. 2 Tiranë. Sipas tij, meqënëse djali nuk kishte shkuar atë natë në shtëpi, ai duke qënë i shqetësuar për mosardhjen e tij, ishte interesuar në të gjitha Komisariatet e Policisë Tiranë, duke përfshirë edhe atë Nr. 2. Prej tyre kishte marrë përgjigjen se ai nuk ndodhej në Polici. Megjithëse ankuesi kishte pyetur disa herë në këtë Komisariat, ai është vënë në dijeni për të vërtetën, në orën 17.30-18.00 të dt. 04.01.2006. Gjithashtu, ai na shkruante se gjatë pyetjes në polici, djali ishte keqtrajtuar nga dy punonjës policie të cilët kishin punuar me të, se atij i ishin marrë shpjegime pa praninë e avokatit mbrojtës, dhe se avokati i tij nuk ishte lejuar nga punonjësit e policisë që të takohej me të kur ndodhej në ambjentet e Komisariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë.

Për të bërë të mundur verifikimin e pretendimeve të ankuesit, nga ana jonë u takua djali i ankuesit në Burgun 313 Tiranë. Ai u pyet me shkrim dhe pretendoi për keqtrajtim nga punonjësit e policisë që e kishin pyetur atë, dhe se i ishin marrë shpjegime jashtë vullnetit të tij dhe pa praninë e avokatit. Gjithashtu, u pyetën avokati i tij dhe dy specialistët e policisë kriminale të Komisariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë, Bledar Vejzati dhe Albert Hoxha, të cilët ishin kontaktuar me të arrestuarin në ambjentet e Policisë. Ndërkohë nga ana jonë u këqyrën edhe dokumenta që kishin të bënin me këtë ankesë,

si kartela mjekësore e tij, libri i personave të shoqëruar në polici, regjistri i të ndaluarëve dhe të arrestuarëve, procesverbali i arrestimit në flagrancë, raporti i shërbimit të punonjësve të policisë të Repartit të Shqiponjave, procesverbali për deklaratimet nga persona ndaj të cilit zhvillohen hetime, procesverbali i pyetjes së të pandehurit S. M., etj. Nga verifikimet e bëra, si pyetja e personave të përmendur më sipër dhe këqyrja e dokumentave të përshkruara më lartë, rezultoi se i arrestuari ishte keqtrajtuar nga personat që e kishin kapur atë në tentativë duke iu vjedhur makinën, ndërsa keqtrajtimin e tij nga punonjësit e policisë nuk mundëm ta provonim. Edhe pretendimet e tij, se i ishin marrë shpjegime pa praninë e avokatit dhe për mos lejim të avokatit mbrojtës për takimin me të nuk qëndronin, sepse në polici atij nuk i ishin marrë shpjegime meqënëse kishte kërkuar avokat, dhe se kur ka shkuar avokati në Polici ai ishte dërguar në burg.

Por nga ana jonë u konstatua fakti se shtetasi S. M., megjithëse ishte kapur në flagrancë nga qytetarët duke iu vjedhur automjetin, mbetur në tentativë, ai u mbajt në polici në gjëndje të shoqëruar nga ora 24.00 e dt. 02.01.2005, deri në ora 22.00 e dt. 03.01.2005, kohë në të cilën ishte bërë edhe arrestimi në flagrancë i tij nga specialisti i policisë kriminale Bledar Vejzati. Mbajtja në këtë gjëndje shoqërimi për 22 orë, vjen në kundërshtim të plotë me dispozitat e K.Pr.Penale, neni 251 e vijues të tij. I kapuri në flagrancë, shtetasi S. M., i është dorëzuar policisë nga qytetarët dhe ishte shoqëruar në Komisaratin e Policisë Nr. 2 Tiranë. Specialisti i policisë kriminale Bledar Vejzati duhet të ishte njoftuar nga strukturat e komisarariatit për ngjarjen dhe të përpilonte procesverbalin e kapjes në flagrancë të tij, si dhe dokumentat e tjera të nevojshme menjëherë dhe duhet t'a vinte atë në dispozicion të prokurorit në dhomat e paraburgimit sa më shpejt dhe jo t'a mbante në gjëndje shoqërimi, kur në fakt ai ishte i arrestuar në flagrancë. Mirëpo këtë veprim ai nuk e ka bërë edhe kur ka marrë kontakt me të në orën 10.00 të dt. 03.01.2006. Në të njëjtën kohë, mbajtja e tij në gjëndje shoqërimi për 22 orë vjen në kundërshtim të hapur dhe të plotë edhe me nenin 45 të Ligjit Nr. 8553, dt. 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit".

Për këto arsye, i rekomandua Shefit të Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë që të analizonin shkeljen ligjore dhe të merrte masë disiplinore ndaj specialistit të policisë kriminale Bledar Vejzati, si dhe ndaj punonjësve të tjerë të policisë që nuk kishin kryer detyrat funksionale në këtë rast. Gjithashtu, i rekomandua që masat disiplinore të jepeshin në prezencë të efektivitetit të policisë me qëllim që të parandaloheshin shkelje të tilla në të ardhmen. Rekomandimi u mirëprit dhe specialistit të policisë kriminale Bledar Vejzati iu dha masa disiplinore "vërejtje me paralajmerim".

3. Ankesën e shtetasit V. K., i cili na shkruante se në dt. 16.02.2006, rreth orës 12.00, kishte qënë duke shkuar në pronën e tij, një magazinë e ndodhur tek blloku i magazinave në Tiranë. Sapo kishte shkuar atje, ka parë dy persona që i kishin shkatërruar portën e oborrit të magazinës së tij dhe e kishin hipur në një makinë. Ai iu ka kërkuar atyre që të hiqnin dorë nga shkatërrimi i pronës së tij dhe ta linin portën e hequr. Gjatë kësaj kohe, ai ka njoftuar Komisarriatin e Policisë Nr. 4 Tiranë, i cili mbulon këtë zonë. Brënda pak minutash aty ka ardhur një grup policësh të Komisarriatit të Policisë Nr. 4 Tiranë dhe për sqarimin e problemit të ndodhur e kanë shoqëruar ankuesin dhe një nga personat që dëmtoi pronën e tij në komisarriat. Sapo kanë shkuar në Polici, një punonjës policie iu ka marrë identitetet, ka bërë kontrollin personal, duke iu hequr sendet personale dhe veç personit të akuzuar ka futur në dhomë izolimi edhe personin e dëmtuar, ndonëse ai kishte kërkuar ndihmën e Policisë dhe për rrjedhojë nuk kishte asnjë shkak ligjor të izolohej. Këtë veprim të paligjshëm ai ia kishte paraqitur oficerit të informacionit. Mirëpo punonjësi i policisë i ishte përgjigjur se do të rrinte aty 10 orë, sepse kishte urdhëruar Shefi i Rendit. Ndërkohë personi tjetër ishte lënë i lirë, pa u pyetur për ngjarjen e ndodhur. Rreth orës 15.00, në momentin që ankuesi po fjalosej me oficerin e informacionit, aty ka kaluar Shefi i Komisarriatit z. Ilo Këçka, i cili ka dëgjuar protestën e ankuesit. Ky ka marrë takim me të, duke u vënë në dijeni për gjithshka që kishte ndodhur dhe ka urdhëruar që ankuesi të lihet i lirë. Gjithashtu, ankuesi pretendonte edhe për zvarritjeve të veprimeve proceduriale nga ana e punonjësve të policisë të këtij komisarriati për këtë ngjarje.

Nga verifikimet e bëra, si pyetja e personave që kishin dijeni për këtë problem, si dhe këqyrja e dokumentave që ishin mbajtur nga punonjësit e policisë, rezultoi se pretendimet e ankuesit ishin të drejta. Ai ishte trajtuar jo si denoncues, por sikur të ishte autor i veprës penale dhe se izolimi i tij ishte bërë me urdhër të Shefit të Rendit të këtij komisarriati Agim Basha. Izolimin e tij ai e kishte bërë për shkak se ankuesi kishte guxuar të protestonte për trajtimin e kundërligjshëm që po i bëhej. Gjithashtu, nga ana jonë u konstatua se punonjësit e policisë kriminale Zenel Bejko e Fatos Goxho, të cilët megjithëse morën dijeni për ngjarjen e ndodhur nuk e kishin vlerësuar atë me seriozitet. Ata duhet të kishin marrë masat e nevojshme, duke njoftuar fillimisht në komisarriat që denoncuesi V. K. të mos trajtohej si i shoqëruar, siç u bë në fakt duke iu bërë kontrolli personal, mbyllur me dryn në dhomën e shoqërimit e mbajtur në këtë gjëndje për 2 orë. Në të njëjtën kohë, ata duhet ta kishin vlerësuar më shumë këtë ngjarje dhe të kryenin menjëherë veprimet e nevojshme, si marrjen e kallzimit të denoncuesit,

marrjen e deklarimeve personit të denoncuar N. F., si dhe kryerjen e veprimeve të tjera të nevojshme procedurale. Mbasdite, rreth orës 17.00, në vëndin e ngjarjes (magazinën e të dëmtuarit) kanë shkuar punonjësit e policisë kriminale të përmëndur më sipër dhe kanë marrë kallzimin e ankuesit V. K., si dhe kanë bërë veprimet e tjera procedurale lidhur me ngjarjen e ndodhur. Më pas materialet i janë dërguar Prokurorisë së rrethit Tiranë për ndjekje të mëtejshme.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës rezultoi se Shefi i Rendit dhe i Sigurisë Publike të Komisariatit të Policisë Nr. 4 Tiranë Agim Basha, duke urdhëruar punonjësit e policisë për mbajtjen e ankuesit V. K në gjëndje izolimi për 10 orë, kishte shkelur hapur të drejtën e tij dhe kishte konsumuar elementët e figurës së veprës penale të “Heqjes së paligjshme të lirisë” të parashikuar nga neni 110 i K.Penal. Për këtë veprim të kundërligjshëm, nga ana jonë iu rekomandua Prokurorisë së rrethit Tiranë fillimi i ndjekjes penale ndaj tij. Rekomandimi u mirëprit dhe ndaj tij u fillua ndjekja penale, mirëpo pasi u bënë hetimet ajo padrejtësisht u pushua. Gjithashtu, drejtuesve të Komisariatit të Policisë Nr. 4 Tiranë i rekomanduam dhënien e masave disiplinore punonjësve të policisë kriminale Zenel Bejko dhe Fatos Goxho, të cilët me veprimet neglizhuese të tyre u bënë shkaktarë të shkeljes së të drejtave të ankuesit. Edhe ky rekomandim u mirëprit dhe atyre iu dhanë masa disiplinore.

4. Duke patur parasysh rastet e shumta për moslejimin e avokatëve të takohen me klientët e tyre kur ata arrestohen, ndalohen ose shoqërohen nga Policia, ne përpiluar më datën 10.07.2006 një rekomandim për Policinë e Shtetit, ku kemi shkruar:

Ne vlerësojmë se rivendosja e institutit të avokatisë me Ligjin Nr. 7541, dt. 18.12.1991 “Për Avokatinë në Republikën e Shqipërisë”, është pjesë shumë e rëndësishme e procesit të demokratizimit të vëndit tonë. Ajo përbënte një nga kërkesat dhe arritjet e sistemit tonë demokratik në fushën e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të njohura dhe sanksionuara edhe nga konventat ndërkombëtare. Veçanërisht nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 10 dhjetor 1948, si dhe Konventa Europiane e të drejtave të Njeriut, miratuar nga vëndet e Këshillit të Europës, më 4 nëntor 1950, të cilat janë ratifikuar nga vëndi ynë.

Në nenin 1 të Ligjit të ri, Nr. 9109, dt. 17.07.2003, “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet se: “*Avokatia në Republikën e Shqipërisë është profesion i lirë, i pavarur, i vetërregulluar dhe i vetëdrejtuar*”.

Ndërsa në nenin 2/e të tij, përcaktohet se:
“Avokati jep ndihmë juridike nëpërmjet pranisë si mbrojtës në kohën e shoqërimit, ndalimit, arrestimit, gjatë procesit të hetimit, shqyrtimit gjyqësor të personave në çështjet penale”.

Ne konstauam se moslejimi i avokatit për të qënë i pranishëm gjatë ndalimit ose arrestimit të personit, kur ai kërkohet nga vetë personi i shoqëruar, ndaluar ose arrestuar, apo edhe nga të afërmit e tij, përbën një shkelje të rëndë kushtetuese dhe ligjore për arsye se:

Së pari, shkelet hapur një nga të drejtat themelore të njeriut, e garantuar nga neni 28, pika 1 i Kushtetutes së Republikës së Shqipërisë në të cilin sanksionohet se: *“Kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. Personi, të cilit i është hequr liria, duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin, si dhe t’i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij”.*

Së dyti, shkelet neni 6, pika 3/c i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, ku është parashikuar se: *“Çdo i akuzuar ka të drejtë që të mbrohet vetë ose të ketë ndihmën e një mbrojtësi të zgjidhur prej tij...”*

Se treti, ky qëndrim vjen në kundërshtim edhe me gërmën “e” të nenit 2 të Ligjit Nr. 9109, dt. 17.07.2003, “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”, ku siç cituam edhe më lartë është parashikuar e drejta e avokatit të japë ndihmë juridike nëpërmjet: *“pranisë si mbrojtës në kohën e shoqërimit, ndalimit, arrestimit, gjatë procesit të hetimit, shqyrtimit gjyqësor të personave në çështjet penale”.*

Në të njëjtën kohë përbën edhe shkelje të nenit 7 të po këtij ligji, ku parashikohet se: *“Avokati ka të drejtë të takojë personin e mbrojtur prej tij, në mënyrë private dhe pa kufizim kohor, në çdo gjëndje të kufizimit të lirisë personale. Organet kompetente kanë të drejtë të mbikqyrin takimin ndërmjet avokatit dhe personit të mbrojtur, por, në çdo rast, u ndalohet të dëgjojnë bashkëbisedimin ndërmjet tyre.*

Organi i prokurorisë, gjykata, administrata e burgjeve dhe Policia e Shtetit janë të detyruara të sigurojnë praninë e avokatit, kur këtë e kërkon personi i mbrojtur prej tij, i ndaluar, i arrestuar ose që është duke vuajtur dënimin. Në të gjitha rastet prania e avokatit duhet të sigurohet menjëherë”.

Së katërti, qëndrimi i mësipërm përbën edhe shkelje të dispozitave të K.Pr.Penale dhe konkretisht të nenit 255 të tij, ku janë përcaktuar detyrat e policisë gjyqësore në rastet e arrestimit ose ndalimit të personit. Sipas pikës 1 të këtij neni, *“oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore që kanë kryer një arrestim ose ndalim, ose kanë marrë në dorzim të arrestuarin, njoftojnë*

menjëherë prokurorin e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi. Ata i bëjnë të ditur të arrestuarit ose të ndaluarit se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë, si dhe të drejtën që ka për të zgjedhur një mbrojtës dhe njoftojnë menjëherë mbrojtësin e zgjedhur ose atë të caktuar kryesisht nga prokurori”.

Në bazë të K.Pr.Penale, neni 32, pikat 1/a dhe 2/a, si dhe të nenit 4 të Ligjit Nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, punonjësit e Policisë së Shtetit ushtrojnë edhe atributet e policisë gjyqësore, si oficerë dhe agjentë të policisë gjyqësore. E përmëdim këtë fakt për të vënë theksin, se dispozitat e mësipërme janë të detyrueshme edhe për punonjësit e Policisë së Shtetit kur kryejnë veprime proceduriale të ndalimit ose arrestimit të personit.

Nga dispozitat kushtetuese dhe ligjore të cituara më sipër, del shume qartë detyrimi që kanë punonjësit e policisë gjyqësore për të vënë në dijeni të shoqëruar, të ndaluarin ose të arrestuarin për të mos bërë ndonjë deklaratë, si dhe për t’ia bërë të njohur të drejtën që ai ka për të komunikuar dhe mbrojtur nga avokati. Gjithashtu, në bazë të këtyre dispozitave, në qoftëse personi kërkon të mbrohet nga avokati, punonjësit e policisë gjyqësore kanë detyrimin që të njoftojnë menjëherë avokatin, mbrojtësin e tij dhe t’i japin mundësinë për realizimin e këtyre të drejtave.

Përveç përcaktimeve të dispozitave të mësipërme, është e rëndësishme të theksojmë se detyrimi i punonjësve të Policisë së Shtetit për të lejuar avokatin të marrë pjesë si mbrojtës i personit të shoqëruar, të ndaluar ose arrestuar është sanksionuar shumë qartë dhe pa ekuivoke edhe në Ligjin Nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”. Sipas nenit 45 pika 1 e tij, punonjësi i policisë ka të drejtë të bëjë shoqërimin e personin në zyrat e policisë ose në organin urdhërdhënës, në kushtet dhe rastet e parashikuara nga neni 27 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në pikën 2 të këtij neni kushtetues përcaktohet se: “Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e mëposhtëme:

- a) kur është dënua me burgim nga gjykata kompetente;
- b) për moszbatim të urdhërave të ligjshëm të gjykatës ose për moszbatim të ndonjë detyrimi të caktuar me ligj;
- c) kur ka dyshime të arësyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;
- ç) për mbikqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent;
- d) kur personi është përhapës i një sëmundje ngjitëse, i paafte mënderisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë;

dh) për hyrje të paligjëshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose të ekstradimit”.

Ndërsa në pikën 3 të nenit 45 të Ligjit “Për Policinë e Shtetit” është përcaktuar se: *“Personi i shoqëruar gëzon të gjitha të drejtat e njohura nga neni 28 i Kushtetutës”*. Neni 28 të Kushtetutës e kemi cituar më sipër, por është e rëndësishme të theksohet, se Ligji “Për Policinë e Shtetit” është në përputhje me Kushtetutën, përse i përket zbatimit dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Ai në nenin 3, pikën 1/b të tij ka përcaktuar si detyrë institucionale edhe *mbrojtjen e ushtrimit të lirive dhe të të drejtave të personit*. Gjithashtu, ligji i jep mundësinë e komunikimit dhe të mbrojtjes me avokat edhe personit të shoqëruar në polici ose në organet e tjera urdhërdhënëse. Pra, megjithëse pozita juridike e të shoqëruarit është shumë më e lehtë se ajo e të ndaluarit ose e të arrestuarit, ligji ia jep mundësinë e komunikimit e të mbrojtjes me avokat edhe atij.

Nga interpretimi i pikës 3 të nenit 45 të Ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe referimi që ai bën, në nenin 28 të Kushtetutës, si dhe nga pika “e” e nenit 2 të Ligjit “Për Profesionin e Avokatit të Republikën e Shqipërisë”, kuptohet qartë, *se edhe personi i shoqëruar ka të drejtën ligjitime të komunikojë e të mbrohet nga avokati*.

Për t’i dhënë fund këtij qëndrimi të kundërligjshëm të punonjësve të policisë, i rekomandua Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit që t’u vlerësonte me seriozitet këtë problem dhe të merrte masat e nevojshme në mënyrë të menjëhershme për lejimin e avokatëve që të hyjnë në ambjentet e Policisë për t’u takuar me klientët e tyre që në momentet e para të shoqërimit, të ndalimit ose të arrestimit në flagrancë. Rekomandimi u mirëprit dhe në zbatim të tij, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit nxori dhe i dërgoi strukturave qendrore dhe vendore të Policisë shkresën Nr. 5025/1, dt. 31.07.2006, “Mbi marrjen e masave për garantimin dhe zbatimin e të drejtave të shtetasve për t’u mbrojtur me avokat”.

5. Rasti i filluar me inisjativë, pas bërjes publike në media të shoqërimit në Komisarjatin e Policisë Nr. 1 Tiranë të gazetarit dhe aktivistit të “Mjaft-it” K. P.. Sipas ankuesit, në mesnatën e dt. 27.10.2006, duke qënë i shoqëruar me një mikun e tij dhe duke investiguar problemin e çertifikatave të fallsifikuara, ishte ndaluar nga dy punonjës policie civile në afërsi të ish Hotel Drinit në Tiranë. Ata i kishin kërkuar atyre dokumentat e identifikimit, dhe meqënëse këta nuk i kishin ato, punonjësit e policisë kanë urdhëruar shoqërimin e tyre në Polici. Ai pretendonte, se meqënëse punonjësit e policisë ishin civila, ju kishte kërkuar dokument identifikimi si punonjës policie, por kjo nuk ishte bërë prej punonjësve të policisë. Pas shoqërimit në Polici, atij i ishin marrë gjurmët e duarëve dhe se ishte mbajtur në kushte

shumë të vështira deri në mesditë për 12 orë. Gjithashtu, ai pretendonte se ndaj tij ishte ushtruar dhunë psikike, ndërsa ndaj të shoqëruarëve të tjerë në këtë komisariat ishte ushtruar dhunë fizike.

Nga verifikimet e bëra nga ana jonë, si këqyrja e librit të shoqërimit të shtetasve në këtë komisariat, si dhe pyetja e punonjësve të policisë Renato Ibrahim, Esmer Përmeti dhe Petrit Myslymi, rezultoi se shoqërimi i shtetasit K. P., në Polici ishte kryer konform akteve normative që rregullojnë shoqërimin e shtetasve në Polici. Mirëpo, megjithëse shoqërimi i tij nga specialisti i policisë kriminale Renato Ibrahim u bë për arsye verifikimi sepse nuk kishte dokument identifikimi, nga ana e specialistit të drejtimit në sallën operative të komisariatit, Esmer Permeti, i cili ishte me shërbim atë natë, për 7.5 orë (nga ora 00.30 deri në orën 08.00 të dt. 28.10.2006) nuk u krye asnjë veprim për problemin për të cilin ai u shoqërua në polici. Ndonëse për këtë veprim neglizhues punonjësi i policisë Esmer Përmeti u justifikua me ngarkesën që kishte atë natë për shkak të ngjarjeve që kishin ndodhur në teritorin e komisariatit, ai nuk mund t'i shmangej përgjegjësisë disiplinore për moskryerjen e detyrës funksionale. Ky veprim bie ndesh me nenin 45 të Ligjit Nr. 8553, dt. 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit", me nenin 69/3 të Rregullores së Shërbimeve të Policisë së Shtetit dhe me Letërporosinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 481, dt. 11.08.2005 "Për një kuptim dhe zbatim sa më të drejtë për shoqërimin e shtetasve në organet e policisë".

Për këto arsye, i rekomandua Shefit të Komisarariatit të Policisë Nr. 1 Tiranë që të analizonte këtë shkelje ligjore dhe t'i jepte masë disiplinore punonjësit të policisë Esmer Përmeti në prani të efektivit, me qëllim që të mos përsëriteshin raste të tilla. Gjithashtu i rekomandua, që me punonjësit e policisë të cilët i lidhte detyra me shoqërimin e personave, të bëhej njohja me aktet normative ligjore e nënligjore përkatëse. Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua.

6. Ankesa e shtetasit A. N., me banim në Pukë, i cili na shkruante se ishte pronar i automjetit Benz Mercedes 300, ngjyrë vishnje, me targë TR 8565 H. Në dt. 22.11.2005, ishte ndaluar nga policia rrugore e Tiranës në aksin rrugor Vorë-Fushë Krujë dhe i ishte komunikuar një gjobë e vendosur ndaj tij në dt. 08.08.2005 nga Policia e Pogradecit. Ai pretendonte se kjo gjobë ishte vendosur në mënyre arbitrare, sepse ai dhe automjeti i tij nuk kishin qënë asnjëherë në Pogradec dhe se makinen e tij nuk ja kishte dhënë asnjë personi tjetër në përdorim.

Për të verifikuar pretendimet e ankuesit, ne i kërkuam shpjegime Komisarariatit të Policisë Pogradec në se nga punonjësit e policisë të këtij komisariati i ishte vendosur ndonjë gjobë ankuesit për shkelje të dispozitave

të Kodit Rrugor. Ky komisarati na informoi se makina me targën e cituar më sipër nuk figuronte debitore në rrethin e Pogradecit.

Në bazë të kërkesës tonë, Komisarati i Policisë Rrugore Tiranë na informoi, se Komisarati i Policisë Pogradec i kishte dërguar formularin e debitorëve të gjobave për qarkullimin rrugor për periudhën 25.04-30.08.2005. Në numërin rendor 96 të këtij formulari ishte dërguar si debitor edhe automjeti me targë TR 8565 H, me numër fletë gjobe 1076901, dt. 08.08.2005, me vlerë 1000 lekë. Kështu nga ana e kartotekës së kundërvajtjeve ishte bërë hedhja e kësaj gjobe në kompjuter dhe si rezultat ky mjet ka rezultuar debitor. Nga verifikimi që u bë shkresës së ardhur nga Komisarati i Policisë Pogradec, pas ndërhyrjes tonë, rezultoi se numri i fundit i kësaj targë ishte regjistruar gabim dhe se gjoba në fakt i përkiste automjetit me targë TR 8564 H, i markës Benz, kamion me ngjyrë të bardhë, i cili ishte në pronësi të një shtetasi tjetër.

Në përfundim të verifikimeve të bëra nga ana jonë, nga përgjigjet e Komisarateve të Policisë Pogradec dhe Policisë Rrugore Tiranë, si dhe nga këqyrja e formularit të debitorëve të gjobave për qarkullimin rrugor që u dërgohen rrethëve, ne arritëm në konkluzionin se pretendimet e ankuesit për vendosje gjobe padrejtësisht ishin të drejta. Punonjësit e kartotekës së kundërvajtjeve në Policinë Rrugore Tiranë ishin treguar të pakujdesshëm në administrimin e dokumentacionit përkatës.

Për të rivendosur në vënd të drejtën e shkelur ankuesit A. N., i rekomanduam Shefit të Komisariatit të Policisë Rrugore Tiranë marrjen e masave të nevojshme për njoftimin ankuesit dhe rikthimin e shumës së lekëve të vjela padrejtësisht atij si gjobë administrative. Gjithashtu, i rekomanduam edhe dhënien e masës disiplinore punonjësit të policisë, i cili me veprimet e pakujdesshme të tij ishte bërë shkaktar i shkeljes së të drejtave të ankuesit, si dhe përgjithësimin e shkeljes me qëllim që të mos përsëriteshim raste të tjera të kësaj natyre të shkeljes së të drejtave të shtetasve nga punonjësit e policisë. Rekomandimi u mirëprit dhe u zbatua.

7. Ankesa e shtetasit shqiptaro-bullgar H. N., banues në Tiranë me profesion avokat, i cili ankohej ndaj punonjësve të policisë të Komisariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë, për arsye se kishin shkelur rregullat për shoqërimin e tij mbi bazën e urdhërit të shoqërimit të lëshuar nga Prokuroria e rrethit Tiranë, si dhe kishin kryer veprime të kundërligjshme ndaj tij. Sipas ankuesit, më datën 27.02.2006, rreth orës 06.00, i kane shkuar në shtëpi një grup policësh dhe në mënyrë të vazhdueshme i kanë rënë ziles së citofonisë së apartamentit të tij. Ankuesi ka zbritur poshtë dhe ka parë pesë policë së bashku me komandantin e tyre, të cilët i kanë thënë se ishin grupi i gatshëm i Komisariatit të Policisë Nr. 2 dhe sipas tyre kishin urdhër për shoqërimin e

tij me forcë në orën 09.00 në Prokurroi, mbasi nuk ishte paraqitur atje, megjithë fletë thirrjet e dërguara nga ai organ.

Ankuesi i është prezantuar punonjësve të policisë se ishte avokat dhe i ka sqaruar se nuk kishte asnjë njoftim për t'u paraqitur në Prokurori, si dhe nuk ishte i pandehur që Policia të sillej në atë mënyrë. Pastaj ai iu thotë që të shkonte në banesë e të vishej dhe meqënëse kishte mjetin e tij privat të vinte me të pas mjetit të Policisë. Punonjësit e policisë nuk e morën në konsideratë kërkesën e tij korrekte, por përkundrazi e kanë kapur nga të dy duart duke e goditur në kokë e kurriz dhe me forcë e kanë futur në furgonin e Policisë. Këto veprime janë kryer në prani të familjarëve të tij, si dhe personave të tjerë komshij të atij pallati, të cilët pasi dëgjuan zhurmën e shkaktuar nga punonjësit e policisë, dolën poshtë të shqetësuar. Pasi e kanë shoqëruar në Komisaratin e Policisë, punonjësit e policisë i kanë thënë që të dorëzonte çfarë kishte me vete duke përfshirë dhe celularin, të hiqte dhe kollaren megjithë sqarimin e tij se sjelljet e tyre ishin të kundërligjshme. Në dhomën e shoqërimit ai është mbajtur deri në orën 08.50 dhe nga këtu e kanë çuar në Prokurorinë e rrethit tek Prokurori K. B.

Nga shqyrtimi dhe analizimi në tërësi i ankesës dhe i sjelljes së punonjësve të policisë, rezultoi se prej tyre ishin shkelur rregullat e shoqërimit të personave në Polici sepse:

a) Sjellja e punonjësve të policisë, duke filluar nga shkuarja në banesën e ankuesit, thirrjet me zë të lartë, rënien në mënyrë vazhduese të ziles së citofonit, moslejimi për ardhjen e tij me mjetin e tij, janë kryer në kundërshtim me nenin 2 të Ligjit Nr.8291 datë 25.2.1998, “Kodi Etik i Policisë”.

b) Përdorimi i forcës për shoqërimin e tij, në kushtet kur ai nuk kundërshtoi shkuarjen në polici, përkundrazi i sqaroi punonjësit e policisë se nuk ishte person i marrë në përgjegjësi penale, nuk kishte marrë njoftim për t'u paraqitur në organin e Prokurorisë, fakt ky i cili rezultoi se ishte i vërtetë, vjen në kundërshtim me nenet 27 e 46 të Ligjit Nr. 8553 datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe nenin 64 të Rregullores së Shërbimeve të Policisë” miratuar me urdhërin e Ministrit të Rendit Publik Nr. 1749 datë 29.07.2005.

c) Dhuna punonjësve të policisë Arben Eshja dhe Shkëlzen Hasandoçi ndaj ankuesit, duke e goditur në kurriz e kokë, vjen në kundërshtim të plotë me nenin 25 të Kushtetutës dhe aktet normative ligjore e nëligjore të Policisë së Shtetit.

ç) Punonjësit e policisë nuk i ishin përmbajtur me korrektësi urdhërit të shoqërimit të lëshuar nga Prokurori z. Koli Bele. Sipas tij, detyra e punonjësve të policisë ka qënë shoqërimi i ankuesit në Prokurorinë e rrethit

Tiranë në orën 0.9.00. Pra, nuk kishte asnjë arësye që personi i shoqëruar të mbahej prej disa orësh në dhomën e shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë, por ishin të gjitha mundësitë që ai të çohet në Prokurori sipas urdhërit.

Për këto arësye, i rekomandua Shefit të Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë që të analizonte këtë rast dhe punonjësve të policisë Arben Eshja dhe Shkëlzen Hasandoçi t'u jepeshin masa disiplinore. Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua.

8. Rasti i filluar me inisjativë dhe më pas, njoftimit dhe shqetësimit të ngritur edhe nga Zyra Ligjore e O.S.B.E-së Tiranë, lidhur me arrestimin e shtetasve homoseksualë N. A., F. M., B. L., F. H. dhe F. D..

Nga shqyrtimi i këtij rasti dhe nga materialet e grumbulluara si, marrja e deklarime të hollësishme personave të sipërpërmëndur dhe nga informacioni i dërguar nga Drejtoria e Policisë dhe Prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë rezultoi se:

Shtetasi N. A., ishte Kryetar i Shoqatës “Gay Albania”, themeluar më vendim të Gjykatës së rrethit Tiranë qysh në vitin 1995. Shqetësimi i tij dhe personave të tjerë të sipërpërmëndur, konsistonte në faktin se nga ana e punonjësve të policisë që kishin kryer arrestimin e tyre prapa Pallatit të Kulturës tek vëndi i quajtur “*Gropa e Hajdin Sejdisë*”, më datën 16 gusht 2006 ishin kryer veprime që vijnë ndesh me të drejtat dhe liritë themelore të garantuara nga Kushtetuta e Republikës të Shqipërisë, duke filluar nga përdorimi i fjalëve fyese, vendosjen e tyre në një dhomë paraburgimi në mjediset e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, me persona të tjerë, të cilët i kanë keqtrajtuar dhe fyer ata. Sipas tyre, në momentin e marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore u është kërkuar dhe sugjeruar të firmosnin për arrestimin e tyre në flagrancë duke i akuzuar se ishin kapur në kryerje e sipër të veprave penale. Gjatë kohës së qëndrimit në dhomat e paraburgimit në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, nga ana e punonjësve të policisë janë shprehur shënja diskriminimi e racizmi në trajtimin e të arrestuarëve për faktin se ata janë homoseksualë, veprime këto që bihen ndesh me nenin 28, pika 5, e Kushtetutës sonë, ku thuhet se: “*Çdo person, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij*”, si dhe nenit 14 të Konventës Europiane për të drejtat Njeriut”, i cili bën fjalë për ndalimin e diskriminimit. Ndaj të arrestuarëve nuk ishte bërë asnjë trajtim etik, por përkundrazi janë demonstruar sjellje jo korrekte dhe diskriminuese deri në shoqërimin e tyre në gjykatë për caktimin e masës së sigurimit me doreza, fakt i cili është transmetuar në mediat elektronike së bashku dhe me informacione personale lidhur me gjëndjen shëndetësore të pandehurve.

Në përgjigjen e dërguar nga Policia, fakti i nxjerrjes në median elektronike të fotografive dhe të emrave të të arrestuarëve, argumentohet me nenin 57 të Ligjit Nr. 8553 datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, marrëdhëniet me publikun, si dhe me nenin 103 të Kodit të Proçedurës Penale.

Në fakt neni 103 i Kodit të Proçedurës Penale dhe konkretisht pika 4 e tij, ndalon publikimin e gjeneraliteteve dhe fotografive të të pandehurëve dhe është gjykata ajo që mund të lejojë publikimin vetëm kur e kërkojnë interesat e të miturit ose kur i mituri ka mbushur moshën 16 vjeç.

Gjithashtu, kryerja e veprimeve të mësipërme nuk bazohej në asnjë prej pikave të nenit 57 të Ligjit Nr. 8553 datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, përkundrazi pika 3 e këtij neni ndalon Policinë që në njoftimet publike të cënojë dinjitetin e personit, sidomos të të miturit.

Duke analizuar në tërësi ankesat e të arrestuarëve dhe nga hetimi i rastit arritëm në konkluzionin se ato qëndronin. Nga ana e punonjësve të policisë nuk kuptohet e zbatohet në praktikë e drejta për të mos u privuar nga liria në mënyrë arbitrare sepse është një e drejtë themelore e shprehur në të gjitha dokumentat kryesore të të drejtave të njeriut si, Kushtetutën tonë, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën Europiane për të drejtat Njeriut” etj.. Nuk kuptohet koncepti kryesor, se liria personale është e lidhur ngushtë me dinjitetin njerëzor dhe është një parakusht për të gëzuar liritë dhe të drejtat e tjera të njeriut.

Për këto arsye, i rekomanduam Drejtorit të Policisë të Qarkut Tiranë që rastin konkret t’u analizonte dhe të merrte masat e nevojshme me qëllim zbatimin korrekt të dispozitave proçeduriale për arrestimin e personave që kanë kryer vepra penale. Gjithashtu i rekomanduam, që ky rast të përgjithësohet me efektivat e punonjësve të policisë gjyqësore të Drejtorisë së Policisë së Qarkut. Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua.

9. Rasti i filluar me inisjativë, pas konstatimit gjatë inspektimit që u bë personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar, në mjediset dhe dhomat e paraburgimit të Komisarariatit të Policisë Krujë. Nga grupi i inspektimit u konstatua se në këtë komisarariat ishin disa persona të arrestuar me probleme shëndetësore të dukshme dhe konkretisht:

Shtetasi Sh. B., i cili vuante nga bronkopneumonia dhe qëndrimi i tij në ato mjedise ishte me pasoja për shëndetin e tij.

Shtetasi G. L., i cili kishte dhimbje dhëmballe e nofulle (në nofull ai kishte të montuar një hekur si rezultat i aksidentit të bërë) dhe megjithë medikamentet e marra nuk kishte asnjë përmirësim për një periudhë kohore prej 8 muajsh. Përkeqësimi i gjëndjes së tij shëndetësore kërkonte ndërhyrje kirurgjikale të specializuar.

Shtetasi R. P., i cili vuante nga veshkat dhe ndonëse ishte çuar për vizitë në spitalin e qytetit të Krujës, nuk kishte asnjë përmirësim. Personi dispononte edhe epikrizën për këtë sëmundje dhe duke patur kriza të herëpashershme të veshkave kishte kërkuar vizitë tek mjeku specialist urolog deri në kryerjen e operacionit, por nuk ishte realizuar.

Shtetasi M. K., i cili vuante nga sëmundja e epilepsisë dhe megjithë rekomandimin e mjekut neurolog të spitalit të Krujës për t'u vizituar në spitalin e Tiranës, një veprim i tillë nuk është realizuar.

Shtetasi N. Ç., i cili ishte i operuar nga zorra e trashë, por kishte dhimbje nga njëra këmbë dhe pretendonte se mjekët e spitalit të Krujës gjatë vizitës nuk kishin treguar kujdesin e duhur dhe nuk i kishin dhënë rekomandim për vizitë në spitalin e Tiranës.

Me qëllim verifikimin e ankesave e të arrestuarve, u komunikua me Shefin e Komisarariatit të Policisë Krujë z. Arian Bozhaj, i cili na informoi se ishte në dijeni të ankesave të paraburgosurve dhe sipas rastit personat e sëmurë ishin çuar për vizitë në spitalin e Krujës. Për të paraburgosurin Sh. B., nga ana e Komisarariatit të Policisë Krujë, i ishte kërkuar Drejtorisë së Policisë së Rendit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë Tiranë, ndërhyrja për dërgimin e tij në spitalin e Burgut Tiranë. Kjo kërkesë i ishte dërguar dhe Prokurorisë së rrethit gjyqësor Krujë. Nga ana e Drejtorisë së Policisë së Rendit ishte kthyer përgjigje verbale, se në spitalin e burgut Tiranë nuk kishte vënd për të paraburgosurin Sh. B..

Në nenin 29 të Ligjit Nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i cili bën fjalë për shërbimin shëndetësor, ndërmjet të tjerave thuhet se: “*Administrata e Institucionit siguron kushtet, mjetet dhe personelin për mbrojtjen e shëndetit të të dënuarve. Organizimi dhe realizimi i shërbimit shëndetësor bëhet nga administrata e insitucionit në bashkëpunim me spitalin e burgjeve, dhe me organet shtetërore kompetente të shëndetësisë*”.

Në nenin 75 të ligjit të sipërpërmëndur thuhet se: “*Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj të arrestuarve dhe të ndaluarve, duke respektuar kufizimet e vendosura për t'a me ligje të tjera*”.

Në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve miratuar me vendimin Nr. 96, datë 09.03.2000 të Këshillit të Ministrave dhe konkretisht në Kreun e VII-të neni 30, paragrafi i dytë, thuhet se: “*Shërbimi shëndetësor duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë të dënuarve që lidhet me shëndetin e tyre dhe në mënyrë periodike duhet të ushtrojë kryesisht kontrolle mjekësore për të parë gjëndjen e përgjithshme dhe veçanërisht atë psikike*”.

Nga inspektimi i kryer rezultoi se shtetasit e mësipërm kishin probleme të rënda me shëndetin. Nga ana e drejtuesve të Komisarariatit të

Policisë së Krujës njëhej gjëndja dhe ishin kryer veprimet e nevojshme për vizita e mjekime të tyre në spitalin e Krujës. Vetëm për të dënuarin Sh. B., ishte konkluduar për dërgimin e tij në spitalin e Burgut Tiranë, veprim i cili megjithë përpjekjet e tyre nuk ishte realizuar për mungesë vëndi në atë spital.

Ne gjykuam se mbajtja e të arrestuarve me probleme shëndetësore në mjedise jo të përshtatshme, siç ishin dhomat e paraburgimit në Krujë dhe koha e gjatë e qëndrimit të tyre në ato mjedise, jo vetëm sillnin pasoja serioze për shëndetin e tyre, por përbënin edhe shkelje të Ligjit Nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, si dhe të akteve të tjera nënligjore për sistemin e burgjeve. Prandaj ishte e domosdoshme kryerja e vizitave të tyre me komision mjekësh, të cilët do të shikonin gjëndjen në fakt të të sëmurëve dhe mbi këtë bazë do të konkludonin për masat e marra me qëllim përmirësimin e shëndetit të tyre. Ngritja e komisionit të mjekëve duhet të ishte një detyrë imediate, dhe se ishte në kompetencën e mjekëve specialistë që pas vizitës për secilin nga të paraburgosurit e arrestuar të bënin diagnostikimin dhe mjekimin e të sëmurëve.

Për këto arsye, i rekomandua Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve që të merrnin masat e nevojshme mjekësore me qëllim diagnostikimin dhe sipas rastit, dërgimin në spitalin e burgut të paraburgosurve të sëmurë që ndodheshin në mjediset e dhomave të paraburgimit të Komisarariatit të Policisë Krujë. Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua.

10. Ankesa e shtetasit A.N. nga Tirana, i cili na shkruante se, në dt. 20.05.2006, ka shkuar ne Komisarariatin e Policisë Nr. 6, Tiranë dhe ka bërë kallzim për një komshije, e cila kishte fyer e kërcënuar nënën e tij. Pasi ka bërë kallzim me shkrim, punonjësi i policisë Përparim Zenuni e ka marrë dhe futur në dhomën e izolimit dhe më pas e ka mbyllur me çelës. Ankuesi ka kërkuar arsyen e izolimit, por punonjësi i policisë nuk i ka dhënë asnjë përgjigje. Ankuesi ka qëndruar i izoluar 3-orë e gjysëm deri në orën 21.30 të datës 20.05.2006. Kur e kanë futur në izolim, i kanë bërë kontroll personal dhe i kanë hequr të gjitha sendet personale përfshirë rripin dhe lidhëset e këpucëve.

Të nesërmen rreth orës 18.30, kur ankuesi ka qënë duke punuar në dyqanin e tij, tek ai ka shkuar punonjësi i Policisë Përparim Zenuni dhe në bisedë me të ankuesi i ka thënë se dje e kishte izoluar padrejtësisht. Punonjësi i Policisë i është përgjigjur se do t’a fuste prapë brënda dhe menjëherë njoftoi furgonin e policisë, i cili erdhi për pesë minuta duke e shoqëruar në Polici së bashku me vëllain e tij SH.N.. Në komisarariat, i kanë

futur në izolim në dhoma të ndara secili më vete, deri në orën 03.00 të ditës tjetër. Pas dy orësh, Policia ka shoqëruar dhe dy punëtorët e lokalit të ankuesit, shtetasit F.K. dhe G.Z., ky i fundit u mbajt i izoluar deri në orën 03.00. Gjatë kësaj kohe janë dërguar në Drejtorinë e Policisë Tiranë, ku u janë marrë gjurmët e gishtave, si dhe janë fotografuar.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese rezultoi se, shoqërimi në Polici i ankuesit dhe i personave të tjerë që punonin me të dhe trajtimi i tyre ishte i kundërligjshëm dhe vinte në kundërshtim të plotë me nenin 27 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 45 të Ligjit 8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”.

Për këto arsye, i rekomandua Drejtorisë së Policisë Qarkut Tiranë që ky rast të analizohet me përgjegjësi dhe punonjësit të policisë Përparim Zenuni t’i jepej masë disiplinore. Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua.

III. Ankesat për largime nga puna të punonjësve të Ministrisë së Brendëshme dhe të Policisë së Shtetit, si dhe ankesat për mos respektimin e të drejtave të tyre.

Në Institucionin tonë kanë paraqitur ankesa 26 oficerë, policë dhe punonjës të tjerë të strukturave mbështetëse të Ministrisë së Brendëshme për largime nga puna apo transferime të padrejta. Sipas tyre, motivacioni dhe shkaqet ligjore të largimit nga puna nuk kanë qënë të bazuara, si dhe nuk janë thirrur e dëgjuar sipas procedurave përkatëse kur ju janë dhënë masat disiplinore. Ndërsa në disa raste të tjera atyre ju atribuohen motivacione të pavërteta, subjektive dhe denigruese.

Gjatë viteve të fundit nga autoritetet e ish M.R.Publik, Ministrisë së Brendëshme dhe të Policisë së Shtetit është propaganduar kryerja e reformës në Polici. Mirëpo, në fakt nga krerët e tyre nuk janë përshtuar e publikuar kriteret ligjore të saj, nuk ka patur transparencë dhe objektivitet gjatë këtij procesi të rëndësishëm për të pastruar radhët e Policisë nga të pa aftët dhe të korrupuarit. Edhe kur është folur për kritere profesionale dhe rezultate në punë si kritere bazë për bërjen e reformës, ato kanë mbetur një farsë dhe në realitet nuk janë zbatuar. Në emër të reformës apo “luftës kundër korrupsionit, apo për të vendosur rend brenda rendit”, figura të rëndësishme të Policisë së Shtetit, si drejtorë apo shefa komisariati janë shkarkuar nga detyra, përjashtuar ose liruar nga policia. Ky fenomen, për veç pasojave negative që iu sjell të ndëshkuarëve, duke iu ndërprerë marrëdhëniet e punës, sjellë në të njëjtën kohë edhe pasoja morale dhe humbjen e besimit të publikut ndaj këtyre organeve. Gjithashtu, ai i shkakton edhe një dëm të konsiderueshëm ekonomik buxhetit të shtetit në përgjithësi dhe buxhetit të

vetë këtyre organeve në veçanti. Krerëve të Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë duhet t'ju tërheq vëmëndjen fakti, se shumë nga të përjashtuarit nga Policia, kanë fituar të drejtën e dëmshpërblimit në rrugë gjyqësore për përjashtim të padrejtë nga Policia. Edhe ky fakt është një tregues real, se përjashtimet e bëra për shumë punonjës policie nuk kanë qënë të motivuara dhe të bazuara në ligj e në prova. Shkarkimet nga detyra të drejtuesve të Policisë pa mbushur disa muaj në vëndin e punës nuk mund të ndikojnë në rritjen e besimit publik ndaj Policisë. Edhe në se ato bëhen të drejta për shkak të shkeljeve ligjore apo të Kodit Etik, përseri ka vënd për kritika, sepse personat e tillë nuk janë studjuar mirë para emërimit në detyrë. Gjithashtu, kjo është edhe një tregues i faktit se emërimet në detyra të punonjësve të policisë nuk bëhen gjithmonë mbi bazë të kriterëve ligjore, profesionale e morale njëkohësisht, por mbi baza njohjesh personale, përkatësive politike dhe për interesa të ngushta. Ky fenomen është bërë shumë i ndjeshëm kohët e fundit, ku numri i punonjësve të policisë të larguar nga puna për shkak të “reformës” është rritur shumë.

Si shëmbuj të zgjidhjes pozitive në favor të ankuesve mund të përmëndim:

1. Ankesa e shtetasit V. T., ish punonjës policie në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Fier. Ai na shkruante se kishte shërbyer në strukturat e Policisë së Shtetit për 21 vjet deri në datën 18.10.2005. Gjatë kësaj periudhe kohore puna e tij ishte vlerësuar e mirë dhe nuk kishte marrë asnjë masë disiplinore. Me Urdhër të Drejtorit të Policisë së Qarkut Fier Nr. 2412, dt. 18.10.2005, ishte përjashtuar nga Policia e Shtetit me motivacionin “Për shkelje me dashje të normave të detyrës me qëllim përfitimi vetjak, duke abuzuar me detyrën dhe mirëbesimin e publikut”. Shkak për përjashtimin e tij nga Policia ishte bërë një kontroll i ushtruar nga punonjësit e SHKB-së së Ministrisë së Brendshme në datën 9 Tetor 2005, ku pretendohet se punonjësit e Policisë Rrugore kishin marrë para nga drejtuesit e automjeteve. Sipas ankuesit, urdhëri i përjashtimit të tij nga Policia ishte i padrejtë dhe i pabazuar në Ligj, sepse në datën 9 Tetor 2005, për të cilën pretendohet se ai kishte abuzuar me detyrën, ai nuk ka qënë në punë, por ka qënë me leje. Faktin që ai në këtë datë nuk ka qënë në punë por ka qënë me leje e provoi eprori i tij, kryeinspektori Ylli Kondi, i cili në dt. 20.10.2005, i kishte bërë një informacion për këtë fakt Drejtorit të Policisë së Qarkut Fier (fotokopja e tij na ishte dërguar së bashku me ankesën edhe neve). Këtë fakt ai e provonte edhe me deklaratën noteriale të bërë nga dy koleget e tij Z. Ç. dhe K. I. (një kopje origjinale të saj na e kishte dërguar neve). Përveç fakteve të cituara më lartë, ai pretendonte se nuk kishte dalë në asnjë nga sekuencat filmike të dhëna nga disa TV me këtë rast. Pas përjashtimit, ai i kishte bërë ankesë në

Komisionin Qëndror të Disiplinës së Policisë së Shtetit, të cilit i kishte dërguar edhe provat e përshkruara më sipër, por akoma nuk kishte marrë përgjigje për shqyrtimin dhe vendimin e tij.

Për verifikimin e kësaj ankese, i kërkuam shpjegime Drejtorisë së Policisë të Qarkut Fier. Kjo drejtori na informoi se ankuesi kishte patur rezultate të mira në punë, nuk kishte marrë asnjë masë disiplinore dhe se ishte përjashtuar nga Policia në bazë të shkresës së Zv/Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për Menaxhimin e Burimeve, Ndhmës dhe Mbështetjes Nr. 2336, dt. 17.10.2005. Bashkë me shpjegimet na dërguar edhe fotokopje të kësaj shkrese. Nga përmbajtja e shkresës dhe nga takimi që u bë me Zv/Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, rezultoi se ai e kishte lëshuar shkresën e mësipërme, në bazë të shkresës Nr. 672, dt. 14.10.2005, të Shërbimit të Kontrollit të Brëndshëm. Nga verifikimi që bëmë në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Fier, përveç fakteve që na shkruante ankuesi, konstatoam se ai nuk ishte thirrur e dëgjuar nga komisioni i disiplinës para dhënies së masës disiplinore, duke shkelur pikën “b”, rregulli 13 të Rregullores së Disiplinës, ku shprehimisht thuhet se: *“Shkelja dhe njoftimi për raportin e hartuar i komunikohet shkelësit me shkrim nga autoriteti disiplinor, duke i kërkuar të japë justifikimet e veta”*.

Gjithashtu, Komisioni Qëndror i Disiplinës na informoi se e kishte konsideruar të padrejtë përjashtimin e ankuesit nga Policia dhe i kishte propozuar Drejtorit të Policisë së Qarkut Fier rishikimin e masës së dhënë.

Nga ana jonë u pa edhe filmi i bërë nga SHKB-ja, nëpërmjet të cilit provohej marja e parave nga punonjësit e tjerë të policisë rrugore dhe nuk rezultoi që ankuesi të ishte i filmuar. Pra ankuesi kishte të drejtë.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese dhe nga provat e mbledhura nga ana jonë, arritëm në konkluzionin se punonjësi i policisë V. T., ishte përjashtuar padrejtësisht nga Policia e Shtetit, dhe nga strukturat përkatëse ishin shkelur procedurat ligjore në dhënien e masës disiplinore. Me këtë veprim të paligjshëm dhe të pabazuar, atij i ishin shkelur edhe të drejtat financiare e morale njëkohsisht.

Për të rivendosur në vënd të drejtën e shkelur ankuesit V. T., i rekomanduam Drejtorit të Policisë së Qarkut Fier që të merrte masat e nevojshme për rikthimin sa më shpejtë në Policinë e Shtetit dhe në detyrën e mëparshme të ankuesit. T’i jepeshin atij të gjitha pagat mujore për kohën e qëndrimit padrejtësisht pa punë për shkak të aktit administrativ të paligjshëm. Për dëmin e shkaktuar në këtë rast të aplikohet përgjegjësia vetjake e punonjësve të organeve të administratës shtetërore, e cila është parashikuar në nenin 4 të Ligjit Nr. 8510, datë 15.07.1999 *“Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”*. Në paragrafin e

dytë të këtij neni parashikohet se: *“Punonjësit e organeve të administratës shtetërore, përjashtimisht, përgjigjen për dëmet që u shkaktajnë personave fizik a juridik privatë, kur vërtetohet se ata kanë vepruar me keqbesim”*. Ndërsa në paragrafin e tretë të nenit 4 të këtij Ligji parashikohet: *“Në rastet e parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, organi shtetëror punëdhënës, pasi dëmshpërblen palën e dëmtuar, ka të drejtë të kërkojë nga punonjësi fajtor kthimin e dëmshpërblimit që ka paguar”*. Gjithashtu, i rekomanduam edhe të mospërsëriten rasteve të tjera të kësaj natyre të shkeljeve të të drejtave të punonjësve të policisë.

Në përgjigjen që na ktheu Drejtori i Policisë së Qarkut Fier, na informoi se në strukturën organike në rolin bazë në Nënseksionin e Policisë Rrugore nuk kishte vende bosh, pasi vendet vakant të krijuara me përjashtimin nga policia të ankuesit dhe disa të tjerëve ishin zëvendësuar dhe me krijimin e vendeve bosh do të ripranonte V. T..

Nga përgjigjia rezultonte se ai nuk e kishte kuptuar thelbin e rekomandimit tonë dhe se nuk e kishte të qartë parimin themelor të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të individit në shtetin ligjor dhe në shoqërinë demokratike. Cilitdo që i shkelet padrejtësisht një e drejtë, siç ishte edhe rasti i ankuesit, menjëherë sapo konstatohet padrejtësia e bërë, duhen marrë masa për rivendosjen në vend të saj duke e rehabilituar individin.

Për këtë arsye ia përsëritëm rekomandimin tonë, duke i bërë të ditur se përjashtimi i padrejtë nga policia i ankuesit përbënte një shkelje të rëndë të të drejtave të tij të garantuara nga Kushtetuta dhe Ligji. Nga ky veprim i kundërligjshëm, atij i ishte shkaktuar një dëm i konsiderueshëm ekonomik e moral njëkohsisht. Për të qënë korrekt me aktet normative në fuqi, atij përveç sa kishim rekomanduar ne, i takonte edhe dëmshpërblimi moral. Qëndrimi që po mbahej ndaj tij, pas rekomandimit tonë, jo vetëm që përlligjte shkeljen e të drejtave të punonjësve të policisë nga drejtuesit e saj vendorë, por ai vinte në kundërshtim të plotë dhe të hapur edhe me nenin 44 të Kushtetutes tonë, ku përcaktohet se: *“Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose zhdëmtohet në përputhje me Ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore”*.

Sipas fjalorit të shqipes së sotme, botim i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë i vitit 1984, faqe 1015, *“rehabilitim d.m.th. t'i kthesh dikujt zyrtarisht të drejtat që i ka humbur ose që i janë hequr gabimisht; t'i kthesh ose t'i vesh përsëri në vend dikujt emrin e mirë ose nderin që i ishte përlyer”*.

Gjithashtu, i bëmë me dije, se vonesa në rikthimin ankuesit në vendin e punës rriste detyrimet financiare ndaj tij, që në fund të fundit edhe nëqoftëse nuk do t'ia jepnin në rrugë administrative, ai kishte të drejtën e marrjes së tyre në rrugë gjyqësore.

Fakti që vendi i tij i punës ishte i zënë, nuk përbënte shkak ligjor për të mos e rikthyer atë, por vetëm një justifikim i pambështetur në ligj. Në këtë rast, në se do të mbahej një qëndrim korrekt, zgjidhja duhej bërë duke e rikthyer në vendin e punës ku kishte qënë më parë punonjësin e policisë i cili ishte emëruar në vendin e ankuesit. E drejta për të revokuar aktet administrative (urdhërat) e nxjerja në të dy rastet, si për përjashtimin nga policia të ankuesit, ashtu edhe atë të transferimit të punonjësit të policisë që e kishte zëvendësuar ankuesin, është një e drejtë ligjore që bazohet në nenet 121 e 124 të Kodit të Proçedurave Administrative. Por edhe rekomandimin e përsëritur Drejtori i Policisë së Qarkut Fier nuk e zbatoi.

Pas këtij qëndrimi antiligjor të tij, i bëmë rekomandim Ministrin të Brendshëm, të cilit përveç sa sipër i kërkuam që t'i jepte masa disiplinore personave përgjegjës që kishin kryer shkeljet ligjore në rastin e përjashtimit nga Policia të ankuesit dhe ndaj atyre që me qëndrimet mosvepruese po vazhdonin shkeljen e të drejtave të tij. Gjithashtu, i rekomanduam që kjo shkelje të përgjithësohej në të gjithë efektivat e Policisë së Shtetit, me qëllim që të mos përsëriteshin raste të tjera të kësaj natyre të shkeljeve të të drejtave të punonjësve të policisë. Rekomandimi u mirëprit, ankuesi u rikthye në vendin e punës, Drejtorit të Policisë së Qarkut Fier Benard Caushaj iu tërhoq vëmëndja dhe rasti u përgjithësua. Ndërsa padrejtësisht dëmshpërblimi i tij financiar nuk u bë. Për të realizuar këtë të drejtë ligjore i sugjeruam ankuesit që të ngrinte padi në gjykatë.

2. Ankesa e shtetases K.H., me banim në qytetin e Lezhës, ish efektive e Drejtorisë së Policisë Qarkut Lezhë, e cila ankohej për largim të padrejtë nga radhët e Policisë. Ankuesja kishte qënë me detyrë sekretare-protokolliste-operatore në Komisarjatin e Policisë Lezhë. Në datën 20.11.2006, i ishte komunikuar verbalisht urdhëri i largimit nga Policia e Shtetit, pa i shpjeguar arsyen, shkaqet, si dhe motivacionin e largimit. Sipas saj, largimi ishte i padrejtë, në kundërshtim me ligjin, pasi ajo nuk kishte kryer shkelje disiplinore, vendi i saj i punës nuk kishte pësuar shkurtim organik dhe se ajo ishte zëvendësuar nga një person tjetër. Gjatë punës së saj në Polici ajo ishte vlerësuar pozitivisht dhe nuk kishte marë asnjë masë disiplinore.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese arritëm në konkluzionin se largimi i ankueses nga puna ishte i pabazuar dhe i kundërligjshëm. Për këto

arsye, i rekomanduam Drejtorit të Policisë së Qarkut Lezhë që të ripranonte ankuesen në strukturat e Policisë. Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua.

3. Ankesa e shtetases A.B. me banim në qytetin e Tiranës, ish punonjëse policie e rolit bazë, me gradën “agjente”, me detyre trup shërbimi në sigurimin e objekteve, në repartin e autopatrullave, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë. Sipas saj, më datën 14.04.2006, i kanë komunikuar urdhërin për përjashtim nga radhët e Policisë së Shtetit, pa i dhënë shpjegime dhe pa i vënë në dispozicion urdhërin e përjashtimit nga Policia. Ndërsa verbalisht i është thënë, se përjashtimi i saj ishte bërë sepse ishte e mbesa e dy personave me aktivitet kriminal, të cilët ishin shpallur në kërkim nga organet e drejtësisë për veprën penale të vrasjes.

Nga përgjigja e Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë, u informuam se ankuesja ishte larguar nga Policia sepse “ishte marrë në kundërshtim me kriteret ligjore, pasi nuk kishte plotësuar moshën 18 vjeç në momentin e fillimit të punës. Gjithashtu, një tjetër shkak ligjor për largimin e saj nga Policia ishte edhe fakti se ajo ishte e mbesa e dy personave me aktivitet kriminal, të cilët ishin shpallur në kërkim nga organet e drejtësisë për veprën penale të vrasjes”.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese si dhe nga provat e mbledhura nga ana e jonë, arritëm në konkluzionin se ankuesja A.B. ishte përjashtuar padrejtësisht nga Policia e Shtetit sepse:

Së pari, ky veprim binte ndesh me nenin 15 dhe 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sepse bënte diskriminimin e saj për shkak të lidhjes së gjinisë së saj me dy personat në kërkim.

Së dyti, në momentin që është nxjerë urdhëri për përjashtimin e saj nga radhët e Policisë, ajo i kishte fituar të gjitha të drejtat e parashikuara në nenin 16 të Ligjit Nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, pra edhe moshën.

Së treti, ishin shkelur procedurat ligjore në dhënien e masës disiplinore, sepse nuk ishte thirrur e dëgjuar dhe nuk i ishte dhënë kopje e urdhërit të përjashtimit.

Për të rivendosur në vënd të drejtën e shkelur ankueses A.B, i rekomanduam Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë që të merrte masat e nevojshme me qëllim rikthimin e saj në Polici dhe t’i jepeshin të gjitha pagat mujore për kohën e qëndrimit padrejtësisht pa punë për shkak të një akti administrativ të paligjshëm. Në përgjigjen e dhënë nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, ndonëse pranohet rekomandimi ynë, ai nuk u zbatua. Pas kësaj, rekomandimin ia dërguam Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe jemi në pritje të shqyrtimit të tij.

IV. Ankesa për shtetasit e humbur

Gjatë këtij viti në Institucionit e Avokatit të Popullit janë regjistruar 7 ankesa për shtetasit e humbur, nga të cilat 3 janë zgjidhur në favor gjatë shqyrtimit, 1 ka qënë jashtë juridiksionit dhe tre janë në ndjekje. Lidhur me këtë fenomen, nga ne është bashkëpunuar me institucionet e specializuara të shtetit për hapjen e dosjeve të kërkimit të tyre, apo edhe për të vënë në lëvizje dosjet e hapura, si dhe me disa TV private që organizojnë emisione televizive për gjetjen e personave të humbur. Disa prej këtyre rasteve mund të përmëdim:

1. Ankesa e shtetasit M. K., nga qyteti i Tiranës, i cili na shkruante se vëllai i tij T.K. me banim në qytetin e Laçit, ishte larguar në drejtim të paditur. Në momentin e largimit nuk ka patur dokument identifikimi dhe as mjete monetare. Vëllai i tij kishte probleme të shendetit mendor dhe ishte trajtuar disa herë në spital. Ankuesi i ishte drejtuar dy herë Komisarariatit të Policisë Lezhë, por asnjëherë nuk kishte marrë përgjigje pozitive.

Ne i kërkua shpjegime Drejtorisë së Policisë së Qarkut Lezhë për këtë problem. Nga përgjigjia e marrë prej saj, ndërmjet të tjerave na shpjegohej se kishin dijeni për këtë problem dhe se pas kërkesës së bërë prej institucionit tonë kishin kryer të gjitha veprimet e nevojshme proceduriale, ishte marrë kallzimi shtetasit M.K., ishte bërë shpallja në kërkim e personit më datën 09.08.2006, si dhe ishte referuar ngjarja në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Ndërsa nga ana e Policisë ishin marrë një sërë masash dhe ishin parashikuar një sërë detyrash, për të saktësuar vendodhjen dhe gjetjen e tij.

2. Ankesa e shtetasit L. Sh., nga qyteti i Durrësit, i cili na shkruante se më 04.06.1995, rreth orës 11.00, në një lagje të Durrsit ka ndodhur zhdukja e nipit të tij (djali i vajzës) J.L.. Jo më vonë se 15 minuta është bërë denoncimi nga nëna e tij në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës, për zhdukjen e fëmijës J.L., por çështja penale, fatkeqësisht kishte filluar në datën 08.06.1995. Pas informacioneve të dhëna nga prindërit e J.L., në datën 10.08.1995, u bë e mundur kapja e autorëve.

Autorët e kësaj ngjarje të rëndë janë dënuar me vendim të formës së prerë, por familjarët e fëmijës J.L. nuk janë pajtuar me këtë vendim pasi, ky proces ka patur mungësi serioziteti si nga Prokuroria ashtu dhe nga Policia për arsye se fëmija jo vetëm që nuk u gjend, por nuk u mor asnjë masë për kërkimin e tij.

Ne i kërkua shpjegime Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, lidhur me masat e marra për këtë ngjarje. Në përgjigjen e dhënë prej saj na informoi se, në kohën e ndodhjes së krimit nuk është bërë shpallja në

kërkim e fëmijes J.L. në kategorinë si i humbur. Pas këtij komunikimi në datën 17.11.2006, nga Komisariati i Policisë Durrës është bërë menjëherë shpallja në kërkim i fëmijës J.L..

3. Ankesa e shtetasit K. K., nga rrethi i Fierit. Ai kërkonte ndihmë për gjetjen e djalit të tij D. N., i cili në vitin 1981 ishte dërguar në Shtëpinë e Fëmijës “Zyber Hallulli”, Tiranë nga nëna e tij K.N., e cila nuk jetonte më.

Në këtë rast kishim të bënim me një fëmijë, i cili ishte birësuar brënda të gjitha rregullave të përcaktuara me ligj, por që prindi i tij biologjik (babai) dëshironte për të hyrë në kontakt me të, por nuk e gjente dot.

Kërkuam shpjegime dhe bashkëpunim nga disa institucione, si Shtëpia e Fëmijës “Zyber Hallulli”, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, Gjykata e Lartë Tiranë, Dega e Mobilizimit Ushtarak Berat, etj. Pas informacioneve të marra dhe kërkimeve të bëra, u bë e mundur që ankuesi të kontaktohej me djalin e tij pas një periudhe prej 25-vjetësh.

V. Rekomandime për parandalimin e torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit dhe shkeljeve të ligjit nga Policia.

Në raportet e viteve të fundit, në mënyrë të përsëritur kemi bërë disa rekomandime, për të cilat gjykan se respektimi i tyre do të sillte parandalimin e torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit dhe të shkeljeve të ligjit nga Policia. Megjithëse ato ja dërguam ish Ministrisë së Rendit Publik dhe Ministrisë së Brendëshme, konstatojmë se edhe pas këmbënguljes tonë të vazhdueshme, pjesa më e madhe e tyre nuk janë zbatuar. Kështu p.sh. mund të përmëndim:

1. Nuk janë marrë masat e nevojshme që të sigurohet e drejta e vizitës nga një mjek për personat e privuar nga liria, qysh në fillim të privimit të tyre nga liria. Kjo e drejtë duhet gjithashtu të nënkuptojë të drejtën që këta persona kanë për t’u ekzaminuar nëse ata dëshirojnë nga një mjek i zgjedhur prej tyre.

Për realizimin e kësaj të drejte gjithashtu duhet që:

- Të gjitha ekzaminimet mjekësore të personave të privuar nga liria e tyre prej policisë duhet të jenë larg dëgjimit, dhe vetëm nëse kundërshton mjeku. Për ndonjë rast të veçantë, larg edhe shikimit të punonjësve të policisë kur ata vizitohen nga mjeku.

- Rezultatet e çdo ekzaminimi, si dhe çdo deklaratë e bërë nga personi i vizituar, duhet të shënohen nga mjeku dhe të jenë në dispozicion të personit të privuar nga liria dhe të avokatit të tij.

2. Personave të privuar nga liria prej policisë, nuk u dorëzohen formulare ku të pasqyrohen e saktësohen të drejtat e tyre. Këta formularë

duhet që të jenë të disponueshëm edhe në gjuhë të huaj. Për më tepër, të interesuarit duhet të ftohen që të firmosin një deklaratë që ata kanë qënë të informuar mbi të drejtat e tyre.

3. Nuk është nxjerë udhëzimi (kod i sjelljes) për marrjen në pyetje nga policia. Ky kod duhet ndër të tjera të trajtojë aspektet e mëposhtme; t'i tregohet sistematikisht të ndaluarit identiteti i personave të pranishëm gjatë marrjes në pyetje (emri dhe/ose matrikuli); kohëzgjatja e lejuar e një seance pyetjesh; periudhat e pushimit ndërmjet këtyre seanceve dhe pauzat gjatë marrjes në pyetje; vendi apo vendet ku mund të mbahet një seancë e tillë; nëse do t'i kërkohet të ndaluarit të qëndrojnë në këmbë gjatë marrjes në pyetje; dhe që ndalohet marrja në pyetje e personave nën ndikimin e drogës, alkoolit, ilaçeve ose nën një gjëndje tronditjeje. Ky kod duhet gjithashtu të parashikojë që të shënohet sistematikisht momenti i fillimit dhe i përfundimit të çdo marrje në pyetje, identitetin e çdo të pranishmi gjatë çdo seance pyetjeje, si dhe çdo kërkesë të formuluar nga i ndaluarit gjatë kësaj seance. Situata e personave veçanërisht të pambrojtur (për shëmbull, minorenët, personat e prekur nga sëmundje ose mangësi mendore) duhet të bëhen objekt i garancive specifike.

4. Nuk zbatohen të drejtat e mësipërme edhe për personat e mbajtur nga policia për qëllime administrative. Nga inspektimi i bërë gjatë këtij viti në pjesën më të madhe të Komisariateve të Policisë në shkallë vendi kemi konstatuar se në disa raste “shoqërimi në polici” përdoret ndaj personave të dyshuar për një vepër penale. Pra shoqërimi përdoret jo për të sqaruar veprime administrative, por me qëllim hetimesh për vepra penale dhe mbas kohës së “shoqërimit” bëhen veprime proceduriale të ndalimit ose arrestimit. Po kështu kemi konstatuar disa raste të kryerjes së veprimeve që çojnë në kërkimin dhe mbledhjen e të dhënave në mënyrë të paligjshme, duke shkelur pikën 2 të nenit 32 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Të dhëna të tilla mund të përmëndim ato që janë marrë nën efektin e dhunës fizike.

5. Nuk është nxjerë nga autoritetet policore qarkorja që të sqarojë se koha e mbajtjes së personit, për arsye administrative ose gjyqësore duhet të llogaritet brënda afatit kohor të caktuar për paraqitjen e një personi para një gjyqtari, që, sipas nenit 28 të Kushtetutës, është jo më tepër se 48 orë. Nga verifikimi i disa ankesave ka rezultuar se koha e ndalimit ose arrestimit fillon pas asaj të shoqërimit, që në disa raste edhe ajo ka qënë tej afatit ligjor.

6. Titullarët dhe kuadrot drejtues të Policisë nuk ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm në lidhje me librat e regjistrimit dhe të mbajtjes së personave në ambjentet e policisë, me qëllim që ato të plotësohen saktë e të mos manipulohen për të mbuluar shkeljet e ligjit. Kemi konstatuar disa raste që

shënimet në këto regjistra nuk përputhen me kohën e saktë të qëndrimit të tyre në Polici, ndërsa në raste të veçanta ata nuk regjistrohen.

7. Nuk ka ndryshuar koncepti për personat e shoqëruar në Polici, të cilët duhet të mbahen në dhoma shoqërimi dhe jo ndalimi, jo të prangosur ose në dhoma të mbyllura me dryn, siç veprohet në disa raste. Po kështu nuk ka ambjente për të shoqëruarit e mitur dhe femra. Dhomat duhet të jenë me kushte të përshtatshme higjienosanitare dhe të pajisura me karrige e tavolina. Këto mangësi fatëkeqësisht janë të pranishme dhe shumë të dukëshme edhe në pjesën më të madhe të Komisariateve të Policisë në Kryeqytet, ku pretendojmë dhe synojmë të kemi një Polici më të kulturuar dhe më të civilizuar.

8. Nuk janë ndryshuar e përmirësuar kushtet e mbajtjes së të ndaluarëve e të arrestuarve në dhomat e paraburgimit në ambjentet e policisë, me qëllim që:

- të respektohen në mënyrë strikte kriteret e parashikuara lidhur me çështjen e hapësirës minimale për të ndaluarin, si dhe
- të ndahen të rriturit nga minorenët dhe t'i kushtohet këtyre të fundit një vëmëndje e veçantë në planin e shëndetit dhe të edukimit.

9. Nuk u mundësua akoma kalimi i dhomave të paraburgimit dhe i personelit të tyre nga varësia e Ministrisë së Brendëshme në atë të Ministrisë së Drejtësisë. Megjithëse ky proces filloi me Drejtorinë e Policisë së Qarkut Vlorë, Tiranë dhe Shkodër, ai nuk mundi të realizohej sipas Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Rendit Publik dhe të Ministrit të Drejtësisë në disa Drejtori e Komisariate Policie. Kjo do të krijonte mundësinë për të vënë efektivisht në jetë të gjitha dispozitat e caktuara në “Rregulloren mbi sigurimin dhe trajtimin e të burgosurve”, të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.96 datë 09.03.2000.

Ministria e Brendëshme insiston për realizimin e kësaj detyre, sepse Ministria e Drejtësisë e ka marrë me javashllëk.

Për veç zbatimit të rekomandimeve të mësipërme, nga organet e Policisë duhet të punohet më shumë për të zbatuar një nga detyrat kryesore institucionale të saj të përcaktuara në nenin 3 të ligjit Nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, atë të mbrojtjes së ushtrimit të lirive dhe të drejtave të personit. Për realizimin e kësaj detyrë është e domosdoshme që:

1. T'i jepet një përparësi më e madhe edukimit dhe formimit profesional në vazhdimësi të punonjësve të policisë të të gjitha roleve dhe gradave. Në këto programe duhet të zërë një vënd të rëndësishëm edukimi i tyre me ndjenjën e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut. Niveli kulturor e profesional, njohja dhe respektimi i të drejtave të njeriut, si dhe

aftësia komunikuese të jenë kritere përcaktuese në rekrutimin, mbajtjen në punë dhe përzgjedhjen në emërimet e ngritje në detyrë të punonjësve të policisë të të gjitha roleve.

2. Duhet që autoritetet politike dhe teknike të niveleve më të larta të dalin herë pas here, më shpesh dhe më fort, me mesazhe të qarta që dënojnë rreptë keqtrajtimet nga policia. Ky veprim duhet të përsëritet me intervale të rregullta nga drejtuesit në të gjitha shkallët e Policisë. Kjo në veçanti t'u theksohet punonjësve të policisë të ngarkuar me marrjen në pyetje të personave të privuar nga liria. Është mjaft pozitive se këtë mesazh e ka dhënë Kryeministri Berisha në mars 2006. Është hera e parë që një Kryeministër publikisht bën thirrje për denoncimin dhe dënimin e policëve që keqtrajtojnë qytetarët.

3. Në të gjitha ambjentet e policisë të vendosen menjëherë posterat e përgatitura në bashkëpunim me institucionin tonë, të cilat bëjnë fjalë për respektimin e të drejtave të njeriut dhe parandalimin e dhunës nga punonjësit e policisë. Ato do të shërbejnë si një kujtesë e vazhdueshme për punonjësit e policisë dhe do t'i ndihmojë ata në zbatimin me rigozitet të ligjit. Është konstatuar se ato që janë vënë, janë hequr pa shkak.

4. Bashkëpunimi i Ministrisë së Brendshme dhe i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me Institucionin e Avokatit të Popullit, në kuadër të punës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, megjithëse ka qënë i mirë, duhet të rritet e përsoset më tej në të ardhmen. Marrdhëniet institucionale me Ministrinë e Brendshme kanë qënë korrekte. Ky fakt është një tregues pozitiv i mirëkuptimit që ky dikaster dhe organet e tij vartëse kanë ndaj rekomandimeve dhe kritikave tona për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke përfshirë edhe ato të punonjësve të policisë të cilat meritojnë më shumë vëmendje. Për këto probleme më datën 15 dhjetor 2006 u organizua një tavolinë e rrumbullakët bashkë me Ministrinë e Brendshme dhe Prokurorinë e Përgjithshme. Gjithashtu këto rekomandime janë bërë edhe me rastin e projektligjit të ri "Për Policinë e Shtetit".

VI. Rekomandime dhe propozime në fushën legislative.

Gjatë shqyrtimit të disa ankesave të ndryshme ne konstatuam se disa akte normative ligjore e nënligjore që ishin në zbatim binin ndesh ose ishin nxjerë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe shkelnin në mënyrë masive të drejtat e qytetarëve dhe të punonjësve të Policisë së Shtetit. Ndërsa disa të tjera nuk zbatoheshin në favor të punonjësve të policisë.

Kështu p.sh. mund të përmëdim:

1. Rasti i ndjekur me inisjativë në lidhje me mosmiratimin e disa akteve nënligjore të parashikuara nga Ligji Nr. 8661, dt. 18.09.2000 "Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit". Ne konstatuam se miratimi dhe hyrja në fuqi e këtij ligji ishte një progres në drejtim të mbrojtjes së interesave ekonomiko-financiare dhe shëndetësore të punonjësve të Policisë së Shtetit. Ky ligj kishte hyrë në fuqi "de jure" më datë 21.10.2000, ndërsa "de facto" ai kishte hyrë në fuqi më datë 05.07.2005, pas miratimit të VKM Nr. 443, dt. 16.06.2005, "Për kushtet, kriteret dhe masën e përfitimeve nga sigurimi shoqëror suplementar i punonjësve të Policisë së Shtetit dhe anëtarëve të familjeve të tyre në rastet kur punonjësi ndërpret karrierën" dhe i shtrinte efektet e zbatimit të tij nga data 16.09.2003.

Mirëpo ligji, në nenet 8, 9, 10 e 11 të tij parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore (VKM) dhe konkretisht:

Neni 8 (kompensimi për dëmtime trupore), parashikon se: "*Punonjësi i Policisë së Shtetit, në rastet e plagosjes a të dëmtimeve trupore, përfiton kompensim për shpenzimet e të gjitha llojeve në masën deri në njëqind për qind të shumës që i nevojitet për riaftësim, brenda dhe jashtë vendit, në institucione shtetërore ose private. Kriteret përcaktohen nga Këshilli i Ministrave*".

Neni 9 (shpenzimet për rehabilitim shëndetësor), parashikon se: "*Shpenzimet, për trajnimin dhe ritrajnimin e punonjësit të Policisë së Shtetit, që vuan nga një dëmtim shëndetësor, për rikthimin e aftësive të humbura përballohen nga Buxheti i Shtetit. Rastet dhe kriteret për përfitim përcaktohen nga Këshilli i Ministrave*".

Neni 10 (ndihmat e menjëhershme), parashikon se: "*Çdo paraardhës, pasardhës dhe bashkëshortja(ti), me të cilët punonjësi i Policisë së Shtetit bashkëjetonte para vdekjes ose plagosjes, përfiton ndihmë të menjëhershme, në masën dhe sipas kriterëve të miratuara nga Këshilli i Ministrave.*

Në çdo pesë vjet të përkujtimit të vdekjes, përfituesve të mësipërm u jepet ndihmë deri në pesë paga bazë mujore për gradën më të lartë, në rolin e mesëm. Masa konkrete e ndihmës miratohet nga Ministri i Rendit Publik".

Neni 11 (shpenzimet e varrimit), parashikon se: "*Paraardhësve, pasardhësve ose personave që organizojnë funeralin dhe paguajnë shpenzimet e varrimit të ish-punonjësit aktiv të Policisë së Shtetit, në dispozicion, të pezulluar, me pagesë kalimtare, në pension, student, kursant ose ushtar (ndihmësagjent), u paguhen shpenzime shtesë varrimi, në masën dhe sipas kriterëve që përcaktohen nga Këshilli i Ministrave*".

Nga interesimi që bëmë pranë strukturave përkatëse të Policisë së Shtetit u informuam se VKM-ja në bazë e për zbatim të dispozitave të mësipërme të ligjit nuk ishte miratuar.

Megjithëse ligji nuk ka caktuar ndonjë afat për nxjerrjen e VKM-së, ne gjykuam se mos nxjerrja e tij bëhet shkak për shkeljen e të drejtave të subjekteve përfituese të parashikuara në ligj.

Për këtë arsye, i rekomanduam Ministrit të Brendshëm që të merrte masat e nevojshme për përgatitjen e projekt Vendimit të Këshillit të Ministrave në bazë e për zbatim të neneve 8,9,10 e 11 të Ligjit Nr. 8661, dt. 18.09.2000 "Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit" dhe dërgimin e tij për miratim në Këshillin e Ministrave. Rekomandimi u mirëprit, Ministria e Brendshme përgatiti projekt vendimin përkatës dhe pasi mori edhe mendimin e disa ministrive të tjera, kohët e fundit e dërgoi atë për miratim në Qeveri. Duhet të theksojmë se në këtë projekt vendim është përfshirë dhe u bë i mundur edhe zbatimi i rekomandimit tonë të bërë prej 5 vite rresht, lidhur me trajtimin ekonomiko-financiar të familjeve të punonjësve të policisë të vrarë apo të plagosur nga viti 1992 deri në vitin 1998. Presim që projekti të kalojë në Qeveri.

2. Rasti i ndjekur me inisjativë lidhur me shkeljen e të drejtave ligjore të të miturve nga ana e punonjësve të policisë gjatë pyetjes kur ata shoqërohen në Polici, arrestohen, ndalohen apo pyetën si dëshmitarë.

Nga shqyrtimi i disa ankesave patëm konstatuar se të miturit pyeten në polici pa praninë e punonjësit social, psikologut dhe të avokatit mbrojtës.

Pyetja e tyre pa praninë e prindërit, psikologut dhe të mbrojtësit përbën shkelje të të drejtave kushtetuese të parashikuara në nenin 54 të saj, ku shprehimisht thuhet se:

“Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatëzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti”.

Ky veprim përbën edhe shkelje të të drejtave të të miturve të garantuara nga dispozitat e K.Pr.Penale dhe konkretisht:

a) Nga neni 35, ku parashikohet se:

“Të pandehurit të mitur i sigurohet ndihmë juridike dhe psikologjike, në çdo gjëndje dhe shkallë të procedimit, me praninë e prindit ose të personave të tjerë të kërkuar nga i mituri dhe të pranuar nga autoriteti që proçedon.

Organi proçedues mund të kryejë veprime dhe të përpilojë akte, për të cilat kërkohet pjesëmarrja e të miturit, pa praninë e personave të treguar në paragrafin 1, vetëm kur një gjë e tillë është në interes të të miturit ose kur vonesa mund të dëmtojë rëndë proçedimin, por gjithmonë në praninë e mbrojtësit”.

b) Nga neni 49/2, ku parashikohet se:

“Kur i pandehuri është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç ose me të meta fizike a psikike që e pengojnë për të realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes, ndihma nga një mbrojtës është e detyrueshme”.

c) Nga neni 361/6, ku parashikohet se:

“Pyetja e dëshmitarëve të mitur mund të bëhet nga kryetari, mbi kërkesat dhe kundërshtimet e palëve. Kryetari mund të ndihmohet nga një familjar i të miturit ose nga një specialist i fushës së edukimit të fëmijëve...”.

Pyetja e kësaj kategorie personash pa praninë e punonjësit social apo specialistit të fushës së edukimit dhe pa praninë e detyrueshme të mbrojtësit sjell pasoja psikike për të miturit, si dhe sjell pasoja juridike për aktet që mbahen nga oficerët e policisë gjyqësore, duke i bërë të pavlefshme ato. Sipas nenit 128/1/c të K.Pr.Penale, *“Aktet proceduriale janë absolutisht të pavlefshme kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me thirrjen e të pandehurit ose praninë e mbrojtësit kur ajo është e detyrueshme”.* Sipas nenit 128/2 të K.Pr. Penale, *“Një akt i cilësuar me ligj si absolutisht i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm”.* Ndërsa sipas nenit 131/1 të K.Pr.Penale, *“Pavlefshmëria e një akti i bën të pavlefshme aktet e mëpasme që varen nga ai që është deklaruar i pavlefshëm”.*

Mirëpo, gjatë shqyrtimit të këtyre ankesave, konstatojmë se një nga shkaqet që sillte këtë shkelje ligjore nga punonjësit e policisë ishte fakti se këta të fundit ndesheshin me vështirësinë e gjetjes së specialistëve të edukimit (punonjësve social) dhe të mbrojtësve. Që ata të vijnë në këto raste duhet t'u sigurohet shpërblimi i punës që kryejnë, për të cilin organet e policisë vendore nuk kanë fonde financiare.

Për këto arsye, i rekomandojmë Ministrin të Brendshëm që t'a vleresonte me seriozitet këtë problem dhe të krijonte një fond të veçantë financiar në organet vendore të policisë për pagimin e punonjësve social dhe avokatëve mbrojtës që thirren për të dhënë asistencën e nevojshme gjatë pyetjes së të miturve nga punonjësit e policisë. Rekomandimi u mirëprit dhe zgjidhjen e problemit policia gjykoj t'a bëj nëpërmjet bashkëpunimit me OJF-të që veprojnë në këtë fushë.

3. Rasti i filluar me inisjativë për përmirësimin e akteve nënligjore që kanë të bëjnë me këqyrjen e vendit të ngjarjes. Për regjistrimin dhe trajtimin e këtij rasti u nxitëm nga ankesat e ardhura në Institucionin tonë prej familjarëve të personave që kanë vdekur në ambjentet e Komisariateve të Policisë, në dhomat e paraburgimit apo në burgje.

Megjithëse nga hetimet e kryera nga organi i prokurorisë ka rezultuar që këto raste vdekjeje kanë qënë vetvrasje, familjarët e viktimave kanë hedhur dyshime mbi shkakun real të vdekjes së tyre, duke pretenduar se

ekspertët që kanë përcaktuar këtë shkak, janë punonjës të Policisë së Shtetit dhe për rrjedhojë ata do të mbrojnë Policinë ku janë të punësuar, si dhe kolegët e tyre që punojnë së bashku me ta në Polici.

Ndonëse nga hetimi i këtyre rasteve ne nuk kemi gjetur të dhëna që të hedhin poshtë përfundimet e organit të prokurorisë, konstatojmë që në këto raste, në këqyrjen e vëndit të ngjarjes kanë marrë pjesë vetëm ekspertë të Institutit të Policisë Shkencore, të cilët kanë bërë edhe ekspertimet përkatëse. Këto veprime ata i kanë kryer në bazë të Rregullores së Institutit të Policisë Shkencore, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Rendit Publik Nr. 751, datë 16.10.2003.

Për të patur një konkluzion ekspertimi sa më objektiv, si dhe për të mënjanuar çfarëdo dyshimi nga familjarët e viktimës, në vitin 2005, i kemi rekomanduar ish Ministrit të Rendit Publik që të bënte ndryshimet përkatëse në Rregulloren e Institutit të Policisë Shkencore, duke parashikuar që në rastet e ndodhjes së ngjarjeve të rënda në ambjentet e Policisë ose të ngjarjeve të tjera të rënda të ndodhura jashtë ambjenteve të Policisë, por që kanë si autorë ose të dyshuar punonjës policie, në këqyrjen e vëndit të ngjarjes dhe në kryerjen e veprimeve ekzaminuese të marit pjesë edhe ekspertë privat të specialiteteve përkatëse.

Nga përgjigjia e dërguar pranohet shkarazi kërkesa jonë, duke nxjerrë si preteks se kjo duhet të bëhet nga ana e Prokurorisë dhe ndërkohë nxiret edhe problemi financiar, se kush duhet të përgjigjet për pagesën e ekspertëve privatë.

Përsa më sipër, gjatë vitit 2006 i rekomanduam Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm që të bënin ndryshimet dhe përmirësimet në aktet nënligjore të përbashkëta lidhur me këqyrjen e vëndit të ngjarjes. Në to të pashikohet që në rastet e ndodhjes së ngjarjeve të rënda në ambjentet e Policisë, në dhomat e paraburgimit apo në burgje, ose të ngjarjeve të tjera të rënda të ndodhura jashtë ambjenteve të Policisë, por që kanë si autorë ose të dyshuar punonjës policie, të vihen në dijeni menjëherë familjarët ose të afërmit e viktimave apo personave të dëmtuar, si dhe t'u jepet mundësia për t'u shprehur nëse kërkojnë ekspert privat në këqyrjen e vëndit të ngjarjes dhe në kryerjen e veprimeve ekzaminuese dhe në qoftë se kjo kërkohet, të lejohet që ata të marit pjesë. Ndërsa problemi i pagesës së tyre duhet të përballohet nga vete pala që i kërkon ata. Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua.

B. Ankesat për organet e pushtetit vendor (Komunat, Bashkitë, dhe Prefekturat)

Gjatë vitit 2006 kemi patur **349** ankesa per organet e mesiperme. Problematika e tyre është e larmishme dhe natyrisht jo e panjohur, pasi është prezantuar edhe në Raportet e mëparëshme.

a) Ankesa për komunat

Nga 94 ankesa që kemi shqyrtuar me Komunat, 11 prej tyre janë të mbartuara nga viti 2005. Nga këto, 5 ankesa janë ende në shqyrtim dhe 89 janë përfunduar, nga të cilat 11 janë zgjidhur në favor te ankuesve, 23 jashtë juridiksionit dhe 31 konsiderohen ankesa të pa bazuara, 17 ankesa jane jashte kompetences dhe 7 ankesa kane rezultuar me heqje dore. Objekti i ankesave të paraqitura gjatë këtij viti, ka qenë kryesisht lidhur me konfliktet e pronësisë në procedurat e ndjekura gjatë ndarjes së tokave nga Komisionet e Ndarjes së Tokave, si dhe me probleme te tjera te cilat lidhen me ceshtje jetike te komunitetit, si zvarritje procedurash administrative, mungese informimi, apo largime nga puna të pamotivuara, apo ne kundershtrim me dispozitat e Kodit te Punes.

Problemet ekzistuese te ankesave te evidentuara vit pas viti janë më të dukshme në këto nivele vendore, sepse dhe niveli profesional nuk është në standartet që kërkohen per pushtetin vendor. Gjithashtu dhe struktura e ketyre organeve dhe vete fondet e kufizuara qe ata kane ne dispozicion per zgjidhjen e ceshtjeve ne terren, i ben edhe me te veshtira zgjidhjet afat shkurtera dhe afat gjata. Megjithate dhe vetemenaxhimi i fondeve te kufizuara qe ata kane, apo iniciativa dhe veteveprimi per menytrat e krijimit te te ardhuarve qofte dhe modeste nga vete komuna, me qellim qe keto ti perdorin me pas ne favor te komunitetit, jane shprehje te mungeses se vizionit per vetqeverisje. Qendrimet apatike dhe mosvepruese te drejtuesve te ketyre organeve kane sjell që dhe vlerësimet dhe qëndrimet e tyre në raport me shkeljet e konstatuara, të mos gjejnë në kohën e duhur zgjidhjen ligjore të domosdoshme. Shpesh nga mos njohja e akteve ligjore dhe nënligjore, komunat jo vetëm që nuk shqyrtojnë dhe nuk zgjidhin probleme, por nuk kthejnë as përgjigje ankuesve për sa kërkojnë. Sikurse e kemi konstatuar edhe ne vitet e tjera, Kodi i Procedurave Administrative, në shumë raste nuk njihet. Por edhe kur njihet ose nuk zbatohet ose keqpërdoret për interesa të caktuara dhe shkaqe të pajustificuara.

Nga numri i ankesave qe kemi ndjekur vecojme ankesen e shtetasit S.U. nga fshati Premal i Komunës Kastrat, te rrethit Malesi e Madhe, me anën e të cilës bëhet prezent shqetësimi lidhur me mos dhënie të tokës

bujqësore në pronësi, në zbatim të Ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”.

Konkretisht ankuesi shpjegon se që në vitin 1990 ka qenë punëtor i SMT-së dega Koplík ndërsa familja e tij ishte banuese në fshatin Premal. Në ankese ai shprehet se kur u nda toka bujqësore në bazë të Ligjit nr. 7501 “Për tokën”, nuk përfitoi tokë, pasi ky ligj nuk është zbatuar në fshatin Premal.

Ankuesi këtë mosveprim të Komisionit të tokës së fshatit Premal dhe mos ndërhyrjen e Komisionit të Tokës së Komunës, i konsideron si shkelje të të drejtave dhe interesave të tij të ligjshme për të përfituar nga Ligji “Për Tokën”.

Per zgjidhjen e kesaj ceshtje shtetasi S. U. kërkoi ndërhyrjen e institucionit të Avokatit të Popullit. Nga verifikimi i kesaj ankese rezultoi se nga drejtuesit e Komunes u mbajt nje qëndrim aspak korrekt për të na kthyer një përgjigje zyrtare lidhur me problemin e parashtruar, duke shkelur haptazi Ligjin nr. 8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtarë” si dhe në pikat 2 dhe 3, të nenit 51 të Kodit të Proçedurave Administrative.

Në vijimesi te kembenguljes tone ne trajtimin e kesaj ankese, nga Kryetari i Komunës Kastrat, na u shpjegua se në Komunën Kastrat toka është ndarë sipas kufinjve të vjetër, çka lë të nënkuptojë faktin se në këtë Komunë nuk ka gjetur zbatimin e tij Ligji nr.7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, duke përbërë kështu një shkelje flagrante të tij dhe të dispozitave të tjera ligjore në fuqi dhe në rastin konkret duke e privuar. S.U. për të përfituar nga një e drejtë që i njihet me ligj.

Lidhur me kete qëndrim i shpjeguam Kryetarit te Komunes se në Ligjin nr.7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën” neni 2 parashikohet shprehimisht se:

“ Shteti u jep tokë personave fizik apo juridik, të cilët gëzojnë të drejtën e pronësisë dhe të gjitha të drejtat që përmbahen në ligj”. dhe më tej në nenin 3

“Toka bujqësore u jepet në pronësi ose në përdorim personave juridike a fizike vendas pa shpërblim”.

si dhe në nenin 6

“Familjeve me banim në fshat, që nuk janë anëtare të kooperativës bujqësore dhe familjeve që punojnë e banojnë në ndërmarrjet bujqësore, u jepet në përdorim tokë bujqësore.”

Nisur nga këto fakte, institucioni i Avokatit të Popullit, i paraqiti Kryetarit te Komunes mendimin se proçedura e ndarjes së tokës sipas

kufinjve të vjetër, është një procedurë që paraqitet problematike dhe që nuk ka asnjë bazë ligjore.

Në kushtet e një sistemi demokratik ku organet shtetërore duhet të udhëhiqen në veprimtarinë e tyre nga parime të shtetit të së drejtës dhe të zbatimit rigoroz të tyre, si dhe në kuadër të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin europian dhe në struktura të tjera ndërkombëtare, praktika të tilla, ku vihet re qartë mosrespektimi i kuadrit ligjor në fuqi, nuk reflektojnë imazhin e një shteti që aspiron integritetin dhe zhvillim në strukturat e Bashkimit Europian.

Për sa më sipër, rekomandua shqyrtimin e çështjes së S. U. në mbledhjen e radhës të Komisionit të Tokës në Qark dhe nxjerrjen e akteve administrative për vënien në vend të së drejtës së shtetasit për përfituar nga Ligji Nr. 7501 datë 19.07.1991 “Për Tokën”.

Perseri me të njëjten objekt është dhe ankesa e paraqitur nga Z.J lidhur me mos dhënie të tokës bujqësore në pronësi, në zbatim të Ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”. Konkretisht nga ana e Komisionit të Ndarjes së Tokës në fshatin Lalëz kur u nda toka bujqësore në bazë të Ligjit nr. 7501 “Për tokën”, ankuesi nuk përfitoi tokë ashtu siç ishte parashikuar në aktin e marrjes së tokës në pronësi.

Këtë mosveprim të Komisionit të tokës së fshatit Ishëm dhe mos ndërhyrjen e Komisionit të Tokës së Komunës, u konsiderua si shkelje e të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve për të përfituar nga Ligji “Për Tokën”. Pas ndërhyrjes tone institucionale, Kryetari i Komunës Ishëm ndermorri gjithë procedurat e nevojshme ligjore duke e pajisur me toke ankuesin në bazë të ligjit përkatës.

Në këtë kontekst vecojmë dhe ankesën e shtetasit SH.C nga Komuna Dajt, përse i përket pengesave apo zvarritjeve administrative që ka hasur nga Komuna Dajt në hipotekimin e një sipërfaqe toke që ai ka përfituar në bazë të Ligjit nr. 7501 datë 19.07.1991 “Për Tokën”.

Gjate trajtimit të kësaj ankese Avokati i Popullit, iu drejtua Kryetarit të Komunës Dajt dhe Seksionit të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Qarkut Tiranë, për të sqaruar rrethanat që kanë sjelle këte vonese për konfirmimin e dokumentacionit të pronësisë dhe më pas regjistrimin e kësaj pasurie në regjistrat e pasurive të paluajtshme në Z.V.R.P.P.

Me qëllim të zgjidhjes përfundimtare të këtij problemi, iu kërkua Komisionit të Tokës në fshat, që të shprehet lidhur me lënien në fuqi ose anulimin në rrugë administrative të aktit të pronësisë.

Ankesa të tilla me të njëjtin objekt kemi patur dhe me Komunen Ishëm, fshati Lalëz apo në fshatin Celigrad, të rrethit Fier.

Nga shqyrtimi i ankesave gjate vitit 2005 me keto organe, mund te vecojme dhe ankesen e 60 familjeve te fshatit Dyshnik Otlak, lidhur me moszbatimin e Ligjit nr. 7501 "Për Tokën", si dhe për mos legalizimin e tokës bujqësore që i është dhënë në pronësi.

Konkretisht ne ankesë shprehen shqetesimi se toka është zaptuar forcërisht në vitin 1992 dhe që prej asaj kohe megjithë kërkesat e vazhdueshme të komunitetit, për të gjetur një zgjidhje ligjore për problemin e parashtruar prej kohësh, vazhdon të jetë evident fakti i mos ndërhyrjes së organeve kompetente.

Në këto kushte u kërkua ndërhyrja e institucionit tonë për të mundësuar angazhimin dhe sensibilizimin e organeve kompetente për të shqyrtuar çështjen në fjalë dhe gjetjen e një zgjidhjeje ligjore, në mbrojtje të interesave të tyre. Për zgjidhjen e kesaj ankesë ju drejtuam Rregjistruesit të Z.RR.P.P.-së Berat, nga i cili u vume ne dijeni se kjo pronë është e rregjistruar tashmë në rregjistrat e Z.RR.P.P. Berat, në favor të ankuesit K.G.

Mbeshtetur në këto përgjigje, ju shpjegua ankuesve e drejta që vendimin e Komisionit të Tokës të Fshatit ta kundërshtojnë pranë Komisionit të Tokës të Komunës, i cili sipas rastit mund të vendosë për plotësimin apo korrigjimin e vendimit të mëparshëm të Komisionit të Tokës. Nëse përsëri ankuesit nuk janë dakort me aktin e dhënies së tokës, i lind e drejta ta kundërshtojnë këtë akt pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ku ata banojnë duke respektuar kërkesat dhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative për kundërshtimin e aktit administrativ.

Vlen të përmendim këtu dhe ankesën e banoreve të fshatit Gjonme, Komuna Gjergjan Elbasan, perkatesisht 40 familjeve të këtij fshati, të cilët ankohen për bllokimin e një kanali vadites për shkak të ndërimit pa leje të një ndërtese në pronë publike, të bërë nga një banor tjetër i këtij fshati.

Këta banorë shpjegojnë në objektin e kesaj ankesë se që me hapjen e themeleve janë ankuar në organet e pushtetit vendor. Kryetari i komunes, nxorri dy urdhera pezullimi, por pengesa është zbatimi i këtyre urdherave. Mosveprimi jo vetëm nuk zgjidhi problemin sepse objekti vazhdonte të ndërtohej dhe konfliktonte banorët me njëri tjetrin. Për këto arsye 40 familjet kërkuan ndërhyrjen e Avokatit të Popullit, sepse si pasoje e mosveprimit nga organet përgjegjëse vendore, këto familje kishin mbetur pa ujë, duke iu demtuar prodhimi bujqësor nga thatësia, pasi ishte bllokuar kanali vadites dhe rruga gjithashtu. Pas ndërhyrjes së Avokatit të Popullit Komuna Gjergjan, problemin e kanalit vadites e zgjidhi në mbledhjen e radhës së Këshillit të Komunës. Ky reagim pozitiv ndaj rekomandimeve të Avokatit të Popullit, është një tregues i rritjes së sensibilitetit dhe përgjegjësisë së këtyre organeve të pushtetit vendor.

Eshte me interes te permendim edhe ankesen e zotit S.L. administrator i nje Shoqerie private per mosekzekutimin e vendimit gjyqesor, nga ana e Komunes Tunje Gramsh. Per kete ankese Zyra e Permbarimit Gramsh, na ka sqaruar se ezauroi te drejtat ligjore ndaj kesaj Komune duke vene sekuester ne llogari te saj. Nga Dega e Thesarit eshte thene se ky vendim nuk ekzekutohej. Per kete arsye i eshte drejtuar Ministrise se Financave per celje fondi per ekzekutimin e vendimit te lartpermendur. Nga pergjigja e marre nga kjo Ministri rezulton se detyrimet finnaciare qe rrjedhin nga vendimet gjyqesore do te likuidohen brenda fondeve te miratuara per institucionet perkatese dhe autorizimin duhet ta jape titullari institucionit, ne kete rast Kryetari i Komunes Tunje, bazuar ne legjislacionin perkates.

Nga shqyrtimi i kesaj ceshtjeje dhe dokumentacionit ligjor i kujtuam Komunes Tunje se detyrimi per njohjen dhe ekzekutimin e vendimit te siperpermendur vjen drejtperdrejt nga;

1.Vendimi i Keshillit te Ministrave nr.335 date 2.06.1998 “Per Proçedurat per zbatimin e vendimeve gjyqesore per detyrimet qe prekin buxhetin e shtetit”, pikerisht pika 1 ku percaktohet :

“Ministrite dhe institucionet e tjera qendrore ndjekin zbatimin e vendimeve gjyqesore per detyrimet e institucioneve buxhetore te vartesis se tyre. Detyrimet qe rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqesore perballohen nga vete institucioni brenda fondeve te miratuara per vitin buxhetor, sipas kriterëve e proçedurave qe do te percaktohen me udhezim te perbashket te Ministrise se Drejtesise dhe Ministrise se Financave”.

2. Vete vendimi gjyqesor i lartpermendur detyron si pale te paditur, Komunen Tunje dhe ne urdhrin e ekzekutimit te vendimit debitore eshte Komuna Tunje, me objekt ”kthim shume”.

Nga sa me siper, i sqaruar dhe Komunes se nese nuk eshte dakort me veprimet permbarimore mund te ushtronte te drejtat ligjore per te kundershuar veprimet permbarimore konform Kodit te Proçedures Civile ne çdo kohe, por nderkohe zgjidhja e problemit nuk mund te behet jashte ketyre te drejtave, thjesht duke mos ekzekutuar vendimet gjyqesore te formes se prere. Por raste te tilla te mos zbatimit te vendimeve gjyqesore nga komunat nuk jane te pakta, pavaresisht numrit te ankesave qe kane ardhur tek ne.

Perballe kesaj suate te krijuar nga mos ekzekutimi i vendimeve gjyqesore te formes se prere dhe nisur nga angazhimi i Qeverise per kete problem kemi kerkuar ne vijimesi angazhimin dhe bashkepunimin e te gjitha organeve te shtetit shqiptar per te rritur dhe konsoliduar shtetin e te drejtes.

Nga komunat si organe kompetente me afer komunitetit dhe problemeve te shumta te tyre, kerkohet nje angazhim me i madh per zgjidhjen e problemeve te tilla jetesore, per te qene me energjike, si per

sigurimin e ujit dhe dritave, te krijimit te kushteve te shkollimit te femijve, te shendetesise dhe te sherbimeve te tjera, te infrastruktures ne pergjithesi, tregues te cilat do te ndikonin ne rritjen e cilesise se jetes se tyre.

Gjatë shqyrtimit të ankesave per Komunat, jo ne pak raste eshte vërejtur se në këto struktura, aktet administrative apo shkallët e ankimit administrativ, nuk njihen ose ndërmerren veprime nga kryetarët e komunave që kapërcejnë kompetencat e tyre. Gjithashtu janë shfaqur dhe zvarritje e neglizhenca në trajtimin e problemeve, mos angazhim për zgjidhjen e fenomeneve, sidomos në zonat rurale. Kjo dhe për faktin se duke qenë të veshur me mandat zgjedhor, Kryetarët e Komunave e konsiderojnë veten të pacënueshëm edhe në rastet kur shkelin ligjin në mënyrë sistematike, me dashje apo për qëllime abuzive. Prandaj mendojmese duhet bere kujdes nga partite politike ne perzgjedhjen e individeve per keto poste.

b. Ankesat për bashkitë

Gjatë vitit 2006 në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë mbërritur 216 ankesa kundrejt Bashkive. Gjithashtu jane ndjekur dhe 41 ankesa te mbartura nga viti 2005, pra gjithsej jane shqyrtuar 256. Nga këto janë përfunduar 230 dhe janë ende në shqyrtim 26 ankesa. Nga totali i ankesave të përfunduara kanë rezultuar 39 ankesa në favor të ankuesve, 64 prej tyre jashtë juridiksionit, 66 ankesa jashte kompetence dhe 51 ankesa të pa bazuara,7 raste kane rezultuar me heqje dore. Nga keto 11 ankesa kane perfunduar me perpilimin e rekomandimve. Natyrisht edhe këtë vit prezantohen probleme dhe fenomene, të cilat nuk janë të panjohura dhe të paditura. Shumica e ankesave të mbërritura gjatë këtij viti ka patur në qendër të vëmendjes, çështjen e strehimit si një problem madhor, i prekshëm, jetik, por praktikisht ende i pazgjidhshëm. Numri i familjeve te pastreha eshte i destinuar te rritet. Nese ky numer do te ulet si efekt i projekteve te realizuara, do te rritet si efekt i rritjes demografike dhe krijimit te familjeve te reja. Per kete arsye kontrolli periodik i kerkesave per strehim dhe te familjeve perfituese do te lejoje njohjen dinamike te situates per sa i perket llojit te familjeve ne pritje, te rezultateve te parashikuara dhe atyre te arritura deri tani. Ky kontroll periodik perben bazen e sejcilit program qe duhet te hartohet per kete kategori ne nevoje. Megjithese Bashkia e Tiranës ka hartuar nje program 10 vjecar per strehimin ne qytetin e Tiranës, kjo eshte e pa mjaftueshme nese nuk do te kete mundesi reale financimi dhe strategji te harmonizuara me programet e qeverise.

Zgjidhja pjeserisht e strehimit te familjeve te pastreha nga renia e skemave piramidale natyrisht është një hap i madh përpara që rrit besimin

dhe shpresën në materializimin e politikave të zgjidhjes së këtij problemi. Megjithatë ende ka shumë për të bërë në këtë drejtim. Duke shpresuar se aktet e fundit ligjore dhe nënljore që kanë dalë nga Qeveria për zgjidhjen e strehimit, si dhe prioriteti i saj në këtë drejtim, do të zgjidhin hap pas hapi këtë problem kombëtar dhe madhor, besojmë se dhe kategoritë e tjera të pastreha do të përfitojnë nga këto politika sociale të shtetit. Megjithatë gjatë trajtimit të këtyre ankesave ka patur pretendime nga ankuesit, se mungon transparenca në për zgjedhjen e kategorive apo në vendimarrjet për zgjidhjen e këtyre çështjeve dhe sidomos në vendimet që marrin këshillat bashkiake, për të cilat pretendohet se asnjëherë nuk dihen kriteret vlerësuese e radha e trajtimit të shtetasve. Mungon informimi publik për ditën e mbledhjeve, apo dhe rendin e ditës të mbledhjeve të këshillave bashkiake, të cilat duhet të jenë publike dhe të njohura, me qëllim që personat e interesuar të jenë pjesë e kësaj procedure, për të cilët janë direkt të interesuar dhe për të cilat duhet të vihen në dijeni, qoftë dhe se kur praktikisht mund të zgjidhen shqetësimet e tyre. Në këtë drejtim është e nevojshme të rritet transparenca nga organet e pushtetit vendor, për t'i bërë të njohur taksapaguesve dhe zgjedhësve të tyre punën dhe arritjet për zgjidhjen e këtij problemi madhor, si dhe strategjitë përkatëse, pasi shpesh shtetasit nuk informohen në kohë për kuadrin ligjor ekzistues dhe në këtë mënyrë humbasin dhe afatet ligjore për mbrojtjen e interesave të tyre të ligjshme. Këto organe, duke qenë se ushtrojnë veprimtarinë mbi bazën e parimit të autonomisë dhe vetëqeverisjes, duhet që të rritin bashkëpunimin me komunitetin për tërheqjen e mendimit të tyre, për alternativat dhe kohën e zgjidhjes. Për gjithë kuadrin ligjor që trajton strehimin, shtetasit janë krejtësisht të pa informuar, pasi shpesh nuk dinë se si dhe ku duhet t'i kërkojnë të drejtat e tyre.

Sikurse edhe vitin e kaluar janë konstatuar mjaft raste kur Bashkitë nuk shfrytëzojnë mjetet ligjore për zgjidhjen e ankesave të shtetasve, nuk shfrytëzojnë kompetencat që u jep Ligji Nr.8652 datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverisjes vendore", duke hezitur në nxjerrjen e urdhërave administrative dhe padrejtesisht duke i treguar qytetarëve rrugën gjyqësore. Ndërkohë që sipas Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjit të sipërcituar, ato kanë të drejtë të ndërmarrin procedime të tilla, duke marrë në shqyrtim dhe vendosur edhe për ankimet administrative.

Vecojme ankesën e shtetasës E.P. e cila paraqet shqetësimin për mosdemshperblimin nga ana e Bashkisë Tirane për një sipërfaqe truall 61.18 m² në pronësi të ligjshme të saj, si dhe të një ndertimi të ndodhur në këtë truall me sipërfaqe ndertimi prej 30 m² dhe me leje të rregullt ndertimi. Në ankese pretendohet se në kundërshtim të plotë me lejen e ndertimit të

marre per ndertesen ne fjale, strukturat perkatese te Bashkise Tirane e kane prishur ate, nderkohe qe siperfaqja ne pronesi te ankueses eshte perdorur per ndertimin e nje rruge publike. Megjithese edhe nga ana e vete Bashkise Tirane jane pranuar keto fakte, perseri ankuesja shprehet se e gjithë kjo ka ndodhur pa u ndermarre me pare proçedurat e shpronesimit dhe te demshperblimit te saj per kete pronesi te ligjshme. Per kete ankese zyra jone, kerkoi shpjegime ne Drejtorine e Legalizim Shpronesimeve ne Bashkine Tirane, nese jane ndermarre proçedura shpronesimi ne kete rast.

Ne pergjigjen e disponuar behet me dije se “per realizimin e proçedurave te shpronesimit per pasurite qe preken nga zbatimi i vendimit te KRRT-se se Bashkise Tirane me nr.313 date 5.07.2004 “Sistemimi dhe rikonstruksioni i infrastruktures ne bllokun “50 vjetori”, drejtoria ne fjale eshte ne pritje te detajimit te buxhetit te Bashkise Tirane per vitin 2006.

Momenti qe ka te beje me objektin 30 m², eshte sqaruar me ankuesen, ku eshte konfirmuar fakti se edhe pse objekti eshte ndertuar ne baze te nje leje te rregullt ndertimi te vitit 2000, ai nuk eshte hipotekuar, pra nuk ka kaluar si titull pronesie ne favor te ankueses apo bashkeshortit te saj. Kemi te bejme pra me nje objekt “de fakto” ekzistues dhe “de jure” inekzistent, fakt qe nuk mund t’a perfshije ate ne rrethin e pronesive qe duhet te shpronesohen sipas ligjit ne kete rast”.

Problemi shqetesues, qe eshte evidentuar edhe ne rekomandime apo çeshtje te tjera te meparshme nga ana jone, lidhet me faktin se ne disa raste Bashkia Tirane ka ndjekur praktika jo te rregullta ligjore ne kuadrin e zbatimit te vendimeve perkatese te KRRT-se, duke kryer punime, cenuar pronesi te ligjshme apo edhe prishur ato, pa kryer me pare shpronesimin e pronareve, pasi edhe destinacioni i punimeve te kryera ne keto raste ka te beje me perdorimin e prones per interes publik.

Duke analizuar pergjigjen si dhe duke iu referuar punimeve tashme te kryera per zbatimin e vendimit te KRRT-se se Bashkise Tirane, perkatesisht “Sistemimi dhe rikonstruksioni i infrastruktures ne bllokun “50 vjetori”, gjykojme se proçedurat e ndjekura per punimet ne kete bllok banimi ne raport me te drejtat legjitime te ankueses ne cilesine e pronares, jane kryer ne kundërshtim te hapur me Ligjin Nr.8561 date 22.12.1999 “*Per Shpronesimet dhe marrjen ne perdorim te perkohshem te pasurise prone private per interes publik*”.

Sikurse eshte theksuar edhe ne çeshtje te tjera te ngjashme, Avokati i Popullit mendon se per sa kohe nuk jane permbushur kriteret e ligjit te mesiperm ne favor te pronareve legjitim, per aq kohe keto punime dhe vepra me vlere urbane do te konsiderohen cenim pronesie private, ne kundërshtim me legjislacionin ne fuqi.

Te njohesh dhe te trajtosh pronaret sipas te drejtave te tyre eshte se pari nje detyrim qe buron nga Protokolli I Neni 1 i Konventes Europiane e te Drejtave te Njeriut ku parashikohet se:

“Çdo person fizik apo juridik ka te drejte per respektimin e pasurise se tij. Askush nuk mund te privohet nga prona e tij, veçse per arsye te dobise publike dhe ne kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e pergjithshme te se drejtes nderkombetare”

Se dyti eshte nje garanci themelore per rendin tone kushtetues te parashikuar nga neni 41 dhe 42 ku midis te tjerash thuhet se:

“Neni 41 pika (4)-Shpronesimet ose ato kufizime te se drejtes se prones qe barazohen me shpronesimin, lejohen perkundrejt nje shperblimi te drejte”.

“Neni 42 pika (1)-Liria, prona dhe te drejtat e njohura me kushtetute dhe me ligj nuk mund te cenohen pa nje proces te rregullt ligjor”.

Dhe se treti eshte nje detyrim ligjor qe buron nga Ligji Nr.8561, datë 22.12.1999 *“Per Shpronesimet dhe marrjen ne perdorim te perkohshem te pasurise prone private per interes publik”* ku midis te tjerash thuhet se:

“Neni 3--Shpronesimi dhe marrja ne perdorim te perkohshem te pasurise prone private realizohet ne perputhje me kushtet dhe procedurat e percaktuara ne kete ligj, duke garantuar transparencen, barazine e shtetasve dhe mbrojtjen e interesave dhe te drejtave te tyre pasurore”.

Avokati i Popullit, eshte shprehur ne disa rekomandime qe punet publike te Bashkise Tirane duhet te ecin paralelisht me zbatimin korrekt te ligjit ne mbrojtje te te drejtave, lirive dhe interesave te ligjshme te individeve. Çdo perpjekje per te anashkaluar legjislacionin ne fuqi dhe per te cenuar te drejtat e pronesise eshte nje veprim, i cili demton forcimin e shtetit te se drejtes.

Ne kete suate te re, ku niveli i shkeljeve te te drejtave dhe lirive themelore po shihet si barometer per etiketimin dhe standartizimin ne planet integruese, Avokati i Popullit apelon per me shume kujdes dhe profesionalizem ne marredhenie me individet dhe me te drejtat qe ata gezojne karshi organeve te administrates publike qendrore apo vendore.

Duke e konsideruar natyren e kundraligjshme te praktikës se lartpermendur si shkelje te te drejtave dhe interesave te ligjshme te ankueses rekomanduam trajtimin e menjehershëm dhe fillimin urgjent te procedurave te shpronesimit ndaj ankueses me cilesine e pronares se ligjshme, ne lidhje me pasurite e regjistruara ne ZRPP-ne perkatese me nr.5/265 dhe 5/303, te cilat cenohen nga zbatimi i vendimit te KRRT-se se Bashkise Tirane nr.313 date 5.07.2004 *“Sistemimi dhe rikonstruksioni i infrastruktures ne bllokun “50 vjetori”*.Ne pergjigje te ketij rekomandimi Bashkia Tirane na informoi

se do te ndermarre te gjitha procedurat ligjore per permbushjen e kesaj te drejte ne favor te ankueses.

Me interes eshte edhe ankesa e gazetares A.G per mosdhenien e nje informacioni te kerkuar ne Bashkine Korce. Sikunder ajo shkruan, bazuar ne ligjin "Per te drejten e informimit per dokumentat zyrtare", ka kerkuar nga titullaret e Bashkise Korçe, dhenien e nje informacioni zyrtar. Informacioni i kerkuar ne kete rast, sikurse shprehej kerkuesja, ka te beje me listat e te pastreheve te kategorise se pare te Korçes ne vitin 1995, listen aktuale te ketyre te pastreheve si dhe listen e te pastreheve qe kane perfutuar strehim per periudhen 1995-2005. Meqenese ankueses i eshte mohuar kjo e drejte kerkoj nderhyrjen e Avokatit te Popullit.

Ne nje kendveshtrim me te gjere te trajtimit te çeshtjes, e drejta e informimit eshte e garantuar ne nenin 23, te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, ku ne piken dy te tij, thuhet shprehimisht:

"Kushdo ka te drejte, ne perputhje me ligjin, te marre informacion per veprimtarine e organeve shteterore, si dhe te personave qe ushtrojne funksione shteterore".

Ne vazhdim te ketij trajtimi, ne nenin 3, te Ligjit Nr.8503 date 30.06.1999 "Per te drejten e informimit per dokumentet zyrtare", percaktohet se: *"Çdo person ka te drejte te kerkoje informacion per dokumentet zyrtare, qe kane te bejne me veprimtarine e organeve shteterore dhe personave qe ushtrojne funksione shteterore, pa qene i detyruar te shpjegoje motivet. Autoriteti publik eshte i detyruar te jape çdo informacion ne lidhje me nje dokument zyrtar, pervec rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe".*

Neni 4 i ligjit te sipercituar, jep kuptimin dhe percaktimin se kur mund te kufizohet dhenia e dokumentave zyrtare dhe me konkretisht;

"Nese informacioni i kerkuar per nje dokument zyrtar kufizohet me ligj, autoriteti publik i leshon kerkuesit nje deklarate me shkrim, ne te cilen tregohen arsyet e mosdhenies se informacionit dhe rregullat ne baze te te cilave ai mund ta kerkoje ate.

Nese kufizimi eshte vetem per nje pjese te te dhenave te dokumentit zyrtar, pjesa tjeter nuk i refuzohet kerkuesit".

Referuar rastit konkret, konstatohet se:

1. Ne perputhje me nenin 7 dhe germen "c", te nenit 9, te Ligjit Nr.8503 date 30.06.1999, te sipercituar, ku thuhet shprehimisht se:

"Kerkuesit i vihet ne dispozicion nje kopje e plote e dokumentit zyrtar, per te cilin kerkohet te informohet",

“Ne perputhje me ligjet, aktet nenligjore dhe rregullat e publikuara prej tij, autoriteti publik parapergatit per shqyrtim apo kopjim, ne pritje te kerkeses nga publiku, dokumente te tilla si:

-kopje te çdo dokumenti zyrtar, i cili i eshte dhene me pare te pakten nje personi, pavaresisht nga formati i tyre dhe qe *autoriteti publik, beson se do te jete me interes per persona te tjere*”, ankuesja ka paraqitur ne perputhje me ligjin, kerkese zyrtare per marrje informacioni dhe dokumentacioni. Por nga Bashkia Korce si autoritet publik, nuk i eshte kthyer pergjigje me shkrim, brenda afatit te percaktuar ne nenin 10, te Ligjit nr. 8503 date 30.06.1999, ne te cilin thuhet shprehimisht se:

“Autoriteti publik vendos per mospranimin e plote ose te pjesshem te kerkeses brenda 15 diteve nga depozitimi i saj. *Ne rast te mospranimit te kerkeses, pergjigja negative, e plote apo e pjesshme, jepet e arsyetuar, me shkrim nga autoriteti publik*”.

Rrjedhimisht, nga ana e Bashkise Korce nuk eshte parapare mundesia as e plotesimit te kerkeses se ankueses, sipas nenit 11 dhe as te shtyrjes se afatit te plotesimit te kerkeses, sipas nenit 12, te Ligjit Nr.8503 date 30.06.1999, “Per te drejten e informimit per dokumentat zyrtare”. Ne procesin e ndermjetesimit nga ana jone, per zgjidhjen e kesaj çeshtje, i kujtuam Bashkise Korce perkufizimin tashme te pranuar nga Parlamenti European, ne lidhje me keqadministrimin nga ana e organeve te administrates publike, sipas te cilit:

“Keqadministrimi ndodh kur nje organ publik, nuk vepron ne perputhje me nje rregull apo princip, i cili eshte i detyrueshem per te”.

Pa dashur te paragjykojme trajtimin e ketij rasti dhe ne perputhje me parimet nderkombetare te funksionimit te administrates publike, gjejme me vend citimin e nenit 22 te Kodit European te Sjelljes se Mire Administrative, ku thuhet shprehimisht se:

“1. Zyrtari do t’u jape, kur ai ka pergjegjesine per çeshtjen ne fjale, anetareve te publikut, informacionin qe ata kerkojne. Kur i takon atij, zyrtari do te jape keshille se si te fillohet nje procedure administrative brenda fushes se tij te kompetences. Zyrtari do te kujdeset qe informacioni i komunikuar te jete i qarte dhe i kuptueshem.

2. Nese nje kerkese gojore per informacion eshte shume e komplikuar apo shume e gjithanshme per tu trajtuar, zyrtari do te keshilloje personin e interesuar te formuloje kerkesen e tij me shkrim.

3. Nese, per shkak te konfidencialitetit te tij, nje zyrtar mund te mos e jape informacionin e kerkuar, ai apo ajo ne perputhje me nenin 18, te ketij Kodi, do ti tregoje personit te interesuar arsyet se pse ai nuk mund t’ja komunikojte informacionin”.

Duke ju referuar ketyre percaktimeve dhe trajtimit qe i eshte bere kerkeses se A.G. arrihet ne konkluzionin se kemi te bejme me shkelje te drejtes se ketij individi, per t'u informuar me dokumentat perkatese zyrtare, te kerkuara prej tij.

Per sa me siper, rekomanduam informimin dhe dhenien e dokumentacionit te kerkuar nga ankuesja.

Gjithashtu do te veconim dhe ankesen e paraqitur nga shtetasja J.Rr, e cila pretendoi se Kryetari i Bashkise Sarande dhe Keshilli Bashkiak i ketij qyteti nuk po vendosin ende te privatizojne nje objekt, per te cilen ankuesja ka fituar te drejten e parablerjes me vendim gjykate te formes se prere. Krahas kesaj ankuesja pretendon se Keshilli Bashkiak Sarande kerkon te mbaje ende si prone shteterore nje objekt qe eshte okupuar aktualisht me destinacion banese pa asnje titull pronesie nga disa trashegimtare te tjere te familjes se ankueses. Per me teper ankuesja shprehet se ky objekt i ishte privatizuar me pare ketyre personave me Vendimin Nr.2 dt.11.11.1998 te Keshillit Bashkiak Sarande, por me vendim gjykate te formes se prere palet jane kthyer ne gjendjen e meparshme. Ne keto kushte Bashkia Sarande eshte e detyruar ti ktheje shumen e lekeve te perfituara nga ky privatizim personave te lartpermendur dhe te disponoje me nje privatizim te ri ne favor te J.Rr..

Avokati i Popullit, pasi u njoh me pretendimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga ankuesja, perpara se te jepte gjykimin e tij te shpejte dhe te paanshem per kete ceshtje, kreu me ane te perfaqesuesve te tij nje verifikim te hollesishem te kesaj ceshtje prane Bashkise Sarande, ne perfundim te se ciles rezultoi e provuar se:

1.Shtetesja J.Rr.si trashegimtare ligjore ka kerkuar ne vitin 2003 ndryshimin e Vendimit Nr.281 dt.08.02.2006 te Komisionit te Kthimit dhe Kompesimit te Pronave Sarande si nje akt, i cili ishte i kundraligjshem dhe cenonte interesat e saj si pronare. Me Vendimin e Gjykates se Shkalles Pare Sarande, J.RR. i eshte kthyer ne natyre siperfaqja prej 215 m² truall, i eshte njohur e drejta e parablerjes per objektin 3 katesh ne truallin e saj te perbere nga 125 m², i eshte kompesuar ne natyre siperfaqja prej 185m² dhe jane konstatuar absolutisht te pavlefshme te gjitha veprimet juridike te Bashkise Sarande qe kane privatizuar kete objekt ne vitin 1998 ne favor te perfaqesuesve te tjere te familjes se ankueses dhe crrregjistrimin e prones se tyre nga ZRPP Sarande.

2. Gjykata e Apelit Gjirokaster me kerkesen e personit te trete te interesuar me Vendimin Nr.186 dt.04.05.2004 ka vendosur prishjen e Vendimit Nr. 1104 dt.19.09.2003 te Gjykates se Shkalles se Pare Sarande dhe pushimin e ceshtjes per sip 215 m² qe ndodhet brenda truallit te personit

te trete te interesuar, prishjen e ketij vendimi dhe pushimin e çeshtjes per sip 250 m2 qe ndodhet brenda truallit te paditises. Lenien ne fuqi te vendimit te Gjykates Sarande per anullimin e privatizimit dhe kontrateve te shitjes se objektit, fshirjen e rregjistrimeve hipotekore dhe njohjen e se drejtes se parablerjes se objektit ne favor te J.Rr.

3. Mbi kerkesen e pales se trete te interesuar, Kolegji Civil i Gjykates se Larte (Dhoma e Keshillimit) me ane te Vendimit Nr.2142 dt.24.12.2004 ka vendosur te mospranoje rekursin per arsye se ai nuk permban shkaqe nga ato te parashikuara ne nenin 472 te Kodit te Proçedures Civile.

4. Serish mbi kerkesen e pales se trete te interesuar Gjykata Kushtetuese me ane te Vendimit Nr.1 dt.16.01.2006 ka vendosur te rrezoje ate, pasi nuk jane verejtur shkelje proçedurale qe shkaktojne nje proçes jo te rregullt ligjor ne dem te paleve.

5.Ndodhur perpara situates te rrezimit te njepasnjeshem te kerkesesave dhe pretendimeve te saj, pala e trete e interesuar ka paraqitur serish nje padi ne Gjykatën e Shkalles se Pare Sarande, ku ka kerkuar te rimarre vlerat qe ka paguar nga privatizimi i objektit 3 katesh, veprime te cilat jane anuluar me vendim gjykate te formes se prere. Me Vendimin e saj Nr.450 dt.15.05.2006 Gjykata e Shkalles se Pare Sarande ka vendosur te pranoje kerkese padine dhe te njohe detyrimin e Bashkise Sarande per ti kthyer shumat perkatese te kontrates se shitjes ne favor te paditesit si dhe shpenzimet e kryera ne objekt.

Referuar sa me lart, duke pare dhe analizuar ne teresi elementet e kesaj çeshtje, Avokati i Popullit ka formuar bindjen e plote se ne favor te J.Rr. ka lindur e drejta per te perfituar sipas nje vendimi gjykate te formes se prere, i cili ne rastin konkret ka fuqine e ligjit. Gjykata e Apelit Gjirokaster me ane te Vendimit Nr. 186 dt.04.05.2004 ka vendosur te njohe te drejten e parablerjes se objektit ankueses dhe te detyroje Bashkine Sarande te ktheje ne gjendjen e meparshme mardheniet me palet e tjera qe kane privatizuar objektin. Ne kete rast mendojme se nuk ka as me te voglin dyshim qe ne favor te J.Rr. duhet te ishin mundesuar te gjitha te drejtat qe njeh dhe favorizon legjislacioni shqiptar. Per me teper kjo eshte nje garanci qe buron nga Neni 142/3 te Kushtetutes se Shqiperise ne te cilen thuhet se:

“Organet e shtetit jane te detyruara te ekzekutojne vendimet gjyqesore”

Lidhur me te drejten e parablerjes se objektit, mendojme se hezitimi per te njohur dhe mundesuar kete te drejte ne favor te ankueses nga ana e Keshillit Bashkiak eshte nje qendrim qe nuk gjen perputhje me veprimet e meparshme te kryera nga ky organ.

Se pari, Bashkia Sarande dhe Keshilli Bashkiak i ketij qyteti me ane te Vendimit Nr.2 dt.11.11.1998 kane ndryshuar destinacionin e objektit, duke e

kthyer ate ne fond banese dhe duke e privatizuar ate ne favor te pjesetareve te tjere te familjes se ankueses.

Se dyti, ky veprim ka deshmuar vullnetin e Bashkise Sarande per te hequr dore nga tagrat e pronesise shtetore per kete objekt dhe per pasoje çdo tentative e re per te rikthyer dhe mbajtur kete objekt serish ne pronesi shtetore perben nje diskriminim te hapur ndaj te drejtave te ligjshme te J.Rr.. Kjo pasi nje qendrim me dy standarte qe do te mund te mbahej nga Bashkia Sarande per kete objekt, duke ja privatizuar njeres pale dhe mos ja kaluar per parablerje pales tjetere, do te demtonte rende integritetin dhe paanshmerine e vendimarrjes se ketij institucioni vendor.

Ne keto kushte sugjeruam qe Bashkia Sarande dhe Keshilli Bashkiak i ketij qyteti duhet te veprojne pa medyshje per te realizuar nje te drejte te ligjshme ne favor te J.Rr, e cila buron nga nje vendim gjyqesor i formes se prere dhe qe nuk mund te diskutohet apo te merret ne shqyrtim nga Bashkia, por duhet te gjeje vetem zbatim.

Projekt-Vendimi Nr.29 dt.19.06.2006 qe u hartua per kete rast deshmoi per pergjegjesi, duke ia paraqitur Keshillit Bashkiak per miratim privatizimin e objektit ne favor te ankueses. Por debatet e zhvilluara ne mbledhjen e Keshillit Bashkiak te mbajtur ne Nr.Prot 6 dt.19.06.2006, vazhdojne tēi sherbejne zvarritjeve administrative te ketij organi, ato u bene nje vendim jo konstruktiv dhe i pambeshtetur ne ligj.

Krahas argumenteve ligjore qe u munduam tēi percjellim me pergjegjesi Bashkise Sarande, e ndjeme pergjegjesi morale dhe qytetare si Avokat i Popullit qe te vinim ne vemendje te ketij organi vuajtjet dhe situaten teper te rende qe ka kaluar J. Rr. dhe familja e saj. Duke menduar se keto plage te pasherueshme qe i jane krijuar kesaj familje do te gjejne sadopak sherim nepermjet nje qendrimi me ligjor, te kujdeshem dhe human qe duhet te mbajne organet e shtetit shqiptar, kerkuam ndaj Bashkise Sarande qe ne vendimarrjen e saj te kete me teper respekt dhe pergjegjshmeri ndaj shtresave te shoqerise qe jane pervuajtur, perndjekur, jane lene te pastrehe dhe flakur ne meshire te fatit nga rregjimi i kaluar.

Ne shqyrtimin e ketij rasti Avokati i Popullit siguroi Bashkine se kerkon qe te garantoje edhe nje here qe nderhyrja ne zgjidhjen e kesaj ceshtje ka qene thjesht qe te mundesoje qytetareve te ketij vendi pa dallim, nje ndihme ligjore, pershpjtim te procedurave administrative ne favor te tyre dhe nje trajtim dinjitoz te te drejtave qe kane perfituar si me ligj, ashtu dhe nepermjet vendimeve gjyqesore te formes se prere.

Për të gjitha arsyet dhe konstatimet e përmendura me lart, ku del mese e nevojshme permbushja dhe zbatimi korrekt i dispozitave ligjore dhe vendimeve gjyqesore ne favor J.Rr. i rekomanduam Bashkise eleminimin e

vonesave dhe marrjen e nje vendimi perfundimtar ndaj kerkeses se J.Rr.per ceshtjen e privatizimit te nje banese ne qytetin e Sarandes.Por perseri Keshilli Bashkiak nuk tregoi pergjegjshmeri dhe mbylli mbledhjen pa u shprehur per rekomandimin tone.

Nga ankesat me objekt mos ekzekutim vendimesh gjyqesore, do te pemendim dhe ceshtjen e H.B. me detyrën e pergjegjeses se Zyres Juridike ne Bashkine Berat. Ankuesja na ka bërë ankesen lidhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe moszbatimin e vendimit te Komisionit te Sherbimit Civil Nr. 128 date 8.07.2005. Nga verifikimet e bëra per kete rast u rezultua se :

Me aktin administrativ Nr. 169 datë 8.06.2005, të Kryetarit te Bashkise Berat, është vendosur masa disiplinore “largim nga shërbimi civil” ndaj ankuesese H.B.

Ankuesja duke mos qenë dakort dhe duke e konsideruar aktin administrativ të padrejtë, në mbështetje të nenit 5 pika 1, të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”, e ka kundërshtuar pranë Komisionit të Shërbimit Civil. Në zbatim të detyrës funksionale për zgjidhjen e ankesave që kanë të bëjnë me masat disiplinore dhe të drejtat e nëpunësit të shërbimit civil, Komisioni i Shërbimit Civil me vendimin Nr.128, datë 8.07.2005, ka vendosur anulimin e ketij akti duke i dhene te drejte ankueses te kthehet ne vendin e meparshem te punes dhe perfitimin e pages per periudhen e qendrimit pa pune.

Bashkia Beratit duke kontestuar vendimin e sipërm të Komisionit të Shërbimit Civil, ka paraqitur ankim prane Gjykates se Apelit Tirane.Gjykata e Apelit Tirane me vendimin Nr.132 date 14.12.2005 per mos paraqitje te Bashkise Berat si pale paditese, bazuar ne nenin 179/1 te K.Pr.Civile ka vendosur pushimin e gjykimit.

Vendimi Nr.132 date 14.12.2005 i Gjykates se Apelit Tirane ka marre forme te prere ne date 14.12.2005 dhe per rrjedhoje ne baze te ligjit Nr.8549 date 11.11.1999 “Statusi nepunesit civil”, vendimi i KSHC Nr.128 date 8.07.2005 eshte i detyrueshem per t’u ekzekutuar nga organet dhe institucionet shteterore.

Ankuesja kerkoi nderhyrjen e Avokatit te Popullit sepse nga Bashkia Berat nuk behej e mundur zbatimimi i vendimive gjyqesore. Ne keto kushte Institucioni i Avokatit te Popullit ne mbrojtje te nje drejte legjitime e ndjeu si detyrim ligjor t’i shpjegoje me kete rast Bashkise se:

Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë bie ndesh me nenin 142/3 të Kushtetutës së Shqipërisë ku thuhet se : “*Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.*” Në këtë konteks nënvizojmë faktin se vendimet gjyqësore të formës së prerë nuk duhet të

konsiderohen si çështje dëshire dhe fakultative, por duhen konceptuar si detyrim ligjor që duhet respektuar me përpikmëri nga çdo organ i administratës publike.

Shkelje tjetër që konstatojme ne qëndrimin mosveprues të Bashkisë Berat është edhe moszbatimi i nenit 8/ pika 3 e ligjit nr. 8549 datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil” ku thuhet konkretisht se: *”vendimet e Komisionit të Shërbimit Civil marrë në përputhje me pikën 1 shkronja “a”, janë të detyrueshme për Institucionet e administratës publike vendore e qëndrore.”*

Qëndrime të tilla pa bazë ligjore, jo vetëm vijnë ndesh me tërë frymën e legjislacionit shqiptar e aktet ndërkombëtare, por në fund të fundit ulin autoritetin dhe besueshmërinë e institucioneve të pavarura si dhe cënojnë rëndë autoritetin e shtetit dhe qeverisjes duke shkelur rëndë të drejtat ligjore të nëpunësit të shërbimit civil.

Duke patur mendimin absolut që administrata publike udhëhiqet nga parimi i transparencës e ligjshmërisë, duke vlerësuar si detyrë imperative obligimin për të çuar përpara demokracinë dhe respektimin e të drejtave e lirive themelore të shtetasve, i rekomandua Bashkisë Berat marrjen e masave për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur ndaj ankueses, për të zbatuar vendimin e Komisionit të Shërbimit Civil, që anuloi vendimin administrativ të Kryetarit të Bashkisë Berat.

Ne këte pjesë të prezantimit të ankesave vecojme atë të A.L. me Bashkinë Kucovë. Ankuesja pretendon për zvarritje procedurash administrative nga ana e Bashkisë për licensimin e saj si subjekt në ushtrimin e aktivitetit në fushën e shërbimeve funerale.

Lidhur me këte ankese duke qenë se ndeshem në interpretime të ndryshme ligjore me drejtuesit e kësaj Bashkisë, për sa i përket plotësimit të disa kriterëve specifike për subjektin që licensohej në këte aktivitet, në vijimesi të shqyrtimit të rastit iu drejtuam Drejtorisë së Rregullave Teknike në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, e cila na sqaroi se dhënia e licensave profesionale, realizohet nga një Komision i Posacem i cili shqyrton rast pas rasti përmbushjen e kriterëve ligjore nga subjekti që kërkon të pajiset me këte leje, në zbatim të Rregullores së Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale për punët dhe shërbimet publike”. Në këte mënyrë pajisja e këtij subjekti me lejen e posacme, nuk mund të paragjykohej nga Kryetari i Bashkisë dhe as të kontestohet Komisioni, i cili e ka dhënë këte të drejtë si organi i vetëm kompetent në këte drejtim. Pengesat që paraqiste Bashkia Kucovë në këte mos procedim, në cdo rast rezultuan formale dhe të pa bazuara. Lidhur me këto shkaqe nga

Prefektura e Qarkut u informuam se pengesat qe i paraprijne kerkesave te subjektit per t'u pajisur me lejen tatimore, jane pengesa te pa justifikuara dhe te pa arsyeshme. Ndersa per sa i takon akt marreveshjes midis Bashkise dhe subjektit qe operon ne nje fushe te caktuar dhe qe Bashkia e konsideroni si kusht te vetem dhe kryesor ne permbushjen e ketij sherbimi, Prefektura sqaron se kjo eshte ne funksion te sherbimit cilesor per komunitetin dhe te shmangies te gjendjes konfuze, per kete arsye ***mund***, pra ***mund*** te lidhet akt marreveshjen, por jo si kusht te vetem te domosdoshem per vazhdimesine e ushtrimit te aktivitetit.

Nje tjeter arsye qe Bashkia e vleresonte si objektive per mos nenshkrimin e akt marreveshjes, eshte dhe refuzimi i subjektit per te marre pjese ne tender megjithe kerkesen per pjesemarrje.

Nga shqyrtimi hap pas hapi i rastit ky shkak rezultoi i pavertete, sepse qe subjekti te marre pjese ne tender duhet se pari te plotesoje disa kushte, nje nder te cilat eshte dhe pajisja me licensen tatimore nga Zyra e Tatim Taksave Kucove, license e cila i refuzohej subjektit dhe per kete mungese, subjekti do te ishte skualifikuar qe ne fillim ne tenderit, per mungese te dokumentacionit administrativo-ligjor, fakt per te cilen Bashkia kishte dijeni sepse per shkak te mos veprimit te saj per akt marreveshjen, nuk licensohej nga Zyra e Tatimeve. Ne kete menyre thirrja per pjesemarrje ne tender, ishte formale dhe e paragjykuar.

Per kete mosveprim te Zyres se Tatimeve Kucove, Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve Tirane, terhoqi vemendje duke shpjeguar se: arsyetimi i Deges se Tatim Taksave Kucove, nuk eshte i mbeshtetur ne ligj per sa i takon mos licensimit te subjektit per shkak te mungeses se akt marreveshjes. Ne vijim kerkohet qe te merren masat e nevojshme per regjistrimin e subjektit dhe mos perseritjen per te ardhmen”.

Ne vijimesi Bashkia e Kucoves na informoi se ne muajin qershor te vitit 2005, ka dale VKM Nr.418 date 9.06.2005, sipas te ciles i jepet e drejta organeve te pushtetit vendor, qe te jap licenca profesionale ne fushen e sherbimeve publike dhe te lidh akt marreveshje me firma te ndryshme.

Nga Zyra jone edhe kjo pengese, apo shkak i ashtuquajtur i ligjshem nga Bashkia Kucove konkludoi jo i bazuar sepse kjo kompetence dhe e drejte i delegohet organeve vendore, pasi ky vendim te hyje ne fuqi dhe nuk ka efekte prapavepruese per subjektin ne fjale, qe e kishte perfituar kete te drejte.

Ndersa arsyeja e mungeses se eksperiences dhe nderkohe e suksesit te subjektit qe operon prej kohesh ne kete sherbim, nuk mund te jene pengesa te ligjshme dhe objektive dhe shkak per te penguar fitimin e kesaj eksperience edhe nga ankuesja, sepse cdo gje e ka nje fillim. Por kur

mohohet kjo mundesi dhe eksperiencia nuk mund te fitohet. Rregullat e ekonomise se tregut dhe te konkurrences jane katalizatore qe skualifikojne te aftin nga i pa afti dhe eksperiencen nga mungesa e saj.

Nga vezhgimi yne rezultoi se ne qytetin e Kucoves kishte disa biznese, te cilat jane tregues te mbijeteses ne tregun e lire te konkurrences dhe te eksperiences gjithashtu.

Ne keto kushte, duke gjykuar se A.L, pengohet pa te drejte dhe ne menyre te paligjshme per te ushtruar aktivitetin ne fushen e sherbimeve, duke i mohuar disa te drejte kushtetuese te mbrojtura dhe te garantuara me ligj, i rekomanduam Bashkie qe te marre te gjitha masat e nevojshme administrative, per te rivendosur ne vend te drejten e shkelur perkundrejt ketij subjekti privat dhe mos perseritjen ne te ardhmen te praktikave te tilla te gabuara dhe ndoshta abuzive.

Ne gamen e ankesave te shumta me Bashkite, do te veconim dhe propozimin qe i kemi paraqitur Bashkise Tirane per te nxjerre pergjegjesine konkrete dhe marrje masash administrative disiplinore ndaj personave pergjegjes, punonjes te Policise Bashkiake Tirane lidhur me nje ankese te prezantuar nga Z.L, ku pretendohej per disa veprime te kundraligjshme te punonjesve te organit te Policise Bashkiake Tirane.

Sikunder pretendon ankuesja, tre punonjes te ketij organi, pa pasur asnje vendim zyrtar, kane shkuar ne pallatin ku banon ankuesja dhe kane prishur nje dere te vendosur prej familjeve R dhe L. Kjo dere ishte vendosur nga ana e ketyre familjeve qe ne vitin 1997, sikurse shprehet ankuesja per arsye sigurie dhe nuk pengonte as hapesiren e shkalles (kati i peste) dhe as ajrimin apo ndricimin e shkalles. Pavaresisht se si eshte vepruar, ankuesja shprehet se ajo dhe perfaqesuesi i familjes tjeter qe ka investuar ne vendosjen e kesaj dere, nuk jane therritur dhe nuk jane degjuar ne lidhje me kete problem. Perkundrazi ne menyre arbitrare eshte vepruar duke hequr kete dere, bazuar vetem ne ankesen e fqinjeve te katit te katert.

Per me teper, nje tjeter problem ne kete rast qendron ne faktin se jo vetem qe dera eshte hequr, por materialet e kesaj dere nuk i jane dorezuar pronareve te saj dhe nuk dihet se ku kane perfunduar, nderkohe qe ankuesja kujton se vlere e deres eshte nje shume jo e vogel, e paguar nga ajo dhe familja R.

Duke e cilesuar veprimin e punonjesve te organit te Policise Bashkiake Tirane, si krejtesisht te njeanshem dhe te kundraligjshem, ankuesja ka kerkuar nderhyrjen e Avokatit te Popullit per zgjidhjen e kesaj ceshtje.

Me marrjen ne shqyrtim te kesaj ceshtje nga ana jone, jane kerkuar shpjegime nga ana e Policise Bashkiake Tirane, persa i perket trajtimit qe i

eshte bere ketij rasti, si dhe per bazen ligjore ne baze te se ciles eshte vepruar. Njekohesisht eshte kerkuar qe te na dergohen nje kopje e akteve te nxjerra nga ana e ketij organi per kete çeshtje.

Ne pergjigjen e dhene prej Policise Bashkiake. Tirane per kete çeshtje, sqarohej se punonjesit e ketij organi kane vepruar mbi bazen e kerkeses dhe kane mbeshtetur veprimet e Task Forces dhe te specialisteve te Njesise Bashkiake nr.2, Tirane, nisur nga ankesat perkatese qe lidhen me kete rast.

Mbi kete baze i jemi drejtuar per shpjegime te metejshme Njesise Bashkiake nr.2, e cila na sqaroi se nuk eshte marre fare me kete rast, pasi nuk ka patur nje ankese dhe per rrjedhoje asnje lloj dijenie per kete çeshtje.

Ne keto rrethana, kemi kerkuar paraqitjen e Kryetarit te Policise Bashkiake Tirane ne zyren tone, i cili jo vetem qe nuk eshte paraqitur, por as edhe nuk ka njoftuar paraprakisht per shkaqet e mosparaqitjes, si nje detyrim qe atij i lind nga parashikimet e nenit 19/c te Ligjit nr.8454 date 4.02.1999 “Per Avokatin e Popullit”, i ndryshuar. Realisht me kete veprim eshte konsumuar shkelja e parashikuar ne nenin 22/1 te Ligjit “Per Avokatin e Popullit”, ku percaktohen sanksionet per mosbashkepunimin me Avokatin e Popullit.

Kemi kerkuar sqarime te hollesishme, pasi veprimi i ndodhur ne kete çeshtje ve ne dyshim edhe kompetencen e mundshme ligjore te ketij organi, kompetence e cila mund te rezultoje e nje organi tjeter. Ne keto kushte, trajtimi i kesaj çeshtje qarteson pabazueshmerine e veprimeve perkatese te ndermarra nga ana e punonjesve perkates te Policise Bashkiake, Tirane. Ky fakt del ne pah jo vetem nga mungesa e sqarimeve te detajuara ligjore nga ana e ketij organi, sipas kerkeses se drejtuar nga ana jone, por edhe nga shmangia qe punonjes te tij i bejne ballafaqimit dhe sqarimit konkret te çeshtjes.

Sa me siper, ne kushtet e cituara te shqyrtimit te kesaj çeshtje nga ana jone, del e nevojshme berja e nje analize te rastit, duke nxjerre pergjegjesite e duhura individuale te punonjesve perkates te organit te Policise Bashkiake Tirane.

Thelbi i çeshtjes nuk qendron nese porta e vendosur nga ana e ankueses konsiderohet nderhyrje e ligjshme ose jo. Te pakten per kete pjese te saj, ne gjykojme se do te analizohej vetem nese do te kishim veprim korrekt ligjor nga ana e organit te Policise Bashkiake, pasi ajo çfare ne konstatojme tregon te kunderten.

Sa me siper, rekomanduar ne perputhje me parashikimin e paragrafit 1, neni 1, te Ligjit nr.8224 date 15.05.1997 “Per organizimin dhe funksionimin e Policise te Bashkise dhe te Komunes”, kryerjen e nje analize te hollesishme per trajtimin e ketij rasti nga ana e organit te Policise

Bashkiake Tirane, nxjerrjen e pergjegjesive konkrete dhe marrjen e masave administrative disiplinore ndaj personave pergjegjes, punonjes te ketij organi.

Megjithese ne veprimtarine e organeve te pushtetit vendor, verehen perpjekje per me shume profesionalizem dhe kulture konformë frymes se ndertimit te nje shteti ligjor, ende eshte larg standateve qe kerkon koha. Per kete arsye gjithmone kemi menduar dhe gjykojme se ka nevojë për një oponencë konstruktive të vazhdueshme, e cila në rastet konkrete që kemi ndjekur me këto organe, jemi munduar t'ia servirim me profesionalizëm e objektivitet me qellim qe te mesojne dhe mos perseritin shkeljet qe kane bere.

c. Ankesat për prefekturat

Gjithsej kemi patur 13 ankesa me prefekturat për këtë vit. Nga keto 12 kane perfunduar dhe 1 eshte ende ne shqyrtim. Nga keto 1 eshte zgjidhur në favor të ankuesit, 5 te pa bazuara, 4 jashte juridiksionit dhe 2 ankesa kane qene jashte competences.

Prefekti eshte hallkë ndërmjetëse midis pushtetit qendror dhe vendor dhe per kete arsye misioni i tij eshte të bashkerendojë punën dhe veprimtarinë me këto institucione. Në këtë këndvështrim nga ankesat e shqyrtuara janë konstatuar raste të zvarritjeve të procedurave administrative, mungesë transparence, apo dhe shkelje te se drejtes se informimit, si dhe shkelje te procedurave administrative ne rastet e largimeve nga detyra.

Do te veconim ankesen e shtetasit F. B, ish nenprefekt i qarkut Diber, per mos zgjidhjen e ceshtjes se perfitimit monetar, bazuar ne kuadrin ligjor qe rregullon marredhenien juridike midis Prefektures dhe ish n/prefektit te qarkut, ne favor te ketij te fundit. Ai u ankua se ne daten 1.11.2005 eshte larguar nga detyra e N/prefektit te qarkut Diber, bazuar ne Ligjin Nr.8097 date 21.03.1996 dhe VKM-se Nr.467 date 23.06.2005 dhe qe nga kjo kohe ankuesit i eshte mohuar e drejta e perfitimit te trajtimit financiar, sipas vendimit te Keshillit te Ministrave, cituar me lart.

Gjate shqyrtimit te ketij rasti u in formuam nga Prefekti i Qarkut Diber, se ne parim pranohet fakti se nenprefekteve u takon te trajtohen me 40% te pages se muajit te fundit per nje periudhe jo me shume se nje vit, nga momenti i largimit nga ky funksion. Por per zgjidhje orientohej ndjekja e problemit ne deget e sigurimeve shoqerore Mat dhe Bulqize. Duke qene se ky perfitim eshte rregulluar per here te pare per funksionin e nenprefekteve, nga Prefekti u sqaruam se ankuesi duhet te shlyeje detyrimin e kontributit te sigurimit suplementar shteteror, ne perqindjen e percaktuar ne ligj, prej dates se emerimit ne kete detyre.

Ne kushtet ne te cilat ndodhej ankuesi, pra kur aktet ligjore dhe nenligjore i kane dhene te drejten e perfitimit te trajtimit financiar ne masen e 40 % te pages referuese, si dhe kur ka shlyer detyrimin e derdhjes se mases se kontributit te sigurimit shoqerore ne masen 3 % te shumes bruto, sipas mandat arketimit te Deges se Sigurimeve Shoqerore qe provon kete fakt, gjykuam se F.B duhet te perfitoje kete te drejte, e cila deri tani i ishte shkelur padrejtesisht.

Per zgjidhjen perfundimtare te kesaj ceshtje i rekomanduam Prefektit te Qarkut Diber, marrjen e masave per rivendosjen ne vend te drejtës së shkelur ndaj tij, per te shlyer detyrimin financiar qe e perfiton ankuesi sipas ligjit dhe akteve nenligjore, duke e trajtuar ne masen 40% te pages se muajit te fundit, per nje periudhe jo me shume se nje vit, nga momenti i largimit nga funksioni i nenprefektit.

Ne vijim te ankesave me prefektet vecojme ate te paraqitur ne emer te Kryesive te dy Fshatrave Nepravishte e Siperme dhe e Poshtme se bashku me Komunen qender Libohove. Ata ngriten pretendimin se Firma "Alfa Glina Sh.p.k" ne kundershtim me ligjin dhe vendimet komunale po vazhdon te kryeje punime per shfrytezimin konçesionar te burimit "Vrizi". Konkretisht u sqaruam se KRT-ja prane Qarkut Gjirokaster me ane te Vendimit Nr.58 dt.14.07.2004 ka rinovuar Lejen e ndertimit Nr.888 dt.24.11.1998 per shfrytezimin e burimit "Vrizi" ne sasine 4-6 l/sek. Leja e vitit 1998, sipas tyre eshte e paligjshme, sepse ajo nuk merr parasysh interesin e banoreve te fshatrave, pasqyruar kjo ne nje vendim negativ te Keshillit te Komunes te asaj kohe. Gjithashtu pretendohej se Leja Nr.58 dt.14.07.2004 e KRT Qarkut Gjirokaster eshte miratur pa marre fillimisht pelqimin e organeve vendore. Ne keto kushte si perfaqesues te fshatrave te mesiperme, pasi nuk gjeten zgjidhje prane Prefektit te Qarkut Gjirokaster, iu drejtuan Avokatit te Popullit duke shprehur shqetesimin se vazhdimi i metejshem i ndertimit do te çojte ne incidente te renda me komunitetin.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me ankesen ne fjale kerkoi shpjegime prane Prefektit dhe KRT-se te Qarkut Gjirokaster, per te gjitha procedurat ligjore qe kane shoqeruar miratimin e punimeve ne burimin e ujit. Por meqenese Komuna Qender Libohove dhe kryesite e fshatrave te mesiperme hapen nje proces gjyqesor per kete ceshtje, nderpreme shqyrtimin e metejshem te ankeses. Raste si ky qe paraqitem me lart dhe qe tregon mosveprimin e organeve te pushtetit vendor, mendojme se nuk ka pse te behen objekt i shqyrtimit gjyqesor perderisa jane te gjitha mjetet dhe mundesite ligjore per zgjidhjen administrative te ceshtjes. Kjo pasi rruga gjyqesore kerkon kohe dhe shume shpenzime te cilat rendojne mbi taksapaguesit.

Nje problematike evidente qe kemi verejtur nga ankesat ne vijimesi per prefektet, ka qene dhe mos zbatim i procedurave ligjore ne rastet e largimeve nga detyra per shkak te ristrukturimeve te tyre. Duke qene se nje pjese e stafit te ketij organi eshte me status te nepunesit civil dhe nje pjese i rregullon marrëdhëniet juridike te punes me dispozitat e Kodit te Punes, ju kemi orientuar ankuesve, sipas rastit rrugen gjyqesore ose shqyrtimin e ceshtjeve prane Komisionit te Sherbimit Civil, duke qene se nga pikepamja ligjore nuk kemi shume hapesira per te realizuar, me detyrim rikthimin e te drejtave te pretenduara si te shkelura.

Si perfundim mund te themi se Prefekturat në zbatim të Ligjit Nr.8927 datë 25.07.2002 “Për Prefektin”, duhet të rrisin rolin e tyre koordinues dhe kontrollues mbi administrimin dhe veprimtarinë e organeve të pushtetit vendor në të gjitha hallkat e tij, si dhe kontrollin e bazueshmërisë ligjore të të gjitha akteve që nxjerrin këto organe, për t’u prerë rrugën veprimeve të kundraligjishme dhe abuzive që në fillim, me qëllim që situata të mos derivojë dhe të sjellë pasoja të pariparueshme sociale dhe ligjore per shtetasit.

d. Ankesat per Keshillat e Qarqeve

Gjate vitit 2006 kemi shqyrtuar 13 ankesa per Keshillat e Qarqeve, nga te cilat vetem 1 prej tyre eshte mbartuar nga viti 2005. Te gjitha ankesat kane perfunduar, nga te cilat 3 kane qene jashte kompetences, 5 jashte juridiksionit, 3 te pa bazuara dhe 2 ankese jane zgjidhur ne favor te ankuesve.

Vecojme ankesen e shtetasit H.B, i cili pretendonte se nga Keshilli i Qarkut Korce nuk vepohet per perfitimin e statusit te deshmorit te atdheut pasi vellai i tij ka rene deshmor ne LANC. Per sa me siper ankuesi kerkoi ndihme juridike nga Institucioni yne per hapat dhe veprimet proceduriale qe duhet te ndiqte ne drejtim te ketij perfitimi. Zyra jone asistoi ankuesin duke e orientuar per rrugen e zgjidhjes qe duhet te ndiqte ne zbatim te Ligjit Nr. Nr.8607 dt.27.04.2000 “Per statusin e deshmorit” si dhe te VKM-se Nr.151 date 25.04.2002, qe ka dale ne baze dhe per zbatim te tij, ne te cilen parashikohen konkretisht dokumentacioni i nevojshem ligjor qe duhet te disponohet per kete perfitim .

Gjithashtu permendim dhe ankesen e Z.T i cili pretendonte se nga Keshilli i Qarkut Shkoder nuk perfiton kompensim per pasurine e luajshme dhe te paluajshme sipas nje akt vleresimi pasurie te Komisionit te Vleresimit te Pasurise se Malesise se Madhe, i cili ka konkluduar qe shuma qe duhet te

perfitoje ankuesi, eshte ne vlere 1.454.582 leke, por qe Keshilli i Qarkut nuk e ka likuiduar.

Dhe ne kete rast nga Zyra jone u sqarua ankuesi lidhur me te drejten e perfitimit te kompensimit per pasurine e luajshme, duke e informuar se ende nuk eshte plotesuar paketa ligjore qe te beje te mundur zgjidhjen e te gjitha rasteve me objekt te tille perfitimi.

Nje ankese tjetere qe do te veconim eshte e shtetasit M.M. i cili shpreh shqetesimin lidhur me nje konflikt pronësie të lindur mes tij dhe një shtetasi tjetër dhe që ka zanafillën nga një kontratë shitblerjeje që ishte lidhur me Këshilli e Rrethit në atë kohë, për një truall që ndodhet në autostradën Tiranë- Durrës.

Konkretisht ai shprehej se në vitin 1994 ka blerë një truall nga Këshilli i Rrethit Tiranë, truall i cili ndodhet në Komunën e Kasharit, në fshatin Yrshek, buzë rrugës nacionale në krahun e majtë të rrugës Tiranë-Vorë. Në këtë truall ankuesi ka kryer një investim serioz, mirëpo ka lindur një problem mes tij dhe nje shtetasi tjetere, i cili pretendon se e ka blerë ai këtë sipërfaqe trualli nga Këshilli i Rrethit, duke hyrë kështu në konflikt pronësie me njëri-tjetrin, duke qenë se të dy ngrejnë pretendime për vërtetësinë e kontratës së shitblerjes së lidhur me Këshillin e Rrethit. Pas nderhyrjes tone ne Keshillin e Qarkut Tirane, ankuesi u informua per situaten ne te cilen ndodhej trualli objekt konflikti dhe u orientua per rruget dhe mjetet ligjore qe duhet te shfrytëzoje, ne rivendosjen e te drejtes te pretenduar si te shkelur.

Lidhur me ankesen e shtetasit E.K nga qyteti i Elbasanit, (te cilen e kemi prezantuar dhe ne raportin vjetor te vitit 2005) ku kemi ekspozuar qendrimin aspak ligjor dhe apatik te mbajtur nga kryetari i Keshillit te Qarkut Elbasan, ndaj vendimit te Komisionit te Sherbimit Civil dhe vendimeve te tjera gjyqesore qe e pasonin, ne te cilat ankuesi kishte fituar gjithë te drejtat e nenpunesit civil, gjate vitit 2006 ne vijimesi te kembenguljes tone per zgjidhjen pozitive te kesaj ceshtje, u arrit qe ankuesi E.K ta zgjidhe kete problem dhe te rifitoje te gjitha te drejtat e shkelura nga kryetari i Keshillit te Qarkut Elbasan. Qendrimet dhe reagimet pozitive ne vazhdimesi ndaj rekomandimeve te Avokatit te Popullit, qofte dhe me vonese, jane tregues i rritjes se pergjegjshmerise dhe ligjishmerise se ketyre organeve, te cilat me veprimtarine e tyre korrekte dhe ligjore rrisin besimin e shtetasve tek organet e shtetit te se drejtes.

Dhe ne kete rast, sikurse ne te gjitha ankesat e tjera te ndjekura me objekt ekzekutim te vendimeve gjyqesore, kemi mbajtur qendrimin e palekundur dhe absolut që administrata publike duhet te udhëhiqet nga parimi i transparencës e ligjishmërisë, duke vlerësuar si detyrë dhe obligim

primar respektimin e të drejtave e lirive themelore të shtetasve, sidomos kur keto te drejta jane fituar me vendime gjyqsore. Por shtetasve vazhdon t'u mohohet perfitimi i te drejtave duke penguar ekzekutimin e vendimeve te formes se prere, gje qe sjell pasoje qe gjendja e paligjishmerise dhe shkeljeve te vazhdoje ne dem te interesave te individit.

dh. Ankesat për Sherbimin e Gjëndjes Civile

Edhe gjate ketij viti prane Zyres tone jane trajtuar ankesa te cilat lidhen me sherbimin e Zyrave te Gjendjes Civile. Keshtu jane shqyrtuar 26 ankesa, nga te cilat 1 ka qene e mbartur nga viti 2005. Te 27 ankesat jane perfunduar, nga te cilat 6 jane zgjidhur ne favor te ankuesve, 12 kane qene te pa bazuara, 5 jashte juridiksionit, 2 jashte kompetences dhe per nje rekomandim te nisur me iniciativen e Zyres tone, nuk kemi pergjigje me shkrim.

Pjesën më të madhe të ankesave për Zyrat e Gjendjes Civile e zënë ato per te cilat pretendohet mosveprim apo veprime me gabime materiale te bera nga nepunes te gjendjes civile dhe per rrjedhoje mos plotesim te kerkesave te shtetasve per sa ata pretendojne. Ne ndonje rast ankohen edhe per zvarritje te procedurave gjatë trajtimit të kerkesave.

Ne ankesat lidhur me sherbimet qe ofron kjo Zyre, pjesa me e madhe jane pefunduar, duke i informuar dhe sqaruar ankuesit per rrugen e zgjidhjes qe duhet te ndjekin dhe procedurat paraprake per realizimin e te drejtave te tyre, bazuar ne ligjin Nr.8950 date 10.10.2002 "Per Gjendjen Civile", ndryshuar me li9gjin Nr.9029 date 13.03.2003 "Per Gjendjen Civile".

Vecojme ankesen e shtetasit K.M i cili kerkonte te informohej se si duhet te vepronte dhe si e percaktonte ligji shqiptar per Gjendjen Civile ndryshimin e kombesise. Lidhur me kete ankese iu shpjegua ankuesit se : Ne baze te ligjit nr. 9029 date 13.03.2003 "Per Gjendjen Civile" neni 37/1 percakton se:

"Foshnja merr kombesine e prinderve me kombesi te njejte te dokumentuar ne Rregjistrin Themeltar te Gjendjes Civile.Kjo kombesi nuk mund te ndryshohet pervec rasteve kur sipas ligjit vertetohet pasaktesia e kombesise se prinderve ose kur ka nje vendim gjyqesor te formes se prere per ndryshimin e atesise ose memesise.

Ndryshimi i kombesise ne cdo rast tjeter behet me vendim gjyqesor".

Gjithashtu permendim ankesen e paraqitur nga M.M, ne te cilen shprehet shqetesimi lidhur me pasaktesine e certifikates personale te leshuar nga ana e zyres se gjendjes civile Vlore, ne te cilen ankuesja rezulton e

martuar por qe ne fakt ka vite me statusin e te shkuorezuares, megjithese po nga kjo zyre ne te shkuaren eshte pajisur me certifikate personale te sakte. Duke gene se kishim te benim me nje gabim material Institucioni yne ju drejtua Zyres se Gjendjes Civile nr.3 Vlore. Ne vijim te kesaj nderhyrje u informuam se nga kjo zyre u realizua korrigjimi perkates, sipas gjendjes faktike te ankueses.

Vecojme dhe ankesen e paraqitur nga shtetasi D.K. ne te cilen shprehet shqetesimi lidhur me mospajisjen me certifikate personale nga ana e zyres se Gjendjes Civile ne Zalle Dardhe.

Gjate shqyrtimit te kesaj ankese u informuam se nga ana e kesaj zyre nuk eshte bere e mundur ky lloj sherbimi, pasi te dhenat personale te ankuesit jane transferuar ne qytetin e Tiranes, gje te cilen ankuesi e kundershkonte pasi nuk kishte bere ndonje kerkese ne te cilen te kishte kerkuar transferimin e te dhenave.

Per sqarimin e kesaj ankese Institucioni iu drejtua Zyres se Gjendjes Civile Zall Dardhe, nga e cila u informua se sipas te dhenave qe ndodhen ne rregjistrin themeltar shtetasi D.K. i perbere nga 6 persona perfshire dhe K. K. eshte shperngulur ne Zyren e Gjendjes Civile Kashar ne Tirane qe ne vitin 1996. Ne vitin 2000 ankuesi i kishte kthyer keto dokumenta ne Zyren e Gjendjes Civile Zalle Dardhe, sipas shenimeve te bera ne regjistrin perkates, por nuk ishin pasqyruar ne Zalle Dardhe.

Lidhur me sqarimin e rregjistrimit te te dhenave te shperngulura nga kjo zyre ne Tirane, pasi u disponuan te gjitha informacionet, u sqarua dhe ankuesi per cdo veprim te kryer nga Zyrat Civile respektive.

Ne konteksin e ankesave me te njejten problematike, duhet nenvizuar fakti se per shkak te levizjes se lire te shtetasve nga nje vend ne tjetrin jo ne pak raste rezulton qe nuk kryhen veprimet perkatese ne Regjistrin e Gjendjes Civile, te regjistrimeve apo c' regjistrimeve sipas rastit, duke krijuar shume probleme dhe veshtiresi ne drejtim te identifikimit dhe per rrjedhoje veshtiresohet pajisja me dokumentat perkatese personale te kerkuara ne keto Zyra.

Permendim dhe ankesen e H.K, lidhur me Zyren e Gjendjes Civile Berat, sepse sipas saj, kjo zyre nuk e pajis nipin e saj me certifikate pasi ai duhet te jete i shoqeruar nga nje prind i tij.

Per sa me siper Zyra jone e informoi shtetasen H.K se: *“Ne baze te ligjit n.8950 date 10.10.2002” Per Gjendjen Civile” neni 5 percakton se, te dhenat individuale e familiare te perberesve te gjendjes civile kane karakter personal. Aktet, te dhenat dhe konfirmimet shkresore per gjendjen civile i jepen vetem personit te cilit i perkasin, anetarit te familjes, kujdestarit, perfaqesuesit ligjor ose me prokure”.*

Ne kete rast lidhur me pergjigjen e marre prej zyres se gjendjes civile, u sqarua ankuesja se si kujdestare e nipit mund ta terhiqe certifikaten duke paraqitur vertetimin e Bashkise Durres ose me prokure.

Rastet e paraqitura me lart, jane ndjekur me kembengulje dhe perkushtim dhe ne shumicen e rasteve jane zgjidhur kerkesat e shtetasve. Por nga rendesia do te permendnim ceshtjen e ndjekur me iniciative nga Zyra jone dhe qe lidhet me *permirësimin e Ligjit Nr. 8950, datë 10.10.2002 "Për gjëndjen civile"*.

Inicimi per ndjekjen e kesaj ankese ishte rasti i bërë publik nga përfaqësuesja e OJF-së "CAFOD" për mosregjistrimin 200 fëmijëve në Komunën e Paskuqanit në rrethin e Tiranës. Pas këtij njoftimi, përfaqësuesit e Institucionit tone shkuan në Zyrat e Gjëndjes Civile të Komunave Paskuqan, Bathore, Zallherr dhe në Bashkinë Kamëz dhe u interesuan për këtë problem. Nga komunikimi me punonjësit e Zyrave të Gjëndjes Civile dhe me drejtuesit e pushtetit vendor në këto njësi administrative, u informuam se problemi i mosregjistrimit të fëmijëve në regjistrat e Gjëndjes Civile ishte kthyer një problem shqetësues. Gjithashtu, prej tyre u informuam se në shume raste, regjistrimi i lindjeve nuk bëhet brenda afatit të përcaktuar ligjor (*45 ditë nga data e lindjes*). Sipas pikës 5 të nenit 34 ligjit Nr. 8950, datë 10.10.2002 "Për gjëndjen civile", ndryshuar me ligjin Nr. 9029, datë 13.03.2003 dhe ligjin Nr. 9229, datë 29.04.2004, me kalimin e këtij afati kohor, kërkohet realizimi i një procesi gjyqësor për konfirmimin e lindjes si dhe pagesa e një gjobe prej 2.000 lekësh (të reja). Pra këto familje, përveç gjobës jo të vogël, duhet të përballojnë edhe shpenzimet e avokatit, që në rastin më të mirë, janë rreth 30.000 lekë (të reja) për këtë shërbim. Një praktikë e tillë, e cila kërkon kohë dhe shpenzime financiare dhe njohje ligji frenon regjistrimin e fëmijëve. Kjo ka bërë që edhe numri i fëmijëve të paregjistruar, sidomos nga shtresat e varfëra të popullsisë, të njohë ndër vite vetëm rritje. Dukuria e mosregjistrimit shfaqet në të njëjtën mënyrë edhe në rastin e vdekjeve, sikurse eshte bere e njohur dhe kohet e fundit nga mediat e shkruara dhe elektronike, sidomos ne kete prag fushate zgjedhore, por qe eshte ngritur qe ne vitin 2002 nga Institucioni yne.

Dukuritë e sipërpërmëndura të mosregjistrimit të lindjeve të fëmijëve dhe të vdekjeve janë shumë e përhapura në minoritetin Romë dhe në familjet e shpërngulura në Tiranë gjatë 15 viteve të fundit. Në rastin e të shpërngulurve, si shkak kryesor i mosregjistrimit në afat është fakti se, duke qënë se këto familje vazhdojnë të jenë të regjistruara në zyrat e gjëndjes civile të vëndbanimeve të mëparshme, prindërve të të lindurve apo familjareve të të vdekurve, u duhet të shkojnë pikërisht në ato zyra për të bërë raportimin e lindjeve apo të vdekjeve. Kjo gjë kërkon shpenzime

udhëtimi dhe harxhim kohe. Pra, në shumicën e rasteve, mosregjistrimi për këtë pjesë të popullsisë, ka ardhur si rezultat i mostransferimit të dokumentave të gjëndjes civile në zyrat e gjëndjes civile të vendbanimit të ri.

Kjo është një dukuri me përmasa të konsiderueshme dhe jo vetëm në Tiranë, por në të gjitha njësitë administrative teritoriale të vendit. Ne kemi konstatuar se kërkesat e ligjit ekzistues të gjëndjes civile përbëjnë një pengesë të pakapërcyeshme për familjet e shtresave të varfëra dhe të paarsimuar për regjistrimin e fëmijëve të tyre.

Theksojmë se shteti ka detyrime ligjore për regjistrimin e tyre. Në bazë të Nenit 7 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, ku shteti ynë është palë që në vitin 1992:

“Fëmijët duhet të regjistrohen menjëherë paslindjes Shtetet Palë duhet të sigurojnë zbatimin e kësaj të drejte në përputhje me legjislacionin e tyre dhe detyrimet ligjore ndërkombëtare përkatëse...”

Mosregjistrimi i këtyre fëmijëve është me pasoja shumë të rënda për të tashmen dhe të ardhmen e tyre, duke iu mohuar çdo mundësi për akses në jetën normale, për shkak të mungesës së një dokumenti identifikimi (çertifikate apo pasaporte). Si rrjedhojë, ata nuk mund të përfitojnë nga shërbimet shtetërore që iu ofrohen, nuk mund të pajisen me pasaporte për të lëvizur lirisht jashtë shtetit, nuk mund të regjistrohen në shkollë, nuk mund të futen në punë, nuk mund të votojnë kur bëhen madhorë, pra atyre iu cënohen shumë të drejta njerëzore. Duke qënë të paregjistruar, ata janë kontigjenti i parë për trafikim të qënieve njerëzore. Nevoja për t’u pajisur me dokumenta të kësaj këtë kategorie qytetarësh, do të nxisë falsifikimet dhe krimin.

Nga ana tjetër, krijimi i mundësisë së raportimit të lindjes apo të vdekjes, jo vetëm në zyrën e gjëndjes civile ku është regjistruar familja, por edhe në zyrën e gjëndjes civile në teritorin e të cilës ka ndodhur lindja apo vdekja, lehtëson procesin e regjistrimit të lindjeve dhe të vdekjeve, duke krijuar lehtësira për familjet që nuk e kanë realizuar ende transferimin e dokumentave të gjëndjes civile, në momentin kur ju lind një fëmijë apo kur ju vdes nje familjar.

Përderisa ligji lejon regjistrimin e martesave në çdo zyrë të gjëndjes civile, atehere duhet të shtohen mundësitë edhe për raportimin e lindjeve dhe vdekjeve në çdo zyrë të gjëndjes civile, sepse mosregjistrimi i tyre është me pasoja jo vetëm për qytetarët, por edhe për vetë shtetin.

Duhet marrë në konsideratë edhe rekomandimi i Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve pranë Kombeve të Bashkuara, i cili në Konkluzionet përfundimtare rekomandon Shtetin Shqiptar *që të marrë masa për*

promovimin e regjistrimit të fëmijëve, duke përfshirë edhe lehtësimin e procedurave për regjistrimet e vonuara kur është e nevojshme dhe duhet t'i kushtojë vëmendje në veçanti grupeve më të prekura.

Për të eliminuar këtë dukuri anormale dhe për t'i dhënë një zgjidhje përfundimtare këtij shqetësimi, Zyra i rekomandoi Ministrit të Brendshëm që të paraqitej një propozim Kuvendit të Shqipërisë për të ndryshuar e përmirësuar ligjin Nr. 8950, datë 10.10.2002 “Për gjëndjen civile”, në keto drejtime :

1. Duke hequr procedurën gjyqësore të konfirmimit të lindjes dhe të vdekjes dhe zëvendësimin e tij me verifikimin administrativ.

2. Krijimin e mundësive të regjistrimit të lindjeve dhe vdekjeve jo vetëm në zyrën e gjëndjes civile ku është regjistruar familja, por edhe në zyrën e gjëndjes civile në teritorin e të cilës ka ndodhur lindja apo vdekja.

Megjithese për këto çështje nuk disponojmë pergjigje me shkrim, çështja me rekomandimet e paraqitura do të ndiqet dhe në vitin në vazhdim, për të bërë të mundur përmirësimin sa më shpejt të jete e mundur të kuadrit ligjor që rregullon këto çështje, sa të rëndësishme aq dhe ligjore. Rastet e trafikimit të fëmijëve Rome të bërë publike kohët e fundit flasin për nevojën e këtij rregullimi.

Një rëndësi të veçantë ka patur këtë vit dhe ndjekja me iniciativë e problemit për kostot e larta të shërbimeve në zyrat e Gjendjes Civile, për të cilën Zyra jone në datë 14.07.2006 i paraqiti një rekomandim Kryeministrit të Shqipërisë dhe Ministrit të Brendshëm duke kërkuar- *përmirësimin e shërbimeve të gjendjes civile në favor të qytetarëve, për të shmangur praktika që shkaktojnë shpenzime të tepërta, volem të panevojshëm pune dhe rradhe të gjata.*

Në këtë rekomandim nënvizohet se Institucioni i Avokatit të Popullit ka përkrahur çdo iniciativë të Qeverisë që synon të deburokratizojë dhe verë në efikasitet të plotë shërbimet që ofron administrata publike karshi individëve. Ky mision përben një çështje më të madhe që kërkon angazhimin e të gjithëve për të ndryshuar imazhin e organeve të shtetit, në kuadër të rritjes dhe përmirësimit të standardeve të tyre. Në këtë aspekt, Institucioni i Avokatit të Popullit ka patur krahas të tjerash në fokus të veprimtarisë së tij mbikqyrjen e atyre organeve apo zyrave shtetërore, të cilat për shkak të mangësive ligjore, administrative, dukurive të ekzagjeruara burokratike dhe mungesës së aftësive menazhuese kanë krijuar një varg të metash dhe parregullsish të dukshme në shërbimet që ofrojnë tek qytetarët. Në këtë këndvështrim dhe për të ardhur në ndihmë ilustrimit konkret të kësaj problematike, Institucioni i Avokatit të Popullit ka zhvilluar së fundi një

studim prane Zyrate te Gjendjes Civile te Njesive Bashkiake Nr. 3, 4, 5 dhe 6 ne Tirane.

Ky studim ka patur per objektive te nxjerre ne pah parregullsite dhe dukurite negative administrative qe shkaktojne rradhe te gjata, volum te paperballueshem pune, shpenzime te panevojshme te personave te interesuar etj.

Nga te dhenat e administruara gjate verifikimeve ne keto zyra, rezultoi krahas te tjerash se nje fluks i konsiderueshem kerkesash nga individete ndryshem paraqiten per vertetimet e banimit. Ky akt perpilohet nga Zyrat e Gjendjes Civile dhe firmoset nga Kryetari i Njesise Bashkiake, duke qene i shoqeruar nga nje çertifikate personale. Pra qytetarit i duhet te shpenzoje detyrimisht 50 leke per tu pajisur me nje çertifikate personale dhe mandej te kerkoje vertetim vendbanimi qe kushton 100 leke.

Nga informacioni zyrtar qe disponojme, rezulton se mesatarisht ne nje dite nje nga Zyrat e Gjendjes Civile ne Tirane leshon rreth 35 vertetime banimi. Nga nje perlllogaritje e thjeshte del se ne harkun kohor 1 vjeçar, Zyrat e Gjendjes Civile ne Tirane prane 11 Njesive Bashkiake leshojne rreth 92.400 vertetime vendbanimi qe kapin vleren totale ne te ardhura ne shumen 9.240.000 leke. Ketij totali per shkak te detyrimit te shoqerimit te vertetimit te vendbanimit me nje çertifikate personale i shtohet edhe nje vlere 50 leke per çdo vertetim, e cila ne total vjetor te perafert kap shifren 4.620.000 leke.

Ne keto kushte per te qene me te qarte, mund te deklarojme se shpenzimet e pergjithshme te qytetareve te Tiranës brenda periudhes 1 vjeçare per tu pajisur me vertetim banimi plus çertifikate personale jane ne shifren e perafert 13. 860.000 leke.

Referuar shifrave te mesiperme, Avokati i Popullit gjykon se shpenzimet e taksapaguesve te Tiranës per tu pajisur me vertetim banimi jane te panevojshme dhe nuk justifikohen nga kosto e sherbimit te administrates se gjendjes civile.

Konkretisht ne Ligjin Nr. 8950 dt.10.10.2002 "*Per Gjendjen Civile*" ndryshuar me Ligjin Nr.9229 dt.29.04.2004 dhe ne aktet nenligjore perkatese nuk eshte percaktuar sherbimi me tarife per vertetimin e vendbanimit. Ky vertetim eshte nje akt i thjeshte qe leshohet nga gjendja civile per te vertetuar vendbanimin e individit. Ky akt perbehet nga nje ¼ flete normale (A4) ne te cilen shenohet konform fletes se rregjistrimit themeltar dhe çertifikates personale, njesia bashkiake ku jeton dhe adresa e shtetasit, e cila ne fund firmoset nga Kryetari i Njesise Bashkiake. Ketij vertetimi ne ndryshim nga çertifikata personale apo familjare i mungon kostoja e elementeve te sigurise se dokumentit. Ai pasqyron tarifen e pajustificueshme prej 100 leke, qe sipas njesive bashkiake eshte miratuar me Vendimin e

Keshillit Bashkiak Tirane Nr.7 dt.07.03.2003 “*Per Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore ne Qytetin e Tiranes*”.

Ne kete rast mendojme se kjo tarife nuk gjen aspak mbeshtetje ne nenin 67 te Ligjit Nr. 8950 dt.10.10.2002 “*Per Gjendjen Civile*” ndryshuar me Ligjin Nr.9229 dt.29.04.2004 ne te cilin midis te tjerash thuhet se tarifate e sherbimit te gjendjes civile miratohen nga Keshilli i Ministrave.

Ne Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.550 dt.01.08.2003, ndryshuar me Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.190 dt.10.04.2004 “*Per Tarifate e sherbimeve qe kryhen nga Sherbimi i Gjendjes Civile*” vertetimi i banimit si sherbim i veçante i sherbimit te gjendjes civile, nuk gjen pasqyrim.

Ne mungese te ketij percaktimi, pushteti vendor nuk eshte i autorizuar te vendose tarifa sherbimi per vertetim banimi dhe per pasoje çdo pagese e kryer do te ishte e pa mbeshtetur ne ligj. Per alogjizem ne gjendjen e ketij vakumi, sherbimi i gjendjes civile per rastin konkret duhet te ishte pa pagese deri ne nje vendim te veçante te Keshillit te Ministrave qe do te percaktonte tarifate sipas ligjit.

Gjithashtu ne veshtrim te Ligjit Nr.8950 dt.10.10.2002 “*Per Gjendjen Civile*” ndryshuar me Ligjin Nr.9229 dt.29.04.2004 te krijohet pershtypja se Zyrat e Gjendjes Civile nuk parashikohen te kene detyre funksionale dhe kryesore leshimin e vertetimit te banimit. Kjo eshte nje proçedure qe derivon nga te dhenat personale qe rezultojne ne rregjistrat perkates dhe qe per pasoje duhet te leshohen per efekt dokumenti, ne mungese te nje mundesie tjeter per ta pasqyruar kete te dhene.

Ne kete kontekst Ligji Nr. 8950 dt.10.10.2002 “*Per Gjendjen Civile*” nuk parashikon te dhena eksplicite te çertifikates personale dhe ne te tilla rrethana mendojme se Keshilli i Ministrave ka diskrecion te plote te vendose ne kete dokument vendbanimin e personit krahas te dhenave te tjera personale. Ky ndryshim propozohet te kryhet ne kuader te reduktimit te shpenzimeve dhe rradheve te panevojshme qe perballojne qytetaret per pajisjen me vertetim banimi dhe te eleminimit te proçedurave te panevojshme burokratike te administrates publike. Mendojme se ky propozim nuk do te ngjalle paqartesi dhe pasiguri edhe per ato raste kur ka te dhena kontradiktore te vendbanimit, pasi ligji i mesiperem ka parashikuar afate dhe ndeshkime rigoroze per personat qe nuk deklarojne vendbanimin e ri.

Ne nje aspekt tjeter, nderhyrja e Keshillit te Ministrave eshte mjaft e domosdoshme per ti prere rrugen kerkesave te panevojshme qe jane sanksionuar ne mjaft formulare sherbimesh te administrates publike, ku njeri nga kriteret e plotesimit te dokumentacionit eshte edhe vertetimi i banimit.

Ky informacion eshte reklamuar nga njesite bashkiake te Qytetit te Tiranes, si njeri nga shkaqet kryesore te volumit te larte te leshimit te ketij dokumenti.

Organet kryesore te administrates publike qe kerkojne kete dokument jane sistemi arsimor parashkollor dhe shkollor publik gjate procedurave te rregjistrimit te nxenesve, sherbimi shendetesor paresor per hapjen e kartelave mjekesore, drejtorite rajonale te sherbimit te transportit rrugor per leshimin e deshmive te drejtimit te automjetit etj.

Mendojme se ne kete rast paraqitja e nje kopje te certifikates personale, ku do te gjente pasqyrim edhe adresa e personit, eshte mese e mjaftueshme per te permbushur kerkesat e ketyre organeve. Por ne çdo rast vlen te merret ne konsiderate propocionaliteti i ketij veprimi, i cili ne shume raste ka rezultuar i panevojeshm per kerkesat administrative te organeve shteterore.

Institucioni i Avokatit te Popullit, duke marre shkas nga iniciativa e Qeverise per te thjeshtuar sherbimet e administrates, beson se evidentimi i vazhdueshem i praktikave administrative problematike te organeve shteterore qe kryejne sherbime publike dhe venia e tyre ne dukje per zgjidhje imediate, duhet te jete parim baze i punes tone te perbashket, per te realizuar ne nje kohe te shkurter nje kusht te rendesishem te Marreveshjes se Asocim-Stabilizimit, siç eshte reformimi i nje administrate sa me efçente.

Për të gjitha arsyet dhe konstatimet e përmendura me lart, ku del mese e nevojshme permbushja dhe zbatimi korrekt i dispozitave ligjore ne favor te individeve te interesuar per sherbime sa me kompakte te zyrave te gjendjes civile, Avokati i Popullit rekomandoi:

-Permiresimin e sherbimeve te gjendjes civile ne favor te qytetareve, per te shmangur praktika qe shkaktojne shpenzime te teperta, volum te panevojshem pune dhe rradhe te gjata.

-Marrjen e masave me karakter normativ dhe administrativ per te eleminuar shpenzimet e panevojshme qe kryhen nga personat e interesuar per tu pajisur me vertetime banimi.

Ky ka qene nje rekomandim mjaft i rendesishem, per te cilin ne vitin 2007 do te organizojme nje inspektim per te pare se sa ka ndryshuar situata. Duke mos patur ne konsiderate luften politike te zhvilluar per certifikatat e gjendjes civile, lidhur me zgjedhjet vendore 2007, ne mendojme se Urdheri i Ministrit te Brendshem per te hequr vlefshmerine 3 mujore te certifikatave kur shtetasve u duhen per qellime administrative, eshte nje zgjidhje qe ka shkurtuar burokracine dhe shpenzimet si dhe zhdukur rradhet e gjata te shtetasve para zyrave te gjendjes civile.

6. Ministria e Mbrojtjes

Per vitin 2006 ndaj strukturave te Ministrisë së Mbrojtjes janë bërë 61 kërkesa e ankesa nga subjekte ushtarakë apo ish ushtarakë. Për vitin 2006 janë përfunduar 59 nga ankesat e paraqitura. Janë në shqyrtim edhe 2 ankesa që i përkasin muajit dhjetor 2006. Duke analizuar në tërësinë e tyre ankesat e ardhura në Institucionin tonë për vitin 2006, konstatohet se ato janë bërë kryesisht nga oficerë, nënoficerë, nga punonjës civile, ushtarë, si dhe ushtarakë të dalë në rezervë.

Nga ankesat e përfunduara gjatë vitit 2006, rezulton se 14 ankesa ose 24 përqind e tyre kanë gjetur zgjidhje pozitive. Ky është një tregues mjaft i kënaqshëm që tregon efikasitetin e punës sonë si dhe bashkëpunimin e frytshëm me Ministrinë e Mbrojtjes. Ndërsa 15 ankesa ose 25 përqind kanë qënë jashtë kompetencës tonë, 24 ose 41 përqind kanë qënë ankesa te pabazuara, në 4 raste ose 7% ankesat kanë qënë jashtë juridiksionit. Në 2 raste ose 3% e ankesave kanë përfunduar me heqje dorë nga ankuesi.

Gjatë vitit 2006 zyra e Avokatit të Popullit ka marrë takim me një numër të madh subjekte ushtarake. Në këto takime ata kanë prezantuar ankesat e tyre. Për ato raste që kanë gjykuar të bëjnë ankesat me shkrim, ata i kanë bërë me shkrim. Organizimi i ditëve të hapura në repartet ushtarake gjatë këtij viti nuk u bë i mundur. Duke parë si mënyra e vetme, për të larguar ngurimin e kësaj kategorie individësh për të bërë ankesa, këtë vit kemi planifikuar të organizojmë ditët e hapura në repartet ushtarake me grup ekspertësh. Mosorganizimi i ditëve të hapura shpjegon atë, që numri i ankesave të marra nga ushtarët për vitin 2006 është më i vogël.

Në përgjithësi natyra e ankesave të prezantuara pranë Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2006 ka qënë:

1. Ankesa për mobilizim në shërbimin ushtarak në kundërshtim me ligjin.
2. Të keqtrajtimit të ushtarëve apo marinarëve nga ana e komandantëve të tyre.
3. Për pensionet e ulta të ushtarakëve të dalë në rezervë para vitit 1992.
4. Ankesa për moszbatim të ligjit për daljen e ushtarakëve në rezervë.
5. Kundër Komisionit të Statusit të Veteranit dhe Dëshmorëve të Atdheut.
6. Për pensionin suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë
7. Mosdhënie e gradës sipas ligjit.etj.

1. Shtetasi S. D. nga Durrësi ka prezantuar ankesën e tij se djali i tij S. S. D. ishte thirur në shërbimin e detyrueshëm ushtarak në kundërshtim me ligjin. Për këtë zyra jonë pas pranimit të ankesës dhe verifikimeve të nevojëshme i kërkoj shpjegime Drejtorisë së Personel Organizimit pranë Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Në përfundim njoftohemi se S. S. D. me urdhërin nr. 794 datë 21.11.2006 është liruar para kohe nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak aktiv.

2. Në Brigadën e Stërvitjes Bunavi ushtar K.K. u ankua se nga ana e komandantit të tij L.D ishte keqtrajtuar duke e goditur dhe përplasur kokën në mur. Si rezultat i këtij veprimi i sipërpermenduri u bë i paaftë për vazhdimin e mëtejshëm të shërbimit ushtarak. Për këtë zyra jonë ndërmori një hetim të hollësishëm duke marrë edhe kartelat klinike të spitalit ushtarak, nga ku në përfundim rezultoi se ankesa e ushtarit ishte e drejtë. Për këtë do të kërkohej nisja e procedimit penal ndaj oficerit L.D. Por ndërkohë ankuesi hoqi dorë nga ankesa. Të detyruar nga ky fakt, duke mos na lejuar ligji të vepronim, çështja u arkivua. Por përpjekjet tona për të zbuluar dhe për të parandaluar raste të kësaj natyre vazhdojnë.

3. Njëpërmjet ankesave të subjekteve ushtarake del përsëri në pah, që ankesat e ushtarakëve apo ish ushtarakëve që ndërpresin karrierën, apo e kanë ndërprerë atë, kohë më parë në kuadrin e reformës në Forcat e Armatosura qysh nga viti 1992 e në vazhdim, zënë një vënd të konsiderueshëm. Këta persona ankohen se, jo vetëm që masa e pensionit të tyre është më e ulët se pensioni i kolegeve të tyre që kanë dalë në pension pas vitit 1993, edhe pse kanë qënë të barazvlefshëm në detyrë, por dhe për të kundërshtuar inisiativën e Kryeministrit , për të ndryshuar ligjin nr. 9418 datë 20.05.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Kërkesa apo ankesa të kësaj natyre kanë paraqitur jo vetëm individë të caktuar, por edhe shoqata e grupime të tjera ish ushtarakësh.

Avokati i Popullit qysh më datën 29.11.2003 i ka drejtuar Kryeministrit z. Fatos Nano, rekomandimin në lidhje me shqyrtimin dhe kalimin në Kuvend të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8087, datë 13.03.1996, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Kombëtar në Republikën e Shqipërisë”. Zyra jonë në fazën kur akoma nuk kishte hyrë në fuqi ligji, (mbasi ai hynte në fuqi më 1 janar 2006), nuk mund të ndërhynte. Për këtë problem përgjigja jonë ka qënë se është e drejta e Qeverisë të bëjë propozime për ndryshime në ligje. Më datë 16.02.2006 Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar Ligjin nr. 9481 “Për

disa ndryshime në Ligjin nr. 9418 datë 20.05.2005. “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, Ligj i cili është botuar në Fletoren Zyrtare pa u dekretuar nga Presidenti i Republikës. Shoqata Kombëtare e Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë ka kundërshtuar këtë ligj, duke kërkuar pranë Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin e disa dispozitave të tij si të papajtueshme me Kushtetutën dhe Ligjin nr. 9210 datë 23.03.2004 “Për Statusin e Ushtarakut në Forcat e Armatosura në Republikën e Shqipërisë”. Me shpalljen e vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe daljen e akteve të tjera zbatuese shpresojmë, që këto probleme të marrin zgjidhjen e duhur.

Është për tu përmendur fakti se, pak nga këta subjekte kundërshtojnë daljen në rezervë pasi, për një gjë të tillë, në përkrahje të reformave në Forcat e Armatosura, ata janë ndërgjegjësuar. Por ankesat e tyre kanë të bëjnë me mospërfitimet e të drejtave që ju siguron atyre ligji nr. 8087, datë 13.03.1996 dhe ndryshimet përkatëse të mëvonshme të këtij ligji. Jo gjithmonë nga strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe disa komanda ushtarake është vepruar me korrektesë, drejt dhe në kohë, në mënyrë që këta ushtarakë, pas ndërprerjes së karrierës, të përfitojnë atë ç’ka ju takon me ligj.

Nga përgjithësimi i këtyre rasteve, ne kemi arritur në konkluzionin se gjatë zbatimit të reformës, në mënyrën se si është vepruar ka patur në disa raste shkelje të të drejtave të kësaj kategorie ushtarakësh. Ankesat e tyre janë bërë prezent tek ne gjatë vitit 2006 dhe kanë përbërë një pjesë të rëndësishme të punës sonë. Konkretisht, pas hetimit tonë për këto ankesa doli se, Ministria e Mbrojtjes pas përcaktimit të kriterëve të reformës si mosha, profesionalizmi dhe përkushtimi në detyrë, ka filluar në vazhdimësi procedurat e ndërprerjes së marrëdhënieve të karrierës së oficerëve aktivë të planifikuar për t’u larguar. Por këto procedura, nuk u kryen gjithmonë konform ligjit dhe akteve nënligjore, por u veprua në mënyrë të tillë, që solli hapur shkeljen e të drejtave e tyre. Kështu I. P. dhe I.K janë ankuar se pas daljes në rezervë nuk ju është dhënë shpërblimi për kohën e lejes së pagueshme që nuk e kishin marrë. Për këtë rast, bashkëpunimi i frutshëm me Drejtorinë e Planifikimit, Programimit dhe Buxhetit në Ministrinë e Mbrojtjes bëri që ata të marrin shpeblimin që ju takonte.

4. Ka edhe ankesa të tilla p.sh ushtaraku V.Ç i është drejtuar me anën e një letre Institucionit të Avokatit të Popullit. Ai është ankuar se e kanë nxjerrë në rezervë me urdhërin nr. 2111 datë 04.07.2005. Duke vlerësuar se urdhëri ishte në kundërshtim me ligjin, ankuesi i është drejtuar Ministrit të Mbrojtjes, por nuk ka marrë asnjë përgjigje. Ka shkuar disa herë në Ministri për t’u sqaruar, por asnjë zyrtar nuk pret dhe nuk e sqaron.

A.M. ka pretenduar se ka punuar prej 18 vjetësh si oficer aktiv me gradën kapiten i parë. Në kohën që do të gradohesha sqaron ai, më nxjerrin në rezervë. Pavarësisht se është e drejta e Komisionit të Lartë të Karrierës i cili ka autoritetin për vlerësimin e ushtarakut për të përparuar në gradë, ne mendojmë se në përzgjedhjen e efektivit për të nxjerrë në rezervë duhet të ketë më shumë qëndrime objektive e të vlerësohen edhe të drejtat e ushtarakëve.

5. Numri i përgjithshëm i ankesave të ardhura për vitin 2006, kundër Komisionit të Statusit të Veteranit dhe Dëshmorit të Atdheut ka qënë 19 ankesa ose rreth 32 përqind e numrit të ankesave të regjistruara për vitin 2006. Mënyra e përfundimit të tyre ka qënë: 7 ankesa janë zgjidhur në favor, 8 ankesa kanë qënë jashte kompetence, kurse 2 ankesa të pabazuara, 1 jashtë juridiksionit dhe 1 ankesë ka përfunduar me heqie dorë. Objekti i ankesave të paraqitura ka qënë për përfitimin e Statusit të Veteranit, për Statusin e Dëshmorit, apo dhe për përfitime shtesë që rrjedhin nga Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.190, datë 03.05.1995, për veteranët të cilët gjatë luftës kanë qënë në burgjet nazifashiste brënda apo jashtë vëndit.

Qysh në fillim konstatojmë se Ministria e Mbrojtjes në vite ka bërë vlerësimin e veteranëve duke paraqitur projektet e nevojshme dhe Qeveria ka nxjerrë Vendimet përkatëse. “Për rritjen e masës së shpërblimit të veteranëve të LANÇ-it të popullit shqiptar” etj.

Nga shqyrtimi i disa ankesave për këtë kategori personash, (veteranët e luftës) doli se dokumentat e paraqitura prej tyre pranë Komisionit Qëndror të Statusit të Veteranit, janë paraqitur jashtë afatit ose paraqitja e dokumentave me vonesë është bërë mbi bazën e një vendimi të gjykatës për rivendosjen e afatit.

Në këto rrethana, për ta zgjidhur këtë situatë, u bashkëpunua dhe me Departamentin e Veteranëve në Ministrinë e Mbrojtjes ku gjetëm mirëkuptim dhe predispozicionin e duhur. Vitin e kaluar në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes studjuam gjendjen e kërkesave të kësaj kategorie individësh. Në përfundim na rezultoi se: Pranë Departamentit të Veteranëve të Luftës, numri i veteranëve që kishin paraqitur ankesa ishte shumë më i madh se sa i janë drejtuar Institucionit tonë. Konkretisht janë rreth 2000 persona në shkallë vendi duke pritur shqyrtimin e dokumentave. Nga këta 1500 veteranë, kanë dërguar përsëri dokumentat në Komisionin Qëndror të Statusit të Veteranit dhe Dëshmorit të Atdheut, ndërsa 500 persona pretendojnë të marrin statusin me vendim gjykate si dhe mjaft të tjerë që pretendojnë të marrin Statusin e Veteranit të Luftës.

Personat e mësipërm i kishin paraqitur dokumentat e mësipërme jashtë afatit të përcaktuar, pas datës 30 Korrik 2002.

Me qëllimin e mirë për të vënë në vënd të drejtën e kësaj kategorie personash të cilët janë me moshë mbi 70 vjeç, me kushte jetese e mundësi të pakta financiare për të përballuar jetesën, dhe për t'ju dhënë një satisfaksion moral dhe material, Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrin të Mbrojtjes, ndërmarjen e inisiativës për hartimin e projektvendimit të Qeverisë, për caktimin e një afati të ri për paraqitjen e dokumentave pranë Komisionit Qëndror të Statusit të Veteranit të Luftës. Ndonëse Ministria e Mbrojtjes ishte dakort me këtë dhe e paraqiti draftin e shtyrjes së këtij afati, ai nuk u pranua nga Ministria e Financave. Institucioni i Avokatit të Popullit edhe këtë vit do të vazhdojë përpjekjet të nxisë Ministrinë e Mbrojtjes për ta paraqitur përsëri draftin për shtyrjen e afatit të shqyrtimit të dokumentave të veteranëve, duke e argumentuar bindësisht domosdoshmërinë e marrjes së një vendimi të tillë nga Qeveria. Por nga ana jonë nuk kemi mjaftuar me kaq. Duke gjykuar se V.K.M-ja nr. 748, datë 11.11.2004 ka krijuar një hapësirë për të aktivizuar Komisionin Qëndror të Statusit të Veteranit në rastet kur vendos gjykata për ta njohur këtë status, ju është rekomanduar ankuesve të kundërshtojnë vendimet e refuzimit të statusit të veteranit në gjykatë. Ka patur raste, kur nga ana jonë ju është dorëzuar e përgatitur kërkesa për kundërshtimin e vendimit që ka refuzuar statusin e veteranit, për t'i ndihmuar ata konkretisht.

Gjatë vitit 2006 një numër i konsiderueshëm ankuesish kanë prezantuar ankesat e tyre për zvarritje të theksuara të shqyrtimit të dokumentave për dhënien e statusit të Dëshmorit të Atdheut nga Komisioni i Statusit të Veteranit dhe Dëshmorit të Atdheut.

Kështu ka ndodhur me ankesën e shtetasit R. D, i cili në muajin shkurt të vitit 2006 është ankuar për zvarritje të procedurave të dhënies së Statusit të Dëshmorit të Atdheut. Për këtë ju kërkuar shpjegime stafit teknik të Komisionit të Statusit të Veteranit dhe Dëshmorëve të Atdheut. Me shkresën nr.95/1 datë 21.03.2006 njoftohemi se : ”Dokumentat për dëshmorin N. D. babai i ankuesit, janë depozituar pranë stafit teknik të Komisionit Qëndror në muajin Dhjetor 2005, periudhë kjo kur komisioni nuk është mbledhur për të shqyrtuar kërkesat me objekt shpallje dhe njohje të Statusit të Dëshmorit të Atdheut. Cilësojmë se dosja e lartpërmendur është vlerësuar dhe përgatitur për Komisionin e radhës, me vendimin e të cilit do të bëhet me dije edhe ankuesi”.

Në ndjekje të këtij rasti mësojmë se ndonëse kishte kaluar një kohë prej rreth 9 muaj, dokumentat e kërkesit përsëri nuk janë shqyrtuar nga ana e Komisionit. Në përgjigje të kërkesave tona për këto zvarritje, njoftohemi se dokumentat janë duke pritur që të shqyrtohen nga Komisioni, i cili deri tani nuk është mbledhur për të shqyrtuar këto kërkesa. Ne kemi insistuar për

një përgjigje të qartë për shkaqet e mosshqyrtimit të këtyre dokumentave. Por përgjigja ka qënë e njëjtë. Sa më sipër, sqarohet se dokumentat janë pregatitur dhe vlerësuar për të kaluar në mbledhjen e rradhës së Komisionit, i cili për të shqyrtuar këto dokumenta ende nuk është mbledhur. Pas insistimit tonë verbalisht jemi sqaruar se këto kërkesa nuk janë shqyrtuar mbasi është pritur të bëhen ndryshimet në ligjin për Statusin e Dëshmorit të Atdheut. Kohët e fundit Kuvëndi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 9650 datë 27.11.2006: Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8607 datë 27.04.2000 “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”. Në fillim të shkurtit 2007 Qeveria ka caktuar Komisionin Qendror për Statusin e dëshmorit si dhe afatin e tij, për ta përmbyllur përfundimisht këtë ligj.

Një prioritet i rëndësishëm i punës së Avokatit të Popullit që nga viti 2000 ka qënë zgjidhja e ankesave të ushtarakëve aktiv në lidhje me trajtimin e tyre financiar, për shkak të natyrës së vështirë të punës apo punës me orar të zgjatur etj. Nga raportet e mëparshme Avokati i Popullit ka rekomanduar nevojën e trajtimit financiar më të mirë të ushtarakëve aktiv apo për çeljen e fondeve për trajtimin financiar edhe të ushtarakëve të dalë në rezervë apo lirim. Me V.K.M-në nr.791, datë 26.11.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.839. datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e ushtarakëve aktiv të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, janë bërë shtesa në pagë për punë të vështira të ushtarakëve aktiv; shtesa për kushte të veçanta pune dhe shërbimi; shtesa në pagë sipas gradës dhe viteve të shërbimit si dhe shtesa për punë të vështira dhe të dëmshme për shëndetin. Këtë ne e vlerësojmë si një arritje të suksesshme për realizimin e objektivave tona në mbrojtje të të drejtave të ligjshme të njeriut, në sajë të një bashkëpunimi të ngushtë me Ministrinë e Mbrojtjes.

Ne mendojnë se një arritje tjetër e suksesëshme në punën tonë ka qënë mbrojtja e së drejtës së shtetasve shqiptarë, që për arsye ndërgjegje , nuk pranojnë të kryejnë shërbimin e detyrueshëm ushtarak me armë, ta kryejnë këtë shërbim duke e zëvendësuar, me shërbimin alternativ, ashtu siç parashikohet edhe nga neni 21 i Ligjit nr. 9047 datë 10.07.2003 “Për Shërbimin Ushtarak në Republikën e Shqipërisë”. Për mosplotësimin e detyrimit ligjor për ngritjen e Komisionit të Shërbimit Alternativ pranë Ministrisë së Mbrojtjes pengesë, ishte bërë Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Prandaj zyra jonë i dërgoi rekomandim për krijimin e kushteve të nevojshme për funksionimin e Komisionit të Shërbimit Alternativ Ministrit të Punës, Çështjeve sociale dhe Shanseve të Barabarta zotit Kosta Barka. Në këtë rekomandim u theksua se: Në pjesën e XV të Kushtetutës së Shqipërisë (Forcat e Armatosura), pika 2 neni 166 është përcaktuar e drejta e shtetasve, që për arsye ndërgjegje, nuk pranojnë

të kryejnë shërbimin me armë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, ta kryejnë këtë shërbim duke e zëvendësuar me shërbimin alternativ, ashtu siç parashikohet në ligj.

Ligji nr. 9047 datë 10.07.2003 datë 10.07.2003 në nenin 21 të tij, ka përcaktuar krijimin e Komisionit të Shërbimit Alternativ, si organ që shqyrton kërkesat dhe dokumentacionin e paraqitur, si dhe merr vendimin përfundimtar për vëndin ku do të kryhet shërbimi ushtarak i shtetasve që për arsye ndërgjegje nuk pranojnë të kryejnë shërbimin ushtarak me armë. Ministri i Mbrojtjes është ngarkuar të nxjerrë urdhër të veçantë për dokumentacionin që duhet të paraqesin shtetasit, që kërkojnë të kryejnë këtë lloj shërbimi. Përbërja, funksionimi dhe detyrat e të drejtat e Komisionit sipas ligjit duhet të përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Me vendimin nr. 39 datë 22.01.2004 të Këshillit të Ministrave është përcaktuar përbërja, funksionimi, detyrat dhe të drejtat e Komisionit të Shërbimit Alternativ. Në mbështetje të ligjit ka dalë urdhëri nr.207 datë 07.04.2004 i Ministrit të Mbrojtjes, i cili ka përcaktuar dokumentacionin, që duhet të paraqesë shtetasi për njohjen e të drejtës për kryerjen e shërbimit alternativ (pa armë). Aktet e mësipërme kanë përcaktuar se: Komisioni Alternativ ngrihet pranë Ministrisë së Mbrojtjes, ka si kryetar zëvendës Shefin e Shtabit të Përgjithshëm dhe e shtrin veprimtarinë në të gjithë vëndin.

Në pikën 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 39 datë 22.01.2004 është përcaktuar se Komisioni përbëhet nga 7 anëtarë, që caktohen respektivisht: Dy përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes, një përfaqësues nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, një përfaqësues nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit (Ministria e Brendëshme sot), një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, dhe një përfaqësues nga Komiteti Shtetëror i Kulteve. Në paragrafin e dytë të pikës 2 të nenit 22 të Ligjit Nr. 9047 datë 10.07.2003 “Për Shërbimin Ushtarak në Republikën e Shqipërisë, është parashikuar detyrimi i Ministrisë së Punës që të bashkërendojë punën me institucionet e shërbimit publik, njësitë e qeverisjes vendore, organizatat jofitimprurëse me karakter humanitar, shërbimin e mbrojtjes së mjedisit dhe shërbimin e zjarrfikësve, që në fund të çdo viti të dërgoni pranë Ministrisë së Mbrojtjes, numrin e vëndeve të punës për këtë shërbim. Pas rekomandimit tonë nga ana e Ministrisë së Punës është përcaktuar emri i anëtarit të këtij Komisioni, si dhe vëndet e punës ku do të dërgohen këta shtetas. Kjo ka krijuar premisa për zbatimin e të drejtës Kushtetuese, për shtetasit që kërkojnë të kryejnë këtë lloj shërbimi.

Është kënaqësi të raportojmë se Ministria e Mbrojtjes është një nga dikasteret e Administratës sonë Publike ku ne gjithmonë, qysh në fillim të veprimtarisë sonë në vitin 2000, kemi gjetur partnerë të gatshëm për të bashkëpunuar në mënyrë institucionale, me qëllimin e mirë dhe të vetëm për zgjidhjen e drejtë të problemeve dhe shqetësimeve të ushtarakëve.

Bashkëpunimi i mirë me Ministrinë e Mbrojtjes është realizuar në kontaktet direkte me drejtues dhe specialistë të drejtorive përkatëse, të ngarkuara për problemet dhe shqetësimet e ankesave të ushtarakëve dhe të Veteranëve. Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe informacioni i dërguar Ministrit të Mbrojtjes në muajin tetor 2005, pas fillimit të punës së Qeverisë Demokratike, ku parashtronim ankesat dhe problemet e pazgjidhura si duhet gjatë periudhës 2000-2004.

Në prioritetet e Punës së Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2007 do të jetë organizimi i ditëve të hapura dhe inspektimeve me grup ekspertësh në reparte të ndryshme, të Forcave Tokësore, Ajrore dhe Detare, me qëllim tërheqjen e ankesave dhe nga ushtarët e nënoficerët e Forcave tona të Armatosura si dhe bashkëpunimi më i ngushtë me Drejtoritë e ndryshme në Ministrinë e Mbrojtjes dhe strukturat e tjera ushtarake për zbatimin korrekt të ligjit dhe zgjidhjen e drejtë të ankesave të ushtarakëve.

7. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Kjo ministri ka bashkëpunuar shumë mirë me institucionin tonë gjatë vitit 2006.

Numri i ankesave të shqyrtuara nga Institucioni ynë lidhur me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB) si dhe të institucioneve në varësi të saj, Institutin e Sigurimeve Shoqërore Shtetërore, Shërbimin Social Shtetëror dhe strukturat e tyre në rrethe ka qenë **159**. Nga këto **19** ankesa kanë qenë për vetë Ministrinë, dhe janë përfunduar **16** ankesa. Kanë rezultuar **3** ankesa të pabazuara, **4** jashtë juridiksionit, **7** të zgjidhura në favor të ankuesve, **2** heqje dore. Janë në proces shqyrtimi **3** ankesa.

Në vijim po trajtojmë disa nga problematikat që janë shqyrtuar:

1. Qytetari M.L me banim në Peshkopi, paraqiti një ankesë ku kërkonte ndërhyrjen tonë institucionale në lidhje me krijimin e mundësive për sistemimin e tij në punë. Nga ana jonë ju kërkua informacion Zyrës Rajonale të Punësimit Dibër për politikën e punësimit që vihen në zbatim dhe konkretisht për mundësitë që mund t'i ofroreshin ankuesit.

Nga kjo zyrë u informuam se kishin ndërmjetësuar me Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Dibër për të parë mundësinë sa më të shpejtë të sistemimit të qytetarit M.L në punë.

2. Një grup personash që gëzojnë Statusin e Invalidit të Punës, me banim në qytetin e Lushnjës u ankuan ndaj MPÇSSHB në lidhje me kriteret e përfitimit të shtesës së pagesës si invalid pune.

Ankuesit shprehën shqetësimin e tyre se përse për të përfituar shtesën e pagesës si invalid pune pranë njësive të pushtetit vendor, një nga kriteret ishte paraqitja e fotokopjes së Dëshmisë së Invalidit të Punës. Kjo përcaktohej në Udhëzimin Nr.682/4 datë 18.06.2004 të nxjerrë nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale në zbatim të VKM-së nr.204 datë 16.04.2004 “Për masën dhe kriteret për përfitim paaftësie nga personat me Statusin e Invalidit të Punës”. Por ky Udhëzim binte në kundërshtim me nenin 46 të Kushtetutës së Shqipërisë. Sipas tyre, hartuesit e këtij udhëzimi duhet të kishin marrë parasysh se anëtarësimi në shoqata bëhet vullnetarisht dhe jo i detyruar.

Ne kërkua shpjegime shkresore nga kjo Ministri dhe u informuam se në zbatim të VKM-së nr.204 datë 16.04.2004 u miratua Udhëzimi nr.296 datë 08.02.2006 në të cilën u hoq kriteri i paraqitjes së Dëshmisë së Invalidit të Punës për të përfituar shtesën e pagesës si invalid pune pranë njësive të pushtetit vendor.

3. Një grup punonjësish të firmës “Ballkan” në Bilisht me anë të njoftimit me postë elektronike prezantuan shqetësimin e tyre lidhur me disa parregullsi që kishin të bënin me marrëdhëniet e punës dhe të mohimit nga ana e punëdhënësit të të drejtave të tyre të njohura nga ligji dhe aktet nënligjore që rregullojnë keto marrëdhënie.

Ata ankoheshin se nga ana e punëdhënësit, i cili ishte i huaj, nuk respektohej orari i punës ose koha javore e punës, ju mbahej padrejtësisht pjesë nga pagesa, nuk përfitonin pushime për ditët e festave apo të shtunat e të dielat dhe shfrytëzoheshin pa asnjë lloj shpërblimi apo kompensimi në pagë.

Pas marrjes në shqyrtim të ankesës, nga ana e Zyrës sonë u bashkëpunua me Inspektoriatin Shtetëror të Punës, duke bërë të mundur respektimin e të drejtave të këtyre punonjësve.

a. Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Gjatë vitit 2006 pranë Institucionit tonë janë paraqitur **132** ankesa drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe strukturave në varësi të tij. Janë përfunduar **123** ankesa. Nga këto ankesa kanë rezultuar **60** të

pabazuara, **25** jashtë juridiksioni, **16** jashtë kompetence, **3** heqje dorë, **19** të zgjidhura në favor të ankuesve. Aktualisht në proces shqyrtimi janë **9** ankesa. Gjithashtu janë shqyrtuar dhe përfunduar **15** ankesa të mbartura nga viti 2005. Nga këto ankesa kanë rezultuar **6** të pabazuara, **6** dërguar për kompetencë, **3** të zgjidhura në favor të ankueve.

Konstatohet se problematika që ngrihet në ankesat e qytetarëve është pothuajse e njëjtë si në vitet e tjera paraardhëse. Konkretisht qytetarët ankohen për masën e përfitimit të pensionit të pleqërisë, mosnjohjen e vjetërsisë në punë, mosdhënien e invaliditetit nga Komisionet përkatëse të Caktimit të Aftësisë për Punë, mospërfitimin e shtesave të pensionit të pleqërisë, zvarritje burokratike nga organet kompetente, apo për kohën e daljes në pension, mospërfitimin e pensionit familjar, mospërfitimin e pensionit si nënë me shumë fëmijë, sigurimin e detyrueshëm për personat e vetëpunësuar në bujqësi, derdhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore për pensionistët që zhvillojnë aktivitet privat etj.

Përgjithësisht nga këto ankesa kemi evidentuar se shpesh herë ankuesit, kryesisht për mosnjohje të Ligjit, nuk kanë konsumuar shkallët e ankimit administrativ në Komisionet e Ankimit pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore si dhe në Komisionin Qëndror të Ankimit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Në këto raste ndihma jonë juridike ka qenë e favorshme duke i dhënë mundësinë qytetarit të qartësohet për problemin e tij, pa i hyrë procedurave të zgjatura administrative nëpërmjet komisioneve. Këtë veprim ua kemi orientuar që ta kryejnë në një moment të dytë, në qoftëse nuk mbeten të kënaqur dhe më pas t'i drejtohen komisioneve përkatëse të Apelit.

Gjithashtu nga ana e Institucionit tonë është bërë një punë jo e vogël për informimin e qytetarëve për zhvillimet e herë pas hershme lidhur me përmirësimet në Ligjin “Për Sigurimet Shoqërore” si dhe mbajtjen në kontakt të vazhdueshëm të tyre për fazat e rishikimit të këtij legjislacioni. Kjo sepse është konstatuar fakti se shumë qytetarë kur i drejtohen Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore marrin përgjigje në mënyre verbale dhe jo shkresore, duke mos u qartësuar për kërkesat e tyre.

Në vijim po paraqesim disa çështje të përfunduara gjatë vitit 2006, të cilat kanë rezultuar të zgjidhura pozitivisht:

1. Qytetarja N.I. me banim në Tiranë paraqiti ankesë ndaj Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë në lidhje me mospërfitimin e pensionit familjar, si e ve dhe duke patur në ngarkim një fëmijë me aftësi të kufizuar. Megjithëse ankuesja kishte arritur moshën për të përfituar pensionin familjar pas vdekjes së të shoqit, nga ana e Agjensisë përkatëse ku

dorëzohen dokumentat, nuk i ishte dhënë e drejta e përfitimit të këtij pensioni.

Këtë ankesë e verifikuam pranë Agjensisë së Sigurimeve Shoqërore dhe pas takimit që patëm me punonjëset e kësaj agjensie, u bë e mundur zgjidhja pozitive e ankesës. Shtetasen N.I e ndihmuam të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm për të përfituar pensionin familjar.

2. Qytetari F.D banues në qytetin e Lushnjës ankohej ndaj Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Lushnjë se pensioni i plotë i pleqërisë nuk i jepej në masën e duhur. Për zgjidhjen e këtij problemi i kërkuam shpjegime shkresore DRSSH-Lushnjë. Nga ana e këtij organi pasi u bënë verifikimet e duhura, rezultoi se pretendimi i ankuesit ishte i drejtë dhe problemi u zgjidh pozitivisht.

Në këtë mënyrë në bazë të ndërmjetësimit tonë u bë e mundur rillogaritja e masës së tij të pensionit dhe qytetarit iu njoh e drejta ligjore e përfitimit të shtesave të pensionit të pleqërisë.

3. Qytetares P.M nga komuna Klos, Burrel nuk i jepej Fleta e Drejtimit nga Spitali nr.5 Tiranë ku ajo ishte shtruar, për ta paraqitur pranë Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë në Burrel për përfitimin e invaliditetit.

Me marrjen në shqyrtim të kësaj ankese i kërkuam shpjegime Drejtorisë së Spitalit nr.5. Nga ana e këtij Institucioni u informuam se pas konsultave të ribëra për gjëndjen e saj shëndetësore, u vendos pajisja e saj me Fletë-Drejtimi për KMCAP-in Burrel, me rekomandimin për 6 muaj grup të dytë invaliditeti.

4. Qytetari P.L nga Tirana kishte paraqitur vazhdimisht kërkesa pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tirane për t'u informuar në lidhje me lindjen e së drejtës për të përfituar pensionin e pleqërisë, por nuk kishte marrë asnjë përgjigje.

Pas ndërhyrjes së Zyres sonë pranë këtij Institucioni, u realizua informimi i plotë i ankuesit për kohën e daljes në pension pleqërie. Pasi të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm për përfitimin e këtij pensioni, të paraqitej për t'i dorëzuar pranë Agjensisë përkatëse të Sigurimeve Shoqërore.

Po kështu duhet të theksojmë faktin se nga trajtimi i mjaft ankesave, të cilat pas shqyrtimit kanë rezultuar të pabazuara, është bërë punë për sqarimin ligjor të problemeve të parashtruara nga ankuesit.

Në bazë të të gjitha evidentimeve, statistikave dhe observimeve të nxjerra si dhe bazuar në rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit që ndikon dhe përçon vizionin e mirëqeverisjes, është arritur në konkluzionin se Qeveria Shqiptare së bashku me institucionet e tjera përkatëse, me gjithë

arritjet e deritanishme, duhet të jetë më efektive, më reale dhe më e përgjegjshme në politikat që lidhen me fushën e sigurimeve shoqërore.

Ky konkluzion ka dalë pasi shumica e ankuesve problemin e masës së pensionit që ata përfitojnë, e shohin në këndvështrimin e një diskriminimi që u bëhet atyre nga shteti për punën që ata kanë bërë për vite me radhë. Ata kërkojnë të ketë edhe një bazë më të mirë për politikat që ndjek shteti në fushën e sigurimeve shoqërore. Megjithëse kohë pas kohe janë bërë përmirësime ligjore në këtë fushë, përsëri vihet re se ka kundërthënie, evazivitet, diferenca të masës së pensioneve të qytetarëve në kushte të njëjta pune etj. Por këto ndryshime dalin jashtë juridiksionit të veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit.

Konkretisht, në këtë kuadër, duke marrë shkas nga ankesat e qytetarëve, po paraqesim problematikat e mëposhtme:

- *Se pari*, në lidhje me rillogaritjen e pensioneve të pleqërisë për periudhën 01.01.1994 – 31.12.1996.

Sipas Ligjit nr.9588 datë 25.07.2006 “Për rillogaritjen e pensioneve”, në nenin 2 citohet:

“Pensionet e pleqërisë në qytet, që kanë datë fillimi datën 01.01.1994 deri më 31.12.1996, përfshirë edhe këtë datë dhe që vazhdojnë të paguhen pas datës 01.07.2006, rillogariten duke indeksuar pagat, mbi të cilat është llogaritur baza e vlerësuar dhe pagën neto, sipas koeficientëve të indeksimit, të miratuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave...”

Pretendimi i të gjithë ankuesve që kanë fituar të drejtën e daljes në pension pleqërie gjatë vitit 1994, është se akoma nuk kanë përfituar nga ky Ligj, megjithëse në të përcaktohet se përfiton dhe kjo kategori e pensionistëve.

Konkretisht, sipas VKM nr.590 datë 31.08.2006 “Për zbatimin e Ligjit nr.9588 datë 25.07.2006 “Për rillogaritjen e pensioneve”, paragrafi I - *Për rillogaritjen e pensioneve të caktuara nga data 01.01.1994 deri me 31.12.1996* përcakton se:

1. *Në zbatim të nenit 2 të Ligjit nr.9588 datë 25.07.2006 “Për rillogaritjen e pensioneve”, pensioneve që kanë datë fillimi nga data 01.01.1994 deri me 31.12.1996, përfshirë dhe këtë datë, u indeksohet paga mbi të cilën është llogaritur baza e vlerësuar dhe paga neto, për periudhën nga data 01.01.1994 deri në datën e fillimit të pensionit individual, por në çdo rast brenda periudhës 01.01.1994 deri më 31.12.1996.*

2. *Indeksimi bëhet sipas procedurave dhe koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit përkates. Koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësuar individuale, pas vitit 1994, sipas viteve, përcaktohen në Vendimin nr.400 datë 21.06.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e*

koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor individual për llogaritjen fillestare të pensioneve”.

Kështu në VKM nr.400 datë 21.06.2006 përcaktohen koeficientët edhe për vitin 1994. Por sipas pikës 2 efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi janë vetëm për pensionet që caktohen me datë fillimi nga 01.01.2006.

Pra, siç shihet, në aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit të sipërcituar nuk ka konsekuencë ligjore në parashikimet përkatëse të bëra, pasi nuk është e perfshire kategoria e pensionistëve që kanë përfituar të drejtën e daljes në pension pleqërie gjatë vitit 1994.

- **Se dyti**, ne lidhje me rillogaritjen e pensioneve të pleqërisë në qytet për periudhën Tetor-Dhjetor 1993.

Kjo periudhë nuk është përfshirë në Ligjin nr.9588 date 25.07.2006 “Për rillogaritjen e pensioneve”. Në nenin 1 përcaktohet se:

“Në kuptimin e këtij Ligji, quhen pensione pleqërie në qytet pensionet e caktuara sipas ligjit nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..”.

Por në parashikimet e bëra ne ligj nuk përcaktohet përfitimi i kategorisë së pensioneve të pleqërisë të caktuara në periudhën kohore Tetor – Dhjetor 1993.

Konkretisht, në nenin 2 përcaktohet rillogaritja e pensioneve për periudhën 01.01.1994 – 31.12.1996, ndërsa në nenin 3 përcaktohet rillogaritja e pensioneve për periudhën 01.01.1996 – 14.06.2005.

Pra, pensionet e caktuara me Ligjin e ri nr.7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, për periudhën kur e kanë përfituar pensionin (Tetor – Dhjetor 1993), nuk janë objekt përfitimi nga Ligji nr.9588 datë 25.07.2006 “Për rillogaritjen e pensioneve”.

Në këtë kuadër, në vazhdim të shqyrtimit të kësaj çështjeje, u kemi Rekomanduar: Ministrit të Financave, Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta si dhe Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, marrjen e një nisme ligjore për plotësimin e Ligjit të sipërcituar, konkretisht të nenit 2, me formulimin: *periudha 01.01.1994 – 31.12.1996 të ndryshohet në periudha 01.10.1993 – 31.12.1996*. Jemi në pritje të përgjigjes së tyre.

Mendojmë se është e nevojshme që gjithnjë e më shumë ky legjislacion të përmirësohet dhe efektet të ndihen tek të gjithë kategoritë e përfituesve të përcaktuar në Ligjin nr.9588 datë 25.07.2006 “Për rillogaritjen e pensioneve”.

Së fundi, duhet të theksojme se bashkëpunimi ndërmjet Institucionit tonë me administratën qendrore dhe lokale të Sigurimeve Shoqërore ka qenë rezultativ, duke vërejtur një përgjegjshmëri në rritje të asaj administrate.

b. Shërbimi Social Shtetëror

Ankesa të paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit drejtuar Shërbimit Social Shtetëror për vitin 2006 rezultojnë **8**. Nga këto janë përfunduar **6**, nga të cilat **2** kanë rezultuar të pabazuara, **4** ankesa në favor të ankuesve dhe janë akoma në proces shqyrtimi **6** të tjera.

Kryesisht këto ankesa kanë konsistuar në pretendime për masën e përfitimit të ndihmës ekonomike, për ndërprerjen e ndihmës ekonomike, mospërfitim të pagesës së kujdestarisë etj.

Në vijimësi po paraqesim disa nga ankesat më tipike të trajtuara në këtë fushë:

1. Qytetari SH.H me banim në Shkodër, u ankua për ndërprerjen e ndihmës ekonomike nga ana e Zyres së Ndihmës Ekonomike dhe Përkrahjes Sociale pranë Bashkisë Shkodër.

Pasi kryem verifikimet e nevojshme pranë kësaj zyre, u informuam se sipas Ligjit të atëhershëm me nr.7710 datë 18.05.1993 “Për Ndihmën dhe Përkujdesin Shoqëror”, si dhe të vendimeve në zbatim të tij, një ndër kriteret e përfitimit të ndihmës ekonomike ishte dhe paraqitja pranë kësaj zyre e dokumentit nga Zyra e Sigurimeve Shoqërore për të vërtetuar faktin nëse janë derdhur kontribute apo jo.

Duke qenë se ankuesi, për efekt vjetërsie në punë kishte derdhur kontribute pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër për një periudhë 5-vjecare (1995-2000), në bazë të ligjit të sipërcituar i ishte ndërprerë ndihma ekonomike.

Ne e sqaruam se nëse aktualisht ishte i papunë dhe i plotësonte kushtet për të përfituar ndihmë ekonomike, duhet të paraqiste dokumentat në Seksionin e Ndihmës dhe Përkrahjes Sociale pranë Bashkisë Shkodër, sepse vetëm kështu mund të përfitonte ndihmën ekonomike të kërkuar prej tij.

2. Qytetari Q.L. banues në Vlorë, paraqiti kërkesën e tij lidhur me mundësitë e përfitimit të ndihmës ekonomike.

Ai konkretisht shprehej se djali i tij E.L, kishte vdekur në muajin Dhjetor të vitit 2005, si pasojë e vrasjes aksidentale nga një shok i tij duke kryer shërbimin e detyruar ushtarak pranë Repartit 301 të Xhenjos, Tiranë. Pasi morëm në shqyrtim ankesën e bërë nga ky shtetas, si dhe pas kontaktimit me të personalisht, e sugjeruam se, në lidhje me përfitimin e

ndihmës ekonomike mund t'i drejtohej Seksionit të Ndihmës Ekonomike dhe Përkrahjes Sociale, pranë Komunës Llakatund, Vlore.

Gjithashtu e sqaruar se, në bazë të Ligjit Nr:8607 datë 27.04.2000, *“Për Statusin e Dëshmorit të Atdheut”*, duhej t'i drejtohej Këshillit të Qarkut, Vlorë, së bashku me dokumentacionin përkatës. Kjo bazuar në nenin 3 të këtij ligji, në të cilën percaktohet se :*“Kërkesën për shpalljen “Dëshmor i Atdheut” e bën familja e dëshmorit, organet shtetërore ose përfaqesues të shoqërisë civile, si dhe në nenin 5 ku percaktohet se: “Kërkesa me dokumentet përkatëse paraqiten në Këshillin e Qarkut, ku ka vendbanimin familja e dëshmorit. Kundër vendimit të Komisionit, të interesuarit kanë të drejtë të ankohen në Gjykatën e Rrethit të Tiranës, brenda një muaji nga data e marrjes në dijeni për vendimin”*.

Në bazë të këtij statusi familja e tij do të gëzonte jo vetëm nderim e përkrahje të veçantë nga shteti, por dhe do të kishte të drejtën të përfitonte një shpërblim financiar mujor.

3. Shtetasi B.K. banues në Tiranë, paraqiti ankesën lidhur me mospërfitimin e pagesës së kujdestarisë për djalin e tij të sëmurë. Me vendim të Komisionit të Caktimit të Aftësisë për Punë, djali i tij kishte përfituar grupin e parë të invaliditetit dhe nga ana e Njësisë Bashkiake nr.4 nuk trajtohej me pagesën e kujdestarisë, pasi nuk ishte në skemën e ndihmës ekonomike.

Me ndërhyrjen e Zyrës sonë pranë kësaj njësie, u bë e mundur zgjidhja e problemit dhe qytetari ju njoh e drejta e përfitimit të pagesës së kujdestarisë.

5. Qytetari Z.K me banim në Kamëz, Tiranë ankohej për Bashkinë Kamëz dhe Shërbimin Social Shtetëror për mosdhënien e shpërblimit për fëmijët e tij trinjakë.

Pas kërkesës sonë për shpjegime në të dy këto Institucione, na u konfirmua fakti se me çeljen e fondit qytetari do të merrte pagesën përkatëse.

Lidhur me problemin e përfitimit të pagesës së kujdestarisë për të cilin kemi raportuar dhe në vitet e mëparshme, qëndrimi i Zyrës sonë ka qenë se ky lloj përfitimi nuk duhej dhe s'kishte pse të lidhej me skemën e ndihmës ekonomike.

Kështu, pas miratimit të Ligjit nr.9355 datë 10.03.2005 *“Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”* u bë e mundur përfitimi i pagesës së kujdestarisë pavarësisht nëse personi përfitues nuk ishte në skemën e ndihmës ekonomike. Gjithashtu u hoq edhe kriteri i shkakut dhe i moshës në përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar.

Në këtë kontekst u nxorren dhe aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit të sipërcituar. Nga interesimi ynë pranë organeve të pushtetit vendor, jemi vënë në dijeni se ka filluar dhënia e pagesës së aftësisë së kufizuar edhe për ata persona që nuk kishin perfituar nga Ligji i mëparshëm nr.7710 datë 18.05.1993 “Për Ndhimën dhe Përkujdesjen Shoqërore”.

Ajo që është konstatuar dhe që vazhdimisht i është vënë theksi nga Zyra jonë gjatë trajtimit të ankesave lidhur me shërbimin social, është se vazhdojnë të ekzistojnë mundësitë e pakta të vendit për të siguruar shëndetin dhe mirëqënien e popullsisë, të cilat janë të kompromentuara nga infrastruktura e dobët, lëvizjet e mëdha demografike, mungesat e përkohshme të stabilitetit të brendshëm dhe kapacitetet e dobëta teknike të strukturave përkatëse. Në këtë kontekst vëmë në dukje se ristrukturimi dhe reformimi i shërbimeve sociale duhet të jetë një element prioritar lidhur dhe me uljen e varfërisë.

Në kuadrin e decentralizimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, kanë filluar procedurat për kalimin e institucioneve të përkujdesit shoqëror në varësi të pushtetit vendor. Sic jemi vënë në dijeni, deri në fund të muajit shkurt 2007 do të bëhet transferimi i 6 institucioneve.

Ministritë përkatëse të fushës së zbatimit të detyrueshëm të politikave në fushën e ndihmës dhe përkujdesit shoqëror, duhet të vazhdojnë punën e nisur për përsosjen e këtyre politikave, të përmirësimit të legjislacionit dhe përshtatjes së tyre me parametrat më të larta të vendeve të përparuara demokratike.

8. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve

Gjatë vitit 2006 ka patur 40 ankesa për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve dhe që kanë përfunduar gjatë këtij viti. 8 ankesa kanë qenë të pabazuara, 21 ankesa kanë qenë jashtë kompetencës dhe juridiksionit, në 6 ankesa është hequr dorë nga shqyrtimi i mëtejshëm nga institucioni ynë me kërkesën e vetë ankuesve, 3 ankesa janë zgjidhur në favor të ankuesve.

Krahas tyre janë paraqitur edhe 2 rekomandime, nga të cilët një i tillë nuk është pranuar dhe është orientuar ankuesja për ndjekjen e rrugës gjyqësore, ndërsa rekomandimi tjetër është pranuar dhe do të trajtohet me poshtë.

1. Në letrën drejtuar Avokatit të Popullit, shtetasi Sh.T. paraqiti një ankesë ku shprehte shqetësimin e tij dhe të banorëve të tjerë të zonës së

prekur nga ndërtimi i aeroportit të Kukësit, në lidhje me zvarritjen e procedurave për kompesimin e tyre për shkak të shpronësimit nga ndërtimi i aeroportit të Kukësit. Konkretisht ai shprehej se Këshilli i Qarkut Kukës kishte miratuar që në janar 2006 dhe kishte dërguar pranë Ministrisë së Transporteve, Punëve Publike dhe Telekomunikacionit të gjithë dokumentacion e duhur ligjor për shpronësimin e tokave të ankuesve që ishin zënë nga ndërtimi i aeroportit të Kukësit, por akoma nuk ishte bërë i mundur kompesimi financiar, duke ngelur kështu një çështje e pazgjidhur për komunitetin e prekur nga ky problem.

Avokati i Popullit, lidhur me trajtimin e ankesës kreu menjëherë ndërhyrjet dhe verifikimet e nevojshme duke iu drejtuar Drejtorisë së Programimit Ekonomik në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për të kërkuar shpjegime lidhur me pretendimin që ankuesit ngrinin në ankesën e tyre si dhe verifikimin dhe shqyrtimin e kërkesave të parashtruara. Në përfundim u arrit që, në përgjigje të kërkesës tonë, nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, u bë një trajtim i qartë dhe kronologjik i problemit të ngritur. Ndër të tjera bëhej e ditur se pas verifikimeve të bëra, për shkak të mungesës së dokumentacionit të plotë, nuk ishte bërë akoma i mundur kompesimi financiar për banorët e tjerë të zonës derisa ata të pajiseshin me dokumentin e pronësisë të kërkuar. Dhe se kjo gjë do të bëhet e mundur vetëm pas plotësimit të dokumentacionit të plotë sipas Ligjit nr. 7843 datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme” si dhe Regullores përkatëse të Z.V.R.R.P., për të vijuar më pas me kompesimin financiar sipas modaliteteve të përcaktuara në VKM nr. 95 datë 20.02.2004.

2. Institucioni i Avokatit të Popullit, në zbatim të funksioneve të tij, ndërmorri me iniciativën e vet një procedurë hetimi lidhur me nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 9232 datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”.

Avokati i Popullit, pas studimit të Ligjit Nr. 9232 datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” evidentoi faktin se ky akt kishte ende nevojë për rregullimin e një sërë marrëdhëniesh, të cilat duhet të realizoheshin duke nxjerrë aktet nënligjore në bazë dhe për zbatim të tij.

Ligji Nr.9232 datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” i miratuar nga Kuvendi shfuqizoi Ligjin Nr.8030 datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, si dhe aktet nënligjore që kishin dalë në bazë dhe për zbatim të tij.

Ligji Nr. 9232 datë 13.05.2004, në nenin 38 të tij ngarkon Këshillin e Ministrave që të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 4, pika 3 e 4, të nenit 8, të nenit 9 pika 1, nenit 17 pika 2 e 3, të nenit 18 pika 2, të nenit 22 pika 1 dhe të nenit 34 pika 3 të këtij ligji.

Megjithëse aktet nënligjore që vendosnin çështjet më kryesore rezultuan se kishin dalë tashmë, në vështrim të Ligjit Nr.9232 datë 13.05.2004 që merr përsipër zbutjen e problemit të strehimit, u konstatua se ende kishte disa detyrime ligjore të pa plotësuara, pra nuk kishin dalë disa akte nënligjore në zbatim të tij.

Avokati i Popullit në kuadër të mbrojtjes të interesave të ligjshme të shtetasve, kërkoi që të informohej nëse Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit ishte angazhuar në përmbushjen e detyrimit ligjor për përgatitjen dhe miratimin e akteve nënligjore vijuese, në bazë dhe për zbatim të Ligjit Nr.9232 datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”.

Në përgjigje të shkresës tonë, nga ana e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit u informuam se baza e nevojshme me aktet nënligjore për zbatim të Ligjit Nr.9232 datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” e cila bën të mundur aplikimin e Ligjit për fazën e parë të zbatimit ishte plotësuar. Gjithashtu me tej shprehej impenjimi i kësaj Ministrie për të plotësuar sa më shpejt të gjithë kuadrin ligjor në zbatim të Ligjit të lartpërmendur.

3. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, u paraqit ankesa e shtetasës E.K. nga Vlora e cila shpreh shqetësimin e saj në lidhje me cënimin e pronësisë së saj dhe më konkretisht për prishjen e shtëpisë së saj dhe marrjen e truallit me qëllim ndërtimin e rrugës Transballkanike, duke aluduar në të njëjtën kohë edhe për devijime të projektit fillestar dhe mosrespektim të procedurave të njoftimit dhe shpronësimit të tyre.

Në këtë kuadër, duke vlerësuar bashkëpunimin ndërinstucional në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të ligjshme të individëve, si dhe për nevoja të shqyrtimit të mëtejshëm nga institucioni ynë të kësaj çështjeje, i jemi drejtuar Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për të kërkuar shpjegime lidhur me ankesën e paraqitur dhe për të mundësuar kështu shqyrtimin sa më korrekt të pretendimeve të ngritura. Nga ana e MPPTT jemi vene në dijeni te faktit se çështja i ka kaluar për shqyrtim të mëtejshëm Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

Lidhur me këtë, dhe me qëllim të sqarimit përfundimtar të kësaj ankese, i jemi drejtuar me anë të disa shkresave zyrtare Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve. Së fundmi na është konfirmuar fakti se prona e ankueses preket nga shpronësimet që do të bëhen për ndërtimin e kësaj rruge

dhe se nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve po kryhen procedurat përkatëse, për të vijuar më pas me finalizimin e kërkesës për shpronësim dhe me daljen e V.K.M. për shpronësimin e pronarëve, pronat e të cilëve preken nga ndërtimi i këtij segmenti rrugor.

4. Pranë institucionit të Avokatit të Popullit, paraqiti një ankesë shtetasi F.X. në emër të Këshillit negociator të pronarëve që preken nga ndërtimi i rrugës Qafë Kashar-Rinas, me të cilën shprehte shqetësimin e përbashkët lidhur me shkeljet e pretenduara gjatë procedurave të shpronësimit të pronarëve në këtë segment rrugor.

Për rastin konkret, Këshilli i Ministrave me vendimin e tij nr. 726 datë 23.11.2005 ka miratuar shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qafë Kashar- Rinas, vendim me të cilin janë njohur edhe pronarët që do prekeshin nga procesi i shpronësimit. Nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit në bazë edhe të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, ankuesit u orientuan ta ndiqnin çështjen më tej në rrugë gjyqësore, në bazë të nenit 24 të Ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” ku parashikohet shprehimisht se:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave për shpronësimin u njoftohet nga ministria kompetente drejtpërdrejt pronarëve të shpronësuar, pronarëve të pasurive që zhvlerësohen nga shpronësimi dhe personave të tretë, të drejtat e të cilëve kompensohen për shkak të shpronësimit, të cilët vetëm lidhur me masën e shpërblimit të caktuar në këtë vendim kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 30 ditëve nga marrja dijeni.

- Ankimi kundër vendimit të Këshillit të Ministrave për shpronësimin nuk pezullon zbatimin e këtij vendimi dhe procedurën përkatëse të regjistrimit të pasurisë së shpronësuar.

- Lidhur me masën e shpërblimit të shpronësimit, nëse nuk bëhet ankimi në gjykatë brenda afatit tridhjetëditor, sipas këtij ligji, vendimi i Këshillit të Ministrave për shpronësimin përbën titull ekzekutiv.

5. Avokati i Popullit nëpërmjet një rekomandimi përgjithësues të bërë që në vitin 2005 e ka njohur Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve me qëndrimin se nuk mund të tolerohet fakti që një pronari të ligjshëm, pra që e ka fituar atë pronë me mënyrat e fitimit të pronësisë të parashikuara në Kodin Civil dhe që e ka të rregjistruar atë pronë në rregjistrat e Z.RR.P.P.-së, duke poseduar kështu një certifikatë pronësie që është një akt zyrtar që vërteton ligjërisht pronësinë e tij mbi atë pronë, të ndërhyhet arbitrarisht dhe në mënyrë abuzive nga organe që nuk kanë asnjë tagër mbi atë pronë, duke mos respektuar edhe procedurën e shpronësimit.

Fatkeqësisht edhe për këtë vit kemi konstatuar mjaft raste ku qytetarë të ndryshëm janë ankuar për shkelje të procedurave të ndjekura dhe mosrespektim të të drejtave legjitime të pronarëve të trojeve në zbatim të Ligjit Nr.8561, datë 22.12.1999 “*Për Shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*”.

Këto çështje paraqesin një problem mjaft delikat dhe që përbën shkak për shkelje të të drejtave të njohura në Kushtetutën e Shqipërisë dhe Ligje të tjera organike. Në mjaft raste veprimet e nxituara të Komisioneve të posaçme të shpronësimeve, si dhe trajtimi jo konform rregullave i dokumentacionit nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, kanë shkaktuar mohim të së drejtës së shpronësimit për interes publik. Këto raste, vlejnjë të përmenden si fenomen, pasi rëndësia e respektimit të të drejtave të pronësisë është e një karakteri prioritar në përmbushjen e standarteve të shtetit të së drejtës.

Për këtë qëllim Avokati i Popullit do të insistojë edhe në të ardhmen në eliminimin e praktikave të parregullta dhe të paligjshme administrative në fushën e transportit dhe telekomunikacionit rrugor, për të garantuar të drejtat dhe interesat e ligjshme të individëve të parashikuara në Kushtetutë dhe në legjislacionin në fuqi.

a. Ankesat për Policinë e Ndërtimit

Dinamika e zhvillimit urban ka pasqyruar perpjekjet dhe angazhimet konkrete për zgjidhjen e çështjeve të tilla prioritare për një zhvillim të qëndrueshëm komunitar, sikurse të ndertimeve pa leje. Vullneti i shprehur legjislativ për t’i dhene fund kaosit urban dhe për integrimin e ndertimeve pa leje dhe futjen e zonave ku ato ndodhen në programe të veçanta urbanizimi, është konkretizuar me miratimin nga ana e Kuvendit të Shqipërisë dhe të hyrjes në fuqi gjatë vitit 2006 të Ligjit nr.9482 datë 16.02.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndertimeve pa leje”.

Objekti i rregullimit të këtij ligji, i cili ka shfuqizuar Ligjin Nr.9209, datë 23.03.2004 “Për legalizimin e shtesave në ndërtime”, dhe Ligjin Nr.9304, datë 28.10.2004 “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”, është legalizimi i ndertimeve të ngritura pa leje në “vendbanime formale”, “zona informale” dhe “territore të tjera”, si dhe të “shtesave pa leje në ndertime me leje”. Në këtë objekt përfshihet edhe kalimi i pronësise së parces ndertimore ku është ngritur ndertimi pa leje, urbanizimi i zonave ku këto ndertime ndodhen me qëllim integrimin e tyre urban, si dhe procedurat perkatese për realizimin e këtij procesi me elemente sociale në favor të shtresave në nevojë.

Nga kompleksiteti i objektit të rregullimit të këtij ligji evidentohet se zbatimi korrekt i tij do t'i japë zgjidhje një sërë çështjesh të ngritura nga ana jone në raportet e mëparshme vjetore, për këto problematike.

Evidentojmë faktin se, një nga këto çështje të konstatuara nga ana jone dhe për të cilën kemi ndermarre hapa konkrete, duke propozuar hartimin e një ligji të ri dhe parashikimin e procedurave të thjeshta administrative për legalizimin, pra ndryshime në Ligjin Nr.9209, datë 23.03.2004 “Për legalizimin e shtesave në ndërtim”, ka gjetur zgjidhje me miratimin dhe hyrjen në fuqi të Ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

Rekomandimit tonë të shprehur në kuadër të përmirësimit të legjislativitetit dhe gjykimit se i duhet dhënë drejta e legalizimit edhe Njësive Bashkiake të Tiranës, për të shpejtuar procedurat dhe rritur autonominë e tyre, i pergjigjet një parashikim me i zgjeruar dhe me i plotë në Ligjin nr.9482 datë 16.02.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, ku janë përcaktuar detyrat e njësive të qeverisjes vendore, përfshirë njësitet bashkiake të Tiranës, si dhe rolin e tyre aktiv në këtë proces.

Në llogjikën e parashikimeve të reja ligjore të bera me hyrjen në fuqi të Ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, evidentojmë se është ndjekur rruga e duhur ligjore për ekzekutimin e vendimeve të mëparshme të marra nga ana e Policisë të Ndërtimit, për prishjen e ndërtimeve pa leje. Këto momente e përforcon akoma me shumë fakti se në nenin 33 të ligjit të sipërcituar, parashikohet se mosdeklarimi brenda afatit kohor, deklarimi i rreme i ndërtimit dhe i sipërfaqes së zënë, si dhe mosparaqitja e plotë e dokumentacionit tekniko-ligjor, sjell përjashtimin nga procesi i legalizimit, urbanizimit dhe integritit të ndërtimit informal dhe prishjen e objektit pa leje, në përputhje me Ligjin nr.8408 datë 25.09.1998 “Për Policinë e Ndërtimit”.

Pra, nëse subjektet e interesuara për legalizim janë në kushtet e nenit të mësipërm, në ligj parashikohet përjashtimi i mundësive të fillimit të procedimit përkatës administrativ për legalizimin e ndërtimit pa leje dhe i jepet kompetencë e plotë organit të Policisë të Ndërtimit që, ose të ndjekë procedurën e plotë ligjore për nxjerrje vendimi për prishje objekti dhe ekzekutimin e tij, ose të ekzekutojë vendimin për prishje që mund të jetë nxjerre ndërkohe nga ana e këtij organi për fillimit të këtij procesi.

Krahas këtyre parashikimeve të bera në ligj, çështjet e shqyrtuara nga ana jone gjatë këtij viti kanë evidentuar se në rastet e ndërtimeve pa leje për të cilat paraprakisht është plotësuar formulari i legalizimit, vendimet e organit të Policisë të Ndërtimit janë pezulluar për ekzekutim, deri në marrjen

e një vendimi përfundimtar nga ana e organit të ngarkuar me ligj për shqyrtimin e mundësisë së legalizimit.

Gjatë vitit 2006, për këtë problematikë që lidhet me veprimtarinë në tërësi të organit të Policisë të Ndërtimit, rezultojnë të jenë marrë në shqyrtim 95 ankesa, nga të cilat rezultojnë 70 ankesa të reja dhe 25 ankesa të mbartura. Nga këto 62 lidhen me veprimtarinë e organit të Policisë të Ndërtimit dhe 33 me veprimtarinë e strukturave përkatesë të Bashkive apo të KRRT-ve pranë tyre.

Nga ankesat të cilat lidhen me problematikën e ndërtimeve pa leje, deri në fund të vitit 2006, rezultojnë të përfunduara 79 ankesa dhe akoma në shqyrtim janë 16 ankesa.

Përsa i përket çështjeve të përfunduara, ka rezultuar se janë zgjidhur në favor 17 çështje, jashtë juridiksionit dhe kompetencës 36 çështje, ndërsa për 26 prej tyre jemi në kushtet e pabazueshmerise se ankeses ose braktisjes së procedimit administrativ të filluar nga ana jonë për shqyrtimin e tyre nga vetë ankuesit, pra jemi në kushtet e heqjes dore të ankuesve nga ndjekja e mëtejshme e çështjeve prej nesh.

Per vete rolin kryesor që organi i Policisë të Ndërtimit luan në këtë fushë, rikonstatojmë se mbartja e problemeve që kanë të bëjnë me ndërtimet pa leje nga ana e këtij organi, vit pas viti, ka sjelle pasojën që ngarkesa e punës të mos jetë racionale, por të krijojë probleme të funksionimit të tij, probleme që shpesh mund të vlerësohen si jo të mirëqena dhe fiktive. Fakt që flet për këto problematike, është numri i madh i rekomandimeve që i janë drejtuar këtij organi nga ana jonë. Gjatë vitit 2006 janë drejtuar 25 rekomandime, si pasojë e konstatimit të veprimeve të parregullta ose të paligjshme të kryera në shkelje të drejtave të lirive të ligjshme të shtetasve, shkelje për të cilat janë propozuar masat konkrete që duhen të merren nga ana e Policisë të Ndërtimit, për rregullimin dhe rivendosjen e gjendjes rast pas rasti, në respektim të këtyre lirive dhe të drejtave të individëve.

Problematika e shfaqur në vitin 2006 për problemet e ndërtimeve pa leje dhe në veçanti për punën e organit të Policisë të Ndërtimit, konstaton disa çështje, që për nga ana teknike evidentojnë se:

- Rekomandimet e drejtuara nga ana jonë pranohen, por duke ndërmarrë veprime të ngadalta dhe jo konkludente. Nisur nga numri i madh i rekomandimeve që këtij organi i janë drejtuar këto vit krahasuar me vitet e tjera, konstatojmë se në më të shumtat e rasteve nuk është përmbushur detyrimi ligjor i dhënies së përgjigjes zyrtare, sikurse parashikohet në nenin 22, të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, nderkohe që një shumicë e tyre mbeten pa përgjigje. Ndaj kërkesave tona për marrje masash administrative ndaj punonjësve, të cilët janë bërë shkak për zvarritje

dhe moszgjdhje të çështjeve në kohë, organi i Policisë të Ndërtimit ka qenë pasiv, me perjashtim të disa rasteve të pakta kur masat e marra nuk n'a janë bere me dije. Te tilla masa administrative për largim nga puna, janë marre gjate këtij viti ndaj ish kryetarit të degës juridike në Drejtorinë e Policisë të Ndërtimit, Kryetarit të degës së Policisë të Ndërtimit, Tiranë, apo edhe ndaj vete Drejtorit të Drejtorisë së Policisë të Ndërtimit.

- Ka një mungesë të theksuar dhe neglizhencë krejtësisht të pajustificuar të këtij organi, në dhenien e përgjigjeve apo informacioneve, pas kërkesave të dërguara për këto qëllime nga ana e institucionit tone. Kjo gjë shpeshherë është shoqëruar paraprakisht nga një mungesë transparence prej këtij organi ndaj personave të interesuar, apo edhe publikut në përgjithësi për veprimtarinë e tij. Mungesa e informacionit të kërkuar, jo vetëm është bere shkak për kohezgjatjen e shqyrtimit të çështjeve nga ana jone, por shpeshherë realisht n'a ka vene në pozite shumë të veshtire me vete ankuesit, të cilët i janë drejtuar institucionit tone për një zgjidhje të mundshme. Problematike mbeten Degët e Policisë të Ndërtimit, në Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkoder, por edhe vetë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë të Ndërtimit. Ndodh që në disa raste, edhe pse jepet informacion në lidhje me çështje të caktuara, ky informacion është i paqarte ose i paplote, fakt i cili n'a detyron t'i ridrejtohem perseri këtij organi për shpjegime të metejshme. Shpeshherë, sidomos për ndërtimet të cilat gjate zbatimit të tyre shfaqen me shkelje në zbatim të projektit të miratuar nga ana e KRRT-ve në njesite perkatese të qeverisjes vendore, dhenia e shpjegimeve jashtë afateve të percaktuara ligjore perkon me hapjen e proceseve gjyqesore në lidhje me këto çështje, ose shpesh i jep mundësi kundervajtesve të hapin procese gjyqesore për këto çështje, gjë që n'a detyron të nderpresim shqyrtimin e metejshëm të rasteve. Ka raste kur pas paraqitjes së kërkesave tona për shpjegime për ankësën të paraqitura në zyren tone, jo vetëm që përgjigja dërgohet jashtë të gjitha afateve ligjore të detyrueshme, por nuk ndermerret asnjë veprim i metejshëm me arsyetimin se nuk ekziston ndonjë ankësë e paraqitur në organin e Policisë të Ndërtimit për këto rast. I tillë p.sh është rasti i ankësës së shtetasit T.A nga qyteti i Shkodrës, ku shprehet shqetësimi për mosveprimin e degës së Policisë të Ndërtimit Shkoder, ndaj një ndërtimi të kundraligjshëm që demton interesat e ligjshme të këtij ankuesi. Gjate shqyrtimit të kësaj çështje përgjigja e dhënë prej degës së Policisë të Ndërtimit ka qenë se: *“Nga ana e këtij shtetasi n'a rezulton se nuk kemi asnjë ankësë me shkrim për objektin në fjalë, të paraqitur pranë degës tone. Nëse personi paraqitet pranë degës tone, së bashku me ankësen me shkrim, Dega e Policisë të Ndërtimit Shkoder, do të jemi të gatshëm për zgjidhjen e problemit konform ligjit”*.

Per mundesimin e metejshem te shqyrtimit te kesaj çeshtje, kemi sqaruar kete dege se njoftimi dhe kerkesa njekohesisht per te vepruar edhe nga ana e Bashkise Shkoder me shkresen nr.T-6/1 date 25.06.2004, si dhe fillimi i proçedimit administrativ per kete rast nga ana e Avokatit te Popullit, perbejne baze te plote per fillimin e nje proçedimi administrativ. Ky fakt, ne reference te percaktimeve te bera ne Kodin e Proçedurave Administrative, kemi vleresuar se nuk justifikonte aspak mosveprimin e organit te Policise te Ndertimit, si dhe pergjigjen qe n'a eshte kthyer me shkresen e sipercituar.

- Vihet re nje mosveprim i vazhduar i ketij organi jo vetem per konstatimin dhe sanksionimin e ndertimeve te kundraligjshme, por edhe per ekzekutimin e vendimeve te cilat jane marre ndaj kundravajtesve te ndryshem, si per sanksionim me gjobe, ashtu edhe per prishje ndertimesh te kundraligjshme. Pavaresisht aktivitetit mjaft të ngjeshur te ketij organi, nuk mund te justifikohet mosveprimi në raste të veçanta, nderkohe qe ka patur edhe ndonjë rast që mosveprimi ka qenë i qëllimshem dhe në këtë drejtim. Ne disa raste edhe pse nga ana e Policise te Ndertimit, jane pranuar rekomandime te drejtuara nga ana jone per ekzekutim sa me te shpejte te vendimeve qe jane marre prej saj dhe jane percaktuar nga ajo vete afate per ekzekutim te pritshem, perseri nuk eshte vepruar, duke bere qe çeshtjet te mbeten perseri pa zgjidhje. Legjislacioni ne fuqi per legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndertimeve pa leje, shpesh shihet si kusht mosveprimi per çeshtje qe i paraqiten ketij organi te cilat lidhen direkt me ndertime pa leje. Ne te gjitha çeshtjet perkatese te shqyrtuara, nga ana jone eshte theksuar me force se, Ligji “Per legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndertimeve pa leje”, jo vetem qe nuk kufizon kompetencen e organit te Policise te Ndertimit, por e perforcon ate ne kuader te konstatimit dhe sanksionimit te ndertimeve te kundraligjshme. Ndaj nuk ka asnje justifikim ligjor nese arsyeja per mosveprim shihet tek fakti se per ndertimin pa leje eshte bere vetedeklarimi per legalizimin, nderkohe qe mund te jemi ne kushtet e nenit 33 te Ligjit “Per legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndertimeve pa leje”, apo ne rastet kur behen shtesa pa leje apo vazhdojne punimet e ndertimit ne objektet pa leje te vetedeklaruara tashme nga subjektet e interesuara, pas dates se percaktuar si limit maksimal ligjor per vetedeklarim. Mosveprimi behet edhe me i dukshem kur kemi te bejme me ndertime te ngritura rishtazi pa leje, te cilat jane ngritur ne kohen e parashikuar nga ligji per kryerjen e vetedeklarimit per ndertimet e ngritura tashme pa leje. Mbetet krejtesisht i pajustificuar veprimi per ekzekutimin e vendimeve per prishje objktesh, te nxjerra nga ana e ketij organi qe ne vitin 2002 apo 2003, fakt qe eshte konstatuar ne jo pak raste nga ana jone.

- Nuk kanë munguar rastet, kur veprimi ka qenë i pjesshëm dhe jo në përputhje me vendimet administrative përkatëse, apo ka qenë i kundraligjshëm nga ana e Policisë të Ndërtimit. Si një fenomen që është konstatuar, është fakti se Policia e Ndërtimit ka patur raste që ka vepruar duke shkatërruar ndërtime, edhe pse ato kanë qenë të legjitimuara me vendime perfundimtare të formës së prerë nga gjykata, apo kur aktet e nxjerra për prishje prej këtij organi kanë qenë pezulluar me vendime gjyqesore të formës së prerë përkatëse, apo shfuqizuar me vendime të tilla. Një rast i tillë është evidentuar në ankesën e shtetasit N.K, kur është ndjekur procedura e konstatimit të ndërtimit të kundraligjshëm. Por kjo procedurë nuk është ndjekur plotësisht në përputhje me parashikimin e bërë në nenin 5 të Ligjit nr.8408 datë 25.09.1998 “Për Policinë e Ndërtimit”, duke evidentuar në këtë rast një procedurë të mangët.

- Shpeshherë në trajtimin e shumë ankesave vazhdon të vërehet një “lojë” shkresash zyrtare ndërmjet KRRT-ve të njesive të qeverisjes vendore me degët e Policive të Ndërtimit, në lidhje me vendimmarrjen përkatëse për ndërtime të ndryshme të evidentuara si të kundraligjshme. Ky konkluzion bëhet me i prekshëm sidomos në rastet kur midis vetë Drejtorisë të Policisë të Ndërtimit dhe degeve të saj, nuk ka koordinim dhe korrektesë në afatet dhe detyrat që lihen në kuadër të hierarkisë administrative rast pas rasti. Një rast i tillë është konstatuar në trajtimin e ankesës së shtetasës E.Sh nga Tirana, ku problemi i kundraligjshmerisë apo shkeljes së ligjit në zbatimin e një projekti të miratuar me vendimin përkatës të KRRT-së në Bashkisë të Tiranës është kthyer në një lojë korrespondence ku njëra palë i kërkon veprimin palës tjetër. Po kështu në disa raste kur në kemi paraqitur rekomandime për të cilat është venë në dijeni Drejtoria e Policisë të Ndërtimit, vërehet se megjithë nderhyrjen e kësaj të fundit me shkresat përkatëse ku kërkohet zbatim ligjshmerie nga ana e degeve të saj dhe ku përcaktohen edhe afate për t’i kthyer përgjigje institucionit tone, perseri nga ana e degeve nuk respektohen afatet e vendosura për dënimin e përgjigjes.

- Vendimet për pezullim punimesh, si mëse parandalimi, në formën që nxirren nuk zbatohen dhe nuk imponohen nga ana e organit të Policisë të Ndërtimit, për subjektin ndaj të cilit nxirren. Është fakt se në shumë ankesa për ndërtime të kundraligjshme, Policia e Ndërtimit, në zbatim të kompetencave bën pezullimin e punimeve në objekt, deri në sqarimin e çështjes. Por ndodh rëndom që, edhe pse është marrë vendim për pezullim punimesh, firmat e ndërtimit apo individëve të ndryshëm vazhdojnë punën, duke e përfunduar ndërtimin, derisa në momentin final të vendimmarrjes ai është bërë fakt i kryer. Këto veprime thellojnë akoma me shumë situatën e paligjshmerisë. Një rast i tillë i shqyrtuar nga ana jone ka të bëjë me ankesën

e shtetasit I.I, ku Policia e Ndertimit, dega Tirana Qytet, ka nxjerre disa akte pezullimi per nje ndertim te ri me shkelje kondicionesh. Por fakti eshte se asnjehere nuk ka nxjerre nje vendim perfundimtar per kete ceshtje, nderkohe qe firma ndertuese ka vazhduar e pashqetesuar ndertimin e objektit.

- Fillimi i procedures se konstatimit te objekteve te kunderligjshme me hartimin dhe mbajtjen e proces verbaleve te konstatimit te ndertimit te kundraligjshem, apo vendimet e pezullimit te punimeve te ndertimit, nuk pasohen me nxjerrjen e nje vendimi perfundimtar nga ana e organit te Policise te Ndertimit. Ne rastin e vendimeve te pezullimit te punimeve te ndertimit, ato mbeten si te tilla dhe konsiderohen te vlefshme dhe me fuqi juridike edhe pas kalimit te afatit te vlefshmerise se tyre detyruese ligjore, ne baze te parashikimeve te Ligjit "Per kundervajtjet Administrative".

- Nje tjetër problem i cili vazhdon te evidentohet gjatë kësaj kohe, sidomos gjatë ekzekutimit të vendimeve për prishje nga ana e organit të Policisë të Ndërtimit, për ndërtimet pa leje, është ai i moszbatimit të nenit 84, të Ligjit "Për urbanistikën", që parashikon se:

"Gjobat, shpërblimet dhe shpenzimet e prishjes, të përcaktuara në këtë ligj, paguhen nga kundërvajtësit brenda 5 ditëve, nga data e njoftimit të vendimit të organit të Policisë të Ndërtimit, ose nga dita kur vendimi i gjykatës merr formë të prerë. Pas kalimit të këtij afati paguhet kamatë 2 për qind në ditë deri në një muaj. Pas kalimit të këtij afati (një muaj), organet e Policisë së Ndërtimit kërkojnë ekzekutimin e tij në rrugë gjyqësore, sipas ligjeve në fuqi. Gjobat, shpërblimet dhe shpenzimet paguhen në zyren e financës së organit të pushtetit lokal". E evidentojme këtë fakt, pasi prishja e një ndërtimi pa leje është në favor të një komuniteti të caktuar njerezish, por shpenzimet e këtij veprimi, nëse nuk paguhen nga kundravajtësi, rëndojnë në xhepat e këtij komuniteti. Me sa kemi konstatuar, në asnjë rast shpenzimet për prishje dhe pastrim të territorit nuk i janë ngarkuar kundërvajtësit që ka ndërtuar pa leje. Zbatimi ne praktike i ketij neni do te ndikonte akoma me shume ne edukimin e shtetasve me frymen e respektimit te ligjit.

- Mosushtrimi i kompetences qe neni 6 i Ligjit "Per Policine e Ndertimit" i jep organit te Policise te Ndertimit ne lidhje me pezullimin dhe njoftimin e KRRTRSH-se per vendimet e marra nga Keshilli i Rregullimit te Territorit, kur veren shkelje te ligjit ne vendimet e tyre. Keshtu, gjate praktikes tone te deritanishme jane evidentuar raste, kur per vendime te ndryshme te KRRT-ve, per shkelje te ndryshme ligjore te konstatuara, organi i Policise te Ndertimit, mund te vepronte duke pezulluar zbatimin e tyre dhe t'ia percillte per shqyrtim KRRTRSH-se, veprim i cili rralle ka ndodhur, duke evidentuar nje qendrim pasiv te ketij organi per ushtrimin e kompetencave te veta, te cilat ne kete rast nuk duhen kuptuar si fakultative,

por si detyrim ligjor. Po kështu janë evidentuar edhe raste kur edhe pse mund dhe duhej të ushtrohej kjo kompetence, organi i Policisë të Ndertimit, ka preferuar të nxjerre në tejkallim të kompetencave të tij vendime për prishje, pa ja kaluar çështjen për kompetencë trajtimi KRRTRSH-se.

- Nga ana e Drejtorisë së Policisë të Ndertimit, është evidentuar në disa raste mosrespektim i afatëve ligjore të percaktuara në nenin 82 të Ligjit nr.8405 datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”, në lidhje me nxjerrjen e një vendimi si organ hierarkik administrativ, ndaj ankimeve administrative që subjektet perkatese i drejtojnë për vendime të nxjerra prej Kryetareve të degëve të Policisë të Ndertimit. Ky mosveprim jo vetëm që përben shkelje të parimit të rendesishëm të marrjes së vendimeve, por lidhet me një anë negative të veprimtarisë së administratës dhe me konkretisht atë të mosushtrimit të kompetencave të dhëna me ligj. Në disa çështje të shqyrtuara kjo sjellje administrative që nuk përputhet aspak me termat e një procesi të rregullt ligjor, krijon konfuzion dhe pasiguri tek individët, të cilët shohin tek kjo administratë një subjekt që në aktivitetin e tij duhet të kontribuojë në respektimin dhe zbatimin e të drejtave të tyre të ligjshme. I tillë është rasti i ankesës së shtetasit J.Q nga Tirana, kur megjithatë ky shtetas ka respektuar afatet ligjore proceduriale për paraqitjen e ankimit administrativ në Drejtorinë e Policisë të Ndertimit, ndaj një vendimi për prishje objekti të nxjerre prej Policisë të Ndertimit, dega Tirana Qytet, Drejtoria e Policisë të Ndertimit edhe pas disa muajsh nga dita e ankimit dhe pasi dega e saj kishte ekzekutuar vendimin, ende nuk kishte nxjerre vendimin perkates.

Përsa i përket aspektit të kuadrit ligjor, konstatojmë se:

- Për shkak të nderthurjes së kompetencave apo percaktimeve jo të qarta që behen në ligje të ndryshme dhe që lidhen me kompetencat dhe juridiksionin e Policisë të Ndertimit, del e nevojshme përgatitja dhe hyrja në fuqi sa më parë e një ligji të ri për urbanistikën. Efektivisht, në disa raste që janë shqyrtuar nga ana jone janë konstatuar vakume ligjore të cilat nuk i japin mundësi veprimi dhe vendimmarrje, as Policisë të Ndertimit dhe as KRRRT-ve, në referencë të nenit 77 të Ligjit “Për urbanistikën”. Akoma me emergjente e ben këto situata hyrja në fuqi e Ligjit nr.9482 datë 16.02.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndertimeve pa leje”. Projekt ligji i ri për urbanistikën i përgatitur nga Qeveria, vlerësojmë se do të jetë një ndihmë dhe zgjidhje efikase për këto çështje. Megjithatë gjykojmë se para kalimit të tij për miratim në Kuvend, ky projekt ligj duhet të kalojë për një diskutim me të gjere në të gjithë grupet e interesit dhe aktoret e dobishëm për një vendimmarrje sa më objektive dhe gjithëpërfshirëse. Në këtë projekt ligj mbeten për t’u qartësuar dhe pasqyruar drejt një sere parashikimesh që

kane te bejne me respektimin e parimeve te autonomise vendore, sikurse p.sh formimi dhe perberja e KRRT-ve te reja, sipas ketyre parimeve.

- Mbetet ende i paqarte ligjerisht, pozicioni detyrues i organit te Policise te Ndertimit, ne rastet kur konstatohet demtim i prones se personave te trete nga ana e firmave te ndertimit, gjate zbatimit te lejeve te ndertimit, per shkak te moszbatimit korrekt te projektit te miratuar, ne reference te ligjit nr.8402, date 10.09.1998 "Per kontrollin e disiplinimin e punimeve te ndertimit".

- Riorganizimi dhe funksionimi i organit aktual te Policise te Ndertimit, ne suazen dhe frymen e parimit kushtetues te decentralizimit, kerkon percaktimin e nje varesie te re administrative te ketij organi dhe perkatesisht varesine prej organeve te qeverisjes vendore. Ne kuader te Kartes Europiane te Autonomise Vendore, qe eshte ratifikuar me Ligjin nr.8548, date 11.11.1999, e cila eshte bere pjese e legjislacionit tone te brendshem, nuk duhet te harrojme parimin qe sanksionon ky akt, sipas te cilit kompetencat qe u besohen organeve lokale duhet te jene te plota dhe mund te diskutohen apo te kufizohen nga nje autoritet tjeter, qendror apo rajonal, vetem brenda ligjit. Eshte kuptimplote fakti se me autonome lokale si koncept Karta Europiane e Autonomise Vendore, kupton te drejten dhe aftesine efektive te bashkesive lokale per te rregulluar e drejtuar, brenda ligjit, nen pergjegjesine e tyre nje pjese te mire te ceshtjeve publike, sikurse edhe eshte infrastruktura urbane ne kete rast dhe ligjshmeria e punimeve te ndertimit.

Projekt ligji me i ri per rregullimin e vartesis administrative dhe menyres se funksionimit dhe fushes se kompetencave te organit aktual te Policise te Ndertimit, gjykojme se eshte nje tjeter hap i rendesishem pozitiv i ndermarre nga ana e Qeverise ne kete drejtim.

Pa mohuar punen pozitive qe eshte kryer ne shume zona ndaj ndertimeve pa leje nga ana e Policise te Ndertimit, te gjitha keto konstatime tregojne problematiken ne teresi te ketij organi, problematike e cila nxjerr nevojen e permiresimit te punes, per nje mirefunksionim dhe sherbim korrekt ligjor ndaj qytetareve. Ne kete kendveshtrim te punes se ketij organi, nisur nga nje problematike e konstatuar kete vit, se fundmi i kemi drejtuar nje rekomandim pergjithesues Drejtorise se Policise te Ndertimit dhe gjithdegeve te saj, per zbatimin korrekt te afateve te procedimeve administrative, per kundravajtjet administrative ne kompetence shqyrtimi nga ana e ketij organi.

Konstatimet e bera lidhen me mosveprimin e organit te Policise te Ndertimit, per pezullim te punimeve ne ndertimet qe rezultojne me shkelje ne zbatim, apo sanksionim me vendim per ndertimet e kundraligjshme.

Pergjithesisht, keto raste kane te bejne me shkelje te distancave apo kondicioneve urbanistike gjate zbatimit te projektit te miratuar ne lejet perkatese te ndertimit, mosrespektim te procedurave te kerkuara nga ligji per dokumentacionin qe duhet te mbahet ne kantierin e ndertimit, apo edhe per ndertime te cilat jane teresisht te kundraligjshme. Më poshtë po paraqesim një rast konkret:

Ne letren drejtuar Avokatit te Popullit, nje perfaqesi e banoreve te pallatit nr.18, rruga “Budi”, Tirane, ka shprehur shqetesimin ne lidhje me mosveprimin e deges se Policise te Ndertimit, Tirana Qytet, persa i perket ndertimit te nje objekti te ri me shkelje te kondicioneve urbanistike. Sikunder ata shprehen dhe bazuar ne nje shqyrtim paraprak qe Zyra per Mbrojtjen e Qytetareve i ka bere kesaj çeshtje, KRRT-ja ne Bashkine Tirane ka miratuar nje leje ndertimi, ne favor te firmes “Dola”, me manipulim te distancave te nevojshme si kondicione urbanistike, ne lidhje me ndertimet kufitare.

Ne keto kushte, kur ankuesve ju perkeqesohen ndjeshem kushtet e banimit nga ky ndertim i ri, keta te fundit i jane drejtuar deges se Policise te Ndertimit, Tirana Qytet. Por qe nga koha kur eshte drejtuar kjo ankese, nuk ka patur asnje veprim.

Pas kerkeses tone per shpjegime per kete çeshtje, dega Tirana Qytet me ane te shkreses nr.838/1 date 7.04.2006, ka sqaruar se pas verifikimit ne vend te problemit qe parashtrohet, ka rezultuar se:

-Subjekti perkates ndertues, po nderton nje godine banimi dhe sherbimi 5, 7 kat me 1 kat parkim nentoke, me vendim te KRRT-se ne Bashkine Tirane, nr.191 date 26.04.2005 dhe nr.269 date 1.06.2005.

-Nga matjet ne vend ka rezultuar se kondicionet ne anen lindore me pallatin 3 kat, nga 10m te miratuar ne plan-vendosje jane zbatuar 9.5m. Ne pallatin 3 kat ishte bere nje shtese banese 2.5m per te cilen ne shkrese shprehej se nuk mund te gjykohej per momentin ne eshte me leje apo jo, pasi ne planvendosjen e miratuar nuk ishte marre parasysh.

-Pallati ne anen jugore te objektit ne ndertim, nga 6 kate qe ishte realisht ne planimetrine e sheshit te ndertimit te miratuar nga KRRT-ja ne Bashkine Tirane, ishte paraqitur si 5 kate, me kondicion 12m.

-Per situaten ndertimore ishte mbajtur procedura ligjore, perkatesisht me nxjerrjen e proçes-verbalit te konstatimit te kundravajtjes nr.1 date 5.04.2006 dhe atij nr.2 date 6.04.2006.

Siç eshte konstatuar nga pergjigja e ketij organi, shkeljet ne kete rast ekzistojne ne kuader te kundravajtjes perkatese administrative.

Sikurse eshte konfirmuar ne aktet qe kjo dege e Policise te Ndertimit ka nxjerre ne kete çeshtje, kemi qene ne pritje te sqarimeve te metejshme per

veprimet e mepasshme qe do te ndermerreshin, apo aktet e tjera qe do te nxirreshin ne lidhje me shkeljet e konstatuara ne zbatimin e projektit te miratuar. Fakti eshte se pavaresisht shkreses tone nr.K3/Z2-10 date 19.04.2006 dhe detyrimit per kthimin e nje pergjigje, nuk n'a eshte konfirmuar veprimi i pritshem nga ana e ketij organi.

b. Ankesat per Ujesjelles Kanalizimet

Gjatë vitit 2006, janë shqyrtuar 18 ankesa, që kanë patur të bëjnë me ujësjellësit dhe kanalizimet. Nga këto 1 ankesë është zgjidhur në favor, 7 kane qenë të pabazuara dhe 10 jashtë juridiksioni.

Ankesën e zgjidhur pozitivisht po e trajtojmë për sa vijon:

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit është prezantuar shqetësimi i një punonjësi të Ndërmarrjes së Ujësjiellës-Kanalizimeve sha Tiranë, lidhur me transferimin e tij të për arsye ristrukturimi në një detyrë tjetër me pagë dhe pozicion me te ulët pranë sektorit të shfrytëzimit në periferi të Tiranës.

Ankuesi pretendoi se duke qenë me profesion kimist, me pervojë pune 24 vjeçare në trajtimin dhe analizimin e ujrave dhe duke mos patur asnjë masë disiplinore apo shkelje në detyrë gjatë ketyre viteve, ai nuk mund të transferohej nga detyra e inxhinierit kimist në atë të rojes së sektorit.

Avokati i Popullit bazuar ne ankesën e mësipërme kërkoi menjëherë shpjegime prane UK sha Tiranë, për të sqaruar hollësisht rrethanat e kësaj çështje. Ne vijim të ndërhyrjeve tona u informuam se nga ana e UK sha Tiranë ishte urdhëruar sistemimi i ankuesit në një vend tjetër pune brenda kësaj ndërmarrje serish ne detyren e inxhinierit kimist, vend i cili ishte pranuar nga ky i fundit pasi plotësonte kriteret e profesionit dhe pagës se tij të mëparshme.

Avokati i Popullit nga studimi i ankesave të ardhura gjatë vitit 2006 për Ndërmarrjet e Ujësjiellës-Kanalizimeve ka konstatuar se problemet kryesore që kane shqetësuar individët kanë qenë kryesisht mardhëniet e punës. Numri i i tyre drejtuar Avokatit të Popullit ka qenë 11 ankesa, por nga te dhenat rezulton se këtë shqetësim e kanë patur edhe mjaft punonjës të tjerë të UK sha, të cilët kanë preferuar tëi drejtohen organeve gjyqësore.

Nga ankesat e paraqitura rezulton se Ndërmarrjet e Ujësjiellës-Kanalizimeve kanë kryer transferime dhe largime nga puna ne numer te madh gjatë vitit 2006, duke i justifikuar këto veprime me realizmin e një reforme të thellë administrative dhe ristrukturuese të organikës së tyre.

Në disa raste Avokati i Popullit është përpjekur të nxjerrë shkelje te mundshme duke kryer hetime mbi procedurat e ndjekura për transferimet apo largimet nga puna. Por në përgjithsi nga ankesat e paraqitura, ka dalë se

këto procedura janë kryer pa të meta thelbësore nga ato që parashikon Kodi i Punes.

Per disa ankesa të tjera kjo nuk është arritur të provohet, pasi ato kane qenë në shqyrtim nga organet gjyqësore. Gjithsesi është për tu përmendur se në shumë raste Avokati i Popullit ka konstatuar se Ndërmarrjet e Ujësjiellës Kanalizimeve në rolin e punëdhënësit shfrytëzojnë në mënyrë të përsëritur vakumet ligjore të Kodit të Punës që nuk rregullojnë ligjërisht momente të mardhenieve të punës, siç janë transferimi në detyrë dhe pasojat juridike të tij. Në shumë raste rezulton se transferimi është i parashikuar në kontratat kolektive të punës të nënshkruara midis UK sha dhe punonjësve, duke e specifikuar si veprim që ndërmerret në rastet e nevojës së ngutshme që ka punëdhënësi në degë të caktuara në rrethe.

Në këtë aspekt janë urdhëruar një sërë transferimesh, të cilat për nga kushtet, largesia me vendin e banimit apo paga dhe shpenzimet e tjera të transportit, kanë qenë të papranueshme për punëmarrësit. Në këto kushte punëmarresit kanë qenë të detyruar të largohen vullnetarisht nga vendi i punës, duke e kthyer kështu transferimin në një metodë të re për largime nga puna.

Avokati i Popullit duke e parë transferimin e punonjësve, si formë të re abuzive për të kryer shkurtime dhe largime të pamotivuara nga puna, do të analizojë me përgjegjesi rrugët ligjore për të mundësuar parandalimin e mëtejshëm të këtij fenomeni, qoftë dhe duke kërkuar ndryshime apo amendime në Kodin e Punës. Vetëm në këtë mënyrë do të bëhet e mundur garantimi i të drejtave të punonjësve dhe eliminimi i praktikave të dyshimta që dëmtojnë rëndë interesat e tyre.

Në një këndvështrim të përgjithshëm të shërbimit publik që ofrohet nga UK sha, Avokati i Popullit konstaton se ankesat për faturime të pasakta janë ulur ndjeshëm. Kjo shpjegohet nga ana jonë me faktin se filialet e UK sha kanë treguar më tepër gadishmëri për tëju përgjigjur dhe zgjidhur ankesat e individëve.

Gjithsesi në këtë rast nuk përjashtohet dhe neglizhenca e vetë individëve për të vënë në vëmendjen tonë shkelje të mundshme. Kjo pasi shpenzimet familjare për ujin e pijshem zënë një pjesë simbolike dhe nuk perbejne rëndim të dukshëm të interesave në raport të njëjtë ekonomik me energjinë elektrike apo me impulset telefonike.

Krahas kësaj Avokati i Popullit vëren se vendosja e matësave të ujit ka vijuar edhe në vitin 2006 me projekte pilot. Por nga të dhënat që ne disponojme, në mjaft zona të tjera ku sistemi matës është i amortizuar, veprohet me llogaritje konsumi afrofe. Në këtë mënyrë, megjithëse për normat afrofe ka një vendim të veçantë të Entit Rregullator të Ujit (ERU),

Avokati i Popullit është përpjekur që kjo praktikë të gjejë një fund sa më të shpejtë në shërbimet publike, pasi nga zbatimi në praktikë i saj janë vënë re abuzime të mëdha në dëm të konsumatorit.

Një tjetër çështje që mendojmë se ka rëndësi për të drejtat e individit në raport me furnizimin me ujë të pijshëm, është edhe rinovimi i kontratave të reja. Kjo çështje është ngritur në mënyrë të vazhdueshme nga ana e Avokatit të Popullit. Por megjithë përpjekjet e vazhdueshme të ERU-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetës-Kanalizimeve pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve, rinovimi dhe lidhja e kontratave të reja me klientet familjarë dhe jo familjarë ka qenë në nivele të ulta.

Në këtë situatë ka ndikuar jo vetëm vëmendja e dobët për të përmirësuar marrëdhëniet kontraktore, por dhe resurset financiare për të siguruar kopje të reja për të gjithë konsumatorët. Me këtë rast duhet përmendur praktika e mirë që kanë disa shoqëri konçesionare të furnizimit me ujë në qytete, duke ofruar kontrata dhe librezat të reja për çdo klient të tyre.

Avokati i Popullit gjatë vitit 2006 ka qenë i detyruar të fokusohet tërësisht për të evidentuar dhe verifikuar shkelje të UK sha në marrëdhëniet e punës. Kjo pasi shumica e numrit të ankesave të paraqitura ka patur si shqetësim garantimin e të drejtave të punonjësve të këtij enti publik.

Në këto kushte detyrimi ynë për periudhën në vazhdim do të jetë fokusimi më tepër në standartet e shërbimit ndaj konsumatorit dhe mbrojtjes së të drejtave të tij ekonomike, duke gjetur dhe kërkuar përmirësimin e dukurive negative që mund të konstatohen gjatë punës tonë për këtë sektor.

c. Ankesa për Albtelekom sha dhe telefoninë celulare

Gjatë vitit 2006 pranë Avokatit të Popullit janë shqyrtuar 23 ankesa për Drejtorinë e Përgjithshme të Albtelekom sh.a dhe filialet e tij nëpër rrethe. Nga këto 3 ankesa kanë qënë të pabazuara, 16 kanë rezultuar jashtë juridiksionit dhe kompetencave, 4 ankesa janë zgjidhur në favor të ankuesve.

Ankesat e zgjidhura pozitivisht dhe problematikat që hasen në këtë ent publik, janë parashtruar si më poshtë vijon:

1. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, u paraqit ankesa e një individi me banim në Tiranë, i cili pretendoi se duke qënë abonent i Albtelekom sha, nga ana e strukturave të kësaj shoqërie ishte kryer një abuzim i hapur me detyrën gjatë përpilimit të faturave të thirrjeve në adresën e tij.

Konkretisht ai deklaroi se nga Muaji Korrik të Vitit 2005 kanë filluar të vijnë fatura telefonike në shuma të mëdha. Fillimisht ankuesi i kishte paguar ato, por më tej duke ndjerë dyshime, ka kërkuar kopje të faturës analitike të thirrjeve. Nga kjo kopje dhe dokumentacioni tjetër përkatës dorëzuar pranë Avokatit të Popullit, dilnin në pah dy shkelje të dukshme të kryera nga punonjësit e Telekomit Zona 2 Tiranë. Së pari ishin kryer thirrje në numra celularë dhe interurbanë me të cilët u provua së ankuesi nuk kishte lidhje njohje (*e provuar në prani të punonjësve të telekom sha*). Së dyti ishte ndryshuar në mënyrë të njëanshme aneksi i kontratës së pajtimit të abonentit, pasi ky i fundit kishte lidhur marrëveshje të veçantë për të patur në përdorim telefonin vërtet për komunikim lokal.

Avokati i Popullit, pasi u njoh me këtë ankesë, filloi verifikimet duke kërkuar mandej nga ana e Drejtorisë së Albtelekom sha që ti përcillej një informacion i hollësishëm lidhur me këtë problem dhe me masat që ata kishin marrë për ta zgjidhur atë, duke nxjerrë dhe përgjegjësitë konkrete disiplinore ndaj nëpunësve përgjegjës.

Më anë të përgjigjës së Drejtorit të Përgjithshëm të Albtelekom sha jemi njoftuar se pretendimi i ankuesit pas verifikimeve të kryera ka rezultuar i drejtë. Në këto kushte nga ana e kësaj shoqërie, nëpërmjet Rajonit Albtelekom Tirana 2 janë kryer zbritjet përkatëse për ato biseda që janë kryer në kundërshtim me aneksin kontraktor që ishte lidhur me këtë kompani. Nga ana tjetër, lidhur me personat përgjegjës, të cilët ndikuan me papërgjegjshmërinë e tyre në faturimin e padrejtë në shuma të mëdha në ngarkim të ankuesit, drejtuesit e Albtelekom sha bënë të ditur se ishte marrë masa e largimit nga puna.

2. Avokatit të Popullit, nisur nga disa ankesa të ardhura pranë tij, të cilat kishin si objekt të tyre formën dhe përmbajtjen e faturës së re të ofruar nga Albtelekom sha, rihapi sërish çështjen e shërbimit analitik të thirrjeve që duhet të ofrohen falas nga ana e Albtelekom sha. Ky veprim bazohej edhe në strategjinë e Institucionit tonë për të ndjekur çështjet e mëparshme deri në zgjidhjen e tyre të plotë.

Konkretisht Avokati i Popullit kërkoi pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Albtelekom sha, Entit Rregullator të Telekomunikacioneve zbatimin e plotë të Rekomandimit të tij të paraqitur gjatë vitit 2005. Ky rekomandim kërkonte përmirësimin e shërbimeve të faturimit ndaj abonentëve, duke shtuar në përputhje me Ligjin Nr.9135 dt.11.09.2003 "*Për Mbrojtjen e Konsumatorit*" listën analitike pa pagesë të thirrjeve telefonike, krahas faturës së shitjes për impulset e harxhuara.

Sipas argumentave të përmendura nga Avokati i Popullit, faturës fillëstare të shitjes i janë shtuar elementë të rinj integralë, si lista e thirrjeve

dhe kohëzgjatja e telefonatave. Kjo formë e re e faturës, në zbatim të dispozitës ligjore të mësipërme, duhet të kishte gjetur zbatim të plotë dhe pa pagesë nga ana e Albtelekom sha. Mirpo nga korrespondenca që është zhvilluar në vazhdimësi me drejtuesit e kësaj kompanie, ky detyrim ndaj konsumatorëve nuk ishte zbatuar dhe ngatërrohej mbase dhe me dashje me aplikimin e shërbimit shtesë të faturës (*më pagësë*) që parashikon Neni 30, paragrafi i fundit i Ligjit Nr.8618 dt.14.06.2000 “*Për Telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë*”.

Në përgjigje të kërkesës së Avokatit të Popullit, Drejtori i Përgjithshëm i Albtelekom sha sqaroi se shërbimi analitik i thirrjeve për abonentët është parë me synimin për të reduktuar në maksimum shpenzimet e konsumatorëve. Si rrjedhim Albtelekom sha filloi në Tetor 2006 të aplikojë një tarifë të re simbolike për çdo konsumator në vlerën e 50 lekëve për listat analitike.

Megjithëse kjo shifër u ul, duke u bërë e papërfillshme për konsumatorin, Avokati i Popullit nuk u pajtua sërish më këtë zgjidhje për aq kohë sa Ligji “Për Mbrojtjen e Konsumatorit” referon shërbim falas ndaj abonentëve për faturat analitike. Në këto kushte, institucioni ynë ju drejtua Entit Rregullator të Telekomunikacionit, duke kërkuar ndërhyrjen e tij deri në zgjidhjen e plotë të kësaj kërkesë.

Në përgjigjen e paraqitur nga ky organ, sqarohet së ERT-ja kishte mbështetur plotësisht kërkesën tonë si të ligjshme dhe të bazuar dhe i ka kërkuar Albtelekom sha të marrë të gjitha masat për korrigjimin e kësaj praktike abuzive. Në vijim të këtyrë masavë ERT-ja ka marrë angazhimin për të ndikuar në shmangien e kësaj praktike edhe gjatë hartimit dhe miratimit të kontratës së re të abonentëve që do të realizohet së shpejti.

Referuar kësaj përgjigje, Avokati i Popullit megjithëse e vlerëson reagimin pozitiv të ERT-së do të vazhdojë të ndjekë deri në fund përmbushjen e këtij angazhimi, i cili është një detyrim i rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit.

Në një vështrim të përgjithshëm si rezultat i konstatimeve tona rezulton se Albtelekom sha megjithëse është futur në rrugën e privatizimit ka vazhduar të tregojë anë negative të administrimit dhe kujdesit ndaj abonentëve. Gjithashtu vetë përmbytja dhe verifikimi i ankesave flet për një shërbim me standarte të ulta që nuk arrin të krijojë bindjen tek qytetarët dhe publiku i gjërë të një institucioni serioz dhe eficient.

Në Institucionin e Avokatit të Popullit nuk kanë qënë të pakta ankesat për zvarritje të procedurave për instalimin, rilidhjen, transferimin e numrave të telefonit etj. Kjo gjë ka ardhur si pasojë e një administrate ineficiente, e pamotivuar për punë, e cila shpesh herë është akuzuar për korrupsion. Në

këtë kompani megjithë ndryshimet e mëdha që janë bërë në kuadër të miratimit të rregullores dhe kontratës së re, janë ndjerë pengesa të mëdha në zbatimin e tyre në praktikë. Në Albtelekom sha është konstatuar në mënyrë të vazhdueshme një paaftësi për të menaxhuar dhe verifikuar në kohë ankesat e abonentëve. Kjo situatë ka qënë tejet e rënduar në aspektet e verifikimit të impulseve të harxhuara dhe matjeve jo të rrëgullta. Si rrjedhojë Avokati i Popullit ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme që klauzolat e kontratës së shërbimit të telefonisë fikse dhe rregullorja e hartuar në shërbim të marrëdhënieve me klientin të zbatohen e respektohen si mjeti primar për të arritur standarte të larta në cilësinë e shërbimeve.

Përveç kësaj gjatë vitit 2006 Albtelekom sha ka bërë një reformim të administratës, duke larguar nga puna një numër të madh punonjësish dhe duke kryer transferime absurde me efekt largimin e tyre nga puna në mënyrë të detyruar. Këto praktika kanë qënë mjaft të dëmshme jo vetëm për të drejtat dhe interesat e punonjësve të kësaj kompanie, që tashmë enden dyerve të gjykatave, por dhe për vetë performancën dhe aftësinë e saj manaxheriale në raport me publikun.

Nga ngjarjet që tronditën thellë besimin ndaj këtij institucioni gjatë vitit 2006 ishte mos transparenca e marrëveshjeve të interkonjeksionit me operatorët celularë dhe zvarritja në kohë e lidhjes së tyre që rëndoi të ardhurat e konsumatorëve. Megjithëse në mënyrë të zgjeruar për këtë çështje do të flasim në vijim, në këtë rast duhet të themi se Qeveria Shqiptare nuk duhet të nxitohet në emërimet që bën në nivele të larta dhe më mjaft përgjegjësi të organeve të administratës publike dhe të të tretëve që punojnë për llogari të tyre, sidomos kur ka interesa të mëdha financiare. Ajo nuk duhet të emërojë persona pa përgatitjen dhe staturën e nevojshme për të përballuar luftën kundër korrupsionit.

Gjithashtu Avokati i Popullit në kuadër të procedurave financiare paraendëse të privatizimit të Albtelekom sha ka shprehur qëndrimin e tij që Qeveria Shqiptare, jo vetëm të kontraktonte firma auditimi për kryerjen e ekspertizës së privatizimit të kësaj kompanie, por ajo nuk duhet të kursente as fonde që këtë kontroll ta shrinte dhe mbi vlerësimin e aseteve apo të veprimeve të tjera administrative që kanë patur qëllime kriminale në të kaluarën dhe në të tashmen. Për realizimin e këtij kontrolli Institucioni i Avokatit të Popullit propozoi pranë Qeverisë dhe Kuvendit që ushtrimi i auditimit në Albtelekom sha nuk duhej të parcelizohej, por ai duhet të kryhej i plotë dhe me ekspertë të specializuar ndërkombëtarë në fushën e krimit të telekomunikimit.

3. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, me cilësinë e përdoruesit të rrëgullt të kartës rimbushëse të Kompanisë Vodafon Albania sha, një

qytetar u ankua se gjatë verës së Vitit 2005 e në vazhdim kishte vënë re, se ndërsa kryente thirrje brënda rrjetit Vodafon, harxhimi i kreditit të tij në kartë ishte shumë i shpejtë. Ky fenomen kishte ndodhur dhe në mjaft qytetarë të tjerë të kësaj zone, pasi, sipas tyre, në Shkodër dhe në të gjitha zonat kufitare përreth kishte një ndërhyrje të pashpjegueshme të rrjetit të telefonisë së lëvizshme të Malit të Zi. Kjo ndërhyrje sipas tyre kishte sjellë që brënda një telefonate të shkurtër të harxhohej e gjithë karta rimbushëse 1000 lekë, çka përbente një shkelje të rëndë të të drejtave dhe interesave të tyre ekonomike si konsumator.

Në këto kushte, Avokati i Popullit për ti ardhur në ndihmë rivendosjes në vend të të drejtave të konsumatorëve të telefonisë së lëvizshme Vodafon në zonën e Shkodrës, kërkoi nga ana e Vodafon dhe ERT që të kryhej një verifikim teknik i kësaj dukurie.

Nga informacioni i ardhur për këtë kërkesë nga Kompania Vodafon, sqarohej se prania e sinjaleve të linjave të tjera të huaja në zonat kufitare ishte një dukuri që njihej nga të gjithë operatorët celularë vendas apo të huaj. Ndaj në të gjitha rastet kompanitë celulare kishin aplikuar një standart të mirënjohur për t'iu instruktuar abonentët për të përdorur në zonat kufitare rrjetin manual të aparatit celular. Kjo këshillohej që abonentit të mos binte rastësisht preh e roamingut të padëshiruar. Në vijim të kësaj jemi informuar nga Shoqëria Vodafon se broshura me këtë informacion të rëndësishëm për konsumatorët shqiptarë të zonës së Shkodrës, ishte shpërndarë sërish për t'iu ardhur në ndihmë të gjithë atyre abonentëve që nuk ishin ende në dijeni për këtë praktikë përdorimi. Ndërsa referuar përgjigjes së ardhur nga ERT-ja, Avokati i Popullit u informua se roamingu i padëshiruar në zonat kufitare edhe pse është një dukuri që ndodh shpesh herë edhe në vende të tjera, duhet të gjejë reduktime sa më të mëdha për të mbrojtur konsumatorin. Nisur nga kjo ankesë, në fillim të Muajit Dhjetor, ERT organizoi një seancë dëgjimore me dy kompanitë celulare që operojnë në tregun shqiptar, ku pas analizës që ju bë sistemit teknik të shpërndarjes së valëve në zonat kufitare, u la si detyrë përforcimi teknik i sistemeve të tyre për të minimizuar ndërhyrjet e rrjeteve të huaja celulare.

4.Çështja që do të paqyrojmë në vijim, përbën një nga praktikat më të rëndësishme të shqyrtuara nga Avokati i Popullit gjatë vitit 2006. Kjo për faktin se hetimi i kësaj ankese, arriti të zbulojë dhe provojë për herë të parë veprimet abuzuese të Kompanisë shtetërore Albtelekom sha në bashkëpunim me Kompanitë celulare Vodafon dhe AMC, në dëm të interesave të konsumatorit.

Institucioni i Avokatit të Popullit kishte krijuar rezerva që në vitin 2001 e në vijim për mënyrën e përmbushjes së procedurave ligjore të lidhjes

së marrëveshjeve të interkonjeksionit. Ato sipas tij ishin kryer gjithmonë në mënyrë hermetike dhe jo transparente, duke nxitur shpesh herë debatë dhe akuza publike.

Ky qëndrim skeptik dhe dyshues gjeti vënd sërish edhe në procedurat e lidhjeve të reja të marrëveshjeve të interkonjeksionit për vitin 2006 midis Albtelekom sha dhe operatorëve celularë Vodafon dhe AMC.

Hetimi i hollësishëm për tarifat e interkonjeksionit filloi me depozitim pranë Institucionit të Avokatit të Popullit të një materiali denoncues nga një individ, ish nëpunës i lartë i Albtelekom sha me njohuri dhe eksperiencë të gjatë në fushën e telekomunikacioneve (*liruar nga detyra pa arsye të përlijtura*), i cili paralajmëroi me fakte dhe oponencë të argumentuar teknike dhe ligjore se në Albtelekom sha dhe në Këshillin Mbikqyrës të tij po bëheshin përpjekje nga njerëz me përgjegjësi dhe të veshur me pushtet, që në kuadër të bisedimeve për çmimet e interkonjeksionit, të ritrajtoheshin dhe të ripropozoheshin ofertat e tarifave të propozuara nga operatorët Vodafon dhe AMC në (21 lekë/min), kur në bazë të oponencës së një grupi pune ekspertësh negociatorë të Albtelekom sha tarifa mesatare e interkonjeksionit duhet të varionte nga (14-16 lekë/min) (Tarifa Hyrëse Kombëtare).

Në kronologji ngjarjesh kjo gjë kishte filluar me Vendimin Nr.4 dt.01.02.2006 të Këshillit Mbikqyrës të Albtelekom sha “*Mbi Platformën e Marrëveshjeve të Reja të Interkonjeksionit me Operatorët Mobilë*” ku ishin përcaktuar kufinj të tarifave të reja që do tu propozoheshin operatorëve për lidhjet e interkonjeksionit. Mbështetur në këtë platformë më dt.06.03.2006 dhe 30.03.2006 në mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës të Albtelekom sha grupi i punës për caktimin e ofertave që do tëju propozoheshin operatorëve celularë për interkonjeksionin doli në përfundimin se për Tarifë Hyrëse Kombëtare Albtelekom sha duhet të propozojë çmimin 14 lekë/minutë. Pas kësaj, meqenëse ky propozim haste në disa interesa të dyshimta të disa prej përfaqësuesve të Albtelekom sha, të cilët kishin hedhur propozimin për 21 lekë/minutë, më dt.05.04.2006 lirohet nga detyra pa një motivacion të bazuar Drejtori i Interkonjeksionit në Albtelekom sha, pasi ky i fundit ishte teknikieni që dha argumentat më bindëse për çmimin minimal të mësipërm.

Më dt.20.04.2006 Këshilli Mbikqyrës në bazë të një relacioni paraprak të pafirmosur nga grupi teknik, pranon në kundërshtim me platformën dhe me dy vendimet e mësipërme, ofertën e AMC-së në 19 lekë/minuti me anë të Vendimit Nr.13. të kësaj date.

Më dt.25.04.2006 Avokati i Popullit, nisur nga njoftimi që kishte marrë për këtë çështje, denoncon publikisht aferat që po ndodhnin në Albtelekom sha për interkonjeksionin.

Më dt.02.05.2006 përpilohet Akti Kontrolli i Grupit të Inspektimit të Këshillit të Ministrave për Antikorrupsionin në Administratë, i cili del me shkelje ndaj drejtuesve të Albtelekomit, por që më tej megjithë interesimin e Avokatit të Popullit, ky inspektim nuk konkludoi me propozime masash disiplinore ndaj drejtuesve të Albtelekomit.

Më dt.03.05.2006 Këshilli Mbikqyrës i Albtelekomit e konsideroi të paaritshme një marrëveshje me operatorët celularë, duke hedhur poshtë tarifën e vendimit të mëparshëm dt.20.04.2006 dhe duke u kthyer sërish tek tarifën e vendimit të datës 30.03.2006.

Mandej ky këshill i kërkoi ERT të fillonte shqyrtimin për caktimin e tyre me vendim, sipas ligjit "*Për Telekomunikacionet në RSH*".

Institucioni i Avokatit të Popullit krijoi bindjen e plotë se të gjitha veprimet e mësipërme (*për të cilat disponon dokumenta të pakontestueshme*) treguan se në Albtelekomit gjatë periudhës së lartpërmendur është tentuar të privilegjohej në mënyrë të paligjshme dhe në kurriz të të gjithë konsumatorëve shqiptarë operatorët celularë. Kjo çështje e cila për fat të mirë ngeli thjesht në fazën e tentativës, tregoi se sa e rëndësishme është transparenca në veprimet e organeve të administratës publike. Pas kësaj Avokati i Popullit, synoi të çonte deri në fund përpjekjet e tij për zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështje, në favor të të drejtave të konsumatorit.

Për këtë qëllim, Institucioni i Avokatit të Popullit i dërgoi një rekomandim ERT-së duke i kujtuar qëndrimin e tij objektiv dhe ligjor që duhet të mbante gjatë vendimarrjes për çështjen e caktimit të tarifave të interkonjeksionit. Konkretisht ERT-së ju kërkua që të zbatonte parimet dhe opinionet e saj për çështjet e Interkonjeksionit të bëra zyrtarisht të njohura nëpërmjet "*Dokumentit të Analizës së Tregut të Telefonisë së Lëvizshme*" të miratuar nga kjo e fundit, ku midis të tjerash ajo pranonte si referencë për këto tarifa treguesin evropian (banchmarch), i cili ishte mjaft larg ofertave të operatorëve celularë për marrëveshjet e vitit 2006.

Në vendimin e marrë nga ERT për tarifën e interkonjeksionit, ky organ zbatoi plotësisht rekomandimin e Avokatit të Popullit, duke e shmangur kështu aferën e lartpërmendur. Roli i ERT-së ishte vendimtar për të shmangur keqpërdorimin e deriathershëm të atyre parimeve nga AMC dhe Vodafon, duke rekomanduar (urdhëruar) referencën me benchmark-un evropian, në nivelin 14-16 lëkë për minutë për tarifën e interkonjeksionit, por edhe duke caktuar çmime më të ulta për të gjithë shërbimet e tjera. Gjithashtu ERT-ja vuri në dukje të Albtelekomit shprehjet e negociatave të interkonjeksionit më anë të dy shprehjeve të saj, të cilat në përmbajtjen e tyre konstatonin shkelje flagrante të afateve ligjore, gjë që kishte shkaktuar jo pak humbje në xhepat e konsumatorëve.

Gjithsesi Avokati i Popullit, megjithë zgjidhjen pozitive të këtij rasti, u bë i vetëdijshëm së qëllimi për të cilin kjo çështje krijoi një vëmendje kaq të madhe në publik nuk dha rezultatin e duhur.

Konkretisht nga përlogaritjet e bëra nga ekspertët e pavarur të pajtuar nga Avokati i Popullit për këtë çështje rezultoi se tarifrat e interkonjeksionit nuk ndikuan shumë në rënien e tarifave të impulseve të telefonisë celulare për përdoruesit fundor. Kjo gjë megjithëse u pranua edhe në një përgjigje të muajit Tetor 2006 nga ERT-ja, nuk u trajtua më tej, pasi për shkak të presionit të gjithanshëm politik, institucional dhe publik mbi kompanitë celulare, tarifrat e tyre pësuan një rënie të lehtë, çka reduktoi dhe zërat e shumtë që kontestonin çmimet e tyre.

5. Një tjetër çështje e mprehtë që kulmoi gjatë vitit 2006 në kërkesat e individëve dhe grupeve të interesit në komunitet ishin padyshim tarifrat e larta të telefonisë celulare që ofroheshin nga dy operatorët në Shqipëri AMC dhe VODAFON.

Avokati i Popullit ka konstatuar prej kohësh që tarifrat e celularëve në Shqipëri vendoseshin dhe aplikoheshin nga operatorët privatë në mënyrë të pakontrolluar nga organet shtetërore përgjegjëse. Për më tepër këto tarifa vepronin në kushtet e një tregu ende të paliberalizuar, ku të krijohej bindja e plotë që konsumatori shqiptar përballet përpara një duopoli të fuqishëm, nga i cili nuk duhet të kërkojë, por vetëm të presë. Për tëi ardhur në ndihmë mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të ligjshme të individëve, Institucioni i Avokatit të Popullit hetoi në mënyrë të pavarur këtë çështje, duke patur si synim kryesor të vërë në lëvizje organet përgjegjëse shtetërore dhe të kërkojë përgjegjësitë për ato mosveprime administrative, të cilat kanë lënë shteg edhe për vakum ligjor në kontrollin e tarifave, duke privilegjuar në mënyrë flagrante operatorët celularë në tarifrat e tyre të larta.

Avokati i Popullit, me përgjegjsi dhe zyrtarisht deklaroi publikisht se operatorët e telefonisë së lëvizshme Vodafon dhe AMC aplikonin si filiale të Vodafon grup dhe Cosmote grup, normat më të larta të fitimit në tregun evropian e më gjërë. Ky konstatim i Avokatit të Popullit megjithëse është kundërshtuar nga dy operatorët e mësipërm ka një burim zyrtar dhe të besueshëm, i cili është “Dokumenti i Analizës së Tregut të Telefonisë së Lëvizshme” të miratuar nga ERT më Nr.381 Prot dt.07.02.2006.

Përveç kësaj Institucioni i Avokatit të Popullit ka studjuar gjatë vitit 2006 tarifrat e ofruara në vendet fqinjë të telefonisë celulare, si dhe ka ardhur në dijeni për një sërë deshmish të individëve të ndryshëm, të cilët kanë konstatuar ndryshime të mëdha në tarifrat e celularëve që janë në përdorim në Greqi dhe Itali, krahasuar më Shqipërinë.

Në një analizë të thjeshtë juridike që ne jemi munduar të kryejmë për tëi ardhur në ndihmë identifikimit të shkaqeve të tarifave të larta të telefonisë mobile është padyshim së pari, mungesa e një metodologjie për caktimin e tarifave të telefonisë celulare që duhet të propozohet nga ERT për miratim në Këshillin e Ministrave.

Ky akt duhet të ishte miratuar në zbatim të detyrimeve që parashikon Neni 62 i Ligjit Nr.8618 dt.14.06. 2000 “*Për Telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë*”.

Avokati i Popullit ka deklaruar më shumë se një herë se këto 6 vjet ERT nuk ka luajtur rolin e tij për të mbrojtur interesat e konsumatorit dhe për të vënë nën kontroll operatorët privatë të telefonisë celulare. Kjo mund të jetë bërë me dashje apo pa dashje siç doli edhe nga hetimi i Komisionit Parlamentar në Vitin 2004, por fakti është se edhe dy vjet pas këtij komisioni, operatorët e telefonisë celulare kanë mundur të mos vihen nën kontroll për tarifën që aplikojnë, tregon qartë pohimin e drejtë të kryer nga ana jonë.

Në këtë kuadër, Avokati i Popullit, me qëllim nxitjen e këtij organi dhe gjetjes së mënyrave ligjore për mbrojtjen e të drejtave ekonomike të qytetarëve nga abuzimet me tarifën e telefonisë mobile, ka vijuar angazhimin e tij edhe gjatë vitit 2006 që të realizojë në bashkëpunim me ERT-në një plan veprimi për vënien në kontroll dhe uljen e këtyre tarifave.

Aktualisht, megjithëse jashtë afatit të caktuar nga vetë ERT-ja Shoqëria Gjermanë, e cila ka hartuar draftin e metodologjisë së caktimit të tarifave nga operatorët celularë, vazhdon të trajtojë dhe ritrajtojë pjesë të ndryshme të këtij dokumenti, sipas oponentëve të prezantuar nga operatorët celularë dhe ERT-ja.

Nga një takim që Avokati i Popullit ka zhvilluar me Kryetarin e ERT-së Z.Hydajet Kopani për këtë çështje, kemi mësuar se ky draft metodologjie ka patur problem për cilësinë e tij, gjë e cila po zgjaste përfundimin dhe miratimin e tij. Lidhur më sa më lart Avokati i Popullit ka këmbëngulur që nga ana e ERT-së të kryheshin sa më shpejt këto procedura, pasi çdo vonesë e mëtejshme e tyre ishte në dëm të interesave të konsumatorit. Nga të dhënat më të fundit të marra për këtë çështje rezulton se ERT ka përgatitur dokumentin final të metodologjisë, i cili pritet që brenda muajit shkurt 2007 të kalojë për miratim në Këshillin e Ministrave.

Krahas kësaj Avokati i Popullit ka konkluduar se një tjetër element i rëndësishëm për uljen e tarifave të telefonisë celulare është vënien në funksionim e operatorit të tretë celular “Eagle Mobile”.

Fillimi i veprimtarisë së kësaj kompanie është një tjetër komponent mjaft i rëndësishëm për të hapur rrugë konkurrencës së ndershme, tarifave të

arsyeshme, liberalizimit të tregut mobil dhe dhënies fund të mungesës së rregullave të lojës në fushën e telekomunikacioneve apo të marrëveshjeve me veprime konkludente midis dy operatorëve celularë aktualë për të mbajtur në të njëjta nivele të larta tarifave të tyre terminuese.

Avokati i Popullit konstaton se ka dy vjet që shteti shqiptar paguan taksën e licencës për këtë kompani, e cila nuk është vënë ende në funksionim. Për këtë ne disponojmë një praktikë korrespondence midis ERT-së, Këshillit Mbikqyrës së Albtëlëkom sha, Kompanisë “Eagle Mobile” dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, ku pasqyrohet kronologjikisht shtyrja dhe zvarritja në kohë e procedurave për vënien në funksionim të këtij operatori.

Tashmë ndodhur përpara deklaratave të fundit të Drejtorit Ekzekutiv të “Eagle Mobile” se kjo kompani do të hapet në Janar 2007 nuk na mbetet gjë tjetër veç të shohim me skepticizëm veprimet e rradhës për të kqyrrur zvarritjet e pritshme gjatë përmbushjes së kësaj procedure.

6. Një tjetër çështje e hetuar nga Avokati i Popullit gjatë vitit 2006 ka qënë privatizimi i AMC-së dhe detyrimet që ajo ka ndaj shtetit shqiptar dhe punonjësve të saj, si dhe mosveprimin e organeve shtetërore për të vënë përpara përgjegjësisë ligjore këtë kompani për shkeljet e konstatuara në fushën e lëgjislacionit tregtar.

Ky hetim filloi me kërkesë të një grupi ish punonjësish të AMC-së që aktulisht janë aksionerë të kësaj kompani. Ata u ankuan së AMC nuk ju ka shpërndarë dividendët prej gati pesë vjetësh. Ndërkohë që edhe pjesa shtetërore prej 12.5 % të aksioneve që administrohet nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës jo vetëm nuk kishte përfituar nga ky aktivitet, por as nuk kishte ndërhyrë me autoritetin e duhur shtetëror që ky problem të merrte fund sa më shpejt.

Avokati i Popullit fillimisht u përball me presionin e AMC që kjo çështje të trajtohej me legjislacionin tregtar, duke i konsideruar veprimet apo mosveprimet e saj, çështje të brendshme të një kompanie private, pra jashtë juridiksionit tonë. Por e drejta jonë për të kërkuar llogari ndaj organeve shtetërore e konkretisht ndaj METE-s ishte mëse e ligjshme, pasi në këtë aferë shteti obligohej në mënyrë të dyfishtë për të përmbushur funksionet e tij në interes të qytetarëve. Përveç kësaj kjo çështje ngrihej në vazhden e një sërë akuzash të tjera që rëndonin ndaj AMC-së, gjë që duhet të krijonte një vëmendje të vëçantë nga strukturat shtetërore.

Nga ndërhyrjet që u nxitën nga ana jonë, perfaqësues të METE-s arritën të bindin drejtuesit e AMC për mbledhjen e ansamblesë dhe shqyrtimin e çështjeve që kërkonin zgjidhje të menjëhershme. Nga zhvillimi i këtyre mbledhjeve ka rezultuar se aksionerët kanë arritur një zgjidhje të

pjeshme të problemeve të tyre, kurse për problemet e pazgjidhura atyre ju është premtuar një mbledhje tjetër.

7. Një tjetër hetim që ndërmorri me iniciativë Avokati i Popullit gjatë vitit 2006 ishin të ardhurat që fitohen nga përqindjet e garancive bankare që depozitohen pranë bankave të nivelit të dytë për llogari të dy operatorëve celularë (Në rastin e numrave me kontratë). Hetimi se ku shkojnë interesat e këtyre depozitave që konsumatorët vënë në bankë në formë garancie për të fituar një numër me kontratë, ishte një procedurë që kërkonte medoemos bashkëpunimin e Reiffessen Bank, bankë e cila kishte trashëguar të gjitha llogaritë e Bankës së Kursimeve.

Avokati i Popullit nisur nga një interes i lartë që kërkohet të arrihej në këtë kuadër, prezantoi kërkesën e tij pranë drejtuesve të kësaj banke për të marrë më tepër informacion. Por nga këta të fundit kjo çështje u trajtua si një veprim që tentonte të shkelte sekretin bankar të klientëve të bankës. Gjithsesi me marrjen e kësaj përgjigje, Avokati i Popullit po shikon hapësirat e mundshme ligjore që këtë çështje ta kalojë për kompetencë dhe veprime të mëtejshme pranë Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë.

Referuar situatës problematike të veprimtarisë së telefonisë celulare në vend dhe pozites monopol të operatorëve të kësaj fushe, Kuvendi i Shqipërisë kreu një hetim parlamentar gjatë muajit Maj-Korrik 2006 me anë të një Komisioni Hetimor. Gjatë seancave dëgjimore, Avokati i Popullit pati detyrimin ligjor të parashtronte pranë këtij komisioni me fakte dhe dokumentacion këndvështrimin dhe opinionin e tij zyrtar për situatën e krijuar, dukë dhënë përgjigje dhe rekomanduar masa të rëndësishme mbi tregun e telefonisë celulare.

Në përfundim të këtij hetimi parlamentar, Avokati i Popullit konstatoi se mjaft nga propozimet e tij ishin përfshirë në rekomandimet përfundimtare që ky komision paraqiti pranë Kuvendit si pjesë e raportit përfundimtar. Në përmbajtjen e këtyre rekomandimeve viheshin në dukje përgjithësisht masat me karakter legjislativ që duheshin marrë për të eliminuar gjendjen duopol të telefonisë celulare në vend. Krahas kësaj rekomandimet kërkonin marrjen e masave të tjera me karakter nënligjor apo administrativ nga Qeveria dhe ERT-ja për të përmbushur detyrimet ligjore karshi kontrollit të veprimtarisë së telefonisë celulare në vend.

Aktualisht megjithëse kanë kaluar më tepër se gjashtë muaj, Avokati i Popullit konstaton më keqardhje se puna e Komisionit Hetimor Kuvendor dhe përfundimet e tij kanë mbetur në letër dhe nuk janë vënë në zbatim. Madje kjo veprimtari nuk është bërë ende publike dhe nuk është shtruar për debat apo diskutime të mëtejshme në seancat kuvendore.

Ky mosveprim për një çështje kaq të rëndësishme për të drejtat dhe interesat e ligjshme të konsumatorëve, na ka detyruar të aludojmë për ndikime aspak të moralshme dhe ligjore të biznesit në vendimarrjen politike, të cilat kanë atrofizuar përpjekjet e organeve të larta kushtetuese dhe ligjore për të vendosur tarifën dhe tregun e telefonisë celulare nën standarde të pranueshme.

Në këto kushte, Avokati i Popullit nisur nga interesa të larta publike do të vijojë të kërkojë nga të gjitha strukturat shtetërore vënien në zbatim të rekomandimeve të komisionit parlamentar hetimor.

Në mendojmë se zbatimi i dokumentit të miratuar nga Komisioni i Kuvendit të Shqipërisë mbi hetimin e tregut monopol të telefonisë celulare është pikënisja e përmirësimit të situatës së krijuar dhe njëkohësisht rivendosja e të drejtave dhe interesave të ligjshme të konsumatorit. Ky dokument është në vetvete një arritje e madhe që tregon ndërgjegjësimin e organeve më të larta në vënd për problemet që shqetësojnë qytetarët. Ndaj dhe materializimi i këtij dokumenti me veprime dhe masa konkrete është një detyrim kushtetues ndaj zgjedhësve dhe kërkon përkushtim maksimal.

Në një konkuzion përfundimtar veçojmë problematikën ende të madhe që paraqet kjo fushë e telekomunikacionit dhe rëndësinë që duhet ti kushtohet nga të gjitha organet kompetente mbarëvajtjes së kësaj veprimtarie për vetë efektet që ajo ka në xhepat e shqiptarëve.

Nga ky këndvështrim Avokati i Popullit do të vazhdojë të ndjekë me përparësi këtë çështje, duke e konsideruar atë primare në punën tonë të mëtejshme në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të individit.

ç. Posta

Gjatë vitit 2006 pranë Avokatit të Popullit janë paraqitur 7 ankesa për Sherbimin e Posta sh.a dhe filialet e saj nëpër rrethe, ndërsa dy raste kanë qenë të mbartura nga viti 2005. Nga këto 2 ankesa ka rezultuar të pabazuara dhe 6 ankesa kanë qenë jashtë juridiksioni.

Avokati i Popullit nga studimi i ankesave të ardhura gjatë vitit 2006 për Posta sha ka vënë re se problemi kryesor që ka shqetësuar individët kanë qenë kryesisht zgjidhja e mardhënieve të punës.

Nga ankesat e paraqitura rezulton se Posta sha ka kryer transferime dhe largime nga puna në numër të konsiderueshëm gjatë vitit 2006, duke patur si qëllim kryesor realizimin e një reforme të thellë organike, e cila ka passjellë shkurtime të vendeve të punës për mjaft punonjës apo transferimin e shumë të tjerëve në zona të largëta nga vendbanimi i tyre..

Avokati i Popullit është munduar të nxjerrë nga këto praktika shkelje të mundshme, duke kryer madje hetime mbi procedurat e ndjekura, sidomos në rastet e transferimeve. Por në përgjithsi nga konkluzionet e arritura në përfundim të hetimeve, ka dalë se këto procedura janë kryer të rregullta, duke respektuar dispozitat e Kodit të Punës.

Ndërsa lidhur me trajtimin e disa ankesave të tjera për zgjidhje të mardhënieve të punës, nuk është arritur të provohet parregullsia e veprimeve administrative të drejtuesve të Posta sha, pasi ato kanë qenë njëkohësisht objekt i shqyrtimit gjyqësor, çka e ka bërë të pamundur trajtimin e këtyre çështjeve nga ana jonë.

Ashtu si dhe në disa raste të tjera të konstatuara në ente të tjera publike, edhe në veprimtarinë e Posta sha del në pah se në mjaft lëvizje transferuese nga detyra të punonjësve është shfrytëzuar indirekt qëllimi i vërtetë i punëdhënësve për largimin tyre nga puna.

Sipas motivacionit të urdhrave përkatës, transferimet e punonjësve të Posta sha janë kryer me qëllimin e nevojave të ngutshme që ka patur punëdhënësi në filiale të caktuara. Por urdhërimi i këtyre transferimeve për vetë largësinë e detyrës së re me vendbanimin, apo nisur nga niveli i ulët i pagës dhe njëkohësisht rritjes së shpenzimeve të tjera, ka qenë objektivisht i pazbatueshëm nga ana e punonjësve të kësaj shoqërie.

Nisur nga kjo pamundësi për tëju përgjigjur efektivisht kushteve të reja të punës, shumë nga punëmarresit kanë qenë të detyruar të braktisin detyrën e tyre të re.

Ky veprim llogjikisht i pritshëm, ka rezultuar të marrë kuptimin e gabuar tek drejtuesit e Posta sha, duke bërë që kjo praktikë të identifikohet si mënyrë “sui generis” e largimeve nga puna.

Avokati i Popullit e ka identifikuar këtë praktikë administrative si mjaft të dëmshme për të drejtat dhe interesat e ligjshme të punonjësve në entet publike. Për këtë qëllim do të bëhen edhe në të ardhmen përpjekje të vazhdueshme për eliminimin e kësaj dukurie nga praktikat administrative të organeve shtetërore.

Vetëm në këtë mënyrë do të bëhet e mundur garantimi i të drejtave të punonjësve dhe eliminimi i praktikave të dyshimta që dëmtojnë rëndë interesat e tyre.

Në një këndvështrim të përgjithshëm të shërbimit publik që ofrohet nga Posta sha, Avokati i Popullit kostaton se ai paraqitet pa të meta thelbësore. Gjithsesi nga njoftimet të ndryshme vërejmë se me kalimin në shërbimin postar të një sërë pagesash për llogari të institucioneve të tjera (KESH sha, ISSH etj) numri i rradhëve të qytetarëve është shtuar dhe jo pak herë kjo situatë është përcjellë me pështjellim nga këta të fundit.

Rast për tëu evidentuar ishte së fundi rradhët e gjata të pensionistëve me të ardhura te pakta që kërkuan të tërhiqnin në kohë shpërblimin e akorduar nga Qeveria për vitin e ri. Si pasojë e konfuzionit të krijuar, megjithë përpjekjet e Posta sha për të zgjatur orarin e shërbimeve ndaj klientëve, u vunë re mangësitë logjistike për të ofruar me lehtësi dhe në kohë një performancë të pranueshme të administratës publike. Me këtë rast Avokati i Popullit do të kerkojë nga Posta sha dhe do të bashkëpunoje me të, për gjetjen e rrugëve dhe mënyrave të reja që do të zgjidhin dhe eliminojnë përfundimisht rradhët e gjata të pritjes nga qytetarët.

Në vijim të shërbimeve që ofron Posta sha është vënë re se ka jo vetëm sportele të pamjaftueshëm për numër klientësh, por dhe një numër të ulët punonjësish për të përballuar në terren shërbimet shtesë të shpërndarjes postare.

Konkretisht gjatë vitit 2006 Posta sha dhe Kesh sha kanë rinovuar marrëveshjen midis tyre për kryerjen e pagesave të klientëve të kësaj të fundit, por dhe për shpërndarjen e faturave të energjisë elektrike në zona të caktuara.

Ky aktivitet ka gjetur vështirësitë e tij të shprehura në ankesat e subjekteve private ne zonën industriale të Tiranës (Superstrada Tiranë-Durrës). Njëri prej këtyre subjekteve ka qenë i detyruar të pranojë se për tu njohur me faturën e energjisë elektrike të kompanisë së tij, atij i duhet të paraqitet çdo muaj në zyren postare pranë Komunës Kashar, ku ndërkohë që kryen pagesat njihet edhe me faturën e energjisë elektrike të muajit. Kjo pasi Posta sha nuk ka të punësuar ende një person që të merret me shpërndarjen e faturave prane subjekteve përkatës. Ky pretendim megjithëse ka atakuar në fillim të trajtimit të ankesës Kompaninë KESH sha, ka filluar të ndiqet së fundi si një e metë e punës së zyrave postare.

Avokati i Popullit në këtë rast do të përpiqet që të mos lejojë që kjo mangësi të kthehet në një praktikë pune nga Posta sha, por të gjejë një zgjidhje sa më të shpejtë dhe të pranueshme për klientët e interesuar të këtij shërbimi.

Referuar sa më lart, Avokati i Popullit do të vijojë të ndjekë me përparësi gjatë vitit në vijim shërbimet e Posta sha për të ndikuar në përmirësimin e ndjeshëm të aktivitetit të saj në favor të interesave të ligjshme të individëve. Në këtë iniciativë besojmë se nuk do të udhëhiqemi vetëm nga ankesat e individëve, të cilat në këtë fushë janë të pakta, por do të aplikojmë ashtu si dhe për organe apo shërbime të tjera inspektive si dhe kryerjen e hetimeve me iniciativë.

d. Shërbimi Hekurudhor (HSH sha)

Avokati i Popullit ka ushtruar me iniciativën e tij në muajt Tetor-Nëntor 2006 një inspektim të shërbimit të transportit hekurudhor të udhëtarëve, duke kontrolluar mjediset dhe kushtet e 16 stacioneve kryesore të udhëtarëve në vend, nga 27 stacione që janë gjithsej në funksionim në të gjithë vendin.

Nga ky inspektim rezultoi se megjithëse në hekurudhën shqiptare udhëtojnë çdo vit rreth 1 milion e 700 mijë persona, pjesa më e madhe e lokomotivave dhe vagonave në shërbim të udhëtarëve janë të prodhimit të viteve 1960 dhe tejet të amortizuar. Gjithashtu rezultoi se trenat e udhëtarëve janë vazhdimisht objekt i sulmeve me mjete të forta të banorëve të disa zonave në vend, ku jo pak udhëtarë, madje edhe drejtues të HSH sha-së kanë mbetur të lënduar.

Gjithashtu kushtet e stacioneve të udhëtarëve kishin mjaft karakteristika të përbashkëta, gjë që tregonte për një degradim të përgjithshëm të këtij shërbimi.

Këto stacione në shumicën e tyre i kishin të zënë hapësirat e tyre funksionale me objekte pa leje dhe mbikalime të paligjshme. Mungesa e mjeteve monetare për të investuar kishte detyruar Drejtorinë e Përgjithshme të HSH-sha të urdhëronte uljen e shpejtësisë së udhëtimit në nivele minimale.

Trenat e udhëtarëve janë bërë shpesh herë shkaktarë të aksidenteve hekurudhore me pasojë vdekjen e shtetasve. Në këto raste shkak janë bërë mbikalimet pa leje të improvizuara nga qytetarët, të cilat çdo ditë rrezikojnë jetën e kalimtarëve. Stacionet e udhëtarëve paraqiteshin në shumicën e tyre mjaft të dëmtuar dhe të lënë pas dorë.

Në ambjentet e tyre kishte gjurme të gjalla të një funksionimi të vjetëruar të shërbimeve, ku në shumicën e rasteve udhëtarëve ju duhej të përballëshin me pamje aspak estetike të dyerve me hekura të ndryshkur, mureve me lagështirë, shërbimit higjieno-sanitar të dalë jashtë funksionit, mungesës së stolave, ngrohjes, ndriçimit, ujit, mundësisë së komunikimit telefonik etj.

Stacionet hekurudhore në shumicën e kohës qëndronin të mbyllur dhe nuk ofronin vend pritje për udhëtarët. Ato hapeshin vetëm 30 min para mbërritjes së trenit dhe mbylleshin menjëherë, duke mos lënë mundësinë e udhëtarëve që vinin nga larg për të gjetur strehë për linjën pasardhëse.

Në disa prej stacioneve hekurudhore u konstatuan ambjente mjaft të ndotura higjieno-sanitare, gjendje e cila kishte bërë të pamundur qëndrimin e udhëtarëve. Në ambjentet funksionale dhe veçanërisht në oborret e

stacioneve u vu re mungesa e tabelave dhe njoftimeve të udhëtarëve, grumbullime dherash dhe hedhurinash, territori në shfytëzim përdorëj për kullotje për kafshë, terrene për shërbim autoshkolle, shërbime ofiçine, ndërtime pa leje etj.

Avokati te Popullit në përfundim të këtij inspektimi arriti në konkluzionin se gjendja e stacioneve hekurudhore të udhëtarëve të inspektuara ishte në kushte kritike dhe nuk përmbushte standartet minimale për shërbim të pranueshëm. Duke qenë të vetdijshtëm për faturën financiare që kërkon rinovimi dhe modernizimi i kësaj infrastrukture, nuk mund të tolerohet aspak situata e mjerushme që u konstatua.

Ne këto kushte, me anë të një rekomandimi të paraqitur pranë Kuvendit të Shqipërisë, Kryeministrit, Ministrit të Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacioneve, Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, u kërkua nga ana e tyre marrja e masave të menjëhershme për përmirësimin e kësaj situatë.

Në marrjen e këtyre masave, Avokati i Popullit vuri si kryefjalë garantimin e shërbimeve publike me standarte ligjore, humane dhe duke respektuar mbi të gjitha dinjitetin e udhëtarëve. Ky dinjitet, po t'ë referohesh të dhënave të fiksuara nga inspektimi (ku njerëzit prisnin trenin të ulur në toke apo mbi binare) është mjaft i çënueshëm dhe nuk mund të gjente tolerancë në asnjë shoqëri të civilizuar.

Përveç kësaj Avokati i Popullit i rekomandoi Qeverisë që të merrte në konsideratë si emergjencë civile transportin hekurudhor të udhëtarëve, duke e kthyer atë në kushte optimale dhe njëkohësisht të mundësonte rritjen e buxhetit që i akordohej kësaj fushe.

Avokati i Popullit parashtroi mendimin se disa stacione hekurudhore me probleme serioze duhet të mbylleshin perkohësisht dhe të rehabilitoheshin në mënyrë të shpejtë, duke plotësuar nevojat minimale. Kjo masë u propozua për ato stacione, ku qëndrimi i udhëtarëve në stacion shoqërohet me rrezik të shtuar për shëndetin e tyre.

Ndërkohe që për stacionet e tjera u kërkua konkretisht krijimi i ambjenteve të tualeteve, vendosjes së xhamave, stolave, rrjetit të ndriçimit të brendshëm dhe të jashtëm, furnizimit me energji elektrike, ujit, eliminimit të lagështirës, ofrimin e mundësive për ngrohje në kohe dimri, pastrimit e sistemit të ambjenteve, vendosjen e koshave për hedhurina, vendosjen e tabelave të orareve, njoftimeve dhe rregullave të tjera të udhëtimit, rregullimin e plateve hekurudhore, rivënien në funksionim të qëndrave të zërit etj.

Përveç nevojës së ngutshme në shërbim të qytetarëve, Avokati i Popullit e ngriti shqetësimin e tij edhe në kuadër të konformitetit të këtij shërbimi me shërbimet hekurudhore të huaja, si detyrim që buronte nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në fushën e transportit hekurudhor të udhëtarëve.

Krahas kësaj në rekomandim u prezantuan me hollësi problemet ligjore dhe administrative që kishin lejuar dhe shkaktuar rëndimin e kësaj situatë.

Konkretisht mos zbatimi i drejtë i Ligjit Nr.9317 dt.18.11.2004 "*Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë*", vakumi ligjor për standartet e shërbimit udhëtar, mos bashkëpunimi i Policisë së Shtetit për mbrojtjen e udhëtarëve në trena, mungesa e inspektimeve higjieno-sanitare, te kushteve të punës dhe të mjedisit nga inspektoratet përgjegjës, mos veprimi i strukturave të Policisë Ndërtimore për eliminimin e rugëkalimeve të paligjshme mbi hekurudhë, mos bashkëpunimi me organet vendore etj, ishin disa nga konstatimet e Avokatit të Popullit, të cilat kërkonin zgjidhje.

Si përfundim në rekomandimin e paraqitur, Avokati i Popullit kerkoi nga ana e Qeverisë dhe strukturave të saj në varësi, marrjen e masave për krijimin e kushteve të pranueshme në shërbimin udhëtar të transportit hekurudhor, duke planifikuar akordimin e fondeve shtesë për rehabilitimin e stacioneve të udhëtarëve. Për këtë rekomandim ka patur reagime serioze dhe të shpejta.

Njekohësisht u rekomandua marrja e nismave ligjore për hartimin e një rregulloreje të veçantë për standartet e stacioneve të trenave dhe përmbushja e kompetencave nga të gjitha organet kompetente shtetërore për eliminimin e problematikave të konstatuara.

Nga përgjigjet e paraqitura pranë Avokatit të Popullit është bërë e njohur se Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudha sha kanë marrë të gjitha masat për ndreqjen e atyre mangësive që vihen re në stacionet e trenave, të cilat mund të kryhen brenda buxhetit që i akordohet çdo vit këtij shërbimi.

Gjithashtu nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të HSH sha është njoftuar se po hartohet rregullorja e re teknike, në një pjesë të së cilës do parashikohen rregulla të veçanta për shërbimin udhëtar të stacioneve dhe kushteve përkatse.

Ministria e Brendshme dhe konkretisht Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka bërë të ditur pranë Avokatit të Popullit se është hartuar një plan masash i hollësishëm i ruajtjes dhe sigurisë fizike të udhëtarëve në trena, i cili do të gjejë shumë shpejt zbatim në terren.

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se janë urdhëruar të gjitha Drejtoritë e Shëndetit Publik nëpër rrethe që të ushtrorjnë kontroll në stacionet hekurudhore dhe të marrin masat e duhura administrative në rast se do të konstatojnë shkelje apo mjedise të rrezikshme për shëndetin e qytetarëve.

Nga ana e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave jemi vënë në dijeni se inspektoratet rajonale të mjedisit kanë ushtruar kontrolle në të gjitha stacionet hekurudhore, ku për disa prej tyre kanë njoftuar organet vendore për heqjen e mbetjeve të ngurta të konstatuara.

Krahas kësaj nga ky organ jemi njohur me detyrimet që janë lënë për zbatim drejtorive rajonale hekurudhore për zhvendosjen e materialeve inerte dhe hekurishteve që jo vetëm kanë ndikim në mjedisin hekurudhor, por që zënë dhe hapësira të konsiderueshme të këtyre objekteve.

Nga përgjigjet e mësipërme të ardhura dhe nga veprimet e kryra nga institucionet e mesipërme shtetërore në lidhje me përmirësimin e gjendjes në stacionet hekurudhore, Avokati i Popullit vëren se ka një gadishmëri dhe një vullnet të mirë për të ndryshuar imazhin e këtij shërbimi.

Gjithsesi Avokati i Popullit do të vijojë të tregojë vëmendje të veçantë për kushtet dhe trajtimin e udhetarëve të hekurudhave deri në përmbushjen e plotë të detyrimeve elementare ndaj tyre.

9. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës

Për vitin 2006 janë trajtuar 62 ankesa për vetë Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe organet në vartësi të saj, nga të cilat 5 ankesa kanë qenë të mbartura nga viti 2005. Nga këto, 20 prej tyre pas shqyrtimit kanë rezultuar të pabazuara, 32 jashtë juridiksionit dhe kompetencave, ndërsa 10 çështje janë zgjidhur në mënyrë pozitive.

Në vijim po paraqesim ankesat e zgjidhura pozitivisht, duke nxjerrë edhe problematikat kryesore me të cilat përballet puna e përditshme e Avokatit të Popullit me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe strukturat administrative në varësi të saj.

1. Prane Avokatit të Popullit paraqiti ankesën e tij perfaqesuesi i një grupi të madh sipërmarrësish privat, në përmbajtjen e së cilës ngriheshin një sërë shqetësimesh, në lidhje me veprimet që kryente Policia Elektrike gjatë konstatimit dhe marrjes së masave për kundravajtjet administrative. Sipas ankuesit gjatë një kontrolli ishte konstatuar se faturimi në kontator nuk ishte real. Pas evidentimit të kësaj shkelje nga ana e grupit të kontrollit ishte mbajtur proces-verbal gjobë në ngarkim të shoqërisë së mësipërme. Sipas

pretendimeve të ankuesit, masa administrative e vënë në këtë rast ishte në kundërshtim me një sërë dispozitash të legjislacionit në fuqi dhe duhej të shfuqizohej si e paligjshme.

Avokati i Popullit pasi u njoh me këtë ankese, kreu një hetim te posaçëm për këtë çështje nga i cili rezultuan jo vetëm parregullsi te kryerjes së detyrës nga punonjës të Policisë Elektrike për rastin konkret, por një praktikë e tërë e paligjshme që aplikohet shpesh nga ky organ në dëm të individëve.

Konkretisht Kodi Civil, në nenin 608 të tij, parashikon midis të tjerash se personi që ka shkaktuar dëmin një tjetri apo pasurisë së tij, pergjigjet nëse këtë veprim e ka kryer në kundërshtim me ligjin dhe me faj. Ky person nuk pergjigjet për dëmin në rast se provon se nuk ka faj.

Nga të dhënat e administruara rezultoi në rastin e kontrollit dhe venies se gjobës nga Policia Elektrike, nuk ishte marrë si provë ndonjë veprim i paligjshëm i subjektit dhe nuk ishte vërtetuar fajësia e tij. Madje gjoba ishte vënë në kundërshtim me Ligjin Nr.9072 dt.22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” sepse në asnjë rast në përmbajtjen e tij, nuk detyrohet perdoruesi i energjisë të lexonte, faturonte apo kryente perlllogaritje të energjisë së harxhuar sipas rrymave përkatese.

Përveç kësaj, nga ana e Policisë Elektrike kishte patur një kapërcim të kompetencave që parashikonte Ligji Nr.8637 dt.06.07.2000 “Për Policinë Elektrike” në rastin e vendosjes së gjobave, pasi në Nenin 10 të tij janë përcaktuar katër raste, në të cilat ky organ ka të drejtë të aplikojë gjoba. a).Lidhja pa kontratë b).Cënimi i sistemit matës dhe vulave të tij c).Lidhja abuzive para sistemit matës d).Konstatimi i shtesës mbi fuqinë e instaluar në kontratë.

Në rastin konkret, Policia Elektrike kishte aplikuar një gjobe me një motivacion shkelje të pa parashikuar në objektin e veprimtarisë së saj, duke e vendosur masën e gjobës në mungesë të plotë të respektimit të Tabelës së Penaliteteve të shkeljeve të miratuar nga ERE.

Avokati i Popullit për ta pergjithsuar këtë praktike të konstatuar, i njoftoi Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë Elektrike fillimin e procedurave hetimore për masat administrative që ishin marrë në ngarkim të subjekteve private për vitin 2006. Objekt i hetimit në këtë rast ishte evidentimi i shkeljeve flagrante që mund të kishin cenuar jo vetëm interesat e ligjshme të konsumatoreve, por dhe veprimtarinë e rregullt dhe ligjore të Policisë Elektrike.

Avokati i Popullit nga tërësia e fakteve dhe provave të dokumentacionit shoqërues të paraqitur nga Policia Elektrike konkludoi se procesi verbal i dëmit i mbajtur ndaj subjektit të mësipërm ishte vënë në

mbështetje të një kundravajtje që nuk ishte parashikuar si e tillë në nenin 10 të ligjit të mesiperm. (*Faturim jo real*). Për më tepër që ky mosveprim sipas dispozitave të parashikuara në Ligjin Nr.9072 dt.22.05.2003 “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*” dhe Kontratën e Furnizimit me Energji Elektrike është në ngarkim të entit furnizues KESH sha.

Nga të dhënat statistikore të paraqitura për gjashtë mujorin e parë të vitit 2006, rezultoi se Policia Elektrike kishte hartuar proces verbale demit ndaj individëve të ndryshëm, për kundravajtje administrative që nuk ishin të parashikuara në nenin 10 të ligjit “*Per Policine Elektrike*” dhe që nuk i takonin si detyrim ligjor respektimi kundravajtësit privat. Disa nga keto statistika figuronin si vijon:

a) Mosfaturim në mates–51 proces verbale demit, b) Diferenca në llogaritjen e çmimit të energjisë së faturuar-72 proces verbale demit, c) Faturime të parregullta-81 proces verbale demit, d) Mos përlllogaritje të koeficientit të transformimit në matje-5 proces verbale demit.

Referuar sa më lart Avokati i Popullit konkludoi në gjykimin e tij se hartimi i proces verbaleve të demit nga Policia Elektrike dhe vjelja e shumave të caktuara në zbatim të ketyre akteve ishin shkelje të rënda të ligjit, të cilat jo vetëm cënonin të drejtat dhe interesat ekonomike të subjekteve private, por kishin krijuar prej kohësh një praktike të dëmshme pune të këtij institucioni.

Në këto kushte, Avokati i Popullit me anë të një rekomandimi drejtuar Ministrin të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë Elektrike, kërkoi marrjen e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktikë të paligjshme me qëllimin e rivenies në vend të të drejtave të shkelura në favor të subjekteve private dhe për të evituar abuzimin e mëtejshëm që kryhej nga nëpunësit publik.

Pas një korrespondence të gjatë me këto organe, Ministri i METE-s, Z. Genc Ruli paraqiti pranë Avokatit të Popullit një shkresë, në të cilën urdherohej menjehere Policia Elektrike për të ndaluar aplikimin e mëtejshëm të proces-verbaleve të demit.

Përpos kësaj kjo ministri urdheronte Policinë Elektrike të hartonte një projekt-ligj me amendimet e duhura në Ligjin “*Për Policine Elektrike*” dhe në bashkëpunim me Avokatin e Popullit. Projekti duhet të dergohej sa më shpejt për mendim pranë METE-s dhe ministrive të tjera. Ky projekt ligj duhet të hartohet në zbatim të rekomandimit të Avokatit të Popullit, për të zgjeruar gamën e shkeljeve, për të cilat Policia Elektrike duhet të caktonte gjobe dhe dëmin përkates, si dhe për të krijuar një raport më të drejtë juridik dhe administrativ me entin furnizues KESH sha.

Në këtë kuader, Avokati i Popullit caktoi një grup pune, i cili në bashkëpunim me Policinë Elektrike dha mendimet e tij për projekt-ligjin e ri, duke u mbështetur në argumentat e rekomandimit të mësipërm. Aktualisht ky projekt-ligj pritet të kalojë për shqyrtim në Këshillin e Ministrave për tëju propozuar më tej Kuvendit për miratim.

2. Pranë Avokatit të Popullit, disa investitore vendas të fushës së prodhimit të energjise elektrike, paraqiten një ankese, në të cilën pretendonin se liria e sipërmarrjes private në fushën e prodhimit të energjise elektrike ishte cënuar së tepërmi nga një kontrate konçesioni e lidhur midis Ish Ministrise së Industrisë dhe Energjitikes, Ministrisë së Ekonomise dhe kompanisë Italiane “Essegei s.r.l”. Sipas tyre, detyrimet e kësaj kontrate nuk ishin përmbushur nga shoqëria Italiane, duke lënë në mëshirë të fatit 25 HEC-e vendore prej gati 4 vjetësh. Këto objekte për mendimin e tyre mund të shfytëzoheshin mjaft mirë nga sipërmarrësit vendas, të cilët gëzojnë kapacitetet e nevojshme dhe mjaft efektive financiare apo teknike në fushën menaxhimit të prodhimit të energjise elektrike.

Avokati i Popullit pasi u njoh me pretendimet e ankuesve, mbledhi dhe analizoi në tërësi aktet ligjore për dhënien në konçesion të 25 HEC-eve vendore në favor të shoqërisë italiane, administroi dokumentacionet teknike, financiare dhe tatimore të veprimtarisë së kësaj shoqërie si dhe aktet e kontrollit përkatës të ushtruara gjatë vitit 2005 dhe 2006 nga Ish Ministria e Industrisë dhe Energjitikës, Ish Ministria e Ekonomise dhe nga Ministria aktuale e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikes të përmbledhura në termat e kontratës konçesionale si Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA).

Nga analiza e të dhenave të mbledhura, rezultoi se kontrata e mësipërme e konçesionit ishte miratuar dhe kishte hyre në fuqi me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.467 dt.03.10.2002 “*Për miratimin e kontrates konçesionale të formes “ROT” ndërmjet Ministrisë së Industrise dhe Energjitikës dhe Ministrise se Ekonomisë, nga njera ane, dhe Shoqërisë Italiane “Essegei srl” nga ana tjetër për hidrocentralet vendore*”.

Nga përmbajtja e këtij vendimi, si dhe nga aneksi bashkëlidhur tij, rezultoi se kësaj kompanie i ishin dhënë në konçesion 25 HEC-e vendore të shpërndara në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Nga përmbajtja e kontrates së konçesionit, shoqëria italiane detyrohej të ushtronte veprimtarinë konçesionale të formes “ROT” në 25 HEC-et vendore, me një afat 30 vjeçar. Ajo sipas aneksit bashkëlidhur kontratës ka qënë e detyruar të zhvillonte një plan investimi me afate të përcaktuara për çdo hidrocentral, procedurë e cila parashikonte rehabilitimin e tyre me anë të një investimi nga 8 deri në 10 milion USD, 6 vjet nga marrja në dorezim të HEC-it të pare ose deri në Vitin 2008. Përveç kësaj, shoqëria e

lartpermendur ishte e detyruar të niste zbatimin e kontratës dhe planit të investimeve brenda 60 ditësh nga marrja në dorezim e objekteve, si dhe të shlyente në vijim detyrimet tatimore dhe të siguronte palet e treta, duke derdhur kontributet dhe lidhur kontratat përkatse.

Ne nenin 9 të kontrates së konçesionit ishte parashikuar midis të tjerash se në rast se programi i investimeve i përcaktuar në shumën 8-10 Milion USD nuk kryhet sipas afateve të detajuara për çdo hidrocentral sipas Aneksit 1 të kontrates, atëhere OSHA (Organi Shteteror i Autorizuar) kishte të drejtë të zgjidhte në mënyre të menjehershme dhe të njeanshme këtë kontratë.

Pas një ekspertize të hollësishme që ju bë të dhënave dhe dokumentacionit të administruar nga Institucioni i Avokatit të Popullit për këtë çështje, rezultoi se kjo kompani, pas miratimit të kontratës së mësipërme të konçesionit në Tetor 2002 kishte abuzuar me veprimtarinë investuese konçesionare, duke lënë pas dore dhe jashtë funksionimit një sërë HEC-esh të vogla vendore, madje duke figuruar debitorë në organet tatimore.

Sipas Programit të Kontrollit “*Mbi Zbatimin e Marreveshjeve të Konçesionit për HEC-et Vendore*” miratuar nga ish Ministri i Ekonomisë me Nr.2934 dt.09.05.2005 dhe ish Ministri i Industrisë dhe Energjitikës me Nr.2260 dt.06.05.2005, grupi i përbashkët i ngritur për këtë qëllim kishte konstatuar midis të tjerash se:

“Për të gjithë periudhën e konçesionit deri në Qershor 2005, kjo kompani, kishte investuar vlera të vogla financiare në 105 000 USD ose rreth 3% të investimit të përgjithshëm dhe nuk kishte rehabilituar asnjë hidrocentral të vetëm. Nuk kishte likuiduar vlerën prej 1.154 USD të investuar nga shoqëritë nën-kontraktore vendase për investimet kryesore në 11 hidrocentrale dhe nuk kishte respektuar derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore për një pjesë të madhe të punonjësve të HEC-eve për vitet 2003 dhe 2004”.

Ndërsa sipas Urdherit Nr.105 dt.08.02.2006 të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës Z.Genc Ruli “*Për ngritjen e grupit të punës për kontrollin e zbatimit të marreveshjeve konçesionare për hidrocentralet*” grupi i punës ngritur për këtë qëllim kishte konstatuar sipas Akt Kontrollit të datës.27.02.2006 midis të tjerash se:

“Shoqëria italiane nuk ka realizuar investimet sipas kontrates konçesionare, investime të cilat janë kryer deri në fund të 2005 në masën 14% dhe kanë një diferencë të përcaktuar në shumën prej 3.9 Milion USD, gjë që bie ndesh me kontratën e konçesionit. HEC-et administrohen tërësisht nga disa shoqëri shqiptare që kanë lidhur kontrata të diskutueshme nën

konçesionare me shoqerinë Italiane, duke kryer dhe investime në objekte në shumën 1.5 Milion USD. Aktualisht janë jashtë gjendjes së punës 16 hidrocentrale, (përfshirë dhe atë të Lurës)”.

Avokati i Popullit në vijim të këtij hetimi kërkoi pasqyrën zyrtare të prodhimit vjetor të enegjisë elektrike për 25 HEC-et e vogla të marra në konçesion nga kompania e mësipërme për vitin 2005, nga ku konstatoi se 11 prej tyre rezultojnë me prodhim vjetor zero, ndërsa pjesa tjetër kishte prodhim brenda kapaciteteve tradicionale (*me pajisjet e vjetra*) dhe me ndikim minimal nga investimet e pakta të kryera nga nën-konçesionarët.

Gjithsesi Avokati i Popullit pa ju referuar më tej situatës së krijuar nga ky subjekt privat, denoncoi fuqishëm me anë të një rekomandimi drejtuar Kryeministrit Z.Sali Berisha dhe Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës Z.Genc Ruli, mosveprimin e organeve në varesi të tyre në marrjen e masave ndëshkuese, mosveprimi i cili kishte shkaktuar bllokimin e prodhimit të enegjisë me neglizhencë të plotë për një kohë të gjatë.

Ky qëndrim në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe të kontratës së konçesionit, kishte dëmtuar sipas Avokatit të Popullit autoritetin e vërtetë të OSH-se në mbrojtje të interesave të ligjshme të individëve dhe aseteve shtetërore, duke privilegjuar në mënyrë të dyshimte subjektin e mesipërm konçesionar, fenomen i cili të bënte të mendoje ndoshta edhe për korrupsion. Në këtë rekomandim ju kërkua gjithashtu METE-s që të merreshin të gjitha masat për evidentimin sa më të shpejtë të të gjitha rasteve të këtij lloji dhe të nxirreshin përgjegjësitë konkrete për neglizhencat dhe mosveprimet e deritatëhershme të asaj gjendje. Gjithashtu Avokati i Popullit në përmbajtjen e rekomandimit nënvizoi mungesën e veprimeve konkrete të OSHA dhe METE-s për të përmirësuar sa më shpejt rregjimet juridike konçesionare në përmirësim të HEC-eve vendore. Ky mosveprim sipas tij po shkaktonte një amortizim të mëtejshëm të burimeve hidrike në vend dhe për pasojë një dëm të konsiderueshëm financiar në kushtet e një krize energjitike në Shqipëri, që është thëlluar shumë në fillim të vitit 2007.

Në përgjigjen e paraqitur pas një korrespondence të gjatë për këtë çështje nga ana e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës u bë e ditur se ky organ kishte ushtruar sërish kontroll mbi shoqëritë konçesionare të HEC-eve të vegjël vendore.

Nga kontrolli i ushtruar në mbi 33 HEC-e të vegjël të shpërndarë në të gjithë vendin, u konstatua midis të tjerash se kompania italiane e mesipërme, nëpërmjet kontratave nënkonçesionare të lidhura me mbi 11 subjekte shqiptare, kishte krijuar marrëdhënie të ndërlikuara juridike, duke shkëlur mareveshjen konçesionare. Pas kryerjes së kontrollit në terren dhe përpunimit të të dhënave, në muajin Maj 2006 konkluzionet e kontrollit iu

dërguan të gjitha shoqërive konçesionare. Njëkohësisht OSHA krijoi grupin e punës të drejtuar nga zëvendesministri i METE-s Z. Gjergj Bojaxhi. Sidoqoftë, nga ana e Ministrisë të METE-s Z. Genc Ruli, u deklarua se në përfundim të kësaj procedure, OSHA kishte arritur në përfundimet e duhura dhe është duke përgatitur projekt-vendimin përkatës me kërkesën për prishjen e kontratës konçesionare me shoqërinë italiane, i cili do të kalojë për miratim brenda Muajit shkurt 2007 pranë Këshillit të Ministrave.

3. Avokati i Popullit nga studimi i Ligjit Nr.9072 dt.22.05.2003 “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*” evidentoi faktin se në bazë e për zbatim të këtij akti nuk kishin dale akte të tjera nënligjore që të rregullonin një sërë mardheniesh dhe të viheshin në zbatim një sërë masash administrative për mbrojtjen e sigurisë publike, jetës, shëndetit dhe pronës.

Konkretisht Neni 62 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr.9072 dt.22.05.2003 “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*” parashikonte se:

Zonat e sigurisë

2.*Këshilli i Ministrave miraton me vendim shtrirjen e zonës së sigurisë dhe ndalimet e kufizimet që vendosen në këtë zonë.*

3.*Brenda zonës së sigurisë ndalohet ngritja e ndërtesave ose objekteve të tjera, mbjellja e bimëve, pemëve, si dhe kufizohet, në përputhje me rregullat e përcaktuara, kryerja e veprimtarive që mund të rrezikojnë sigurinë dhe funksionimin e centralit elektrik, nënstacioneve, linjave ajrore ose kabllore, jetën, shëndetin ose mbrojtjen e pronësisë.*

Avokati i Popullit, nisur nga situata e rënduar, në të cilën konstatohej lehtësisht kalimi i linjave të tensionit të lartë shumë pranë qendrave të banuara apo ndërtimeve të banimit të kryera në afërsi të nënstacioneve elektrike, paraqiti një rekomandim pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe për dijeni Kryetarit të Këshillit të Ministrave, ku kërkohej hartimi dhe miratimi i një akti nënligjor për caktimin e zonave të sigurisë në objektet elektrike. Të gjithë kemi parasysh linjën e tensionit të lartë që u ndërtua para rreth 10 vitesh, që fillon nga Hotel “Tirana” në qendër dhe vazhdon përmes Bulevardit “Zogu I”. Kur u ndërtua u tha se do të ishte e përkohshme. Por kjo përkohshmëri deri tani është rreth 10 vjeçare dhe nuk kemi dëgjuar për ndonjë projekt të afërt për heqjen e saj, sepse është një rrezik eminent i përditshëm për çdo qytetar që kalon në këtë bulevard në mes të Tiranës.

Ky rekomandim veç të tjerash përcillte shqetësimin e Avokatit të Popullit për rrezikun që ju kanosej shtetasve nga linjat elektrike dhe synonte të nxiste organet kompetente për të parandaluar në kohë shkaktimin e kërcënimeve serioze për jetën dhe shëndetin e popullatës, duke miratuar aktet përkatëse.

Kjo iniciativë duhet të përmbushej krahas të tjerash edhe për të definuar përfundimisht distancat e nevojshme që duhet të respektohen nga subjektet shtetërore dhe private gjatë ndërtimeve, zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme me qëllim tregtar, bujqësor etj, si detyrë parësore për të garantuar në mënyre reciproke të drejtat dhe interesat e ligjshme publike ose private.

Nga përgjigja e paraqitur nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës jemi njohur se ky organ në zbatim të nenit 62 të ligjit nr. 9072, date 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", urdhëroi përgatitjen e projekt vendimit "Për zonat e mbrojtura". Por ndaj këtij projekti, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, informoi se normat e projektimit të rrjeteve elektrike, ku përfshiheshin edhe zonat e mbrojtura, ishin miratuar në parametra të ngjashëm me VKM nr. 68, date 15.2.2001 "Për miratimin e standarteve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit të punimeve të ndërtimit".

Pas ballafaqimit të këtyre normave me ato të formuluar nga ana e METE në projekt-vendimin e përgatitur për këtë qëllim, u konkludua se vendimi i mësipërm e plotësonte qëllimin për të cilin do të kërkohej një vendim tjetër konform ligjit të ri "Për sektorin e energjisë elektrike".

Për pasojë nga ana e METE u njoftua se meqenëse ishte konfirmuar vlefshmeria e parametrave të parashikuar në VKM e mësipërme, nuk ishte nevoja për miratimin e një VKM te re, por do të kryheshin referencat përkatese për ta zbatuar më qarte detyrimin e nenit 62 të ligjit të mësipërm. Me anë të këtij veprimi METE i dha zgjidhje detyrimit ligjor, duke e konsideruar të përfunduar këtë praktikë.

4. Avokati i Popullit në vijim të ndjekjes së plotësimit me akte nënligjore të legjislacionit në fuqi në fushën e mbrojtjes së të drejtave të konsumatorit, konstatoi se Ligji Nr.9135 dt.11.09.2003 "Për Mbrojtjen e Konsumatoreve" kishte mangësi të dukshme në rregullimin e një sërë mardheniesh dhe në vënien në zbatim të një sërë masash administrative bashkerenduese. Konkretisht Neni 51 i Ligjit Nr. 9135 dt.11.09.2003 "Per Mbrojtjen e Konsumatoreve" parashikon se:

"Mbikqyrja e tregut

1. *Strukturat publike të kontrollit të tregut kanë të drejtë që për sigurinë e mallrave dhe të shërbimeve:*

- a) *të kërkojnë të dhënat e nevojshme nga shitësi, prodhuesi dhe furnizuesi;*
- b) *të organizojnë kontrolle për mallrat dhe shërbimet edhe pas hedhjes në treg të tyre;*
- c) *të marrin mostra të mallrave për të verifikuar të dhënat e etiketës;*
- ç) *të kontrollojnë kushtet e tregtimit të mallrave dhe të shërbimeve;*

d) të ndalojnë hedhjen në treg të mallrave ose shërbimeve kur, gjatë periudhës së kontrollit, dyshohet për sigurinë e tyre;

dh) të heqin mallrat dhe të ndalojnë shërbimet e rrezikshme në treg, si dhe t'i asgjësojnë ato nëse është e nevojshme;

e) të njoftojnë konsumatorët për mallrat e rrezikshme dhe të mundësojnë kthimin e tyre te shitësit ose ofruesit e shërbimit;

ë) të ndalojnë importimin dhe eksportimin e mallrave të rrezikshme.

2. Mënyra e bashkërendimit të veprimtarive të strukturave publike të kontrollit të tregut përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

Nga sa më lart, dispozita e sipërcituar kishte ngarkuar në mënyre specifike detyrat që duhet të përmbusheshin nga ana e Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikes për hartimin dhe mandej miratimin e aktit nënligjor për bashkërendimin dhe mënyrën e koordinimit të veprimeve nga organet e autorizuar shtetërore për mbikqyrjen e tregut.

Avokati i Popullit, nisur nga situata e rënduar, në të cilën mungesa e një kontrolli efikas dhe të organizuar të organeve shtetërore, mund të shkaktonte kërcënime serioze për jetën dhe shëndetin e popullatës (rasti i gripit të pulave) mendoi se hartimi dhe miratimi i këtij akti ishte një detyrë imediate që duhet të realizohej sa më shpejt. Krahas kësaj ky veprim do të rriste edhe më shumë garantimin nga strukturat shtetërore të standarteve të shërbimit dhe produkteve ndaj konsumatoreve në treg, si dhe mbrojtjen nga mallra të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e tyre.

Në këto kushte, Avokati i Popullit i paraqiti një rekomandim Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe për dijeni Kryetarit të Këshillit e Ministrave ku kërkohet hartimi dhe miratimi sa më i shpejtë i aktit të mësipërm.

Në përgjigjen e parë të paraqitur nga ana e Ministrit të Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikes Z.Genc Ruli, jemi informuar se ky detyrim dhe modalitetet që parashikon bashkërendimi i tregut do të implementoheshin në kuadër të një projekti serioz me Programin CARDS 2003, "Mbikqyrja e Tregut në Shqipëri", i cili ishte në fazën e diskutimeve me palet e interesuara për modelin e mbikqyrjes së tregut që duhej të zbatohet.

Në përgjigjen e dytë, pas interesimit tonë të vazhdueshëm, Z. Ruli sqaroi se METE me mbështetjen e projektit CARDS "Mbikqyrja e Tregut në Shqipëri" kishte përgatitur një projekt-ligj horizontal "Siguria e pergjithshme e produkteve, kerkesat themelore dhe vleresimi i konformitetit të produkteve", ku një kapitull të veçantë zinte mbikqyrja e tregut. Në këtë kapitull ishte përcaktuar në mënyrë të detajuar dhe mënyra e kordinimit, bashkëpunimit dhe këmbimit të informacionit ndërmjet METE dhe ministrive të linjes, në funksion të garantimit të një niveli të lartë të

mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë së konsumatorëve. Ky projekt-ligj, më tej i është dërguar për komente Sekretariatit të OBT dhe pas kësaj do të dërgohej për miratim në Kuvendin e Shqipërisë.

Nga ana tjetër, METE kishte ngritur grupe të përbashkëta pune me përfaqesues nga Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për bashkërendimin e veprimtarive të mbikqyrjes së tregut. Në funksion të këtij qëllimi, me Urdhër të Kryeministrit nr.236, datë 2.10.2006, ishte ngritur grupi ndërministror i drejtuar nga Zevendes Kryeministri, ku ngarkohej METE dhe MBUMK për drejtimin e procesit të përgatitjes së një strategjie ndersektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikqyrjes së Tregut.

5. Prane Avokatit të Popullit një individ paraqiti ankesën e tij sipas të cilës Policia Elektrike Tiranë kishte ndërprerë furnizimin me energji të banesës së tij pa shkaqe të arsyeshme dhe të pa bazuara në shkelje individuale në rrjetin elektrik. Pas kësaj, megjithëse ai ishte drejtuar disa herë në Policinë Elektrike, nga ana e tyre nuk ishte marrë asnjë masë për verifikimin dhe zgjidhjen e kësaj ankese. Por sipas nëpunësve të këtij organi ky veprim ishte justifikuar për shkak të arketimeve të ulta dhe lidhjeve të paligjshme që ishin njoftuar nga KESH sha në zonën ku banonte ankuesi.

Avokatit të Popullit, pasi u njoh me këtë ankese, si dhe duke dënuar hapur ndëshkimet kolektive që kryhen nga këto organe, kërkoi nga ana e Policisë Elektrike një informacion të hollësishëm për këtë çështje, duke ju paraqitur kopje të librezes së energjisë të ankuesit të lidhur me KESH sha, në të cilën ai figuronte mjaft i rregullt në pagesat e energjisë.

Me anë të përgjigjes së paraqitur nga Drejtori i Policisë Elektrike jemi njohur se ky organ kishte zhvilluar një verifikim të plotë të kësaj ankese pranë banesës së ankuesit, ku përveçse nuk ishin konstatuar shkelje ishte sqaruar se ndërprerja e energjisë kishte ardhur si pasojë e informacionit të gabuar të KESH sha Tirane për disa kliente të saj në atë zonë. Pas kësaj kësaj punonjes të kësaj drejtorie kishin rilidhur energjine për disa banesa të kësaj zone, të cilat kishin rezultuar të rregullt me pagesat e energjisë.

6. Pranë Avokatit të Popullit u paraqit ankesa e një shtetaseje, e cila ngriti shqetësimin për faturime të mëdha që vinin në adrese të saj nga KESH sha, si pasojë e një vjedhje që kryhej vazhdimisht nga banore të tjerë në rrjetin elektrik të furnizimit të banesës së saj dhe shkallëve të pallatit. Shtetasja në fjalë kishte paraqitur ankesën e saj edhe më parë në Policinë Elektrike dhe pranë KESH sha, por ajo pretendoi se nga ana e tyre nuk ishte marrë asnjë masë për verifikimin dhe zgjidhjen e problemit të denoncuar.

Avokati i Popullit pasi u njoh me këtë ankese, kreu menjëhere verifikimet dhe ndërhyrjet e tij për këtë çështje pranë KESH sha Zona e Shperndarjes Tirane dhe Drejtorisë së Policise Elektrike Tiranë.

Nga pergjigja e paraqitur nga Drejtori i Policise Elektrike është bërë e ditur se në bazë të interesimit të institucionit tonë, nga ana e tyre ishte ushtruar kontroll në pallatin përkatës, lidhur me dyshimet që ekzistonin nga banoret e pallatit për vjedhje dhe abuzime të ndryshme me rrjetin elektrik. Në përfundim të këtij kontrolli rezultoi se ndaj dy banorëve të këtij pallati, Zona Elektrike me anë të faturuesve të saj kishte kryer faturim afrofe në mënyre të padrejte, duke përfshire këtu edhe llogaritjen e ndriçimit të ambjenteve të përbashketa. Gjithashtu gjatë këtij kontrolli u konstatua se njëri prej banoreve furnizohej me energji nga mjediset e shkallëve në mënyre të kundraligjshme. Në këto kushte nga ana e Policise Elektrike ishte njoftuar Drejtori i KESH sha Tiranë dhe ishin propozuar masa konkrete disiplinore ndaj faturistes. Krahas kësaj për kundravajtesin ishte marrë masa e ndërprerjes së energjisë elektrike.

7. Pranë Avokatit të Popullit paraqiti një ankese një shtetas me detyrën e inxhinierit në Shoqerine Albpetrol sha Patos, në të cilën bëri prezent shqetësimin e tij, lidhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe mos përfitimin e kundravleftës për pushimet vjetore të pa shfrytëzuara për vitin 2005, gjate të cilës ankuesi ka qenë në marredhënie pune.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, rezultoi se ankuesi kishte punuar prej 44 vitesh në naftë në detyra të ndryshme. Në vitin 2005 ai nuk kishte shfrytëzuar lejen e zakonshme vjetore, sepse kishte qënë e nevojshme vazhdimësia e punës. Në Janar 2006 i ishte dhënë leja e zakonshme. Me pas, Drejtori i Qendrës së Naftës dhe Gazit (QNG), i ka ndërprere lejen e zakonshme dhe i jep shkëputjen nga puna pasi mbushi moshën për pension, duke i paguar vetem disa ditë nga leja e pa përfituar e vitit 2005, megjithëse gjatë kësaj periudhe ankuesi kishte qenë në punë rregullisht dhe pa ndërprerje.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese, si dhe pasi nuk u ra dakort parimisht me Dejtoringun e Pergjithshme të Albpetrol sha për trajtimin e plotë financiar të këtij punonjesi, Avokati i Popullit, me qëllim rivendosjen në vend të të drejtave të tij, paraqiti një rekomandim, ku parashtroi shkaqet ligjore që duhet të udhëhiqnin veprimet e kësaj shoqërie në favor të interesave të ankuesit.

Konkretisht ankuesi kishte përfituar një shpërblim të barabarte me 2 paga mujore në kohën e daljes në pension sipas Albpetrol sha dhe ky ishte një kompesim i plotë. Por ky përfitim dhe kjo e drejtë, sipas nesh buronte nga kontrata kolektive e punës, sipas të cilës :”*Punëdhënesi detyrohet të*

shpërbleje me dy paga mujore punonjesin që del në pension nga marrëdhëniet e punës ose gjate periudhës së asistences për shkak të reformes,(nje vjecare ose te thjeshte), në momentin e shkeputjes se marrëdhënies së punës me Albpetrol SHA”. Pra në këtë rast ishte respektuar vetëm detyrimi i mësipërm, i cili nuk kishte lidhje me përfitimin tjetër që pretendonte ankuesi për shpërblimin në vlerë të lejes vjetore.

Gjithashtu lidhur me pretendimin se trajtimi financiar ishte kryer i plotë nga Albpetrol sha referuar kontratës kolektive të punës, sqaruar se Kodi i Punes kishte përparësi në zbatimin e detyrimeve ligjore, ku në nenin 94 të të cilit parashikohet se *“Kur marrëdhënia e punës ka përfunduar dhe punemarrësit nuk i janë dhënë pushimet vjetore që i takojne, ai ka te drejtë për një shpërblim të barabartë me pagën e këtyre pushimeve”*.

Në përfundim të parashtrimit të këtyre argumentave u konkludua se ankuesi duhet të trajtohej tërësisht në kushtet e nenit të mësipërm dhe për këtë arsye i takonte të përfitonte atë të drejtë, që padrejtesisht dhe pa asnjë baze ligjore i ishte mohuar.

Në përgjigje të këtij rekomandimi, Drejtori i Përgjithshëm i Albpetrol sha bëri të ditur se në favor të ankuesit ishte lëvruar një fond i veçantë financiar, i cili përmbushte përfundimisht pagesën për lejen vjetore të pa kryer nga ana e tij.

8. Pranë Avokatit të Popullit, u paraqit ankesa e një grupi punonjësish të Shoqërisë Alb-Krom sha, për moslikujdimin e punës së kryer nga muaji Janar deri në Gusht të vitit 2000 nga ana e drejtuesve kësaj kompanie. Konkretisht ata sqaronin se kishin punuar si shofera transporti për llogari të Uzinës së Ferokromit Burrel dhe Shoqërisë Alb-krom. Që kur kjo shoqëri kishte ndërprerë marrëdhëniet e punës, ajo detyrohej të levronte pagat në favor të tyre për kohën e mëparshme, gjë e cila megjithë interesimin e tyre ndër vite nuk ishte realizuar akoma.

Avokati i Popullit pasi u njoh me këtë ankese, kreu menjëherë verifikimet e nevojshme pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Energjitikës dhe vijoi të ndërmjetesonte me qëllim zgjidhjen e kësaj çështje brenda një kohe sa më të shkurtër.

Për këtë qëllim, Avokati i Popullit, në vijim të përpjekjeve të tij, paraqiti edhe një rekomandim pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, duke kërkuar rivenien në vend të të drejtave të shkelura ndaj punonjesve të ALB-Krom sha.

Nga përgjigja e paraqitur nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës është bërë e njohur se Shoqëria Alb-krom sh.a. kishte kaluar në likuidim në rrugë gjyqësore, gjë e cila kishte vonuar në kohë shlyerjen e detyrimeve ndaj personave të interesuar. Nderkohë në këtë përgjigje

shprehej angazhimi se fondet që do të siguroheshin së shpejti nga shitja e asetëve të shoqërisë, do të përdoreshin për likuidimin e detyrimeve, duke përfshirë me prioritet edhe pagesat e prapambetura për rrogat e punonjësve të saj.

9. Pranë Avokatit të Popullit u paraqit një ankesë në të cilën një individ shprehu shqetesimin, lidhur me mohimin e të drejtës së informimit nga ana e Drejtorit të Qytetit Studenti, lidhur me praktikën e ndjekur nga ana e kësaj ndërmarrje për dhënien me qera të bodrumeve të mencës së vjetër.

Avokati i Popullit pasi u njoh me këtë ankese, kreu menjëherë nderhyrjet e tij përkatse pranë kësaj ndërmarrje, duke bërë të mundur që në përfundim të kësaj procedure, Drejtori i Qytetit Studenti të bindej për detyrimet e tij ligjore për të informuar qytetarin për veprimtarinë e strukturave administrative në varësi të tij.

Për këtë qëllim u organizua një takim në mjediset e kësaj drejtorie, ku ankuesi u njoh më të dhëna shkresore dhe verbale mbi procedurat administrative të ndjekura nga ky organ për çështjen që i interesonte, duke marrë konform rregullave edhe kopje të caktuara të kësaj praktike.

Në këtë rast, Avokati i Popullit pati rastin të luajë rolin që i ka autorizuar edhe Ligji “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentat Zyrtare”, duke promovuar dhe detyruar organet të vënë në zbatim dispozitat e tij në favor të të drejtave të individëve.

10. Pranë Avokatit të Popullit u paraqit ankesa e një individi, lidhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës nga Ndermarrja e Trajtimit të Studenteve Nr.1 Tirane, pa asnjë bazë ligjore apo motivacion.

Në objektin e kësaj ankese, sqarohej se ai kishte qenë i punësuar në këtë Ndërmarrje që prej vitit 1993. Gjate vitit 2006 ai kishte marrë raport mjekesor, fakt për të cilin kishte njoftuar paraprakisht edhe punedhënsin e tij. Kur ankuesi është paraqitur pas raportit në detyrë ai është njoftuar se duhet të largohet nga puna, dhe nuk ka marrë sqarime të mëtjshme për motivin e këtij largimi. Ndërkohë që edhe urdhëri i largimit të tij nuk kishte në përbërje motivacionin apo referimin e shkeljes konkrete.

Avokati i Popullit pasi u njoh me këtë pretendim, duke gjykuar se urdhëri për largimin nga puna nuk përmbante elementet e duhur sipas ligjit, kërkoi me nderhyrjen e tij institucionale pranë Drejtorisë Trajtimit të Studenteve që ndaj ankuesit të rivendoseshin të drejtat e shkelura.

Pas disa kontakteve të mëtjshme të zhvilluara me drejtuesit e kësaj ndërmarrje është bërë e mundur që ankuesi pas sqarimit të plotë të disa rrethanave që kishin të bënin me shkeljet e dyshuara në adrese të tij nga ndërmarrja, të fillonte sërish punë.

11. Krahas çeshtjeve të zgjidhura pozitivisht, Avokati i Popullit është përballur gjatë vitit 2006 me një fluks të madh ankesash për largimet nga puna që janë kryer nga strukturat në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, sidomos nga Shoqëritë Anonime me kapital tërësisht shtetëror.

Më së shumti këto ankesa janë drejtuar për Albpetrol sha, Uzinën e Përpunimit të Thellë të Naftës në Ballsh, Armo sha etj.

Përgjithësisht referuar Kodit të Punes, por dhe faktit se shumë prej këtyre ankesave janë paraqitur paralelisht edhe në rrugë gjyqësore, verifikimi që ka kryer Avokati i Popullit për shkaqet e këtyre largimeve nga puna ka qene i kufizuar. Ashtu si dhe ne raste të tjera, detyra jone ka qene e fokusuar në nxjerrjen në pah të parregullsive proceduriale gjatë kryerjes së kësaj procedure dhe bërjen prezent të tyre në organin përkates, duke kërkuar rivenien në vend të të drejtave të shkelura.

Në disa raste jemi munduar që të luajmë rolin e ndërmjetesuesit midis punëdhënësve dhe punëmarresve për të arritur në një komunikim dhe zgjidhje të mundshme për ankesat që janë parashtruar.

Konkretisht një rast për tu përmendur ka qenë ballafaqimi që Avokati i Popullit zhvilloi midis drejtuesve të Albpetrol sha dhe Konfederatës së Sindikatave të Naftës. Nga të dhënat dhe transparenca e treguar u arrit që këta të fundit të merrnin përgjigje të drejtperdrejta për trajtimin e tyre financiar pas largimit nga puna.

Gjithsesi duhet nënvizuar fakti se për vetë fluksin e madh të largimeve nga puna dhe abuzivizmit që mund të shoqëroje këto procedura nisur nga motive të brendshme aspak ligjore të punëdhënësve, nga ana e Avokatit të Popullit, ashtu si dhe për rastet e tjera do të shikohet mundësite për të propozuar ndryshime të mundshme në Kodin e Punes. Kjo me qëllim rritjen dhe garantimin në një shkallë më të lartë të të drejtave të punëmarrsve dhe mbrojtjes së tyre juridike ndaj shkeljeve të caktuara në mardhëniet e punës.

Si konkluzion mund të themi se problematika me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës zë një vend të konsiderueshëm në veprimtarinë e Avokatit të Popullit. Në një vështrim të përgjithshëm konstatojme se roli i METE-s në raport me shoqëritë anonime me kapital tërësisht shtetëror nuk është në nivelet që pritet. Në shumë raste është vënë re se METE është përpjekur të mbulojë të metat dhe mangësitë e këtyre shoqërive, duke marrë mbi vete përgjegjësi. Por kjo ka rënduar tej përgjegjësisë reale këtë dikaster, duke vënë në pozitë të vështire jo pak herë dhe përfituesit e shërbimeve të tyre. Rast që ilustron këtë konstatim është problematika me KESH sha, e cila do të gjejë një shtjellim më të gjërë në rubrikat në vijim.

Përveç kësaj METE gjatë vitit 2006 nuk ka qënë në gadishërine e duhur për të përcjelle me korrektësi dhe brenda afateve të arsyeshme projekt-aktet nënligjore pranë Këshillit të Ministrave për miratim. Kjo veprimtari funksionale është dashur të nxitet edhe nga Institucioni i Avokatit të Popullit për rastet kur mungesa e këtyre akteve shkakton një vakum në dëm të të drejtave, shëndetit dhe jetës së qytetarëve. Gjithsesi kjo ndërhyrje nga ana jonë, e cila ka përfshirë dhe është fokusuar në të gjithë administratën e lartë shtetërore do të vijojë edhe në të ardhmen për të mundësuar një përgjigje më të mirë ndaj kërkesave të ligjshme të individëve.

Ne pajtohemi me kritikën publike se METE vazhdon të luajë një rol jo shumë aktiv dhe aspak transparent në punën për krijimin e burimeve shtesë hidroenergjitike në vend. Megjithatë gjatë vitit 2006, Avokati i Popullit vuri në vëmendje të saj problemet dhe abuzimet që ishin bërë në këtë sektor, përsëri ato janë mjaft evidente dhe nuk janë eliminuar ende. Duhet thënë se në kushtet e krizës energjitike, nevoja për të vënë në punë një numër të madh HEC-esh të vogla, duhet të ishte kryefjalë e politikave dhe strategjive afatshkurtra të kësaj ministrie, por në realitet, kjo procedurë nuk është vënë në lëvizje për shkaqe që nuk përlligjin mosveprimet e konstatuara. Me këtë rast rezulton se edhe përpjekja për të hartuar dhe miratuar një ligj të ri për miratimin e veprimtarisë konçensionare të HEC-eve të vogla ka mbetur deri tani si projekt në letër dhe është bërë shpesh herë shkak për ngrirjen e sipërmarrjes private në shfrytëzimin e objekteve ekzistuese hidroenergjitike. Kjo burokraci dhe “statu-quo” është e pafalshme dhe duhet të korrigjohet sa më shpejt, duke hapur rrugë liberalizimit të një tregu të qëndrueshëm vendas në fushën e prodhimit të energjisë elektrike, në të mirë të interesave publike dhe rritjes cilësore të jetesës së individëve.

Për të gjitha çështjet dhe problematikat e parashtruara më lart, Avokati i Popullit do të vijojë të mbajë në vëmendje veprimtarinë e kësaj ministrie dhe strukturave në varësi të saj me qëllim përmirësimin e punës së saj konform standardeve të pranueshme të mirëqeverisjes.

a. Ankesat për Korporatën Elektroenergjitike (KESH) Sh.A.

Gjatë vitit 2006 Avokati i Popullit ka trajtuar 57 ankesa kundër KESH-it, nga të cilat 3 kanë qënë të mbartura nga viti 2005 dhe 54 kanë ardhur gjatë vitit 2006. Nga këto, 17 ankesa janë zgjidhur pozitivisht, 17 prej tyre mbas verifikimit kanë rezultuar të pabazuara dhe 23 kanë qënë jashtë juridiksionit dhe kompetencave. Në vijim do të prezantojmë çështjet të cilat kanë rezultuar pozitive dhe problematikën që ka hasur Avokati i Popullit

gjatë shqyrtimit të ankesave për cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike nga KESH sha:

1. Avokati i Popullit në fillim të vitit 2006 filloi me iniciativën e tij hetimin e veprimtarisë së KESH sha në kuadër të lidhjeve të kontratave të reja me konsumatorët familjare dhe jo familjare. Nga të dhënat që u mblodhen nga ky hetim rezultoi se kontratat e reja për furnizimin me energji elektrike të konsumatoreve familjare dhe jo-familjare ishin miratuar me ane të Vendimeve të ERE-s Nr.40 dhe 41 date.31.08.2005. Këto dokumente të miratuara dhe të botuara në Fletore Zyrtare ishin parashikuar të hynin në fuqi me 1 Janar 2006.

Kësisoj rrjedhimisht kuptohet se periudha Shtator-Dhjetor 2005 përveç të tjerash ishte planifikuar për tëi lënë kohë KESH sha të kryente të gjitha procedurat paraprake për modelimin, botimin dhe shumefishimin e kopjeve të kontratave të reja në funksion të shpërndarjes dhe nënshkrimit të tyre nga të gjithë konsumatorët familjarë dhe jo-familjarë.

Nga hetimi i kryer, Avokati i Popullit konstatoi se në asnjë rast konsumatorët familjar dhe jo-familjar nuk ishin pajisur me kontratën e re të furnizimit me energji elektrike, përveç atyre që paraqiteshin për lidhje fillestare. Krahas kësaj ishte mëse e llogjikshme se nënshkrimi i kontratës së furnizimit me energji elektrike midis palëve, përveçse ishte një obligim që buronte nga legjislacioni në fuqi, përbente gjithashtu një kusht të domosdoshëm për të implementuar mardheniet e reja kontraktore që kishin hyrë në fuqi që nga 1 Janari 2006.

Për këtë qëllim nevojitej që veprimtaria e KESH sha për të përmbushur këtë kërkesë në kohë reale, duhej të percillej me anë të një plani masash afatshkurter, i cili do të iniciante procedurat e nënshkrimit të kontratës së re nga të gjithë konsumatorët brenda afateve që koençidonin me hyrjen në fuqi të këtij dokumenti.

Avokati i Popullit gjykoi se ky proces tërësisht formalo-juridik mund të kryhej si gjatë momentit të pagesës së faturave, ashtu dhe me initiative të vetë struktuarve të KESH sha në terren. Përveç kësaj ishte e llogjikshme se nënshkrimi i kontratave të reja përbente një avantazh të madh për vetë kompaninë KESH sha, në kuadër të vleresimit dhe evidentimit të numrit të sakte të konsumatoreve dhe minimizimit të tendencës së disa prej tyre për të shpëtuar legalizimit të mardhenieve të furnizimit me energji.

Gjithashtu po të analizoje situatën e këtij vakumi në kontekstin juridiko-civil, detyrimisht formoje bindjen se konsumatori i pa pajisur me kontratën e re, kishte të drejtë të kundërshtonte çdo detyrim të ri kontraktual. Për më tepër, këto kundërshtime midis palëve nuk mund përbenin objekt të shqyrtimit gjyqësor, për aq kohë sa palët nuk figuronin në lidhjen e një

mardhënie kontraktore. Kjo për arsye se kontrata është një veprim juridik i dyanshëm midis palëve që sjell pasoja juridike dhe krijon të drejta dhe detyrime reciproke vetëm pas lidhjes së saj. Ndaj dhe kjo gjëndje vakumi dhe kaosi duhet të gjente rrugën e shpejte të zgjidhjes, për të mos u rreshtuar më pas në vargun e parregullsisve të tjera esenciale që vihen re në shërbimet e shpërndarjes së KESH sha.

Për këtë qëllim, Avokati i Popullit paraqiti një rekomandim pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Kesh sha, duke kërkuar fillimin sa më shpejtë të procedurave për shtypjen, shpërndarjen dhe lidhjen e kontratave të reja në favor të klienteve familjarë dhe jo familjarë.

Në përgjigjen e tij, Drejtori i Përgjithshëm i Kesh sha njoftoi se konstatimi i Avokatit të Popullit për mos paisjen e abonenteve me kontrata të reja ishte i drejtë. Por për rastin në fjalë, ai u justifikua me vonesat në kryerjen e procedurave të tenderimit, të cilat kishin shtyre në kohë shtypjen e kontratave të reja. Megjithatë ai bëri me dije se tashme ishin marrë të gjitha masat administrative dhe kishte filluar shpërndarja dhe lidhja e kontratave të reja në të gjitha filialet e KESH sha nëpër rrethe.

Nga njoftimet që kemi marrë për këtë çështje në vijim të ndjekjes së saj, Avokati i Popullit konstatoi se megjithë vullnetin e mirë dhe përpjekjet e vazhdueshme të KESH sha në disa zona, shpërndarja dhe lidhja e kontratave ka patur probleme dhe nuk ishte bërë e plotë. Gjithsesi këto parregullsi sporadike nuk kanë eklipsuar aspak përmbushjen e këtij detyrimi ligjor të KESH sha ndaj klienteve, i cili duhet konsideruar ende në proces.

2. Tashme në publik është bërë mëse i njohur qëndrimi ndër vite i Avokatit të Popullit për çështjen e çmimeve të energjisë elektrike. Gjithsesi gjate vitit 2006 konsumatori shqiptar u perball sërish me rritje të çmimit të energjisë, që për shumë arsye dhe argumente që do të sjellim në vijim konsiderohet nga ana jonë i padrejtë.

Duhet thënë se procedurat që u zhvilluan gjate vitit 2006 për rritjen e çmimit të energjisë, u shoqëruan si rrallë herë me një qëndrim të përbashkët kontestues nga shoqatat dhe grupet e interesit, ku një vend kryesor zuri dhe qëndrimi i Institucionit të Avokatit të Popullit.

Konkretisht në Mars 2006, pranë Avokatit të Popullit, Lëvizja "Mjaft" depozitoi kërkesën e 5 mije qytetareve, të cilët kërkonin ndihmën tonë për të ndërhyrë në mos miratimin e tarifave të reja që KESH sha kishte propozuar pranë Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike.

Nga shqyrtimi i kërkesës së tyre, si dhe duke u njohur me materialet dhe argumentat ligjore që KESH sha kishte depozituar pranë ERE-s, Avokati i Popullit formoi bindjen se propozimi i KESH sha pranë ERE-s për të rritur çmimin e energjisë elektrike për konsumatorin familjar nga 4.5 Lekë/Kvh në

5.2 lekë/Kvh (Blloku I) dhe nga 9 leke/kvh ne 10 lekë/kvh (Blloku II) dhe për të ulur bllokun e parë të konsumit të energjisë nga 210 kvh në 180 Kvh ishte i papranueshëm.

Kjo pasi ulja e kufirit të Bllokut të Parë të llogaritjes së energjisë nga 210Kvh ne 180 Kvh ishte një veprim që prekte direkt shtresën më të marginalizuar të shoqërisë, duke rritur në këtë mënyre shpenzimet e saj tepër të reduktuara që janë burim i pensioneve, asistencës, ndihmës ekonomike etj. Kjo ulje dëmtonte në mënyrë të drejtperdrejtë shtresat në nevojë, kompesimi i të cilave nga qeveria ishte shume simbolik (ulja ne Bllokun e I ne masen 0.5 leke/Kvh është rreth 80-90 lekë në muaj) dhe nuk mjaftonte për të përballuar vështiresite financiare të jetesës së përditshme.

Krahas kësaj, Avokati i Popullit, nuk mund të binte dakort me këto çmime për sa kohe që shërbimet që ofroheshin nga KESH ishin me të meta thelbësore. Në atë periudhë që diskutoheshin çmimet e reja të energjisë, KESH sha rezultonte se kishte rreth 145.000 kliente të saj pa matesa dhe faturonte ende afrofe në kundërshtim me ligjin “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” për të gjithë personat pa matësa. Ndërkohë afati i fundit ligjor për zbatimin e kësaj procedurë ishte 31 Dhjetori 2004 (dispozitë që u ndryshua ne Maj 2006, duke ja lënë shtyrjen e këtij afati ERE-s).

Përveç kësaj KESH sha faturonte me të njëjtën kërkesë pagese mbi bazë përlllogaritje afrofeje edhe kur kufizimet e energjisë elektrike ishin minimale, edhe kur ato ishin maksimale. Kjo kompani faturonte afrofe për mjaft persona me matësa të rregullt, dukuri e cila kishte shkaktuar mjaft pakënaqësi tek qytetarët. Rivenia në vend e të drejtave të konsumatorit në këtë rast ishte mjaft e dyshimte referuar procedurave tepër burokratike dhe jo transparente të kompesimit.

KESH sha vazhdonte të ofronte shërbim të furnizimit me energji jashte standarteve dhe ndonjëhere me rrezikshmëri të lartë për pronën dhe shendetin e individëve, nje dukuri e cila vinte në kundërshtim me një sërë nenesh të Ligjit Nr.9135 dt. 11.09.2003 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve” dhe kontratës së furnizimit me energji elektrike. KESH sha vazhdonte të mos lidhte kontratën e re të furnizimit me energji elektrike që kishte hyrë në fuqi që më 1 Janar 2006. Ajo evidentonte një nivel të ulët të sigurisë në rrjetin kompjuterik të arkëtimeve financiare dhe ishte akuzuar shpesh here për dukuri korrupsioni dhe abuzimi me detyren në dëm të konsumatorit. KESH sha aplikonte hapur shkelje të ligjit “Për Mbrojtjen e Konsumatorit” dhe të Ligjit “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” për aq kohë sa kryente dënime kolektive me anë të kufizimit të energjisë elektrike edhe për ata kliente që ishin të rregullt.

KESH sha vazhdonte të aplikonte orare të kufizimeve të energjise të pa njoftuara më parë publikisht, duke mos respektuar detyrimet kontraktore dhe duke sjellë një dëm të konsiderueshem ekonomik tek konsumatorët.

Përveç këtyre konstatimeve që Avokati i Popullit i kishte provuar më parë nga shqyrtimi i ankesave të qytetarëve, ai ju kundervu me argumenta dhe fakte të sakta pretendimit të KESH sha se çmimet kerkonin te njehsonin nivelet e tyre me ato të shteteve fqinjë ballkanike.

Nga të dhënat e depozituara zyrtarisht nga homologe të vendeve të rajonit me kërkesë të Avokatit të Popullit rezultoi se sidomos Republika e Maqedonisë aplikonte për familjaret një çmim prej 46.2 euro per 1000 kvh energji të harxhuar, ndërsa në Shqipëri me tarifata aktuale familjari paguan 79.9 Euro per 1000 Kvh të harxhuara, pra afër 2 herë më shtrenjtë. Gjithashtu sipas të dhënave të marra në rrugë zyrtare nga ERE, identifikohet me lehtësi se Armenia, Bullgaria, Gjorgjia, Moldavia etj, kishin një çmim më të ulët energjie, kur dihet që keto shtete kishin edhe kosto më të lartë prodhimi si pasojë e burimeve përgjithësisht me TEC-e të energjise, me naftë, gaz apo qymyr. Kurse Shqipëria me energjinë që prodhonte me rreth 90% nga hidrocentralet me uje dhe me kosto shumë here më të lirë, propozonte nivele më të larta çmimi se vendet e mësipërme. Bëhet fjalë për të dhënat e viteve 2003-2005.

Nga ky argument, Avokati i Popullit konkludoi se KESH sha kishte një mungesë koherence dhe transparence në të dhënat e kostove të energjisë të prodhuar në vend dhe të importuar. Gjithashtu referimi në atë kohë i koston të energjise, sipas studimit të Shoqërisë së huaj DECON të kontraktuar nga Banka Boterore, nuk ishte serioz nga ana e KESH sha, sepse dihet se në vitet 2000-2002 kishte patur thatësire dhe ishte importuar shumë energji. Pra ishte e papranueshme kostoja 11.7 lekë e vitit 2003, kur bëhet fjalë tashmë që ndodheshim në fillim te vitit 2006.

Një tjetër argument i KESH sha, i cili u hodh poshtë nga ana jonë, ishte se tarifata e propozuara ishin detyrim edhe i marreveshjeve me donatorët dhe i asistencës së partnereve të tjerë të huaj. Ky argument ishte i pasaktë pasi nga të dhënat që ishin bërë publike gjatë mbledhjes së donatorëve të KESH sha ishte kërkuar para së gjithash që të rriteshin arketimet dhe të uleshin borxhet për energjinë e harxhuar. Kjo kërkesë ishte anashkaluar qëllimisht nga KESH sha, sepse kjo kompani nuk arrinte të realizonte 100% arketime. Madje kjo kompani nuk kishte të hartuar një strategji për rritjen e nivelit të arketimeve në shkallë vendi, megjithëse nga ana e Avokatit të Popullit ishin dhënë edhe variante konkrete sesi mund të realizohej kjo ide.

Gjithsesi nga të dhënat që dispononte Avokati i Popullit, Shqipëria vazhdonte të kishte një humbje teknike dhe jo teknike të energjisë elektrike

të përlogaritur në shifrën 2 miliard e 300 milion kvh ose më tepër se 100 Milion USD në vit. Kjo shume po të minimizohej me anë të masave të gjithanshme dhe të shpejta do të mundësonte jo vetëm uljen e kostos së çmimit të energjise, por dhe rritjen e kapaciteteve investuese të vetë KESH sha ne vepra të tjera energjitike në vend.

Në përfundim të kësaj analize, Avokati i Popullit përmendi dhe faktin se KESH sha vazhdonte të aplikonte një diskriminim të plotë të kategorisë së qytetarëve që paguanin. Me anë të veprimeve të saj KESH sha kishte legjitimuar platformën financiare, sipas të cilës, klienti i rregullt duhet të paguante edhe për atë klient që nuk paguan, madje duhet të paguante edhe për vetë koston e krizës manaxheriale të kësaj kompanie. Kjo sipas Avokatit të Popullit përbente një rrezik të madh për shkak të zbatimit të këtij standarti të dyfishtë, të cilin ne shume raste në heshtje e mbështesin edhe përfaqesues të lartë të politikës. Kurse në nivele vendore kryetarët e komunave e minibashkive kishin dalë hapur në mbrojtje të atyre që nuk paguajnë. Kjo bënte që edhe vetë klientët e rregullt ti shmangeshin detyrimeve të KESH sha, duke humbur përfundimisht besimin tek kjo kompani.

Për të gjitha argumentat dhe konstatimet e përmendura me lart, nga ku rezultonte se KESH sha nuk i kishte përmbushur një sërë detyrimesh thelbësore në mardhënie me konsumatorët, duke ju cënuar atyre të drejtën e përdorimit të shërbimeve publike sipas kushteve ligjore dhe kontraktore në fuqi, Avokati i Popullit paraqiti një rekomandim pranë ERE-s ku kërkonte mospranimin e propozimit të KESH sha për rritjen e çmimit të energjise elektrike.

Gjithashtu Avokati i Popullit kërkoi caktimin e një afati konkret ndaj KESH sha për të realizuar një seri masash dhe veprimesh urgjente me qëllim përmirësimin e gjendjes së furnizimit me energji brenda të gjitha standarteve ligjore dhe kontraktore në favor të të drejtave të konsumatorëve.

Në përgjigje të këtij rekomandimi, Kryetari i Entit Rregullator të Sektorit të Energjise Elektrike (E.R.E) me anë të një përgjigje të tij bëri të ditur se ERE kishte marre në konsiderate një pjesë të mirë të objeksioneve të parashtruara nga Avokati i Popullit dhe do të dilte së shpejti me një vendim përfundimtar. Megjithatë këtë, ERE, njoftonte se nga Kryeministri Z.Sali Berisha i ishte paraqitur një shkresë ku kërkohet pezullimi i vendimmarrjes në lidhje me ndryshimin e çmimeve të energjisë elektrike, me qëllimin për të bërë të mundur vlerësimin prej qeverisë të disa aspekteve të politikës së çmimeve që kishin të bënin me disa konsumatore parësore dhe mundësisë së rivlerësimit dhe subvencionimit të ndonjë kategorie konsumatorësh. Pikërisht bazuar në kërkesën e lartpërmendur, Bordi i Komisionerëve me vendimin nr.27, datë 20.04.2006, vendosi që

KESH sh.a për konsumatorët fundore për periudhën 1 janar- 30 qershor 2006, të aplikonte çmimet e përcaktuara sipas vendimit nr.55, date 2.12.2004 të Bordit të Komisionereve të ERE-s, duke mos i ndryshuar ato.

Kjo përgjigje u prit shume mirë nga Avokati i Popullit, për arsyen se ndërhyrja e Qeverisë për të riformuluar kërkesat e KESH sha nisej nga interesa të gjera për të ndihmuar shtresat në nevojë dhe disa grupe të tjera shoqërore me të ardhura të ulta, argumenta këto që kishin përputhje me qendrimin tonë për këtë çështje.

Pas një periudhe të shkurtër, në Qershor 2006 pranë Avokatit të Popullit u paraqit një shkresë nga Enti Rregullator i Sektorit të Energjise, me ane të së cilës, njoftoheshim për tarifën e reja të propozuara nga KESH sha për periudhën 1 Korrik-31 Dhjetor 2006. Krahasuar me propozimet e Muajit Mars 2006, KESH sha kishte rimodeluar tarifën dhe dallimet e fashave të perlllogaritjes së energjise së harxhuar për konsumatorin familjar, duke propozuar që fasha e parë e konsumit të ishte në kufirin e 600 Kvh dhe me tarifë 7 lekë/Kvh. Ndersa fasha e dyte tej limitit 600 kvh të kishte tarifën 10 lekë/kvh.

KESH sha referuar propozimeve të mësipërme, kishte informuar Entin Rregullator të Sektorit të Energjise se për konsumatorët familjare në nevojë, Qeveria shprehej se do të kryente subvencionimin ndaj tyre deri ne limitin 210 Kvh, duke paguar diferencën e tarifës aktuale 4.5 leke/Kvh në 7 lekë/Kvh.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me propozimet e reja të KESH sha, përsëriti sërish argumentat e rekomandimit të tij të parë ndaj ERE, duke shtuar se diferencimi i ri dhe i pamotivuar tek konsumatorët do të krijonte sërish një rritje artificiale të pa justifikuar ndaj tyre. Me keto tarifa, sipas një perlllogaritje të thjeshtë, vetëm për 210 Kvh si fashë e parë, konsumatori familjar do të paguante 535 lekë më shumë dhe për konsumin deri në 600 Kvh do të paguante 94 lekë me shumë. Kjo sipas Avokatit të Popullit i mohonte konsumatorit të rregullt familjar të përfitonte nga konsumi në fashën e parë limit prej 4.5 lekë Kvh, duke e detyruar atë të pranojë tarifën e re 7 lekë deri në 600 Kvh.

Sipas propozimeve të mësipërme, të krijohej ideja se konsumatorët familjare ishin të ndare së fundi në tre fasha, ku njera do të ndikohej nga subvencionimi qeveritar, tjetra nëpërmjet kufirit 600 Kvh dhe pas kësaj çdo njësi Kvh do të ishte 10 lekë.

Ne keto kushte, Avokati i Popullit prezantoi para ERE-s mendimin e tij se këto tarifa ishin një diskriminim i hapur i individit sipas nenit 18 të Kushtetues në të cilën parashikohej se *“Askush nuk mund të diskriminohet padrejtesisht për shkak të tilla si gjendja ekonomike, sociale etj”*.

Në përgjigjen përfundimtare që u paraqit nga ERE, bashkëlidhur vendimit përkatës të miratimit të çmimit të energjisë elektrike, u bë e ditur se ky organ përsersite sërish vlerësimin pozitiv për Avokatin e Popullit dhe qëndrimet e tij në këtë çështje, duke i konsideruar opinionet e tij një element të rëndësishëm në vendimarrjen e saj. Nga vendimi i marrë nga ERE për çmimet e energjise u arrit që çmimi i fashes së tretë prej 10 lekë/Kvh të mos merrej në konsideratë dhe të miratohej vetëm çmimi prej 7 lekë/Kvh për konsumatorin familjar. Në këtë çmim merrej në konsideratë kontributi i Qeverise në 35% të klienteve të kësaj kategorie, të cilët do të subvencionoheshin për diferencën nga 4.5 lekë/Kvh deri 7 lekë/Kvh për një konsum deri në 220kv/muaj.

Krahasuar me propozimet e mëparshme ky nivel i ri çmimesh edhe pse me rezerva të vogla, u konsiderua një arritje e madhe për interesat ekonomike të konsumatorëve të KESH sha, pasi kjo rritje nuk kishte impakt në nivele të ekzagjeruara në shpenzimet e tyre.

Gjithsesi ky vendim pritej të vlerësohej nga Avokati i Popullit duke mbajtur në vëmendje së pari kompesimin e Qeverise, i cili megjithese u shoqërua me një konfuzitet të madh, arriti të përmbushet me vështiresi gjatë vitit 2006 dhe, së dyti nga saktësia e sistemit matës të KESH sha, e cila vazhdon të mos tregojë realisht luhatjet e çmimit të ri, për vetë abuzimet që kryhen në këtë fushë.

Në një tentativë të tretë gjatë Muajit Nëntor 2006, KESH sha propozoi rritje të çmimit të energjisë për klientet përfitues në tensionin e lartë dhe për disa veprimtari të tjera sipërmarrje të privilegjuara si Furra Buke dhe Ujesjëllesa. Në seancën dëgjimore të rradhës për këtë qëllim, Avokati i Popullit dënnoncoi haptazi këtë propozim, si një orvatje e Kesh sha për të rritur në mënyre të paargumentuar përfitimet ndaj sipërmarrjes private, gjë që do të kishte impaktin e saj edhe në rritjen e çmimeve të produkteve që ofroheshin nga këto shërbime.

Në Dhjetor 2006, ERE me anë të vendimit të saj, hodhi poshtë propozimet e Kesh sha, duke i konsideruar ato me mangësi të mëdha në argumentimin ekonomiko-financiar të nevojave të saj.

Kjo ishte një tjetër mesazh i qartë i ERE-s që vërtetonte mungesën e seriozitetit dhe amullinë që mbizotëron në KESH sha për të kërkuar me profesionalizem masa të qëndrueshme ekonomike në përmiresim të bilancit të saj financiar. Ky rast është evidentuar nga Avokati i Popullit si një shkak më shumë që edhe në të ardhmen propozimet e kësaj kompanie të gjejnë një kritikizem dhe kontestim të fortë në koneksitet me treguesit e tjerë të cilësisë së shërbimeve.

3. Avokati i Popullit, nisur nga ankesat e disa konsumatoreve jofamiljare të zonës Yrshek Tirane ishte vënë në dijeni se Drejtoria e Zonës së Shpërndarjes së KESH sha Tirane vazhdonte të mos shpërndante faturat e konsumit të energjise elektrike në adresat e subjekteve private.

Kjo dukuri, sipas tyre, vijonte prej kohësh dhe për pasojë subjekteve private të kësaj zone ju duhej të paraqiteshin në Zyrën e Postës Yrshek për të marrë faturat e energjisë dhe për të kryer njëkohesisht pagesat përkatse. Me tej, pas një periudhe të caktuar, ky shërbim ishte reduktuar vetëm në kryerjen e pagesës së konsumit të energjisë, sipas një liste të paraqitur nga Zona e Shpërndarjes KESH sha Tiranë pranë Postes sha Yrshek. Ndërsa për sigurimin e kopjes së faturës së energjisë, subjekteve private ju duhej të paraqiteshin pranë Filialit të Shitjes së KESH sha Tirane, pasi sipas këtyre të fundit, KESH sha nuk dispononte personel të plotë për të ofruar shpërndarjen e faturave të energjisë në disa zona të Tiranës. Avokati i Popullit, pas verifikimeve që kreu për këtë ankese, pranë Zyrës së Postës Yrshek, konstatoi se praktika e lartpërmendur vazhdonte të aplikohet nga KESH sha në kundërshtim me aktet ligjore dhe mardheniet kontraktore me konsumatorët.

Prandaj referuar problemit të mësipërm, paraqitëm një rekomandim pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Kesh sha dhe Zonës së Shpërndarjes së Kesh sha Tiranë, ku vuri në vëmendje të tyre faktin se subjektet private në rolin e konsumatorit jo familjar nuk ishin të detyruara të paraqiten pranë Filialit të Shitjes së KESH sha Tiranë për të marrë faturën, pasi përveçse ky veprim kishte koston dhe angazhimin e vet për këto shoqëri, kjo mardhënie nuk gjente trajtim të njëjtte në qendrat e tjera të banuara, duke passjellë në këtë mënyrë një trajtim jo të barabarte dhe diskriminues ndaj kësaj kategorie të veçantë të konsumatoreve.

Referuar Nenit 37 pika 5 te Ligjit Nr.9135 dt.11.09.2003 “Për Mbrojtjen e Konsumatorit” parashikohet se:

“Faturat duhet tëi dorezohen konsumatorit në vendin e tij të banimit, në menyre zyrtare (me poste ose dorazi) dhe jo më vonë së pesëmbëdhjete dite kalendarike përpara afatit të pageses”

Në rastin konkret ky detyrim ligjor jo vetëm nuk ishte zbatuar, por ishin aplikuar forma të tjera të parregullta të KESH sha, të cilat kishin cënuar në parim të drejtën e konsumatorit për tu njoftuar dhe përfituar të drejtat e ligjshme gjatë përdorimit të shërbimeve publike. Në pikën 5 dhe 6 të kontratës së furnizimit me energji elektrike për konsumatorin familjar dhe jofamiljar të KESH sha ishte percaktuar midis të tjerash se: *“Furnizuesi i dërgon faturën konsumatorit në adresën e dhene ne kontrate, brenda dates 25 të muajit pasardhes”*. Pra klauzola e mësipërme kontraktore, tregonte se

KESH sha kishte detyrimin për të zbatuar një formë të caktuar të shpërndarjes së faturave. Për këtë qëllim, mungesa e organizimit të kësaj veprimtarie për konsumatorët që nuk e përfitonin atë aktulisht u konsiderua nga Avokati i Popullit si një fenomen keqmanaxhues që duhej korrigjuar. Për këtë qëllim në rekomandimin e hartuar për këtë qëllim, ju kërkua KESH sha që të zbatonte detyrimet ligjore dhe kontraktore ndaj konsumatoreve, në lidhje me dërgimin e faturave të energjisë në destinacion, duke hartuar një plan masash për të realizuar këtë detyrim me mjetet më të përshtatshme që dispononte KESH sha.

Nga korrespondencat dhe pergjigjet që kemi patur për këtë rekomandim nga KESH sha jemi njohur se me anë të një marreveshje të re, e cila ka hyre në fuqi në Tetor 2006, midis Kesh sha dhe Posta sha ishte bere e mundur që shpërndarja e të gjitha faturave elektrike të kryhet në destinacion nga nëpunësit e postës. Si rrjedhim i kësaj marreveshje, klienteve jo familjare nuk do tëju duhej të njiheshin me faturat e energjise prane Filialeve të Kesh sha, por nëpër adresat e tyre përkatse. Megjithëse në parim kjo mardhënie është sanksionuar në formën më të mirë të mundshme, Avokati i Popullit do të vazhdoje ta ndjekë këtë rast për të parë zbatimin e tij konkret në terren.

4. Avokati i Popullit nisur nga ankesat që ju bënë prezente gjatë vitit 2006, konstatoi se KESH sha kreu një riorganizim organik të strukturave të saj, duke larguar dhe transferuar nga detyra një numër të madh personash. Gjatë trajtimit të këtyre ankesave, Avokati i Popullit vuri re se procedurat e shkarkimit të nëpunësve në mjaft raste ishin kryer me të meta thelbësore dhe në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Punës.

Megjithëse shumica e tyre kaluan apo janë ende në proçese gjyqësore, për t'ei ardhur sadopak në ndihmë ankuesve, si dhe për të korrigjuar praktikën e dëmshme që aplikoheshin ndaj tyre nga KESH sha, Avokati i Popullit kreu një hetim me qëllim përgjithësimin e rasteve dhe paraqitjen e shkeljeve konkrete.

Në përfundim të këtij hetimi, Avokati i Popullit paraqiti pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Kesh sha një rast të veçantë, i cili ilustronte praktiken e gabuar që ndiqej nga Kesh sha për largimet nga puna.

Konkretisht një ish punonjës i Filialit të Shitjes të KESH sha Tiranë kishte paraqitur një ankese, në të cilën ngrinte shqetesimin për largimin e padrejte të tij nga puna. Përveç kësaj, ai ankohej se proçedura me ane të së cilës ai ishte larguar, ishte shoqeruar me parregullsi të mëdha dhe të dukshme. Në vijim të kësaj ankuesi argumentoi se kishte marre dijeni për heqjen e tij nga puna ditën që i ishin ndërprere mardhëniet financiare dhe ky veprim i ishte njoftuar me ane të një shkrese pa datë, vulë, numër protokollit

dhe elementë të tjerë të domosdoshëm për një akt administrativ të rregullt, (administruar kjo edhe nga Avokati i Popullit).

Avokati i Popullit duke konstatuar se praktika e mësipërme ishte kryer rëndome nga Kesh sha edhe për shumë punonjës të tjerë, paraqiti pranë Drejtorit të Përgjithshëm të kësaj kompanie një rekomandim, duke kërkuar korrigjimin e menjëhershëm të veprimtarisë së saj në kuadër të largimeve nga puna dhe për disa aspekte të tjera të mardhënieve të punës.

Avokati i Popullit argumentoi ligjërisht se praktika e ndjekur vinte në kundërshtim me nenet 107, 108 109 të Ligjit Nr.8485, date 12.5.1999 “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” ku flitej për aktet administrative individuale, në të cilat përfshihet dhe shkresat për largimet nga puna.

Në këto raste Kesh sha nuk kishte plotësuar asnjë element kryesor të formës dhe përmbajtjes së këtyre akteve, pa të cilat këto të fundit konsideroheshin absolutisht të pavlefshëm. Ndër këto elemente mungonte arsyetimi i aktit, data e hyrjes në fuqi të tij, baza ligjore, identifikimi i aktit me anë të treguesve dhe referencave të regjistrave të protokollit etj. Përveç kësaj zgjidhja e mardhënieve të punës ishte shoqëruar edhe me shkelje të tjera të konstatuara në vështrim të zbatimit të legjislacionit të punës.

Konkretisht me Ligjin Nr.7961 dt.12.07.1995 ndryshuar me Ligjin Nr.8085 dt.12.03.1996 dhe Ligjin nr. 9125 dt.29.07.2003 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” janë të përcaktuara në mënyre eksplicite rastet e zgjidhjes së mardhënieve të punës midis punëdhënësit dhe punëmarresit.

Konkretisht në bazë të Nenit 143 dhe 144 të ligjit të mësipërm, parashikohet midis të tjerash se:

“Për të zgjidhur kontratën me kohë të pacaktuar, palët duhet të respektojnë një afat njoftimi prej një muaji gjatë vitit të parë të punës, prej dy muajsh për dy deri në pesë vjet, prej tre muajsh për më shumë se pesë vjet pune. Kur punëdhënësi mendon të zgjidhe kontratën e punës, ai duhet të njoftojë me shkrim punëmarrësin 72 ore para takimit dhe të bisedojë me të. Punëdhënësi gjatë kësaj bisede i parashtron punëmarresit arsyet e vendimit të parashikuar për tu marrë dhe i jep atij mundësinë për tu shprehur. Zgjidhja njoftohet me shkrim 48 orë deri në një javë pas takimit. Punëdhënësi që nuk respekton këtë proçedure detyrohet ti japë punëmarrësit një dëmshpërblim prej dy pagash mujore shtesë dëmshpërblimeve të tjera”.

Megjithëse këto dispozita janë të detyrueshme për zbatim nga palët, për ti ardhur në ndihmë edhe rasteve kur pushimi nga puna konsiderohet nga punëdhënësi i kryer me shkaqe të justifikuara, përsëri ky i fundit në bazë të nenit 153 të Kodit të Punës është i detyruar që të ndërmarre një proçedurë të rregullt administrative, duke respektuar hierarkine e masave disiplinore,

aplikimi i të cilave në mënyre të përsëritur është kusht për largimin nga puna në varësi të shkeljeve.

Avokati i Popullit referuar dispozitave të mësipërme konstatoi se KESH sha në shume raste nuk kishte zbatuar asnjë element të tyre, duke shkaktuar kështu një shkelje të të drejtave të punonjësve.

Ne e kritikuar këtë praktike të Kesh sha për të mos lënë që gabimet e tyre të korrigjoheshin në rrugë gjyqësore, sepse përveçse kjo rrugë kërkon kohë, shpenzime të medha madje të panevojshme dhe angazhim të vazhdueshëm nga të dyja palët, ajo nuk është mënyra e duhur për të qeverisur apo manaxhuar një organ shtetëror apo ent publik. Përkundrazi veprime të tilla tregojnë një paaftësi apo keqmanaxhim të dukshëm që nuk përmireson aspak si imazhin e organeve, ashtu dhe pozitën e karrierës së vetë punëdhënësve.

Me anë të përgjigjes së paraqitur nga Kesh sha për këtë rekomandim, jemi njohur se për rastin konkret të prezantuar ishin kryer të gjitha procedurat sipas ligjit dhe njëkohësisht ishin urdhëruar të gjitha strukturat e Kesh sha të zbatonin rigorozisht dispozitat e Kodit të Punës, lidhur me respektimin e të drejtave të punonjësve gjatë zgjidhjes së mardhenieve të punës. Duke e parë këtë prononcim të Kesh sha si mjaft deklarativ, Avokati i Popullit brenda kompetencave të tij do të shikojë edhe në të ardhmen mundësinë që të ndërhyjë për ato raste të ankesave për mos respektimin e ligjit në dëm të të drejtave dhe interesave të ligjshme të individëve.

5. Avokati i Popullit gjatë vitit 2006 ashtu si dhe në ente të tjera publike, konstatoi se Kesh sha kishte zbatuar transferime abuzive të nëpunësve të saj me pretendimin e vetëm për ti larguar ata nga puna në mënyrë të detyruar. Kjo praktike është kritikuar nga ana jone në shume raste dhe ka gjetur edhe ndërhyrjet përkatse me anë të rekomandimeve. Në vijim po ju paraqesim një rast që ilustron këtë veprimtari abuzive, i cili megjithese në përfundim të shqyrtimit dhe ndërhyrjeve përkatse nuk gjeti zbatimin e duhur nga Kesh sha, tregon në mënyre flagrante shkeljet e konsumuara nga kjo kompani.

Konkretisht pranë Avokatit të Popullit kishte paraqitur një ankesë një punonjëse e Divizionit të Shpërndarjes së Kesh sha, Tiranë, e cila paraqiti shqetësimin e saj lidhur me transferimin e pozicionit të punës, për shkak të riorganizimit të strukture ku punonte, pranë së cilës ajo kishte kryer punën e faturistes dhe njëkohësisht të Kryetares së Sindikatës së Zonës.

Nga verifikimet e bëra për këtë ankese nga Avokati i Popullit rezultoi se ankuesja ishte njoftuar për vendimin administrativ të transferimit të saj nga Tirana në Kolonje. Por ky urdhër transferimi për vetë pasojat që sillte, mund të konsiderohej masë ndëshkimore disiplinore. Kjo për faktin se

transferimi i saj nga Tirana në Kolonjë, qenia grua dhe familjare me banim prej 40 vitesh në Tiranë dhe për më tepër detyra që kishte mbuluar si faturiste, nuk argumentonin daljen e një urdhëri të tillë. Në kundërshtim me këtë konkluzion, Kesh sha e justifikoi këtë veprim si nevojë e kësaj kompanie për të sistemuar punonjësit atje ku ata mund të shprehnin aftësitë e tyre.

Kjo përgjigje në asnjë rast nuk të krijonte bindjen se nga ana e Kesh sha ishte proceduar bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore. Kjo për faktin se vendimi administrativ i ndryshimit të vendit të punës, si faturiste nga Tirana në Kolonjë, me shkakun se ky ndryshim bëhej edhe për të ndihmuar veprimtarinë ekonomike të ndermarrjes, jo vetëm nuk përlligjej, por ishte shume subjektive, në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Punës dhe të kontrates kolektive të punës, madje shumë cinike për nga efektet që prezantonte gjatë zbatimit të saj në praktike.

Avokati i Popullit e konsideroi këtë praktike në kundërshtim edhe me percaktimet e pikës 5 të nenit 181 të Kodit të Punës, sepse ndryshimi i kushteve të kontratës së punës të përfaqësuesve të organizatës së punëmarresve, duhet të bëhej vetëm me pëlqimin e punëmarresit dhe të kësaj organizate, ç'ka tregonte se nuk ishte zbatuar ky detyrim. Përjashtimi i parashikuar në këtë rast *“kur ndryshimi ishte i domosdoshem për veprimtarinë ekonomike të ndërmarjes”*, në çështjen e mësipërme nuk rezultonte që të ishte aspak argumentues. Gjithashtu në këtë procedim administrativ ishte shkelur dhe pika 7 e nenit 181 të Kodit të Punës, sepse për përfaqësuesit e zgjedhur të organizatave të punëmarrësve, sindikatës, punëdhënësi duhet të krijonte kushte dhe lehtësi për ushtrimin normalisht të funksioneve të tyre.

Nga sa me lart, Avokati i Popullit paraqiti një rekomandim pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Kesh sha, ku kërkonte marrjen e masave për rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura ndaj ankueses.

Në përgjigjen e paraqitur nga kjo kompani çështja në fjalë refuzohej të zgjidhej në favor të ankesues, duke u mbeshtetur në të njëjtat fakte të përmendura edhe gjatë korrespondencës së mëparshme.

Avokati i Popullit megjithë insistimin e tij për të bindur drejtuesit e kësaj kompanie në domosdoshmërinë e zbatimit të rregullt të dispozitave të Kodit të Punës, kuptoi realisht se prapa këtij refuzimi qëndronte qëllimi i vërtetë i transferimit abuziv dhe tendencioz.

Ky qëndrim antiligjor dhe antihuman i mbajtur në shume raste me mjaft punonjës të thjeshtë të Kesh sha ka krijuar një përshtjellim të madh në ligjshmërinë që duhet të ekzistojë në veprimtarinë e enteve publike. Me këtë rast, Avokati i Popullit do të vazhdojë të ngrejë edhe në të ardhmen

probleme të kësaj natyre, duke i rikujtuar çdo drejtuesi se ligji duhet të zbatohet me përpikmëri dhe jo të shfrytezohet për abuzivizëm.

6. Avokati i Popullit është ndalur akoma dhe më shumë gjatë vitit 2006 në lidhje me mungesën e një sistemi serioz leximi dhe faturimi nga ana e Kesh sha në raport me qytetarët. Në këtë kuadër ndërhyrjet në mjaft raste kane qënë pozitive, por njëkohësisht ato kanë nxjerrë në pah një sërë problematikash që vazhdojnë të mbajnë shërbimet e Kesh sha në një nivel keqadministrimi të papranueshëm.

Nisur nga kjo gjendje Avokati i Popullit ka ndikuar dhe paraqitur propozime konkrete edhe në të kaluarën për të përmirësuar mënyrën e leximit të matësave dhe shmangien e veprimeve abuzive.

Megjithese këto propozime të Avokatit të Popullit u morën në konsiderate gjatë vitit 2006 nga ana e Kesh sha, ato nuk patën efektin e duhur, pasi në shume raste faturistet dhe përgjegjësit e filialeve të Kesh sha e konsideruan këtë proces një fushatë afatshkurter projekti pilot dhe jo një detyrë të përhershme korrekte në raport me klientët.

Konkretisht në Tirane dhe në disa qytetet të tjera u publikuan me anë të shpalljeve oraret e leximit të matesave nga ana e faturuesve me qëllim që klientët nisur nga volumi i madh i ankesave të ishin prezent për të korrigjuar parregullsi të mundshme.

Mirpo kjo veprimtari gjeti pengesa aspak të justifikuar nga ana e punonjësve të Kesh sha dhe nuk vijoi normalisht sipas urdhërave të organeve eprore të Kesh sha. Kjo gjë solli që kjo procedurë të dështonte plotësisht. Aktualisht ajo aplikohet vetëm me dëshirë të punonjësve të rregullt të leximit, duke sjelle një progres të pjesshëm në këtë drejtim. Nga ana tjetër posterat e vendosura në çdo boks aparatësh matëse, të cilët njoftonin klientët për mënyrën e leximit të aparateve të tyre vijojne të mbeten një dëshmi e gjallë paradoksi që karakterizon shërbimet e Kesh sha në këtë fushë.

Kësaj problematike i shtohet gjithashtu edhe dështimi i Kesh sha për të vendosur brenda afateve ligjore matësat e energjisë në shkallë vendi. Mendojme se megjithë përpjekjet e saj ky detyrim do të vazhdojë të mbaje peng interesat e ligjshme të qytetareve. Gjithsesi ne do të vazhdojme të jemi në ndjekje edhe të premtimeve të bëra, tashme të kthyer në një vendim zyrtar të ERE për afatin përfundimtar të vendosjes së matësave deri me 31 Mars 2007.

Por mendojmë se kësaj ideje nuk i për afrohen qëndrimet e fundit të mbajtura nga drejtuesit e Kesh sha, të cilët duke pranuar dështimin e plotë të sistemit të leximit dhe faturimit të Kesh sha, nuk janë të gatshëm të pranojnë caktimin e tarifave të energjisë sipas fashave ditore të propozuara së fundi nga ERE.

Gjithsesi për të ilustruar me prova konkrete shkeljet që ndodhin nga moskryerja e një transparence të efektshme gjate leximit të matësive, çka është edhe “Thembra e Akilit” në këtë shërbim, në vijim po ju paraqesim njërin nga rastet e zgjidhur pozitivisht që e tregon më së miri këtë problem që shfaqet rëndomë në Kesh sha.

Pranë Avokatit të Popullit një qytetar u ankua se faturat e konsumit të energjise elektrike që i vinin në adresë të tij kohët e fundit kishin një rritje mjaft të madhe, e cila nuk korrespondonte me konsumin e tij real. Për këtë çështje ankuesi kishte bërë konform rregullave një aplikim ankese edhe në Kesh sha. Por megjithë pritjen e tij të gjatë nga ana e tyre nuk ishte marrë asnjë masë verifikuese për problemin e ngritur.

Avokati i Popullit pasi u njoh me këtë ankesë, kërkoi menjëherë verifikimin e kësaj ankese nga ana e strukturave përkatëse të Kesh sha. Kjo ndërhyrje u krye duke kërkuar edhe përgjegjësitë konkrete disiplinore ndaj nëpunësve përkatës, në rast se do të konstatoheshin shkelje të mundshme.

Nga përgjigja e ardhura nga Divizioni i Shpërndarjes së Kesh sha Tiranë, është bërë e njohur se pas kontrollit të kryer ishte konstatuar se ndaj ankuesit ishte fatuar jashtë konsumit real që shënonte matësi i tij.

Në këto kushte, sipas drejtuesve të Kesh sha ishte marrë masa e zbritjes së kësaj shume në muajt në vijim, duke e pajisur për këtë qëllim ankuesin edhe me një vërtetim zyrtar. Ndërsa lidhur me shkeljet e konstatuar ishte marrë masa e largimin nga puna të faturueses.

7. Nisur nga e gjithë problematika e parashtruar më lart, Avokati i Popullit, ashtu si dhe në vitet e kaluara krahas ndërhyrjeve të tij rast pas rasti është përpjekur që çështjet e Kesh sha të shikohen me një sy analitik, për të qëmtuar dhe propozuar mënyra të reja zgjidhjeje për mjaft çështje. Kjo është parë si mënyrë për të ndihmuar Kesh sha të kuptojë rëndësinë e përmirësimit të këtij shërbimi konform kushteve të reja bashkëkohore që duhet të përmbushë. Por megjithë këtë qëndrim dashamirës dhe bashkepunues nga ana e tyre, kemi vënë re se Kesh sha mban një kurs menaxhimi dhe mardhënie me të tretët mjaft hermetik dhe jo të përgjegjshëm. Këto cilësi negative të këtij drejtimi na kanë vënë shpesh herë në pozitë me qytetaret, kur na është dashur tëju sqarojmë pozicionin tonë në raport me këtë kompani.

Gjithsesi Avokati i Popullit duke e konsideruar çështjen e energjise elektrike një çështje kombëtare, që nuk i perket vetëm Kesh sha, por edhe Kuvendit, Qeverisë dhe organeve të tjera të larta kushtetuese ka prezantuar kudo parimin, sipas të cilit : *“Aksesi në burimet thelbësore të jetesës është një nevojë humane thelbësore dhe për rrjedhim një e drejte elementare për*

tu respektuar. Mungesa e aksesit të plotë në këto burime është një rrezik i madh dhe një goditje e rëndë për dinjitetin njerëzor”.

Ky parim tashmë bie ndesh me rastet e përsëritura të kufizimeve drastike të energjisë elektrike gjatë fund vitit 2006 e në vijim, të cilat na rikujtuan të gjithëve sesa vulnerabël ishin këto qëndrime të Kesh sha dhe se sa i prekshëm është impakti i tyre negativ tek të gjithë shqiptarët.

Sipas Avokatit të Popullit, gjendja e krijuar dhe ende e pazgjidhur e furnizimit të plotë me energji elektrike, ka çenuar shpresën e shqiptareve për të gëzuar lirisht një të drejtë elementare, por njëkohësisht ka rënduar dhe dëmtuar buxhetin e shtetit në mënyrë të pajustificueshme.

Avokati i Popullit ka mendimin gjithashtu kriza dhe problemet e KESH sha janë pasoja të akumuluar në vite, që kanë si faktor të përhershëm interesat e paskrupujt të segmenteve të caktuara shtetërore për të shfrytëzuar në mënyre abuzive entet publike. Por meqenëse kjo përgjegjësi ka mbetur abstrakte, atëhere fokusi do të duhet të drejtohet mbi veprimet dhe mos veprimet e paligjshme dhe të parregullta të KESH sha, të cilat tashmë janë evidentuar.

Avokati i Popullit ka raportuar çdo vit në Kuvend mbi gjendjen e shërbimeve të furnizimit me energji elektrike, duke u shprehur hapur mbi pikat kryesore të këtij sistemi që kërkojnë përmirësim. Por nisur nga kriza e fundvitit 2006, me keqardhje pamë se kërkesave tona të vazhdueshme për daljen e KESH sha nga fenomene të keqmenaxhimit, ju përgjigj një krize energjitike e përsëritur, e cila për shumë arsye besojmë se është derivat i natyrshëm i gjendjes së konstatuar të keqmenaxhimit dhe jo vetëm i thatesirës, apo i mospërmbushjes së rregullt të kontratave të importit me kompani të huaja.

Avokati i Popullit i ka dërguar një informacion të hollësishëm Qeverisë që në Tetor 2005, ku pasqyrohej gjendja reale e shërbimit të furnizimit me energji elektrike në vend dhe parashtroheshin problemet e keqmenaxhimit të KESH sha. Në atë kohë ky dokument përfaqesonte konstatimet e institucionit tonë në këtë fushë, si dhe një ndihmë reale në favor të ekzekutivit të ri, për të njohur dhe analizuar gjendjen menaxhimit të energjise mbi bazën e opinioneve të një institucioni të pavaruar kushtetues.

Por pas më tepër se një viti, ishim të detyruar të konstatojmë se përmbajtja e këtij informacioni vazhdonte të mbetej e njëjtë dhe e pa ndryshueshme, duke njohur madje rëndim të fenomeneve negative.

Këto fenomene të përcjella me hollësi në materialin e lartpërmendur mbi argumentat e mos rritjes së çmimit të energjisë elektrike, ishin dhe vazhdojnë të jenë çështje themelore të daljes së Kesh sha nga kriza. Ne mendojmë se Shqipëria nuk vuan më shumë nga kriza energjitike, sesa nga

nje krizë e brendshme e vetë Kesh sha në mireadministrimin e aseteve dhe shërbimeve që ajo disponon.

Avokati i Popullit ne keto qendrimet dhe ne keto perfundime ka rritur jashte çdo ndikimi politik duke u bazuar teresisht ne argumenta te paanshem dhe objektiv qe jane te prekshem nga te gjithë.

Madje nga ana jonë eshte propozuar se fundi qe ne kushtet e situates se krizes energjitike apo emergjences kombetare dhe thellimit te treguesve te humbjeve jo teknike, KESH sha duhet te trajtohet si ent i stimuluar dhe te vihet perkohesisht nen drejtimin e nje grupi ekspertesh te pavarur, deri ne realizmin e treguesve kryesore dhe daljes nga kriza. (*Profesore Universitetesh, Akademike te fushes*).

Ky propozim ju prezantua Kuvendit të Shqiperise dhe Qeverisë ne 14 Dhjetor 2006 me ane te nje rekomandimi, në të cilin kërkohet midis të tjerash kryerja e një analize të hollesishme për mbarëvatjen e punës të Kompanise KESH sha, duke marre madje masat konkrete administrative dhe disiplinore për zyrtarët përgjegjës.

Avokati i Popullit mbajti këtë qëndrim, duke pare se kriza e fund vitit 2005 ishte ricikluar brenda të njëjtave rrethana dhe simptomatike të ngjashme në vitin 2006. Kjo tregonte se krahas mos përmbushjes së vazhdueshme të treguesve të tjerë të këtij shërbimi, plani menaxherial i kësaj kompanie për vitin 2006 ishte hartuar ose zbatuar me të meta thelbesore dhe jashtë parashikimeve, veprime për të cilat dyshonim që mund të kishin edhe anë subjektive në keq përdorimin me dashje të fondeve publike.

Në këto kushte, ne patëm detyrimin kushtetues dhe të drejtën ligjore të propozonim pranë organeve të mësipërme edhe masa administrative për rehabilitim e situates së krijuar, duke mos shmangur në këtë rast nga përgjegjësia kryesore edhe Drejtorin e Përgjithshëm të KESH sha dhe drejtuesit e tjerë të divizioneve të kësaj kompanie.

Avokati i Popullit nuk besonte dhe nuk beson ende se ndryshimet në drejtimin e menaxhimit të KESH sha do të përmiresojnë menjëherë situatën energjitike në vend. Por çdo ndryshim do të perbejë një mesazh të qartë se çështja e energjisë elektrike është çështje kombëtare dhe nuk mund të gjejë tolerance në çdo aspekt të saj negativ nga ana e Qeverisë.

Si përgjigje e këtij propozimi, Ministri i Ekonomise, Tregtisë dhe Energjistikës parashitri me argumeta pranimin të shumë prej mangësive që ishin konstatuar nga ana e Avokatit te Popullit në punën e Kesh sha. Por qëndrimi i tij dhe i Qeverisë Shqiptare, nuk ka shkuar me larg sesa kaq deri në ditën kur përpilohet ky raport.

Gjithsesi e rëndesishme për ne është fakti se kemi arritur të formulojmë me një bazë të shëndoshe faktesh për parregullsitë e Kesh sha,

pikat e së cilës i kemi ngritur dhe do tëi ngremë në çdo rast kur do te na jepet mundësia. Në këtë qëndrim Avokati i Popullit garanton se është në emërues të përbashket me të gjitha OJF dhe grupet e tjera të interesit në vend, duke përfaqësuar me këtë rast pjesën dërmuese të ankesave të qytetareve.

Si konkluzion përfundimtar për këtë çështje, mund të themi se Avokati i Popullit e konsideron veprimtarinë e Kesh sha njërin nga handikapet më të mëdha me të cilat po ndeshen sot shërbimet publike në vend. Për këtë qëllim vëmendja jone do të vijojë të jetë teresisht e fokusuar mbi këtë çështje, duke dalë në të ardhmen me akoma me shume propozime dhe ide për të përmirësuar këtë situatë sa më shpejt.

10. Ministria e Financave

Numri i ankesave, kërkesave dhe njoftimeve drejtuar Avokatit të Popullit nga shtetas dhe persona juridikë për shkeljen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të tyre nga administrata financiare, ku përfshihen Ministria e Financave, organet doganore, tatim-taksat, INSIG sha dhe Agjensia Kombëtare e Privatizimit për vitin 2006 është 61. Nga ky numër, 19 ankesa i janë adresuar Ministrisë së Financave si institucion, 5 Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, 16 per degët në varësi të saj, 14 i janë adresuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe degëve në varësi të saj, 2 ankesa për INSIG sha dhe 5 ankesa i janë adresuar Agjensisë Kombëtare të Privatizimit. Krahas këtyre ankesave gjatë vitit 2006 janë përfunduar edhe 12 ankesa të mbartura nga viti 2005, nga të cilat 2 kanë qenë të pabazuara, 7 kanë qenë jashtë juridiksioni, 2 kanë qenë jashtë kompetence, një me rekomandim është zgjidhur pozitivisht.

Siç thamë më sipër, për vetë këtë Ministri kemi pasur gjithsej 19 ankesa. Nga këto 3 kanë qenë të pabazuara, 4 kanë rezultuar jashtë juridiksionit të Institucionit të Avokatit të Popullit, 3 janë konsideruar me mungesë kompetence, 1 ankesë është zgjidhur në favor që në fazën e parë të ndërhyrjes dhe verifikimit, 1 ka hequr dorë, dhe 7 ankesa janë zgjidhur në favor pas paraqitjes së rekomandimeve përkatëse nga Avokati i Popullit.

Në lidhje me ankesat e drejtuara këtij institucioni, do të trajtojmë disa prej tyre, të cilat paraqesin problematika të mprehta apo që janë zgjidhur në mënyrë pozitive.

1. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, janë prezantuar një numër i konsiderueshëm ankesash (12 gjithsej brenda një tre mujori), kryesisht nga përgjegjës dhe specialistë të të gjitha Degëve të Thesarit ne

rrethe, për sa i përket urdhërit të Ministrit të Financave për ndërprerjen e marrdhënieve të punës.

Institucioni i Avokatit të Popullit me qëllim nxjerrjen në pah dhe për të përgjithshuar probleme të ndryshme që janë konstatuar gjatë trajtimit të këtyre ankesave, pasi ka komunikuar direkt me përgjegjësit e Degëve të Thesarit në rrethe, Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve pranë Ministrisë së Financave, i ka paraqitur një rekomandim Ministrit të Financave me qëllim korrigjimin e disa praktikave të paligjshme që ndiqen nga Degët e Thesarit në rrethe gjatë zgjidhjes së kontratave të punësimit, ndërprerjes së marrdhënieve të punës dhe emërimit në detyrë të punonjësve të tjerë. Konkretisht ankuesi M.O. ish specialist i Degës së Thesarit në Tropojë ka paraqitur një ankesë, në të cilën sqaronte se pas një vjetërsie pune prej 30 vjetësh, nga të cilat 13 vjet pa ndërprerje në këtë degë, është larguar nga puna me urdhër të Ministrit të Financave “Për ndërprerjen e marrdhënieve të punës” pa motivacion, bazuar në shkresën nr. 976 prot. dt. 10.02.2006, dërguar gjithë specialistëve në shkallë vendi ku njoftoheshin për këtë ndërprerje në kuadër të ristrukturimit të sistemit të thesarit dhe buxhetit. Ndër të tjera citohej se: “... do të trajtoheni me përparësi në bazë të aftësive profesionale të testueshme, për tëu punësuar në degët e thesarit të ristrukturuara”.

Në këtë kontekst dhe me të njëjtat pretendime lista e ankuesve të drejtuar në Institucionin tonë vijon me ankesa të tjera nga Degët e Thesarit në Elbasan, Vlorë, Përmet, Librazhd, Korçë, etj.

Këta qytetarë sqaronin se jo vetëm nuk ishte respektuar asnjë nga procedurat e sipërpërmendura të testimit të punonjësve me qëllim mbrojtjen e vendit të punës, por në vend të tyre ishin marrë persona të tjerë, të pa testuar.

Ministria e Financave në përgjigjen e saj shprehej se: “Me organizimin total të Drejtorive të Ministrisë së Financave është bërë mbyllja e degëve të Buxhetit në rrethe dhe marrja e kompetencave të tyre nga degët e Thesarit në rrethe. Në këtë kuadër, është përcaktuar dhe numri i punonjësve që do të punojnë në këto degë të ristrukturuara tashmë, pra në Degët e Thesarit dhe Buxhetit të marra së bashku. Kjo gjë ka përligjur njoftimet me shkrim të të gjithë specialistëve të thesarit në rrethe, si dhe lirimimin nga detyra të tyre”.

Megjithatë, në vijim të sqarimeve të ardhura nga Ministria e Financave thuhet se pas njoftimit për ndërprerjen e marrdhënieve të punës, rast pas rasti janë konfirmuar ose jo në detyrat e tyre të gjithë specialistët dhe shembulli konkret është rasti i njërit prej ankuesve, konkretisht të M O i

cili është emëruar përsëri në pozicionin e specialistit në Degën e Thesarit Tropojë.

Për Ministrinë e Financave dhe organet e vartësisë së saj, ka patur një numër mjaft të madh ankesash lidhur me shkeljen e të drejtave të njohura nga marrëdhëniet e punës, por rregullisht ne i kemi drejtuar ankuesit në Komisionin e Shërbimit Civil dhe në Gjykatë. Gjithashtu, kjo Ministri ka pasur përgjegjësinë e saj për propozimin e 3 vendimeve me objekt: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.43, datë 27.01.2006 “Për shmangien e nepotizmit dhe ndikimit të pushtetit në rekrutimin dhe karrierën e personelit të administratës tatimore”; nr.44, Vendimi datë 27.01.2006 “Për shmangien e nepotizmit në administratën publike”; Vendimi nr.48, datë 27.01.2006 “Për disa shtesa në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.04.1999 “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, që u shfuqizuan si antikushtetues nga Gjykata Kushtetuese më datë 21.03.2006, me kërkues Avokatin e Popullit, Komitetin Shqiptar të Helsinkit, dhe Grupin Shqiptar për të Drejtat e Njeriut. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, vendosi pezullimin e zbatimit të këtyre Vendimeve të Këshillit të Ministrave, pasi vlerësoi se në rastin konkret, zbatimi i tyre mund të sjellë pasoja që prekin interesat e individëve, të cilat janë të pariparueshme”. Kurse më datën 20.07.2006 Gjykata Kushtetuese dha vendimin e saj përfundimtar, duke shfuqizuar si antikushtetues tre vendimet e mësipërme.

2. Ne vijimësi të ankesave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës, është prezantuar me një tjetër rasti i E.B., ish inspektore ne Drejtorinë e Auditit te Brendshëm në Ministrinë e Financave për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe moszbatimin e vendimit te Komisionit te Sherbimit Civil Nr.52 date 6.02.2006 për rikthim në punë.

Nga verifikimet e bëra për këtë ankese ka rezultuar se ankuesja kishte filluar marrdhëniet e punës ne Drejtorinë e Auditit te Brendshëm në vitin 2001, pasi konkurroi konform kërkesave te ligjit Nr.8549 date 11.11.1999 “Statusi nëpunësit civil”. Pas periudhës një vjeçare te provës në vitin 2002 ishte konfirmuar si nëpunëse civile e shërbimit civil, nga Departamenti i Administratës Publike.

Më datë 4.01.2006 me urdhërin Nr. 19 të Ministrit te Financave, është njoftuar se duhet të largohet nga shërbimi civil me motivacion “*ndryshim i strukturës organike të Ministrisë*”, bazuar në Urdhërin Nr.180 datë 17.11.2005 të Kryeministrit.

Ankuesja duke e konsideruar aktin administrativ të padrejtë, në mbështetje të nenit 5 pika 1, të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”, e ka kundërshtuar pranë Komisionit të Shërbimit Civil.

Komisioni i Shërbimit Civil me vendimin Nr.52 datë 6.02.2006, pas shqyrtimit të çështjes në përfundim ka vendosur: *“shfuqizimin e aktit administrativ Nr.19 datë 4.01.2006 të Ministrit të Financave, si akt i nxjerrë në kapërcim të kompetencave të tij ligjore”, kthimin e ankueses në pozicionin e mëparshëm të punës, pagimin e pagës për gjithë kohën e qëndrimit padrejtesisht pa punë, duke filluar nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare”*.

Ministria e Financave, nga verifikimet tona dhe nga informacioni i ankueses nuk rezultonte që vendimin e mësipërm ta kishte ankimuar dhe për këtë shkak ky vendim konsiderohej i detyrueshëm për t’u zbatuar nga kjo Ministri.

Në përgjigje të kërkesës së zyrës tonë për shpjegime drejtuar Ministrisë së Financave, u informuam se: *“Ndryshimet në strukturën organizative, janë paraprirë nga ndryshime funksionale. Këto ndryshime janë lidhur përkatësisht me përshkrime të reja të punës dhe si pasojë dhe kërkesa të reja të vendit të punës. Kriteret që janë ndjekur për emrat të cilët janë larguar, janë tërësisht mbi baza profesionale dhe që lidhen me cilësinë e punës”*.

Avokati i Popullit duke e konsideruar këtë qëndrim si të padrejtë, ka dale me rekomandim për këtë rast, në të cilin ka shpjeguar se: Urdhëri Nr.19 datë 4.01.2006 i Ministrit të Financave, për largimin nga shërbimi civil të E.B., është mbështetur në ndryshimin e strukturës organike të Ministrisë dhe jo për shkaqe që lidhen me aftësitë profesionale dhe cilësinë e punës së ankueses, sikurse na shpjegohet në përgjigjen që kjo Ministri na ka dërguar sipas shkresës Nr.497/1 datë 31.01.2006, apo me mos përshtatjen me kërkesat e reja të vendit të punës.

Pra sipas kësaj përgjigje nuk ka pasur lidhje motivacioni i urdhërit të largimit të Zj.B, i cili është bërë objekt i shqyrtimit nga KSHC, me arsyetimin që jepet nga kjo Ministri për këtë urdhër. Për këtë rast ekziston një vendim i Komisionit të Shërbimit Civil, të cilin askush nuk mund ta gjykojë apo vleresojë pa ndjekur rrugën ligjore të ankimit në Gjykatën e Apelit, të cilën Ministria e Financave, brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, nuk e kishte ezauruar megjithëse kishte të gjitha mundësitë të provonte dhe argumentonte pretendimet e saj për këtë largim nga shërbimi civil të ankueses.

Gjatë shqyrtimit të çështjes në KSHC nga ana e Ministrisë, nuk është argumentuar dhe nuk është paraqitur asnjë provë që të vërtetonte pa-aftësinë profesionale në detyrë të Zj.B apo cilësinë e punës së saj, sikundër pretendohet në përgjigjen e dërguar lidhur me rastin konkret, dhe aq më pak të provohet fakti i mos plotësimit të kriterëve për vendin e punës, i cili në

shpjegimet e Ministrisë paraqitej si argument për largimin nga shërbimi civil të ankueses. Megjithatë edhe nëse do të pranojmë argumentat e Ministrisë së Financave për ndryshim të përshkrimit të vëndeve të punës dhe kërkesave të reja të vendit të punës, duhet të ishin zbatuar detyrimet e përcaktuara në nenin 24, të ligjit Nr. 8549 datë 11.11.1999 “Statusi i nepunesit civil”, sipas të cilit: “Në rast të ndryshimit të kërkesave për vëndet e punës per shkak të ndryshimit të përshkrimit të punës, nepunësit civil i lihet 6 muaj kohë për t’u përshtatur me kërkesat e reja.... Kur në mbarim të kësaj periudhe konstatohet pa përshtatshmëri me vendin e ri të punës, do të zbatohen dispozitat e nenit 23 pikë 2 të këtij ligjit”, proçedure e cila në rastin në fjalë, nuk rezulton të jetë zbatuar.

Prandaj Institucioni yne i paraqiti një rekomandim Ministrit të Financave, të cilit i kërkoi zbatimin e vendimit të KSHC.

Përgjigja e Ministrisë së Financave për këtë rast, ka qenë antiligjore, duke na informuar se rasti është duke u ndjekur ne Gjykatën e Apelit, pavarësisht se kjo nuk pret aspak te drejtën e ankueses. Për rastin në fjalë Ministria e Financave nuk ka zbatuar akoma vendimin e KSHC, megjithëse me vendimin e datës 12.12.2006 dhe Gjykata e Apelit është shprehur për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Shërbimit Civil lidhur me rikthimin e ankueses në vëndin e mëparshëm të punës dhe dhënien e pages për periudhën nga data e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.

3.Në nje letër drejtuar Avokatit të Popullit, qytetari I.Xh. ka paraqitur një ankesë, lidhur me mos lëvrimin e pagesës së detyruar si ekspert pas raportit të përpiluar në vitin 2001, për vlerësimin e pasurisë së sekuestruar të shoqërisë “Europa sh.p.k.”, në favor të Agjensisë së Trajtimit të Kredive pranë Ministrisë së Financave.

Institucioni i Avokatit të Popullit ju drejtua për shpjegime vetë Agjensisë së Trajtimit te Kredive për rastin në fjalë.

Në përgjigjen e ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme pranë Agjensisë së Trajtimit të Kredive, është sqaruar se në lidhje me raportin e vlerësimit për pasurinë e sekuestruar të shoqërisë “Europa sh.p.k.”, pagesa kundrejt ankuesit ishte shlyer. Nga kontaktet e mëtejshme me ankuesin, ky i fundit na konfirmoi faktin se atij nuk i ishte bërë asnjë pagesë. Në këto kushte ne iëu drejtuam përsëri Agjensisë së Trajtimit të Kredive, ku ndër të tjera i kërkuaam të na dërgonte bashkangjitur çdo lloj dokumentacioni (vërtetimi apo fature të nënshkruar) që vërtetonte shlyerjen e këtij lloj detyrimi.

Drejtoria e Përgjithshme pranë ATK dërgoi në përgjigjen e saj së fundmi këtë vertetim, nga i cili pasqyrohej urdhër pagesa në zyrën e Përmbarrimit të rrethit Tiranë, për rastin në fjalë.

Duke përfunduar, u vu re që data e urdhërit të mësipërm korrespondonte me kërkesën e formular nga ana jonë për herë të dytë, çka lë të nënkuptohet se ATK-ja është vënë në lëvizje vetëm pas kërkesës tone, duke treguar gatishmërinë e saj, qoftë edhe të vonuar kundrejt personit, për tëju pergjigjur detyrimeve të saj ligjore.

4. Në vijim të ankesave përmëndim atë të paraqitur nga shtetasit R.R dhe Z.R., lidhur me mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Shkallës së Parë Tirane në të cilën është vendosur detyrimi i Ministrisë së Financave si dhe Këshillit të Ministrave tëi dëmshpërblejë për pasurinë e përmbytur nga ujëmbledhësi i Bovillës.

Në përgjigje të kërkesës sonë për shpjegime lidhur me këtë ankesë, nga Ministria e Financave theksohej se “Ujëmbledhësi i Bovillës është në vartësi të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, institucion ky i cili ka qenë përgjegjës dhe ka pasur në dispozicion fondet e nevojshme për dëmshperblimin e banorëve të dëmtuar nga ngritja e këtij ujëmbledhësi. Ne bazë të ligjit është ky institucion, i cili në bazë të këtij vendimi duhet të kryejë detyrimin ligjor për ekzekutimin e tij”.

Në kushtet kur vendimi kishte marrë formë të prerë dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimit të mësipërm detyronte Këshillin e Ministrave dhe Ministrinë e Financave të dëmshpërblejnë qytetarin, Institucioni yne ka argumentuar se vendimi i Gjykatës nuk mund të interpretohet duke i kaluar detyrimin Ministrisë së Punëve Publike dhe Telekomunikacionit.

Institucioni i Avokatit të Popullit duke u nisur nga fakti se, të gjitha proceduarat gjyqësore kanë përfunduar, dhe Zyra e Përmbarimit Tiranë në përmbushje të këtij detyrimi ligjor është vënë në lëvizje duke dërguar lajmërim për ekzekutim vullnetar, vendim për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm, si dhe në bazë të nenit 606 të Kodit të Proçedurës Civile ka vendosur masën e gjobës ndaj Drejtoreshës së Përgjithshme të buxhetit Znj.Mimoza Dhemi, kemi kërkuar dhe zbatimin e nenit 142/3 të Kushtetutës nga këto organe. Kështu, duke argumentuar se në asnjë rast vendimet e gjykatave nuk mund e nuk duhet të bëhen objekt i ndonjë shqyrtimi apo vlerësimi nga asnjë organ tjetër shtetëror, kemi rekomanduar marrjen e masave të nevojshme për korrigjimin e qëndrimit dhe vënien në ekzekutim të vendimit gjyqësor të formës së prerë në favor të shtetasve R.R. e Z.R.

Lidhur me rekomandimin e dërguar, nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave u informuam se, nga ana e tyre është kërkuar ndjekja me prioritet përsa i përket ekzekutimit të vendimit të mësipërm. Gjithashtu me anë të kësaj shkrese është përcjellë edhe një kopje e urdhërit të këtij organi për zbatimin e rekomandimit tonë.

Por nga ana e Ministrisë së Financave u informuam se ajo nuk disponon fonde për ekzekutimin e çdo vendimi gjyqësor. Në vazhdimin e mëtejshëm të procedurave, edhe pse nga ana e Ministrisë së Financave nuk është predispozicioni për të shlyer detyrimin përkatës kemi përgatitur një rekomandim tjetër në vijim, lidhur me detyrimin e tyre për zbatimin e vendimit gjyqësor.

5. Gjatë kryerjes së detyrës Kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individëve, Avokati i Popullit nder të tjera është interesuar edhe për plotësimin e akteve nënligjore nga organet e Administratës Publike. Ndër të tjera, Kuvendi i Shqipërisë duke patur si qëllim respektimin e të drejtave të njeriut ka nxjerrë Ligjin nr.9381 datë 28.04.2005 “Për kompesimin e burgimit të padrejtë”.

Në nenin 9, paragrafi 2-të ligjit të mësipërm, konkretisht thuhet se: “Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerrin udhëzime të përbashkëta për strukturat përgjegjëse për formën dhe përmbajtjen e dokumentacionit që paraqitet për ekzekutimin e pagesave të kompesimit për burgim të padrejtë”.

Referuar dispozitës së mësipërme dhe duke konstatuar mungesën e akteve nënligjore, nga ana jonë ju kërkuan shpjegime dy ministrive përkatëse. Nga korrespondenca me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Drejtësisë, kjo e fundit konfirmoi faktin se ishte në fazën e studimit e përgatitjes së akteve nënligjore me një grup të përbashkët pune me Ministrinë e Financës.

Pra, ndonëse kishte kaluar rreth 1 vit, nga ana e dy ministrive nuk ishte vepruar për nxjerrjen e udhëzimit të përbashkët, duke shkelur afatin 3-mujor, brenda të cilit ato ishin të detyruara të nxirnin udhëzimin e përbashkët. Në këto kushte, ne i kemi rekomanduar Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Drejtësisë përshejtimin e procedurave për nxjerrjen e akteve nënligjore, në përputhje me kërkesat e nenit 9/2 të Ligjit nr.9381 datë 28.04.2005 “Për kompesimin e burgimit të padrejtë”.

Në përgjigjen ardhur nga këto Institucione, është konfirmuar pranimi i argumentave të sjella në vëmendje nga Institucioni ynë. Grupi i përbashkët i punës përgatiti udhëzimin e përbashkët për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që njohin dhe kompesojnë burgimin e padrejtë. Në këtë mënyrë Institucioni ynë ndikoi pozitivisht për të plotësuar një boshllëk ligjor, i cili pengonte kompesimin e personave të burgosur padrejtësisht.

a. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Degët në varësi të saj

Për organin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve më vete, kemi pasur gjithsej 5 ankesa. Nga këto 4 janë konsideruar jashtë juridiksionit, ndërkohë që 1 ankesë është konsideruar e pabazuar.

Për degët e organeve tatimore në rrethe kanë ankuar tek ne gjithsej 16 ankesa, nga të cilat 4 kanë qenë të pabazuara, 6 ankesa kanë rezultuar jashtë juridiksionit, 2 ankesa janë konsideruar jashtë kompetence, 2 ankesa janë zgjidhur në favor të ankuesve dhe për 1 ankesë nuk është pranuar rekomandimi i paraqitur prej Institucionit të Avokatit të Popullit.

Më hollësisht paraqiten 2 raste drejtuar këtyre organeve, nga të cilat njëra është zgjidhur pozitivisht dhe e dyta nuk është pranuar nga organi tatimor në rreth, megjithë argumentat e paraqitur në rekomandimin tonë.

1. Një qytetar nga Shkodra, L N, ankohej se 2 policë tatimorë të rrethit Tirane padrejtësisht i kishin bllokuar lejen e qarkullimit të automjetit me targë Sh3213D që në vitin 2004, duke pretenduar se subjekti ushtron aktivitetet i pa pajisur me çertifikatë tatimore. Kjo gjë kundërshtohej nga ankuesi, i cili na kishte sjelle dhe çertifikatën me të cilën e kishte pajisur dega e tatim-taksave në Shkodër, çertifikatë e cila në kohën e bllokimit të mjetit kishte qenë e vlefshme.

Në vijim, meqenëse qytetari kishte 2 vjet i bllokuar nga këta persona që nën fuqinë e ligjit abuzonin me besimin e tij, i është drejtuar Avokatit të Popullit për të ndërmjetësuar për të marrë lejen e mjetit të tij, të bllokuar padrejtësisht nga policët tatimorë të quajtur: S. Kosto dhe B. Seferi.

Avokati i Popullit i është drejtuar me kërkesën për shpjegime dhe ka marrë kontakte direkte me Policinë Tatimore të rrethit Tiranë, duke kërkuar ndërmjet të tjerash kthimin e lejes së qarkullimit të këtij qytetari, dhe ndëshkimin e dy policëve tatimorë nëse pretendimet e mësipërme qëndronin.

Në përfundim të shqyrtimit të këtij rasti dhe nga përgjigja e marrë nga organi tatimor në rreth, ankuesit ju kthye leja e qarkullimit. Megjithatë për oficerët tatimorë nuk u mor asnjë masë, pasi njëri prej tyre nuk rezultonte më në marrdhënie pune, kurse tjetri nuk jetonte më.

2. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, është paraqitur një ankesë lidhur me çrregjistrimin e një personi juridik, të deklaruar të tillë me vendim të Gjykatës së rrethit Tiranë qysh në muajin shtator të vitit 2005.

Konkretisht administratori i shoqërisë, kishte depozituar prej mëse 6 muajsh pranë Degës së Tatim-Taksave Tirane kërkesën për çrregjistrimin në fjalë bashkalidhur, me vendimin e Gjykatës. Por Dega e Tatim-Taksave Tiranë, vazhdonte të shtypte padrejtësisht formularët e TVSH-së, TAP-it dhe

Sigurimeve Shoqërore e Shendetësore, në emër të personit juridik, edhe për vitin 2006.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi ka kërkuar shpjegime nga Drejtori i Degës së Tatim-Taksave Tiranë, dhe pas një analize të dokumentacionit të paraqitur doli me rekomandimin përkatës drejtuar Degës së Tatim-Taksave Tiranë, ku ndër të tjera rekomandoi: Çrregjistrimin e menjëhershëm të kësaj shoqërie nga dega e Tatim-Taksave Tiranë, bazuar në vendimin e gjykatës së rrethit Tiranë. Zyra jonë ka argumentuar se: “Tatimpaguesit që kanë vendosur të mbyllin veprimtarinë e tyre (pra te çrregjistrohen), kërkojnë nga gjykata ku kanë marrë të drejtën për të ushtruar veprimtari, të marre vendimin përkatës të mbylljes së veprimtarisë. Gjykata njofton organin tatimor të rrethit përkatës për kerkesën e tatimpaguesit. Organi tatimor, kur tatimpaguesi nuk ka paguar të gjitha detyrimet tatimore brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit nga gjykata paraqet kundërshtimin për çrregjistrimin e tatimpaguesit. Kur organi tatimor e paraqet kundërshtimin përkatës brenda 30 ditëve, gjykata nuk mund të marrë vendim për çrregjistrimin e tatimpaguesit. Këtë vendim ajo mund ta marrë vetëm pasi organi tatimor i rrethit përkatës, ka tërhequr kundërshtimin dhe ka konfirmuar me shkrim se tatimpaguesi që kërkon mbylljen e veprimtarisë ka rregulluar situatën dhe nuk ka detyrime tatimore të papaguara”.

Për këtë ankues (subjekt tregëtar), Dega e Tatim-Taksave Tiranë kishte dërguar një herë vërtetimin për pagim të plotë të të gjitha detyrimeve për vitin 2005 nga Shoqëria në fjalë, gjë që i ka dhënë të drejtën Gjykatës së rrethit Tiranë për çrregjistrimin e shoqërisë së interesuar për këtë problem.

Në përgjigjen e saj, Dega e Tatim-Taksave Tiranë ka pretenduar se Shoqëria ka dorëzuar vendimin e çrregjistrimit të saj me vendim gjykate, katër muaj pas marrjes së këtij vendimi. Nga komunikimi i drejtpërdrejt me një nga inspektoret e kësaj dege, për të parë mundësinë e zgjidhjes së kësaj çështjeje, përsëri është pretenduar për detyrime të pashlyera nga ana e shoqërisë, për shkak të dorëzimit me vonesë të formularëve në bankë, megjithëse personi juridik ishte çrregjistruar prej kohësh me vendim gjykate.

Në këto kushte, Institucioni i Avokatit të Popullit duke parë burokracinë dhe zvarritjet e pafundme të bëra nga kjo degë tatimore për këtë biznes, ka orientuar administratorin e firmës të ushtronte të drejtën e ankimit pranë Drejtorisë së Pergjithëshme të Tatimeve, dhe në vijim në Gjykatën e Tiranës për shkeljen e kërkesave të Ligjit nr. 8560 datë 22.12.1999 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Degët në varësi të saj

Për këtë organ së bashku me degët e rretheve kemi patur gjithsej 14 ankesa. Nga këto, 4 janë ende në shqyrtim, 5 janë konsideruar jashtë juridiksionit, 2 kanë rezultuar jashtë kompetence, 2 ankesa janë zgjidhur në favor të ankuesve, 1 ka përfunduar me rekomandim.

Ankesat që janë ende në shqyrtim që nga viti 2006 në fushën doganore, kryesisht prezantojnë si objekt të tyre kundërshtime të urdhërave të Drejtorisë së Përgjithëshme të Doganave për lirime nga detyra të punonjësve. Ankuesit disponojnë vendime të Komisionit të Shërbimit Civil dhe vendime të formës së prerë të Gjykatës së Apelit për rikthim në vendin e mëparshëm të punës, por ato nuk janë zbatuar.

1. Ankuesi me inicialet A. B. ka parashtruar ankesën e tij lidhur me mosekzekutimin e Vendimit të Komisionit të Shërbimit Civil nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Për këtë problem, kemi dërguar Rekomandim drejtuar Drejtorisë së Përgjithëshme të Doganave, ku kërkohej ekzekutimi i Vendimit të Komisionit të Shërbimit, për rikthimin në detyrë në vendin e mëparshëm dhe pagimin e pagës për kohën e qëndrimit pa punë të ankuesit të mësipërm.

Në përgjigje të Rekomandimit tonë nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, u pretendua se kjo çështje po ndiqet gjyqësisht dhe në përputhje me vendimin që do të merret nga gjykata, do t'i jepet zgjidhje përfundimtare kërkesës së ankuesit A.B.

Përsa më sipër, në vazhdim të procedurave gjyqësore, ankuesi A.B. na ka bërë të ditur se me Vendimin Nr.18, dt.21.03.2006, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së Drejtorisë së Përgjithëshme të Doganave për rivendosjen në afat të padisë, pra ka lënë në fuqi Vendimin Nr.226 dt.23.12.2005 të Komisionit të Shërbimit Civil.

Duke vazhduar më tej, ankuesi ka bërë kërkesë për nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit dhe me Vendimin Nr.31 dt.06.04.2006, Gjykata e Apelit Tiranë ka nxjerrë Urdhërin e Ekzekutimit. Megjithë plotësimin e praktikës nga pikëpamja ligjore, nga ana e Drejtorisë së Përgjithëshme të Doganave vazhdonte të mbahet qëndrim refuzues, duke mos zbatuar vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Apelit Tiranë si dhe Vendimin e Komisionit të Shërbimit Civil.

Në kushte të tilla kur Avokati i Popullit ka mendimin e palëkundur se nga ana e Organit të mësipërm, po vepron në kundërshtim flagrant me ligjin dhe për pasojë vazhdonte të shkelej në mënyrë të pandërprerë e drejta themelore e shtetasit e fituar edhe në rrugë gjyqësore, kemi përsëritur

rekomandimin drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave dhe për dijeni Ministrit të Financave, duke sugjeruar edhe një herë të merrej në konsideratë Rekomandimi ynë i mëparshëm.

Në këtë rekomandim kemi theksuar mungesën e argumentave ligjorë nga ana e Drejtorisë së Përgjithëshme të Doganave, si dhe shkelje të nenit 142/3 të Kushtetutës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Organet e Shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”, të nenit 8, pika 3 e Ligjit Nr.8549 dt.11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil” në të cilin thuhet se: “Cdo drejtues i institucioneve të administratës publike duhet të ketë të qartë se vendimet e Komisionit të Shërbimit Civil janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë institucionet e Administratës Publike Qendrore dhe Vendore”.

Për sa më sipër, jemi ende në pritje të një qëndrimi zyrtar të Drejtorisë së Përgjithëshme të Doganave, si dhe Ministrit të Financave, lidhur me ekzekutimin e vendimeve.

2. N vijim të ankesave të paraqitura pranë Institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, ankuesi F.K. ish punonjës në Zyren e Financës në Sektorin e Borxhit, në Degen të Doganës Durrës, kategoria C 2, paraqiti shqetësimin e tij lidhur me ndërprerjen e pa motivuar të marrëdhënieve të punës dhe më tej me moszbatimin e vendimit të Komisionit të Shërbimit Civil Nr.376 datë 18.05.2006.

Në objektin e kësaj ankese sqaroheshim se, pasi ankuesi i ishte nënshtruar konkursit në tetor të vitit 1997, kishte filluar marrëdhëniet e punës më 15.01.1998 në Doganën e Durrësit kategoria C2, që sipas VKM Nr.686 datë 2.11.2005, i pergjigjej klasifikimit nëpunës civil i nivelit ekzekutues. Aktualisht prej dy vjetësh punonte në Zyrën e Financës, Sektori i Borxhit. Në vijim, ankuesi parashkonte se i ishin ndërprerë marrëdhëniet e punës, sipas vendimit Nr.1355/30 datë 8.03.2006, vendim i cili kundërshtojte si i padrejtë dhe i pabazuar, sepse urdhëri mbi të cilin ishte bazuar nuk ishte kuptuar drejt nga Administrata Doganore, pasi në këtë rast nuk kishte asnjë konflikt interesi.

Sipas Ligjit Nr.9367 datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave për zyrtarin e organit doganor-tatimor”, neni 31, 32 nuk mund të zotëronte në mënyrë aktive asnjë aksion ose pjesë të kapitalit në shoqëri tregtare, që kryejnë veprimtari import-eksport. Ndërsa neni 18 Kreu VI i VKM Nr.680 datë 2.11.2005, përcaktonte shkeljet dhe jo konfliktin e interesave, gjë për të cilat ankuesi pretendonte se, në asnjë rast dhe në asnjë periudhë kohore, nuk kishte kryer shkelje.

Nga ana e Drejtorit të Administrimit, Trajtim Personelit ankuesi ishte sqaruar se kishte konflikt interesi pasi ai- gruaja e tij ishte farmacistë, fakt të cilin ai e kontestonte me dokumenta shkresore, sepse ajo vetëm ishte e

punësuar dhe b- pasi ankuesi kishte qenë punonjës i një agjensie doganore, të cilën përsëri ai e konsideronte fakt të pa vërtetë, sepse me dokumenta shkresore ishte e provuar, se nuk ishte i punësuar në këtë agjensi.

Për nevojat e shqyrtimit të kësaj ankese kërkuam një shpjegim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe pas përgjigjes së saj vlerësuam se ndaj ankuesit ishin kryer veprime të padrejta dhe të parregullta. Për këtë arsye i rekomanduam kësaj Drejtorie, të merrte të gjitha masat e nevojshme për të rivendosur në vend të drejtën e shkelur të qytetarit. Qëndrimi i Drejtorisë së Doganave kundrejt këtij rasti, u konsiderua i padrejtë dhe i pa bazuar në ligj. Kjo për faktin se motivacioni i vendimit të largimit nga puna të ankuesit (për shmangien e konfliktit të interesave në Administratën Doganore) ishte çështje provash dhe faktesh, lehtësisht të kontrollueshme dhe e provueshme, procedurë e cila ndiqej paraprakisht nga Komiteti Disiplinor. Në këto kushte, vlerësuam se në këtë rast nga strukturat doganore, nuk ishte vepruar aspak në mënyrë ligjore.

Në përgjigje të këtij rekomandimi u informuam se çështja e personit ishte duke u shqyrtuar në rrugë gjyqësore dhe për këtë arsye në rrugë administrative konsiderohej e përfunduar, duke e lënë në çmim të gjykatës vlerësimin nëse qytetari F.K. kishte të drejtë në kërkesat e tij apo jo.

3. Në ankesën e paraqitur nga ana e administratorit të Shoqërisë “X” sh.p.k prezantohej problemi lidhur me bllokimin e mallit të shoqërisë me datë 23.03.2006 nga Dega e Doganës Durrës me arsyetimin se shoqëria konsiderohej debitor kundrejt Degës Durrës për shumën 3.186.314 Leke, megjithëse ankuesi pretendonte se detyrimi ishte shlyer kohë më parë.

I ndodhur në kushte të vështira me pasoja të rënda ekonomike për shkak të mallit që ndodhej i bllokuar dhe urgjences që kërkohej për zhbllokimin e tij, Avokati i Popullit kreu ndërhyrjet përkatëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për këtë problem.

Nga verifikimet tona rezultoi se, vonesat e zhbllokimit të mallit që importohej nga personi juridik nga jashtë kishin ndodhur për efekt se detyrimi që mbartej kundrejt degës së doganës Durrës ishte arkëtuar në një degë banke ku Dega e doganës Durrës nuk ekzistonte si klient dhe për pasojë nuk ka figuruar i shlyer detyrimi. Megjithatë në përfundim pas një verifikimi të plotë edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, çështja është sqaruar dhe është zgjidhur në favor të ankuesit tashmë, me rezultat zhdoganimin e mallit të bllokuar.

c. Ish-Agjensia Kombëtare e Privatizimit

Për vitin 2006 ka patur 5 ankesa ndaj ish-Agjisë Kombëtare të Privatizimit, të cilat janë përfunduar të gjitha. Nga keto 2 janë konsideruar jashtë juridiksionit, 2 jashtë kompetence dhe 1 është zgjidhur në favor të ankuesit.

Lidhur me këtë Agjensi sqarohet se nuk ekziston më, duke përfshirë dhe Degët në rrethë. Në vijim ky organ është kthyer provizorisht deri në një ri-organizim përfundimtar të tij, në Drejtori të Administrimit dhe Shitjeve të pronës publike pranë Ministrisë së Financave.

Për sa u përket ankesave jashtë kompetence dhe jashtë juridiksionit, ankuesve u është dhënë orientim i plotë për rrugën ligjore që duhet të ndjekin për realizimin e kërkesave të paraqitura në objektin e ankesave.

Ankesat e evidentuara të këtij viti, kishin të bënin me objekte të shitura në më shumë se një persona, të cilët e konsiderojnë veten pronarë të ligjshëm, por njëkohësisht të mbetur pa pronë në posedim, si dhe pa marrë vleftën e parave që kishin dhënë një herë në AKP për blerjen e pronës.

Në një nga rastet e evidentuara, ekzistonte dhe vendim gjykate që detyronte AKP për kthimin e shumës që ishte dhënë për blerjen e objektit. Mosekzekutimi i vendimit gjyqësorë ku palë debitore është AKP-ja justifikohet me pretendimin se Agjensia nuk ekziston më, dhe pritet një ri-organizim përfundimtar i saj.

Për sa më sipër mendojmë, se është në kundërshtim me ligjin që Ministria e Financave nuk zbaton një vendim gjyqësor të formës së prerë, pavarësisht mos-organizimit të Ish-Agjisë Kombëtare të Privatizimit në një organ tjetër me kompetenca të plota për tëju përgjigjur detyrimeve të njohura me ligj, pasi përsëri organi që do ngrihet do jetë në vartësi të Ministrisë së Financave. Avokati i Popullit edhe në të ardhmen do të synojë të evidentojë dhe ndërhyjë për shkelje të administratës publike financiare si dhe do të synojë përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor financiar.

Si konkluzion mund të themi se përgjithësisht krahasuar me vitin 2005, bashkëpunimi ynë me organet financiare dhe kryesisht nga ato doganore është në nivel të kënaqshëm për sa i përket respektimit të detyrimit të tyre ligjor për dhënie të shpjegimeve dhe informacioneve Institucionit të Avokatit të Popullit.

11. Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Zhvillimet ne kete fushe te administrates publike, gjatë vitit 2006 kane qene te lidhura ngushte me reformen ne arsim, te bazuar ne konceptimin e saj nga ana e Qeverise me vizionin per nje model edukimi te vazhdueshem, duke filluar qe ne moshen parashkollore dhe qe vazhdon gjithe jeten. Keto reforma ne sistemin e arsimit jane konceptuar dhe kane filluar tashme zbatimin e tyre ne disa elemente qe kane te bejne me, reformen e plote te curriculave mesimore, rishikimit dhe ngritjes se pages se arsimtareve duke vendosur statusin e mesuesit si pike reference per gjithe aktoret e domosdoshem ne kete proces, permiresimin rrenjesor te kushteve te shkollimit, kompjuterizimi dhe lidhja ne internet e çdo shkolle. Per arsimin e larte kjo reforme eshte konceptuar ne masivizimin e dijes universitare, duke nxitur e hapur dyert e shkollave te larta publike, pas Maturës shtetërore, permiresimin dhe plotesimin e autonomise se universiteteve publike, reformimin universitar ne perputhje me parimet e objektivat e procesit te Bolonjes etj.

Keto hapa te reja ne fushen e arsimit, sigurisht qe jane shoqeruar me nje problematike konkrete te pasqyruar ne çeshtjet e shqyrtuara nga ana e Institucionit tone.

Keshtu, gjate vitit 2006 ka patur 76 ankesa apo kërkesa të ardhura ndaj Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe institucioneve në vartësi të saj. Janë në fazën e shqyrtimit pranë Zyrës sonë 10 ankesa. Në favor janë zgjidhur 13 ankesa apo kërkesa, kanë qenë jashtë juridiksionit dhe kompetences 12 ankesa, të pabazuara kanë qenë 40 ankesa dhe për 1 çështje rekomandimi dërguar organit përkatës është refuzuar. Ndërsa nga viti 2005 janë mbartur për shqyrtim 14 ankesa, nga të cilat 7 janë zgjidhur në favor, 3 jashtë juridiksionit dhe kompetencës dhe 3 të pabazuara.

Një numër jo i vogel ankesash kanë patur si objekt probleme qe lidhen me marredhenien e punesimit ne sektorin e arsimit, duke filluar qe nga problemi i pageses, shperblimeve, trajtimeve te veçanta, apo edhe i largimeve nga puna të mësuesve. Gjithashtu ka patur ankesa në të cilat është pretenduar zvarritje e procedurave për ekuivalentimin e diplomave të individeve të cilët kanë mbaruar studimet jashtë vendit, diskriminim dhe shkelje të ligjeve dhe akteve nënligjore në procedurën e marrjes në punë të stafit akademik nga ana e organeve drejtuese të fakulteteve etj.

Strategjia kombetare per femijet 2005-2010, e miratuar me VKM nr.368 date 31.05.2005, ka nxjerre si perparasi ne fushen e arsimit 9 vjeçar permiresimin e kushteve fizike te godinave, duke zbatuar standarte bashkekohore te ndertimit dhe mirembajtjes se tyre. Ky synim i pasqyruar ne

objektivin për rikonstruksionin dhe rehabilitimin e godinave të shkollave perkatese, është një ndër angazhimet dhe detyrimet që i ngarkohen si organeve të qeverisjes vendore, ashtu edhe Ministrise së Arsimit dhe Shkences. Me konkretisht në objektivat 9 dhe 11 të planit të veprimit të kësaj strategjie, parashikohet rikonstruksioni i 250 shkollave në vit. Megjithatë, nisur nga çështjet e filluara me inisiativë nga ana e Institucionit të cilat lidhen me realizimin e objektivave të sipercituara të planit të veprimit, rezulton se sidomos në zonat rurale të thella, nuk janë kryer apo parashikuar në masën e mjaftueshme rehabilitime apo rikonstruksione objektesh shkollorë. Kjo gjë është pasqyruar në kërkesat që strukturat rajonale të Ministrise së Arsimit dhe Shkences apo edhe njesitë perkatese vendore, i kanë drejtuar kësaj ministrie gjatë kësaj kohe.

Problematika të tjera të evidentuara nga çështjet e shqyrtuara gjatë këtij viti, kanë të bëjnë me ushtrimin e kompetencave që i njihen me ligj Ministrisë së Arsimit dhe Shkences. I tillë është rasti i një ankese që lidhet me veprimtarinë e Qendres Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, ku akti bazë për rregullimin e veprimtarisë së kësaj qendre konceptohet në këtë rast nga ana e Ministrisë me nxjerrjen e një akti administrativ të emertuar “Statut”, ndërkohe që VKM-ja nr.70 datë 15.02.2001 “Për statusin e spitaleve universitare”, i ndryshuar, autorizon vetëm nxjerrje rregulloreje dhe udhëzimesh.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë i njeh *Ministrinë* si organ i administratës publike, të drejtën për të nxjerrë vetëm *urdhera* dhe *udhëzime* (neni 102, pikë 4 të Kushtetutës), brenda fushës së kompetencave të tij. Kurse në nenin 118/1 të Kushtetutës, parashikohet se: “*Aktet nenligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë*”. Kurse në nenin 119 të Kushtetutës, akte nenligjore që mund të nxirren nga Ministri titullohen, *rregulloret apo urdherat me karakter të brendshëm dhe që janë të detyrueshme vetëm për njesitë administrative që varen prej tyre*. Sipas ketyre percaktimeve, Statuti nuk mund të njihet si akt administrativ që nxirret nga ana e Ministrisë, apo si akt që është në kompetencën e tij. Në këtë llogjikë, Statuti si akt administrativ në këtë rast, nuk është në pajtim me kompetencat kushtetuese të Ministrisë. Për këtë çështje kemi shkruar edhe në pjesën që ben fjale për Ministrinë e Shëndetësisë

Ankesat e trajtuara, kanë nxjerrë në pah një sërë problemesh të tjera, të cilat kërkojnë përmirësim të punës dhe reagim të organeve përgjegjëse. Duhet theksuar se ndërkohe, ende vazhdojnë të mbeten pa zgjidhje disa çështje të cilat janë trajtuar nga ana e tyre dhe për të cilat janë drejtuar rekomandime perkatese. Për këtë po përmendim dy nga çështjet, të cilat

kane qene pjese e raportit te vitit 2005, por qe ende nuk kane gjetur zgjidhje perfundimtare.

- Ankuesja K.L. është ankuar lidhur me dy vendimet e nxjerra nga ana e Dekanit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, konkretisht akti me objekt *“Vërejtje e rëndë me paralajmërim për përjashtim nga puna për mosparaqitje në punë në datat 02.04.2005 dhe 04.04.2005 dhe largim jashtë shtetit pa lejen e titullarit të fakultetit”* dhe Vendimin me objekt *“Lirimin e Znj.K.L. nga detyra e Përgjegjëses së Departamentit të Gjuhes frenge”*. Ajo ngre pretendimin se keto vendime janë të pabazuar në ligj, dhe në vendimmarrjen e Dekanit ankueses i është shkelur e drejta për të marrë pjese dhe për t’u dëgjuar para nxjerrjes përfundimtare të akteve të mësipërme.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes kemi arritur në konkluzionin se nga aktet administrative të nxjerra ndaj ankueses, kësaj të fundit i janë shkelur të drejtat e njohura nga Kushtetuta dhe ligjet, konkretisht neni 42 i Kushtetutes dhe neni 47 e 93 i Kodit të Proçedurave Administrative.

Konstatohet se proçesi administrativ, si nga ana e Departamentit dhe nga ana e Dekanit, nuk është zhvilluar në termat e një proçesi administrativ të rregullt dhe sipas proçedurave ligjore, pasi eshte shkelur e drejta për t’u dëgjuar. Ne keto kushte kemi rekomanduar revokimin e akteve e sipërpërmendura, por nga ana e Dekanit, nuk eshte pranuar.

Në përfundim, duke i gjetur të pabazuara pretendimet e parashtruara nga ana e Dekanit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, i jemi drejtuar Ministrit të Arsimit ku i kemi kërkuar, vënien në vend të të drejtës së shkelur të ankueses, duke urdhëruar shfuqizimin e masës disiplinore si dhe të kthimit për rishqyrtim të vendimit të lirit nga detyra e përgjegjëses së Departamentit, për të zbatuar proçedurat ligjore. Rezulton që ende nuk kemi një përgjigje zyrtare lidhur me këtë rekomandim.

- Çështja tjetër ka te beje me nje çeshtje te ndjekur me inciative, nisur nga fakti se ne mediat elektronike dhe ato te shkruara, eshte bere disa here prezent si nje problem shume shqetesues, mos sistemimi ne dhoma i studenteve te cilet rregjistrohen ne vitin e pare ne shkolle te larte, ne qytetin Studenti.Te ndjeshem nga situata e krijuar, me qellimin per te vene ne levizje strukturat shteterore, per permiresimin e kushteve te studenteve dhe perdorimin 100% te kapaciteteve te cilat jane te caktuara per trajtimin e tyre, Institucioni i Avokatit te Popullit ndermori me inisiative nje proçes hetimi.

Ne përfundim te ketij proçesi, rezultoi se, nisur nga kuotat e miratuara me Vendim te Keshillit te Ministrave, te cilat pesuan rritje te ndjeshme ne raport me vitin e kaluar, problemi u paraqit shqetesues per faktin e rendesishem te zenies se disa prej godinave te cilat jane ne administrim te Ndermarrjeve te Trajtimit te studenteve Nr.1 dhe Nr.3 Tirane , nga ana e

personave te cilet kane ardhur nga zona te ndryshme te vendit dhe nuk kane asnje lidhje me Universitetet.

Nga informacioni i cili na u vu ne dispozicion, Ndermarrja e Trajtimit te Studenteve 1, ku perfshihet Qyteti Studenti, pranon studente nga 57 Fakultete te 3 Universiteteve te Tiranes. Kapaciteti aktual i kesaj ndermarrje eshte 6800 studente. Konkretisht jane zene me familjare 4 godina 15a dhe b, 18 dhe 19, nga 232 familje.

Ne rast se keto godina do te ishin te lira, do t'i krijonin mundesi akomodimi edhe 1000 studenteve dhe do te zgjidhte perfundimisht problemin e strehimit te studenteve apo do t'i krijonin kushte me te mira akomodimi studenteve duke caktuar jo me 3 apo 4 persona ne nje dhome, por me pak.

Ndersa persa i perket informacionit te marre nga ana e Ndermarrjes se Trajtimit te Studenteve nr.3, rezulton se kjo e fundit ka ne perdorim gjithsej 10 godina, 8 prej te cilave jane zene forcerisht nga ana e banoreve te ardhur qe ne vitin 1997. Ne keto godina jane 486 familje te cilat nuk kane lidhur asnjehere asnje kontrate qeraje me ndermarrjen dhe nuk kane shlyer asnjehere detyrimin e tyre ndaj KESH-it dhe Ndermarrjes se Ujesjelles Kanalizimeve per perdorimin e energjise elektrike dhe te ujit.

Nga verifikimi rezulton gjithashtu se nga ana e kesaj Drejtorie jane zhvilluar procese gjyqesore per lirimin e banesave per 100 familje, nderkohe qe per te tjerat nuk eshte ndermarre asnje veprim. Pavaresisht se tashme ekzistojne vendimet e formes se prere dhe per te cilat, megjithese jane leshuar urdhrat e ekzekutimit, ato ende nuk jane ekzekutuar nga ana e Zyres se Permbarrimit Tirane.

Sa me siper, referuar fakteve dhe situates se parashtruar del si domosdoshmeri qe nga ana e Ndermarrjes se Trajtimit te Studenteve nr.1 dhe nr.3 te kryhen te gjitha procedurat ligjore per lirimin e ambienteve te zena nga ana e familjeve te cilet rezultojne tashme pa kontrate.

Duke qene se keto ndermarrje jane shoqeri anonime, Institucioni i Avokatit te Popullit ka derguar rekomandim duke parashikuar domosdoshmerine qe Keshilli Mbikqyres te nxjerri vendime me objekt lirimin e ambienteve te zena nga familjet, te cilat nuk kane asnje kontrate, duke i caktuar nje afat te arsyeshem per lirimin e tyre. Lidhur me ceshtjen, i jane derguar rekomandime ne te njejten kohe Ministrit te Arsimit dhe Zyres se Permbarrimit Tirane.

Rezulton qe ky problem ende eshte aktual, pasi nuk nderhyhet megjithese cilesohet ate si nje problem mjaft emergjent, ne kushtet e reformes se qeverise ne drejtim te liberalizimit te arsimit te larte. Mendimi

yne eshte se, Ministria e Arsimit dhe Shkences nuk guxon te perballlet me problemin dhe te zbatoje ligjin.

Nje hap pozitiv gjate vitit 2006 eshte bere me pergatitjen e projekt-ligjit “Per arsimin e larte ne Republiken e Shqiperise”, i cili ka kaluar ne nje diskutim te gjere me te gjitha grupet e interesit.

Megjithate, gjykojme se ende dhe pavaresisht perpjekjeve per permiresimin e legjislacionit ne kete fushe, nuk jane identifikuar dhe konceptuar korrektesisht probleme qe lidhen me pranimin e kandidateve per studente ne shkollat e larte publike, apo edhe me kritere te tjera qe lidhen me ndjekjen normale te procesit te mesimit ne sistemin e arsimit 9 vjeçar dhe atij te mesem publik.

Si ne ligjin aktual ne fuqi per arsimin e larte, ashtu edhe ne projekt-ligjin e pergatitur, nuk gjen percaktime konkrete ne lidhje me kuptimin dhe aplikimin e konceptit te laicitetit ne procesin teresor akademik te shkollave te larta publike. Praktikës se meparshme qe Institucioni yne ka patur me çeshtje qe lidhen me kete problematike, gjate vitit 2006 i eshte shtuar nje ankese e paraqitur nga shtetesja B.H, studente ne Universitetin “Aleksander Moisiu”, Durres.

Konkretisht shtetesja B.H eshte pezulluar per ndjekjen e procesit te mesimit nga ana e Rektorit te Universitetit “Aleksander Moisiu”, Durres, per shkakun se paraqitej ne ambientet e universitetit me veshje tipike te nje femre te besimit musliman dhe me floke te mbuluara me shami.

Pa dashur te ndalemi ne detaje, gje qe do te jepet ne pershkrimin e ketij rasti ne vijim, theksojme se sipas shpjegimeve te dhena prej Rektorit te ketij universiteti, “Rregullorja” e prezantuar si e tille dhe e hartuar nga rektoriati i Universitetit “Aleksander Moisiu”, Durres, ka sherbyer ne kete rast si baze ligjore per pezullimin e bere ndaj ankueses per ndjekjen e procesit te mesimit.

Pas nje analize teresore te trajtimit te rastit nga ana jone, si ne aspektin e ngushte te marredhenies administrative ndermjet paleve por dhe me gjere, eshte arritur ne konkluzionin se efektivisht problemi me i madh ne kete çeshtje qendronte ne konceptimin qe behet ne kete rast nga ana e Rektoratit te Universitetit “A.Moisiu”, Durres, ne lidhje me rregullimin e çeshtjeve sikurse ai i veshjes se ankueses.

Fakti eshte se ne nenin 10 te Kushtetutes parashihet se shteti eshte asnjanyes ne çeshtjet e besimit e te ndergjegjes dhe garanton lirine e shprehjes se tyre ne jeten publike. Edhe ne nenin 24 te Kushtetutes percaktohet se secili eshte i lire te zgjedhe, ose te ndryshoje fene, ose bindjet, si dhe t’i shfaqe ato individualisht ose kolektivisht, ne publik ose ne jeten private, nepermjet kultit, arsimimit, *praktikave ose kryerjes se riteve*.

Ne morine e akteve nderkombetare, mund te permendet neni 18 i Deklarates Universale te Drejtave te Njeriut ku thuhet se: “Çdo njeri ka te drejten e lirise se mendimit, te ndergjegjes dhe te fese. Kjo e drejte nenkupton lirine per te ndryshuar fene ose bindjet, vetem per vetem apo bashkarisht si ne publik ashtu edhe privatisht, nepermjet arsimimit, praktikave, kultit dhe kryerjes se riteve”, neni 9 i Konventes Europiane per te Drejtat e Njeriut, Konventen per Luften kunder diskriminimit ne Fushen e Arsimimit, nenin 26 te Konventes Nderkombetare per te drejtat Civile dhe Politike etj.

Liria e besimit dhe e ndergjegjes dhe liria e shprehjes se tyre ne jeten publike, jane liri individuale te garantuara nga Kushtetuta e Republikes se Shqiperise. Si te tilla, kufizimi i tyre mund te behet vetem me ligj per nje interes publik, ose per mbrojtjen e te drejtave te te tjereve (neni 17/1 i Kushtetutes). Per me teper, kufizimi qe mund te behet ne keto raste, nuk mund te cenoje thelbin e lirive dhe ne asnje rast nuk mund te tejkaloje kufizimet e parashikuara ne Konventen Europiane per te Drejtat e Njeriut (neni 17/2 i Kushtetutes).

Pikepyetja qe ngrihej ne kete çeshtje ishte se, a mundej qe nje akt nenligjor sikurse rregullorja, te kufizonte liri te garantuara me Kushtetute? Pergjigja eshte prerazi Jo. Nga ana tjeter ne kete çeshtje duhet te mbajme parasysh parimin e pergjithshem te se drejtes se ajo qe nuk pengohet shprehimisht me ligj, lejohet. Ne keto kushte, veç rekomandimeve perkatese qe i jane drejtuar Rektorit te Universitetit “Aleksander Moisiu”, Durres, eshte duke u pergatitur nje rekomandim mbi nevojen e rregullimit te kesaj çeshtje qe lidhet me lirine e besimit dhe ushtrimit apo kufizimit te saj ne procesin mesimor ne arsimin e larte me ane te nje ligji, sikurse parashikohet ne keto raste shprehimisht ne Kushtetute. Zgjidhja e mundshme mund te behet me futjen ne fuqi te nje ligji specifik. Ose kjo zgjidhje mund te gjenerohet edhe me nje parashikim perkates dhe rregullim ne projekt-ligjin e lartpermendur ende ne proces miratimi “Per arsimin e larte ne Republiken e Shqiperise”.

Problematike tjeter e cila eshte evidentuar ne ankesat e paraqitura ne vitin 2006, eshte ajo qe lidhet me aplikimin e standarteve sipas sistemit arsimor te Kartes se Bolonjes dhe kalimit nga sistemi aktual ne kete sistem, duke rregulluar pasojat e mundshme. Nje ankese e tille eshte paraqitur ne institucionin tone nga ana e Qendres Shqiptare per te Drejtat e Njeriut ne mbeshtetje te nje grupi studentesh, çeshtje e cila eshte ende ne shqyrtim.

Nga ankesat e trajtuara përmendim:

1. Shtetaset E.V, L.G dhe N.B, ndihmesmesuese te Institutit te Femijeve qe nuk degjojne, Tirane, kane paraqitur nje ankese lidhur me faktin

se, ne tabelën e pagave, nuk ekziston emertimi i tyre si ndihmesmesuese dhe ne keto kushte ato paguhen si edukatore konvikti. Pra, pavaresisht se ato kane arsimin e larte per mesuesi, dhe kryejne nje pune te nje niveli me larte, marrin nje page ne te njejtin nivel me edukatoret.

Nje shqetesim tjetër i cili është prezantuar nepermjet ankeses, është fakti se ndihmesmesueset punojne dhe ditën e shtune, ne ndryshim nga kategoria e mesuesve.

Ne momentin e depozitimit te kesaj ankese, Institucioni yne ka zhvilluar nje korespondence me Ministrine e Arsimit dhe qendrimi i mbajtur ne shkresen Nr.3149 Prot. date 07.06.2005, ka qene:

“Per specifiken e ketyre Institucioneve , ndihmesmesuesi nuk ka norme mesimore per realizimin e programit mesimor, **por angazhohet ne procesin mesimor 2-3 ore ne dite**, ndersa pjesen tjetër te kohes se punes e zene aktivitetet edukative me nxenesit dhe zhvillimi i studimit pasdite”.

Perballë ketij qendrimi, ankueset shpjegojne se puna reale qe ato kryejne nuk është ajo qe i perket ndihmesmesuesit, ne kete Institut, per vete specifiken e tij, sepse ka konvikt, ndihmesmesueset nuk angazhohen 2-3 ore ne dite se bashku me mesuesin.

Keshtu referuar dhe nenit 58 pika 9 te Dispozitave Normative per shkollat publike te miratuara nga Ministri i Arsimit te cilat kane hyre ne fuqi ne vitin shkollor 2002-2003, ku parashikohet se:

“Ndhimesmesuesi punon 6 dite ne jave me 6 ore ne dite (36 ore ne jave)”,

ndihmesuesit e zhvillojne punen e tyre te pavarur nga mesuesit, ne menyre qe nxenesit te qendrojne per nje kohe sa me te gjate me personel te specializuar, duke patur parasysh faktin tjetër se kriteret e pranimit ne pune te kujdestareve nuk parashikojne domosdoshmerine e arsimit te larte.

Sa me siper, duke ballafaquar punen konkrete te cilen kryejne ndihmesmesueset e ketij Instituti dhe parashikimit te bere ne Dispozitat Normative, pas takimeve te zhvilluara me perfaqesues te Drejtorise se Institutit dhe te Ministrise se Arsimit, arrihem ne konkluzionin se ajo është ne perputhje te plote persa i perket kohes se punes. Nderkohe qe persa i perket permbajtjes ajo është realizuar ne perputhje me specifikat e Institutit perkates. Evidentuar ne kete çështje edhe se ne Kontraten kolektive te vitit 2002 te lidhur midis Ministrise se Arsimit, Ministrin te Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe perfaqesueve te dy sindikatave te arsimit, parashikohej se shkolla punon 5 dite ne jave. Ne kete rast lindte pyetja, nese do te zbatoheshin Dispozitat Normative apo Dispozitat e Kontrates Kolektive?

Gjithashtu kemi evidentuar se Dispozitat Normative rezultonin te mos ishin miratuar me urdher apo udhezim te Ministrin te Arsimit. Ato ishin

firmosur nga Ministri, por ishin derguar per zbatim me shkrese zyrtare nga Sekretari i Pergjithshte. Referuar nenit 102 pika 4 te Kushtetutes, ne zbatim te kompetencave te tij ministri nxjerr urdhra dhe udhezime. Ne keto kushte nevojitet rregullimi sipas kushtetues i kesaj ceshtjeje.

Por nga ana e ankueseve dhe Drejtorise se Shkolles, u shpreh shqetesimi se, nisur nga specifika e trajtimit te femijeve qe nuk degjojne, te cilet duhet te kene nje perkujdesje te vecante, dhe te punes konkrete qe keto te fundit bejne, nevojitet nje rregullim i ri i posaçem ne perputhje me ndryshimet qe kane pesuar normat e mesueseve dhe te veshitresise se punes qe ato kryenin.

Pra me fjale te tjera, Drejtoria e shkolles kompetente ne evidentimin e nevojave te Institutit me qellimin e realizimit sa me mire te sherbimit per femijet, ishte e mendimit se per ndihmesmesuesit fakti qe punojne edhe ditene e shtune, perbente nje ngarkese te madhe.

Ne te njejten kohe sugjerohej se asistenca per keta femije duhet te ishte ne nje nivel me te larte. Kjo nenkuptonte se kujdestaret duhet te merreshin ne pune me nje nivel te caktuar arsimor, i cili te perputhej me punen qe ato kryenin. Pra, fakti qe per keta femije te djelen kujdeseshin vetem kujdestaret paraqiste problem per Drejtorine e shkolles. Me fjale te tjera ne konceptin e Drejtorise se Shkolles kjo ishte e pamjaftueshme, pasi keta femije kishin nevojte per nje perkujdesje te specializuar dhe ditene e djele.

Sa me siper, duke marre shkas nga fakti se Ministria e Arsimit ishte ne proces te ndryshimeve te Dispozitive Normative, ne menyre qe keto ndryshime te ishin sa me te drejta, sygjeroam ngritjen e nje grupi pune ku te terhiqej dhe te ballafaqohej mendimi i te gjithe grupeve te interesit, duke perfshire ketu organizatat te cilet kane ne fokusin e veprimtarise se tyre mbrojtjen e te drejtave te femijeve me aftesi te kufizuara si dhe vete personelin e shkollave te vecanta.

Ne keto kushte, ne baze te parashikimeve te Kushtetutes dhe Ligjit "Per Avokatin e Popullit", i kemi rekomanduar Ministrit te Arsimit dhe Shkences, terheqjen dhe ballafaqimin e mendimeve te grupeve te interesit, ne menyre qe akti perfundimtar, pra Dispozitat e reja Normative qe do te miratoheshin, te ishin jo vetem ne perputhje me ligjet, por dhe me kushtet e reja te cilat jane bere prezente, me qellim per nje mbrojtje sa me te mire si te te drejtave te personelit qe kujdeset per femijet me aftesi te kufizuara dhe te drejtave te vete femijeve.

2. Shtetasi M.H nga Berati, ka paraqitur nje ankese ku parashtrohej shqetesimi se kishte mbaruar studimet e larta per stomatologji ne nje Universitet te Rumanise, por edhe pse i ishte drejtuar Ministrise se Arsimit

per njehsimin e diplomes qe ne muajin Shkurt 2006, nuk kishte marre asnje pergjigje zyrtare per trajtimin e kerkeses se tij.

Sa me siper, ankuesi ka kerkuar nderhyrjen e Institucionit te Avokatit te Popullit per trajtimin brenda afateve ligjore te ceshtjes.

Bazuar ne ankesen e paraqitur, i kemi kerkuar shpjegime Drejtorise se Arsimit te Larte prane Ministrise se Arsimit dhe Shkences p-er trajtimin e ketij rasti. Nepermjet nje proçesi ndermjetesimi aktiv ne vazhdim jemi informuar nga kjo drejtori se ankuesit i ishte njohur diploma ne daten 26 Qershor 2006 dhe kerkohej qe ai t'a terhiqte ate prane kesaj Ministrie. Nisur nga kjo zgjidhje pozitive e ceshtjes, kemi vene ne dijeni ankuesin per nevojen e kryerjes se veprimeve per terheqjen e diplomes se tij te njehsuar tashme ne Ministrine e Arsimit dhe Shkences.

3. Shtetasi Th.K, nga Pogradeci ka shprehur shqetesimin per shkelje te drejtes se tij per te ushtruar profesionin.

Me marrjen ne shqyrtim te kesaj ceshtje nga ana jone, jane kerkuar shpjegime prej Zyres Arsimore Pogradec. Nderkohe pas ballafaqimit te fakteve dhe dokumentacionit perkates kemi verejtur si me poshte:

Rezultonte qe, ankuesi kishte mbaruar ne vitin 1983 arsimin e larte dega "Filozofi" dhe kishte punuar deri ne date 06.12.2005 me detyra te ndryshme, deri sa ne kete date ishte liruar nga detyra e pergjegjesit te Zyres Arsimore Pogradec me Vendimin Nr.51 date 07.12.2005 dhe ishte vene ne dispozicion te Zyres Arsimore Pogradec.

Duke qene se ne vendimin perkates ishte percaktuar se ankuesi ishte ne dispozicion, Zyra Arsimore ishte e detyruar nga ky akt qe te vihej ne levizje dhe te nxirrte aktin e emerimit te tij, natyrisht ne profilin e tij, dhe ne rast se nuk kishte mundesi, ne nje lende te nje profili te afert me degen per te cilin ai ishte arsimuar. Ne pergjigjen e kesaj zyre, parashtrohej se ankuesit i ishin ofruar disa mundesi, por ai nuk kishte pranuar. Zyra Arsimore Pogradec, si organ vendimmarres ne emerimet e personelit mesimdhemes duhej te shprehej me vendime konkrete, pasi ishte ne kompetencen e saj dhe ishte detyrueshme qe ajo te shprehej ne menyre zyrtare. Gjithashtu nuk mund te paragjykohej prej saj pergjigja negative nga ana e ankuesit ne rast se kjo zyre nuk kishte nxjerre nje vendim te caktuar. Ky vendim duhet te ishte jo vetem i ligjshem, por dhe i rregullt çka nenkuptonte, si ai duhej te pershtatej me kualifikimin dhe eksperiencen e personit per te cilin po vendosej.

Lidhur me kete fakt ne konstatoam se Zyra Arsimore Pogradec kishte marre nje vendim per emerim mesues provizor te ankuesit, ne shkollen "Gjergj Pekmezi" per lenden Histori-Gjeografi ne date 22.12.2005.

Si nga pergjigja e kesaj zyre, ashtu dhe ne objeksionet e ankuesit, ishte i vertete fakti se ne shkollen “Gjergj Pekmezi” rezultonin ore ne lenden Sociologji, e cila natyrisht duhej te mbulohej nga specialiste te profilit perkates. Rezultonte gjithashtu se kjo lende nuk mbulohej teresisht me mesues te profilizuar ne sociologji, por oret e saj i ishin shperndare mesuesve te tjere te shkolles. Ne keto kushte arrihem ne konkluzionin se ky vendim i marre nga ana e Zyres Arsimore Pogradec nuk ishte i drejte per faktin se :

Se pari: Lenda e sociologjise eshte dege e Fakultetit te Shkencave sociale dhe natyrisht me afer kesaj lende jane deget e ketij fakulteti dhe jo te Fakulteteve te tjera;

Se dyti: Fakti qe ishte mesi i procesit te mesimdhenies se vitit shkollor, nuk pengonte kete zyre qe ne rast se kishte mundesi t’i siguronte nxenesve specialiste per lendet perkatese. Qellimi i procesit mesimor eshte pikerisht rritja e nivelit mesimdhenes dhe natyrisht nje nga faktoret qe ndikojne eshte dhe kualifikimi i personelit mesimdhenes. Ne rast se oret mesimore te cilat nuk zhvilloheshin nga mesues sociologjie ne lenden sociologji ishin te mjaftueshme ne menyre qe ankuesi te merrte nje emerim definitiv, atehere ne nuk e gjetem te bazuar ne ligj vendimin e emerimit te tij provizor, pikerisht ne nje lende e cila ishte larg profilit te tij.

Si perfundim, duke konkluduar se trajtimi i ceshtjes se ankuesit nga ana e Zyres Arsimore Pogradec, kishte cenuar te drejten e tij per te ushtruar profesionin, ne perputhje me arsimin dhe pervojen ne pune, bazuar ne parashikimet e nenit 14 te Ligjit Nr.7952, datë 21.6.1995 “Per sistemin arsimor parauniversitar”, V.K.M Nr. 707 date 16.10.2003 “Per riorganizimin e Drejtorive Arsimore te Rretheve ne Drejtori Arsimore Rajonale dhe ne Zyra Arsimore”, si dhe ne Ligjin “Per Avokatin e Popullit, i kemi rekomanduar zyres ne fjale, revokimin e aktit te emerimit provizor te ankuesit dhe emerimin e tij si mesues definitiv, ne baze te profilit te tij arsimor dhe ushtrimin e kompetencave bazuar ne ligj dhe aktet nenligjore (neni 121 i Kodit te Proçedures Administrative).

Pas rekomandimit tone, Zyra Arsimore Pogradec, ka kthyer nje pergjigje ku jemi vene ne dijeni per emerimin si mesues definitiv te ankuesit, ne date 06.02.2006 per lenden e filozofise ne shkollen e mesme te pergjithshme “Muharrem Çollaku”, duke konfirmuar keshtu pranimin e rekomandimit dhe nje zgjidhje pozitive te ceshtjes.

4.Shtetesja B.H, studente ne Universitetin “Aleksander Moisiu”, Durres, ne daten 20.10.2006 ka shprehur shqetesimin ne lidhje me mospranimin nga ana e Rektorit te Universitetit “Aleksander Moisiu”, Durres, te frekuentimit te metejshe me te procesit mesimor prej saj.

Sikunder ajo shkruante, ishte regjistruar per te vazhduar studimet ne Universitetin "A.Mosiu", Durres, ne degen Anglisht. Mirepo ajo nuk pranohej per te ndjekur studimet dhe shkak per kete mospranim, ajo shprehej se, sipas Rektorit ishte bere veshja e saj, veshje e mbuluar me shami. Nderkohe ajo shkruante se nga koha e ndalimit per te ndjekur procesin mesimor, i ishte dhene nje afat dy javor per te hequr veshjen e saj, me qellim qe te pranohej me pas ne procesin e mesimit. Megjithate, ankuesja shprehej se keto deklarata per afatin e caktuar, i ishin thene verbalisht dhe jo me shkrese zyrtare.

Per kete çeshtje, ankuesja shkruante se ishte ankuar ne nje sere institucionesh, por ende nuk kishte marre nje pergjigje.

Ne keto kushte, duke e cilesuar kete fakt si mohim te se drejtes se saj per te vazhduar studimet e larta, ankuesja ka kerkuar nderhyrje nga ana e Avokatit te Popullit per zgjidhjen e kesaj çeshtje.

Me marrjen ne shqyrtim te kesaj çeshtje nga zyra jone, kemi kerkuar prej Rektorit te Universitetit "Aleksander Moisiu", Durres dhenien e shpjegimeve, persa i perket trajtimit qe i ishte bere kesaj çeshtje. Ne keto shpjegime, kemi kerkuar sqarime lidhur me bazen ligjore ku mbeshtetej veprimi ne kete rast, si dhe kemi kerkuar kopje te aktit administrativ (te mundshem) qe ishte nxjerre per kete çeshtje. Veç ketyre shpjegimeve, kemi kerkuar te n'a dergohej nje kopje e Rregullores se funksionimit te Universitetit "Aleksander Moisiu", Durres.

Kjo procedure shqyrtimi ka vazhduar paralelisht me nje takim te zhvilluar ne zyren e Rektorit, ne daten 30.10.2006.

Ne kete takim eshte debatuar ne lidhje me menyren se si ishte trajtuar kjo çeshtje, nisur jo vetem nga rasti konkret, por edhe nga praktika tonat te meparshme ne raste identike ne sistemin arsimor publik.

Duhet theksuar se ne kete takim, realisht pati nje reflektim gjysem pozitiv nga ana e Rektorit, fakt qe eshte konkluduar me pranimin e studentes B.H (dhe te studentit J.M) ne mesim. Po ne kete takim kemi kerkuar te marrim nje kopje te "Rregullores", e cila sipas shpjegimeve te dhena prej Rektorit e stafit tjetër prezent, ishte perdorur si baze ligjore per trajtimin e ketij rasti. N'a eshte dhene vetem nje fotokopje e ketij "dokumenti zyrtar", ku qe ne fillim binte ne sy emertesa "Urdher i brendshem" (jo rregullore), me nr.prot.195 date 4.20.2006, si dhe fakti qe ky akt administrativ ishte nxjerre nga ana e nje organi, i cili ishte emertuar shprehimisht "Bordi i Universitetit". Duke mos analizuar paraprakisht permbajtjen e ketij akti, nenvizuam faktin se ne fund te ketij akti administrativ nga dokumenti qe ne n'a ishte dhene si kopje, mungonte firma e personit qe kishte tagren e

firmosjes, cilesimi me funksionin perkates te ketij personi, si dhe mungonte vulosja e ketij akti me vulen e institucionit perkates.

Menjehere pas takimit te sipercituar, eshte realizuar nje takim me ankuesen, nga e cila morem sqarime te tjera ne lidhje me kete ceshtje. Po keshtu eshte kontaktuar edhe studenti tjetër J.M, i cili ishte pezulluar per ndjekjen e procesit mesimor per arsye te ngjashme me ato te ankueses, sepse mbante mjeker.

Me konkretisht, ankuesja n'a ka sqaruar se ishte therritur vecmas nga ana e zv.rektorit si dhe nga ana e Rektorit, ku edhe ishte pyetur per shkaqet e mbajtjes se shamise dhe veshjes perkatese. Mbas shpjegimeve qe ka dhene, ajo ka pohuar se nga ana e Rektorit i ishte komunikuar verbalisht fakti se nuk do te lejohej te ndiqte procesin e mesimit derisa te paraqitej me veshje tjetër ne universitet dhe per kete i ishte dhene nje afat dy javor. Ankuesja gjithashtu ka konfirmuar faktin se, nuk kishte marre asnje njoftim apo shkrese zyrtare per kete pezullim, per ndjekjen normale te procesit te mesimit. Mbas kesaj bisede ankuesja ka konfirmuar se, nuk ishte lejuar ne ditet ne vazhdim jo vetem qe te ndiqte mesimin, por edhe as te afrohej tek dera e godines se universitetit prej rojes se godines. Afati dy javor qe i ishte dhene ankueses, realisht perfundonte te nesermen e dates ne te cilen ne kemi zhvilluar takimin ne zyren e Rektorit. Duke patur parasysh reagimin qe patem nga ana e ketij te fundit ne takimin e zhvilluar me te, kemi keshilluar ankuesen qe te prese reagimin tone, por edhe te vete Rektoratit edhe pse te nesermen perfundonte afati i caktuar dhe edhe pse ankuesja nuk ishte dakort qe te ndryshonte veshjen e saj. Po keshtu, i kemi kerkuar asaj qe te paraqitej rregullisht ne Universitet, per te vazhduar procesin e mesimit.

Bazuar ne premtimin se pergjigja per shpjegimet e kerkuara per kete ceshtje do te ishte shume e shpejte nga ana e Rektorit, kemi qene ne pritje te kesaj pergjigje. Fakti eshte se pas disa kontaktimesh me telefon, se fundmi pas nje kohe relativisht te gjate nga ajo e cila n'a ishte premtuar, jane derguar sqarimet perkatese.

Ne shkresen e sipercituar te Rektoratit te Universitetit "Aleksander Moisiu", Durres, sqarohej se:

Ky universitet ka nje rregullore te brendshme te miratuar nga ana e Bordit Akademik dhe ku ne menyre te qarte eshte e ndaluar frekuentimi i universitetit nga studente veshja dhe paraqitja e te cileve, pasqyron dhe perçon ne proporcione te ekzagjeruara fe, sekte dhe/ose diskriminime racore apo sigmatizojne grupe te ndryshme shoqerore.

Ne zbatim te kesaj rregulloreje, nga ana e rektoratit studentet Behije Hoxha dhe Julian Mebelli jane thirrur dhe njoftuar per kete rregullore, si dhe jane keshilluar te pershtasin veshjen dhe paraqitjen e tyre ne perputhje me te. Per

kete arsye atyre u jane lene dy jave afat reflektimi. Pas perfundimit te ketij afati dhe ne pergjigje te ankeses verbale te studenteve ne fjale, Bordi Akademik ka vendosur shprehimisht;

*-Per t'ju dhene mundesi gjykimi pa peshen e presionit dhe ngarkesave te panevojshme, te gjitha faktoreve dhe aktoreve qe jane direkt apo indirekt pjese e institucionit te te interesuarve, qe laiciteti ne universitete te rregullohet ne menyre eksplicite me ligj, si dhe per te çliruar Universitetin nga pesha e problemeve qe presin te zgjidhen, **vendosi pezullimin e perkohshem, vetem per kete vit akademik te zbatimit te pjeses se rregullores qe prek çeshtjen ne fjale.***

-Vendimi merret duke u nisur nga fakti se studentet nuk kane patur dijeni per rregulloren e Universitetit ne Prill 2006, kohe qe korrespondon me kryerjen nga ana e studenteve te pararegjistrimeve, kur universiteti nuk kishte filluar te funksiononte.

-Universiteti do te beje te gjitha perpjekjet civile dhe institucionale qe rregullorja te reflektuje zgjidhjet ligjore qe institucionet e ngarkuara do te japin, per sa i perket vijes ndarese mes lirive themelore te njeriut dhe ndarjes se shtetit nga feja te garantuara ne Kushtetute nga njera ane dhe laicitetit te Universitetit te shprehur ne Ligjin e Arsimit te Larte nga ana tjeter.

-Rregullorja perfundimtare do te zbatohet vitin e ardhshem akademik me rigorozitet pa perjashtim per te gjitha studentet, duke perfshire edhe rastet e siperpermendura”.

Nisur nga keto percaktime te bera ne kete shkrese dhe per te patur nje analize te qarte te trajtimit te kesaj çeshtje, gjykuam se duhej te sqaroheshin keto pika:

1. A e kishte ne kompetencen e tij struktura e emertuar “Bordi Akademik” (apo Bordi i Universitetit siç ishte titulluar faktikisht ne urdherin e bredshem), nxjerrjen e nje akti te tille administrativ si “Rregullorja”, e prezantuar ne kete çeshtje?

2. Dokumenti i paraqitur dhe i emertuar ne shkresen e Rektoratit si “Rregullore”, a ishte i tille dhe çfare perfaqesonte ai ne te vertete?

3. A perfaqesonte ky dokument nje akt administrativ ne tere elementet e tij te domosdoshem, per aq sa ai i ishte prezantuar si kopje dokumenti zyrtar zyres sone?

4. A ekzistonte nje akt administrativ i nxjerre nga autoriteti perkates kompetent per pezullimin e ndjekjes se procesit mesimor, drejtuar ankueses dhe studentit tjeter J.M?

5. A mundej qe dokumenti i cilesuar si Rregullore nga ana e Rektoratit te ezauronte çeshtje te tilla, si ato per te cilat kishte ndodhur pezullimi ne ndjekjen e procesit mesimor per studentet e sipercituar?

Per te arritur ne konkluzionet perkatese, u be analiza ligjore e çdo pike ne menyre te veçante dhe me konkretisht:

Lidhur me piken e pare, ne reference te parashikimeve te Ligjit nr.8461 date 25.02.1999 “Per arsimin e larte ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar, konstatohej se ne nenin 7 parashikohej cilesimi i shkollave te larta publike (sikurse Universiteti “Aleksander Moisiu”), si institucione autonome. Ne piken “a” dhe “b” te ketij neni parashikohej se:

“-shkolla e larte zgjedh organet dhe autoritetet e veta drejtuese, -personeli i shkolles se larte ka te drejte te zgjedhe e te zgjidhet ne organet drejtuesete shkolles se larte ne perputhje me statusin e shkolles se larte”.

Ne nenin 15 dhe 16 te ketij ligji, thuhej shprehimisht qe:

“Senatet dhe keshillat ne shkollat e larta jane organe kolegjiale, te zgjedhura, qe vendosin per problemet me te rendesishme te shkolles se larte ne fushen e mesimit, kerkimit shkencor dhe ne ate **administrativo-financiare**. Keto organe mblidhen periodikisht.

Senati eshte organi me i larte i shkolles se larte universitare; **keshilli i fakultetit** eshte organi me i larte i fakultetit; keshilli i shkolles eshte organi me i larte i shkolles se larte jouniversitare dhe **keshilli i departamentit** eshte organi me i larte i departamentit. Perberja detyrat, kompetencat dhe funksionimi i senateve dhe i keshillave perkatese percaktohen me statutet e shkollave te larta dhe ne rregulloret e tyre te brendshme”,

“Autoritetet drejtuese te shkollave te larta dhe te strukturave te njesive te tyre perberese jane:

- a) **Rektori** per shkollen universitare
- b) **Drejtori** per shkollen jouniversitare
- c) **Dekani** per fakultetin.....

Detyrat dhe kompetencat e ketyre autoriteteve drejtuese burojne nga ky ligj dhe percaktohen me hollesi ne statutet e shkollave te larta”.

Ne vazhdim te parashikimeve te ketij ligji, ne nenin 25 thuhej shprehimisht qe:

“Ministria e Arsimit dhe Shkences miraton strukturen orientuese te administrates se shkollave te larta ne te gjitha nivelet. Personat pergjegjes per mbarevajtjen administrative dhe ekonomike te shkolles se larte jane kancelari i shkolles se larte dhe kancelaret e fakulteteve, te cilat jane specialiste me formim te larte ekonomik dhe me pervoje menaxhuese.

Kancelari i shkolles se larte publike universitare apo jo universitare, propozohet, perkatesisht nga rektori ose drejtori dhe emerohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkences. Kancelari i fakultetit propozohet nga dekani dhe emerohet nga rektori. Detyrat dhe kompetencat e kancelareve percaktohen ne statutin e shkolles se larte.”

Lidhur me menyren e rregullimit me akte ligjore dhe nenligjore te menyres se funksionimit te shkollave te larta publike, ne nenin 29 parashikohej qe:

*“Shkolla e larte funksionin ne baze te ketij ligji, te akteve nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij, **te statutit dhe rregulloreve te brendshme.***

Statuti i shkolles se larte hartohet, perkatesisht, nga senati i universitetit apo keshilli i shkolles se larte dhe miratohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkences.

Statuti i shkollave te larta ushtarake ose te policise miratohet nga ministri perkates.

*Rregullorja e zgjedhjeve te organeve dhe autoriteteve drejtuese hartohet nga senati ose keshilli i shkolles se larte dhe miratohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkences. **Rregullorja e brendshme e fakultetit miratohet nga rektori.** Rregullorja e brendshme e departamentit miratohet nga dekani i fakultetit ose drejtori i shkolles se larte jo universitare. **Keto rregullore hartohen nga keshillat perkates.***

Ne zbatim te ketij ligji statutet e shkollave te larta paraqiten per miratim ne Ministrine e Arsimit dhe shkences jo me vone se tre muaj nga data e hyrjes ne fuqi te ketij ligji. Ne qofte se brenda nje muaji nga data e paraqitjes per miratim, Ministria e Arsimit dhe Shkences nuk shprehet mbi kete statut, ai konsiderohet i miratuar”.

Konkretisht, per te pasur nje analize me te hollesishme, kemi kerkuar nje kopje te dokumentit “Statut”, i cili rregullonte sipas ligjit menyren e funksionimit te Universitetit “Aleksander Moisiu”, Durres. Kemi kontaktuar per kete qellim me Ministrine e Arsimit dhe Shkences, si dhe me vete Rektorin e Universitetit “Aleksander Moisiu”. Fakti eshte se nga sqarimet e marra rezultonte qe ishte pergatitur nje draft statut per kete universitet, por qe ende nuk ishte miratuar si akt nenligjor sipas kompetences, nga ana e Ministrimit te Arsimit dhe Shkences. Sqarimi i vetem qe n’a u dha, ishte se organet perkatese drejtuese te Universitetit “Aleksander Moisiu”, Durres, vepronin ne baze te disa dispozitave kalimtare.

Nje moment tjeter ku u ndalem ne kete çeshtje eshte se, çfare perfaqesonte struktura “Bord Akademik” (ose Bordi i Universitetit) ne kete rast. Fakti ishte se sipas percaktimeve te Ligjit nr.8461 date 25.02.1999 “Per arsimin e larte ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar, senati i shkolles se

larte universitare perbehej nga perfaqesuesit e zgjedhur nga keshillat e fakulteteve te shkollave te larta jouniversitare dhe nga studentet.(neni 17).

Sipas pergjigjes qe kishte dhene Rektorati i Universitetit “A.Moisiu”, Bordi Akademik kishte ne perberje e tij Rektorin, Zv.rektorin, Dekanen e Fakultetit te Ekonomise dhe Administrimit, Dekanin e Fakultetit te Edukimit dhe Drejtoreshen e Shkolles se Larte Profesionale. Problemi qe evidentohet ne kete rast ishte se fjala “bord” ne gjuhen angleze, e perkthyer ne shqip do te thote “keshill”, nderkohe qe pershtatur me terminologjine e perdorur nga ana e Rektoratit ne kthimin e pergjigjes, konstatohej se emertesa “Bord Akademik” = “Keshill Akademik”. Ligji per arsimin e larte nuk e njihte kete term, ne kuadrin e organeve dhe autoriteteve te veta drejtuese. Por perberja e ketij bordi akademik nuk perafrohej me perberjen e senatit, si nje nga organet drejtuese te shkolles se larte publike.

Per me teper, ne percaktimet e bera nga ana e ligjit behej fjale per rregullore te brendshme te fakultetit apo te departamentit, te cilat hartoheshin nga keshillat perkates dhe qe miratoheshin prej perkatesisht, Rektorit apo Dekanit te Fakultetit. Meqenese behej fjale per nje rregullore te brendshme qe nuk kishte te bente me zgjedhjen e organeve dhe autoriteteve drejtuese, atehere behej fjale per rregullore te fakultetit apo departamentit. Po per çfare fakulteti behej fjale ne rastin konkret? Ne fund te fundit, ke fakultet perfaqesonte “Bordi Akademik” dhe mbi ç’baze ishte ngritur ai si organ? Te gjitha keto pikepyetje ngriheshin duke marre te mireqene faktin se dokumenti qe neve n’a ishte paraqitur nga ana e Rektoratit, ishte me te vertete nje rregullore, fakt qe do te analizohet ne piken e dyte. Ne keto kushte, ky akt ishte nxjerre nga nje organ i pidentifikuar dhe atij i mungonte si procedure, miratimi nga ana e dekanit perkates. Rrjedhimisht, ne keto kushte kishim te benim me nje akt administrativ absolutisht te pavlefshem.

Lidhur me piken e dyte, ishte e nevojshme te sqarohet se çfare perfaqesonte dhe kuptonte koncepti i aktit administrativ te emertuar “Rregullore”. Ne kete sens, akti administrativ i nxjerre nga ana e organit perkates te administrates publike dhe i emertuar “Rregullore”, eshte nje akt nenligjor qe nxirret ne baze dhe per zbatim te ligjit. Ne thelb keto akte kane karakter normativ dhe jane te detyrueshme per te gjithë subjektet te cilave ato u drejtohen per zbatim. Po te verehej me kujdes, qe ne emertese ky dokument ishte emertuar “Urdher i brendshem”. Per me teper edhe per nga menyra e formulimit ai nuk perafrohej aspak me “Rregulloren”.

Ne teorine e se drejtes, urdheri eshte nje akt nenligjor i cili ndeshet me shpesh ne kompetencat qe ka nje organ individual. Ai nxirret ne kuader te zgjidhjes se nje çeshtje konkrete dhe jo te pergjithshme, per me teper qe ne

çeshtjen konkrete ai mund të nxirret nga një titullar për të përcaktuar detyrimin e subjekteve të caktuara, për zbatimin e disa normave rregulluese të përgjithshme të sanksionuara me një akt tjetër nenligjor, sikurse rregullorja. Pra, në këtë gjykim dokumenti i paraqitur dhe i cilesuar si rregullore, nuk përmbente një rregullore, por një akt tjetër nenligjor që nuk përputhej me kompetencat e organit që e kishte nxjerrë atë.

Lidhur me piken e tretë, ishte e nevojshme të mbahej parasysh se çfarë përcakton teoria e të drejtës administrative në lidhje me përmbajtjen e aktit administrativ. Ndërsa aspekti i formës së këtij akti që në të ishte paraqitur ishte në rregull, pasi respektonte rregullin e ekzistencës të aktit administrativ në formë shkresore, përmbajtja e këtij akti kishte mangësi.

Kështu që një akt të kësaj përmbajtje të plotë të domosdoshme, duhet të përmbajë, autoritetin, organin që e nxjerr aktin, si dhe çdo delegim apo nëndelegim të pushteteve, identifikimin e paleve të cileve u drejtohet akti, parashtrimin e fakteve që janë bërë shkas për nxjerrjen e tij kur ato janë të rëndësishme, bazën ligjore të aktit, datën e hyrjes në fuqi të tij, nënshkrimin e titullarit të organit që nxjerr aktin etj. Këto elemente të formës dhe përmbajtjes së një akti administrativ janë tepër të rëndësishme dhe nuk mund të injorohen. Ato konsiderohen pjesë përberëse e vetë aktit dhe mosrespektimi ose moszbatimi i tyre mund të ndikojë drejtpërdrejt në rregullsinë dhe në vlefshmerinë e tij.

Sikurse është theksuar që në fillim, ky akt kishte mungesë të elementeve të përmbajtjes, të cilat të çonin në përfundimin se këtu nuk bëhej fjale për rregullshmeri, por për pavlefshmeri të aktit.

Lidhur me piken e katërt, nëse ekzistonte apo jo një akt administrativ i nxjerrë nga autoriteti përkatës kompetent për pezullimin e ndjekjes së procesit mesimor, drejtuar ankueses dhe studentit tjetër J.M.

Faktikisht ndodheshim përpara rastit kur një marrëdhënie administrative e vendosur mes paleve (rektoratit dhe studenteve), ishte një marrëdhënie e pezulluar “de facto” dhe jo “de jure”. Në të gjithë praktikën e ndjekur, diskutimin e zhvilluar në takimin me Rektorin, apo qoftë edhe në sqarimet që në të ishin dhënë në përgjigjen për këtë çështje, pezullimi që i ishte bërë ankueses dhe studentit tjetër, kishte qenë thjesht mbi bazën e një urdheri verbal dhe jo mbi bazën e një akti administrativ shkresor. Edhe sikur të merrnim të mirëqenë faktin se urdheri i pezullimit përfaqësojë një akt administrativ të nxjerrë në formë verbale, mbetet e paqartë nëse kjo ishte apo jo një kompetencë e Rektorit, apo e ndonjë autoriteti tjetër dhe për më tepër, ky akt nuk ishte zbardhur edhe pse ishte kërkuar të bëhej një gjë e tillë, nga ana e vetë studenteve të interesuar (neni 107 i Kodit të Procedurave

Administrative) .Çeshtjen e kompetences ne kete rast, do t'a zgjidhte me se miri Statuti i miratuar.

A mundej qe nderprerja e ndjekjes se procesit te mesimit te behej pa akt administrativ, apo me ane te nje urdheri verbal? Ne te dyja rastet vleresuar se nuk ishin respektuar kerkesat e Kodit te Proçedurave Administrative, ndaj edhe praktika e ndjekur ishte plotesisht ne kundërshtim me keto parashikime.

Nese problemin e shohim ne aspektin tjetër, qe nga momenti i komunikimit te afatit (dy jave) ndaj ankueses, brenda te cilit ajo duhej te rregullonte problemin e veshjes, (gje e cila ka pasuar me pezullimin qe i ishte bere asaj per ndjekjen e metejshme te mesimit), jemi ne kushtet e fillimit te nje proçedimi administrativ. Ky proçedim administrativ kishte vazhduar me nje vendim te ndermjetem pezullimi (nderprerje "de facto") dhe normalisht, kishte perfunduar me ripranimin e ankueses ne mesim. Parashikimet e Kodit te Proçedurave Administrative percaktojne se, ky proçedim i nisur, me sa duket me iniciativen e autoritetit perkates te Universitetit "A.Moisiu", duhej patjetër te derivonte vendime te ndermjetme dhe te perfundonte me nje vendim perfundimtar. Gjithçka kishte ndodhur, ishte thjesht çeshtje fakti, pasi nuk kishim as vendim te ndermjetem te detyrueshem ne kete rast per t'u nxjerre ne forme shkresore dhe as vendim perfundimtar te nxjerre ne te njejtat kushte.

Lidhur me piken e peste, konstatuam se dokumenti i cilesuar si "Rregullore" nga ana e Rektoratit, nuk mund te ezauronte çeshtje te tilla individuale, si ato per te cilat kishte ndodhur pezullimi ne ndjekjen e procesit mesimor per studentet e sipercituar. Fakti eshte se ky dokument (pavaresisht konstatimeve te mesiperme qe evidentojne probleme ne lidhje me vlefshmerine e tij ligjore), kishte karakter rregullues te pergjithshem dhe nuk mund te merrte persiper zevendesimin e nje akti administrativ individual, te nevojshem per trajtimin dhe zgjidhjen e kesaj çeshtje.

Te pretendosh se ky rast mund te kishte per baze rregullimi direkte ne keto kushte "Rregulloren", do te thoshte qe nga ana e pales perkatese te se drejtes administrative "Rektorit apo Rektoratit", nuk kuptohej vete marrëdhënia administrative perkatese.

Mbi bazen e kesaj analize, natyrshem dolem ne disa konkluzione, te cilat po i rendisim si me poshte vijon:

-Urdheri i brendshem nr.195 date 4.10.2006, ishte nje akt administrativ absolutisht i pavlefshem. Si i tille ai nuk mund te sillte asnje pasoje, por mjaftonte konstatimi i tij ne kushtet e sipercituara.

-Urdheri i brendshem nr.195 date 4.10.2006, nuk ishte nje akt nenligjor apo akt administrativ i llojit "Rregullore", sikurse pretendohet.

Ekzistenca faktike e ketij akti dhe elementet e tij nuk perafrohen me aktin administrativ te emertuar "rregullore" dhe nga ana tjeter, dukej qarte se kompetenca e organit qe mund te nxirrte kete akt nuk ekzistonte ne kete ceshtje. As per nga ana strukture e ndertimit si dokument, ai nuk ishte rregullore.

-Urdheri i brendshem nr.195 date 4.10.2006, kishte probleme jo vetem te karakterit formal, por edhe te vete permbajtjes se tij si akt administrativ, ne reference te kopjes se aktit qe n'a ishte derguar bashke me pergjigjen nga ana e Rektoratit te Universitetit "Aleksander Moisiu".

-Pezullimi i ndjekjes se procesit mesimor per studentet ishte nje pezullim faktik, pa nje akt individual perkates administrativ te nxjerre nga ana e autoritetit pergjegjes. Realisht ky mosveprim per nxjerrje akti administrativ, kishte vene organin perkates te administrates ne kushtet e demit jashtekontraktor shkaktuar ndaj studenteve.

-Mungesa e aktit individual ne kete ceshtje, nuk mund te justifikonte si perdorim baze ligjore per rregullimin e ceshtjes, "Rregulloren" apo nje akt administrativ qe realisht nuk ishte rregullore, por urdher i brendshem.

Analiza e deriketushme qe i eshte bere ceshtjes, kishte te bente me vleresimin e ngushte te problemit per aq sa kishte ndodhur realisht ne aspektin administrativ individual. Por efektivisht problemi me i madh qendronte ne konceptimin qe behej ne kete rast nga ana e Rektoratit te Universitetit "A.Moisiu", Durres, ne lidhje me rregullimin e ceshtjeve sikurse ai i veshjes se ankuseses.

Fakti eshte se ne nenin 10 te Kushtetutes parashihet se shteti eshte asnjanes ne ceshtjet e besimit e te ndergjegjes dhe garanton lirine e shprehjes se tyre ne jeten publike. Edhe ne nenin 24 te Kushtetutes percaktohet se secili eshte i lire te zgjedhe, ose te ndryshoje fene, ose bindjet, si dhe t'i shfaqe ato individualisht ose kolektivisht, ne publik ose ne jeten private, nepermjet kultit, arsimimit, **praktikave ose kryerjes se riteve**.

Ne morine e akteve nderkombetare, mund te permendet neni 18 i Deklarates Universale te Drejtave te Njeriut ku thuhet se: "Çdo njeri ka te drejten e lirise se mendimit, te ndergjegjes dhe te fese. Kjo e drejte nenkupton lirine per te ndryshuar fene ose bindjet, vetem per vetem apo bashkarisht si ne publik ashtu edhe privatisht, nepermjet arsimimit, praktikave, kultit dhe kryerjes se riteve"; neni 9 i Konventes Europiane per te Drejtat e Njeriut; Konventen per Luften kunder diskriminimit ne Fushen e Arsimimit; nenin 26 te Konventes Nderkombetare per te drejtat Civile dhe Politike etj.

Liria e besimit dhe e ndergjegjes dhe liria e shprehjes se tyre ne jeten publike, jane liri individuale te garantuara nga Kushtetuta e Republikes se

Shqiperise. Si te tilla, kufizimi i tyre mund te behet vetem me ligj per nje interes publik, ose per mbrojtjen e te drejtave te te tjereve (neni 17/1 i Kushtetutes). Per me teper, kufizimi qe mund te behet ne keto raste, nuk mund te cenoje thelbin e lirive dhe ne asnje rast nuk mund te tejkaloje kufizimet e parashikuara ne Konventen Europiane per te Drejtat e Njeriut (neni 17/2 i Kushtetutes).

Pikepyetja qe ngrihej ne kete çeshtje eshte se, a mundet qe nje akt nenligjor sikurse rregullorja (?!), te kufizojë liri te garantuara me Kushtetute? Pergjigja eshte prerazi Jo. Nga ana tjeter ne kete çeshtje duhet te mbajme parasysh parimin e pergjithshem te se drejtes se ajo qe nuk pengohet shprehimisht me ligj, lejohet.

Ne keto rrethana, kemi vleresuar se pergjigja e Rektoratit te Universitetit “Aleksander Moisiu”, ne lidhje me kushtin e ripranimit te studentes B.H per vazhdimin e procesit te mesimit dhe te pezullimit te zbatimit te “Rregullores” per kete vit akademik, jane zgjidhje te cilat bien ndesh jo vetem me anen administrative te trajtimit te çeshtjes, por me e rendesishmja zgjidhje qe nuk kane baze ligjore dhe qe bien ndesh me parashikimet perkatese ne Kushtetute.

Trajtimi i kesaj çeshtje ne formen qe ajo paraqitej, perbente shkelje te te drejtave te ligjshme te ankueses, per te ndjekur rregullisht procesin mesimor ne Universitetin “Aleksander Moisiu”, Durres.

Nga ana tjeter, ne akordance me piken 2, te nenit 15, te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, organet e pushtetit publik, ne permbushje te detyrave te tyre duhet te respektojne te drejtat dhe lirite themelore te njeriut, si dhe te kontribuojne ne realizimin e tyre.

Per sa me siper, ne mbeshtetje te nenit 17 dhe pikes 3, te nenit 63 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, te nenit 21/b, te Ligjit Nr.8454 date 4.02.1999 “Per Avokatin e Popullit”, si dhe ne perputhje me nenin 116/a te Kodit te Proçedurave Administrative, i kemi rekomanduar Rektoratit te Universitetit “Aleksander Moisiu”, Durres, perkatesisht:

1.Heqjen nga perdorimi te Urdherit te Brendshem nr.195 date 4.10.2006, sepse eshte absolutisht i pavlefshem.

2.Mosperseritjen e nje situate te tille, si nje praktike e gabuar dhe jo ligjore nga ana e Rektoratit te Univesitetit “Alkesander Moisiu”, Durres.

3.Ndjekjen e proçedures ligjore per miratimin sa me te shpejte te Statutit, si nje nga aktet kryesore per rregullimin e veprimtarise te ketij universiteti.

Kjo çeshtje eshte ende ne shqyrtim nga ana jone.

5. Shtetesja A.M, nga Tirana.me detyrë Kryetare e Degës së Financës pranë AEFS “Vojo Kushi” , Tirane.

Ankuesja me detyrë Kryetare e Degës së Financës pranë AEFS “Vojo Kushi”, Tirane, ka paraqitur shqetësimin lidhur me largimin e saj të padrejtë nga puna me vendimin nr.91 dt.18.09.2006 të Rektoratit, mbi bazën e raportit të kontrollit të Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion Institucioni i Avokatit të Popullit, ka ndërmarrë një proces hetimi lidhur me këtë ankesë duke iu drejtuar Rektoratit të AEFS për dhenien e shpjegimeve për pretendimet e ankueses.

Në përgjigje të shkresës tonë, nga ana e Rektoratit të AEFS janë dhënë shpjegime të hollësishme për procedurën e marrjes së vendimit nr.91 dt.18.09.2006 për shkarkimin e ankueses, ku ndër të tjera citohej rekomandimi i Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës të punës.

Në vazhdim, lidhur me kontrollin e fundit që ishte ushtruar nga Departamenti i Kontrollit të Brendshëm, Rektoriati i AEFS i referohej pikës 4 në faqen 16, ku ngarkoheshin me përgjegjësi përgjegjësit e Degëve të Administratës, Financës dhe të Shërbimeve për veprime administrative dhe më tej në faqen 17 pika 3 paragrafi 2, ku rekomandohej zgjidhja e menjëhershme e kontratës të punës të Kryetares të Degës së Financës.

Në aktin e kontrollit konstatoheshin një sërë shkeljesh ligjore në ngarkim të Rektorit. Ndërsa për rastin e ankueses, lidhja dhe shkelja që konstatohej kishte të bënte me lidhjet nepotike të saj me Rektorin. Më poshtë, theksohej fakti se në akt-kontroll ishte bërë vetëm konstatimi i faktit të lidhjes nepotike, duke aluduar gjithsesi më poshtë se lidhja farefisnore e Rektorit me Kryetaren e Degës së Financës, ishte akt i pastër nepotik dhe që nuk përjashtonte ndikim në vendimmarrje lidhur me administrimin financiar.

Ky ishte i vetmi referim që bëhej lidhur me ankuesen, ndaj institucioni yne është shprehur në këte çështje dhe është i mendimit se lidhja nepotike që konstatohej dhe mbi bazën e të cilës aludohej për veprime korruptive, nuk përbënte një shkak për marrjen e vendimit nga Rektoriati për largimin nga puna të ankueses.

Për më tepër vlen të theksohej fakti se në atë kohë Rektori ishte larguar nga detyra e tij që ushtronte në AEFS “Vojo Kushi” dhe se lidhja e tij farefisnore me ankuesen nuk duhej dhe nuk mund të përbënte shkak për largimin e saj nga detyra si dhe për të bërë aludime për afera të ndryshme korruptive, pa patur më parë prova të mjaftueshme për çdo rast që do konstatohej.

Vendimi nr.91 dt.18.09.2006 i Rektoratit për largimin e ankueses nga puna, duke u bazuar vetëm mbi raportin e kontrollit të Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion, ishte një vendim i pabazuar në ligj apo ndonjë akt tjetër normativ, çka përbënte një praktikë të

gabuar dhe që nuk duhej të merrej për bazë në të ardhmen, sepse kështu përbënte shkak për shkeljen dhe mosrespektimin e të drejtave të njeriut, e në rastin konkret për cënim të rëndë të figurës së znj. Muho, e cila penalizohej shumë rëndë vetëm mbi bazën e lidhjes nepotike që ekzistonte me ish-rektorin.

Në këtë kuadër kemi theksuar se nga ana e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, në shkresën e tij me nr. 5985 prot. datë 06.09.2006 drejtuar Senatit të Akademisë së Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi”, citohehin shkeljet e rënda, të përsëritura të kryera nga drejtuesit e kësaj Akademie dhe në të njëjtën kohë ngarkohej me përgjegjësi krejsore Rektori i Akademisë, për të cilin ishte rekomanduar masa përkatëse, dhe kjo vetëm për Rektorin dhe jo për punonjës të tjerë të Akademisë, siç ishte rasti i ankueses, të cilët ishin nën varësinë direkte të tij.

Në kuadër të objektit të veprimtarisë sone si institucion kemi theksuar në këtë çështje se krahas mbrojtjes ligjore që i atribuohet ankueses, do të ishte më e drejtë që në rast se do të ekzistonin prova dhe materiale kompromentuese që do të përfshinin atë në afera korruptive, ashtu siç aludohej në akt-kontroll, atëherë rruga ligjore që duhej të ndiqej do të ishte kallëzimi penal pranë organit të prokurorisë si një organ i specializuar për të ushtruar ndjekjen penale dhe ngritjen e akuzave mbi bazën e provave që do mblidheshin gjatë hetimit, por jo mbi bazën e aludimeve të konstatuara gjatë kontrollit.

Ky qëndrim i yni është mbështetur tashme edhe nga Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr.20 dt.11.07.2006, e cila mbi bazën e kërkesës së Institucionit të Avokatit të Popullit, Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe Grupit Shqiptar për të Drejtat e Njeriut ka vendosur shfuqizimin e tre vendimeve të Këshillit të Ministrave, si vendime antikushtetuese dhe që cënonin të drejtat e individit për punësim.

Nga përgjigjet dhe argumentat e dhena në këtë rast, në asnjë moment nuk të krijohet bindja se për gjithcka ishte proceduar bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore, por të krijonte idenë se ishte marrë mbi baza subjektive.

Duke gjykuar se shteti ligjor që kërkojmë të ndërtojmë duhet të udhëhiqet nga parimi i transparencës e ligjshmërisë, duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve, nga ana jone i është rekomanduar zv.Rektorit të AEFS marrja e masave për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur ndaj ankueses dhe marrja e masave administrative për rikthimin e saj në detyrën si Kryetare e Degës së Financës.

12. Ministria e Shëndetësisë

Gjatë vitit 2006 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionet në vartësi të saj janë shqyrtuar gjithsej 47 ankesa. Kanë qenë të mbartura gjithashtu dhe 5 raste nga viti 2005. Janë përfunduar 47 ankesa, 10 janë zgjidhur në favor, 11 kanë rezultuar të pabazuara dhe 7 kanë qënë jashtë juridiksionit, 12 jashtë kompetence, 3 raste të zgjidhura në favor me rekomandim. Janë mbartur 5 ankesa për shqyrtim në vitin 2007.

Problematika e çështjeve që kanë të bëjnë me këtë ministri ka qënë kryesisht lidhur me vendimet për largimet nga detyra, transferime, tarifa prej 100-lekësh që paguhet për çdo recete me ilaçe të rimbursueshme, mosrimbursim të ilaçeve, kërkesa Ministrisë së Shëndetësisë për tëu kuruar jashtë shtetit, trajtimi i të sëmurëve me probleme të shëndetit mendor, si dhe trajtimi shëndetësor i fëmijëve talasemikë. Fillimisht shprehim vlerësimin mjaft pozitiv për Ministrin e Shëndetësisë, Z. Maksim Cikuli, i cili ka bashkëpunuar mjaft mirë me Avokatin e Popullit dhe ka vlerësuar dhe marrë masa pozitive për zbatimin e Rekomandimeve tona.

Në vijim të përpjekjeve tona institucionale, kemi ndërmarrë nisma për evidentimin dhe vënien në dukje të të metave që ofrojnë shërbimet shëndetësore, si kusht parësor për të mënjeluar dukuritë negative dhe për të rritur me performanca serioze cilësinë e shërbimeve që ofrohen në qendrat tona spitalore. Kësaj nisme i erdhi në ndihmë edhe miratimi i ndryshimeve të reja që ju bënë në Kuvend Ligjit Nr.8454 dt.4.02.1999 “*Per Avokatin e Popullit*”, të cilat sanksionuan të drejtën e Avokatit të Popullit për të kryer inspektime edhe në institucionet publike shëndetësore, veçanërisht në spitalet psikiatrike, duke i dhënë veprimtarisë tonë hapësira të reja për të përmbushur sa më mirë misionin kushtetues, në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individëve.

1. Duke marrë shkas nga media elektronike, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka ndërmarrë me inisiativë inspektime në spitalet dhe pavionet psikiatrike. Zgjedhja e inspektimit në këtë shërbim mjekësor është rezultat i disa të dhënave që kishim nga prononcimet e mjekëve specialist, të cilët e cilësojnë shërbimin shëndetësor psikiatrik si të prapambetur dhe të lënë larg vëmendjes, trajtimit dhe përmirësimit të kushteve të tij nga organet kompetente të kësaj fushe.

Nisur nga qëllimi i mirë për të ofruar jo vetëm të dhënat tona reale nga inspektimet e kryera, por dhe ndihmën tonë institucionale për të përmirësuar standartet shëndetësore në shërbimet psikiatrike dhe më gjerë. Konkretisht situata e konstatuar në Spitalin Psikiatrik të Elbasanit pas ushtrimit të një kontrolli me dt. 13.02.2006 për kushtet spitalore, administrimin mjekësor

dhe për gjendjen e mjeteve ndihmëse në dispozicion të pacientëve rezultoi se në këtë Spital shtrimi i detyruar i pacientit me simptoma akute, pa pëlqimin e tij ose të kujdestarit, nuk shoqerohej me paraqitjen e kërkesës së miratimit të masës së shtrimit të detyruar brenda 48 orësh në gjykatë.

-Kuotat ushqimore dietike ditore për pacientët e Spitalit Psikiatrik të Elbasanit ishin të pamjaftueshme.

-Në momentin e kontrollit Spitali Psikiatrik në Elbasan, kishte mbipopullim dhe u konstatua mungesë pajisjesh akomodimi.

- Shërbimi i ushqimit paraqitej në kushte të papërshtatshme

- Nga kontrolli rezultoi mungesë artikujsh të higjenës personale.

-Rrezik i pajisjeve të vendosura në dritare.

-U konstatuan mungesa të xhamave të dritareve të dhomave dhe uji të ngrohtë.

-Furnizimi me veshje ndaj pacientëve, ishte i mjaftueshëm.

-Spitali Psikiatrik Elbasan në organikën e tij nuk kishte të punësuar psikologë, punonjës social dhe neurologë, kërkesa të cilat parashikohen si nga ligji ashtu dhe nga vetë nevojat e kurimit të pacientëve.

-Për 320 pacientë që kuroheshin kishte mungesë stafi mjekësor, si dhe kishte mungesa periodike të medikamenteve bazë të trajtimit të rasteve akute, të cilat në mjaft raste kanë detyruar spitalin të kryejë blerje të paautorizuara. Ndërkohë u konstatua një shpërndarje jo e drejtë e medikamenteve nga strukturat e Ministrisë së Shëndetësisë, duke furnizuar nganjëherë spitalin e mësipërm edhe me ilaçe diabeti, për të cilat nuk ka fare nevoja.

- U evidentua se kontrollet dhe inspektimet ndaj këtij institucioni kanë qenë pothuajse inekzistente, përveç vizitës përpara pak kohësh nga inspektimi ynë që kishte bërë Ministri i Shëndetësisë.

Për sa më sipër, i jemi drejtuar Ministrin të Shëndetësisë Zotit Maksim Cikuli, dhe Qendrës Rajonale Spitalore Spitalit të Shërbimit Psikiatrik me rekomandim për përmirësimin e trajtimit ligjor, shëndetësor dhe social të pacientëve të Spitalit Psikiatrik në Elbasan, gjithashtu për këto probleme të konstatuara, nga ana jonë është vënë në dijeni Kryeministri Zoti Sali Berisha, Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë dhe Komisioni i Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut pranë Kuvendit të Shqipërisë.

Në përgjigjen e tij Ministri i Shëndetësisë duke vlerësuar pozitivisht nismën e ndërmarrë nga institucioni ynë në drejtim të standardeve të shërbimit të kujdesit shëndetësor, ka marrë këto angazhime:

“Lidhur me çështje të respektimit të të drejtave ligjore të rezidentëve në strukturat psikiatrike referuar parashikimit se: “Shefi i klinikës, brenda

48 orëve nga dhënia e lejes për shtrim të detyruar, duhet ta paraqesë rastin përpara gjykatësit të vetëm në gjykatën e rrethit ku ndodhet institucioni, shprehim angazhimin tonë se si për ata të cilët aktualisht rezultojnë të shtruar pa pëlqimin e tyre apo të kujdestarit të tyre ashtu edhe për shtrimet e ardhshme, në institucionin psikiatrik të Elbasanit dhe në institucionet analoge në rrethe të tjera të vendit, do të nisin menjëherë dhe ndiqen procedurat e nevojshme ligjore për të përmbushur këtë kërkesë të ligjit dhe të drejtë të individit.

E njëjta gjë do të nisë menjëherë të kryhet edhe për njoftimin nga drejtuesi i institucionit apo shërbimit psikiatrik të gjykatës për rastet kur kujdestari ligjor i personit me çrregullime mendore nuk ka përmbushur detyrimet e tij sipas ligjit, kjo aq me tepër kur në kushtet aktuale siç është vërejtur dhe nga ju ndihma dhe mbështetja nga familjarët apo përgjithësisht, nga kujdestarët ligjorë nuk rezulton.

Më tej, në lidhje me kuotën financiare ushqimore është pranuar se norma në fuqi është relativisht e vjetër, porse ajo ku duhet vënë me tepër theksi ka të bëjë me menyrën e servirjes, ambjentit dhe menyrës se si konsumohet ushqimi për të cilat në kuadrin e ndërhyrjeve që do të kryhen në këtë institucion pritet të përmirësohen.

Referenca e bërë nga ana juaj për mbipopullim, është e lidhur kryesisht me politikën të cilën ka filluar tashmë të ndjekë Ministria e Shëndetësisë pas miratimit prej saj të Politikës së Shëndetit Mendor në vitin 2003 dhe më pas të planit të veprimit në raport me Shëndetin Mendor në mesin e vitit 2005, ku në mënyrë graduale ka filluar tashmë deinstitutionalizimi i institucioneve psikiatrike të përqëndruara e me një numër të konsiderueshëm shtretërisht e personash në drejtim të krijimit dhe mbajtjes së shtëpive të mbrojtura, me një kapacitet e numër shumë më të kufizuar e ku në të cilat do të ofrohet një kujdes multidisiplinor me një rol të kujdesit shëndetësor më të tërhequr në raport me shërbimet sociale e social psikologjike në shërbim të kësaj kategorie.

Ofrimi i kushteve hoteliere dhe infrastrukturore të përshtatshme të vërejtjeve nga inspektimi i bërë dhe që janë konfirmuar edhe nga vizita në terren e Ministrisë të Shëndetësisë do të jenë objekt i një plani masash me synim përmirësues të situatës në secilin prej këtyre institucioneve psikiatrike me theks të veçantë në institucionin e Elbasanit për arsye edhe të situatës, veçanërisht të rëndë, atje”.

Në përfundim, jemi informuar se Ministria e Shëndetësisë është në procesin e hartimit të një plani masash për përmirësimin e gjëndjes në strukturat spitalore psikiatrike dhe hap pas hapi do të vazhdojë të komunikojë ndërhyrjet dhe statusin e gjëndjes pranë këtyre strukturave

psikiatrike. Nga ana tjetër duke patur parasysh edhe kohën relativisht të gjatë nga hartimi i ligjit “Për Shëndetin mendor”, në kuadrin e rishikimit në tërësi të legjisllacionit në këtë fushë, Ministria e Shëndetësisë e konsideron partner dhe vlerësonte maksimalisht bashkëpunimin e institucionit të Avokatit të Popullit, në këtë proces të rëndësishëm.

Me përgjigjen e Drejtorisë së Spitalit Psikiatrik Elbasan është shprehur gatishmëria për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit në drejtim të ngritjes së kualiteteve të shërbimit ndaj të sëmurëve, nëpërmjet hallkave ligjore, përkujdesjes psikike, fizike, sociale dhe reabilituese të tyre, të ushqimit e përmirësimit të kushteve fizike të ambjenteve spitalore, si dhe jemi informuar për disa hapa të bërë për të arritur objektivat e duhura.

Kështu është zbatuar menjëherë rregulli i shtrimit vullnetar nëpërmjet deklaramit të firmosur nga pacienti, për shtrimet e pavullnetshme është marrë deklarimi i kujdestarit familjar. Ndërsa për shtrimet urgjente të pavullnetshme nga juristja e Drejtorisë së Shërbimit Publik është hartuar një kërkesë standart bazuar në nenin 28 të ligjit “Për shëndetin mendor” që ti drejtohen gjykatës.

-Në lidhje me xhamat e munguara, janë dhe vijon vënia e tyre apo rezervimi për një çast të metejshëm.

-Sistemi i ngrohjes qëndrore është riparuar dhe ngrohja ka funksionuar normalisht.

-Per riparimin e nyjeve hidrosanitare i eshte bere kerkese Ministrise se Shendetesise dhe pritet aprovimi i fondit te duhur.

-Në lidhje me paisjen e shtratit të të sëmurëve janë vënë në përdorim të gjitha rezervat, gjithashtu janë shpërndarë 100 batanije në repartet më problematikë të dhuruara nga Spitali i Pergjithshëm. I është bërë propozim Ministrisë së Shëndetësisë për shkurtimin e normativave të paisjeve të shtratit dhe veshjes së të sëmurëve.

-Në lidhje me ushqimin, menecat janë pajisur me stola; është shtuar përkujdesja me pjesëmarrjen e K/infermierëve domosdoshmërisht gjatë këtij procesi, si dhe janë pajisur të gjithë të sëmurët me pjata dhe lugë. Po ashtu dyert e jashtme së shpejti do të pajisen me zgara hekuri.

-Po bëhen përpjekje për vënien në efikasitet më të gjerë rehabilitimi i të sëmurëve dhe përsëri ka vijuar kërkesa për shtesë buxhetore nga Ministria e Shëndetësisë.

-Eshtë bërë veçimi i të shtruarve me prapambetje mendore për meshkuj dhe femra dhe po shikohet mundësia e vendosjes së tyre në një repart të vetëm.

Në përfundim nga ana e autoriteteve rajonale të spitalit është premtuar se po vlerësohet dhe po ndiqet hap pas hapi situata reale e gjëndjes fizike të

spitalit, të pajisjeve të shtratit dhe veshjeve të të sëmurëve, shërbimit në përgjithësi dhe me tendencë për riorganizime në sektorët e shërbimeve për tëju adoptuar nevojave koherente dhe atyre strategjike, vlerësime të cilat do ti nisen Ministrisë së Shëndetësisë për të dhënë mbështetjet e duhura financiare dhe strategjike.

2. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit është paraqitur nga Sekretari i Shoqatës së Talasemikëve ankesa se dhjetra fëmijë që vuajnë nga sëmundja e Talasemisë në spitalet tona, nuk kanë kujdesin e duhur të personelit shëndetësor. Në të njëjtën kohë ata parashtronin se kjo shoqatë ka kërkuar protokoll mjekësor për këtë diagnozë, dhe në kohën e depozitimit të ankeses ky protokoll nuk ishte krijuar. Në vazhdim të letrës së tyre kjo shoqatë parashtronte se nuk ekzistonte një strategji kombëtare për sigurimin e gjakut me cilësi dhe ndjekjen nën kontroll të vazhdueshëm të këtyre fëmijëve. Sa më sipër kjo shoqatë ka kërkuar ndërhyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit për të ndërgjegjësuar strukturat shtetërore në rregullimin e kësaj situate.

Në këto kushte për të krijuar një panoramë të saktë të kësaj çështjeje shumë delikate, Institucioni ynë ndërmori një proces hetimi. Ky proces përfshiu si korespondencën zyrtare me Ministrinë e Shëndetësisë dhe komunikimin e drejtëpërdrejtë me specialistë të fushës, personelin në Qendrën Spitalore “Nënë Tereza” si dhe me drejtues të Qendrës Kombëtare të Gjakut në Tiranë.

Në përfundim, duke marrë shkas dhe nga raporti i paraqitur nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë Zotit Cikuli, Nr. 393 datë 15.09.2005 “Për verifikimin e bartshmërisë së talasemikëve të politransfuzuar për HIV Hepatit B Hepatit C” konstatuam se:

Ekzaminimi i fëmijëve talasemikë për sëmundje që transmetohen nëpërmjet transfuzionit të gjakut duhet të bëhet çdo vit. Ky ekzaminim nuk ishte kryer rregullisht sidomos në rrethe. Në vijim parashtrohet se aktualisht komisioni i Përhershëm i Diagnostikimit dhe trajtimit të Hemoglobinopative pranë QSUT-se ka përpiluar dhe zyrtarizuar protokollin e plotë për ndjekjen shëndetësore të sëmurëve hemoglobinopatë.

Mungesa e zyrtarizimit të këtij protokolli ka qenë një mungesë serioze për plotësimin e nevojave mjekësore të talasemikëve. Sipas raportit përfundimtar të grupit të punës rezultonte ndër të tjera, se kishte mungesa të akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 8032 datë 16.11.1995 “Për shërbimin e transfuzionit dhe kontrollin e gjakut e produkteve të tij dhe transplantimeve”, duke e vënë theksin kryesisht në mungesë të Rregullores së Përgjithshme mbi funksionimin e Shërbimit Kombëtar të Transfuzionit

dhe të Rregullores mbi Kontrollin e Brendshëm dhe të Jashtëm të cilësisë në Shërbimin e Transfuzionit të Gjakut.

Sa me sipër, në vijim të konstatimeve, arritëm në konkluzionin se nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë ka patur mosveprim si në drejtim të mosnxjerrjes së akteve nënligjore, dhe të ushtrimit të presionit për funksionimin dhe kontrollin e organeve që merren me manipulimin e gjakut, produkteve të tij dhe transplantëve.

Për këtë arsye kërkuam nga ana Ministrit të Shëndetësisë Zotit Maksim Cikuli, ndërmarrjen e një procedimi disiplinor ku të evidentohen përgjegjësitë dhe personat përgjegjës për mosveprimin e konstatuar.

Nga ana tjetër, duke evidentuar si një nga faktorët më të rëndësishëm rritjen e cilësisë së gjakut, përshendetëm përgatitjen e strategjisë kombëtare për sigurinë e gjakut, e cila pa dyshim do të shoqërohet me hapa konkretë për implementimin e saj në një të ardhme të afërt.

Në këto kushte i rekomanduam autoritetit të Ministrisë së Shëndetësisë:

Nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 8032 datë 16.11.1995 “Për shërbimin e transfuzionit dhe kontrollin e gjakut e produkteve të tij dhe transplantimeve”, si dhe fillimin e një procedimi disiplinor për evidentimin e përgjegjësive për shkeljet e konstatuara.

Në përgjigje të Rekomandimit tonë, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë jemi informuar ndër të tjera se mosbërja publike e të dhënave të gjetura është shprehje e një përkujdesi të dobët të shërbimeve shëndetësore treguar ndaj fëmijëve talasemikë si rezultat i politikave shëndetësore të ndjekura nga drejtuesit e mëparshëm të Ministrisë së Shëndetësisë. Ndjekja e gjëndjes shëndetësore të fëmijëve talasemikë nuk ka qënë e bazuar në një protokoll zyrtar të miratuar dhe si i tillë një sërë ekzaminimesh të nevojshme, përfshirë këtu dhe kontrollin ndaj agjentëve infektues me përhapje gjaku nuk janë aplikuar me përkujdesje shtetërore. Tashmë gjëndja, sipas informacionit të ardhur, ka ndryshuar, me miratimin zyrtarisht të protokollit të ndjekjes së të sëmurëve me talasemi, është krijuar Komisioni i Hemoglobinopative në QSUT dhe është miratuar “Strategjia për gjak të sigurt”.

3. Avokati i Popullit, në vijim të inisjativave tona zyrtare për t evidentuar dhe vënë para vëmendjes së organeve shtetërore raste të keqadministrimit dhe keqmanaxhimit të shërbimit shëndetësor, bazuar në të dhëna të ëra publike nga Televizioni Top-Channel, Emisioni “Fiks-Fare”, ka ushtruar një inspektim dhe kontroll të ambjenteve të Shërbimit të Konsultës Ortopedike pranë Qendrës së Traumës në Spitalin Ushtarak.

Nga verifikimi dhe kontrolli i gjithanshëm i godinës dhe dhomave ku ofrohej shërbim mjekësor rezultoi se në tërësi ky ambjent ishte jashtë çdo standarti dhe i rrezikshëm për jetën dhe shëndetin si të pacientëve, ashtu dhe të personelit mjekësor të Shërbimit të Konsultës Ortopedike.

Konkretisht u konstatua se godina dy kate, ku punojnë këta mjekë ishte e përmbytur në katin e dytë dhe kati i parë paraqitej me një lagështirë të madhe. Dhomat e mikrokirurgjisë, mjekëve, të radiologjisë, të konsultave dhe të vizitave, nuk kishin xhama, dritare, ngrohje, korrent. Tavanët e të gjitha dhomave pikonin në mënyrë të vazhdueshme ujë dhe paraqesnin rrezik për shembje.

Në këto ambjente nuk konstatohej asnjë element sigurie teknike për godinën, për kushtet higjieno-sanitare të saj, apo për trajtimin me cilësi të pacientëve. Referuar të dhënave të administruara nga ana jonë, rezultonte se në Vitin 2004 Shërbimi i Konsultës së Ortopedisë ishte transferuar në godinën ku ndodhet sot, për arsye të rikonstruksionit të ambjenteve ekzistuese. Nga Ministria e Shëndetësisë ishte komunikuar se periudha e qëndrimit në ambjentet e reja do të ishte shumë e shkurtër dhe kushtëzohej thjesht me disa punime rikonstruksioni të vogla.

Pas përfundimit të këtij rikonstruksioni, megjithë kërkesën e mjekëve, ambjenti i ri ka ndryshuar destinacion duke u kthyer në dhoma të reanimacionit. Në këto kushte, Shërbimi i Konsultës Ortopedike ishte detyruar të ofroje ndihmën e tij mjekësore në ambjentet e godinës së mësipërme prej gati 3 vjetësh, duke marrë premtime të vazhdueshme për transferimin e tij.

Për sa më sipër, i nisëm një rekomandim Ministrit të Shëndetësisë Zotit Maksim Cikuli për mbylljen e menjëhershme të ambjenteve spitalore të Shërbimit të Konsultës Ortopedike dhe transferimin e këtij shërbimi në një vënd tjetër të përshtatshëm për jetën dhe shëndetin e mjekëve dhe pacientëve.

Nga tabloja tepër e rënduar e lartpërmendur, Avokati i Popullit shprehu papajtueshmërinë e tij ndaj këtij primitivizmi të pamërituar ndaj shoqërisë, që ofrohet ende në fushën e shëndetësisë. Në këto kushte, duke dënuar me forcë neglizhencën shtetërore për gjëndjen e konstatuar, Avokati i Popullit i kujtoi Ministrit të Shëndetësisë se për çështjen në fjalë nuk ka ndërhyre asnjë institucion tjetër shtetëror që ka për kompetencë të kontrollojë kushtet higjieno-sanitare, të punës dhe ruajtjes shëndetit dhe jetës së njerëzve.

Po ashtu këto standarte nuk kanë qenë as objekt kontrolli i puns se Inspektoratit Sanitar Shtetëror, i cili detyrohet me ligj të ushtrojë periodikisht një veprimtari të tillë dhe të marrë masa deri në pezullim të

veprimtarisë në godinat që paraqesin rrezik real për jetën dhe shëndetin e individëve.

Në përgjigje të rekomandimit të mësipërm, nga Ministria e Shëndetësisë jemi informuar se: “Shqetsimi i ngritur nga Televizioni Top Channel dhe Institucioni i Avokatit të Popullit lidhur me Shërbimin e Konsultës Ortopedike është analizuar nga Ministria e Shëndetësisë. Duke qënë se ky repart ndodhet në Spitalin Qëndror Universitar të Ushtrisë është biseduar me Ministrinë e Mbrojtjes dhe informohemi se problemi i ngritur nga ana juaj është zgjidhur dhe sot nuk ekziston më”.

4- Pranë institucionit tonë u ankuan disa prej shefave të shërbimeve të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë në lidhje me kërkesën e drejtuar nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, për plotësimin e një formulari (autorizimi), i cili është nxjerrë në zbatim të Statutit të QSUT-së për shmangien e konfliktit të interesave.

Nga shqyrtimi i kësaj çështjeje, konstatuam se autorizimi i kërkuar për t’u plotësuar në këtë rast, bazohej në parashikimet e Ligjit nr.9367 datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, si dhe në përcaktimet e bëra në Statutin e QSUT-së “Nënë Tereza”, për konfliktin e interesave. Tashmë për këtë çështje ne problemin e kemi konsideruar të zgjidhur.

Por nisur nga përmbajtja e aktit administrativ të emërtuar “*Statuti i Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”*”, evidentuam terminologji të përdorura në të, të cilat nuk janë në pajtim me bazën ligjore në fuqi.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështjeje u arrit në konkluzionin që kompetenca e Ministrit të Shëndetësisë konkretisht në këtë rast, ishte miratimi i rregullores së hartuar nga njësitë organizative-administrative që drejtohen prej tij, dhe urdhërimi i zbatimit të kësaj rregulloreje ndaj subjekteve nën varësi, me anë të një Urdhëri perkatës, sepse titullimi si statut nuk kishte bazë ligjore. Ky urdhër duhet të jetë i përbashkët me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Këto konstatime të bëra nga ana jonë gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje, nxorën në pah vetëm një manësi administrative që u ngrit nga ne, në kuadër të mirëfunksionimit të QSUT “Nënë Tereza”. Për sa më sipër, dolëm me rekomandim për: Hartimin dhe miratimin e Rregullores për funksionimin e QSUT-së “Nënë Tereza”, në përputhje me parashikimet e bëra në pikën 6 të VKM nr.70 datë 15.02.2001 “Për statusin e spitaleve universitare”.

Rekomandimi i mësipërm i Avokatit të Popullit, është pranuar tashmë nga Organet drejtuese të spitalit “Nënë Tereza” Tiranë. Në përgjigjen e Drejtorit të QSUT-së citohej se: “Në administratën e QSUT-së ekziston tashmë dhe është në proces përfundimi një projekt rregullore e përgjithshme,

e cila së shpejti do tëi përcillet Ministrisë së Shëndetësisë për miratimin përkatës”.

5- Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit janë paraqitur gjatë vitit 2006 ankesa nga grupe individësh, kryesisht pensionistë, të cilët kanë shfaqur pakënaqësi, duke kundërshtuar pagesën që kryejnë pranë farmacive, ku u duhet të tërheqin barna me rimbursim.

Konkretisht bazuar në Pikën 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.87 dt.15.02.2006 “*Për administrimin dhe mbulimin e shpenzimeve të recetës me rimbursim*” të gjithë pacientët e siguruar që marrin barna me rimbursim, detyrohen të paguajnë recetën rimbursuese me tarifën 100 lekë.

Tarifa e miratuar në vendimin e mësipërm dhe kundërshtimet lidhur me pagimin e saj, janë bërë shkak që Institucioni i Avokatit të Popullit të ndërmerre një verifikim të hollësishëm për këtë çështje, duke kërkuar shpjegime konkrete pranë ISKSH-së.

Sqarimet e prezantuara për aplikimin e kësaj tarife nga Drejtoresha e ISKSH-se Zj. Elvana Hana na informuan se të ardhurat e fituara nga recetat përballonin koston e saj (*me disa elementë shtesë sigurie*) dhe ishin një nevojë reale për administrimin sa më efektiv të fushës së sigurimit shëndetësor. Gjithsesi, sipas Zj. Hana, nga ana e ISKSH-së po shikohej mundësia e reduktimit ose heqjes së kësaj tarife, në përfundim të rezultateve të një studimi që do të maste impaktin financiar konkret të kësaj tarife në të ardhurat e institutit.

Avokati i Popullit pasi u njoh me këtë qëndrim zyrtar, si dhe pasi analizoi në tërësi kuadrin ligjor të fushës së sigurimit shëndetësor, konkludoi se praktika financiare që ishte ndjekur mbi pacientët e siguruar ishte në kundërshtim me të drejtat dhe interesat e tyre ekonomike. Për sa më sipër dolem me rekomandim drejtuar Kryeministrit Zotit Sali Berisha, Ministrit të Financave Zotit Ridvan Bode, dhe Ministrit të Shëndetësisë Zotit Maksim Cikuli, duke argumentuar se:

“Konkretisht administrata shëndetësore që merret me kujdesin ndaj pacientëve, vizitat e tyre dhe dhënien e mjekimit me anë të recetave përkatëse, kryen me këtë rast një shërbim publik, i cili është falas. Ky shërbim sipas skemës së sigurimit shëndetësor mbulohet pjesërisht nga kontributi i të siguruarve dhe pjesërisht nga kontributi i shtetit. Në këtë rast pagesa e një tarife për recetën e rimbursueshme e vë pacientin sigures në pozita aspak favorizuese, pasi atij përveç kontributit që derdh për sigurimet shëndetësore, i duhet të paguajë sërish për recetën që i lëshohet nga mjeku. Nga kjo rrjedhimisht konstatohet se pacientit të siguruar i duhet të paguajë dy herë për të njëjtën shërbim, pavarësisht nga shuma e vogel.

Arsyetimi i ISKSH-së se receta e rimbursueshme kishte karakterin e një fature financiare dhe duhej trajtuar me elementë sigurie që rrisnin koston e saj, argumentuam se nuk duhet të cenonte aspak të ardhurat e të siguruarve.

Kjo sepse në nenin 17 te Ligjit Nr. 8485 dt.12.09.1999 “Kodi i Proçedurave Administrative” parashikohet se:

“Shërbimet e administratës publike janë pa pagesë, përveç rasteve në të cilat ligji parashikon pagesën për shërbimin e ofruar nga administrata”. Në rastin konkret shërbimi i ofruar mbulohet tërësisht nga kontributet dhe nuk mund të aplikohen pagesa të tjera, përveç atyre të parashikuara me ligj. Gjithashtu në këtë rast nuk ishte miratur ndonjë ligj që të caktonte këtë pagesë. Krahas kësaj, pika 3 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.87 dt.15.02.2006 “Për administrimin dhe mbulimin e shpenzimeve të recetës me rimbursim” nuk bazohet dhe nuk është autorizuar nga ndonjë ligj që të miratonte një tarifë të tillë, duke qënë në kundërshtim të hapur me Nenin 118 të Kushtetutes pika 2 në të cilën thuhet se:

“Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte”

Në lidhje me sa më lart, konstatoam se dispozitat e Ligjit Nr. 7870 dt.13.10.1994 “Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) nuk përmbanin autorizime për nxjerrjen e akteve nënligjore në lidhje me caktimin e tarifave të recetave.

S dyti, kostoja e recetës së rimbursueshme është një çështje sigurie dhe kërkonte administrimin sa më efektiv të sigurimit dhe kujdesit shëndetësor. Megjithatë ajo nuk mund t’i faturohet pacientit të siguruar për aq kohë sa kjo tarifë nuk shkon në përfitim të tij, por në të ardhurat e administratës shtetërore.

Së treti kostoja e recetës prej 100 lekë nuk është reale dhe nuk justifikohet aspak me elementët shtesë që i janë vendosur asaj. Kjo për shkak se po t’i referohesh edhe pagesës së certifikatës personale apo familjare si dokument me elemente me të lartë sigurie, ato kanë një tarifë 50 lekë. Gjithsesi kjo kosto, duhet të mbulohej tërësisht nga fondet e dhëna për administrimin e skemës së sigurimeve shëndetësore, pa prekur zëra të tjerë apo të ardhura shtesë nga të siguruarit.

Referuar sa më lart, Avokati i Popullit, duke përcjellë me këtë rast shqetësimin e drejtë të pensionistëve, si shtresa më e prekur, e cila përfiton të ardhura të pakta, ka përcaktuar qëndrimin e tij zyrtar, sipas të cilit tarifa e parashikuar për recetat e rimbursueshme duhej shfuqizuar.

Në përgjigje të interesimit dhe nderhyrjeve tona të vazhdueshme për çështjen e mësipërme, Znj.Elvana Hana me detyrë Drejtoresh e ISKSH-së ka sqaruar se kjo çështje është marrë së fundi në konsideratë nga ana e tyre dhe po shikoheshin të gjitha mundesitë që kjo pagesë të reduktohej.

Gjithsesi sipas Znj.Hana për këtë çështje, po hartohet një projekt vendim konkret, i cili do të kalojë shumë shpejt në Këshillin e Ministrave për miratim.

Avokati i Popullit, duke parë reagimin pozitiv të drejtuesve të ISKSH-së e vlerësoi këtë përpjekje të tyre, e cila do të bëjë të mundur eliminimin e shqetësimit të ngritur nga ana e ankuesve brenda një kohe të shkurtër.

13. Ministria e Punëve të Jashtme

Gjatë vitit 2006 për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ambasadat dhe Konsullatat e Republikës së Shqipërisë jashtë vendit janë shqyrtuar gjithsej 34 ankesa. Nga këto ankesa, 23 rezultojnë të jenë jashtë kompetencës së Avokatit të Popullit, 3 ankesa kanë rezultuar të pabazuara, kurse 8 të tjera janë zgjidhur në favor.

Pjesa më e madhe e ankesave që lidhen me këtë Ministri, kanë të bëjnë me ankesat e qytetarëve shqiptarë për përfaqësitë e vendeve të huaja të akredituara në Shqipëri. Një nga prioritetet e Ministrisë së Jashtme gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, është mbrojtja e interesave jo vetëm të shtetit shqiptar, por dhe të shtetasve shqiptarë që punojnë e jetojnë jashtë vendit. Institucioni i Avokatit të Popullit me ndërhyrjet e tij, pas shqyrtimit të ankesave, ka synuar të ndikojë për mirëqeverisje, jo vetëm tek administrata shqiptare brenda vendit, por edhe tek ajo pjesë e saj që funksionon jashtë Shqipërisë. Institucioni ynë ka nxitur rritjen e vëmendjes së Ministrisë së Punëve të Jashtme për forcimin e konsullatave apo sektorëve konsullorë në ambasadat tona, sidomos në Greqi, Itali, Gjermani, Angli etj, ku jeton një numër i konsiderueshëm i shtetasve shqiptarë, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit konsullor.

Për të gjitha rastet e trajtuara, bazuar në specifikën e tyre, ankuesve ju është dhënë konsulenca e nevojshme juridike apo duke i kaluar për kompetencë edhe pranë Drejtorisë Konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Por kemi arritur në konkluzionin se, angazhimi efektiv i strukturave përfaqësuese të shtetit shqiptar në mbrojtje të interesave të shtetasve shqiptarë që jetojnë e punojnë jashtë vendit përbën çelsin e

zgjidhjes së problemeve të ndryshme që ndeshin këta te fundit në një shtet të huaj.

Nga ankesat e shqyrtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit po përmendim:

1. Ankesen e paraqitur nga Kryeplesia e Fshatit Borje dhe nga banoret e tjere te Komunes Shishtavec Kukes, te cilet kane kerkuar ne menyre te perseritur hapjen e pikes kufitare ne zonen e tyre.

Lidhur me kete ankese Institucioni i Avokatit te Popullit i ka drejtuar nje rekomandim Ministrit te Puneve te Jashtme, ku nder te tjera evidentohet se:

Institucioni i Avokatit te Popullit, gjate aktivitetit te tij te vazhdueshem per evidentimin e shkeljes se te drejtave te njeriut dhe rivenien ne vend te tyre konform standarteve kushtetuese dhe ligjore, ka qene gjithmone i prirur te perkrahe veçanerisht ato shtresa te popullsise, te cilat perballojne aktualisht nje gjendje te rende ekonomike.

Duke shprehur bindjen e plote se thellimi i nivelit te varferise, ndikohet veçanerisht nga gjendja e disa zonave te thella dhe te izoluar te vendit, ku komunikimi, burimet e pakta natyrore dhe shkembimi tregetar jane ne nivele mjaft te ulta per vete kushtet e veshtira gjeografike dhe infrastruktures tejet te amortizuar, mendon se rritja e cilesise se jetes se banoreve te ketyre zonave dhe krijimi i mundesive te barabarta te tyre per tu integruar ne ritmin bashkekohor te zhvillimit ekonomik dhe shoqeror te vendit, duhet te jete nje objektiv kryesor dhe i vazhdueshem i Qeverise Shqiptare dhe i te gjithe organeve te tjera shteterore.

Lidhur me ankesen e paraqitur, pas komunikimeve zyrtare qe Institucioni i Avokatit te Popullit ka patur me Drejtorine e Kufirit dhe Migracionit ne Drejtorine e Pergjithshme te Policise se Shtetit ka rezultuar se ne zbatim te vendimit te Keshillit te Ministrave, Policia e Shtetit ka percaktuar strukturen organike te Pikes Kufitare Borje Kukes, jane bere emerimet e personelit si dhe jane siguruar ambjentet e nevojshme per funksionimin e veprimtarise normale te kontrollit kufitar, por serish kjo pike nuk eshte vene ne funksionim. Arsyeja sipas tyre, ka qene se ne anen tjeter te kufirit nuk eshte krijuar sherbim pike kufitare, pasi midis Shtetit Shqiptar dhe UMNK nuk ka ende nje marreveshje dy paleshe per hapjen e saj.

Institucioni i Avokatit te Popullit ka shprehur mendimin se bashkeveprimi i puneve midis institucioneve qendrore te shtetit eshte nje detyre teper e rendesishme per te patur efekte dhe impakte pozitive ne zbatimin e legjislacionit ne fuqi dhe permbushjes se interesave dhe nevojave te ligjshme te individeve.

Ne keto kushte kemi nenvizuar rendesine qe paraqet veprimtaria diplomatike e Shtetit Shqiptar me Qeverine Kosovare dhe UMNİK, lidhur me lidhjen e nje marreveshje nderkombetare dy paleshe, ku te percaktohet bashkerendimi i veprimeve te ndersjella per hapjen e pikes kufitare prane Fshatit Borje Kukes. Ky veprim do te mundesonte jo vetem nje rinisje te rregullt te procedurave ligjore te hapjes se kesaj pike kufitare, por dhe do te evitonte shpenzimet aktuale qe kryen nga Ministria e Brendshme per mbajtjen e nje efektivit te plote per kete njesi kufitare.

Për të gjitha arsyet dhe konstatimet e përmendura me lart, ku del mese e nevojshme permbushja dhe zbatimimi i dispozitave ligjore ne favor te permiresimit te komunikimit te disa zonave teper te izoluar te vendit, si kusht per te respektuar te drejtat e tyre te shkelura si pasoje e zvarritjeve te procedurave ligjore, Avokati i Popullit ka kerkuar marrjen e masave diplomatike dhe administrative per realizimin e ketij procesi brenda nje kohe te shkurter, konkretisht venien ne zbatim te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr.334 dt.20.05.2005 *“Per hapjen e pikes se kalimit kufitar ne Fshatin Borje te Kukesit, ne kufirin shteteror tokesor te RSH-se me Kosoven”* dhe lidhjen e marreveshjes dypaleshe me Qeverine Kosovare dhe UMNİK per zbatimin e masave te ndersjella per venien ne funksionim te Pikes Kufitare ne fshatin Borje Kukes.

Ne pergjigje te rekomandimit te derguar , nga ana e Ministrit te Jashtem jemi informuar se, “misioni yne ne Prishtine e ka percjelle menjehere Vendimit e Shqiperise prane autoriteteve kompetente ne Kosove dhe ka marre kontakte te vazhdueshme me to. Por pergjigja e tyre, tani per tani, nuk eshte inkurajuese, duke paraqitur nje sere veshtiresish te tilla si: ekzistenca e dy pikave te kalimit ne afersi me fshatin Borje, Shishtavec dhe OrgjostArtjushe, mungesen e infrastruktures, veshtiresite financiare per personel dhe investime etj, pa perjashtuar, sipas tyre, edhe mungesen e deshires se popullsisë kosovare ne kufi me kete zone.

Ne vijim jemi informuar se ne Kosove po vazhdon procesi i transferimit te kompetencave nga UNMIK-u tek autoritetet vendore kosovare, i cili perfshin edhe administrimin e kufijve tokesore me Shqiperine. Nisur nga ky fakt, jane marre kontakte edhe me autoritetet kosovare pergjegjese dhe ata kane premtuar se procedurat per hapjen e kesaj pike kufitare do te fillojne sapo te perfundoje procesi i transferimit te kompetencave.”

2.Ankesen e shtetasit M.K. lidhur me zvarritjen e legalizimit te dokumentave, qe i behej nga zyra e legalizimit te dokumentave te sherbimit konsullor. Ankuesi ishte sekretar i nje noteri dhe kryente legalizimin e dokumentave, sipas rregullave dhe tarifave te vendosura nga Ministria e Drejtesise dhe ishte i pajisur me prokure nga qytetaret, qe te firmoste

dokumenta te ndryshem per jashte shtetit, per arsye se qytetaret nuk kishin mundesi qe t'a kryenin vete kete legalizim, apo nuk ishin ne gjendje ekonomike per te ardhur vete ne Tirane.

Drejtoria Konsullore per arsye te specifikes qe ka legalizimi i ketyre dokumentave, kishte nderprere si brenda vendit ashtu dhe ne perfaqesite jashte shtetit, kete praktike pune te legalizimeve te dokumentave.

Kjo ankese u zgjidh me nderhyrjen e Institucionit. Per t'i ardhur ne ndihme shume qytetareve u be legalizimi i dokumentave, per arsye se shtetasve tane u kalonin afatet ligjore per t'u paraqitur ne shtetet fqinje. Por me kete rast ndoshta duhet pare liberalizimi I procedurave te legalizimit te dokumentave duke u dhene licensa personave te caktuar, sipas procedurave te MPJ. Kjo mund te luante rol pozitiv ne zgjidhjen e shpejte te nevojave te shtetasve tane, per arsye te dokumentave te shumta qe u kerkohen atyre nga shtete te BE-se.

Ne te njejten kohe evidentojme dhe njehere ne kete raport se qe ne vitin 2002 e ne vazhdim, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Drejtësisë i jemi drejtuar me një rekomandim, i cili ka të bëjë me:

- Zbatimin e procedurës së përgatitjes dhe botimit të teksteve zyrtare në gjuhën shqipe të akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë, nga Ministria e Drejtësisë, e cila realizon përkthimin zyrtar të akteve ndërkombëtare të përgatitura për miratim, nga ana e organeve kompetente.
- Realizimin e botimit në gjuhën shqipe të teksteve të konventave dhe marrëveshjeve të ratifikuara nga vendi ynë, teksti i të cilave nuk është botuar në Fletoren Zyrtare, me qëllim që të kenë mundësi të gjithë organet që janë të detyruara t'i zbatojnë ato të njihen më parë me to. Për m tepër holësi është folur në pjesën për Ministrinë e Drejtësisë.

Por, pavaresisht se ky proces paraqet nje rendesi te madhe, rezulton se gjate viteve ne vazhdim nuk është ndërmarrë asnjë hap konkret për të realizuar këtë proces kaq të rëndësishëm dhe që lidhet ngushtë me zbatimin e të drejtave të njeriut në vendin tonë.

Gjithshtu evidentojme se në funksion të realizimit të funksioneve tona kushtetuese e ligjore, bashkëpunimi me grupin e punës të ngritur pranë Ministrise se Puneve te Jashtme, për hartimin e raporteve për zbatimin e Konventave në të cilat vendi ynë ka aderuar ka rezultuar i frytshëm. Përmendim këtu kontributin e dhënë nga Institucioni ynë në Raportin qe shqyrtoi mbledhja e Komitetit per te Drejtat Ekonomike e Social – Kultureore prane Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) paraqitur nga Shteti Shqiptar.

14. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin 2006 kanë ardhur gjithsej 13 ankesa, kurse 3 ankesa i përkasin vitit 2005. Janë të përfunduara 15 ankesa, 2 jane zgjidhur në favor, 2 të pabazuara, 6 janë konsideruar jashtë juridiksionit, 3 jashtë kompetence, si dhe për 2 ankesa është hequr dorë. Ka mbetur në shqyrtim për vitin 2007, vetem 1 ankesë.

Problematika e ankesave që kanë patur të bëjnë me këtë Ministri kanë qënë kryesisht problemet me qeratë e lidhura kur objektet janë ndërtesa shtetërore, për ndihmë financiare për aktivitete sportive, për mospagim të vjetërsisë në punë nga ana e Institucionit pas lirimit nga detyra, për njohje të përfitimeve nga Federata Shqiptare e Notit, për shkeljen e të drejtës së autorit si dhe lidhur me marrëdhëniet e punës.

Nga ankesat që janë në shqyrtim përmëndim një kërkesë të ligjshme që ngrihet nga ana e një grupi qytetarësh, ish punonjës të Hotel “Dajtit”, pas mbylljes së aktivitetit të tij.

Konkretisht, ish punonjësit e larguar nga puna tashmë të Hotel “Dajtit”, të grupuar në Sindikatën përkatëse, kanë paraqitur ankesën e tyre lidhur me mos – zbatimin ende në kohë nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të detyrimit ligjor për shpërblim të vjetërsisë në punë, pas lirimit nga detyra me VKM nr. 146 datë 08.03.2006, për shkak të mbylljes së veprimtarisë ekonomiko-financiare të Hotel “Dajtit”.

Në pergjigjen e ardhur nga Ministria e Kulturës për këtë problem, na u sqarua ndërmjet të tjerave se:

“.... Për sa i përket trajtimit financiar të punonjësve sipas vjetërsisë, Enti i Turizmit nuk mund të bëjë asnjë veprim, sepse në VKM nr. 146 datë 08.03.2006, nuk parashikohet shpërblimi sipas vjetërsisë”.

Referuar sa më lart, duke parë dhe analizuar në tërësi elementët e kësaj çështje, Avokati i Popullit i ka rekomanduar autoritetit të kësaj Ministrie: Respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, referuar në nenin 145 të “Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë,” për lëvrimin e menjëhershëm në kohë të shpërblimit për vjetërsi në punë, pas lirimit nga detyra të ish-punojësve të hotel “Dajtit”.

Kjo çështje konsiderohet ende e hapur nga Zyra jonë, në pritje të qëndrimit të mëtejshëm zyrtar të Ministrisë.

15. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave

Gjatë vitit 2006 janë trajtuar 5 ankesa të drejtuara ndaj Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave kryesisht për problematikën e ndotjes së mjedisit. Nga këto, 2 ankesa kanë qenë jashtë kompetencave, 1 ankesë ka qenë e pabazuar dhe 2 ankesa janë zgjidhur në favor të individëve.

Pergjithësisht Avokati i Popullit vëren se shkak i numrit të ulët të ankesave të paraqitura në fushën e mjedisit është se akoma shoqëria jonë nuk është ndërgjegjësuar plotësisht për ndikimin që ka në jetën dhe shëndetin e saj ndotja e mjedisit. Gjithsesi problemet e mjedisit vazhdojnë të mbeten në qendër të vëmendjes për realizimin e standarteve të kërkuara, jo vetëm të sanksionuara në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, veçanërisht nga Konventa e Arhusit, por edhe nëpërmjet zbatimit korrekt të Ligjit Nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”. Këto përpjekje të Avokatit të Popullit kanë gjetur bashkëpunim të ngushtë edhe me organizatat jo fitimprurëse që punojnë për çështjet mjedisore, prej të cilave janë arritur të mblidhen të dhëna të plota për gjendjen e mjedisit, duke u njohur nga afër në mënyre periodike me botimet e tyre.

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dhe Inspektorati i Mjedisit janë organe të ngarkuara me ligj, që hartojnë politika, mbikqyrin dhe marrin masa parandaluese dhe vënë sanksione ndaj çdo subjekti apo veprimtarie që përmban rrezik të shtuar në fushën e ndotjes së ambientit, dëmtimit të shëndetit të njerëzve dhe ekosistemit në tërësi.

Sipas informacioneve që disponon Avokati i Popullit, problemet e ndotjes në Shqipëri, referuar dhe raporteve ndërkombëtare zyrtare apo organizatave joqeveritare, vazhdojnë të jenë të mëdha dhe mjaft të drejtperdrejta për shëndetin e qytetarëve.

Ne jemi të vetëdijshëm se ndotja kërkon projekte dhe financime të mëdha për rehabilitim dhe pastrim. Por kjo nuk do të thotë që të nënvlerësohet puna që duhet të bëjnë organet e ngarkuara me ligj për konstatimin e ndotjes, marrjen e masave për shmangien nga rreziqe të ndryshme të popullsisë që banon përreth etj. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave duhet të tregojë një vëmendje të veçantë gjatë procedurave për dhënien e lejeve mjedisore në favor të subjekteve, pasi ka të dhëna se në disa raste këto leje jepen formalisht, duke mos kryer kontroll paraprak mbi përmbushjen e kriterëve mjedisore. (*Rasti i fabrikës së baterive, Shkozë, Durrës*).

Avokati i Popullit ashtu siç u përmend edhe më lart ka evidentuar dhe ka nderhyrë për raste ku nëpërmjet ankesave të qytetarëve në zona të

ndryshme në vend, është vënë re se Inspektoratët Rajonalë të Mjedisit luajnë një rol inaktiv në përmbushjen e detyrave të tyre funksionale. Konkretisht është konstatuar se këto struktura nuk arrijnë të kryejnë inspektimet minimale në bazë të ankesave të paraqitura. Kjo nga ana e tyre justifikohet shpesh për mungesë të logjistikes së nevojshme. Por pavarësisht kësaj, mosveprime të tilla kanë sjellë që ankesat e individëve të ngelen pa zgjidhur për një kohë relativisht të gjatë, gjë që ka shkaktuar pa të drejtë vazhdimin eventual të ndotjes së mjedisit apo rrezikimin e jetës dhe shëndetit të tyre.

Gjithashtu është konstatuar se inspektimet dhe kontrollet ndaj subjekteve të ndryshme apo në terrenet e ndotura, kryhen vetëm nepërmjet ankesave apo urdhrave që vijnë nga ministria e linjës ose nga njoftimet në media dhe nuk janë pjesë e një strategjie kontrolli të mirëorganizuar me iniciativën e tyre.

Kjo menyrë organizimi e punës, vazhdon të ngelet një handicap i madh, i cili duhet të përmirësohet konform legjislacionit në fuqi. Forca e ligjit që duhet të veprojë në kuadër të mbrojtjes së mjedisit dhe parandalimit të ndotjes, duhet të jetë e menjëhershme, sepse nga vetë natyra e saj, ndotja përfaqëson një rrezik real, që nuk i përngjan asnjë lloj fenomeni tjetër në fushën e administrimit shtetëror.

Krahas kësaj, vazhdon të konstatohet se prania në terren e inspektorëve të mjedisit nuk shoqërohet me mjete dhe pajisje matëse për ndotjen, por detyrimisht është kërkuar ndihma e specializuar e strukturave të tjera shtetërore, gjë që kërkon kohën dhe procedurat e duhura burokratike, të cilat vonojnë efektivitetin e këtij shërbimi.

Mungesa logjistike në aparatura të posaçme bashkëkohore, ka sjellë përveç kësaj që verifikimet e kontrollet, të mbartin një peshë subjektive dhe të mos prezantojnë realisht ndikimet në terren të ndotjeve të ndryshme. Si rezultat i këtyre mangësive, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dhe Inspektorati i Mjedisit e ka të pamundur të jap një opinion zyrtar mbi gjendjen e mjedisit, çka e detyron ndonjëherë atë të bëjë deklarata aspak të besueshme, siç ishte ajo se fundi mbi nivelin e pranueshëm të ndotjes së ajrit në Tiranë.

Duke e konsideruar veprimtarinë e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave mjaft të rëndësishme për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe ambientit që na rrethon, mendojmë se veprimtaria e saj duhet të jetë më tepër aktive në të ardhmen, me qëllim përmbushjen sa më mirë të standarteve të kërkuara. Rast për të ilustruar inaktivitetin sidomos të inspektorateve rajonale të mjedisit, është mungesa e kontrollit të nivelit të ndotjes në stacionet hekurudhore, fakt i cili u evidentua nga një inspektim i Avokatit të Popullit që është pasqyruar me gjerësisht në rubriken perkatse.

Dy rastet e zgjidhura në favor janë si vijon:

- Rasti i parë ka qenë shqetësimi i përsëritur drejtuar Avokatit të Popullit nga disa banorë të një pallati në afërsi të qendrës së Tiranës, të cilët kanë pretenduar së një subjekt privat i përpunimit dhe tregtimit të peshkut ndot në mënyrë akustike banesat përreth. Në lidhje me këtë ankesë, Avokati i Popullit ka kërkuar menjëherë nga ana e Inspektoratit të Mjedisit dhe Institutit të Shëndetit Publik, marrjen e masave të kqyrjes së ambjentit dhe evidentimit të mundshëm të ndotjes.

Nga përgjigjet e paraqitura pranë Avokatit të Popullit është bërë e njohur se Inspektorati Rajonal i Mjedisit Tiranë dhe Instituti i Shëndetit Publik kishin kryer matjet e duhura të vibrimit dhe zhurmave në banesat e ankuesve, nga ku ishte konstatuar ndotje akustike tej limiteve të lejuara nga ana e makinerive ftohëse të subjektit privat, sidomos gjatë periudhës së natës. Në këto kushte, nga ana e Inspektoratit të Mjedisit është marrë masa e pezullimit të përkohshëm të veprimtarisë, deri në eliminimin e problemeve teknike të pajisjeve që krijojnë zhurma dhe virbrime jashtë normave të lejuara.

- Rasti i dytë ka të bëjë me ankesën e një individi nga qyteti i Lushnjës, i cili pretendoi pranë Avokatit të Popullit se një subjekt privat ndot vazhdimisht ambjentin përreth, duke vënë në punë dy gjenerator të mëdhenj për furnizim me energji elektrike. Kjo ndotje megjithëse ishte vënë në vëmendjen e Inspektoratit të Mjedisit, nga ana e këtij organi nuk ishte marrë asnjë masë, qoftë dhe kontrolli mbi pajisjet zhurmuese. Avokati i Popullit në vijim të ndjekjes së kësaj ankese, kërkoi menjëherë nga ana e Inspektoratit Rajonal të Mjedisit Fier, që të ushtronte detyrat e tij konform ligjit për këtë çështje. Pas kontrollit që u ushtrua për këtë qëllim, u bë e mundur që gjeneratorët të zhvendosnin pozicion, gjë e cila minimizonte në maksimum ndotjen akustike dhe të ajrit për banorët përreth.

Si rrjedhim i konstatimeve të lartpërmendura, Avokati i Popullit do të kërkojë vazhdimisht që aktiviteti i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave të realizohet me plane dhe strategji të afta për të ju ndodhur sa më pranë problemeve të komunitetit.

Probleme për pyjet

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Pyjeve dhe Drejtorinë e Shërbimit Pyjor në rrethe ka patur 3 ankesa, nga të cilat 2 kanë rezultuar të pabazuara dhe 1 është zgjidhur në mënyrë pozitive.

Kjo ankesë është paraqitur nga Shoqata Atdhetare e Fshatit Kuç Vlorë, lidhur me cënimin e fondit pyjor të këtij fshati nga ana e personave të

panjohur, në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi. Krahas kësaj, ata janë ankuar për institucionet shtetërore përgjegjëse në Vlorë, të cilat megjithë njoftimet e shumta nuk kishin nderhyrë për te parandaluar shkatërrimin e fondit pyjor dhe ndëshkimin e autorëve përgjegjës.

Nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit u kerkuan shpjegime pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Vlorë dhe Kryetarit të Komunës Kuç, duke vënë njëkohësisht në dijeni edhe Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave.

Ne përgjigje të interesimit të Avokatit të Popullit, Drejtori i Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Vlorë, ka sqaruar hollësisht situatën e pyjeve pranë Komunës Kuç Vlorë dhe menyrën e administrimit të tyre. Krahas kësaj nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Vlorë jemi informuar se cënimet e fondit pyjor kanë qenë minimale, por është abuzuar me planifikimin e prerjeve në parcelat përkatse tej normës së lejuar. Për rrjedhojë kjo drejtori ka percjellë pranë Avokatit të Popullit një kopje të akt-marrëveshjes së nënshkruar me përfaqësuesit e Komunës dhe me Shoqatën Atdhetare Kuç, ku ndër të tjera është kërkuar bashkëpunim dhe rakordim për të shfrytëzuar ligjërisht dhe në mënyrë të kontrolluar fondin pyjor përkatës. Kjo akt-marrëveshje për përfaqësuesit e shoqatës ishte një zgjidhje e drejtë e shqetësimit të tyre dhe aktualisht ajo po zbatohet në terren.

Pavaresisht ankesës së mësipërme, Avokati i Popullit nisur edhe nga pasqyrimet në media të veprimtarisë së paligjshme që kryhet në dëm të fondit pyjor, vëren se kjo çështje duhet të gjejë një vëmendje akoma më të madhe nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave.

16. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

Gjatë vitit 2006 për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit janë regjistruar 19 ankesa. Në favor të shtetasve janë zgjidhur 3 të tilla. Kryesisht ankesat e paraqitura kanë patur për objekt largimet nga puna. Në këtë kuadër vlen të theksohet ankesa e shtetasit Y.G. me banim në Pogradec, i cili ankohej ndaj MBUMK për neglizhenca në ekzekutimin e një vendimi gjyqësor. Konkretisht ai shprehet se në tetor 2005 është larguar nga detyra e tij si Drejtor i Bordit të Kullimit në Pogradec dhe se për këtë, ka pretenduar shkelje të të drejtave të tij duke iu drejtuar më pas Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe Gjykatës së Apelit në Korçë. Gjykatat i kanë

dhënë atij të drejtë, duke vendosur që shtetasi Y.G. duhet të përfitonte 10 paga mujore.

Më tej ai shton se nga ana e Zyrës së Përmbarrimit Tiranë, ishin kryer të gjitha procedurat përkatëse ligjore për të mundësuar ekzekutimin e këtyre vendimeve gjyqësore. Procedura ishte refuzuar nga MBUMK me pretendimin se kishin paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Ky justifikim ishte në kundërshtim të plotë me ligjin, qëndrim i cili mbështetej edhe nga Zyra e Përmbarrimit Tiranë, që e konsideronte këtë pretendimin të Drejtorisë Juridike të MBUMK si të pabazuar. Zyra e Përmbarrimit kishte ndjekur të gjitha procedurat ligjore për ekzekutimin e plotë të këtij vendimi, duke aplikuar sanksionin e gjobës ndaj Sekretarit të Përgjithshëm të MBUMK, pasi kishte kaluar afati për ekzekutim vullnetar dhe akoma nuk ishte përmbushur detyrimi ndaj palës kreditore. Në vazhdim të shqyrtimit dhe verifikimit të kësaj ankese nga ana e institucionit tonë, i kemi drejtuar një rekomandim Sekretarit të Përgjithshëm të MBUMK për përshpejtimin e procedurave për ekzekutimin e vendimit gjyqësor në favor të shtetasit Y.G. Pas ndërhyrjes tonë, kemi marrë konfirmimin se nga ana e MBUMK është lëshuar autorizimi për likuidimin financiar të ankuesit, duke e zgjidhur çështjen përfundimisht në favor të tij.

Në këtë pjesë të Raportit, do të prezantojmë dhe ankesat që kemi patur për çështje të ligjit “Për tokën”.

Ankesa për çështje të Ligjit “Për Tokën”

Ankesat që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën” dhe kontestimet e ish pronarëve të tokave bujqësore për këtë Ligj janë 3 ankesa. Të gjitha këto ankesa kanë të përbashkët faktin, se ankuesit pretendojnë se nuk janë pajisur plotësisht apo pjesërisht me tokë bujqësore sipas normave për frymë, bazuar në Ligjin e mësipërm “Për Tokën”.

Ulja e ndjeshme e ankesave për çështje që kanë të bëjnë me problemin e kalimit në pronësi private të tokës bujqësore është në rradhë të parë për faktin se ky proces, pas shumë debateve dhe oshilacioneve gjatë 15 vjetëve, po i afrohet përfundimit të tij.

Megjithatë objekti i ankesave të familjeve bujqësore adresuar institucionit tonë mbetet i njëjtë: mosdhënia apo mosplotesimi me tokë bujqësore në pronësi i subjekteve që përfitojnë nga Ligji nr.7501, datë 19.7.1991 “Për Tokën” dhe akteve nënligjore dalë në zbatim të tij. Edhe shkaqet mbeten të njëjta: mos funksionimi i komisioneve të tokave në shumë fshatra, megjithëse ekzistojnë formalisht, mungesa e vullnetit të tyre për të

trajtuar familjet e mbetura pa tokë për shkaqe të ndryshme, mos ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë me te cilat janë detyruar komisionet e tokës në fshat apo komunë për trajtimin e gjyqfituesve sipas legjislacionit për tokën. Por problemi më shqetësues mbetet mungesa e vënies së fondit të tokës bujqësore të lirë në dispozicion të komisioneve të tokave për t'u ndarë familjeve bujqësore që për shkaqe të ndryshme, kryesisht për krijimin e mbivendosjeve të parcelave nga puna e papërgjegjshme e disa komisioneve në fshatra dhe komuna, ka krijuar një kategori të veçantë subjektsh përfituese pa tokë. Një ankesë e veçantë ka qënë ajo e shtetasit S.U. i cili me të drejtë ankohej ndaj Komisionit të Tokës në Komunën Kastrat të rrethit Malësi e Madhe, sepse nuk e kishte pajisur me tokë në bazë të legjislacionit në fuqi. Lidhur me këtë ankesë, institucioni i Avokatit të Popullit ndërmori një procedurë hetimi, duke iu drejtuar me kërkesë për shpjegime Kryetarit të Komisionit të Tokës së Komunës. Në pergjigje ai, na ka konfirmuar faktin se ankuesi nuk është pajisur me tokë dhe kjo për faktin se toka në atë zonë ishte ndarë sipas kufinjve të vjetër. Duke e cilësuar këtë fakt si shkelje të rëndë të të drejtave të ankuesit për të përfituar nga Ligji “Për Tokën” si dhe një mosrespektim të dispozitave ligjore nga ana e Komisionit të Tokës, i jemi drejtuar me rekomandim Komisionit të Tokës së Qarkut Shkodër për shqyrtimin në mbledhjen sa më të afërt të këtij Komisioni të pretendimeve të ankuesit dhe shpalljen e një vendimi nga ana e këtij Komisioni lidhur me rastin në fjalë. Për këtë rekomandim nuk kemi marrë akoma një përgjigje.

17. Ankesat per administraten e Sherbimit Informativ Shtetëror

Gjate vitit 2006 ne Institucionin e Avokatit te Popullit kane ardhur 11 ankesa, kunder veprimeve apo mosveprimeve te administrates se Sherbimit Informativ Shteteror (SHISH), kryesisht nga punonjes te ketij sherbimi per largime nga puna.

Per shkak te natyres se sherbimeve, ankesat dhe kerkesat jane pare me perparesi dhe kujdes te posaçem, duke i verifikuar dhe kerkuar pergjigje nga administrata Sherbimit Informativ Shteteror ne menyre zyrtare. Si rrjedhoje, pas shqyrtimit dhe verifikimit te tyre, ka rezultuar se keto ankesa kane qene te pabazuara per arsye te reformimit dhe ristrukturimit te Sherbimit Informativ Shteteror.

Si baze ligjore ne largimin nga puna si punonjes te Sherbimit Informativ Shteteror eshte perdorur pika “d” e nenit 45 te ligjit 9347, date

17.3.2005 “Per Statusin e punonjesit te Sherbimit Informativ Shteteror”. Kjo me synimin qe keta persona te vazhdonin te trajtoheshin nga ana financiare.

Nga pergjigjet zyrtare te Sherbimit Informativ Shteteror, per ankesat qe shqyrtoheshin nga zyra jone, del se reformimi eshte bere mbi bazen e Urdherit te Kryeministrit dhe Urdherit te Titullarit te Institucionit. Eshte e drejte ligjore e Drejtorit te ketij institucioni qe te beje emerime, levizje ne detyre apo edhe largime nga detyra, ne baze te legjislacionit ne fuqi.

Nder ankesat e ardhura veçojme ankesen e shtetasit P.R., i cili pretendoi se telefoni tij celular pergjohej per shkak te konflikteve qe ai kishte me Ministrine nga e cila ai varej. Pas verifikimeve zyrtare ne strukturen e posaçme per pergjimet, qe funksionon sipa ligjit perkates prane Prokurorise se Pergjithshme, rezultoi se ankesa e ketij shtetasi ishte e pabazuar.

18. Veprimtaria e Nenseksionit te te Drejtave te Femijeve

Nenseksioni i te Drejtave te Femijeve u krijua si embrion ne Prill te vitit 2004, si pjese e Seksionit te Pergjithshem te Institucionit te Avokatit te Popullit, mbi bazen e nje marreveshjeje midis Institucionit te Avokatit te Popullit dhe Organizates Save the Children. Avokati i Popullit synon te jape nje kontribut te veçante ne luften per mbrojtjen e te drejtave te femijeve, si me ane te trajtimit te ankesave individuale ashtu dhe te hetimit me iniciativen e tij te rasteve te bera publike. Gjithashtu edhe me ane te shqyrtimit te legjislacionit dhe rekomandimeve per ndryshime apo permiresime te nevojshme.

Organizatet jofitimpruese vendase dhe te huaja, luajne nje rol te rendesishem duke u siguruar sherbime te ndryshme femijeve-viktima, si asistence ligjore falas, bejne pune hulumtuese, publikojne raporte mbi gjendjen e te drejtave te femijeve, si dhe organizojne trajnime te ndryshme per edukimin e zyrtareve publike duke rritur ndergjegjesimin e tyre. Per kete arsye, eshte i rendesishem krijimi i mekanizmave te bashkepunimit me to. Ne kete kuader ka filluar dhe bashkepunimi i Zyres sone me Save the Children. Ne Janar 2006 projekti eshte ridimensionuar me afat 3-vjecar dhe mbeshtetjen financiare te SIDA-s (Agjensia Suedeze per Zhvillim).

Projekti perfshin shume aktivitete per mbrojtjen e te drejtave te femijeve ne perputhje me Konventen, instrumentat e tjere nderkombetare, ligjet dhe aktet nenligjore ne fuqi ne Republiken e Shqiperise. Gjithashtu projekti perfshin rritje te ndergjegjesimit te opinionit publik per misionin

dhe rolin e Nenseksionit per te drejttat e femijeve, ndertim kapacitetesh, asistence teknike, mbeshtetje infrastrukturore, forcim institucional, pune kerkimore, nderhyrje direkte ne rast shkelje te te drejteve te femijeve, pjesmarrje te femijeve, etj. Me konkretisht, disa nga aktivitetet me te rendesishme te projektit jane krijimi i nje ambjenti vetem per femijet prane zyres se Avokatit ne Tirane, ngritja e dy qendrave rajonale per femije, angazhim aktiv ne hartimin e raporteve alternative per zbatimin e Konventes, zgjerim te stafit te Nenseksionit jo vetem me juriste por edhe me punonjes sociale, psikologe, sociologe, mjekte etj, ngritjen e nje librarie per te drejttat e femijeve, bashkepunim dhe koordinim i punes me institucionet shteterore dhe shoqerine civile, monitorim i legjislacionit aktual dhe propozime per ndryshim, etj.

Rezultatet e pritshme nga projekti me "Save the Children"

1. Fuqizimi dhe kualifikimi i metejshem i kapaciteteve njerezore te Zyres se Avokatit te Popullit e ne veçanti te Nenseksionit per te Drejttat e Femijeve per te bere nje mbrojtje me te mire e profesionale te te drejtave te femijeve.

2. Krijimi i nje biblioteke te veçante per te drejttat e femijeve, qe do t'i sherbeje grumbullimit te informacionit mbi praktikat me te mira lidhur me mbrojtjen e te drejtave te femijeve.

3. Krijimi i nje baze te nevojshme per nje ambjent miqesor per femijet ne punen e Nenseksionit.

4. Lehtesimi i komunikimit me femijet me ane te hapjes se nje linje telefonike direkte komunikimi per ankesat dhe nje faqe website.

Permiresime te metejshme

1. Gjate 2006 eshte nisur studimi krahasues i legjislacionit shqiptar per femijet me Konventen e Kombeve te Bashkuara per te Drejttat e Femijeve. Ky studim pritet te perfundoj ne 2007 dhe bazuar ne gjetjet e tij do te pergatitet edhe rekomandime konkrete per permiresimet e legjislacionit.

2. Po keshtu nga Nenseksioni mbetet shume per tu bere ne kuadrin e sensibilizimit te opinionit publik, per ekzistencen, punen e misionin e tij ne mbrojtje e te drejtave te femijeve. Per kete do te zhvillohen fushata promovimi dhe do te mbahen kontakte te rregullta me median. Gjate 2007 do te punohet per ndergjegjesimin e femijeve per te drejttat e tyre.

3. Duhet te punohet ne drejttim te ngritjes se nje sistemi referimi te rasteve per femijet, me pjesemarrjes te shoqerise civile dhe institucioneve shteterore qe ofrojne sherbime per femijet. Hapi i pare do te jete identifikimi dhe hartezimi i institucioneve/organizatave dhe sherbimeve qe ata ofrojne e me pas bashkerendimi i dhe koordinimi i rasteve.

4. Duhet te punohet me median lokale, jo vetem ne drejtim te marrjes se informacionit per shkeljet e te drejtave te femijeve por edhe ne promovimin e te drejtave te femijeve.

Nenseksioni aktualisht ka tre zyra: nje prane Zyres Qendrore te Avokatit te Popullit dhe dy zyra Rajonale, nje ne Shkoder dhe nje ne Korçe. Ne çdo zyre punojne dy juriste. Keshtu, stafit te Institucionit te Avokatit te Popullit, i jane bashkangjitur pese juriste te cilet paguhen nga Save the Children.

Gjate vitit 2006 Nenseksioni per te Drejtat e Femijeve ka punuar kryesisht ne drejtim te ngritjes se zyrave rajonale te NDF-se, plotesimit te stafit te tyre dhe promovimit te Nenseksionit ne nivel kombetar e rajonal.

Lidhur me veprimtarine e Nenseksionit gjate vitit 2006, si pjese organike e veprimtarise se Avokatit te Popullit, mund te perqendrohemi e te permbledhim keto drejtime kryesore:

1. Ngritja e Zyrave Rajonale te NDF-se ne Shkoder dhe Korçe

Nje nder aktivitetet kryesore te Nenseksionit ka qene hapja e dy zyrave rajonale ne Korçe dhe Shkoder. Per kete jane marre kontakte te vazhdueshme me perfaqesuesit e pushtetit vendor te Korçes dhe Shkodres per dhenien e ambjenteve te pershtatshme per zyrat. Rikonstruktimi, pajisja dhe menaxhimi i ketyre dy zyrave rajonale eshte mundesuar dhe mbeshtetur nga projekti i perbashket i zyres se Avokatit te Popullit me Save the Children dhe SIDA.

Keshtu ne Shkoder jane marre ne perdorim dy ambjente prane Prefektures Shkoder ku njera sherben si zyre per ekspertet dhe zyra tjeter e pajisuar me infrastrukture miqesore per femijet do te sherbej per takimet me rastet dhe veçanerisht femijet. Ambjentet feminare jane te parat te ketij lloji ne nje zyre shteterore. Kjo zyre u perurua ne 7 Nentor dhe ne te moren pjese Avokati i Popullit, perfaqesues te pushtetit vendor: Kryetari i Bashkise, Kryetari i Qarkut Shkoder, Prefekti, Drejtori i Drejtorise Arsimore etj, OJF lokale dhe media.

Ndersa fale bashkepunimit me Prefekten e Korçes dhe Drejtorit te Pergjithshem te Telekomit, u be e mundur hapja e Zyra Rajonale e Korçes prane godines se Albtelekomit te Korçes. Kjo zyre u inagurua ne 22 Dhjetor me pjesemarrjen e faktoreve kryesor te pushtetit vendor.

Funksionet kryesore te zyrave rajonale jane:

1. te presin ankesat mbi çeshtjet e shkeljeve te te drejtave te femijeve.

2. te monitorojne zbatimin e te drejtave te femijeve ne institucionet shteterore rajonale
3. te vendosin dhe forcojne bashkepunimin me aktoret kryesor rajonal per te drejtat e femijeve dhe te ngre nje sistem bashkepunimi te ndersjellte
4. te promovojne te drejtat e femijeve ne rajonin perkates.

Hapja e ketyre zyrove rajonale do te lehtesoje procesin e ankimit te qytetareve edhe per çeshtje te tjera prane Institucionit te Avokatit te Popullit, pasi do te jete me e lehte dhe afer gjeografikisht ndaj institucionit tone. Keshtu, megjithe kohen e shkurter te funksionimit te ketyre zyrove, ka patur nje numer te rritje te ankesave te depozituara ne keto zyra rajonale.

2. Aktivitetet e Nenseksionit per te Drejtat e Femijeve gjate 2006: jane shtrire ne tre drejtime kryesore: promovimit te zyrove rajonale, monitorimi dhe studimi i te drejtave te femijeve dhe advokimi per çeshtje specifike.

A. Promovimi i Nenseksionit dhe te drejtave te femijeve:

Takimi me Forumin e Zerit 16+ ne Elbasan: Ne kuader te promovimit dhe informimit te femijeve per ekzistencen e Nenseksionit u zhvillua nje takim i hapur me 50 femije te Forumit te Zerit 16+ ne Elbasan. Ky eshte grup femijesh, nen mbeshtetjen e Save the Children, punojne ne drejtim te advokimit te te drejtave te femijeve. Femijet ishin shume te interesuar ne drejtim te informacionit mbi Institucionin e Avokatit te Popullit, rolin dhe veprimtarine e funksionimi i tij, dhe ne veçanti mbi Nenseksionin per te Drejtat e Femijeve dhe mundesise per bashkepunim ne te ardhme. Gjithashtu me femijet u diskutuan te drejtat e parashikuara ne Konventen e Kombeve te Bashkuara per te Drejtat e Femijeve dhe si mund te promovojme dhe permiresojme zbatueshmerine e tyre.

B. Monitorimi i zbatimit te te drejtave te femijeve:

B.1 Monitorimi i qendrave residenciale:

Monitorim i dy qendrave residenciale ne Shkoder: Zyra e NDF-se ne Shkoder gjate muajit dhjetor 2006 ka zhvilluar vizita monitoruese ne dy qendra residenciale per femijet: Qendra e Misionareve te “ Nene Tereza “ dhe Qendren Residencial publike Shtepia e Femijes parashkollor 3 – 6 vjeç. Keto vizita kishin ne thelb monitorimin e zbatimit te standarteve te sherbimeve sociale, nevojat e ketyre qendrave per zbatimin efektiv te standarteve ne fjale, intervista me femije etj. Nga takimet e zhvilluara rezulton se ne Qendren jo-publike “Nene Tereza” kushtet ishin me te

pershtatshme per femijet se ato ne qendren publike Shtepia e Femijes sidomos ne drejtim te numerit te femijeve te akomoduar per dhome dhe sistemit te ngrohjes se godines. Shkak per kete ishin mungesat ne buxhet per kryerjen e investimeve si dhe perballimin e shpenzimeve per ngrohje.

B.2 Monitorimi i shtypit per respektimin e te drejtave te femijeve: Ne kuader te projektit te perbashket me SIDA dhe Save the Children, u kontraktua Instituti i Medias Shqiptare per te zhvilluar monitorimin e medias se shkruar mbi pasqyrimin e te drejtave te femijeve ne media. Per kete, u monitoruan per nje muaj 6 gazeta me numrin me te madh te kopjeve te shitura.

Ne pergjithesi, verehej nje lloj njetrajtshmeria persa i perket larmise se temave mbi femijet te pasqyruara ne gazetate e perditshme te monitoruara. Arsyeya kryesore per pasqyrimin e femijeve ne faqet e gazetave zakonisht ishte ndonje konference per shtyp ose raport i botuar nga ndonje organizate vendase apo nderkombetare. Ne kete drejtim, kishte nje mungese te theksuar te nismave spontane nga vete gazetate per te pasqyruar me iniciativen e tyre te drejtat e femijeve ne gazetate e perditshme, me disa perjashtime te pakta. Gjithashtu, keto gazeta nuk tregonin ndonje perpjekje per te ndjekur keto ceshtje me vone, pas botimit te raporteve.

Disa nga rekomandimet e nxjerra nga monitorimi jane:

- Gazetaret duhet te rrisin pasqyrimin e problemeve te femijeve ne media dhe ta zgjerojne ate edhe me analiza te gjendjes se te drejtave te femijeve;

- Gazetaret duhet t'i trajtojne femijet si gjithe njerezit e tjere dhe jo ne menyre paternaliste, sensacionale, viktimizuese, apo shfrytezuese;

- Duke pasur parasysh gjithe kujdesin qe duhet treguar kur trajton femijet, gazetaret duhet te perpiqen te rrisin pranine dhe vizibilitetin e femijeve ne media;

- Gazetaret duhet te tregojne vemendje te vecante per gjuhen dhe termat qe duhen te perdoren, sidomos kur pasqyrohet krimi dhe drejtesia per te mitur;

- Gazetaret gjithnje duhet te kene parasysh perkufizimin e interesit publik te Kodit te Etikes kur marrin vendime per te intervistuar femijet dhe per te botuar informacion rreth tyre.

Ky raport dhe analize eshte planifikuar qe te diskutohet ne nje tryeze te rumbullaket me perfaqesues te medias dhe KKRT gjate vitit 2007.

B.3 Studimi mbi perputhshmerise se legjislacionit shqiptar me Konventen per te drejtat e Femijeve. Ne kuader te projektit te perbashket me

Save the Children ka nisur studimi i detajuar i perputhshmerise te kuadrit ligjor shqiptar me Konventen per te Drejtat e Femijeve. Kjo analize po kryehet nga Klinika Ligjore per te Miturit. Studimi synon te permbledhe ne nje dokument te gjithe legjislacionin shqiptar per femijet dhe praktikat perkatese ne gjykate dhe organet administrative. Nje pjese kryesore e studimit do te jene gjetjet dhe rekomandimet per permiresimet legjislative per te drejtat e femijeve. Ky studim mund te sherbeje si nje baze e mire per te lehtesuar pergatitjen e Kodit te Femijeve qe eshte planifikuar per t'u pergatitur nga Ministria e Drejtesise gjate vitit 2007. Metodologjia e studimit eshte konsultuar me nje eksperte Norvegjeze per te drejtat e femijeve si dhe eshte diskutuar ne dy tryeza te rumbullaketa te zhvilluara gjate muajit Nentor. Tryeza e pare(24.11.2006) u zhvillua me pjesemarrjen e Avokatit te Popullit, Anetare te Gjykates se Larte, Gjyqetare te Gjykates se Rrethit, Prokurore dhe perfaqesues te Zyres se Permbarimit ne Tirane, Shkolles se Magjistratures dhe Fakultetit te Drejtesise. Ndersa tryeza e dyte(27.11.2006) u zhvillua me pjesemarrjen e perfaqesuesve te Ministrive te Linjes dhe OJF-te qe punojne me femijet. Ne keto tryeza u diskutuan metodologjia dhe gjetjet paraprake te studimit.

C Advokim per ceshtje te caktuara:

Tryeza e Rrumbullaket "Mbrojtja e femijeve, detyrim kushtetues dhe ligjor", date 25.10.2006: Gjate trajtimit te ankesave te zyres se Avokatit te Popullit jane vene re shkelje te te drejtave te femijeve te shoqeruar nga organet e policise. Per kete arsye u zhvillua nje tryeze e rrumbullaket me perfaqesues te Drejtorise se Qarkut Tirane, Komisariateve te Tiranës dhe Seksionit per te Miturit prane Ministrise se Brendshme dhe Ministrise e Drejtesise. Gjate diskutimit u trajtuan shume probleme qe lidhen me shoqerimin e femijeve ne komisariate. Disa nga sygjerimet e dala nga takimi mbi kete pike ishin:

Mungesa e infrastruktures per te miturit: Te pershpejtohet procedura per kalimin e dhomave te paraburgimit nen administrimin e Ministrise se Drejtesise.

Krijimi i ambienteve miqesore per femijet ne Komisariate dhe dhomat e paraburgimit.

Te hapen sektoret per te miturit prane Drejtorive te Qarqeve te Policise.

Te ngrihen institucione per rehabilitimin e femijeve nen 14 vjeç ne konflikt me ligjin.

Kuadri ligjor: Te pergatiten akte nenligjore te cilat rregullojne dhe saktesojne momentin qe i lind e drejta e personit te shoqeruar per t'u takuar me avokatin mbrojtës.

Te advokohet per te çelur nje fond prane Drejtorive te Qarqeve te Policise per te paguar sherbimin e avokatit mbrojtës falas.

Kapacitetet profesionale : Te identifikohen punonjesit e policise te cilet do te merren me te miturit dhe te kualifikohen mbi teknikat e intervistimit dhe trajtimit te te miturve.

Keto probleme u ringriten edhe ne Tryezen e Rrumbullaket te mbajtur me 15 Dhjetor 2006 me pjesemarrjen e Prokurorit te Pergjithshem z. Theodhori Sallaku dhe Zevendes Ministri i Brendshem z. Gjergji Lezhja.

D. Fuqizimi i bashkepunimit me aktoret kryesor per te drejtat e femijeve: Nje nder objektivat e Nenseksionit eshte te vendos nje ure bashkepunimi me OJF-te dhe te krijoje nje sistem referimi te ndersjellte per raste te ndryshme. Ne kete kuader do te zhvillohen takime periodike me OJF-te per te diskutuar mbi çështje e caktuara. Takimi i pare u zhvillua ne *ne date 20.10.2006*. Ne takim ishin prezent 19 perfaqesues te OJF- qe punojne me/per te drejtat e femijeve ne Shqiperi dhe Avokatit te Popullit: Aleanca per Femijet ne Shqiperi, Amaro Drom, Amici dei Bambini, Qendra Bethany, CRCA, Cafod, Klinika Ligjore per te Miturit, ICMC, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, “Ndihamoni Jeten”, Parlamenti Rinor, QTMPKF, Save the Children dhe World Vision.

Ne takim perveç informimit te OJF-ve me Nenseksionin, zyrat rajonale dhe projekteve te planifikuara per vitin ne vazhdim u diskutuan edhe shume pika mbi bashkepunimin e mundshem ndermjet Nenseksionit dhe OJF-ve. Disa nga pikat kryesore te diskutimit jane:

Vizibiliteti i NDF-se : Avokati i Popullit dhe sidomos NDF-ja duhet te kete nje strategji per informimin e publikut per te qene me afer personave ne nevojë.

Reforma per kuadrin ligjor per te miturit: Duke marre ne konsiderate rolin dhe funksionimin e institucionit te Avokatit te Popullit, u sugjerua qe ky institucion te ndermarre nje iniciative per te ngritur nje grup ekspertesh per te rishikuar kuadrin ligjor dhe te rekomandoje akte ligjore/nenligjore per permiresim e tij.

Ndjekja e rasteve te NDF-se. Struktura me punonjes vetem me background ligjor i NDF-se nuk u cilesua shume efikase, sidomos kur punohet drejtperdrejt me femijet. Per kete arsye OJF-te u vete-ofruan qe gjate trajtimit te ketyre rasteve, NDF-ja mund te kerkoje ndihmen e punonjesve social te ketyre OJF-ve.

Monitorimi i te drejtave te femijeve : NDF-ja gjate monitorimeve te ndryshme qe do te ndermarre te ftoje edhe OJF-te per femijet qe punojne ne kete drejtim.

Sistemi i referimit te rasteve : Ka patur shume raste ku NDF-ja, ka inicuar investigime dhe rekomandime bazuar ne referimet e rasteve nga OJF-te. Megjithate ky sistem referimesh duhet permiresuar dhe institucionalizuar. Duhet te punohet sidomos ne drejtim te mire-koordinimit te ceshtjeve qe ngrihen.

3. Çeshtje konkrete te trajtuara nga Nenseksioni si dhe nga gjithe Institucioni i Avokatit te Popullit, gjate vitit 2006, qe kane lidhje me te drejtat e femijeve.

Me qellim qe te stimuloje nje reflektim dhe veprimtari sa me te madhe ne drejtim te mbrojtjes se femijeve, Avokati i Popullit, ka trajtuar me perparesi rastet e abuzimit, keqtrajtimit dhe shkeljes se te drejtave te femijeve, qe ne fillim te ushtrimit te aktivitetit te tij ne fushen e mbrojtjes se te drejtave te njeriut.

Gjate vitit 2006, Zyra e Avokatit te Popullit duke perfshire dhe Nenseksionin per te Drejtat e Femijeve, ka shqyrtuar gjithsej 47 raste ankesash qe kishin lidhje me te drejtat e femijeve, ose 22% raste me shume se ne vitin 2005. Nga keto 12 raste jane ndjekur kryesisht nga Institucioni i Avokatit te Popullit dhe 35 raste me ankese/kerkese drejtuar institucionit. Nga keto jane ne shqyrtim 18 prej tyre, 12 kane rezultuar jashte juridiksionit apo kompetences se Avokatit te Popullit, 5 ankese te pabazuara, 8 prej tyre jane zgjidhur ne menyre pozitive, 3 ankese jane konkluduar me rekomandime te pranuar nga organet e administrates, si dhe rezulton dhe 1 ankese per te cilen eshte bere rekomandim, por qe nuk eshte pranuar nga organi te cilit i jemi drejtuar.

Megjithese ka patur nje rritje te konsiderueshme te numerit te rasteve te trajtuara, vazhdojne qe ankesat per femijet te vijne nga prinderit ose te afermit e tyre. Kjo duket qarte edhe ne faktin qe gjate 2006 vetem 1 ankese eshte bere nga femijet.

Raste e trajtuara gjate 2006 kane qene te fushave te ndryshme, por kryesisht objekt i ketyre ankesave ne pergjithesi ka qene i lidhur me trajtimin e veçante te femijeve, me te drejten e prezences se prindit gjate pyetjes se tyre, gjendjes fizike te demtuara te shkollave, me mosregjistrimin e femijeve nga Zyrat e Gjendjes Civile prane Bashkive, mos prezenca e psikologut/punonjesit social gjate intervistimit te femijeve nga organet e policise, femije te humbur jashte territorit te Shqiperise, probleme te mosperfitimit te se drejtes se kujdestarise per femijet me aftesi te kufizuara, probleme te mosperfitimit te pensionit familjar per femijet e mbetur jetime pas vdekjes se nje prindi, mostrajtimin e duhur mjekesor per femijet e semure, mosekzekutim vendimesh gjyqesore qe kane lidhje me femijet, etj.

Nga keto vlen te veçojme keto problematika:

a. kushtet e papershtatshme te shkollave, te cilat ne zonat e largeta per shkak te pamundesise financiare te Bashkive/komunave perkatese per rikonstruksione, kane dale pothuajse jashte perdorimit(*shih pjesen e raportit per Ministrine e Arsimit*);

b. mos respektimi i veprimeve proceduriale penale per pyetjen e femijeve ne pranine e psikologut/punonjesit social ose prinderit;

c mos perfitimi i statusit te jetimit ne rastin e vdekjes se njerit nga prinderit.

d. femijet e humbur ne territoret jashte Shqiperise.

Konkretisht po paraqesim permbledhtas disa raste, kater prej te cilave jane perfunduar me rekomandim nga Zyra jone.

1. Rasti i ndjekur me iniciative per tre femije te braktisur nga prinderit: Ne Gazeten “Ballkan” te dates 13.06.2006 u publikua artikulli “*Dy femije ne mjerim braktisen nga prinderit*”. Objekt i artikullit kishte te bente me fatin e tre femijeve nga fshati Mborje-Korçe te cilet ishin braktisur nga prinderit e tyre. Per kete, Nenseksioni ka bere *ex officio* verifikime ne Korçe dhe Shkoder si dhe me ane te nje psikologu eshte bere vleresimi psikologjik i femijeve. Pas publikimit te rastit ne media, Klinika Kenedi ne bashkepunim me Komunen e Drenoves moren masa vleresimin dhe sistemimin e ketyre tre femijeve. Nga analiza paraprake rezultoi se si rrjedhoje e menyres se jeteses se tyre ata kishin kaluar trauma. Dy prej femijeve V. dhe S. me vendim te KMCAP jane percaktuar si *Oligofeni Idiot*. Sherbimi Social Shteteror kishte marre vendim per vendosjen e V. ne Qendren Nene Tereza ne Shkoder, e specializuar per femijet me aftesi te kufizuar. Vendosja e saj ne kete qender ka qene mjaft pozitive per te ne drejtim te zhvillimit psikomotorr dhe psikologjik, nderkohe qe per vellain e saj **S.** situata paraqitet shume ndryshe. Me ane te nje deklarate noteriale nga i ati, ai eshte vendosur prane nje familje. Nga ekzaminimi psikologjik del se S.ndodhet ne gjendje te rende mendore, nuk mund te fliste dhe vetem belbezon dhe se ka nevojte per trajtim te specializuar psikosocial e mjeksor dhe aktualisht atij i ofrohej nje sherbim i tille. Zyra jone i ka kerkuar Sherbimit Social Shteteror mundesine e gjetjes te nje forme alternative per vendosjen ose ofrimin te sherbimeve psikosociale ndaj e S.

2. Rasti i te miturve shqiptar qe kthehen nga Kroacia: Gjate muajit Dhjetor ne median shqiptare u pasqyrua lajmi se 29 shqiptare jane ndaluar nga policia kroate ne tentative per te kaluar ilegalisht ne Itali. Sipas medias, te ndaluarit pohohet te kene shprehur pretendimet se “*po keqtrajtohen dhe*

nuk po u respektohen te drejtat e njeriut". Lidhur me kete, Zyra e Avokatit te Popullit iu drejtuar Zyres homologe te Ombudsmanit Kroat dhe Ambasades Shqiptare ne Kroaci per te marre nje informacion mbi kete çeshtje. Ne informacionin e derguar nga zyra e Ombudsmanit Kroat dhe Zyra e Ambasades tone ne Zagreb rezulton sa me poshte:

Ne Qendren e Pritjes se te Huajve ne Jezhevo, ishin vendosur 38 shqiptare, nder ta 9 ishin te mitur. Shumica e tyre qendron ne qender prej me pak se 8 dite. Te miturve, ne perputhje me Nenin 167 te Kodit Familjar Kroat, u ishin caktuar kujdestaret perkates. Kushtet fizike te qendres ishin brenda standarteve dhe plotesonin kushtet per qendrimin ne to. Emigrantet e pyetur nuk kishin ankesa ndaj kushteve fizike te qendres dhe sjelljes se stafit te qendres. Emigrantet ankoheshin per dy probleme te tjera: daten e percaktuar per kthimin e tyre(10 Janar 2007) dhe mbajtjen e parave nga ana e autoriteteve kroate. Ne lidhje me keto probleme sqarohet se organizimi i kthimit te emigranteve nga Kroacia behet me ane te linjave te autobuzit(30 emigrante per autobus). Per kete arsye, emigrantet duhet te grumbullohen dhe te presin formimin e grupit me 30 persona. Kthimi i organizuar me ane te linjes se avioneve eshte i disponueshem per personat qe mund ta perballojne financiarisht. Emigranteve ne institucion ju mbahen 30 Euro ne dite per shpenzimet (ushqim dhe fjetja) dhe 30 euro per udhetimin e kthimit. Ne momentin e kthimit te emigranteve autoritetet perkatese u leshojne nje fature me specifikimet e shpenzimeve. Ambasada Shqiptare ne Kroaci, mban kontakte te rregullta, pothuajse te perditshme me punonjesit e qendres ne Jezhevos, dhe po keshtu organizon edhe takime me emigrantet shqiptar ne kete qender.

Per sa me siper rezulton se nga ana e autoriteteve Kroate zbatohen dhe respektohen te drejtat e klandestineve shqiptare ne Kroaci. Vonesat e kthimit te tyre, behen ne zbatim te rregullave proceduriale te brendshme dhe po keshtu edhe mbajtja e parave.

3. Ankesa e B.D per shkeljet e te drejtave proceduriale ndaj djalit te tij: B.D. ankohet ndaj oficereve te Komisarariatit te Policise Durres se kundershtrim me dispozitat e Kodit Penal dhe Kodit te Proçedures Penale, kane shoqeruar dhe mbajtur ne dhomat e shoqerimit per 4 ore, djalin e tij te mitur E.D, 16 vjeç, i cili ishte therritur si deshmitar per nje veper penale. Ai eshte marre nga shkolla me ane te nje furgoni te policise. Duke analizuar veprimet e kryera nga ana e punonjesve te policise konstatojne shkelje flagrante te te drejtave te te njeriut, parashikuar ne Kushtetuten e Republikes te Shqiperise dhe proçedurave ligjore te parashikuara Kodin e Proçedures Penale, dhe konkretisht:

Nuk është përdorur fletë thirrje në rastin e thirrjes së shtetasit E. D., kërkesë kjo e nenit 59 të Rregullores për shërbimet e policisë së shtetit dhe ajo çka është me të rëndësishme në nenin 132 Pika 1 e Kodit të Procedurës Penale. Po kështu, nuk është respektuar dinjiteti i personit dhe aq më tepër për të miturin E. D. i cili është marrë para shkolles dhe me mjet policie. Marrja e deklarimeve të shtetasit E. D. është realizuar në kundërshtim me rregullat pa praninë e prindit apo psikologut, çka përben shkelje të nenit 54 të Kushtetutës ku thuhet “ *Fëmijet, të rinjtë, gratë shtatzena dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti*”. Gjithashtu është shkelur edhe neni 361/6 të Kodit të Procedurës Penale që bën fjalë për pyetjen e të miturit ku specifikohet se “*Kryetari (gjykata) mund të ndihmohet nga një familjar i të miturit ose nga specialisti i fushës së edukimit të fëmijëve*”.

Duke analizuar të gjitha të dhënat e çështjes, Institucioni i Avokatit të Popullit i rekomandoi Prokurorit të Rrethit Durrës, marrjen e masave disiplinore ndaj dy oficerëve të policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Durrës që kanë kryer këto shkelje, dhe ky rekomandim është pranuar.

4. Ankese e T.M: Prane Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesën qytetarja T. M. në të cilën shpreh shqetësimin e saj lidhur me mosekzekutimin e vendimit të formës së prere për të takuar nipin L. G. dy here në muaj. Duke marrë në konsideratë problemin në sjellje të fëmijës L.G., Institucioni i Avokatit të Popullit, me kërkesë të T.M, lehtësoi procedurat për të realizuar takimin dhe mundësoi që takimi të zhvillohet në ambientet e Zyres Rajonale të Shkodrës. Ambientet femino-re të Zyres ishin të pershtatshme për fëmijën dhe atmosfera e takimit ishte me të qetë për të. Duke marrë shkas nga ky rast, Zyra Rajonale e Shkodrës, i propozoi Zyres së Permbarimit Shkoder që takimet ndërmjet fëmijëve dhe prindërve në rastet e divorcimit, mund të organizohen edhe në zyrat e NDF-se.

5. Në Institucionin tone here pas here kanë ardhur ankesa nga të miturit ose prindër fëmijësh për keqtrajtim dhe shkelje të të drejtave ligjore nga ana e punonjësve të policisë gjatë shoqërimit në polici, procesit të pyetjes së tyre si autor të veprave penale ose si dëshmitarë. Duke marrë shkas nga këto fakte, Institucioni ndërmorri me iniciativën e tij hetime për të verifikuar këto probleme. Nga shqyrtimi i këtyre ankesave kemi konstatuar se të miturit pyeten në polici pa praninë e punonjësit social dhe të avokatit mbrojtës. Ky veprim përben shkelje të të drejtave kushtetuese të parashikuara në nenin 54 të saj. Një nga shkaqet që sjellin këto shkelje ligjore është fakti se këta të fundit ndeshen me vështirësinë e gjetjes së specialisteve të edukimit (punonjësve social) dhe të mbrojtësve. Për sa më sipër Institucioni i Avokatit të Popullit, brenda kompetencave të

parashikuara ligjore, i dergoi nje rekomandim Ministrise se Brendshme. Duke marre ne konsiderate te rezultatet e investigimeve te Institucionit tone, rekomanduam qe punonjesi social duhet te jete prezent **gjithnje** gjate fazes se pyetjes se te miturve. Per kete duhet te sigurohet shperblimi i punes qe kryejne, per te cilin organet e policise vendore nuk kane fonde financiare. Gjithashtu Ministrise se Brendshme iu rekomandua qe te krijojne nje fond te veçante financiar ne organet vendore te policise per pagimin e punonjesve social dhe avokateve mbrojtës qe thirren per te dhene asistencen e nevojshme gjate pyetjes se te miturve nga punonjesit e policise. Ky rekomandim eshte pranuar nga Drejtoria e Policise se Shtetit e cila ka pergatitur nje leter porosi per te gjitha komisariatet e policise per te respektuar te drejten per te patur nje avokatat ne momentin e shoqerimit. Ndersa ne lidhje me prezencen e psikologut, eshte sqaruar qe kjo do te ofrohen nga shoqeria civile dhe eshte parashikuar ne marreveshjen e perbashket te bashkepunimit te pergatitur nga Ministria e Brendshme.

6. Investigimi me iniciative mbi problemin e regjistrimit te femijeve: Organizata CAFOD shprehu shqetesimin per ekzistencen e nje numer te madh femijesh te paregjistruar. Sipas tyre ky fenomen eshte kryesisht i perhapur ne zonat rurale dhe informale, si rrjedhoj e procedurave te nderlikuara te parashikuara ne ligj per regjistrimin e femijeve. Bazuar ne kete ankese, NDF-ja ndermori hetime mbi kete fenomen ne zonen e Bathores, Bashkise se Kamzes, Komunen e Zallherit dhe Babrruse. Nga takimet e zhvilluara me Kryetaret e njesive vendore perkatese dhe zyres se gjendjes civile rezultoi se ne ato zona kishte nje numer te konsiderueshem femijesh te paregjistruar. Kjo ka ardhur si rrjedhoj procedurave te nderlikuara ligjore per regjistrimin e femijeve nese skadon afati 45 ditor i regjistrimit te femijeve. Familjet e ketyre femijeve si pasoje e mos informimit dhe migrimin te brendshem nuk kane bere ne kohe regjistrimin e femijeve te tyre prane zyrave te gjendjes civile. Gjithashtu konstatuam se femijet e paregjistruar i perkasin kryesisht familjeve te shperngulura dhe komunitetit Rom dhe Egjyptian. Vertetimi i ketyre lindjeve me ane te gjykates eshte jashte mundesive ekonomike dhe arsimore te ketyre familjeve.

Institucioni i Avokatit te Popullit, duke marre shkak nga keto konstatime, ne Korrik 2006 i dergoi Ministrise se Brendshme nje rekomandim per disa ndryshime mbi Ligjin per gjendjen civile. Rekomandimi cilesoi se procedura e vertetimit te lindjes me vendim gjykate duhet te eliminohet. Ne çdo moment regjistrimi i femijes duhet te behet me akt administrativ, me lehtësi dhe pa shpenzime per prinderit.

Deri me tani, nuk eshte marre asnje reagim nga autoritetet perkatese ne lidhje me kete rekomandim.

Si perfundim, mund te themi se Avokati i Popullit eshte i angazhuar seriozisht te jape nje kontribut me rendesi te veçante ne fushen e mbrojtjes se te drejtave te femijeve. Kjo duke rritur ndergjegjesimin e individeve te komunitetit dhe te administrates publike ne lidhje me te drejtat dhe pergjegjesite reciproke ne mbrojtjen e garantimin e te drejtave te femijeve.

KREU I KATERT

1. E drejta e Avokatit të Popullit për rekomandime legislative

Në nenin 24 të Ligjit “Për Avokatin e Popullit” parashikohet e drejta e Avokatit të Popullit për rekomandime legislative. Në këtë dispozitë përcaktohet se: “Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkak që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë:

a. t’u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve;

b. t’u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore; mosshqyrtimi i propozimit brenda 30 ditëve sjell si pasojë pezullimin e fuqisë së akteve nënligjore që shkaktojnë shkelje të të drejtave dhe lirive.

c. të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me kërkesën për shfuqizimin e akteve të tilla”.

Qysh nga fillimi i veprimtarisë në qershor të vitit 2000 deri në fund të vitit 2006, institucioni ynë e ka përdorur shpesh herë këtë të drejtë, kur ka konstatuar gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave apo njoftimeve se janë kushtet e mësipërme për të bërë rekomandime për përmirësimin e legjislacionit.

Siç del nga Pasqyra nr.1, gjatë periudhës 2000-2006 janë bërë 41 rekomandime drejtuar organeve që kanë të drejtën ligjvënëse (deputetëve të Kuvendit, Kryeministrit dhe anëtarëve të Qeverisë) që të bëjnë ata propozime për ndryshime apo përmirësime të ligjeve. Nga 41 rekomandime janë pranuar 28 që kanë rezultuar me 20 ndryshime apo përmirësime të ligjeve; 8 janë në fazën e projektit për miratim në Kuvend; 5 janë refuzuar; 4 janë në shqyrtim dhe 4 pa përgjigje zyrtare.

Në Pasqyrën nr.2 janë pasqyruar rekomandimet për ndryshime apo plotësime të akteve nënligjore normative që ka në kompetencë të nxjerrë Këshilli i Ministrave (Qeveria) për periudhën 2000-2006. Nga 33 rekomandime, janë pranuar 26, që kanë rezultuar 16 me ndryshime, nxjerrje

apo përmirësime të akteve nënligjore nga Qeveria; 10 janë në fazën e projektit; 2 janë refuzuar; 3 janë në shqyrtim dhe 2 pa përgjigje zyrtare.

Kurse në Pasqyrën nr.3 janë pasqyruar rekomandimet për ndryshime apo plotësime të akteve nënligjore normative në kopetencë të ministrave dhe drejtuesve të tjerë të institucioneve qendrore. Nga 32 rekomandime janë pranuar 25, nga të cilët për 21 janë bërë ndryshimet apo përmirësimet, 4 janë në fazën e projektit, 4 janë refuzuar, kurse 3 janë pa përgjigje.

Si përfundim, duke patur parasysh se nga 106 rekomandime, propozime apo kërkesa me karakter legjislativ janë pranuar deri tani gjithsej 79 prej tyre, ose rreth 75%, mund të themi se rezultatet janë të kënaqshme.

Pasqyra Nr. 1

**Evidenca e rekomandimeve per plotësime apo ndryshime te ligjeve te Kuvendit te Shqipërisë
Per periudhen 2000-2006**

<i>Nr</i>	<i>Ankuesi</i>	<i>Permbajtja e rekomandimit</i>	<i>Kujt i drejtohet</i>	<i>Data e dergimit</i>	<i>Përfundimi</i>
1	Ankesa e 70 ish ushtarakëve të larguar nga detyra.	Rekomandim: “Për një ndryshim në Ligjin Nr. 8087 datë 13.03.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve në F.A. të Republikës së Shqipërisë e konkretisht nenin 19/1 për ndryshimin e termit “braktisje në detyrë”.	Komisionit Parlamentar të Mbrojtjes në Kuvend, i cili mori iniciativën legislative.	16.03.2001	Rekomandimi është pranuar. Doli Ligji Nr. 8948 datë 03.10.2002, i cili bëri ndryshimet në nenin 19/1, sipas rekomandimit të Avokatit të Popullit.
2	Ankesa e shtetasit K.D.	Rekomandim: “Për iniciimin e nxjerrjes së një ligji për rregullimin e simboleve fetare në shkollat publike”	Kryeministrit. Ministrit të Arsimit dhe Shkencës	26.04.2001	Ministri i Arsimit ka pranuar që të nxjerrë një udhëzim për të rregulluar këtë problem, por deri tani nuk është nxjerrë
3	Federata e Sindikatave të Punonjësve të Transportit	Rekomandim: “Ndryshimi i Ligjit Nr.8435 datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, në lidhje me taksën për rregjistrimin vjetor të automjeteve dhe taksën për aks	Ministresë së Transporteve, Ministresë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor.	20.07.2001	Rekomandimi është pranuar. Doli Ligji Nr. 8840 datë 11.11.2001 që rriti përqindjen e D.P.T. Rrugor si agent tatimor në 20 përqind, duke ndryshuar nenin 4 të ligjit

4	Ankesa të ish pronarëve	Rekomandim: “Propozohen ndryshime në Ligjin nr. 7665 datë 21.01.1993 “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, për shfuqizimin e neneve 7/ç dhe 13 të tij.	Komisionit të Ligjeve, ekonomisë e financave në Kuvend. Ministrit të Turizmit e Rregullim Territorit	12.10.2001	Rekomandimi është pranuar. Shfuqizuar me nenin 30 të Ligjit Nr. 9235 datë 29.07.2004 “Për kthimin e kompesimin e pronës”
5	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin Nr. 8097 datë 21.03.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”.	Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale. Komisionit parlamentar të çështjeve kushtetuese dhe ligjeve.	14.12.2001 Përsëritur në datën 06.03.2003	Rekomandimi është pranuar në parim, por nuk është miratuar në ndryshimet që i janë bërë ligjit.
6	Ankesa të shtetasit J.L.	Rekomandim: “ Për ndryshimin e nenit 6, pika 2 të Ligjit Nr. 8360 datë 10.06.1998 “Për kriteret dhe mënyrat e shpërndarjes të pasurive të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjërë”.	Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Punëve e Çështjeve Sociale. Komisionit Parlamentar për Punën dhe Çështjet Sociale	14.12.2001	Pa përgjigje.
7	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: “ Dërgohen propozime për marrjen e nismës ligjvënëse lidhur me përmirësimet e ndryshime të akteve ligjore e nënligjore për përfundimin e procesit të rivlerësimit e rishpërndarjes së pasurisë së ish kooperativave bujqësore si dhe, ndryshime në Ligjin Nr. 8435 datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”	Ministrit të Bujqësisë. Ministrit të Financave. Kryeministrit.	26.12.2001	Pa përgjigje.

8	Ankesa nga ushtarakët	Rekomandim: “Për rregullimin ligjor të punës jashtë orarit dhe shërbimit 24 orësh”.	Ministrit të Mbrojtjes	2001	Rekomandimi është pranuar dhe rregulluar me nenin 31 të Ligjit “Për statusin e ushtarakut” dhe mbi këtë bazë dhe me rregullore të Ministrisë së Mbrojtjes
9	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për përgatitjen e Ligjit “Për zhdëmtimin e personave të dëmtuar”, në zbatim të nenit 44 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.	Kryeministrit dhe Ministrit të Drejtësisë	24.12.2001	Rekomandimi është pranuar pjesërisht. Doli Ligji Nr. 9381 datë 28.04.2005 “Për kompesimin e burgimit të padrejtë”.
10	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “ Për zbatimin e nenit 10 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për lidhjen e marrëveshjeve me bashkësitë fetare dhe miratimin e tyre në Kuvendin e Shqipërisë”.	Dërguar të gjithë Kryeministrave.	16.01.2002 Përsëritur në 09.12.2005	Rekomandimi është pranuar pjesërisht. Është lidhur marrëveshja vetëm me Komunitetin katolik nëpërmjet Ligjit Nr. 8902 datë 23.05.2002.
11	Ankesa nga Shoqata e të Verbërve	Rekomandim: “Për domosdoshmërinë e ndryshimit të Ligjit Nr. 8098 datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbrit”.	Zv/Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve e Çështjeve Sociale	02.04.2002	Rekomandimi është pranuar në parim. U ngrit grupi ndërmintor për hartimin e strategjisë kombëtare për personat me aftësi të kufizuar. Dokumenti ju dërgua Këshillit të Ministrave.

12	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për bërjen e disa ndryshimeve në Ligjin Nr. 8388 datë 05.08.1998 “Për grumbullimin e armëve dhe municioneve luftarake”	Kryeministrit. Kryetarit të Kuvendit.	16.04.2002	Rekomandimi është pranuar pjesërisht. Kuvendi zgjati afatin e veprimit të Ligjit, duke miratuar Ligjin Nr. 9018 datë 06.03.2003 “Për mbledhjen e armëve, të municioneve dhe materialeve të tjera luftarake”
13	Banorë të komuniteteve në Tiranë, Durrës dhe Librazhd	Rekomandim: “Për përgatitjen sa më shpejt të projekteve për plotësimin e legjislacionit për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe të ambientit nga rrezatimet jo jonizuese të telefonisë celulare”.	Ministrit të Mjedisit. Ministrit të Shëndetësisë. Ministrit të Drejtësisë.	13.05.2002 Përsëritur në dt. 27.10.2004	Është kthyer përgjigje nga Ministritë. Janë përgatitur draftet e ligjit, por akoma nuk janë dërguar në Qeveri.
14	Ankesa e shtetasit B.I.	Rekomandim: “Për një plotësim në Ligjin Nr. 7710 datë 18.05.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”, lidhur me parashikimin e procedurës së ankimit administrativ kundër vendimeve të seksioneve përkatëse të Bashkive apo Komunave”.	Zv/ Kryeministrit dhe Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	09.05.2002	Rekomandim është pranuar dhe zgjidhur me nenin 25 të Ligjit Nr. 9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror”.
15	Ankesa e shtetasit Th.K	Rekomandim: “Për ndryshimin e e ligjit Nr. 7889 datë 14.02.1994 “ <i>Për statusin e invalidit</i> ” për përfitimin e një shtese mujore mbi pensionin e invaliditetit, për të gjithë të aksidentuarit gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak”.	Zv.Kryeministrit Ministrit të Mbrojtjes	12.06.2002	Rekomandimi është pranuar dhe problemi është zgjidhur me nenin 17 të Ligjit Nr. 9418 datë 20.05.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

16	Konferenca Kombëtare	Rekomandim: “ Mbi masat që duhen marrë për zbatimin e Rekomandimeve të Konferencës Kombëtare “ <i>Shteti dhe shoqëria civile në mbrojtje të të drejtës së jetës</i> ”, që të krijohet një organizëm shtetëror për të kontrolluar gjakmarrjen etj.	Kryeministrit, disa ministrave	10.09.2002	Rekomandimi u pranua. Doli Ligji Nr. 9389 datë 04.05.2005 “Për Këshillin Koordinativ për luftën kundër gjakmarrjes”
17	Me inisiativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për marrjen e masave për të realizuar ndryshimin e Ligjit Nr. 5840 datë 20.02.1979 “ <i>Për rregjistrimin e akteve të gjëndjes civile</i> ”, me qëllim çrregjistrimin e personave të vdekur nga listat e zgjedhësve”.	Kryeministrit. Kryetarit të Kuvendit	11.09.2002	Rekomandimi u pranua. Neni 57/7 i Ligjit nr.8950 datë 10.10.2002 i lejon zyrat e gjendjes civile të zgjidhin problemin duke ju drejtuar vetë gjykatës.
18	Ankesa të ish pronarëve	Rekomandim: “Të përshpejtohet procesi legjislativ në bazë të nenit 181 të Kushtetutës për miratimin e akteve nënligjore që rregullojnë problemet e pronësisë, mosdhënien e titullit “ <i>person i stimuluar në fushën e turizmit</i> ”, ndalimin e tjetërsimit të pronës shtetërore të rregjistruar dhe bllokimin e privatizimit apo të dhënies me qera të objekteve shtetërore dhe trojeve të tyre”	Kryetarit të Kuvendit. Komisioneve Parlamentare dhe Qeverisë.	19.09.2002	Rekomandimi është pranuar. Doli Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë Nr. 9 datë 03.10.2002, e cila i kërkoi Qeverisë dhe organeve të qeverisjes vendore që deri në hartimin e projektligjit të ri “Për kthimin e Kompesimin e pronave” të ndërpritet thetërsimi dhe dhënia me qera e pronave shtetërore.
19	Ankesat e ish pronarëve	Rekomandim: “Për masat që duhen marrë në zbatim të neneve 41/1 dhe 181/2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë”, me qëllim rregullimin e drejtë dhe përfundimtar të çështjes së pronave.	Kryeministrit. Kryetarit të Kuvendit.	19.09.2002	Rekomandimi u pranua. Dolën ligjet Nr. datë 29.07.2004, Nr. 9388 datë 04.05.2006 “Për kthimin dhe kompesimin e pronës”

20	Ankesat e ish pronarëve	Rekomandohet të merret në konsideratë Vendimi nr.26 datë 24.04.2001 i Gjykatës Kushtetuese në projektligjin “Për kthimin dhe kompensimin e ish pronarëve”	Kryetarit të Kuvendit. Komisioneve parlamentare në Kuvend	28.10.2002	Rekomandimi u pranua. Neni 8/2 i ligjit nr.9235 datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës ish pronarëve”
21	Me iniciativën e Avokatit të Popullit.	Rekomandim: Për plotësimin e Ligjit Nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”.	Komisionit të Ligjeve dhe të Drejtave të Njeriut në Kuvend, i cili mori iniciativën legislative.	25.11.2002	Rekomandimi është pranuar. Doli Ligji Nr. 9071 datë 22.05.2003 Për një ndryshim në Ligjin Nr. 8328 datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajnimin e të dënuarve me burgim”
22	Njoftimi i zotit Pjetër Arbnori	Rekomandim: “Për përmirësimin e nenit 4 të Ligjit Nr. 8292 datë 25.02.1998 “Për Forcat Speciale dhe ato të Ndërhyrjes së Shpejtë”, sepse nuk lejohet hetimi i policëve që bëjnë pjesë në këto forca, kur akuzohen për vepra penale.	Komisionit të Ligjeve dhe të Drejtave të Njeriut në Kuvend, i cili mori iniciativën legislative dhe e paraqiti në Kuvend.	26.11.2002 Përsëritur në 2006	Nuk u miratua projektligji në seancë parlamentare. Eshtë ribërë propozimi, drejtuar Komisionit të Ligjeve dhe Sigurisë Kombëtare si dhe në projektligjin “Për Policinë e Shtetit”
23	Me iniciativën e Avokatit të Popullit.	Rekomandim: “Për plotësimin e Ligjit Nr. 8609 datë 08.05.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës të Shqipërisë” për t’u mundësuar gjithë të dënuarve që të votojnë në zgjedhjet për pushtetin vendor.	Komisionit Bipartizan në Kuvend.	13.02.2003 Përsëritur në datën 20.10.2006	Rekomandimi është pranuar në parim, por ndryshimi nuk u pasqyrua në Kodin Zgjedhor.

24	Ankesa e shtetasit S.H.	Rekomandim: “Për zbatimin dhe përmirësimin e legjislacionit në fushën e sigurimeve shoqërore”, ku është propozuar “Ndryshimi i nenit 59 të Ligjit Nr. 7703 datë 11.03.1993 <i>“Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”</i> ”.	Kryeministrit. Ministrit të Punës e Çështjeve Sociale. Komisionit Parlamentar të Punës e Çështjeve Sociale.	23.09.2003.	Rekomandimi është pranuar. Doli Ligji Nr. 977 datë 21.04.2005 “Për disa ndryshime e shtesa në Ligjin nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar neni 18.
25	Ankesa nga shtetas dhe shoqata	Rekomandim: “ Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 8087 datë 13.03.1996 <i>“Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Shtetëror”</i> ”.	Kryeministrit	19.11.2003	Rekomandimi është pranuar. Zgjidhur me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 9418 datë 20.05.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të F.A. të Republikës të Shqipërisë. Neni 14 pika 6 e tij.
26	Një numur i madh të dënuesish që vuajnë dënimet në burgje.	Rekomandim: “ Propozohet ndryshimi në Ligjin nr. 7941 datë 31.01.1995 për hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 7895 datë 27.01.1995 <i>“Për Kodin Penal në Republikën e Shqipërisë”</i> ”.	Komisionit të Drejtave të Njeriut në Kuvend. Një grup deputesh morën inisiativë legjislative.	20.11.2003 Përsëritur në datën 08.03.2006	Projektligji u diskutua në maj 2006 në Komisionin e Ligeve dhe ka mbetur për riformulim.

27	Ankesa e ish gjeneralit Y. D.	Rekomandim: “Bërja e një statusi të veçantë për ushtarakët madhorë duke u nisur nga rasti i ish gjeneralit Y.D”.	Ministrit të Mbrojtjes	24.03.2004	U muar parasysh në ndryshimet e Ligjit Nr. 9171, datë 22.01.2004 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në FA të R. Shqipërisë dhe konkretisht Pika 2 e nenit 22 ku thuhet: “Statusi i gjeneralëve pas daljes së tyre në rezervë/lirim rregullohet me VKM. Doli VKM Nr. 542 datë 12.08.2004 “Për statusin e ushtarakut me gradë madhore në FA pas daljes në lirim”.
28	Ankesa	Rekomandim: “Për plotësimin e nenit 28 të Ligjit “Për Statusin e Ushtarakut”.	Ministrisë së Mbrojtjes	03.11.2004	Rekomandimi u pranua si i drejtë dhe Ministria e Mbrojtjes ka hartuar draftin.
29	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “ Propozime për përmirësimin e Kodit Zgjedhor”, me qëllim që numurimi i votave në çdo zonë elektorale të bëhet nga tre gjyqtarë.	Bashkëkryetarëve të Komisionit Parlamentar për Reformën Zgjedhore	22.11.2004	Rekomandimi nuk është pranuar.
30	Ankesa e shtetasit D.M.	Rekomandim: “Për plotësimin e nenit 40 të Ligjit Nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim përfitim të pensionit familjar pas vdekjes së bashkëshortit, nga bashkëshortja ose bashkëshorti student nën moshën 25 vjeç	Komisionit të Ligjeve në Kuvend. Institutit të Sigurimeve Shoqër-re.	28.01.2005 16.03.2005	Rekomandimi nuk është pranuar.

31	Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë	Rekomandim: “Propozim për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9209 datë 22.03.2004 <i>“Për legalizimin e shtesave në ndërtim”</i> për të thjeshtuar procedurat e legalizimeve dhe për të ulur masën e gjobave.	Kryeministrit. Komisionit parlamentar të Ligjeve, e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregëtisë e Mjedisit.	16.03.2005 Përsëritur më datën 16.09.2005	Rekomandimi është pranuar. Doli Ligji Nr.9482 datë 16.02.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa lejë”, ku është për-fshirë edhe rekomandimi i Avokatit të Popullit
32	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për disa shtesa e ndryshime të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, plotësuar më ligjin nr. 8600 datë 10.04.2000 <i>“Për Avokatin e Popullit”</i> .”.	Kryetarit të Kuvendit Mori iniciativë një grup deputetësh	01.04.2005	Rekomandimi është pranuar. Doli Ligji Nr. 9398 datë 12.05.2005.
33	Shoqata Uniteti Kombëtar	Rekomandim: “Për zhbllokimin e situatës së krijuar nga mosfutja në përdorim e letrave me vlerë dhe bonove të privatizimit”	Kryeministrit. Ministrit të Financave. Ministrit të Ekonomisë dhe Energjetikës.	12.10.2005.	Rekomandimi u pranua. Doli ligji Nr.9516 datë 18.04.2006
34	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Propozim për një ndryshim në Ligjin Nr.8436 datë 28.12.1998 <i>“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”</i> ”, për të caktuar afate për qëndrimin në detyrë të kryetarëve dhe zëvendëskryetarëve të gjykatave.	Kryetares së Kuvendit. Kryetarit të Komisionit për çështjet ligjore Kryeministrit	08.11.2005	Rekomandimi është pranuar në parim. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” ndodhet në Kuvend.

35	Grup Shoqatash	Rekomandim: “Për ndërmarrjen e inisiativës ligjore për parashikimin ligjor të termit “ <i>Taksë e drejtpërdrejtë</i> ” në Ligjin nr. 8977 datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë” si dhe në Ligjin nr. 8982 datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendor”, për cilësimin ligjor të llojeve të “ <i>taksave vendore të drejtpërdrejta</i> ” për efekt të përjashtimit të veteranëve të luftës, invalidëve dhe të të verbërve”.	Ministrit të Financave, Ministrit të Brendshëm, Komisionit të Financës dhe Buxhetit në Kuvend.	23.11.2005	Rekomandimi u pranua në parim, por nuk është përfshirë deri tani në ligjet e miratuara.
36	Me inisiativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për ndryshimin dhe përmirësimin e përmbajtjes së nenit 86 të <i>Kodit Penal</i> , për veprën penale të “ <i>torturës</i> ”.	Ministrit të Drejtësisë.	16.12.2005	U pranua. Me shkresën e datës 06.01.2006 të Ministrit të Drejtësisë. Njoftohemi se është gati projektligji në Parlament me ndryshimet që do të bëhen në Kodin Penal.
37	Me inisiativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për marrjen e inisiativës për rregullimin ligjor të ndërtimeve të objekteve fetare”.	Kryeministrit Ministrit të Punëve Publike etj	28.12.2005	Rekomandimi u pranua në parim. Është në projektligjin e ri për urbanistikën
38	Ankesa nga Shoqata joqeveritare	Rekomandim: “Për ndryshimin dhe përmirësimin e Ligjit Nr. 8950 datë 10.10.2002 “ <i>Për Gjëndjen Civile</i> ” ndryshuar më Ligjin Nr. 9029 datë 13.03.2003 dhe Ligjin nr. 9229 datë 29.04.2004” për regjistrimin e fëmijëve të pargjistruar.	Ministrit të Brendshëm. Kryeministrit.	12.07.2006	Kryeministri ja ka dërguar Ministrit të Brendshëm

39	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: Për projektligjin “Për pagat, Shpërblimet dhe Strukturat e Institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”.	Kryetarit të Komisionit të Çështjeve Ligjore. Grupeve Parlamentare	13.07.2006	Nuk u pranua. Çështja ndodhet për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese.
40	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: Për plotësimin e Ligjit Nr. 9087 datë 19.06.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, për të rregulluar tre çështje: votimi i të burgosurve në zgjedhjet lokale, ndalimi i pjesëmarrjes së fëmijve në fushatat elektorale dhe zgjedhja e zëvendës kryetarit të komunës apo bashkisë direkt nga populli, njëlloj si kryetarët.	Bashkëkryetarëve të Komisionit Parlamentar për Reformën Zgjedhore. Kryetarit të Komisionit të Çështjeve Ligjore.	20.10.2006	Nuk ka përgjigje zyrtare.
41	Koalicioni për barazi gjinore	Rekomandim: “ Për parashikimin në Kodin Zgjedhor të kuotave prej 30% për pjesëmarrje të grave në politikë”.	Bashkëkryetarëve të Komisionit për Reformën Zgjedhore.	25.10.2006	Nuk ka përgjigje zyrtare.

Pasqyra Nr. 2

Evidenca e rekomandimeve për nxjerrje, ndryshime apo plotësime në aktet nënligjore të Këshillit të Ministrave per periudhen 2000-2006

Nr	Ankuesi	Permbajtja e rekomandimit	Kujt i drejtohet	Data e dergimit	Përfundimi
1	Ankesa e shtetasit M.Sh. etj.	Rekomandim: “Propozohet shtyrja e afatit të veprimit të V.K.M. Nr. 585 datë 11.12.1997 “Për evidentimin e familjeve që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale”, si dhe plotësimi i listave të kreditorëve.	Kryeministrit	16.06.2000	Rekomandimi u pranua në parim. Por pa nxjerrë V.K.M. u plotësuan listat e kreditorëve në njësitë e qeverisjes vendore.
2	Shtetasti A.R. ish pronar trualli	Të shfuqizohet si antikushtetuese shkronja “c” e pikës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 18.03.2000 “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive që veprojnë në sektorët strategjikë” si dhe pikës 4 të V.K.M. nr.438, datë 14.08.1995 “Për privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore të transformuara në shoqëri tregtare” për çmimin e truallit që i është kthyer ish pronarëve	Gjykatës Kushtetuese	15.11.2000	Kërkesa u pranua. Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr.26, datë 24.04.2001 vendosi: 1. Shfuqizimin si antikushtetues të pikës 1, shkronja ‘c’ të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 18.03.2000 “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të

					aksioneve të shoqërive që vepronë në sektorët jostrategjikë”. 2. Pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.438 datë 14.08.1995 “Për privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore të transformuara në shoqëri tregëtare”.
3	Ankesa te shtetasve	Rekomandim: “Për pagesën nga Agjensia Kombëtare e Privatizimit për taksën e regjistrimit të pasurive të paluajtëshme që ju ka shitur personave fizikë ose personave privatë”.	Kryeministrit Ministrit të Financave Agjensisë Kombëtare të Privatizimit	11.05.2001	Rekomandimi u pranua. Doli VKM Nr. 386 datë 31.05.2001”Për pagesën e taksës së kalimit të pronësisë nga privatizimi i pronës shtetërore”.
4	Shoqatat e “Dëshmorëve të Atdheut”, dega Fier dhe Krujë	Rekomandim: “Për nxjerrjen e disa akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit Nr. 8607 datë 27.04.2000 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”.	Kryeministrit	08.10.2001	Rekomandimi është pranuar. Doli VKM Nr. 151 datë 25.04.2002 “Për statusin Dëshmor i Atdheut”.

5	Ankesa të shoqatave të ish pronarëve	Të nxirren Vendimet e Qeverisë në përputhje me vendimin nr.26 datë 24.04.2001 të Gjykatës Kushtetuese	Ministrit të Ekonomisë	24.10.2001	Rekomandimi u pranua. Me VKM nr.119 datë 27.02.2003 u riformulua gërma “c” e pikës 1 të VKM nr.119 datë 18.03.2000, sipas Vendimit nr.26, datë 24.04.2001 të Gjykatës Kushtetuese
6	Ankesa e një numuri të madh të dënuarish që vuajnë denimin në burgje	Rekomandim: “Për plotësimin e kërkesave të Ligjit Nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, për kriteret e shpërblimit të punës së të dënuarve.	Kryeministrit Ministrit të Drejtësisë	13.05.2002	Pranuar në parim. Akoma nuk është miratuar VKM.
7	Ankesa e shtetasit A.M.	Rekomandim: “Për shfuqizimin e pikës 1 të VKM nr.24.10.2001 dhe urdhërit të Ministrit të Arsimit “Për kuotat shtesë të Shkollave të Larta”, që krijonte diferencim për kandidatët për studentë në shkollat e larta	Kryeministrit. Ministrit të Arsimit	04.07..2002	Rekomandimi është pranuar. Doli VKM Nr. 362 datë 18.07.2002
8	Disa familjare te punonjsve te policise, te vrare ne krye te detyres	Rekomadim: “Per permiresimin e V.K.M. Nr. 552 date 27.11.1999 “ <i>Per trajtimin ekonomik e financiar te familjareve te punonjesve te policise te vrare e plagosur per shkak te detyres</i> ”.	Keshillit te Ministrave. Ministrit Rendit Publik	06.12.2002 Perseritur disa here dhe heren e fundit date 19.09.2006	Rekomandimi është pranuar dhe ndodhet për miratim në Qeveri

9	Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë	Të shfuqizohet si antikushtetues Vendimi nr.441 datë 26.09.2002 i Këshillit të Ministrave “Për ndalimin e menjëhershëm të veprimtarisë së shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit në shtretërit e lumenjve”	Gjykatës Kushtetuese	13.12.2002	Pranuar. Para shqyrtimit të çështjes në Gjykatën Kushtetuese, Qeveria mori Vendimin nr.19 datë 10.01.2003 “Për disa ndryshime në vendimin nr.441 datë 26.09.2002
10	Ankesa e shtetasit Q.H.	Rekomandim: “Për të deklaruar (konstatuar) pavlefshmërinë absolute të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 226 datë 20.08.2002 “Për komunikimin me organet e medias së shkruar dhe elektronike”.	Kryeministrit	27.05.2003	Rekomandimi u pranua. Kryeministri me urdhërin Nr. 157 datë 12.11.2003 revokoi urdhërin Nr. 226 datë 20.08.2002.
11	Ankesa e shtetasit Q.H	Rekomandim: “ Për ndryshimin e VKM Nr. 64 datë 02.02.2001 “ <i>Për inkuadrimin e gradave ushtarake, në gradat e Policisë së Shtetit dhe për caktimin e funksioneve organike që do të ushtrohen sipas tyre</i> ”.	Këshillit të Ministrave, Ministrit të Rendit Publik	29.05.2003	Rekomandimi nuk u pranua. Por pati efektet e tij pozitive. Eshtë bërë i mundur korigjimi i shumë rasteve të dhënies së gradave në mënyrë të padrejtë

12	Ankesa e shtetasit S.H.	Rekomandim: “Për përmirësimin e udhëzimit Nr. 1 datë 24.12.2002 “Për llogaritjen dhe indeksimin e bazës së vlerësuar për efekt pensioni”. Zbatimi me akt nënligjor i parashikimeve të nenit 61 Pika 1 të Ligjit Nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në R.Shqipërisë”, dhe udhëzimit Nr. 1 datë 24.12.2002 “Për llogaritjen dhe indeksimin e bazës së vlerësuar për efekt pensioni”.	Kryeministrit etj.	23.09.2003	Rekomandimi është pranuar. Në zbatim të këtij rekomandimi doli VKM Nr. 357 datë 01.06.2004 e VKM Nr. 374 datë 31.05.2005 “Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor individual për llogaritjen fillestare të pensioneve”.
13	Ankesa e shtetasit Xh.K dhe i një numuri të madh të veteranëve nga i gjithë vëndi.	Rekomandim: “Për ndërmarjen e iniciativës për hartimin e projektvendimit për caktimin e një afati të ri, për paraqitjen e dokumenteve para Komisionit Qëndror të <i>Statusit të Veteranit</i> , me qëllim njohjen e statusit të veteranit”.	Ministrit të Mbrojtjes	26.11.2003	Është pranuar dhe për këtë ka dalë VKM Nr.748 datë 11.11.2004, i cili zgjati afatin deri më 31.12.2006
14	Ankesa e shtetasit G.D.	Rekomandim: “Mbi hartimin e një projektvendimi për trajtimin e detyrimeve ndaj shtetit, ndaj sigurimeve shoqërore dhe të tretëve që rrjedhin nga zbatimi i marrëveshjes së konçesionit të formës BOT për uzinën e ferrokromit Elbasan dhe për minierat e kromit Prrrenjas e Pojskë, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike e Privatizimit dhe Shoqërisë italiane Darfo SPA”.	Këshillit të Ministrave.	2003	Pranuar. Janë bërë ndryshime në ligj që falin detyrimet e papaguara ndaj Sigurimeve Shoqërore

15	Ankesa e Infosoft System” Sh.a.	Rekomandim: “Për revokimin e paragrafit që parashikon formularin e “Autorizimit të Prodhuesit” në kapitullin e tretë të Udhëzimit të K.M. Nr. 1 datë 01.01.1996 “Për Prokurimin Publik” ndryshuar me VKM Nr.3 datë 10.07.2003 “Për disa ndryshime të VKM. Nr. 1 datë 01.01.1996 “Për Prokurorimin Publik”.	Kryeministrit	13.12.2003	Rekomandimi është pranuar nga ana e Agjensisë së Prokurimit Publik. Por akoma nuk është bërë shfuqizimi përkatës në dokumentet standarte ku parashikohet ky formular.
16	Ankesa e shtetasit N.GJ.	Rekomandim: “Për përfshirjen në listën e subjekteve që përfitojnë pension suplementar të nënpunësve të Komisionit të Shërbimit Civil dhe të Avokatit të Popullit”.	Kryeministrit. Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale.	08.07.2004.	Rekomandimi u pranua, por akoma nuk janë bërë shtesat përkatëse në aktet nënligjore.
17	Ankesa të të dënuarve	Rekomandim: “Për përshpejtimin e procedurave për miratimin e VKM për trajtimin e të gjitha strukturave të Policisë së Burgjeve sipas nenit 12 të Ligjit Nr. 8321 datë 02.04.1998 “Pë Policinë e Burgjeve”.	Ministrit të Drejtësisë	22.12.2004	Rekomandimi u pranua. Ministria e Drejtësisë ka çuar në K.M, dy projekt vendime që janë miratuar.
18		Rekomandim: “Për marrjen e të gjitha masave në bashkëpunim dhe me institucionet e tjera qendrore, për dhënie të tokës bujqësore në pronësi në bazë të Ligjit Nr. 7501 datë 19.07.1991 “Për tokën” subjekteve që ende nuk kishin marrë ose nuk janë plotësuar me tokë në pronësi”.	Ministrit të Bujqësisë. Kryeministrit	09.03.2005	Rekomandimi u pranua. Ka dalë VKM Nr.291 datë 06.05.2005 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 230 datë 22.07.1991 “Për krijimin e Komisionit të

					Tokave” në fshatra të cilat shqyrtojnë mosmarrëveshjet dhe konfliktet brënda fshatit, që kanë lindur në vijimësi të procesit të ndarjes së tokës dhe që në kohën e shqyrtimit nuk kanë marrë zgjidhje ligjore”.
19	Ankesa e shtetasit B.K.	Rekomandim: “Për përshpejtimin e procedurave lidhur me funksionimin e Komisionit Shtetëror Trepalësh, si dhe për nxjerrjen e akteve nënligjore për ish të përndjekurit politikë”.	Kryeministrit.	24.03.2005 Përsëritur në datën 02.11.2005	Rekomandimi nuk ka përgjigje.
20	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për rritjen e transparencës dhe zbatimin e Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” duke përgatitur një Rregullore tip”.	Kryeministrit.	12.10.2005	Rregullorja është përgatitur. Ndodhet në Këshillin e Ministrave.
21	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: “Për përgatitjen e akteve të reja nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 9380 datë 28.04.2005 “Për të drejtat e autorit dhe te drejtat e tjera të lidhura me të”.	Ministrit të Financave Ministrit Turizmit, Kulturës, Rinisë e Sporteve.	18.10.2005	Rekomandimi u pranua në parim.
22	Ankesa e shtetasit A.K.	Rekomandim: “Për përgatitjen e akteve të reja nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 9267 datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigu-rimeve, risigurimeve dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime”.	Ministrit të Financave. Këshillit të Ministrave Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve.	18.11.2005	Rekomandimi u pranua. Është përgatitur projektvendimi “Për kriteret e liçencimit të dëmeve në sigurime”.

23	Ankesa të shumta	Rekomandim: “Për situatën e çmimeve të operatorëve të telefonisë së lëvizshme dhe propozimi për miratimin sa më parë të metodologjisë së caktimit të tarifave nga ERT”.	Entit Rregullator të Telekomunikacionit	25.11.2005	Pranuar në parim. Është në fazën e përgatitjes nga Enti Rregullator i Telekomunikacionit.
24	Ankesa e shtetasit P. S. etj.	Rekomandim: “Kërkohej përsheptimi i procedurave për ndryshimin e VKM Nr. 146 datë 26.02.1998 “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”.	Ministrit të Arsimit. Finacave dhe Punëve Publike.	2005	Nuk është kthyer përgjigje zyrtare.
25	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr.9389, datë 04.05.2005 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues të Gjaktarrjes”	Kryeministrit. Kryetares së Kuvendit.	02.02.2006	Rekomandimi është pranuar, por deri tani nuk janë nxjerrë aktet nënligjore.
26	Ankesa të shtetasve dhe organizatave joqeveritare të të drejtave të njeriut	Shfuqizimin si antikushetues i 1. V.K.M. nr.43, datë 27.01.2006 “Për shmangien e nepotizmit dhe ndikimin e pushtetit në rekrutimin dhe karrierën e personelit të administratës publike”. 2. V.K.M. nr.44, datë 27.01.2006 “Për shmangien e nepotizmit në administratën publike”. 3. V.K.M. nr.48, datë 27.01.2006 “Për disa shtesa në vendimin nr.205 datë 13.04.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë”	Gjykatës Kushtetuese	09.02.2006	Pranuar. Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr.20 datë 11.07.2006 vendosi shfuqizimin e tre vendimeve të Qeverisë.
27.	Ankesa nga shtetas të ndryshëm	Rekomandim për përgatitjen e projektvendimit të Qeverisë për zbatimin e neneve 8, 9, 10 dhe 11 të ligjit nr.8661, datë 18.09.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”	Kryeministrit Ministrit të Brendshëm	03.03.2006	Rekomandimi është pranuar, është përgatitur projekt vendimi i Qeverisë

28	Shoqata e Talasemikëve të Shqipërisë.	Rekomandim: “ Për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 8032 datë 16.01.1995 “ <i>Për shërbimin e transfuzionit dhe kontrollit të gjakute produkteve të tij dhe transplantimeve</i> ”.	Ministrit të Shëndetësisë.	13.03.2006	Rekomandimi është pranuar, është miratuar strategjia për gjak të sigurtë.
29	Ankesa të shtetasve	Rekomandim për hartimin dhe paraqitjen për miratim të projekt vendimit të Qeverisë, për vënien në zbatim të nenit 51 të ligjit nr.9135 datë 11.09.2003 “Për mbrojtjen e konsumatorit”.	Ministrit të Ekonomisë	20.03.2006	Rekomandimi është pranuar. Po përgatitet një projektligj “siguria e përgjithshme e produkteve” ku një kapitull të veçantë do të zërë Mbikqyrja e tregut.
30	Ankesa nga shtetas të ndryshëm	Rekomandim: “Per aktet nenligjore te Ligjit Nr. 9232 date 13.05.2004 “ <i>Per programet sociale per strehimin e banoreve te zonave urbane</i> ”.	Ministrit te Pieve Publike, Trasportit e Telekomunikacioneve	29.03.2006	Rekomandimi u pranua.
31	Me iniciativën e Avokatit të Popullit.	Rekomandim: “ Për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr.9110, datë 24.07.2003 “ <i>Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Për Krime të Rënda</i> ”.	Kryeministrit.	24.05.2006	Rekomandimi u pranua. Ministria e Drejtësisë po përgatit kuartrin e nevojshëm ligjor.
32	Ankesa nga ushtarakët	Rekomandim për plotësimin e kërkesave të nenit 39 të Ligjit nr.9210 datë 23.03.2004 “Për Statusin e Ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” për kriteret e përfitimit nga ushtarakët të së drejtës së parablerjes për objektet ushtarake të dala të lira.	Ministrit të Mbrojtjes	30.05.2006	Ministria e Mbrojtjes e pranoi rekomandimin, por nuk janë dakort ministritë e tjera.
33	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: “Për shfuqizimin e Pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 87, datë 15.02.2006 “ <i>Për administrimin dhe mbulimin e shpenzimeve të recetave me rimbursim</i> ”	Kryeministrit. Ministrit të Financave, Ministrit të Shëndetësisë	21.12.2006	Rekomandimi është në shqyrtim.

Pasqyra Nr. 3

Evidenca e rekomandimeve për nxjerrje, ndryshime apo plotësime për aktet nënligjore të ministrave dhe drejtuesve të institucioneve të tjera qendrore për periudhën 2000-2006

Nr	Ankuesi	Permbajtja e rekomandimit	Kujt i drejtohet	Data e dergimit	Përfundimi
1	Subjekte private të qytetit të Korçës	Rekomandim: “Për shfuqizimin e Pikës 4 të Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë Nr. 362 datë 18.08.2000 “ <i>Mbi zbatimin e detyrave për dhënien e lejës higjeno-sanitare</i> ”.	Ministrit të Shëndetësisë	27.09.2000	Rekomandimi u pranua.
2	Ankesat e një numri të konsiderueshëm qytetarësh.	Rekomandim: “ Për masat që duhen marrë për zbatimin e Ligjit Nr. 8503 datë 30.06.1999 “ <i>Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare</i> ”, me qëllim që çdo autoritet publik të nxjerrë rregullore.	Kryeministrit. Çdo ministri edhe institucioni qendror, çdo organi të pushtetit vendor	09.11.2000 Përsëritur datë 24.01.2002	Rekomandimi është pranuar pothuajse nga të gjitha ministratë, institucionet qendrore dhe organet e pushtetit vendor.
3	Shtetasi R. R. në emër të 49 familjeve nga Tirana.	Rekomandim: “ Mbi problemin e 49 familjeve të shpronësuara nga Ujëmbledhësi i Bovillës me qëllim që projektvendimi i paraqitur të dërgohet sa më parë për shqyrtim në Këshillin e Ministrave”.	Ministrit të Punëve Publike	27.09.2000	Kthyer përgjigje pozitive më datën 19.02.2001, por megjithatë problemi nuk është zgjidhur me ndonjë akt ligjor, por me vendime gjykatë

4	Ankesa të studentëve pasuniversitarë	Rekomandim për rivendosjen e së drejtës së shkelur në lidhje me tarifat e regjistrimit për specializim pasuniversitar	Ministrit të Arsimit	12.01.2001	Pranuar. Ministri i Arsimit përgjigjet se do të ndryshojë Udhëzimin përkatës
5	Ankesa të shtetasve	Rekomandim për ndryshimin në Udhëzimin nr.39 datë 31.03.1999 të Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë	Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë	15.02.2001	Rekomandimi u pranua
6	Ankesa nga ushtarakët	Rekomandim: “Për një ndryshim në VKM Nr. 379 datë 26.06.1995 “ <i>Për privatizimin e objekteve që dalin të lira nga ristrukturimi</i> ”	Ministrit të Mbrojtjes	13.04.2001	Pranuar dhe kanë dalë VKM Nr. 524 datë 30.07.2004 dhe VKM Nr. 452 datë 09.07.2004 Për marrje kredi me interes.
7	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: “Për nxjerrjen e një udhëzimi të përbashkët, për mbajtjen e proces verbaleve të kallëzimit përsonave të keqtrajtuar nga policia jashtë shtetit”.	Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Rendit Publik	03.07.2001	Rekomandimi u pranua. Doli Udhëzimi i Përbashkët i Prokurorit të Përgjithshëm dhe i Ministrit të Rendit Publik Nr. 2037 dhe 1210 datë 23.07.2001
8	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: “ Për marrjen e masave dhe nxjerrjen e udhëzimeve që përcakton V.K.M. Nr. 335 datë 20.06.1998 “ <i>Për procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin buxhetin e shtetit</i> ”.	Ministrit të Drejtësisë. Ministrit të Financave	19.11.2001	Rekomandimi është pranuar nga Ministria e Financave, por nuk është vepruar nga Ministria e Drejtësisë
9	Ankesa të të dënuarve	Rekomandim: “ Për plotësimin e kërkesave të Ligjit Nr. 8092 datë 03.02.1996 “ <i>Për shëndetin mendor</i> ”, për të nxjerrë rregulloren “ <i>Për masat e sigurimit të personave për të cilët gjykata ka marrë masën mjekësore të mjekimit të detyruar</i> ”.	Ministrit të Shëndetësisë Ministrit të Drejtësisë	13.05.2002	Rekomandimi është pranuar. U krijua Instituti për kurimin e të dënuarve me trauma psikike e përdorusve të drogës në Krujë.

10	Ankesa të të dënuarve	Rekomandim: “Për krijimin e kushteve për funksionimin e Komisionit Mbikqyrës të Ekzekutimit të Vendimeve me Burgim, sipas kreut të tretë të Ligjit Nr. 8331 datë 21.04.1994 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.	Kryeministrit Ministrit të Drejtësisë,	11.11.2002	Pranuar Është ngritur dhe funksionon Komisioni Mbikqyrës.
11	Me iniciativën e Avokatit të Popullit	Rekomandim: “Për rritjen e objektivitetit të ekspertimeve mjeko-ligjore, në rastet e vdekjeve të shtetasve kur dyshohet se janë dhunuar nga punonjës policie apo nëpunës të shtetit”.	Instituti të Mjekësisë Ligjore.	16.01.2003	Rekomandimi u pranua. Doli Udhëzimi Nr. 22 datë 27.01.2003, i cili udhëzon kryerjen e eks- pertimit me grup eksper- tësh ku njëri duhet të jetë patjetër nga Instituti i Mjekësisë–Ligjore.
12	Ankesa e policit Q.H.	Rekomandim: “ Për përmirësimin e Urdhërit Nr. 1661 datë 08.04.2002 “Për komunikimin me media”.	Ministrit të Rendit Publik	28.05.2003	Rekomandimi u pranua në parim, por nuk u ndryshua
13	Pas një inspektimi në Spitalin psikiatrik Tiranë	Rekomandim për zbatimin e nenit 23 të ligjit nr.8092 datë 03.02.1996 “Për shëndetin mendor” në spitalin psikiatrik Tiranë për të nxjerrë një rregullore për komisionin që për ligj masat e kufizimit fizik	Ministrit të Shëndetësisë	13.06.2003	Rekomandimi pa përgjigje
14	Ankesa të punonjësve të policisë	Rekomandim: “ Për ndryshimin e urdhërit të Ministrit të Rendit Publik Nr. 1484 datë 18.06.2001, pika 14 dhe urdhër shërbimit Nr. 1172 datë 04.04.2003 të Drejtorit të Policisë së Shtetit pika 8, duke zgjatur afatin e pranimit të ankesave të punonjësve të policisë për gradat deri më 31.12.2004”.	Ministrit të Rendit Publik	16.12.2003	Rekomandimi u pranua më datën 20.01.2004.

15	Ankesa të shtetasve.	Rekomandim: “ Të rishikohen për ulje tarifat e shitjes së energjisë elektrike të miratura me vendimin e E.R.E Nr. 22 datë 30.12.2003”.	Entit Rregullator të Energjisë	12.02.2004	Rekomandimi u pranua. U ulën pjesërisht tarifat e energjisë elektrike.
16	Ankesa e shtetasit A.T.	Rekomandim: “Për revokimin e Urdhërit Nr. 191 datë 22.04.2002 dhe për mospërfshirjen në përbërje të Komisionit Qëndror të Përmirësimit Racor (KQPR-së) të antarëve të subjekteve të tjera konkurrese”	Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit	12.10.2004	Rekomandimi u pranua. Revokuar me Urdhërin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit Nr. 223 datë 12.05.2005
17	Me iniciativë të Avokatit të Popullit (Pas inspektimit në dhomat e parburgimit Berat)	Rekomandim: “Për shfuqizimin e rregullores “Për sigurimin dhe trajtimin e të parburgosurve” miratuar me Urdhërin e Ministrit të Rendit Nr. 1075/2 datë 15.09.1999 dhe urdhërimin për zbatimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Sistemit të Parburgimit”, miratuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë Nr. 3750/2 datë 23.07.2003”	Ministrit të Drejtësisë dhe të Rendit Publik	29.03.2005	Rekomandimi u pranua. Kthyer përgjigje se është përgatitur drafti i rregullores ku janë marrë në konsideratë të gjitha vërejtjet e Avokatit të Popullit
18	Ankesa e shtetasit B.V.	Rekomandim: “Për shfuqizimin e një pjese të Urdhërit Nr. 110 datë 20.04.2004 të Ministrit të Industrisë dhe Energjitikës “Mbi miratimin e strukturës së Policisë Elektrike”	Ministrit të Industrisë dhe Energjitikës. Për dajeni Kryeministrit.	31.03.2005	Nuk është kthyer përgjigje zyrtare.
19	Ankesa e shtetasit L.D.	Rekomandim: “Për bërjen e ndryshimeve në rregulloren e Institutit të Policisë Shkencore, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Rendit Publik Nr. 751 datë 16.01.2003, duke parashikuar që në rastet e ndodhjes së ngjarjeve të rënda në ambjentet e policisë ose jashtë saj, por që kanë si autorë të dyshuar punonjës policie, në kqyrjen e vëndit të ngjarjes dhe në kryerjen e veprimeve ekzaminuese të marrin pjesë dhe ekspertë privatë të specialiteteve përkatëse”.	Ministrit të Rendit Publik	30.05.2005	Rekomandimi u pranua në parim. Datë 16.02.2006 Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit sugjeron që t’i drejtohem Prokurorit të Përgjithshëm.

20	Ankesa e shtetasit L.D. Pas vetvrasjes së shtetasit A. D. në Komisarlatin e Policisë Nr. 4 Tiranë.	Rekomandim: “Për shfuqizimin e udhëzimit të Ministrit të Rendit Publik Nr. 168 datë 20.10.1993 “Për rregullat e shoqërimit të shtetasve në Komisarlate, Reparte, Posta të Policisë dhe Zyra të tjera të tyre” si dhe për përgatitjen, miratimin dhe vënien në zbatim të Rregullores së re të shoqërimit të shtetasve në zyrat e policisë	Ministrit të Rendit Publik	28.06.2005	Rekomandimi u pranua. Me urdhërin e Ministrit të rendit Publik Nr. 1749 datë 29.07.2005, u bë shfuqizimi i urdhërit të mësipërm dhe u miratua Rregullorja e Policisë së Shtetit.
21	Ankesa e shtetasit A. B.	Rekomandim: “Kërkohet shfuqizimi i nenit 10 paragrafi i tretë i Rregullores së Fakultetit Histori Filologji të Universitetit të Tiranës”	Fakultetit Histori Filologji. Rektorit të Universitetit të Tiranës.	30.06.2005	Rekomandimi u pranua. Është shfuqizuar paragrafi i tretë i nenit 10 të Rregullores.
22	Ankesa e të dënuarve Z.F. dhe Gj.R. në Burgun e Burrelit.	Rekomandim: “Për rregullimin çështjes së uljes së dënimit për të dënuarit që punojnë në burgje dhe marrja e masave për korigjimin e pasojave të aktit të nxjerrë nga Prokurori i Përgjithshëm me shkresën nr. 3223 datë 08.10.2004, dërguar Prokurorive në rrethe”.	Ministrit të Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm	22.09.2005	Rekomandimi nuk u pranua nga Prokurori i Përgjithshëm. dhe Ministri i Drejtësisë
23	Me iniciativën e Avokatit të Popullit. Vetvrasja e shtetasit A.B. në Komisarlatin e Policisë Nr. 3, Tiranë.	Rekomandim: “Për ndryshimin dhe përmirësimin e Kreut XII-të “shoqërimi i personave” të Rregullores së Shërbimeve të Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Rendit Publik Nr. 1749 datë 29.07.2005, si dhe për hartimin e Metodikës së njoftimit të akuzës dhe marrjes në pyetje të personave që dyshohen si autorë të veprave penale, ose që kanë dijeni për rrethana të hetimit”.	Ministrit të Brëndshëm.	22.12.2005	Rekomandimi u pranua në parim pjesërisht, në pikat e propozuara me shkresën e datës 20.02.2006 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

24	Ankesa e shtetases L. G. etj.	Rekomandim: “Për dispozitat e reja normative që do të miratohen, për një mbrojtje sa më të mirë si të të drejtave të personelit që kujdeset për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe të drejtave të vetë fëmijve”.	Ministrit të Arsimit.	17.01.2006	Rekomandimi u pranua në parim. Është në proces rishikimi i dispozitave normative.
25	Ankesa e shtetases E.S.	Rekomandim: “Per shpejtimin e punes per hartimin e marreveshjes shqiptaro–greke, per perfitimn e sigurimeve shoqerore nga shtetasit e te dy vendeve”	Ministrit te Punes e Çeshtjeve Sociale Ministrit te Puneve te Jashtme Drejtorit te ISSH	15.02.2006	Ka përgjigje zyrtare nga Ministri i Punës. Po punohet në këtë drejtim.
26	Me iniciativen e Avokatit te Popullit	Rekomandim: “Per pershpejtimin e procedurave per nxjerrjen e akteve nenligjore ne zbatim te Ligjit Nr. 9381 date 28.04.2005 “Per kompesimin per burgim te padrejte”.	Ministrit te Financave Ministrit te Drejtesise	27.03.2006	Rekomandimi u pranua. dhe eshte perpiluar udhezimi i perbashket.
27	Ankesa të shtetasve dhe organizatave joqeveritare	Rekomandim për mospranimin e propozimit të KESH sha për rritjen e çmimit të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë	Entit Rregullator të Energjisë	03.04.2006	E.R.E. me vendimin nr.27 datë 20.04.2006 nuk pranoi rritjen e çmimeve
28	Me iniciativen e Avokatit te Popullit	Rekomandim: “Per permiresimin e akteve nenligjore te perbashketa per kqyrjen e vendit te ngjarjes ne ambjentet e Komisariateve te Policise, paraburgimit dhe ne burgje”.	Ministrit te Brendshem Prokurorit te Pergjithshem	07.04.2006	Rekomandimi u pranua.
29	Ankesa të të dënuarve	Rekomandim: “Per konstatimin si akt administrativ absolutisht te pavlefshem te Urdherit te Drejtorit te Pergjithshem te Burgjeve Nr. 1522 te vitit 2006 “Per organizimin dhe kryerjen e takimeve speciale”.	Ministrit te Drejtesise Kryeministrit	20.04.2006	Rekomandimi u pranua pjesërisht.

30	Ankesa të shtetasve	Rekomandim: “Per rishikimin e Udhezimit Nr. 6291 date 17.08.2005 “ <i>Per Evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve noteriale si dhe per organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale</i> ”.	Ministrit te Drejtesise Dhomes Kombetare te Noterise	12.05.2006	Rekomandimi u pranua pjesërisht
31	Me iniciativen e Avokatit te Popullit.	Rekomandim: “ <i>Per krijimin e kushteve te nevojshme Per funksionimin e Komisionit te Sherbimit Alternativ</i> ”.	Ministrit te Punes e Çeshtjeve Sociale. Ministrit te Mbrojtjes	26.09.2006	Rekomandimi u pranua. Janë krijuar kushtet
32	Ankesa të Mjekëve	Rekomandim: “Per hartimin dhe nxjerrjen e rregullores Per funksionimin e Qendres Spitalore Universitare “Nene Tereza” Tirane.	Ministrit te Shendetesise, Ministrit te Arsimit	13.10.2006	Rekomandimi u pranua. Do bëhet ndryshimi.

2. Çështje të filluara me iniciativën e Avokatit të Popullit ("ex officio")

Sipas nenit 13 të Ligjit nr.8454, dt.4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", ndryshuar me ligjin nr. 9398, datë 12.05.2005 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", ndryshuar me ligjin nr. 8600, datë 10.04.2000",

Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike, por me pëlqimin e të interesuarit ose të dëmtuarit.

Në rastet kur Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes me nismën e vet dhe kur kujdestari ose përfaqësuesi i tij ligjor nuk vepron, nuk kërkohet pëlqimi i të dëmtuarit kur është i mitur apo i paafte mendërisht apo me aftësi të kufizuara ose për mbrojtjen e të drejtave të një numri të madh të individëve.

Në mbrojtje të interesave të një komuniteti të gjërë, të cilët mund të preken nga procedimi administrativ, Avokati i Popullit ka të drejtë të fillojë një procedim administrativ dhe të marrë pjesë në të, në përputhje me kërkesat e Kodit të Procedurës Administrative.

Këto ndryshime kanë hyrë në fuqi me 1 Korrik 2005. Për këtë arsye, numri i çështjeve të ndjekura me iniciativë është rritur në krahasim me vitin 2005.

Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar totali i çështjeve të filluara me iniciativë gjatë vitit 2005 dhe 2006.

	2005	2006
- Ankesa të drejta ose zgjidhur në favor	11	22
- Jashtë kompetence ose juriksionit	4	3
- Të refuzuara për shkak se nuk u bënë ankesa individuale sipas ligjit, ose gjatë shqyrtimit u tërhoqën, ose në përfundim doli se ankesa ishte e padrejtë apo e pavërtetë	2	2
- Në shqyrtim	8	8
Totali	25	35

3. Në ndjekje të rasteve të prezantuara në Raportet Vjetore 2001, 2002, 2003, 2004 dhe 2005

Disa nga rastet (*ankesa, kërkesa apo rekomandime*) që janë prezentuar në Raportet e viteve 2001 deri 2005 kanë përfunduar dhe gjatë këtij raporti janë pasqyruar në pjesët përkatëse ku trajtohet problematika e tyre. Prandaj në këtë Kre të këtij Raporti do të paraqesim shkurtimisht, disa nga rastet të cilat janë akoma në ndjekje edhe për vitin 2007.

1. Rekomandimi drejtuar Këshillit të Ministrave, që në mbrojtje të të drejtës kushtetuese të lirisë fetare të sanksionuar në nenin 24 të Kushtetutës, Këshilli i Ministrave duhet të respektojë detyrimin kushtetues të parashikuar në pikën 5 të nenit 10, në të cilin parashikohet se: “Marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare të rregullohen mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave. Këto marrëveshje ratifikohen në Kuvend”. Ky rekomandim është përsëritur disa herë dhe ende ky detyrim kushtetues nuk është realizuar.

Rezulton se megjithëse kanë kaluar 8 vjet nga miratimi i Kushtetutës së 28 nëntorit 1998, shteti shqiptar ka ratifikuar vetëm marrëveshjen me Komunitetin Katolik, me ligjin nr. 8902 datë 23.05.2002 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjellta”. Përsa i përket Komunitetit Musliman Shqiptar, Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe Kryegjyshitës Botërore Bektashiane, projekt marrëveshjet janë hartuar nga Komiteti Shtetëror i Kulteve dhe u është dërguar për komente tre entiteteve të mësipërme, para se këto projekt marrëveshje t’i paraqiten Qeverisë Shqiptare. Më 30 dhjetor 2006 Kryetari i Komitetit Shtetëror për Kultet, z. Rasim Hasanaj me kërkesën tonë, na ka informuar:

“Me urdhërin Nr.73, datë 25.04.2006 të Kryeministrit, u ngrit Grupi ndërinstitucional i punës për hartimin e projekt marrëveshjeve, i kryesuar nga Kryetari i Komitetit Shtetëror për Kultet. Në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit, brenda afateve të përcaktuara, projekt marrëveshja tip (bazë) është përfunduar dhe iu është dërguar Kabinetit të Kryeministrit dhe Ministrit të urizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, duke paraqitur edhe dy variantet e mundshme për plotësimin e kuadrit ligjor për marrëveshjet midis Shtetit dhe bashkësive fetare. Konkretisht këto variante janë:

- Pasi të miratohet nga Qeveria dhe të nënshkruhet prej saj dhe bashkësive fetare, Marrëveshja ratifikohet në Kuvend dhe mbi këtë bazë Qeveria lidh marrëveshje me secilën bashkësi fetare, sipas

veçantive të tyre. Kjo Marrëveshje do të ishte bazë edhe për hartimin e një ligji mbi fenë.

- Marrëveshja tip (bazë) iu dërgohet bashkësive fetare për njohje dhe pas një kohe të mjaftueshme fillojnë negociatat me to. Pa përfundimit të negociatave bëhet nënshkrimi i Marrëveshjes midis Këshillit të Ministrave dhe secilës prej bashkësifetare dhe pastaj kjo Marrëveshje i paraqitet Kuvendit për ratifikim.

Paralelisht me këtë punë, grupet e negocimit të ngritura posaçërisht për secilën bashkësi fetare, kanë bashkëpunuar me këto bashkësi, duke marrë versionet e përpiluara prej tyre, të cilat Grupi i Punës i ka përfshirë në tekstet e projekt marrëveshjeve, që iu janë rikthyer bashkësive fetare. Aktualisht ne jemi në pritje të një mendimi konkret mbi procedurën e negocimit përfundimtar dhe të nënshkrimit të marrëveshjeve.

Si përfundim mund të themi se, që pas daljes së Urdhërit përkatës të Kryeministrit, është bërë një punë voluminoze dhe me cilësi nga Grupi ndërinstitucional i punës dhe gjithë aktorët e tjerë që morën pjesë në këtë punë, duke bërë të mundur hartimin e versionit përfundimtar të marrëveshjes midis Shtetit dhe bashkësive fetare, gjë që përbën një ngjarje të rëndësishme në jetën fetare të vendit në përgjithësi dhe në marrëdhëniet e Shtetit me fenë në veçanti”.

Marrëveshjet e kërkuara nga neni 10 i Kushtetutës janë bërë të domosdoshme dhe urgjente, sepse duhet që në të njëjtën kohë të pajtohen interesat e shtetit tonë laik me ato të bashkësive të ndryshme fetare, me qëllim që të garantohet respektimi i bindjeve fetare të secilit person, por edhe të ruhet karakteri laik i shtetit dhe shoqërisë sonë. Në mënyrë të veçantë ne kemi rekomanduar se në këto marrëveshje duhet rregulluar kufizimi për të mosmbajtur brenda ambienteve të shkollave publike sende apo veshje që tregojnë përkatësinë fetare siç është p.sh. përvoja franceze, apo kufizime të tjera që mund të konsiderohen të nevojshme nga ekspertët e fushës. Kuptohet se këto kufizime nuk duhen lënë në diskrecionin e rregulloreve të shkollave, sepse kjo është një shprehje vullneti administrativ antikushtetuese. Në këtë mënyrë do të arrihet edhe përputhja e legjislacionit tonë me kërkesat e Konventave dhe akteve të tjera ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Qysh nga viti 2001 e në vazhdim ne kemi bërë rekomandime për tre ish kryeministrat paraardhës si dhe kemi përmendur këtë çështje në Raportet tona vjetore në Kuvend. Faktikisht të gjithë e kanë pranuar në parim Rekomandimin e mësipërm, por realisht është lidhur vetëm një marrëveshje nga tre apo katër të tilla që ne mendojmë se duhen.

Për nxitjen e këtij procesi, ja kemi kujtuar edhe Qeverisë së drejtuar nga Kryeministri Berisha në dhjetor 2005 detyrimin e plotësimit të detyrës që rrjedh nga neni 10 i Kushtetutës. Theksojmë përsëri se plotësimi i këtij detyrimi duhet shpejtuar, me qëllim që të rregullohen ligjërisht çështje të tilla siç janë propaganda fetare tek fëmijët, mbulimi i trupit dhe i kokës nga femrat, rritja e mjekrës nga meshkujt, të devijimit të riteve tradicionale të fesë islame në zona të prapambetura, por edhe ndërtimi i kryqeve, varrezave etj, pa leje në vende publike, çka mund të përbëjë një rrezik për traditën shqiptare të harmonisë fetare në të ardhmen.

2. Plotësimi i ligjit “Për të Drejtat e të Dënuarve” me aktet nënligjore për shpërblimin e punës së të dënuarve dhe ndryshime të Rregullores së Policisë së Burgjeve. Brenda vitit 2003 duhej të hartohej drafti nga Ministria e Drejtësisë. Meqënëse një gjë e tillë nuk u realizua në vitin 2003, plotësimi me akte nënligjore i ligjit të sipërcituar u fut në programin e vitit 2005. Nga verifikimet tona rezultoi se edhe në vitin 2006 nuk është bërë gjë nga Ministria e Drejtësisë.

3. Rekomandim drejtuar Kuvendit të Shqipërisë “Për përgatitjen sa më shpejt të projekteve për plotësimin e legjislacionit për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe të ambientit nga rrezatimet jo jonizuese të telefonisë celulare”. Rekomandime me të njëjtën përmbajtje, i kemi drejtuar ish Kryeministrit, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë të Transporteve. Deri tani kemi përgjigje vetëm nga Ministria e Shëndetësisë e cila shprehet dakort lidhur me faktet e parashtruara në Rekomandimin tonë dhe konfirmon krijimin e një grupi pune, i cili nuk ka arritur në një konkluzion përfundimtar për shkak të mendimeve të kundërta rreth vendosjes së njesisë rregulluese. Kurse Ministria e Drejtësisë përgjigjet se po përgatitet projektligji për sa më sipër.

4. Propozimi drejtuar Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë për ndryshimin dhe përmirësimin e Vendimit të K.M. nr.552 datë 27.11.1999 “Për trajtimin ekonomik e financiar të familjeve të punonjësve të policisë të vrarë apo plagosur për shkak të detyrës”, për t’i shtrirë efektet e zbatimit të tij nga 01 janari 1991. Ne e kemi përsëritur këtë rekomandim, por nuk kemi marrë përgjigje se është përgatitur një projekt vendim i ri dhe është futur në radhë për miratim nga Qeveria.

5. Propozimi për një ndryshim në ligjin nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, datë 08.11.2005. Pranuar në parim. Është përgatitur projektligji i ri dhe ndodhet në Kuvend për shqyrtim.

6. Rekomandimi në lidhje me përgatitjen e akteve të tjera nënligjore, në zbatim të ligjit nr.9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e Sigurimeve, risigurimeve dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime”.

7. Rekomandimi për ndryshimin dhe përmirësimin e përmbajtjes së nenit 86 të Kodit Penal, për veprën penale të torturës. Është përfshirë në projektin për ndryshime në Kodin Penal, që ndodhet për shqyrtim në kuvend.

8. Rekomandimi për rregullimin ligjor të ndërtimeve të objekteve fetare, është përfshirë në projektligjin e ri që po përgatitet “Për Urbanistikën”.

ANEKSE

1. Vlerësime dhe letra falenderimi nga qytetarët

Vlerësim nga Institucione Ndërkombëtare

Në Raportin e Ecurisë (Progress Report) të Bashkimit Europian për Shqipërinë (Nëntor 2006), konkretisht në pjesën për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, lidhur me Institucionin e Avokatit të Popullit thuhet: “Zyra e Avokatit të Popullit në Shqipëri ka luajtur një rol në rritje në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përgjithësi”.

Ky Raport, ndër të tjera, i referohet disa prej rekomandimeve të Avokatit të Popullit, si ai për përkufizimin e torturës sipas standarteve të legjislacionit ndërkombëtar; për ndëshkimin e shkelësve të të drejtave të të burgosurve dhe të ndaluarve nga policia; për ngritjen e një gjykate për të miturit; për garantimin e të drejtave të grave në përfaqësim; për të drejtat e të miturve, romëve, të personave me aftësi të kufizuara; të pronës, të punës dhe organizimit sindikalist në përgjithësi, si dhe rekomandimi për funksionimin e Komitetit Ndërministror për trajtimin e fenomenit të gjakmarrjes dhe pasojave të lidhura me të.

Letra falenderimi nga qytetarët

Avokatit të Popullit

1.

Ndjej një detyrë qytetare T’ju falenderoj për kujdesin dhe korrektësinë që treguat në lidhje me ankesën time për ndërtesën e bankës së djegur në Marsin e 1997 në Shkodër.

Sapo mora kontakt me z.Ervin Gjini drejtor i Drejtorisë Rajonale të monumenteve të kulturës në Shkodër, në lidhje me shkresën Nr.104 Prot. dt.14.12.2005, në të cilën akuzohet se pronarët, sipas marrëveshjes

paraprake, i detyrohen shtetit 4.716.847 lekë për investimin e pjesshëm të ish bankës.

Ju siguroj, sikurse e pranoi dhe vetë z.Gjini në mes pronarëve dhe Drejtorisë Rajonale të monumenteve të kulturës në Shkodër, nuk është bërë asnjë lloj marrëveshje juridiko-financiare.

Duke ju përgëzuar për vazhdimin e çështjes sa më me drejtësi dhe korrektesë.

**Ju përshëndes me nderim
Artan Benusi**

25.01.2006

Avokatit të Popullit

2.

Duke patur në konsideratë Rekomandimin e Avokatit të Popullit në adresë të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Elbasan për kthimin në vendin e mëparshëm të punës të z.Endri Kotherja dhe të korrespondencës së vazhdueshme për zbatimin e Vendimit të Komisionit të Shërbimit Civil nr.268, datë 30.12.2004 dhe Vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë me nr.32, datë 10.05.2005 në zbatim të legjislacionit shqiptar, Ju shpreh falenderimet e mia për veprimtarinë dhe kontributin Tuaj në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut e për demokracinë në tërësi.

Gjithashtu, falenderime shpreh edhe për Komisionerin z.Gëzim Lleshi dhe Nd/Komisioneren Rezana Konomi, të cilët me parashtimet dhe argumentat ligjore ndihmuan në zbatimin e vendimeve të sipërpërmendura.

Duke ju falenderuar edhe një herë për veprimtarinë Tuaj fisnike në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut!

28.04.2006

Endri Kotherja

Avokatit të Popullit

3.

Ju falenderoj së tepërmi për vlerësimin dhe ndjekjen profesionale të problemit që unë trajtoja në letrën drejtuar Institucionit Tuaj. Ju me profesionalizëm dhe humanizëm ju përkushtuat zgjidhjes në kohë të problemit. Marrja e përgjigjes nga ana Juaj që problemi që unë kam parashtruar tek Ju është në proces, më gëzon pa masë. Sigurisht që zgjidhja duhet të jepet nga qeveria që zvarrit problemin. Çfarë është ky proces zvarritës, kur unë dhe ligji jemi një dhe antiligji është ai që është pengesë e zbatimit në kohë të ligjit. Anti ligji kërkon hallakatje zvarritje të pa drejta.

Fjala proçes nuk ka vend në problemin që unë trajtoj. Problemi që unë trajtoj kërkon përkushtim, seriozitet dhe korrektësi ligjore.

U drejtova tek Ju me konsideratën e lartë si Institucion që mbron të drejtat e qytetarëve.

Ju jeni drejtësia në luftë me padrejtësitë antiligjore. Drejtësia është motivi i punës Suaj të pa lodhur profesionale në shërbim të qytetarëve, prandaj dhe njëherë, duke Ju falenderuar, kërkoj të mësoj prej Jush kush e pengon zgjidhjen në kohë të problemit.

8 Maj 2006

**Me respekt
Romeo Mikelo**

Letër falenderimi

4.

Unë e ashtuquajtura Majlinda Menaj kam paraqitur pranë Institucionit të Avokatit të Popullit një ankesë lidhur me mosmarrjen e çertifikatës së saktë nga ana e Gjendjes Civile Vlorë pasi jam e shkrurorëzuar dhe atje figuroj e martuar.

Mbas ndërhyrjes së Institucionit Tuaj pranë kësaj zyre u bë e mundur korrigjimi në rregjistrat e Gjendjes Civile Vlorë.

Dëshiroj të shpreh falenderimet e mia lidhur me zgjidhjen pozitive të problemit tim.

22.06.2006

**Me respekt
Majlinda Menaj**

Letër falenderimi

5.

Unë i ashtuquajturi Haxhi Ymeri Pinari dëshiroj të falenderoj Institucionin e Avokatit të Popullit lidhur me ankesën e bërë për problemin tim pasi u zgjidh pozitivisht në favorin tim mbas mbledhjes së bërë prej K.R.T.

09.05.2006

**Falenderimet e mia
Haxhi Ymeri Pinari**

Avokatit të Popullit

6.

Këto ditë na është dorëzuar materiali Juaj në lidhje me rekomandimin e bërë për lejimin e avokatëve në ambientet e policisë së bashku edhe me urdhërat e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë. Duke qenë se këto probleme na kishin krijuar edhe ne vështirësi në punën tonë për nismën e marrë prej jush dhe korrektesën për njoftimin e dhënë Dhoma e Avokatëve Vlorë Ju falenderon, duke shprehur në këtë rast edhe një herë konsideratat më të larta për Ju dhe Institucionin fisnik të Avokatit të Popullit.

Edhe një herë pranoni falenderimet tona.

**Për dhomën e avokatëve Vlorë
Kryetari
Avokat Kastriot Brahim Muço**

28 shtator 2006

**GAZETAT - SHTYPI I SHKRUAR
PER VITIN 2006**

NR	DATA	GAZETA	TITULLI	RUBRIKA
1	09.01.2006	KORRIERI	Avokati i Popullit: Lejet për objektet fetare t'i miratojë vetëm KRRTRSH-ja	Artikull
2	13.01.2006	ALBANIA	Dobjani: "Rrëzimi i kryqit, vepër provokative	Njoftim
3	13.01.2006	KOHA JONE	Të pushuarit nga puna, tek Avokati i Popullit	Artikull
4	13.01.2006	BALLKAN	Avokati i Popullit, dënon aktin e rrëzimit të kryqit në Bushat	Njoftim
5	13.01.2006	PANORAMA	Avokati i Popullit: Rrëzimi i kryqit vepër provokative	Njoftim
6	13.01.2006	KORRIERI	Të hiqen kryqet e paligjshme në vend	Artikull
7	18.01.2006	KOHA JONE	Dobjani: Ndërtimorët tejkalojnë kompetencat	Artikull
8	18.01.2006	TEMA	Dobjani-Di Stasi: Mbështetje të plotë për procesin e decentralizimit	Njoftim
9	18.01.2006	STANDART	Dobjani: Do të riparohen defektet ligjore	Prononcim
10	18.01.2006	ALBANIA	Avokati i Popullit pret në zyrën e tij Komisionerin European Giovanni Di Stas-in	Njoftim
11	18.01.2006	SHEKULLI	Presidenti i Pushteteve Lokale të Këshillit të Evropës, vizitë në zyrën e Avokatit të Popullit	Njoftim
12	18.01.2006	METROPOL	Avokati i Popullit pret në zyrën e tij Presidentin e Pushteteve Lokale të Këshillit të Evropës, Giovanni di Stasi	Prononcim
13	18.01.2006	DITA	Avokati i Popullit takim me Giovanni Di Stassin	Njoftim
14	18.01.2006	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit dhe Delegacioni i Këshillit të Evropës: Ndhmë për reformat e decentralizimit	Prononcim
15	20.01.2006	TEMA	Avokati i Popullit viziton Lazaratin	Njoftim
16	20.01.2006	TIRANA OBSERVER	Avokati i Popullit, takim në Lazarat	Artikull

17	20.01.2006	SHEKULLI	Gjirokastër, Dobjani, takim 6 orë me lazaratasit	Artikull
18	20.01.2006	BALLKAN	Dobjani viziton Lazaratin: Kryekomunari, na kanë dënuar për arsye politike	Artikull
19	20.01.2006	PANORAMA	Gjirokastër: Dobjani në Lazarat për ankesat	Njoftim
20	30.01.2006	PANORAMA	Avokati i Popullit kallëzoi për ndjekje penale 31 uniforma blu në shkallë vendi gjatë pesë viteve	Artikull
21	31.01.2006	SOT	Avokati i Popullit: Vakum ligjor për tarifat e telefonisë celulare	Artikull
22	01.02.2006	SOT	Të larguarit, 15 ankesa tek Avokati i Popullit	Njoftim
23	03.02.2006	"55"	Avokati i Popullit vlerësohet nga OKB	Njoftim
24	04.02.2006	KORRIERI	Mjekët: Po na kontrollojnë dosjet	Prononim Alket Jaupi
25	06.02.2006	SHEKULLI	Dobjani: Të pezullohet plotësimi i autorizimit nga mjekët e QSTU-së	Prononcim Ermir Dobjani
26	06.02.2006	PANORAMA	Avokati i Popullit: Autorizimi për pasurinë e mjekëve, i paqartë	Prononcim
27	06.02.2006	KORRIERI	Ndihmësmësueset ankohen pranë Avokatit të Popullit	Artikull
28	07.02.2006	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit: Autorizimi bie ndesh me ligjin "Për mbrojtjen e të dhënave personale"	Prononcim
29	07.02.2006	GAZETA SHQIPTARE	Dobjani ministrit Cikuli: "Pezulloni kontrollin e pasurive të mjekëve"	Prononcim
30	07.02.2006	SHEKULLI	Avokati i Popullit: Cënohet mbrojtja e të dhënave personale. Të pezullohet firmosja.	Artikull
31	08.02.2006	KORRIERI	Avokati i Popullit: Të ndryshojë përmbajtja e autorizimit	Prononcim
32	11.02.2006	SHEKULLI	Dobjani: Çamët, shteti t'i drejtohet urgjent Strasburgut	Prononcim
33	11.02.2006	BALLKAN	Avokati i Popullit sugjeron ankimim	Prononcim
34	11.02.2006	TIRANA OBSERVER	Avokati i Popullit, reagon për çështjen çame	Njoftim
35	11.02.2006	DITA	Avokati i Popullit: Ligji ndërkombëtar ka përparësi	Prononcim
36	11.02.2006	KORRIERI	Dobjani: Ligjet ndërkombëtare, përparësi me ligjet vendase	Prononcim

37	11.02.2006	KOHA JONE	Avokati i Popullit: Ligji ndërkombëtar ka përparësi	Prononcim
38	11.02.2006	ALBANIA	Avokati i Popullit: "Spekulativ, justifikimi i gjykatës greke për pronat e çamëve"	Prononcim
39	11.02.2006	GAZETA SHQIPTARE	Dobjani: Ligjet ndërkombëtare mbi ato vendase	Prononcim
40	12.02.2006	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit denoncon Berishën në Gjykatën Kushtetuese	Njoftim
41	14.02.2006	GAZETA SHQIPTARE	Avokati i Popullit dhe tre organizata: Të shfuqizohen vendimet e Qeverisë: "Padi në Kushtetuese"	Artikull
42	14.02.2006	ZERI I POPULLIT	Komiteti i Helsinkit, Avokati i Popullit dhe grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut denoncojnë qeverinë në Gjykatën Kushtetuese	Artikull
43	14.02.2006	SHEKULLI	Kërkesës së Avokatit të Popullit i janë bashkuar edhe tri OJF: "Nuk mbrojmë korrupsionin, por Kushtetutën dhe ligjet"	Njoftim
44	14.02.2006	KORRIERI	Ankim në Gjykatën Kushtetuese për vendimin e Berishës kundër "nepotizmit"	Njoftim
45	14.02.2006	"55"	Avokati i Popullit shndërrohet në OJF	Artikull
46	14.02.2006	TEMA	Avokati i Popullit: Ligji për nepotizmin antikushtetues, të shfuqizohet	Njoftim
47	14.02.2006	PANORAMA	Aleanca për të Drejtat e Njeriut ankimon pranë Gjykatës Kushtetuese tre vendime të Këshillit të Ministrave	Artikull
48	17.02.2006	TIRANA TIMES	Ombudsmani dhe OJF-të kundër vendimit të Qeverisë	Njoftim
49	18.02.2006	GAZETA SHQIPTARE	Gazeta publikon raportin e Avokatit të Popullit. Ja të gjitha shkeljet	Artikull
50	18.02.2006	GAZETA SHQIPTARE	Avokatit të Popullit: KLD të hetojë gjyqet për telefoninë	Artikull
51	18.02.2006	SHEKULLI	Avokati i Popullit, Ermir Dobjani publikon bisedën me kreun e Kongresit të Autoriteteve Lokale në KE	Artikull
52	18.02.2006	PANORAMA	Dobjani: Largime të padrejta në administratë	Njoftim
53	19.02.2006	GAZETA SHQIPTARE	Raporti i Avokatit të Popullit: Dhuna e policisë shqetësuese	Artikull

54	19.02.2006	TIRANA OBSERVER	Dosjet e Lazaratit që do të shqyrtohen	Intervistë Jorgo Dhrami
55	23.02.2006	TIRANA OBSERVER	Raporti, Historite e rralla tek Avokati i Popullit	Artikull
56	23.02.2006	TIRANA OBSERVER	Ja për çfarë janë ankuar 2300 persona në vitin 2005	Artikull
57	26.02.2006	GAZETA SHQIPTARE	Situatë interesante në vend: negociohet në Lazarat, por jo në kuvend	Artikull
58	26.02.2006	BALLKAN	Avokati i Popullit një muaj më parë negocioi me kryekomunarin për dorëzimin e të gjithë të kërkuarve	Artikull
59	28.02.2006	KORRIERI	Avokati i Popullit: Të miturit e zhdukur, riadhesime të dyshimta	Artikull
60	01.03.2006	RD	Dobjani: Gjykatat dhe prokuroria, për problemet për qytetarët	Artikull
61	01.03.2006	ALBANIA	Avokati i Popullit: "Institucionet e shtetit, këto shkelëse të mëdha të ligjeve	Njoftim
62	01.03.2006	KORRIERI	Dobjani, raport në Komisionin e Ligjeve	Njoftim
63	01.03.2006	TEMA	Avokati i Popullit, Ermir Dobjani, raporton në Komisionin e Ligjeve	Njoftim
64	01.03.2006	BALLKAN	Dobjani raporton përpara deputetëve të djathtë	Njoftim
65	01.03.2006	STANDART	Avokati i Popullit propozon sistem proporcional të pastër. Mbështet sugjerimin e Kryeministrit Sali Berisha	Artikull
66	01.03.2006	STANDART	Avokati i Popullit: Të prishen kryqet e xhamitë pa leje	Artikull
67	02.03.2006	PANORAMA	Avokati i Popullit për kinezët e arrestuar	Artikull
68	04.03.2006	SHEKULLI	Inspektoret e Avokatit të Popullit kanë vënë re mungesa në psikiatrikun e Elbasanit	Artikull
69	04.03.2006	PANORAMA	Avokati i Popullit: 320 pacientët ushqehen me 257 lekë në ditë	Artikull
70	05.03.2006	KORRIERI	Raporti i Avokatit të Popullit	Njoftim
71	05.03.2006	ALBANIA	Dobjani: "Vitin e kaluar ishin 197 ankesa për prokurorinë	Njoftim
72	05.03.2006	RD	Avokati i Popullit shprehet për zvarritje të hetimeve nga organi i akuzës	Artikull
73	06.03.2006	STANDART	Avokati i Popullit raporton në Kuvend	Njoftim

74	06.03.2006	KORRIERI	Dobjani: Gjykatat nuk japin vendime të drejta	Artikull
75	06.03.2006	"55"	Sot Kuvendi diskuton për Avokatin e Popullit	Njoftim
76	08.03.2006	TIRANA OBSERVER	Pas inspektimit në burgjet e vendit, Avokati i Popullit i dërgon letër kryeministrit Berisha	Artikull
77	09.03.2006	TIRANA OBSERVER	Avokati i Popullit i përgjigjet Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve	Prononcim Artur Lazebeu
78	10.03.2006	GAZETA SHQIPTARE	Raporti i papublikuar i Avokatit të Popullit: Në vitin 2005 kemi verifikuar 4361 dosje të ardhura nga qytetarët	Artikull
79	11.03.2006	PANORAMA	Avokati i Popullit: Takimet speciale, dhjetëra reagime nga të dënuarit	Artikull
80	12.03.2006	RD	Dobjani: Ankesa të shumta për Bashkinë e Tiranës	Artikull
81	13.02.2006	KORRIERI	Avokati i Popullit: Shqiptarët e dënuar nga drejtësia greke "në dorë" të Presidentit	Artikull
82	14.03.2006	KORRIERI	Avokati i Popullit: Zgjedhjet, skaner për numërimin e votave	Artikull
83	16.03.2006	STANDART	Dobjani, letër OSBE-së: Votat të numërohen me skaner	Artikull
84	16.03.2006	STANDART	Dobjani: "Të mbyllet spitali ortopedik!"	Artikull
85	17.03.2006	PANORAMA	Avokati i Popullit nuk lexon raportin	Njoftim
86	18.03.2006	TIRANA OBSERVER	Avokati i Popullit propozon idenë në Ministrinë e Drejtësisë	Artikull
87	22.03.2006	KOHA JONE	Avokati i Popullit: Kushtetuesja: Ligji për nepotizmin, i padrejtë	Artikull
88	22.03.2006	GAZETA SHQIPTARE	Dobjani: Ato vendime kthyen luftën e klasave	Artikull
89	24.03.2006	PANORAMA	Avokati i Popullit: Të mos rritet çmimi i energjisë	Artikull
90	24.03.2006	BALLKAN	Mjaft, peticion Avokatit të Popullit	Njoftim
91	24.03.2006	KORRIERI	Avokati i Popullit: "KESH-i ka mashtruar qytetarët me kufizimet"	Artikull
92	24.03.2006	GAZETA SHQIPTARE	Avokati i Popullit e Mjaft: Jo energjisë së shtrenjtë	Njoftim
93	24.03.2006	ALBANIA	Avokati i Popullit: "Beli dhe KESH-i mashtrojnë qytetarët dhe donatorët"	Njoftim

94	24.03.2006	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit e "Mjaft" kërkojnë transparencë nga KESH	Artikull
95	29.03.2006	KORRIERI	Autorizimi i ri për konfliktin e interesave sipas rekomandimeve të Avokatit të Popullit	Artikull
96	31.03.2006	KORRIERI	Avokati i Popullit: KESH-i, kompani e keqadministruar	Prononcim
97	31.03.2006	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit ka reaguar sërish kundër kësaj rritje të çmimit të energjisë	Artikull
98	31.03.2006	ALBANIA	Avokati i Popullit: "Rritja 17 për qind e çmimit të energjisë, mashtrim"	Artikull
99	02.04.2006	ZERI I POPULLIT	Faturat e shtrenjta, nga pensioni nuk mbetet asgjë	Artikull
100	02.04.2006	SHEKULLI	Avokati i Popullit dhe Mjaft kanë të drejte	Artikull
101	05.04.2006	TIRANA OBSERVER	Të burgosurit: Na konvertoni punën në ditë lirie	Artikull
102	06.04.2006	KORRIERI	Dobjani: Qeveria, sukses në luftën kundër krimit dhe korrupsionit	Njoftim
103	07.04.2006	PANORAMA	Inspektorët e Avokatit të Popullit në qelinë ku vdiq studenti	Artikull
104	07.04.2006	KORRIERI	Vetëvarja e Karajt: Avokati i Popullit fillon hetimet	Artikull
105	07.04.2006	TEMA	Avokati i Popullit: Nisin hetimet për vetëvarjen në paraburgim	Artikull
106	08.04.2006	TELEGRAF	Dobjani: Për një shoqëri dhe shtet sa më pak të dhunshëm	Intervistë Ermir Dobjani
107	09.04.2006	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit: Të ndërhyhet në burgjet e vendit	Artikull
108	09.04.2006	ALBANIA	Avokati i Popullit, Dobjani, raporton: "Kushtet në burgje janë skandalozë".	Artikull
109	13.04.2006	KORRIERI	Dobjani, KE: Të respektohet autonomia vendore	Njoftim
110	13.04.2006	ALBANIA	KE-ja në zyrën e Dobjanit për qeverisjen vendore	Njoftim
111	13.04.2006	ZERI I POPULLIT	Misioni evropian i monitorimit tek Dobjani për decentralizimin	Njoftim
112	14.04.2006	TEMA	Trafikantja e heroinës, padit hetuesit tek "Avokati i Popullit	Artikull
113	15.04.2006	TELEGRAF	Avokati i Popullit, kontroll në qelitë e Tiranës	Artikull

114	16.04.2006	KORRIERI	Avokati i Popullit: T'i detyrojmë zyrtarët "të mbledhin buzët"	Intervistë
115	17.04.2006	PANORAMA	Avokati i Popullit: Shkelet ligji për burgun e padrejtë	Artikull
116	18.04.2006	PANORAMA	Inspektorët e Avokatit të Popullit në takime me të dënuarit që po firmosin dokumentin e revoltës	Artikull
117	19.04.2006	ALBANIA	Avokati i Popullit: "Jemi duke monitoruar greven".	Njoftim
118	21.04.2006	KORRIERI	Dobjani shqyrton ankesat e qytetarëve	Njoftim
119	22.04.2006	GAZETA SHQIPTARE	Qytetarët, ankesa tek Avokati i Popullit	Njoftim
120	26.04.2006	GAZETA SHQIPTARE	Dobjani e Spahiu zbulojnë planin	Artikull
121	26.04.2006	GAZETA SHQIPTARE	Kërkesa e veçantë ndaj autoritetit të Emigracionit	Artikull
122	26.04.2006	BALLKAN	Autoritetet norvegjeze të Emigracionit, takim njohës me Avokatin e Popullit	Artikull
123	26.04.2006	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit dhe ZMQ: Të ulen çmimet e telefonisë celulare	Artikull
124	26.04.2006	KORRIERI	Avokati i Popullit: "Qeveritaret u shitën tek kompanitë celulare"	Artikull
125	26.04.2006	SHEKULLI	Avokati i Popullit dhe ZMQ-ja thonë se ka tentativa korrupsioni për favorizim të kompanive celulare në interkonjeksion	Artikull
126	26.04.2006	KOHA JONE	Avokati i Popullit dhe ZMQ-ja, kallëzim penal Albtelekomit	Artikull
127	26.04.2006	ALBANIA	Avokati i Popullit, padi Albtelekomit për abuzimet	Artikull
128	26.04.2006	TEMA	Dobjani: Albtelekom, po tentohet sërish vjedhja	Artikull
129	26.04.2006	PANORAMA	Strehim politik viktimave të trafikut	Artikull
130	26.04.2006	PANORAMA	ZMQ dhe Dobjani, kallëzim Albtelekomit	Njoftim
131	27.04.2006	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit: Padi Albtelekomit për marrëveshjet dhe favorizimet	Artikull
132	28.04.2006	BALLKAN	Avokati i Popullit në Gjirokastër për ankesat e qytetarëve	Njoftim
133	28.04.2006	TIRANA OBSERVER	Avokati i Popullit: Të mos shkurtohen orët e takimeve speciale	Artikull

134	28.04.2006	TIRANA OBSERVER	Xhepa: Denoncimi i Avokatit të Popullit, shkelje e rëndë	Njoftim
135	28.04.2006	TIRANA OBSERVER	Avokatit të Popullit: "Ja ankesat tona"	Njoftim
136	30.04.2006	ALBANIA	Avokati i Popullit: "Mos ua kufizoni takimet speciale të dënuarve"	Artikull
137	30.04.2006	TRIBUNA JURIDIKE	Kompleksiteti i menaxhimit të burgjeve	Artikull Skender Haluci
138	04.05.2006	ALBANIA	Avokati i Popullit: "Kushtet në burgje, skandaloze"	Artikull
139	05.05.2006	TIRANA OBSERVER	Avokati i Popullit: Kushtet e paraburgimit mundësojnë arratisje të tjera	Artikull
140	19.05.2006	BALLKAN	Dobjani, vizitë në Austri, takime me homologët	Njoftim
141	23.05.2006	ALBANIA	Dennis De Concini në Tiranë, me ftesë të Avokatit të Popullit	Njoftim
142	24.05.2006	GAZETA SHQIPTARE	Ish-senatori i SHBA në Tiranë për fëmijët e shfrytëzuar	Njoftim
143	24.05.2006	SHEKULLI	Dhuna: Komisionerët e Avokatit të Popullit vizitojnë Selimin	Njoftim
144	25.05.2006	GAZETA SHQIPTARE	Avokati i Popullit: Selimi u keqtrajtua	Artikull
145	25.05.2006	SHEKULLI	Avokati i Popullit të merrej pak me çështjen e kontratave	Artikull
146	25.05.2006	STANDART	Avokati i Popullit, letër ERE-s: Mos rritni çmimet e energjisë	Artikull
147	26.05.2006	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit: KESH të mos rrisë çmimin e energjisë	Artikull
148	26.05.2006	PANORAMA	Avokati i Popullit letër ERE: Mos miratoni çmimin e ri të dritave	Prononcim
149	26.05.2006	ALBANIA	Avokati i Popullit: "Qeveria të mos rrisë çmimin e energjisë"	Artikull
150	30.05.2006	NDRYSHJE	Avokati i Popullit kërkon rishikimin e dosjeve me paditë civile në dëm të dy operatorëve që kanë dalë gjithnjë fitues	Artikull
151	03.06.2006	ALBANIA	Avokati i Popullit: "Jo abuzimeve në fushën e prodhimit të energjisë"	Artikull
152	07.06.2006	ALBANIA	Avokati i Popullit zbulon skandalin në qelitë e Krujës	Artikull
153	09.06.2006	PANORAMA	Avokati i Popullit: "Mbroni jetën dhe familjet e gjyqtarëve të Krimeve të Rënda"	Artikull

154	21.06.2006	Shekulli	Avokati i Popullit, ende pa konkluzion per rastin Perfundi	Prononcim Jorgo Dhrami
155	21.06.2006	GAZETA SHQIPTARE	Avokati i Popullit, hetimet të rikthehen në fillimin e tyre	Prononcim Jorgo Dhrami
156	23.06.2006	SHEKULLI	Avokati i Popullit: Të përjashtohen 2 policët që shoqëruan Anarildon	Konferencë Shtypi
157	23.06.2006	KORRIERI	Avokati i Popullit: Policia shtyu të miturin në varje	Artikull
158	23.06.2006	PANORAMA	Avokati i Popullit: Të penalizohen uniformat që ndaluan Amarildo Përfundin në komisariat	Artikull
159	23.06.2006	BALLKAN	Vetëvraska e 18-vjeçarit, Avokati i Popullit përfundon hetimet	Njoftim
160	23.06.2006	ALBANIA	Prokuroria e Korçës mbyll hetimet për vetëvarjen e 18-vjeçarit	Njoftim
161	23.06.2006	ALBANIA	Dobjani i kërkon Olldashit të largojë nga puna dy policët	Artikull
162	23.06.2006	GAZETA SHQIPTARE	Raporti i Avokatit të Popullit: U ushtrua dhunë	Artikull
163	23.06.2006	TIRANA OBSERVER	Avokati i Popullit: Të largohen dy policët	Njoftim
164	23.06.2006	TEMA	Avokati i Popullit i kërkon Olldashit të ndëshkojë dy policët që morën "në pyetje" gjimnazistin	Artikull
165	23.06.2006	KORRIERI	Avokati i Popullit: Ushtarakët e pastrehë mbeten me gisht në gojë	Artikull
166	23.06.2006	STANDART	Raporti i Avokatit të Popullit: Përmirësoni ligjin kundër torturës	Njoftim
167	23.06.2006	STANDART	Dobjani: Policët e Korçës torturuan adoleshentin	Artikull
168	24.06.2006	PANORAMA	Raporti i Avokatit të Popullit, merren masa ndaj efektivëve	Artikull
169	24.06.2006	KOHA JONE	Avokati i Popullit: Rasti "Perfundi", shembull per policine.	Artikull
170	24.06.2006	GAZETA SHQIPTARE	Reagon ministria e Brendshme pas raportit të Avokatit të Popullit për fatin tragjik të 18-vjeçarit	Artikull
171	25.06.2006	TIRANA OBSERVER	Avokati i Popullit: Pezullim dy drejtuesve	Njoftim
172	25.06.2006	GAZETA SHQIPTARE	Avokati i Popullit, gati paditë për policët	Njoftim

173	27.06.2006	ALBANIA	Komiteti i Helsinkit i bashkohet nismës së Avokatit të Popullit: Të ndryshojë ligji për torturën	Njoftim
174	30.06.2006	TEMA	Lavdërim Tufa i drejtohet Dobjanit dhe "Helsinki": "Po më shkelen të drejtat!"	Njoftim
175	01.07.2006	PANORAMA	Avokati i Popullit: Viktima është pyetur për vjedhje që s'ishin në hetim	Artikull
176	01.07.2006	ALBANIA	I pandehuri Tufa i shkruan Dobjanit: "ADN-ja nuk është e imja".	Artikull
177	01.07.2006	BALLKAN	I pandehuri Tufa i kërkon ndihmë Avokatit të Popullit dhe KSHH-se	Njoftim
178	02.07.2006	BALLKAN	Avokati i Popullit dha alarmin për çmimet	Artikull
179	12.07.2006	SHEKULLI	Gjykata më e lartë në vend rrëzon tri vendimet e qeverisë për nepotizmin në administratën publike me kërkesë të Avokatit të Popullit	Artikull
180	12.07.2006	ALBANIA	Ankimi erdhi nga opozita, AP dhe Komiteti i Helsinkit	Artikull
181	13.07.2006	TEMA	AP: Te zbatohen ligjet pa shkelur të drejtat	Artikull
182	13.07.2006	GAZETA SHQIPTARE	AP: Lejoni avokatet të takojnë klientet	Njoftim
183	14.07.2006	KORRIERI	Pas Rekomandimit të AP-se, shkarkohet kreu i Permbarimit në Lushnje	Artikull
184	14.07.2006	PANORAMA	Avokati i Popullit dhe KLSH kërçet e institucioneve kushtetuese leter kërçeve të grupeve parlamentare	Artikull
185	14.07.2006	ZERI I POPULLIT	KLSH dhe Avokati i Popullit: Po çënohet pavarësia, funksionimi ynë	Artikull
186	19.07.2006	KORRIERI	Avokati i Popullit: Duhet liberalizim i tregut, miratim i metodologjisë së çmimeve dhe aktivizimi i "Eagle Mobile"	Artikull
187	19.07.2006	GAZETA SHQIPTARE	Avokati i Popullit: AMC dhe Vodafone të dëmshpërblejnë klientët	Artikull
188	19.07.2006	GAZETA SHQIPTARE	Avokati i Popullit: Çmimet e larta sepse mungon metodologjia	Artikull
189	19.07.2006	SHEKULLI	Avokati i Popullit: Ka pasur përplasje për tarifën e interkoneksionit. Pa të drejtë u shkarkua drejtori i interkoneksionit	Artikull

190	19.07.2006	KORRIERI	Avokati i Popullit: "ERT vonoi metodologjinë e tarifave, spekuluan kompanitë celulare"	Artikull
191	19.07.2006	BALLKAN	Avokati i Popullit: Çmimet e telefonisë, jashtë kontrollit	Artikull
192	19.07.2006	ALBANIA	Dobjani: "Albtelekomi, fajtor për tarifat e kripura"	Artikull
193	19.07.2006	R.D.	Avokati i Popullit: Duhet liberalizim i tregut, miratim i metodologjisë së çmimeve dhe aktivizimi i "Eagle Mobile"	Artikull
194	13.09.2006	SOT	"Avokati i Popullit", i trajtuar e i katandisur më keq se populli	Artikull
195	29.09.2006	Tirana Observer	Policia s'me jep pasaporte. Ndhme AP-se	Artikull
196	05.10.2006	Albania	AP "keshillon" policine per te paraburgosurit	Artikull
197	06.10.2006	Koha Jone	Korrupsioni, Dobjani takon Gilman	Njoftim
198	06.10.2006	Tema	AP: "Te denuarve u shkelet e drejta e votes"	Njoftim
199	06.10.2006	Gazeta Shqiptare	Antikorrupsioni, Dobjani takon Gilman	Njoftim
200	06.10.2006	Ballkan	AP takon drejtorin e antikorrupsionit	Njoftim
201	17.10.2006	Shekulli	Statuti I Qendres Spitalore Universitare eshte vetem Rregullore	Artikull
202	19.10.2006	Tirana Observer	AP nxjerr ne pah shkeljet e bera ne Burgun e Burrelit	Artikull
203	26.10.2006	Standard	Te denuarit duhet te votojne te gjithë	Njoftim
204	27.10.2006	Albania	AP: "Grate ne politike te mbrohen me ligj"	Njoftim
205	31.10.2006	Panorama	AP, 40 min debat per veshjet islame	Artikull
206	31.10.2006	Shekulli	Perfaqesues te AP-se takohen me Rektorin	Artikull
207	31.10.2006	Shqip	AP per zgjidhjet e ceshtjeve fetare	Njoftim
208	01.11.2006	Panorama	AP fton studentin me mjekerr te depozitoje ankesen	Njoftim
209	03.11.2006	Tirana Observer	AP kerkon masa per pastrimin e Bovilles	Artikull
210	05.11.2006	Standard	AP: Ndaloni abuzimet ne hipoteka	Artikull
211	08.11.2006	Panorama	Hapet Zyra e AP-se ne Shkoder	Njoftim
212	08.11.2006	Korrieri	AP shtrihet ne veri te vendit	Njoftim
213	08.11.2006	Tirana Observer	AP peruron Zyren Rajonale ne Shkoder	Njoftim

214	08.11.2006	Tema	AP: Komiteti per Gjakmarrjen nuk zbaton dot ligjet	Prononcim. E. Dobjani
215	09.11.2006	Shekulli	AP: "Te semuret te perfshihen ne listen e amnistise	Njoftim
216	10.11.2006	Shekulli	AP fillon hetimet pas rastit tragjik te femijes	Njoftim
217	10.11.2006	Shekulli	AP vuri ne levizje Prokurorine per rastin e zhdukjes se biznesmenit Remzi Hoxha	Njoftim
218	10.11.2006	Korrieri	Ja çfare iu kerkuar AP-se per rastin Remzi Hoxha	Njoftim
219	14.11.2006	BALLKAN	AP vlereson si konstruktiv Raportin e BE-se	Njoftim
220	14.11.2006	Koha Jone	AP komenton Raportin e BE-se	Njoftim
221	17.11.2006	TIRANA OBSERVER	AP inspekton ambientet e burgut te Lezhes	Njoftim
222	18.11.2006	Shqip	AP komenton trafikun e femijeve	Prononcim
223	20.11.2006	Koha Jone	AP i drejtohet ujesjellesit per kushtet higjenike	Artikull
224	21.11.2006	Gazeta Shqiptare	AP dhe KLSH ne Gjykatën Kushtetuese per Ligjin e Pagave	Njoftim
225	21.11.2006	Zeri Popullit	OSBE dhe AP kembengulin per informimin publik	Prononcim. A. Lazebeu
226	09.12.2006	Standard	AP rekomandon ndryshimin e ligjit per trajtimin e policeve te vrare e te plagosur	Artikull
227	09.12.2006	Shekulli	AP i kerkon Kryeministrit trajtim te barabarte per policet e vrare	Artikull
228	10.12.2006	Korrieri	AP kerkon sherbim pa arme ushtarak per besimtaret	Artikull
229	12.12.2006	Standard	AP kerkon ratifikimin e konventes per Personat me Aftesi te Kufizuar	Njoftim
230	12.12.2006	Zeri I Popullit	AP kerkon garantimin e te drejtave te personave me aftesi te kufizuara	Njoftim
231	13.12.2006	55	AP dhe Qeveria e pas 3 Korrikut per personat me aftesi te kufizuara	Artikull
232	16.12.2006	Panorama	AP kerkon kujdes per personat e shoqeruar ne Polici	Njoftim
233	16.12.2006	Tema	AP: Paraburgimi dhe te miturit - ende pike e dobet	Njoftim
234	16.12.2006	Ballkan	AP: Policia shkel te drejtat e njeriut gjate shoqerimit ne ambientet e saj	Njoftim

235	22.12.2006	Panorama	AP interesohet prane Ombudsmanit Kroat per shqiptaret e ndaluar nga policia	Njoftim
236	22.12.2006	Korrieri	AP-Ombudsmanit Kroat: "Mos keqtrajtoni shqiptaret e ndaluar"	Artikull
237	22.12.2006	Tema	AP-Homologut Kroat per klandestinet	Artikull
238	22.12.2006	Ballkan	AP reagon pre shqiptaret klandestine ne Kroaci	Njoftim
239	22.12.2006	Shekulli	AP:"Nderprerja e parave per te burgosurit eshte ndeshkim kolektiv	Artikull
240	23.12.2006	55	AP peruron ne Korçe Nenseksionin e Femijeve	Artikull
241	23.12.2006	Gazeta Shqiptare	Hapet ne Korçe Zyra per te Drejtat e Femijeve	Njoftim
242	23.12.2006	Korrieri	AP "iken" ne Korçe per te Drejtat e Femijeve	Artikull
243	23.12.2006	Rilindja Demokratike	Ne Korçe perurohet Nenseksioni i Femijeve	Njoftim
244	23.12.2006	Zeri I Popullit	AP; Trafiku i femijeve ne Juglindje - problem	Artikull
245	27.12.2006	Albania	AP publikon pergjigjen e Ombudsmanit Kroat per shqiptaret e ndaluar	Artikull
246	27.12.2006	Albania	AP reagoi pas njoftimeve te medias	Artikull
247	30.12.2006	Korrieri	AP kerkon heqjen e tarifes per se recetes per ilaçet e rimbursuara	Artikull
248	30.12.2006	Standard	AP kerkon qe ilaçet e rimbursuara te jepen pa tarifen 100-lekeshe	Artikull

MEDIA ELEKTRONIKE PER VITIN 2006

	ORGANI	DATA	RUBRIKA	PASQYRIMI
1	Tv.Klan, Top Channel, TVA, News 24, Vizion+	12.01.2006	Toleranca ndaj tjetrit fillon nga intoleranca ndaj vetes	Prononcim Ermir Dobjani
2	Top Channel	12.01.2006	Avokati i Popullit për shkurtimet në Administratë	Prononcim Artur Lazebeu
3	ATSH	12.01.2006	Avokati i Popullit kërkon gjetjen e autorëve të shkatërrimit të Kryqit në Bushat	Njoftim
4	TVSH, TVA, Tv.Klan, Top Channel, Vizion +, News 24	17.01.2006	Avokati i Popullit takon Presidentin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, Giovani Di Stasi	Njoftim
5	ATSH	17.01.2006	Dobjani: Vlerësoj nismën e Qeverisë për prishjen e ndërtimeve pa leje	Njoftim
6	News 24	19.01.2006	Avokati i Popullit Ditë e hapur në Lazarat	Njoftim
7	ATSH	19.01.2006	Dobjani: Do të shqyrtohen ankesat e të dënuarve Lazaratas	Njoftim
8	BBC	25.01.2006	Avokati i Popullit vizitë zyrtare në Londër	Prononcim Ermir Dobjani
9	Tv.Grek "Alter"	31.01.2006	Si i zhdukuri Greqia fëmijët shqiptarë	Emision
10	Tv.Berat, Tv.Kuçova	31.01.2006	Avokati i Popullit dhe e drejta e informimit	Njoftim
11	ATSH	01.02.2006	Dobjani takon dy përfaqësuesit e OKB për Konventën kundër torturës	Njoftim
12	TNSH	02.02.2006	Avokati i Popullit për dhunën shtetërore dhe torturën si dhe reagimet e tij në ndjekje të rekomandimeve të Komitetit Kundër Torturës në Shqipëri	Intervistë Sotiraq Nushi

13	Top Channel, TVA, NTV, Tv.Koha,	06.02.2006	Avokati i Popullit dhe "Mbrojtja e të dhënave personale"	Prononcim Alket Jaupi
14	News 24, NTV	10.02.2006	Ligji ndërkombëtar ka përparësi mbi ligjin vendas	Njoftim
15	TVSH	11.02.2006	Shteti të lëvizë për çështjen Çame	Intervistë Ermir Dobjani
16	Top Channel, TVSH, TVA, News 24, Vizion+	13.02.2006	Avokati i Popullit dhe 3 OJF kundërshtojnë vendimin e Qeverisë	Konferencë Shtypi
17	Tv.Klan,	14.02.2006	Avokati i Popullit për konfliktin e interesave	Intervistë Ermir Dobjani
18	News 24, Nesër TV	18.02.2006	Raporti i Avokatit të Popullit: Dhuna e policisë, shqetësuese	Njoftim
19	TVSH	19.02.2006	Raporti i Avokatit të Popullit: Dhuna e policisë, shqetësuese	Njoftim
20	TVSH	21.02.2006	Dhuna policore ndaj gazetarit të dënohet rreptësisht	Prononcim Artur Lazebeu
21	News 24, TVSH	27.02.2006	Avokati i Popullit për deklarimin e pasurive dhe mbrojtjen e të dhënave personale	Prononcim Artur Lazebeu
22	Tv. Alsat	28.02.2006	Avokati i Popullit për marrëveshjen midis Shqipërisë dhe Greqisë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve	Prononcim Artur Lazebeu
23	ATSH	28.02.2006	Avokati i Popullit paraqet raportin e 2005-s në Komisionin e Ligjeve	Njoftim
24	ATSH	04.03.2006	Avokati i Popullit: Gjatë 2005 ka pasur 197 ankesa për Prokurorinë	Njoftim
25	ATSH	05.03.2006	Dobjani: Qytetarët ankohen se gjykatat nuk japin vendime të drejta dhe zvarrisin proceset	Njoftim
26	Top Channel	07.03.2006	Emisioni "Fiks Fare": Avokati i Popullit për problemet e shërbimit në spitalin ortopedik	Prononcim Gëzim Lleshi
27	Tv.Koha	08.03.2006	Avokati i Popullit për problemet e fshatit Nepravishtë	Prononcim Ervin Karamuço
28	Top Channel	09.03.2006	Avokati i Popullit dhe problemet e energjise	Emisioni Shqip
29	Tv.Klan	10.03.2006	Avokati i Popullit dhe ankesat e qytetareve	Emision

30	ATSH	10.03.2006	Avokati i Popullit: Mosdhënia e lejeve të ndërtimit dhe shkelja e ligjit shqetësimet kryesore të qytetarëve për bashkinë e Tiranës	Njoftim
31	News 24, Top Channel, NTV	12.03.2006	Avokati i Popullit në përkrahje të lëvizjes "Mjaft" për tarifat e energjisë elektrike	Njoftim
32	News 24, TVSH	21.03.2006	Avokati i Popullit: Gjykata Kushtetuese ngrin tre vendimet e Qeverisë	Njoftim
33	BBC	21.03.2006	Avokati i Popullit: Gjykata Kushtetuese ngrin tre vendimet e Qeverisë	Intervistë
34	Mega TV. Greqi	22.03.2006	Avokati i Popullit kundër trafikut të fëmijëve	Emision Artur Lazebeu Ritvana Ruçi
35	TVSH, TNSH, Top Channel, Tv.Klan, Vizion+	23.03.2006	Avokati i Popullit me petition nga MJAFT për energjinë elektrike	Prononcim Ermir Dobjani
36	Top Channel	03.04.2006	Avokati i Popullit mbi gjëndjen në burgje	Emision Skënder Haluci
37	News 24, ATSH	05.06.2006	Dobjani takon reporterët e Këshillit të Europës	Njoftim
38	Top Channel	06.04.2006	Komisionerët e Institucionit të Avokatit të Popullit inspektim në burgun e sigurisë së lartë	Njoftim
39	ATSH	07.04.2006	Avokati i Popullit mbështet koalicionin për nxitjen e pjesëmarrjes së grave dhe të rinjve në politike	Njoftim
40	News 24, TVSH	06.04.2006	Avokati i Popullit mbështet koalicionin për nxitjen e pjesëmarrjes së grave dhe të rinjve në politike	Njoftim
41	ATSH	12.04.2006	Avokati i Popullit takohet me delegacionin e Këshillit të Europës	Njoftim
42	News 24, Top Channel	14.04.2006	Avokati i Popullit inspektim i befasishtëm ne Komisaritet e policisë	Prononcim Artur Lazebeu
43	Top Channel	17.04.2006	Avokati i Popullit inspektime ne Burgje	Intervistë Skender Haluci

44	TVSH, Tv.Klan	18.04.2006	Avokati i Popullit, Inspektime ne Burgje	Intervistë Skënder Haluci
45	ATSH	21.04.2006	Avokati i Popullit nis fushatën e ditëve të hapura në rrethe	Njoftim
46	ATSH, TVSH, Top Channel, Tv.Klan, TVA, TNSH, Tv.Alsat, News 24,	25.04.2006	Avokati i Popullit dhe Zyra per Mbrojtjen e Qytetarëve kërkojnë uljen e çmimeve të Telefonisë celulare	Konferencë Shtypi
47	ATSH	25.04.2006	Transparencë për marrëveshjet e interkonjeksionit	Intervistë Artur Lazebeu
48	News 24	26.04.2006	Avokati i Popullit kërkon sa do të vendosen xhepat e konsumatorëve	Prononcim Artur Lazebeu
49	Teuta Tv, Adriatik Tv	28.04.2006	Avokati i Popullit pret ankesa në Durrës	Prononcim Artur Lazebeu
50	ATSH	02.05.2006	Avokati i Popullit në turin e dytë të "Ditëve të hapura" pret ankesat e qytetarëve	Njoftim
51	Tv.Alsat	03.04.2006	Avokati i Popullit dhe problematika e tij e ditës	Intervistë Ermir Dobjani
52	Koha Tv, Gjeli Tv.	04.05.2006	Avokati i Popullit dhe çmimet e KESH	Emisioni "Ajbërg" Ervin Karamuço
53	Vizion +	12.05.2006	Vendimet e gjykatës zbatohen, nuk interpretohen	Prononcim Artur Lazebeu
54	Koha Tv	12.05.2006	Rradhë të gjata në zyrat e gjendjes civile	Prononcim Artur Lazebeu
55	Top Channel	16.05.2006	Struktura për fëmijët e trafikuar mungon ende	Prononcim Artur Lazebeu
56	ATSH	18.05.2006	Dobjani në Austri, takime me zyrtare austriakë	Njoftim
57	ATSH	22.05.2006	Dennis De Concini në Tiranë me ftesë të Avokatit të Popullit, Ermir Dobjani	Njoftim
58	News 24	23.05.2006	Dobjani dhe De Concini takojne Ministrin e Drejtësisë Bumçi dhe Kryeministrin Berisha	Njoftim
59	Tv.Alsat	24.05.2006	Marrja forcërisht e Arjan Selimit e ligjshme, keqtrajtimi jo.	Prononcim Jorgo Dhrami

60	Vizion +, Koha Tv, News 24,	01.06.2006	Avokati i Popullit rekomandon zgjidhjen e kontratës koncesionare për HEC-et lokale.	Prononcim Artur Lazebeu
61	TVSH	07.06.2006	Tarifat e telefonisë celulare	Emision Ermir Dobjani
62	Tv.Alsat	08.06.2006	Solidarizohem me protestat për tarifat e telefonisë celulare	Intervistë Ermir Dobjani
63	ATSH	13.06.2006	Avokati i Popullit dhe OSBE organizojnë takim "E drejta e medias për informim, të drejtat dhe detyrimet"	Njoftim
64	ATSH	19.06.2006	Avokati i Popullit nis shqyrtimin e vetëvrasjes së 18 vjeçarit Amarild Përfundi	Njoftim
65	ATSH, TVSH, Top Channel, Tv.Klan, TVA, TNSH, Tv.Alsat, News 24, Vizion +, Koha TV	22.06.2006	Avokati i Popullit: Të përjashtohen dy policët që keqtrajtuuan Anarildon	Konferencë Shtypi
66	Top Channel	23.06.2006	Për shfaqjen e figurave në media	Prononcim Artur Lazebeu
67	ATSH	23.06.2006	Avokati i Popullit, takon përfaqësuesit e Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit	Njoftim
68	Top Channel, Tv.Alsat	11.07.2006	Gjykata Kushtetuese shfuqizon tre vendimet e Qeverisë për nepotizmin në administratën publike me kërkesë të Avokatit të Popullit	Prononcim Artur Lazebeu
69	Top Channel	12.07.2006	Të sigurohet avokat në dhomat e paraburgimit	Prononcim Sotiraq Nushi
70	TVSH, News 24, Tv.Koha	18.07.2006	Avokati i Popullit: AMC dhe Vodafon të dëmshpërblejnë klientët	Prononcim Ermir Dobjani
71	ATSH	21.07.2006	Avokati i Popullit mirëpret ankesat në adresë të re	Njoftim
72	Tv.Alsat	09.08.2006	Avokati i Popullit për regjistrimin e zgjedhësve	Prononcim Artur Lazebeu
73	Tv.Alsat	12.08.2006	KESH të dëmshpërblejë qytetarët e dëmtuar	Prononcim Artur Lazebeu

74	News 24	14.08.2006	Të sigurohet avokat në dhomat e paraburgimit	Intervistë Sotiraq Nushi
75	Vizion +	27.08.2006	Avokati i Popullit dhe ligji kundër torturës	Prononcim Artur Lazebeu
76	TVSH	30.08.2006	Avokati i Popullit dhe Zyra e Rregjistrimit të Pasurive	Prononcim Artur Lazebeu
77	Top Channel	07.09.2006	Avokati i Popullit vazhdon me të njëjtin ritëm ankesash në zyrat e reja.	Intervistë Artur Lazebeu
78	Vizion +	25.09.2006	Te drejtat e te burgosurve	Emision. S. Haluca
79	News 24	26.09.2006	AP ne Vila 24	Emision. A.Lazebeu
80	News 24	03.10.2006	AP dhe Çeshtjet e medha	Emision. A.Lazebeu
81	TVSH, Vizion+,Top Channel, News 24, TVA, Klan	03.10.2006	AP dhe OSBE hapin projektin "Te drejtat e dukshme"	Njoftim
82	Top Channel	05.10.2006	AP:"Te denuarve tu sigurohet e drejta e votes"	Prononcim. A Lazebeu
83	ATSH	06.10.2006	AP takon Drejtorin e Antikorrupsionit, Gilman	Njoftim
84	News 24	10.10.2006	AP ne Vila 24	Emision J. Dhrami
85	Vizion+	11.10.2006	AP per te drejtat e te burgosurve	Prononcim J.Dhrami
86	News 24	17.10.2006	AP ne Vila 24	Emision G.Lleshi
87	TVSH	24.10.2006	AP kerkon qe te burgosurit te votojne te gjitha, te votohet edhe per nentitullaret e njesive vendore si dhe per menjanimin e femijeve nga mitingjet politike	Prononcim E.Dobjani
88	News 24, Vizion+	25.10.2006	AP kerkon te vendoset nje kuote zgjedhore prej 30% per grate	Prononcim. A Lazebeu
89	ATSH	26.10.2006	AP kerkon nje kuote 30% per grate ne organet vendimmarrese	Njoftim
90	Teuta TV	30.10.2006	AP ne Universitetin e Duresit per çeshtjen e shamijave	Prononcim. A. Lazebeu
91	TVSH;Top Channel;Klan	07.11.2006	AP hap Zyren Rajonale ne Shkoder	Njoftim
92	A1 Tv	09.11.2006	AP fillon hetimin e vdekjes se femijes ne spitalin e Tiranës	Njoftim
93	News 24	13.11.2006	AP vlereson Raportin e BE-se	Njoftim

94	ATSH	14.11.2006	AP komenton Raportin e BE-se per Shqiperine	Njoftim
95	A1 Tv	14.11.2006	AP dhe skandali i vdekjes se femijes ne spital	Interviste. A. Lazebeu
96	News 24	20.11.2006	AP dhe OSBE ne Peshkopi	Prononci A. Lazebeu
97	Top Channel	20.11.2006	AP dhe KLSH ne Gjykatën Kushtetuese	Njoftim
98	Top Channel	20.11.2006	AP komenton trafikun e femijeve	Emisioni Fiks Fare
99	Alsat Shkup	22.11.2006	AP ne mbledhjen e Ombudsmaneve te Ballkanit	Interviste. E. Dobjani
100	News 24	08.12.2006	AP: Trajtim i barabarte per policet e vrare para 1998	Prononcim S. Nushi
101	TVSH. News 24. Vizion +. Teuta. Koha	11.12.2006	AP, Unicef, Save the Children - Konferencë Kombetare per personat me aftesi te kufizuara	Njoftim
102	Top Channel, News 24. TVSH, Klan, Teuta, Koha	15.12.2006	AP, Prokurori i Pergjithshem dhe Drejtori i Pergjithshem i Policise terheqin vemendjen per shoqerimet ne polici	Njoftim
103	News 24	22.12.2006	AP i drejtohet Ombudsmanit te Kroacise per Imigrantet ilegale shqiptare	Njoftim
104	Top Channel, News 24, TVH	23.12.2006	AP hap Zyren Rajonale ne Korçe	Njoftim
105	Top Channel, News 24	26.12.2006	AP merr pergjigje nga Ombudsmani Kroat: "Shqiptaret do te kthehen me 10 Janar"	Prononcim. A. Lazebeu

STATISTIKE PERMBLEDHESE E MBULIMIT MEDIATIK 2006

MEDIA E SHKRUAR

a)


Artikuj	Prononcime	Njoftime	Intervista	Konferenca shtypi	Gjithsej
135	24	82	3	4	248

MEDIA ELEKTRONIKE


b)

Njoftime	Prononcime	Intervista	Emisione	Konferenca shtypi	Gjithsej
43	33	12	13	4	105

Ankesa, kërkesa dhe njoftime të trajtuara nga zyra e AP gjatë vitit 2006
Totali 3609




**Ankesa dhe kërkesa të paraqitura verbalisht pranë
Zyrës së Pritjes së Popullit gjate vitit 2005
Totali 1624**




- Ankesa verbale të regjistruara në sekretari për shqyrtim, pasi u bënë me shkrim
- Ankesa dhe kërkesa verbale, të cilave iu është dhënë përgjigje menjëherë, në zbatim të nenit 17/a dhe 17/b të ligjit.

Ankesa me shkrim te trajtuara gjate vitit 2006
Totali 2835




- Numri i ankesave të regjistruara gjatë vitit 2006
- Numri i ankesave të mbartura nga viti 2005


Mënyra e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave të përfunduara gjatë vitit 2006, pavarësisht nëse kanë qenë brenda ose jashtë juridiksionit
Totali 2623



**Mënyra e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave që kanë qenë brenda
juridiksionit gjatë vitit 2006
Totali 1431**




Gjendja e ankesave të marra në shqyrtim gjatë vitit 2006
Totali 2849




- Ankesa të përfunduara gjatë vitit 2006
- Ankesa që vazhdojnë të jenë në shqyrtim në vitin 2007


**Krahasimi i ankesave të ardhura për vitet 2000 - 2006,
(përfshirë edhe ato që ju është dhënë përgjigje menjëherë)
Totali 22118**



**Shperndarja e ankesave te regjistruara gjate vitit 2006 sipas institucioneve
Totali 2555 raste**



MEDIA E SHKRUAR PER VITIN 2006



MEDIA ELEKTRONIKE PER VITIN 2006

